AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

STUDIME

Revistë për studime filologjike

20

2013

PRISHTINË
2014

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS

STUDIME

A Review for philological Studies

20

2013

Del një herë në vit.
Published annually.

Këshilli redaktues - Editorial Board

Rexhep Ismajli - Kryeredaktor, editor-in-chief
Eqrem Basha - Sekretar, secretary
Victor A. Friedman, anëtar, member
Teuta Abrashi, anëtar, member
Mehmet Kraja, anëtar, member

Idriz Ajeti, Kryeredaktor nderi - Editor-in-chief of honour

Adresa e Redaksisë / Address:

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
Redaksia e revistës “Studime”
Rr. Agim Ramadani, p.n.
10 000 Prishtinë
Republika e Kosovës
Tel. + 381 38 249 303
Fax. + 381 38 244 636
E-mail: ashak@ashak.org

SHËNIM I REDAKSISË

Revista *Studime*, që nga nr. 1/1994 (1995) deri tek nr. 19/ 2012 (2013) mbulonte fushëveprimtarinë e seksioneve të gjuhësisë dhe të letërsisë, të shkencave shoqërore dhe të arteve. Nga nr. 20/ 2013 (2014) vijon të dalë me të njëjtin emër, *Studime*, por tani me specializim vetëm në fushat e gjera filologjike. Kështu kanë vendosur organet përkatëse të Akademisë.

Me propozim të Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë u zgjodh Redaksia e re me këtë përbërje: profesor dr. Victor Friedman, Universiteti i Chicago-s, profesore e asociuar dr. Teuta Abrashi, Universiteti i Prishtinës, akademik Mehmet Kraja, AShAK, akademik Eqrem Basha, AShAK (sekretar i Redaksisë) dhe akademik Rexhep Ismajli, AShAK (Kryeredaktor). Në këtë mënyrë, duke përfshirë me 2/5 e anëtarëve të redaksisë specialistë që vijnë nga mjedise shkencore jashtë Akademisë, Seksioni dhe Kryesia e AShAK-ut kanë dashur të theksojnë se Redaksia e kësaj reviste është e hapur ndaj komunitetit shkencor në këto fusha jo vetëm për ndihmesa, por edhe për vetë politikën e Redaksisë dhe përmbajtjen e revistës.

Kjo përbërje e Redaksisë ka vendosur që në rubrikat e revistës të rezervuara për botimin e materialeve me karakter studimor të sjellë nga ndihmesat e ofruara materiale origjinale autoriale, ndërsa në rubrikat e tjera materiale të natyrës studimore, të informimit shkencor nga veprimtarria e Akademisë, siç janë tryezat, konferencat dhe diskutimet shkencore të organizuara nga ajo në fushat e filologjisë. Natyrisht, përfshihet aty dhe rubrika e kritikave, recensioneve dhe shënimeve të ndryshme.

Të gjitha punimet studimore i shtrohen recensionimit me shkrim. Recensionet janë të natyrës konfidenciale dhe ruhen në arkivin e Redaksisë. Për ndihmesat e tjera, si Përvjetorët, materialet e veprimtarive shkencore, kritikat e recensionet, informatat, vendos vetë Redaksia.

Për materialet e këtij numri, të trashëguara nga Redaksia e përbashkët, është kërkuar mendimi i anëtarëve të Redaksisë, natyrisht, për fushën përkatëse, dhe është kërkuar konsultimi i bashkëpunëtorrëve të Redaksisë dhe të Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të AShAK-ut.

Për materialet studimore që do të botohen në vëllimet e revistës *Studime*, si dhe deri tash, nga bashkëpunëtorët e saj aktualë dhe potencialë Redaksia kërkon që, kur të dërgojnë materiale për shqyrtim, t'u përmbahen rregullave vijuese:

- materialet të jenë rezultat i studimeve origjinale vetanake;

- të mos e kalojnë vëllimin prej 8 faqesh A4, me margjina 2 cm, 2 cm, 2 cm, me font Times New Roman 12, normal;

- të kenë një Abstrakt në fillim dhe një listë deri në 10 fjalë çelës;

- të kenë një rezyme në fund;

- teksti themelor mund të jetë në gjuhën shqipe, ose në një prej gjuhëve me qarkullim ndërkombëtar (anglisht, frëngjisht, gjermanisht). Tekstet e hartuara shqip duhet të kenë një rezyme në një prej gjuhëve të cekura me qarkullim ndërkombëtar, ndërsa tekstet e hartuara në gjuhë të tjera duhet të kenë rezyme në gjuhën shqipe;

- materialet e dorëzuara duhet të jenë të radhitura në Word dhe të mos kenë asfarë formatimi; skicat duhet të dorëzohen në formën e radhitur të zakonshme për Word, por Redaksisë duhet t'i dorëzohet edhe një version me format pdf;

- nëse ka shenja të veçanta, përveç versionit pdf, Redaksisë duhet t'i dërgohen edhe referencat për fontet përkatëse, ose vetë fontet.

Redaksia konsideron se, meqenëse është ruajtur emri i revistës, në të ardhmen duhet të ruhet edhe referimi numerik i saj.

Ndërkohë, mbi bazë të propozimit të Seksionit të Shkencave Shoqërore, Kryesia e AShAK-ut ka vendosur të botohet dhe revista *Studime shoqërore*, e cila do të ketë redaksi të veçantë.

Redaksia e revistës *Studime.*

EDITORIAL NOTE

Since its first issue, No.1/1994 (published in 1995), to the issue No.19/2012 (spring 2013), the academic journal *Studime* dealt with subject matters covered by the sections of the linguistics, literature, humanities, and arts. Starting from the issue No.20 (1)/2013 (spring 2014), the journal will continue coming out with the same name, but it will be dealing exclusively with specialized topics pertaining to philological studies. This has been decided by the competent bodies of the Kosova Academy of Sciences and Arts (AShAK).

Proposed by the Section of Linguistics and Literature, a new Editorial Board has been elected, comprising: Prof Dr. Victor Friedman, University of Chicago; Associate Professor Dr. Teuta Abrashi, University of Prishtina; Academician Mehmet Kraja, AShAK; Academician Eqrem Basha, AShAK (Editorial Board secretary); and Academician Rexhep Ismajli, AShAK (Editor-in-Chief). By applying a representation quota of two-thirds of the editorial board's members being specialists from the academic community outside the AShAK, the Linguistics and Literature Section and the ASHAK Presidency wished to emphasize that the journal's editorial board is open to a broader community of scholars who can be part of the journal not only with their contributing papers but also be part the Editorial Board's policies and the contents of the journal.

This composition of the Editorial Board has decided that as of this issue of journal, the rubrics reserved to the publication of research work will be used for publishing original texts by authors. Other rubrics will include papers related to the research and other activities of Academy's activities, namely, round-table discussions, conferences, and academic debates from the field of philological studies. In addition, there will also be rubrics of critical analyses, reviews, and miscellaneous notes.

All papers will be subject to written recension/reviewing. Recensions will be of a confidential nature and will be kept in the Editorial Board's archive. The Editorial Board will decide on the publication of other texts, such as anniversaries/obituaries, reports on scientific activities, critiques, recensions, and news feeds. Associates of the Editorial Board and the AShAK's Linguistics and Literature Section have been consulted with regard to the materials published in this issue of the journal.

The Editorial Board wishes to advise the current and potential associates of *Studime* that, just like it has been the case so far, they are instructed to pursue the following rule when sending their papers for publication:

- The papers should be based on the results of individual original research;

- They should not exceed eight 8 A4 pages of 2x2 mm margins, written in 12pt normal New Times Roman font;

- The papers should have an abstract at the head and a list of up to 10 keywords;

- They should have a summary at the end;

- The body text can be either in Albanian or in one of the internationally-used languages (English, German, and French). The texts in Albanian should have as summary in one of the above-listed international languages, while the texts are in one of the foreign languages should have a summary in Albanian;

- The texts should be in plain Word format; charts should be submitted on normal Word format pages, but a copy in PDF format has to be attached as well;

- In cases the texts contain special symbols, in addition to the PDF format, the references on respective fonts or the fonts codes should be submitted to the Editorial Board.

The Editorial Board considers that since the name of the journal remains the same, its numeral references will be kept in the future as well.

In the meantime, based on a proposal by the Social Sciences (humanities) Section, the AShAK Presidency has decided to start with the publication of another academic journal, *Studime Shoqërore,* with a separate editorial board.

PËRVJETORË
ANNIVERSARIES

80 VJETORI I LINDJES SË PROFESOR DR. WILFRIED FIEDLER-IT
80TH ANNIVERSARY OF PROFESSOR DR. WILFRIED FIEDLER

Rexhep ISMAJLI

NË TRADITËN E MADHE TË ALBANOLOGJISË GJERMANE



Një nga albanologët më të njohur të kohës sonë, gjithsesi më i rëndësishmi në hapësirën gjuhësore gjermane të këtij gjysmëshekulli në kapërcyell, profesor dr. Wilfried Fiedler merret intensivisht dhe me sukses të shënuar me studimet e gjuhës shqipe, të raporteve të saj me gjuhët e Ballkanit dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi. Profesor dr. Wilfried Fiedler me punën e tij të palodhshme ka dhënë ndihmesë substanciale jo vetëm për studimet e gjuhës e për bashkëpunimin kulturor, po me këtë edhe për miqësinë midis popujve tanë.

Nga fillimet e viteve ’60 ai nuk pushon së ushqyeri opinionin shkencor me rezultate të hulumtimeve të veçanta për strukturën e gjuhës shqipe, për përdorimet dhe shtrirjen e saj, për shqipen standarde, duke i zgjeruar më tej këto vrojtime me vështrimet më të gjera ballkanistike. Me rezultatet e punës së tij, me intensitetin e preokupimeve albanistike, me përqendrimet në studimin e strukturës së shqipes së sotme, por pa lënë anash as thellimet në aspekte të veçanta diakronike, me ndihmesat për njohjen e kulturës dhe të letërsisë shqiptare në botën gjermane, me fjalorët shqip-gjermanisht e gjermanisht-shqip, me Gramatikën e madhe dhe risimtare në shumë aspekte, me mësimdhënien e frytshme të shqipes për gjermanët, profesor dr. Wilfried Fiedler hyn në radhën e të mëdhenjve të albanologjisë gjermanishtfolëse e me këtë të albanologjisë në tërësi, siç janë J. G. von Hahn, G.

Meyer, N. Jokl, M. Lambertz, që tashmë përbëjnë historinë e kësaj shkence, dhe qëndron ndër më të rëndësishmit të kësaj dijeje të kohës sonë.

I lindur më 1933 në Oberfrohna të rrethit Chemnitz (Kemnic), pas mbarimit të studimeve për sllavistikë në Universitetin e Berlinit, Wilfried Fiedler më 1955 nisi të punonte si asistent shkencor në Akademinë e Shkencave të Berlinit. Nisi të mësonte shqip pasi ishte ftuar të bashkëpunonte për studimin e këngëve çame, për të mos u ndarë më asnjëherë nga albanologjia. Nga 1959 ishte mësimdhënës i gjuhës shqipe në Universitetin Humboldt të Berlinit ndërsa nga 1968 bashkëpunëtor shkencor në Institutin Qendror për Gjuhësi të Akademisë së Shkencave të Republikës Demokratike Gjermane, ku bashkë me Oda Buchcholz udhëhiqnin grupin për studimet ballkanistike. Pas rënies së Murit të Berlinit dhe shpërbërjes së Akademisë Wilfried Fiedler nisi mësimdhënien bashkë me Martin Camajn në Universitetin e Mynihut, ku qëndroi si profesor titullar deri sa u pensionua më 1998. Pas pensionimit ai u ftua si profesor të mbante mësime të shqipes në Institutin e Studimeve të Europës Juglindore në Universitetin Friedrich Schiller të Jenës, ku vijon edhe sot. Më 1991 profesor dr. Wilfried Fiedler u zgjodh anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa më 2006 anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në botën shqiptare W. Fiedler është i pranishëm qysh nga viti 1955 në Shqipëri, pastaj kryesisht si pjesëmarrës në veprimtari shkencore herë pas here në Tiranë, ndërsa me rregull në Prishtinë qysh nga vitet ’70, pjesëmarrës shumë aktiv i Seminarit Ndërkombëtar të Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare dhe i shumë veprimtarive të tjera akademike aty. AShAK është botuesi i dy veprave madhore të W. Fiedlerit gjermanisht (*Das albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555)*, 2004, ff. 812 dhe *Die Pluralbildung im Albanischen*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2007, ff. 510).

Gramatika e shqipes

Përveç studimeve të veçanta për strukturën e shqipes dhe të gjuhëve të Ballkanit të botuara nëpër organet shkencore gjithandej, puna që e bëri më të njohur studiuesin Fiedler është vepra e përbashkët me Oda Buchholz *Albanische Grammatik,* Berlin*,* 1987, në të cilën sistemi gramatikor i shqi-

pes së sotme vështrohet në tërë gjerësinë e tij: në fonologji, në strukturën morfologjike dhe në fushën sintaksore. Pjesën për morfologjinë në këtë gramatikë, pra edhe atë për foljet, e karakterizon tendenca për të qenë shterruese sa u përket formave. Në anën tjetër, bie në sy qëndrimi risimtar në raport me gramatologjinë për shqipen në shumë aspekte të shqyrtimit të çështjeve morfologjike, sidomos në sistemin e foljeve. Në fushën e sintaksës kjo Gramatikë është gjithsesi e para për shumë aspekte të vështrimit. Kjo gramatikë sot konsiderohet ndër veprat bazë të gramatologjisë shqiptare në përgjithësi. Edhe pse synimi bazë i autorëve ka qenë të hartojnë një gramatikë sa më gjithëpërfshirëse të shqipes standarde me anime drejt gramatikës së tipit të akademive, ata me të drejtë dhe me shumë mprehtësi kanë ditur të përkapin elemente të rëndësishme të varieteteve të më hershme të shqipes letrare apo edhe të varieteteve dialektore dhe kanë ofruar kështu shpjegime plotësuese qoftë si bazë për shpjegimet e shqipes standarde, qoftë edhe si informacion për lexuesit që mund të kenë kërshëri lidhur me to.

Studimi për Buzukun

Libri i W. Fiedler-it *Das albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555)* është një monografi e gjerë dhe gjithëpërfshirëse. Si në asnjë të ngjashëm në tërë albanologjinë, në të janë shqyrtuar në mënyrë të detajuar të gjitha aspektet e sistemit foljor të gjuhës shqipe te libri i parë i botuar "Meshari "(1555). Duke u marrë me segmentin më të begatshëm të morfologjisë së shqipes, të foljeve, në veprën e Gjon Buzukut, Fiedler në fakt ka bërë një monografi shumë të gjerë për tërë gjuhën e librit të parë shqip. Për ta bërë këtë, atij i është dashur të rimerrte në detaje tepër të ndërliqshme studimet e deritashme për grafinë dhe për sistemin fonologjik të Buzukut, për të krijuar një përfytyrim të plotë të vetin për këtë sistem, që do të shërbente si bazë për hulumtimet dhe interpretimet e tij të sistemit morfologjik të foljeve. Shënimet kritike për transkriptimin bashkë me kapitullin për sistemin fonetik-fonologjik të gjuhës së Buzukut paraqesin një monografi më vete.

Pjesën për foljet në këtë vepër, që në fakt është hulumtimi i parë kështu sistematik i një segmenti të strukturës gjuhësore të Buzukut, e mbase përgjithësisht të një autori shqip, Fiedler e fillon me sistemin e formave fol-

jore sintetike, ku shtrohen në të gjitha detajet rezultatet e hulumtimit të tij për të gjitha format e kohëve dhe të mënyrëve. Tre tipat e formave foljore janë shqyrtuar nëpër tri shtyllat e mëdha semantike-sintaksore të temporalitetit, aspektualitetit-akcionalitetit, modalitetit-emocionalitetit. Si në gramatikën e shqipes së sotme, merret me format kohore 'perifrastike', me problemin e admirativit te Buzuku, për të kaluar pastaj te shqyrtimi i gjerë për format sintetike modale dhe përdorimi i tyre dhe problemet e gramatikalizimit, duke shqyrtuar çështje nga më të ndryshmet lidhur me përdorimin e formave të përbëra foljore. Nuk janë lënë anash as ndërtimet e sistemit foljor të shqipes me 'pjesëza formë-formuese', pjesoren dhe zgjerimet e saj, duke përfshirë këtu kompleksin e infinitivit dhe çështjet që lidhen me të. Në këtë vepër kemi një trajtim të gjithanshëm e shterrues për tërësinë e sistemit foljor të shqipes së Gjon Buzukut.

Mund të them se monografia e Wilfried Fiedler-it "Sistemi foljor shqip në gjuhën e Gjon Buzukut" paraqet një vepër me rëndësi të dorës së parë për studimet e shqipes në këtë fushë, përshkrimin e plotë të sistemit foljor të shqipes për një autor, gjithsesi më të rëndësishmin në fushën e foljeve. Monografia paraqet një vështrim origjinal për këtë sistem të shqipes të begatuar me shqyrtime përqasëse me tekste të tjera të vjetra dhe me gjuhën e sotme. Përtej përshkrimit të sistemit foljor të shqipes, paraqitjes së funksionimit të formave foljore, të relacioneve semantike e sintaksore, interes shkencor paraqesin vështrimet dhe komentet e shpeshta të autorit në aspektin ballkanistik. Krahasimi i formave dhe kategorive të gjuhës së Buzukut me forma dhe kategori të folmesh e dialektesh të gjuhëve të tjera ballkanike, siç mund të shihet dhe në studime të tjera të këtij autori të botuara në periodik shkencor e në botime të veçanta, rezultatet që ka shënuar ai në këto përqasje, e vënë atë në shkallën e ballkanologëve më të kërkuar.

Monografia e Wilfried Fiedler për foljet në veprën e Buzukut (1555) pasqyron shkallën më të lartë të njohjeve për këto çështje në fushën e albanologjisë. Me këtë vepër begatohet ndjeshëm buzukologjia dhe studimi i sistemit foljor të shqipes në tërësi.

Studimet për shumësin në gjuhën shqipe

Më 2006 patëm nderin të bashkëpunonim me profesor Fiedler-in rreth botimit të veprës më frymëgjatë të jetës së tij – *Die Pluralbildung im*

Albanischen, që paraqet versionin e ripunuar të disertacionit të tij të doktoratës, e që në fakt është përshkrimi dhe studimi më i plotë i shumësit në gjuhën shqipe dhe ndër më të rëndësishmit për studimet gramatikore në tërësi. Këtë studim të gjerë, sistematik e të gjithanshëm, ku jepen tipat e mundshëm të ndërtimit të shumësit në shqipen moderne, prodhimtaria e tipave të veçantë, ndryshimet tingullore gjatë procesit të formimit të tyre, ndërlidhja me aspekte të tjera formale e semantike të emrave në raport me shumësin, etj., gjithë duke i vështruar brenda shqipes standarde dhe varieteteve të tjera të shqipes ashtu si fenomene të tjera lidhur me këtë kategori gramatikore të shqipes, e shoqërojnë mbi 70 harta dialektologjike për tërë hapësirën shqipfolëse në Ballkan. Fjala është për rezultatin e një hulumtimi afatgjatë të të gjitha fenomeneve të shumësit të emrave në gjuhën shqipe, duke përfshirë formantet dhe proceset morfologjike të formimit të shumësit, shtrirjen gjeografike, informacionet për aspektet historike të studimit të shumësit dhe pasqyrimin në harta të përhapjes së fenomeneve. Gjerësia e tillë e shpjegon dhe kohëzgjatjen e studimit (kishte nisur në vitet ’60 të sh. 20 dhe formën e parë e kishte marrë si disertacion i doktoratës), ndërsa synimi për të qenë shterues sa i përket vjeljes së materialeve e eksponon qëndrimin metodologjik në fushën e studimeve gjuhësore të autorit: këtë qëndrim ai synon ta shtrijë jo në një korpus të caktuar, po përpiqet ta përfshijë gjithë gjuhën.

Historia e hulumtimit të kësaj çështjeje në albanistikë është e begatshme, por jo gjithnjë shteruese. Pas Konstantin Kristoforidhit e Sami Frashërit, që këto çështje i kishin shtruar në mënyrë përkatëse në gramatikat e tyre, formimi i shumësit në shqipen u bë objekt vështrimi që nga Gustav Meyer-i, i cili i kushtoi një punim të veçantë, e deri tek Eric Hamp, i cili po ashtu bëri një studim të veçantë të çështjes. Në këtë grup studimesh hyn vepra e gjerë e Eqrem Çabejtë mbi shumësin e singularizuar të shqipes, ndërsa në gramatika të ndryshme çështja zuri detyrimisht vend me rëndësi. Në përgjithësi studimet e kësaj çështjeje janë ndarë në asosh ku mbisundonte vështrimi sinkronik dhe përshkrues dhe në grupin tjetër me më shumë depërtime, që merret kryesisht me shqyrtimet diakronike të çështjes. Ndërkaq për depërtime serioze rindërtuese veçohen E. Çabej, Sh. Demiraj, B. Bokshi, etj.

Qëllimi që i kishte shtruar Fiedler vetes fillimisht përmblidhet në sa vijon: të jepte një indeks të plotë të mënyrave të formimit të shumësit në shqipen e kësaj kohe, duke marrë parasysh varietetet; ky indeks duhej të tregonte sa të fuqishëm janë tipat e ndryshëm, pra sa prodhimtarë janë tipat përkatës të shumësit në shqipen e sotme; karakterizimet e tipave të veçantë shtronin dhe çështjen e vështrimit të aspektit semantik; sa ndikim kishte struktura tingullore e temës lidhur me sufiksat e përzgjedhur; çfarë roli mund të kishte në këtë çështje kategoria e gjinisë; meqenëse çështja ishte shtruar për shqipen e sotme, vështrimi duhej të ishte edhe dialektologjik, ndërsa kjo e përfshinte në njëfarë mase vështrimin historik. Këtë veçori historiko-dialektologjike Fiedler-i e ka theksuar në versionin përfundimtar të veprës së tij.

Mund të thuhet se kjo vepër paraqet një model studimi nga ky aspekt i vështrimit të çështjeve të strukturës së sotme të shqipes, një vepër që studimet albanistike nuk do të mund ta anashkalojnë në të ardhmen.

Studimet ballkanistike

Në studimet e tij për shqipen vëmendjen e tërheqin sidomos ato që lidhen me sistemin foljor të saj të përkapur në të gjitha varietetet, me vështrime edhe historike, po sidomos në përqasje me gjuhët e tjera të Ballkanit.

Studimet e profesor Fiedler-it për aspektet tipologjike të shqipes kanë vlerë të dorës së parë si nismëtare në këtë fushë. Dhe ato lidhen drejtpërsëdrejti me fushën tjetër të rëndësishme për hulumtimet e tij, e që është ballkanistika. Në ndërlidhje me këto dy pika do të përmendja studimin e tij të rëndësishmëm "Ist das Albanische 'dem Typus nach', die entscheidende Sprache der ganzen balkanischen Gebiets?" (A është shqipja "sipas tipit" gjuha vendimtare e të gjithë rajonit të Ballkanit?" Në këtë studim dhe të tjerë në këto fusha, ai niset nga një konstatim gjithsesi i drejtë: në shqyrtimin e rolit të shqipes në kuadër të gjuhëve të Ballkanit nuk është më e rëndësishmja të evidentohen vetëm përbashkësitë në fushën e leksikut, madje as të numërohen qoftë dhe në mënyrë shteruese tiparet e përbashkëta të njohura si 'ballkanizma' duke sjellë shembuj nga shqipja, gjë që del e vetëkuptueshme në veprat standarde ballkanologjike. Në vend të kësaj ai propozon të përshtatet një tjetër karakterizim, një karakterizim që ai e quante

arealtipologjik. Dhe këtë e bënte duke u mbështetur tek studimi i Ernst Levy "Der Bau der europäischen Sprachen", Dublin 1942. Në këtë drejtim ai, ndryshe nga ata që në kuadër të ballkanistikës kërkojnë tiparet e vceçanta të përbashkëta, shihte më parë varësitë e ndryshueshmërisë brenda një sistemi gjuhësor dhe pastaj brenda një sistemi të përbashkët të arealit ballkanik. Më tutje ai theksonte po ashtu pamjaftueshmërinë e kuadrit të Sprachbundit ballkanik me 4 a 5 anëtarë. "Më tepër jemi të mendimit se Ballkani– krahasuar me rajonet e tjera të pjesës sonë të tokës – paraqet vetëm një ngjeshje të izoglosave të të përbashkëtave të kushtëzuara nga interferencat brenda gjuhëve të Europës dhe të hapësirës së afërt"[1]. Sipas këtij koncepcioni, do të duhej të shihnim a mos ka diçka si bërthamë areale (Arealkern), ku ndikimet e intereferencave do të shiheshin më së qarti. Në atë rast gjuhë 'vendimtare' nuk do të ishte ajo prej së cilës në radhë të parë shkojnë ndikime drejt gjuhëve fqinje, po e tillë do të ishte "ajo gjuhë që do të duhej të kishte raporte intensive interference me shumë gjuhë fqinje"[2]. Se shqipja mund të jetë gjuha 'vendimtare' ballkanike në kuptimin arealtipologjik, pra se tiparet e ndryshme do të duhej të përqendroheshin në një mënyrë specifike areale në morofologji, këtë Fiedler përpiqet ta mbështesë më së qarti në këtë mënyrë: "brenda tipave të shënuesve karakteristikë për Ballkanin në përgjithësi, tipat e shënuesve të shqipes do të duhej të kenë tendencë të jenë më të shpeshtë dhe/ ose të dëshmonin një shkallë më të lartë morfologjizimi se në gjuhët fqinje"[3]. Se shqipja shpesh qëndron në pikë kryqëzimi subarealesh të ndryshme, prandaj mund të interpretohet si "gjuha vendimtare e Ballkanit", këtë ai e sheh të përteguar në paradigmën e formave joaktive:

- egzistenca e përbashkët e formave joaktive sintetike në greqishten e re dhe në shqipen përbën një tipar shumë markant;

- te kohët e foljeve, që ndërtohen sipas parimit folje ndihmëse + folje

---

[1] "Wir sind viel mehr der Meinung, dass der Balkan lediglich – verglichen mit andere Regionen unseres Erdteils – eine Verdichtung der Isoglossen interferenzbedingter Gemeinsamkeiten innerhalb der Sprachen Europas und des angrenzenden Raums bietet".

[2] "sollte lediglich am intensivsten in Interferenzbeziehungen mit recht vielen Nachbarsprachen stehen".

[3] "Innerhalb der fuer den Balkan insgesamt charakteristischen Markertypen sollten die Markertypen des Albanischen tendenziell haeufiger sein und/ oder einen hoeheren Morphologisierungsgrad aufweisen als in den Nachbarsprachen".

e plotë në trajtë joveprore, si në të gjitha gjuhët fqinje, edhe në shqipen format veprore dhe joveprore dallohen përmes kundërvënies së foljeve ndihmëse 'habere' dhe 'esse';

- parimi i tretë i diskutuar këtu – parimi i formave me pjesëza parashtesore, si në gjuhët fqinje sllave, përdoret vetëm në lidhje me forma të caktuara, psh. të aoristit, të optativit, të admirativit, pra kategoritë e krijuara vonë; dhe lidhur me këtë e sheh tipar dallues pjesëzën u nga IE *sṷe, ndërtim që është morfologjizuar, ashtu si në pjesën perëndimore të sllavishtes ballkanike në një pozitë të ngulitur në pozitë të shtrënguar me temën e foljes, dhe jo si në sllavishten ballkanike lindore si element enklitik; në shqipen kjo mund të demonstrohet edhe në një rrethanë: perfekti *është hapur = u ka hapur*, pluskp. *ishte hapur = u kishte hapur*, perf. II *ka qenë hapur – u ka pasë hapur*.

Në të tri rastet e përmendura shqipja ka arritur shkallë më të lartë morfologjizimi, prandaj mund të themi se "grupi foljor në shqipen është ndërtuar në mënyrën më të fortë të morfologjizimit"; se ky tipar këtu del më së qarti dhe në mënyrë më konsekuente e sistematike.[4]

Studimet albanistike, fjalorët, përkthimet

Profesor Fiedler ka në dorëshkrim dhe një **Hyrje në studimet albanologjike**, që mund të gjendet në internet dhe që pret ndonjë botim klasik.

Me studimet e tij frymëgjatë, me gjerësinë e jashtëzakonshme të njohjeve gjuhësore – nga gjuhët gjermanike tek sllavet e baltiket, tek romanet e greqishtja e hungarishtja, me thellimin në hulumtimin e fenomeneve, me këmbënguljen e pashembullt në respektimin e realieve gjuhësore dhe të detajit në përgjithësi, ai ia ka dalë të na japë një sërë studimesh të dorës së parë, qëndrueshmëria e të cilave nuk zbehet. Do vënë në pah qysh tash se në tërë këtë gamë të gjerë interesash e njohjesh, studimet për gjuhën shqipe zënë gjithsesi kryet e vendit në interesimet e thelluara të profesor Fiedler-it. Duke e parë gjuhën shqipe në një kuadër më të gjerë, në një anë hapësinor ballkanik, në anën tjetër tipologjik, ai na ka sjellë dhe vijon të na i begatojë dijet dhe horizontet me njohje optimalisht të verifikuara deri në detajet më

[4] Shih W. Fiedler, Einführung in die Albanologie, f. 43-46.

të vogla dhe gjerësisht të vendosura në një tablo më të gjerë të studimeve për gjuhët moderne të Europës. Profesor Fiedler, vetë studiues i thelluar, shquhet dhe me tiparin fisnik të bashkëpunuesit të zellshëm me të tjerët në këtë punë: hulumtimet e tij për botën shqiptare kanë nisur me një bashkëpunim të veçantë me studiuesit e folklorit muzikor Doris dhe Erich Stockmann në fushën e muzikës popullore çame, për të vijuar me dr. Oda Buchcholz në studimet në fushën e gramatikës së shqipes, në përkthimet e letërsisë shqipe në gjuhën gjermane, në **Wörterbuch Albanisch-Deutsch** me O. Buchholz dhe G. Uhlisch; **Albanische Grammatik**. Leipzig 1987, ISBN 3-324-00025-4 (mit Oda Buchholz), me dr. A. Klosin në **Wörterbuch Deutsch-Albanisch**, me profesor dr. Norbert Boretzkyn, dhe sidomos në fushën e mësimdhënies së shqipes i njohur ndër shumicën e albanologëve të sotëm gjermanë.

Profesor Fiedler bashkë me O. Buchcholz njihet po ashtu si përkthyes i letërsisë shqipe në gjuhën gjermane sidomos me *Gjeneralin e ushtrisë së vdekur* dhe me *Novelat* e I. Kadaresë, me *Palimpsestin* e M. Camajt, *Tregimet shqiptare* dhe *Antologjinë e poezisë shqipe të Kosovës*, ashtu si me përkthime gjermanisht nga gjuhë të tjera sllave, baltike e hungareze.

(Fjalë e mbajtur në Konferencën Ndërkombëtare "Jehonat e së shkuarës – zërat e së ardhmes" në nderim të figurës dhe të veprës së albanologut Wilfried Fiedler më 18-19 tetor 2013 në Tiranë, me organizim të Qendrës së Studimeve Albanologjike në Tiranë dhe të Fondacionit "Konrad Adenauer" po ashtu në Tiranë).

Profesor Dr. Wilfried FIEDLER, München-Berlin-Jena

BOTIMET SHKENCORE - WISSENSCHAFTLICHE PUBLIKATIONEN[5]

I Botime autoriale, libra si njësi të veçanta bibliografike - Selbstverfasste, bibliographisch selbstständige Bücher

1. **Untersuchungen zur Pluralbildung im Albanischen**. Berlin, Humboldt-Universität. Phil. Fak., masch.-schr. Diss. 1961, 412 S., zahlreiche Karten.
2. **Das albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555).** Vorwort - Parathënie R. Ismajli, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë 2004, ISBN 9951-413-15-3.
3. **Die Pluralbildung im Albanischen**. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Vorwort R. Ismajli, Prishtinë 2007, ISBN 978-9951-413-62-6.

II Botime bashkautoriale, libra si njësi të veçanta bibliografike - Mitverfasste, bibliographisch selbstständige Bücher

1. Albanische Volksmusik. Bd. 1. Gesänge der Çamen. Berlin 1965. 302 S., m. Doris und Erich Stockmann.
2. **Wörterbuch Albanisch-Deutsch**. Leipzig 1977, 739 S., m. O. Buchholz u. G. Uhlisch; 7. Aufl. Leipzig-Berlin-München-Wien-Zürich-New York 1994.
3. **Albanische Grammatik**. Leipzig 1987, 582 S., m. O. Buchholz.
4. **Wörterbuch Deutsch-Albanisch**. Leipzig-Berlin-München-Wien-Zürich-New York 1997. 831 S., m. A. Klosi.

III Dorëshkrime në internet - Internet-Manuskripte

1. **Einführung in die Albanologie**. PDF-Datei, 4,64 MB.

IV Përkthime veprash shkencore në gjuhën gjermane - Übersetzungen von wissenschaftlichen Werken in die deutsche Sprache

1. E.I. Demina: Das Wechselverhältnis der Oppositionen perfektiver: imperfektiver Aspekt und Aorist: Imperfekt im Bulgarischen. In: **ZfSl 21** (1976), S. 751-758. (Aus dem Russischen).
2. M.M. Guchman: Die Ebenen des Satzanalyse und die Kategorie des Genus verbi. In: **Satzstruktur und Genus verbi**. Berlin 1976, S. 9-32. (Aus dem Russischen).

[5] *Gjendja - Stand: 18. 12. 2013.* Falënderojmë profesor dr. Wilfried Fiedler-in që pati mirësinë të na vinte në dispozicion këtë bibliografi të hartuar prej tij bashkë me lejen për botimin e saj.

3. V. Mathesius: Über die Notwendigkeit der Stabilität in der Literatursprache. In: **Grundlagen der Sprachkultur. Beiträge der Prager Linguistik zur Sprachtheorie und Sprachpflege**. Teil 1. Berlin 1976, S. 86-102. (Aus dem Tschechischen).
4. B. Havránek: Die Aufgaben der Literatursprache und die Sprachkultur. In: **Grundlagen der Sprachkultur...,** S. 103-141. (Aus dem Tschechischen).
5. J. Mukařovský: Über die Dichtersprache. In: **Grundlagen der Sprachkultur**...., S. 162-228. (Aus dem Tschechischen, m. I. Seehase).
6. **Tschechische Volksmärchen**. Hrsg. von J. Jech. Übersetzung und deutsche Fachbearbeitung der 2. Auflage von Wilfried Fiedler. Berlin 1984, 527 S.
7. **Slowakische Volksmärchen**. Hrsg. von Viera Gašparíková. Übersetzung Wilfried Fiedler. München 2000, 324 S. (=Die Märchen der Weltliteratur) (Diederichs), Kreuzlingen/München 2000, 324 S.

V Përkthime beletristike - Belletristische Übersetzungen

1. Pál Gál: **Vom Wassertropfen zum großen Meer**. Übersetzung aus dem Ungarischen von Wilfried Fiedler. Budapest-Berlin 1970. 40 S.
2. László Dala: **Die Geburt der Maschinen**. Übersetzung aus dem Ungarischen von Wilfried Fiedler. Budapest-Berlin 1970.
3. **Erkundungen. 8 albanische Erzähler**. Hrsg., aus dem Albanischen übersetzt und mit einer Nachbemerkung versehen von Oda Buchholz und Wilfried Fiedler. Berlin 1976, 323 S.
4. Ismail Kadare: **Der General der toten Armee**. Aus dem Albanischen von Oda Buchholz und Wilfried Fiedler. Berlin (1977), 258 S.
5. **Der bekümmerte Zweig**. Albanische Poesie in Jugoslawien. Hrsg. von A. Podrimja und S. Hamiti. Übertragen von O. Buchholz u. W. Fiedler. Prishtinë 1979, 99 S.
6. **Die Schleierkarawane**. Erzählungen von Ismail Kadare. Übers. v. O. Buchholz u. W. Fiedler. Berlin 1987. 182 S.
7. Dritëro Agolli: **Zylo oder Die abenteuerliche Reise durch die wundersame Welt von Bürokrátien**. Übers. von O. Buchholz und W. Fiedler. Kiel 1991, 288 S.
8. Martin Camaj. **Palimpsest**. Gedichte. Aus dem Albanischen von Wilfried Fiedler. München 1998. 44 S.

VI Botime në përmbledhje shkencore, manualë, leksikë, festshrifte – Veröffentlichungen in wissenschaftlichen Sammelwerken, Handbüchern, Lexika, Festschriften

1. **Lexikon der Weltliteratur**. Hrsg. von G. Steiner. Weimar 1963 (12 Artikel zur albanischen Literatur)
2. Zum Genus im Albanischen. In: **Beiträge zur Sprachwissenschaft, Volkskunde und Literaturforschung** (Steinitz-Festschrift). Berlin 1965, S. 87-102.

3. Zu einigen Problemen des Admirativs in den Balkansprachen. In: **Actes du Premier congrès international des études balkaniques et sud-est-européennes**. Sofija 1968, S. 367-369.
4. Das aromunische Verbalsystem in balkanologischer Sicht. In: **Beiträge zur rumänischen Philologie**. Hrsg. v. W. Bahner. Berlin 1968, S. 115-139.
5. **Meyers neues Lexikon**. Zweite, völlig neu erarbeitete Aufl. in achtzehn Bänden. Bd. 1 Artikel: Albanien. Literatur. S. 181-182; Albanische Sprache. S. 183; Albanistik. S. 183. Leipzig 1972.
6. Reflexiv und Medium im Bulgarischen. VII. **Miżdzynarodowy kongres slawistów. Streszczenia referatów i kommunikatów**. Warszawa 1973.
7. Die Kategorie des Genus verbi in ihrem Verhältnis zu einigen verwandten morphologischen Kategorien. In: **Satzstruktur und Genus verbi**. Berlin 1976, S. 63-94, m. R. Lötzsch und K. Kostov.
8. Die Entwicklung der Literatursprachen der Völker Südosteuropas im Zusammenhang mit den sozialen Umgestaltungen während des 19. und 20. Jahrhunderts. In: **LS, R. A, 33**. Berlin 1976, S. 1-20, m. W. Bahner, O. Buchholz u. R. Lötzsch.
9. Zur Entwicklung der neugriechischen Diglossie im 19. und 20. Jahrhundert. In: **LS, R. A, 33**. Berlin 1976, S. 46-68.
10. Die funktionell-semantische und die morphologische Kategorie des Genus verbi im Deutschen, Tschechischen und Slowakischen. In: **LS, R. A, 29/1.** Berlin 1976, S. 332-350.
11. **Lexikon fremdsprachiger Schriftsteller von den Anfängen bis zur Gegenwart**. I. Leipzig 1977. Artikel: Agolli (S. 29), Çajupi (S. 280), Fishta (S. 526), Frashëri (S. 541), Gjata (S. 596), Gjerqeku (S. 596).
12. Zur Rektion der Verben in den Balkansprachen. In: **LS, R. A, 43**. Berlin 1977, S. 1-115, m. O. Buchholz, A. Beyrer u. K. Kostov.
13. Zur Stellung der Objektzeichen in der albanischen Literatursprache der Gegenwart und bei Gjon Buzuku. In: **Akten des Internationalen albanologischen Kolloquiums Innsbruck 1972. Innsbruck 1977**. S. 433-458, m. O. Buchholz.
14. Die Kommentativität und ihr morphologischer Ausdruck im Bulgarischen und Polnischen. In: **Kategorie werbalne w języku polskim i bułgarskim**. Warszawa 1977, S. 15-22.
15. Modalität und Modalitätsausdruck im Bulgarischen, Tschechischen und Deutschen. In: **Linguistische Arbeitsberichte. 21.** Leipzig 1978, S. 136-153, m. K. Kostov.
16. Zur Herausbildung des modernen gesellschaftlichen Wortschatzes im Albanischen. In: LS, R. A, 58. Berlin 1979, S. 102-178, m. O. Buchholz
17. W. Bahner unter Mitarbeit von O. Buchholz, W. Fiedler, J. Irmscher und H. Walther: Entwicklungsrichtungen in der Herausbildung des modernen gesellschaftlichen Wortschatzes in Südosteuropa. In: **LS, R. A, 58**. Berlin 1979, S. 1-34.

18. **Lexikon fremdsprachiger Schriftsteller von den Anfängen bis zur Gegenwart. II**. Leipzig 1979. Artikel: Jakova (S. 116 f.), Kadare (S. 150), Kelmendi (S. 178); Kristoforidhi (S. 232 f.), Marko (S. 384), Mekuli (S. 415), Migjeni (S. 433), Mjeda (S. 448), Musaraj (S. 476), Noli (S. 526)
19. Условные предложения в албанском языке (на матеряале MESHARI Бузука)/ Uslovnye predloženija v albanskom jazyke (na materiale MESHARI Buzukua) [Konditionalsätze im Albanischen (am Material aus dem MESHARI des Buzuku)]. In: **Проблемы синтаксиса языков балканского ареала/** Problemy sintaksisa jazykov balkanskogo areala. Leningrad 1979, S. 226-249.
20. **Lexikon fremdsprachiger Schriftsteller von den Anfängen bis zur Gegenwart. II.** Leipzig 1980. Artikel: Rada (S. 122); Shkreli (S. 280), Shuteriqi (S. 281); Spasse (S. 330), Xoxa (S. 562), Zyko Kamberi (S. 597).
21. Mbi strukturën e sistemit foljor në gramatikat e Konstandin Kristoforidhit dhe të Sami Frashërit [Zur Struktur des Verbalsystems in den Grammatiken von Konstandin Kristoforidhi und von Sami Frashëri]. In: **Konferenca shkencore e 100-vjetorit të Lidhjes shqiptare të Prizrenit**. Prishtinë 6-7 qershor 1978. II, Prishtinë 1981; S. 69-84.
22. Collective plural forms in Albanian and Balkan Slavic. In: **Folia Slavica 4** (1981) (= Studies in Balkan Linguistics. To honor Eric P. Hamp on his sixtieth birthday), S. 263-272.
23. Възвратен и медиален залог в българския език/ Văzvraten i medialen zalog v bălgarskija ezik [Reflexiv und Medium im Bulgarischen]. In: **Езиковедската българистика в ГДР/ Ezikovedskata bălgaristika v GDR**. Sofija 1982, S. 280-297.
24. За категорията вид в балканските езици/ Za kategorijata vid v balkanskite ezici [Zur Kategorie des Aspekts in den Balkansprachen]. In: **Езиковедската бъларистика в ГДР.** Sofija 1982, S. 297-317.
25. Zum Genus im Litauischen und Albanischen. (Zusammenfassung). In: **Tarptautinė Baltistų Konferencija**. Vilnius 1985, S. 31-32.
26. Die Monatsnamen im Albanischen. Emrat e muajve në gjuhën shqipe. In: **Studime filologjike dhe pedagogjike për nder të prof.dr. Aleksander Xhuvanit.** Tiranë 1986, S. 577-616, m. O. Buchholz.
27. Zur Typologie des Futurs in den Balkansprachen. In: **Abstracts der Sektionsvorträge und Rundtischgespräche. XIV. Internationaler Linguistenkongreß**. Berlin 1987, S. 456.
28. Zur Typologie der grammatischen Interferenz zwischen den Balkansprachen im Bereich der Konnektive. In: **LS, R. A, 157**. Berlin 1987, S. 45-68.
29. Zur Arealtypologie des Konjunktivs in den Balkansprachen. In: **LS, R. A, 157.** Berlin 1987, S. 69-100.
30. Der Konjunktiv Imperfekt der Balkansprachen. (Zur Frage der Consecutio temporum und verwandter Phänomene). In: **LS, R. A, 157**. Berlin 1987, S. 101-123.

31. Formimi i shumësit të emrave femërorë dhe problemet e shqipes letrare [Die Bildung des Plurals der femininen Substantive und die Probleme der albanischen Literatursprache]. In: **Gjuha letrare shqipe dhe epoka jonë. Materiale të Konferencës shkencore mbajtur në Tiranë më 7-8 dhjetor 1984**. Tiranë 1988. S. 245-261.
32. **BI Schriftsteller-Lexikon. Autoren aus aller Welt**. Von einem Autorenkollektiv unter der Leitung von Hannelore Gärtner. Leipzig 1988 (10 Artikel zur albanischen Literatur).
33. Fenomeni morfologici dell'arbëresh sotto l'aspetto balcanologico. In: **Le minoranze etniche e linguistiche. Atti del 2º Congresso Internazionale. Piana degli Albanesi. 7/11 settembre 1988. I.** Palermo 1989, S. 299-312.
34. Zur Arealtypologie der Futurbildung in den Balkansprachen. In: **LS, R. A, 192.** Berlin 1989, S. 70-109.
35. **Encyklopédia literárnych diel**. Spracoval kolektív autorov. Zostavovatel' Libor Kněžek. Bratislava 1989. 20 Artikel zu Werken der albanischen Literatur, m. O. Buchholz.
36. **BI-Lexikon. Literaturen Ost- und Südosteuropas**. Hrsg. von L. Richter und M. Olschowsky. Leipzig 1990. Mehrere Artikel zu literarischen Strömungen in Albanien (m. O. Buchholz) sowie ein Übersichtsbeitrag "Sprachen der Region" (S. 326-335).
37. **Das neue Osteuropa von A - Z. Neueste Entwicklungen in Ost- und Südosteuropa.** Hg. Peter Rehder. 1. Aufl. München 1992; 2., verb. Aufl. München 1993. Beiträge von W.F.: *Albanien* (S. 13-43); *Albanische Literatur* (S. 43-46); *Albanische Sprache* (S. 46-48); *Armenische Sprache und Literatur* (S. 63-65); *Balkan* (S. 77-78); *Balkankriege* (S. 78-80); *Balkanpakt* (S. 80); *Balkansprachen* (S. 81); *Baltische S*prachen (S. 81); *Deutschbalten* (S. 180); *Dorpat* (S. 189); *Durrës* (S. 194); *Estnische Sprache und Literatur* (S. 208-210); *Fishta, Gjergj* (S. 213-214); *Großer Vaterländischer Krieg* (236-237); *Guslaren* (S. 239-240); *Hoxha, Enver* (S. 245-246); *Islam* (S. 255-256); *Juden* (267-270); *Kadare, Ismail* (S. 300-301); *Kaunas* (S. 314); *Kosovo-Albaner* (S. 344-346); *Lenin, Wladimir Iljitsch* (S. 371-372); *Lettische Sprache und Literatur* (S. 373-374); *Litauische Sprache und Literatur* (S. 386-388); *Marxismus-Leninismus* (S. 386-388): *Mutter Teresa* (S. 437); *Noli* (S. 445); *Osteuropa* (S. 458); *Panduren* (S. 462-463); *Shkodra* (S. 618); *Skanderbeg* (S. 626-627); *Slawen* (S. 629-630); *Slawinen* (Slavinen) (632-633); *Sprachen der Sowjetunion* (S. 665); *Stalin* (674-675); *Stalinismus* (S. 676-677); *Tirana* (S. 698-699); *Turkvölker* (S. 752-753); *Wilna* (S. 821-822).
38. Ist der Ausdruck der Negation ein balkanlinguistisch interessantes Phänomen? In: **Sprache in der Slavia und auf dem Balkan. Slavistische und balkanologische Aufsätze Norbert Reiter zum 65. Geburtstag.** Hrsg. v. U. Hinrichs, H. Jachnow, R. Lauer, G. Schubert, Wiesbaden 1993, S. 67-78.
39. Das Griechische und die anderen südosteuropäischen Sprachen. In: **Byzanz und seine Nachbarn, hrsg. von Armin Hohlweg** (= Südosteuropa-Jahrbuch. Im Namen der Südosteuropa-Gesellschaft hrsg. von Walter Althammer), München 1996, S. 235-248.

40. Einführung in die Balkanphilologie. In: **Einführung in die slavischen Sprachen**. Hrsg. P. Rehder, 3., verb. u. erw. Ausg. Darmstadt 1998, S. 347-364. 4., durchgeseh. Aufl. 2003
41. Tempus, Modus und Aspekt in den Sprachen Südosteuropas. In: **Handbuch der Südosteuropa-Linguistik**. Hrsg. von Uwe Hinrichs unter Mitarbeit von Uwe Büttner, Wiesbaden 1999, S. 487-517.
42. *Konceptet e Kristoforidhit për strukturën e fonetikës dhe të morfologjisë së shqipes. 9 Computer-Seiten. Im Druck. in Elbasan (??).*
43. Die albanische Sprache, ihre Geschichte und die Geschichte ihrer Erforschung. In: **Albanien. Reichtum und Vielfalt alter Kultur**. Hrsg. v. Staatl. Museum für Völkerkunde München, 2001, S.105-111.
44. Zu Problemen der zweisprachigen albanisch-deutschen Wörterbücher. In: **Sprachwandel und Lexikographie**. Hg. von B. Kunzmann-Müller und M. Zielinski. Frankfurt a. M. 2002, S. 21-35.
45. Albanisch. In: **Variationstypologie/Variation Typology.** Ein sprachtypologisches Handbuch der europäischen Sprachen in Geschichte und Gegenwart/ A Typological Handbook of European Languages Past and Present. Hrsg. von/ Edited by Thorsten Roelcke. Berlin, New York: de Gruyter, 2003. XV, 1047 S., S. 749-797.
46. Die albanische Sprache und ihre Standardisierung. In: **Österreichische Osthefte 45** (2003) 1/2, 227-241 oder in: **Albanien. Geographie-Historische Anthropologie-Geschichte-Kultur-Postkommunistische Transformation.** Hrsg. Peter Jordan, Karl Kaser, Walter Lukan, Stephanie Schwandner-Sievers, Holm Sundhausen (= Osthefte. Sonderband 17. Wien, Frankfurt a.M. et al. 2003, S. 227-241.
47. Der südosteuropäische Typus des grammatischen Analytismus - die "balkanische Partikelkonstruktion" im Verbalsystem. In: **Die europäischen Sprachen auf dem Wege zum analytischen Sprachtyp.** Hrsg. v. Uwe Hinrichs unter Mitarbeit von Uwe Büttner = Eurolinguistische Arbeiten. Hrsg. Uwe Hinrichs. Bd.1, Wiesbaden 2004, 484 S., S. 363-398.
48. Disa probleme në lidhje me përdorimin e alfabeteve të ndryshme në përkthimet e Kristoforidhit. In: **Republika e Maqedonisë. 95-vjetori i Kongresit të Manastirit. Shkup 16-18 nëntor 2003**. Shkup 2005, S. 60-74.
49. *Disa mendime të reja në lidhje me trajtat e admirativit te Buzuku. 15 Computer-Seiten. Im Druck in Tirana.* ??
50. Zu einigen Problemen der Negation in der Sprache Buzukus. In: **Nach 450 Jahren. Buzukus "Missale" und seine Rezeption in unserer Zeit**. Hrsg. Bardhyl Demiraj (= Albanische Forschungen. Band 25), Wiesbaden 2007, 328 S., S. 27-41.
51. Disa mendime rreth sistemit rasor të gjuhës shqipe. In: **Studime Filologjike Shqiptare. Konferencë shkencore, 21-22 nëntor 2007**. Prishtinë 2008, S. 81-90.
52. Die *crux* mit der Wiedergabe des albanischen Schwa. In: B. Demiraj (Hrsg.): **Der Kongress von Manastir - Herausforderung zwischen Tradition und Neuerung in der albanischen Schriftkultur**. Hamburg 2009, S. 153-174.

53. Disa tipare të përbashkëta në strukturën e morfo-sintaksës së shqipes dhe të greqishtes. In: **Çështje të studimeve diakronike të shqipes. Materialet e Konferencës shkencore, 6 korrik 2009**. Prishtinë 2010, S. 41-56.ISBN 978-9951-413-88-6.
54. Der Ablativ bei Martin Camaj. In: B. Demiraj (Hrsg.): **Wir sind die Deinen.** Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet. Wiesbaden 2010, S. 238-276.
55. Der "Dialektatlas der Albanischen Sprache" (ADGjSh) und die Pluralbildung der Substantive/Plural formation in Albanian and the "Dialect Atlas of the Albanian Language". In: G. Belluscio & A. Mendicino (Hrsg.): **Scritti in onore di Eric Pratt Hamp per il suo 90. compleanno**. o.O. o.J. S. 91-108.
56. **Zur Frankophonie im albanischen Sprachgebiet**. Im Druck in Chişinău [?]. 6 Computer-Seiten.
57. Tendencat e formimit të shumësit në shqipen e sotme. In: **Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit**. Tiranë 2011. S. 145-158.
58. Zur historischen Lexikographie des Albanischen. In: **Lexicographica**. Band 27. Hrsg. v. Gouws, Rufus H./ Heid, Ulrich/ Schierholz, Stefan/ Schweickard, Wolfgang/ Wiegand, Herbert Ernst. Berlin 2011. S. 183-194.
59. Gedanken zum Seminar in Ibë 2008. In: P**ërrallë dimri. ABC e vogël e përkthimit letrar. Ein Wintermärchen. Kleine Fibel der literarischen Übersetzung**. Tiranë 2011. S. 26-31.
60. Der Komplex des Genus verbi (=der Diathese) und der verwandten morphologischen und funktional-semantischen Kategorien im Deutschen und Albanischen. In: **Përrallë dimri**... S. 32-53.
61. Zur Morphologie des albanischen Admirativs - eine historisch-balkanologische Untersuchung. In: **Aktuelle Fragestellungen und Zukunftsperspektiven der Albanologie**. Hg. von Bardhyl Demiraj. Wiesbaden 2012. S. 29-93.
62. Disa veçori tipologjike të urdhërores në gjuhët ballkanike. In: **Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit/ Albanian and Balkan Languages**. Hg. von Rexhep Ismajli. Prishtinë 2012. S. 101-117.
63. Heteroprosopie bei nichtfiniten Konstruktionen als balkanisches Phänomen (gemeinsam mit N. Boretzky) In: B. Rugova (Red.): **Studime për nder të Rexhep Ismajlit me rastin e 65-vjetorit të lindjes. Prishtinë 2012**. S. 121-150.
64. Gjuha e Gjon Buzukut nga këndvështrimi i gjuhësisë ballkanike. In: **Poeta nascitur, historicus fit - ad honorem Zef Mirdita**. Hgrs. Albert Ramaj. Zagreb 2013.S. 771-784.

VII Botime në revista shkencore - Veröffentlichungen in wissenschaftlichen Zeitschriften

1. Disa çështje të metrikës së këngëve popullore çame [Einige Fragen der Metrik çamischer Volkslieder]. In: **GjA 2** (1965), S. 319-322.

2. In memoriam: Maximilian Lambertz. In: **GjA 2** (1965), S. 331-340.
3. Zu einigen Problemen des albanischen Admirativs. In: **Wiss. Zs. d. K.-M.-**Univ. Leipzig 1966/3, S. 561-566.
4. Franz Bopps Verdienste um die Erforschung der albanischen Morphologie. In: **Wiss. Zs. d. Humboldt-Univ. Berlin, Ges.-Sprachw. Reihe 18** (1969), S. 313.
5. Zur Kategorie des Aspekts in den Balkansprachen. In: **ZfSl 15** (1970), S. 60-77.
6. Zur Verbreitung eines grammatischen Morphemtyps. Südslawisch *neka, nek* und typologisch Verwandtes. In: **ZfSl 16** (1971), S. 58-67.
7. Reflexiv und Medium im Bulgarischen. In: **ZfSl 17** (1972), S. 380-393.
8. Interferenzbedingte grammatische Synonymie und Homonymie. Zu den Perfektbildungen in westmakedonischen Mundarten. In: **ZfSl 17** (1972), S. 62-88.
9. Zhvillimi i infinitivit gegë nga aspekti i ballkanologjisë [Die Entwicklung des gegischen Infinitivs aus balkanologischer Sicht]. In: **GjA. Seria e Shkenc. filol. V**-1975 (1976), S. 27-49.
10. Die Pluralbildung bei den türkischen Elementen des Albanischen. In: **Балканско езикзознание/ Balkansko ezikoznanie - Linguistique Balkanique XX/1-2** (Sofija 1977), S. 125-145.
11. Supletivizmi në sistemin foljor të gjuhës së Buzukut [Der Suppletivismus im Verbalsystem der Sprache Buzukus]. In: **GjA 7 (1977**), S. 159-181.
12. Maksimilian Lamberci [Maximilian Lambertz]. In: **SKShH** 4, Prishtinë 1978, S. 317-320.
13. Rreth formimit të leksikut shoqëror në gjuhën shqipe [Zur Herausbildung des gesellschaftlichen Wortschatzes im Albanischen] I. In: **Përparimi**, Prishtinë 1980, 3, S. 311-340; II. In: **Përparimi**, Prishtinë 1980, 4, S. 477-512, m. O. Buchholz.
14. Rreth zhvillimit të disa termave politiko-shoqërore në gjuhën shqipe para vitit 1912 [Zur Etwicklung einiger gesellschaftlich-politischer Termini im Albanischen vor dem Jahr 1912]. In: **GjA 10** (1980), S. 55-73.
15. Rreth gramatikës së Gjergj Pekmezit dhe të Maksimilian Lambertzit [Zur Grammatik von G. Pekmezi und M. Lambertz]. In. **SNdSh 6**, Prishtinë 1980, S. 175-178.
16. Zur Herkunft der albanischen synthetischen Nichtaktivformen. In: **ZPSK** 34 (1981), S. 534-543.
17. Nachruf: Eqrem Çabej. In: **ZPSK** 34 (1981), S. 591-593, m. O. Buchholz.
18. Zum Ausdruck der Handlungsphasen im Deutschen und in den süd- und westslawischen Sprachen. In: **ZfSl 26** (1981); S. 54-57, m. W. Duda u. B. Müller.
19. Disa mendime rreth sistemit të genus verbi-t në gjuhët ballkanike [Gedanken zum System des Genus verbi in den Balkansprachen]. In: **SNdSh 7** (1982), S.187-200.
20. Probleme des Vergleichs von Satzmodellen des Albanischen und Deutschen. In: **ZPSK 35** (1982), S. 379-387, m. O. Buchholz.
21. Disa aspekte në lidhje me zhvillimin e terminologjisë së gjuhësisë në gjuhën shqipe [Einige Aspekte in Verbindung mit der Entwicklung der sprachwissenschaftlichen Terminologie im Albanischen]. In: **SNdSh 7** (1984), S. 107-111.

22. Struktura e kategorisë së kohës në gjuhët e Ballkanit. [Die Struktur der Kategorie des Tempus in den Sprachen des Balkans]. In: **GjA 14** (1984), S. 45-65.
23. Formes verbales analytiques de type "balkanique" dans l'histoire de la langue albanaise. In: Recherches Albanologiques. 2 (1985), Prishtinë, S. 45-68.
24. Për çështjen e shënjimit të kuantitetit të zanoreve në gjuhën e Buzukut [Zur Frage der Bezeichnung der Vokalquantität in der Sprache Buzukus]. In: **GjA 16** (1986), S. 41-56.
25. Zum Verhältnis von arealer Linguistik und Arealtypologie (am Beispiel der Balkansprachen). In: **ZPSK 42** (1989), 3, S. 306-323.
26. Zur Struktur der Kategorie des Tempus in den Balkansprachen. In: **Recherches Albanologiques. 4** (1990), S. 43-65.
27. *[Zanoret hundore në gjuhën e Konstantin Kristoforidhit [Die Nasalvokale in der Sprache Konstantin Kristoforidhis]. Manuskript 20 S. Bereits in Prishtinë erschienen?]*
28. Ist das Albanische, "dem Typus nach", die entscheidende Sprache des ganzen balkanischen Gebietes? In: **Albanica 3-4.** Winter 1992. Washington, DC, 1992, S. 78-95.
29. In memoriam Martin Camaj. In: **Zs. f. Balkanologie** 29/1, S. 52-54.
30. Zgjedhimi i katërt dhe gjuha e Buzukut. In: **Studime. 12** (2005), S. 23-32.
31. Zum Neutrum im Albanischen und Baltischen. In: **Studime. 14** (2007), S. 33-49.
32. *Selman Riza dhe habitorja e shqipes. In: **Studime 16-17** (2010), S. 43-48.

VIII Recensione - Rezensionen

1. Český lid. In: **DJbfVk 3** (1957), S. 565-566.
2. L. Newmark: Structural Grammar of Albanian. In: **Zs.f.Phon.u.allg. Sprachw**. 11(1958), S. 263-265.
3. Polska sztuka ludowa. In: **DJbfVk 4** (1958), S. 590-592.
4. A.E.Graf: 6000 deutsche und russische Sprichwörter. In: **DJbfVk 4** (1958), S. 569-570.
5. Bajki Warmii i Mazur. In: **DJbfVk** 4 (1958), S. 239-240.
6. M. Lambertz: Lehrgang des Albanischen. In: **Zs.f.Phon.u.allg.Sprachw**.
7. M. Lambertz: Die Volksepik der Albaner. In: **DJbfVk 6** (1960), S. 499
8. H. Peukert: Serbokroatische und makedonische Volkslyrik. In: **DLZ 84** (1963), S. 458
9. T. Hoffmann: A gabonaneműek nyomtatása a magyar parasztok gazdálkodásában. In: **Zs. für Agrargeschichte und Agrarsoziologie 12** (1964), S. 100.
10. Václavkova Olomouc 1961. In: **DJbfVk 11** (1965); S. 457-459.
11. Studia Albanica. In: **DLZ 88** (1967), S. 810-812.
12. Sorbischer Sprachatlas. Bearb. v. H. Faßke, H. Jentsch u. S. Michalk. In: **DJbfVk 13** (1967); S. 511-514.
13. G.V. Schulz: Studien zum Wortschatz der russischen Zimmerleute und Bautischler. In: **DJbfVk 13** (1967), S. 203-204, m. W. Rudolph
14. W. Sperber: Die sorbischen Flurnamen des Kreises Kamenz (Ostteil). In **DJbfVk 14** (1968), S. 27.

15. Novellistica italo-albanese. Testi orali raccolti dal Prof. Luca Perrone. In: **DJbfVk 14** (1968), S. 212-213.
16. M. Camaj: Albanische Wortbildung. In: **DLZ (1969),** Sp. 1097-1099.
17. Chansonnier des Preux Albanais. Intr. de Z. Sako. In: **DJbfVk 15** (1969), S. 224-225.
18. K. Koschmieder-Schmid: Vergleichende griechisch-slavische Aspektstudien. In: **ZfSl 15** (1970); S. 107-111.
19. К. Бунина: История глагольных времен в болгарском языке. Времена индикатива / I.K. Bunina: Istorija glagol'nych vremen v bolgarskom jazyke. Vremena indikativa. In: **ZfSl** 16 (1971), S. 765-772, m. K. Kostov.
20. Русские исторические предания/ Russkie istoričeskie predanija. In: **Jb. f. Volkskunde u. Kulturgeschichte 17 (NF 2) (1974)**, S. 289-292, m. G. Burde-Schneidewind.
21. К. В. Школина: Синонимия способов выраыения модальности в современном немецком языке/ K. V. Školina: Sinonimija sposobov vyraženija modal'nosti v sovremennom nemeckom jazyke. In: **ZPSK** 5 (1974), S. 435-440.
22. M. Lambertz: Die Mythologie der Albaner. In: **GjA, Seria Shkenc. filol**. 4 (1975), S. 194-196.
23. W. Steinitz: Ostjakologische Arbeiten. Band I. Band II. In: **Jb. f. Volkskunde u. Kulturgeschichte. 22 (N.F. 7)** (1979), S. 265-267.
24. F. Gregor: Der slowakische Dialekt von Pilisszántó. In: **ZfSl** 24 (1979), S. 588-590.
25. P.R. Magocsi: Let's speak Rusyn. In: **ZfSl** 24 (1979), S. 585-588.
26. Gy. Décsy: Die linguistische Struktur Europas. In: **Orientalische Literaturzeitung 75** (1980), Nr. 1, Sp. 8-11.
27. E. Çabej: Studime Gjuhësore. In: **ZPSK 34** (1981), S. 626-628, m. O. Buchholz.
28. Τίτου Π. Γιοχάλα, Τὸ Ἑλληνο-Ἀλβανικὸν Λεξικὸν τοῦ Μάρκου Μπότσαρη, (Φιλολογικὴ ἔκδοσις ἐκ τοῦ αυτογράφου)/ Titou P Giochala, To Hellēno-Albanikon Lexikon tou Markou Mpotsarē (Filologikē ekdosis ek tou Autographou). In: **Balkan Studies** 1982, 1, S. 285-288. Thessalonikē, m. O. Buchholz.
29. H. Koschat: Die čakavische Mundart von Baumgarten im Burgenland. In: **ZfSl** 28 (1983), S. 484-487.
30. G. Neweklowsky: Die kroatischen Dialekte des Burgenlandes und der angrenzenden Gebiete. In: **ZfSl** 28 (1983), S. 479-484.
31. V. Bojić - W. Oschlies: Lehrbuch der mazedonischen Sprache. In: **ZfSl** 30 (1985), S. 787-790.
32. Ziele und Wege der Balkanlinguistik. Beiträge zur Tagung vom 2.-6. März 1981 in Berlin. Hrsg. v. N. Reiter. In: **ZfSl** 31 (1986), S. 747-752.
33. W. Steinitz: Dialektologisches und etymologisches Wörterbuch der ostjakischen Sprache. In: **ZPSK** 39 (1986), S. 271-273.
34. B. Sokolova: Die albanische Mundart von Mandrica. In: **ZfSl** 32 (1987), S. 315-318.

35. N. Molnár: The calques of Greek origin in the most ancient Old Slavic gospel texts. In: **ZPSK** 41 (1988), 1, S. 125-126.
36. F. Gregor: Die alte ungarische und slowakische Bergbauterminologie mit ihren deutschen Bezügen. In: **ZPSK** 41 (1988), 1, S. 137-138.
37. Р. Ницолова: Прагматичен аспект на изречението в българския книжовен език/ R. Nicolova: Pragmatičen aspekt na izrečenieto v bălgarskija knižoven ezik. In: **ZfSl 33** (1988), S. 260-261.
38. Ch.E.Kramer: Analytic Modality in Macedonian. In: **ZfSl 33** (1988), S. 781-783.
39. Aspects of Language. Studies in Honour of Mario Alinei. In: **ZPSK 43** (1990), 1, S. 149-153.
40. **Albanica.** A Quarterly Journal of Albanological Research and Criticism. Number 1. Winter 1990. Special Issue. Kosova's Tragedy and its Actors; Number 2. Spring 1991. Special issue dedicated to Martin Camaj. In: Südostforschungen. Band 51. München 1992. S. 473-476.
41. Hans-Jürgen Sasse: Arvanitica. Die albanischen Sprachreste in Griechenland. Teil I. In: **Münchner Zs. f. Balkankunde. 9. Band**. München 1993, S. 205-220.
42. Aspekte der Albanologie. Akten des Kongresses "Stand und Aufgaben der Albanologie heute". 3.-5. Oktober 1988, Universität zu Köln. Hrsg. von W. Breu, R. Ködderitzsch und H.-J. Sasse. In: **Südostforschungen. Band 53**. München 1994, S. 538-542.
43. M. Snoj: Rückläufiges Wörterbuch der albanischen Sprache. In: **Südostforschungen. Band 54**. München 1995, S.490-496.
44. G. Schramm: Anfänge des albanischen Christentums. Die frühe Bekehrung der Bessen und ihre langen Folgen. In: **Südostforschungen. Band 55.** München 1996, S. 495-501.
45. Südosteuropa-Handbuch. Band VII. Albanien. In: **Südostforschungen. Band 55**. München 1996, S. 485-495.
46. Ali Dhrimo/Hamlet Bezhani: Deutsch-albanisches Wörterbuch. Fjalor gjermanisht-shqip. In: **Südostforschungen. Band 56**. München 1997, S. 618-622.
47. Armin Hetzer: Nominalisierung und verbale Einbettung in Varietäten des Albanischen.
48. In: Südostforschungen. Band 57. München 1998, S. 499-504.
49. Xhevat Ylli: Das slavische Lehngut im Albanischen. Teil 1: Lehnwörter. In: **Südostforschungen. Band 57**. München 1998, S. 496-499.
50. Eric Pratt Hamp: Il sistema fonologico della parlata di Vaccarizzo Albanese. In: **Südostforschungen. Band 58.** München 1999, S. 536-539.
51. Vladimir Orel: Albanian Etymological Dictionary. In: **Kratylos 47**, 2002, S. 192-195.
52. Rexhep Ismajli: "Në gjuhë" dhe "për gjuhë" (Rjedhat e planifikimit të shqipes në Kosovë 1945-1968). In: **International Journal of the Sociology of Language", 178. Sociolinguistic Studies on the Albanian language**. Edited by E. Derhemi and P. Pani. Berlin. New York 2006, S.129-134. Albanische Version in: Studime. 10. 2003. Prishtinë 2004, S. 316-318.

53. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë: Fjalor i shqipes së sotme. Botim i dytë i ripunuar (me rreth 35.000 fjalë) [Wörterbuch des heutigen Albanisch. Zweite, überarbeitete Auflage (mit ca. 35.000 Wörtern)], 1584 S. In: **Südostforschungen. Band 63/64.** München 2004/2005 (ersch. 2007), S. 736-740.
54. Cimochowski, Wacław: Studia Albanica. Pod redakcję Leszka Bednarczuka i Ireny Sawickiej. Toruń 2001. 142 S.; Wacław Cimochowski: Për gjuhën shqipe = Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Botime të veçanta LI. Seksioni i gjuhësisë dhe i letërsisë. Libri 23. Redaksia Idriz Ajeti, Besim Bokshi, Rexhep Ismajli. Prishtinë 2004. 469 S. In: **Südostforschungen. Band 63/64**. München 2004/2005 (ersch. 2007), S. 746-748.
55. Beci, Bahri: Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri. Pejë o. J.. In: **Südostforschungen. Band 63/64**. München 2004/2005 (ersch. 2007), S. 749-754.
56. Ledeboer, Randolf: Vergleichende Untersuchungen zu "müssen" und "können" in den Balkansprachen. Wiesbaden 2006. In: **Kratylos 54** (2009), S. 202-206.
57. Kahl, Thede: Hirten in Kontakt. Sprach- und Kulturwandel ehemaliger Wanderhirten (Albanisch, Aromunisch, Griechisch).(= Balkanologie. Beiträge zur Sprach- und Kulturwissenschaft. Hg. von Thede Kahl, Michael Metzeltin, Gabriella Schubert und Christian Voss. Band 2). Wien-Zürich [2007]. In: **Südostforschungen. Band 67** (2008). München 2009, S. 561-566.
58. Nordalbanien - L'Albania del Nord. Linguistisch-kulturhistorische Erkundungen in einem unbekannten Teil Europas. Contributi linguistici e culturali su un'area sconosciuta dell'Europa. Hgg. Monica Genesin und Joachim Matzinger. Hamburg: Verlag Dr. Kovač 2009. 189 S. ISBN 978-3-8300-3555-8. In: **Südostforschungen. Band 69/70**. München , S. 707-711.

IX Botime të veçanta shkencore - Sonstige wissenschaftliche Veröffentlichungen

1. H. Wilsdorff: Ethnographisch-geographisch-historisches Register für die Jahrgänge 1 - 10, in Zusammenarbeit mit W. Eckardt, W. Fiedler, S. Kube, B. Schöne, S. Zühlke. In: **DEMOS 12** (1972), H. 3-4, 14 Sp., S. 259-390.
2. **Ukrainische Volksmärchen**. Hrsg. v. P.V. Lintur. Fachbearbeitung Wilfried Fiedler. Berlin 1972, 800 S.
3. Albanologische Publikationen von Albanologen der Deutschen Demokratischen Republik. In: **Akten des Internationalen albanologischen Kolloquiums Innsbruck 1972. Innsbruck 1977**, S. 107-112.
4. **Lettische Volksmärchen**. Hrsg. von O. Ambainis. Fachbearbeitung Wilfried Fiedler. Berlin 1977, 446 S.
5. **Litauische Volksmärchen**. Hrsg. v. B. Kerbelytė. Fachbearbeitung Wilfried Fiedler. Berlin 1978, 479 S.

X Shkurtesat e përdorura - Verwendete Abkürzungen

DLZ Deutsche Literaturzeitung, Berlin

GjA Gjurmime albanologjike - Albanološka istraživanja, Prishtinë

GJA Gjurmime albanologjike, Prishtinë pas 1968.

DJbfVk Deutsches Jahrbuch für Volkskunde, Berlin

LS, R ALinguistische Studien. Reihe A, Berlin

SKShH Seminari mbi kulturën shqiptare për të huaj, Prishtinë

SNdSh Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë.

Zs. f. Phon. u. allg. Sprachw. Zeitschrift für Phonetik und allgemeine Sprachwissenschaft, Berlin

ZfSl Zeitschrift für Slawistik, Berlin

ZPSK Zeitschrift für Phonetik, Sprachwissenschaft und Kommunikationsforschung, Berlin

ARTIKUJ
PAPERS

Victor FRIEDMAN, Chicago

SHUMËSI TURK -*LV₂R (-LAR/-LER)* NË GJUHËN SHQIPE DHE NË KONTEKSTIN BALLKANIK

KDU 811.18'362: 811.512.161
811.1351.18 (497) = 512.161

Abstract

This article is the first attempt at a unified account of Turkish plural markers in the Balkan languages. While it is well-known that Turkish plurals are used for a small number of Turkish nouns referring to prestigious males, in fact their usage in the colloquial language is more widespread. Their use in Balkan Slavic occurs differentially in Bulgarian, Macedonian, and the former Serbo-Croatian. In Bulgarian, it is a stylistic device related to the use of Turkisms in general, in BCSM it is extremely marginal except in Kosovo, and in Macedonian the usage resembles that found in Albanian, where it is most productive. The usage also occurs in Aromanian but not in Romanian, Greek, Romani, or Judezmo. This points to western Macedonia - in this respect as in others - as the nucleus for the innovation. At the same time, it is the languages precisely in the middle of the social hierarchy that share the features of the innovation.

0. Hyrje

Wilfried Fiedler me veprat e tij ka dhënë kontribute monumentale për studimin e gjuhës shqipe. Me këtë artikull dëshiroj të shtoj disa vështrime për shumësin e turqishtes në gjuhën shqipe, gjë që është trajtuar edhe tek Fiedler 1977 dhe 2007. Këtu do të shtoj jo vetëm të dhëna për gjuhën shqipe që nuk paraqiten në veprat e Fiedler-it, por shumësin e turqishtes do ta vështroj në kontekstin e tij ballaknik. Përveç gjuhës shqipe, shumësi i turqishtes paraqitet në maqedonishte, në bullgarishte, në boshnjakishte dhe - gjë që nuk është shënuar deri tani - në arumanishte. Dukuria mungon jo vetëm në greqishte, por edhe në rromishten dhe në gjuhët e tjera romane në Ballkan (rumanishte dhe ebreo-spanjishte). Me këtë do të shohim se kjo dukuri ka vlera të ndryshme indeksikale në gjuhë të ndryshme.

1. Hulumtimet e mëparme

Edhe Miklosich-i (1890:9) dhe Sandfeldi (1930:161) e përmendin shumësin e turqishtes si një dukuri në gjuhën shqipe dhe në bullgarishten e serbishten. Që të dy saktësojnë se dukuria është kufizuar te fjalët me prej-

ardhje turke dhe japin shembujt: *aga - agalari* (sll.), *agallarë* (shq.) (Miklosich) dhe *at - atlar* (sic) (Sandefld). Siç shohim, Miklosich-i i ka dhënë format me shenjat e shumësit sllav dhe në shqipen *-i* përkatësisht *-ë*, derisa Sandfeld-i nuk e vështroi këtë fenomen, as drejtshkrimin e saktë për gjuhën shqipe. Përveç kësaj, shumësat e turqishtes funksionojnë në gjuhën shqipe krejt ndryshe nga gjuhët ballkanike sllave, ndërsa midis gjuhëve sllave ka ndryshime, siç do të shohim.

2. Shqipja

Gjuha shqipe është e vetmja gjuhë standarde në Ballkan që përfshin edhe markerin e shumësit me prejardhje turke. Fiedler (2007: 314-318) ka dhënë materiale nga Cipo (1954) dhe Kostallari etj. (1976) për standardin dhe materiale dialektore nga hulumtimet e tij, si edhe nga Boretzky (1975), Çabej (1960), dhe Çeliku (1963). Këtu do të shtojmë edhe materialet nga Kaleshi (1971) dhe nga interneti.

-llarë

aga, *at*, *baba*, *pasha*, *hoxha*, *subash*, *usta*, *xhaxha*, *dai* (*dajllarë*), *qehaja* (*qehajallarë* [Cipo 1954], *qehallarë* [Kostallari 1976]). Kaleshi (1971) shton edhe *shah, çaush*, dhe *hanëm*. Këtu mund të themi se mendimi i Kaleshit ndoshta përfaqeson një normë të vjetër. Zakonisht, shumësi turk në gjuhën shipe përdoret vetëm për burra që janë me njëfarë prestigji. *At*, megjithëse nuk është njeri, është mashkull dhe me prestigj, dhe *hanëm* është njeri me prestigj, megjithëse nuk është mashkull.

Çeliku (1963:207) shton *komshi (komshillar*) 'neighbor' nga Toskëria e mesme veriore dhe te Boretzky (1975:237) kemi *dost, mixhë* (*mixhallarë*)*, axha, xhaxha, baxhanak* (*baxhallarë*) si edhe *çaush*.[1]

-lerë

dervish, *efend*, *haxhi*, *kadi* 'judge' (Fiedler-i [2007:318] përmend ndikimin e mundshëm të turqishtes standarde *kadılar*. Mund të shtojmë se

[1] Boretzky (1975: 237) përmend *alltpatllare* siedhe *jediler* dhe *kërkler* që përdoren vetëm në perrallat dhe vetëm kur të gjithë janë meshkuj. Megjithatëse *alltplare* nuk është njeri, është në lidhen e ngushtë me prestigj maskullor. Në çdo rast, të gjithë janë njësitë lekskalizuara.

edhe në turqishten dialektore në perëndim të Rumelisë mund të kemi *kadilar*), *sheh*, *bej,* [te Cipo (1954) edhe *beg*].[2] Për *myfti*, te Cipo (1954) kemi vetëm *myftilerë* dhe te Kostallari etj. (1976) vetëm *myftinj*. Por që të dy kanë vetëm *kryemuftinj* si shumës të fjalës *kryemyfti*. Kaleshi (1971) shton *zabit* nga Kosova (te Kostallari etj. 1976, vetëm *zabitë*; fjala mungon te Cipo 1954). Veselaj (2010) shton edhe *sanxhakbej*.[3]

Siç vëren Fiedler-i (2007:317), kemi shumës të turqishtes me fjalë shqipe vetëm nëpër të folme, p.sh. *mbret*, *prift* 'priest'. Që të dy ndodhen në gegnishten veriore, por i pari edhe në toskërishten e mesme. Fiedler (2007: 317) citon edhe *dhespot* nga Tahir Dizdari (prej Tirane) dhe *trimllarë* nga një almanak i vitit 1898. Çeliku (1963:207) ka shënuar *gjysh*/ *gjyshllar* në toskërishtjen e mesme veriore. Kaleshi (1971) shton edhe *kollaxhi-lerë* (te Kostallari etj. 1976. vetëm *kallogjer-ë*).

Përveç kësaj, kemi përdorimin në gjuhën e folur të sufiksit *-lerë/-llarë* për familje, fise, etj. edhe në Shqipëri, të Veriut dhe të Jugut, në Maqedoni si edhe në Kosovë, p. sh. *Brajkallarë*, *Cërnallarë*, *Durmishallarë*, *Bakijallarë*, *Haskallarë*, *Tafallarët* (Nesimi 1987, Fielder 2007:317). Emrat si *Kostallari, Thomallari, Stefanllari* etj. janë nga ky tip.

Kemi një shembull interesant nga një grup për biseda në Internet. Një bisedues kishte emrin-përdorues *hahaha*. Një përodorues tjetër, që quhet *lloqe lloqe*, bënte koment për diçka që shkroi *hahaha*:

edhe kur Kolombi zbuloi Amerikën kishte miliona e miliona hahaha-llarë që nuk e besonin. (lloqe loqe 2011)

Boretzky (1975:237) citon *xhanllar* dhe Çabej (1960:74) *dajllar* (me kuptimin 'trim') si shumësa që nga pikëpamja etimologjike janë bërë njëjës. Mund të themi se *dajllar* me këtë kuptim mund të jetë ose njëjës ose shumës, siç shihet në një këngë kreshnike:

Mirash Preka burr dajllar
Me Luc Dedën i flet dy fjal.
Kta dy djelm si dy dajllar...

[2] Kaleshi (1971:276) shkruan se *bej* del në përgjithësi në toskërishte, ndërsa *beg* përdoret veçanërisht në të flomet e vjetra të Prizrenit. Mund të shtojmë edhe në të folmet e vjetra të qyteteve të Maqednisë Perëndimore.

[3] Në gjuhën e sotme standarde, *sanxhakbej*.

Siç vëren Fiedler-i (2007: 317), nuk ka shumës të tipit truk te Buzuku, por fjala *pashallarë* gjendet te Bogdani. Mirëpo është e mundshme që Buzuku t'i ketë evituar kastile elementet turke dhe në këtë pikëpamje. Përveç kësaj, Stringa (1990) tregon se ka shumë luhatje dialektore apo të gjuhës së folur me përdorimin e shumësit turk në fjalët me prejardhje turke.

3. Maqedonishtja

Jašar-Nasteva (2001:215) vëren se në maqedonishte shumësi turk përdoret pothuajse gjithnjë si thirror, p. sh., *kardašlar!*, *joldašlar!*, *efendiler!,* etj. Përveç kësaj, kemi edhe rastet kur shumësi përdoret si njëjës si në gjuhën shqipe, për sh. *Turče agalarče* apo *begler* 'bej', *beglerka* 'bejlereshë'*, begleri(te)* 'bejlerë(t)' (Dimitrovski et al. 1983:8). Interesante është se edhe në shqipe edhe në maqedonishte shumësi *bejler* përdoret si temë për derivimin e trajtës femërore.

Në Maqedoninë Perëndimore shumësi turk përdoret edhe në gjuhën maqedone tek emrat mashkullorë për familjet, fiset, etj., bile tek emrat krejt maqedonas, p.sh. *Blaželer* (Grannes 1977:84, duke cituar Skok 1972 II: 578).[4]

4. Bullgarishtja

Si në maqedonishte, edhe në bullgarishte shumësi turk përdoret si njëjës, për sh. nga *agalari* "agallarë' kemi njëjës *agalarin* 'aga' me markerin e njëjësit *-in*. Grannesi (1977) ka bërë një studim të shumësave të turqishtes në letërsinë bullgare. Të gjithë janë në përdorim për meshkuj dhe, nga 24 shembujt, 21 janë thirrorë ose thirrje (që funksionojnë si thirrorë, por kanë të bëjnë me vetën e tretë). Shembujt shfaqen në Tabelën 1 me indentifikimin etnik:

Origjinali	Folësi	Të adresuarit
agalar (2 herë)	Bullgar/ Bullgar	Shqiptarë/ Turq
amudžalar	Bullgar	Turq
babaitlar	Turk	Bullgarë
čengeneler	Bullgar	Rromë
čodžuklarăm	Turk	Turq

[4] *Blaževci* në gjuhën standarde.

čorbadžilar (2 herë)	Bullgar/Turk	Bullgarë/Bullgarë
efendiler (3 herë)	Çifut/Bullgar/Turk	Bullgarë/Turq/Bullgarë
jabandžiler	Bullgar	Bullgarë
kardašlar	Turk	Turq
kjopo[o]lar (2)	Turk/Bullgar	Bullgarë/Bullgarë
komitlar	Turk	Bullgarë
komšular	Bullgar	Bullgarë
hajnlar	Turk	Bullgarë
hristianlar	Grek	Bullgarë
kjaratalar	Turk	Turq
osmanlar	Turk	Turq
agalari	Bullgar	Lexues
medrese-hodžalari	Bullgar	Lexues
kăragalar	Bullgar	Lexues

Tabela 1: Shumësa turq në letërsinë bullgare (sh. Grannes 1977).

Midis shqipes dhe maqedonishtes shfaqet në fakt një ndryshim, mjaft prej shembujve jo vetëm që s'kanë prestigj, por janë në të vërtetë fyerje: *kjopolar* (bij qensh; 2 herë), *hajnlar* (tradhtarë), *komitlar* (përdoret si fyerje në kontekst), *kjaratalar* (maskarenj). Përveç këtyre, edhe *amudžalar* dhe *babitlar* përdoret me ironi dhe jo me respekt. Domethënë se një e treta del në kontekste negative. Në 20 nga 21 shembujt, ose folësi ose i adresuari ose që të dy janë turq (pothuajse gjithnjë), dy janë myslimanë të tjerë (shqiptarë, rromë) dhe tre kanë lidhje me pushtetin osman (grek (prift), çifut, dhe tre çorbaxhinj (të krishterë qytetarë të pasur). Vetëm njëherë flet një bullgar për bullgarë të tjerë: kur Bai Ganua thirri *kjopoolar*! Por edhe ky përdorim i turqizmit funksionon si një shenjë e karakterit të Bai Ganos.

Si në maqedonishte, edhe në bullgarishte, shumësi turk, kur përdoret në tregim dhe jo si thirror ose thirrje (tre shembujt e fundit), e ka sufiksin e shumësit sllav *-i*.

Grannes-i diskuton edhe çështjen që disa herë ndoshta kemi të bëjmë me menjanimin e kodit dhe jo me një huazim. Kështu, p.sh. në shembullin e parë, konteksti është ky:

Daj părvo na agite. Bujrjunus, agalar! (Gannes 1977:85) dmth. 'Jepu së pari agallarëve. Bujrëm, o agallarë!' Në bullgarishte, shprehja *bujrum* përkon me *bujrëm* të shqipes, dhe forma *bujrunuz* është më afër me turqishten *buyurunuz*. Përveç kësaj, folësi përdor shumësin *agi* në një fjalim që është krejtësisht bullgar. Nga 18 shembujt që janë thirrorë, 7 janë të këtij tipi.

Edhe thirrori *čodžuklarăm* ‘o djem të mi’ është nga ky tip, sepse edhe folësi edhe i adresuari janë turq. Kështu 8 nga 18 shembujt thirrorë mund të jenë mënjanime të kodit.

Grannes (1977:91) përmend edhe fjalën *krajlar* ‘bandit, kaçak’ si një shembull të mundshëm të shumësit turk me një fjalë me origjinë bullgare. Fjala *krai* në bullgarishte vjen nga fjala rumune *crai* ‘krajl, udhëheqës, hajdut, vjedhës, gruar’ nga sllavishtja e vjetër *kralĭ* ‘mbret’. Në rumanishte, *crai* është njëjës, por në bullgarishte forma me *-i* ngjan në shumës megjithëse është njëjës, dhe për këtë arsye kemi lloj-lloj formash për shumës, si: *krajovci, krajevci, krajlar*. Edhe nga rrënja kemi një njëjës të ri, *kraišnik,*me shumës *kraišnici*. Me sa duket, turqishtja *kıray* ‘hajdut, vjedhës’’, (sh. *krayılar*), është huazuar nga bullgarishtja, dhe ndofta turqishtja prapë ka ndikuar në bullgarishten (Georgiev 1979:706-707). Mund të shënojmë këtu edhe *gjaurlar* ‘kaurë’ (Kjuvlieva 1980: 95), që përdorej si fyerje.

Në përgjithësi, pëdorimi i shumësit turk në bullgarishte (veçanërisht, por jo vetëm në letërsi) u ngjet tipareve të turqizmave në bullgarishte në përgjithësi: ato përdoren në stilin historik, arkaik, të vjetër, dialektor, apo të gjuhës së folur. Të gjitha këto tipare janë të përshtatshme për përdorimet e shumësit turk në bullgarishte. Për më tepër, faktin që në një të tretën e shembujve shumësat turq përdoren si fyerje mund ta vlerësojmë si pjesë të uljes stilistike të turqizmave në shekullin 19, veçanërisht në Bullgari dhe Greqi, por edhe në vendet e tjera në Ballkan (shih Friedman 2005).

5. Ish-serbokroatishtja dhe boshnjakishtja

Për ish-serbo-kroatishten, Popović (1960:584) jep shembujt *hòđa-hođalári* (sic) dhe *h̏ät-hatlári* (at/atallarë) nga Bosnjë, edhe citon trajta *pašalȁr* (sic) nga Belić (1905:393). Trajta te Belić (1905:393) në të vërtetë është *pašalár*, me trajtën [*paša*] në kllapa, dmth. nuk është e qartë a është kjo shpjegim apo njëjës, sepse s’ka kontekst. Mirëpo, me më tepër rëndësi është vendi prej nga doli kjo trajtë: Stajkovci, që është një fshat afër Haraçinës, tani në komunën e Gazi Babës së Shkupit (në kohën e Belić-it, ishte në Turqi). Domethënë se në terminologjinë e sotme dialekti i përket maqedonishtes dhe jo serbishtes. Duke pasur parasysh se s’ka shembuj të tjerë te Belić (1905), mund të themi se ky fakt përkrah idenë se ka një izoglosë

sociolinguistike midis maqedonishtes dhe serbokroatishtes. Edhe Grannes (1977:84) vëren se në letërsinë serbokroate shumësi turk nuk shfaqet. As Škaljić (1966:11-62) nuk e përmend shumësin turk, megjithëse jep një shembull - *agalari* - nga një këngë popullore myslimane prej Bosnje para Luftës së Dytë Botërore. Fjalët e tjera të zakonshme si *paša, beg, hodža*, etj. nuk kanë shumës turk te Škaljić-i. Shprehja *Hadžilar-bajram*, nga Bosnja, është një trajtë leksikalizuar, siç shihet në trajtën tjetër *Hažilajbajram* (Škaljić 1966:296), kurse *hadži* nuk lakohet dhe *hadžija* ka shumës *hadžije*. te Knežević (1962:328) gjendet *beglêri*, *dostlâri*, dhe *tibelërosun* (nuk e besoj, turq. *tövbeler olsun* 'tovbe qoftë') dhe që të gjithë janë nga serbishtja e Kosovës.

Në boshnjakishten e sotme standarde shumësi turk mungon përveç tek Isaković (1995: 4) që përmend *agalar*, por si trajtë të njëjësit, d.m.th. si variant dhe jo shumës i fjalës *aga*. Te Halilović (1996) dhe Jahić (1999) ka vetëm *beglerbeg* (sh. *beglerbegovi* ose *beglerbezi*; edhe tek Isaković 1995), që qartësisht është leklikalizuar. Kështu, në ish-serbokroatishte si edhe në boshnjakishte, shumësi turk përdoret si shumës vetëm në dialektet në kontakt me turqishten dhe shqipen.

6. Gjuhët romane të Ballkanit

Shumësi turk nuk është shënuar në literaturën për gjuhësinë ballkanike, por gjendet në gjuhën arumune. Si në gjuhën shipe dhe përdorimet jothirrore në gjuhët sllave ballkanike, ai del si një marker i shumësit i gjuhës amtare. Trajta *păshălarl'i* gjendet te Fjalori katërgjuhësh i Daniil Voskopojarit (Leake 1814:391, Kristophson 1974: 49), si edhe te Polenakovikj (2007: 74, 87, 165) gjejmë *aga/agalarĭ, beg/beglerańĭ,* and *păšă/păšălarĭ*. Fjalë të tjera turke nuk dalin me shumësin turk, p.sh. *mufti/muftiań*, *hoge/hoğădzĭ*. Edhe te fjalët që dalin me shumësin turk, shfaqen shumësa amtarë: *agadzĭ, beĭ* (nj. *beĭŭ*), *păšadzĭ/păšatsĭ.* Mirëpo, Polenakovikj kishte shënuar që *agalarĭ* përdoret "shumë më shpesh" *(mnogu počesto*). Te Papahagi (1974) nuk asnjë shumës turk. Duke pasur parasysh se disa burime ishin të njëjta për Papahagi-un dhe Polenakovikj-in, ndofta Papahagi-u vendosi të mos përfshinte shumësat turq. Studimi i Wendt-it (1960:149-160) për morfologjinë turke në gjuhën rumune nuk e përmend shumësin

turk, dhe duke pasur parasysh se ai ka bërë një studim i hollësishëm për këtë lëndë, mund të themi se shumësi turk mungon në rumunishte. Në burimet për meglenorumanishten nuk kam gjetur të përmendej ky fenomen.

7. Greqishtja, rromishtja, judezmo

Kyrianoúdēs (2007:147-148) thotë qartë se s'ka shumës turk në greqishte, por për rromishten dhe judezmon kemi vetëm argumentin e heshtjes. Megjithatë, duhet vërejtur se në gjuhën rrome, në disa të folme të Ballkanit, ka parapshtesa të shumësit nga grqishtja (*-ides*) dhe rumanishtja (*-urja*). Këto prapashtesa përdoren veçanërisht për huazimet. Përveç kësaj, në të folmet që janë në kontakt të ngushtë me turqishten, shumë elemente të tjera janë huazuar, p.sh. *sarimiz* 'ne të gjithë' (rrom *sar-* 'të gjithë + turq. *-imiz* 'ynë'), *devlam* 'O im Zot' (rrom. *devla* 'O Zot' + turq. *-m* 'im'), *akanadan* 'from now on' (romani *akana* 'tani" + turq. rrjedhorja *-dan), dadedžik* 'babi' (rrom. *dade* 'o baba' + turq. diminutiv *-cik*) dhe bile zgjedhimet e foljeve (shih Cech and Heinschink 1999: 150-153, Friedman 2013). Përveç kësaj, prapashtesat *ÇV$_4$-, lV$_4$k, lV$_4$-*, (-çi/xhi, -lëk, -li), që janë mjatft produktive dhe gjenden gjithandej në Ballkan, janë shumë të rralla në rromishte. Parpashtesat nga greqishtja dhe rumanishtja përdoren më shumë në dialektet që nuk janë më në kontakt me këto gjuhë, ndërsa disa prej këtyre dialekteve akoma janë në kontakt me turqishten. Ndoshta pikërisht indeksikaliteti (indexicality) si turqishte te kjo prapashtesë e motivon kufizimin e saj te këmbimet e kodit në rromishte (shih Friedman 2013 për ndarjen si një parim grammatikor në rromishte).

8. Përfundime

Ndryshimet midis gjuhëve ballkanike për vendin e shumësit turk s'kanë të bëjnë me ndryshimet gramatikore dhe prandaj duhen këkuar në nivelin shoqëror, pëkatesisht sociolinguistik.

Po të kemi parasysh vendin e islamit dhe situata shoqërore për çdo gjuhë, mund të bëjmë disa vërejtje. Përqindja myslimane është më e lartë për shqipen sesa për gjuhët sllave. Kur të kemi parasysh serbokroatishten dhe boshnjakishten, interesane është se boshnjakishtja, megjithëse ka një indentifikim mysliman, shkon me varietetet e tjera të ish-serbokroatishtes.

Maqedonishtja ndryshon edhe nga ish-serbokroatishtja edhe nga bullgarishtja me përdorimin e shumësit turk me emrat e familes etj., gjë që pasqyron kontaktet e ngushta me shqipen dhe turqishten, veçanërisht në Madqedoninë Perëndimore, ku ka shumë maqedonishtfolës mylsimanë. Në bullgarishte, shumësi turk përdoret si turqizmat e tjerë si një mjet stilistik.

Greqishtfolësit myslimanë ishin shumë të paktë, përveç në Kretë dhe në Maqedoninë Jugperëndimore. Edhe arumanishtfolësit myslimanë ishin të paktë. Judezmo ishte një gjuhë jomyslimane (përveç për Dömnet) dhe, megjithëse rromët në Ballkan janë me shumicë myslimanë, pushetit osman nuk kishte besim në ta (shih Friedman 1991). Ndryshimi midis rumanishtes dhe arumanishtes përcakton pikërisht Maqedoninë Perëndimore si bërthamë të zonës së konvergjencës ballkanike. Në këtë bërthamë gjuhët në qendër të hierarkisë shoqërore shfaqin më tepër ndikim turk nëpërmjet përdorimit indeksikal të shumësit turk.

Bibliografi

Arbri (username). 2007. *Lufta në Lemajë*. <http://www.malesiaforum.com/showthread.php?t=2388> u hap 1 June 2013.

Belić, Aleksandar. 1905. *Dialekti istoče i južne Srbije* (Srpski dijalektološki zbornik 1). Belgrade: Srpska Kraljevska Akademija.

Boretzky, Norbert. 1975. *Die Türkische Enfluss auf das Albanische* I. Wiesbaden: Harrassowitz.

Çabej, Eqrem. 1960. Alb, *vise* 'Orte, Platze' und die singularisierung Plurale im Albanischen II. *Lingua Posnaniensis* 8.71-132

Cech, Petra and Mozes Heinschink. 1999. *Sepečides-Romani: Grammatik, Texte und Glossar eines türkischen Romani-Dialectes*. Wiesbaden: Harrassowitz.

Çeliku, Mehmet. 1963. Vërejtjet mbi të folmen e Dumresë. *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore* 1963/3: 205-256.

Cipo, K., et al.1954. *Fjalor i gjuhës shqipe*. Tirana: Instituti i Shkencave.

Dimitrovski, Todor (chief ed.). 1983. *Rečnik na makedonska narodna poezija*. I. Skopje: Insitut za makedonski jazik.

Friedman, Victor A. 1991. The Earliest Text in Balkan (Rumelian) Romani: A Passage from Evliya Çelebi's *Seyāḫat-nāme* (with Robert Dankoff). *Journal of the Gypsy Lore Society, Fifth Series* 1/1: 1-20.

Friedman, Victor A. 1995. Persistence and Change in Ottoman Patterns of Codeswitching in the Republic of Macedonia: Nostalgia, Duress and Language Shift in Contemporary Southeastern Europe. In Durk Gorter et al. (eds.), *Summer School: Code-switching and Language Contac: 58-97.* Ljouwert/Leeuwarden: Fryske Akademy.

Friedman, Victor A. 2005. From Orientalism to Democracy and Back Again. In Raymond Detrez and Pieter Plas (eds.), *Developing cultural identity in the Balkans: Convergence vs. Divergence*: 25-43. Berlin: Peter Lang.

Friedman, Victor A. 2006. The Balkans as a Linguistic Area. In Keith Brown (ed.), *Elsevier Encyclopedia of Language and Linguistics*, Vol. 1: 657-672. Oxford: Elsevier.

Friedman, Victor A. 2013. Compartmentalized Grammar: The variable (non-)Integrarion of Turkish Verbal conjugation in Romani Dialects. *Romani Studies. Series 5* 23/1: 107-120

Fiedler, Wilfried. 1977. Die Pluralbildung bei den türkischen Elementen des Albanischen. *Balkansko ezikoznanie* 20: 125-145.

Fiedler, Wilfried. 2007. *Die Pluralbildung im Albanischen.* Prishtina: ASHAK.

Georgiev, Vladimir (chif ed.). 1979. *Bălgarski etimologičen rečnik* II. Sofia: BAN.

Grannes, Alf.1977. The use of the Turkish pluralizer -lx^{2}r in South Slavic and Albanian. *The New Zealand Slavonic Journal* 3/2: 83-93.

Halilović, Senahid. 1996. *Pravopis bosanskoga jezika*. Sarajevo: Preporod.

Isaković, Alija. 1995. *Rječnnik bosanskoga jezika*. Sarajevo: Bosanska knjiga.

Jašar-Nasteva, Olivera. 2001. *Turski leksički elementi vo makedonskiot jazik*. Skopje: Institute for the Macedonian Language.

Jahić, Dževad. 1999. *Školski rječnik bosanskog jezika*. Sarajevo: Linguos.

Kaleshi, Hasan.. 1971. The Importance of Turkish influence upon word formation in Albanian. *Balcanica* (Belgrade) 2: 271-293.

Kjuvlieva, V.1980. Morfologičnata adptacija i asimilacija na turskite zameki — šăštestvitelni i prilagatelni — v bălgarskija ezik. *Izvestija na Instituta za bălgarski ezik* 24: 78-135

Knežević, Anton. 1962. *Die Turzizmen in der Sprache der Kroaten und Serben*. Meisenheim am Glan: Anton Hain.

Kostallari, Androkli (chief ed.). 1976. *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës sqipe*. Tirana: Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë.

Kowalski, Tadeusz. 1936. *Zur semantischen Funktion des Pluralsuffixes -lar, -lär in den Türksprachen*. Cracow: PAN.

Kristophson, Jürgen. 1974. Das Lexikon Tetraglosson des Daniil Moschopolitis. *Zeitschrift fur Balkanologie,* 10 /1: 1-128.

Kyranoudēs, Panagiōtis. 2007. *Morfologia tōn tourkikōn dianeiōn tēs ellinēkēs glōssas.* Salonica: Institute of Modern Greek Studies, Aristotle University of Thessaloniki.

Leake, William M. 1814. *Researches in Greece*. London: John Booth.

lloqe lloqe. 2010. <http://www.gazetatema.net/web/2011/12/10/nasa-e-pranon-na-kane-humbur-500-gure-te-marre-ne-hene/> u hap 1 June 2013.

Miklosich, Franz. 1890. Über die Einwirkung des Türkischen auf die Grammatik des südosteurpäischen Sprachen. *Sitzungsberichte der philoophisch-historischen Classe der kaiserlichen Akademie der Wissenschaften* 120/Abteilung I: 1-12.

Nesimi, Remzi. 1987. Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës. *Dialektologjia shqiptare* 5: 176-203.

Polenakovikj, Haralampie. 2007. *Turskite elementi vo aromanskiot*. Skopje: MANU

Popović, Ivan. 1960. *Geschichte der serbokroatischen Sprache*. Wiesbaden: Otto Harrassowitz.

Sandfeld, Kristian. 1930. *Linguistique balkanique*. Paris: Klincksieck.

Škaljić, Abdulah. 1966. *Turcizmi u srpskohrvatskom jeziku*. Sarajevo: Svjetlost.

Skok, Petar. 1972. *Etimologijski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika* II. Zagreb: Jugoslovenska akademija znanosti i umjetnosti.

Stringa, Ruzhdi. 1990. Rreth gjendjes së sotme të prapashtesës -llarë në gjuhën letrare shqipe. *Gjuha jonë* 1990/4 : 47-52.
Wendt, Heinz F. 1960. *Die türkischen Elemente im rumänischen*. Berlin: Akademie-Verlag.
Veselaj, Nuhi. 2010. Shumësi dhe shquarsia e emarave në shqipen standarde (VIII). <www.zemrashqiptare.net/news/id_15253/rp_0/act_print/rf> u hap 1 June 2013.

Victor A. FRIEDMAN, Chicago

TURKISH PLURAL *-LV_2R (-LAR/-LER)* IN ALBANIAN AND WITHIN THE BALKAN CONTEXT

Summary

The use of the Turkish plural marker *-lV_2r* (*-lar/-ler*) in Standard Albanian is well known, its occurrence in Balkan Slavic has been duly noted, and a variety of dialectal Albanian phenomena have been observed in various sources. However, the present work not only brings all of these together and investigates them from a language ideological point of view but also describes a usage in Aromanian that has escaped the attention of Balkanists until now. Moreover, the absence of the phenomenon from Greek, Romani, and Judezmo has only been noted for Greek, and this fact combined with the heretofore unattested observation of the phenomenon in Aromanian contributes both to our understanding of western Macedonia as a nucleus of Balkan linguistic innovation, and the sociolinguistic factors uniting Albanian, Balkan Slavic and Balkan Romance vis-à-vis the other Balkan languages. The differing effects of Turkish on the Indo-European Balkan languages is not due to so-called structural differences, since all the affected languages share not only an ancient common ancestor but also more recent morphosyntactic convergences. Thus, explanations for such differences need to be sought in sociolinguistics and language ideology.

Giuseppina TURANO, Università di VENEZIA

NGA TEORIA **E PARIMEVE DHE E PARAMETRAVE** TEK TEORIA E **MINIMALIZMIT**: FRAZA KAUZATIVE

KDU 81'36-116.6

1. Hyrje

Të dy modelet e ndryshme të zhvilluara në kuadrin e gramatikës gjenerative, **Teoria e parimeve dhe e parametrave** dhe **Programi minimalist,** kanë sjellë dallime thelbësore për sa i përket analizës së disa strukturave sintaksore. Në këtë artikull të shkurtër do të përpiqemi të tregojmë se si mund të analizohen frazat kauzative të gjuhës shqipe sipas secilit prej këtyre modeleve.

2. Fraza kauzative

Në gjuhën shqipe folja kauzative *bëj* përzgjedh ndërtime në lidhore, të cilat mund të kenë kryefjalën parafoljore (1a) ose pasfoljore (1b):

(1) a. *Gjykatësi bëri që **dëshmitari** ta lexojë betimin*

b. *Gjykatësi bëri ta lexojë betimin **dëshmitari***

Pavarësisht nga pozicioni në të cilin ndodhet, kryefjala e foljes në lidhore është gjithnjë në rasën emërore (*dëshmitari*).

Pos dy varianteve të sipërpërmendura, hasim edhe një të tretë në të cilin folja kauzative *bëj* përzgjedh një fjali të varur me folje në lidhore me një kundrinor të drejtë *orën* në kallëzore, dhe një kryefjalë, e cila, në vend që të ketë tiparet e rasës emërore (*Beni),* shfaqet në rasën kallëzore (*Benin)*.

(2) *Çdo trokitje e bënte Benin (që) të shihte orën*

Është e qartë se rasa kallëzore nuk shënohet nga folja në lidhore, sepse folja *të shihte* i shënon rasën kallëzore vetëm emrit *orën*. I vetmi element që mund t'i shënojë rasën kallëzore emrit *Ben* është folja kryesore *bëj*. Si përftohen ndërtimet (1a-b) dhe (2)?

Para se të trajtohet struktura e frazës kauzative, do të analizohet struktura e frazaveme folje në flidhore.

3. Fraza lidhore

Në gjuhën shqipe, folja lidhore ka shënjues të mënyrës, kohës dhe vetës. Mënyra shprehet nëpërmjet pjesëzës modale të pandryshueshme ***të,*** kurse markuesit e vetës dhe të kohës realizohen në format foljore, siç e dëshmojnë mbaresat në dy paradigmat në vijim:

(3) *të lexo**j,** të lexo**sh,** të lexo**jë,** të lexo**jmë,** të lexo**ni,** të lexo**jnë***

(4) *të lexo**ja,** të lexo**je,** të lexo**nte,** të lexo**nim,** të lexo**nit,** të lexo**nin***

Mënyra lidhore mund të përdoret si në fjalitë e pavarura (5) ashtu dhe në ato të varura (6):

(5) *Të rrojë sa malet*!

(6) *Lindita dëshironte të fliste me shoqet*

Fjalia e nënrenditur me folje në lidhore mund të paraprihet nga lidhëza *që.* Kur kjo është e shprehur, në brendësi të frazës lidhore, përbërësit ndjekin rendin SVO (*Subject, Verb, Object*):

(7) *Ata prisnin **që** Lindita të lexonte të gjithë librat*

Kur lidhëza *që*nuk është e shprehur, kryefjala e fjalisë lidhore gjendet në fund të frazës dhe rendi i përftuar është VOS:

(8) *Ata prisnin të lexonte të gjithë librat **Lindita***

Kryefjala e frazës lidhore nuk mund të zërë pozicionin parafoljor:


(9) **Ata prisnin **Lindita** të lexonte të gjithë librat*

4. Analiza sipas teorisë së parimeve dhe parametrave

4.1. Struktura e frazës

Sipas teorisë së ***parimeve dhe parametrave*** (Chomsky 1981, 1986a, 1986b), fraza është projektimi i fleksionit (shënuar I = ***I**nflection*). Fleksioni është koka e frazës së pavarur, që shënohet si IP (*Inflection Phrase*). Një fjali i *Beni lexonte gazetën* do të paraqitej kështu:

(10)




Folja *lexoj* gjenerohet si kokë e sintagmës foljore VP, por e lë këtë pozicion për t'u ngritur në të majtë të frazës për të marrë fleksionin. Kështu, në sintaksën e shfaqur, atë e gjejmë në pozicionin kokë të sintagmës fleksionale IP. Kryefjala *Beni* gjenerohet në brendësi të sintagmës foljore VP, konkretisht në pozicionin e specifikuesit, ku folja i shënon rolin tematik. Pastaj ai zhvendoset nga pozicioni SpecVP drejt atij Spec IP ku i shënohet rasa emërore nga koka I. Ndërsa kundrinori i drejtë *gazetën* e merr rasën kallëzore në brendësi të sintagmës foljore VP.

Në fjalitë e varura, koka më e lartë është ajo e komplementuesit. Në këtë kategori bëjnë pjesë elemente që shërbejnë për t'i paraprirë një fjalie të varur. Ashtu si fleksioni, edhe komplementuesi projekton një sintagmë, e cila do të quhet sintagmë komplementuese dhe shkurtimisht do të shënohet **CP** (***C****omplementizer* ***P****hrase*). Pozicioni kokë i kësaj sintagme është ai i komplementuesit, ndërsa si komplement i saj shërben një sintagmë fleksionale IP. Le të marrim në shqyrtim një frazë si më poshtë:

(11) *Tha se Beni lexonte gazetën*


Fraza e pavarur *Beni lexonte gazetën* është projektuar si komplement IP i sintagmës komplementuese CP. Në pozicionin kokë të kësaj të fundit vendoset komplementuesi *se*:

(12)



Siç e kemi thënë më lart, fleksioni është pozicioni në të cilin kontrollohen si tiparet e kohës, ashtu dhe ato të përshtatjes së foljes. Duke u nisur që nga propozimi i Pollock-ut (1989), tiparet e kohës u dalluan nga ato të përshtatjes, kështu që në strukturën e fleksionit u shquan dy pozicione të ndryshme, **T(ense)** e **Agr(eement)**. *Tense* është koka më e ulët dhe aty realizohen tiparet e kohës, ndërsa *Agr* është koka më e lartë dhe aty realizohen tiparet e përshtatjes me kryefjalën. *Tense* e *Agr* janë koka funksionale që projektojnë secila sintagmat përkatëse TP dhe AgrP: koka Agr merr si komplement të saj TP, ndërsa koka T merr si komplement një sintagmë foljore VP. Folja, që gjenerohet si kokë V, më pas ngjitet në pozicionin kokë T për të marrë tiparet e kohës, duke vijuar të ngjitet sërish drejt kokës Agr për të marrë tiparet e përshtatjes. Kryefjala, në këtë strukturë, vendoset në SpecAgr:

(13)



4.2. Struktura e frazës lidhore

Siç kemi parë, fleksioni i lidhores shpreh tre lloje të ndryshme informacionesh: atë të mënyrës, të kohës dhe të vetës. Mënyra realizohet me anë të pjesëzës ***të.*** Kjo pjesëz mund të ndahet nga folja vetëm nga fjala mohuese *mos* dhe nga klitikët, të vetmet elemente që mund të zënë vend mes pjesëzës ***të*** dhe foljes së shtjelluar.

(14) a. *Lindita të **mos** flasë*

b. *Lindita të **më** flasë*

Përbërës të tjerë si emërorë apo ndajfoljorë përjashtohen:


(15) a. **të Lindita flasë*

b. **të gjithmonë flasë*

Ky është një tregues që dëshmon se pjesëza ***të*** është element i fleksionit të lidhores. Por fakti që ajo mund të ndahet prej foljes nga pjesëza

mohuese apo klitikët, do të thotë që ky element zë një pozicion të ndryshëm nga ai i foljes flektive. Paraqitja e strukturës së fjalisë me folje në lidhore duhet të marrë parasysh edhe elementin që realizon mënyrën e foljes. Struktura e kësaj foljeje mund të ketë kështu një pozicion sintaksor të etiketuar MP (*Mood Phrase*), që krijon vend edhe për pjesëzën ***të***. Pra, struktura e foljes lidhore do të paraqitet si më poshtë:


(16)



Folja leksikore *lexo* ngjitet drejt pozicionit T ku merr morfemën e kohës *-n-,* ndërsa në pozicionin Agr do të marrë morfemën e vetës *-m*, derisa të marrë formën *lexonim*. Forma e plotë e foljes realizohet duke përfshirë edhe pjesëzën *të*, të vendosur në pozicionin M.

Siç pamë më lart, fraza lidhore mund të paraprihet nga komplementuesi *që,* i cili, po të jetë i shprehur, zë pozicionin C brenda strukturës së kësaj fjalie. Në këtë rast, rendi i përbërësve brenda strukturës do të jetë SVO, ku kryefjala i paraprin foljes në lidhore. Kur komplementuesi *që* është i shprehur, kryefjala zë pozicionin e specifikuesit të sintagmës MP:

(17)



Kryefjalës *Lindita* i shënohet rasa emërore nga e gjithë sintagma fol-

jore në pozicionin e specifikuesit të sintagmës MP ku realizohet formësimi i lidhores. Ndërsa kundrinori i drejtë *librat* e merr rasën kallëzore në brendësi të sintagmës foljore VP.


Në ato raste kur komplementuesi ***që*** nuk është i shprehur, kryefjala mund të zërë vetëm pozicionin në fund të fjalisë.

(18) a. *Pritnin të lexonte të gjithë librat* ***Lindita***

b. **Pritnin* ***Lindita*** *të lexonte të gjithë librat*

Rendi VOS varet nga fakti se, në mungesë të komplementuesit *që*, kryefjala *Lindita* ndodhet në një kontekst të tillë në të cilin i shënohen tiparet rasore nga dy elemente njëkohësisht: fleksioni i lidhores, që shënon rasën emërore, dhe folja kryesore *pritnin,* që kërkon rasën kallëzore. Kjo mundësi e dyfishtë e shënimit rasor e bën të pamundur realizimin e kryefjalës *Lindita* në pozicion parafoljor. Pozicioni i vetëm ku mund të realizohet kryefjala është ai i adjunktit në sintagmën foljore VP:

(19)



Ka gjasa që në këto ndërtime niveli CP të mungojë tërësisht. Në një rast të tillë, folja kryesore përzgjedh drejtpërdrejt sintagmën MP dhe për këtë arsye përjashtohet mundësia e vendosjes së kryefjalës *Lindita* në pozicionin e specifikuesit të kësaj sintagme, pasi do të ndodhej nën drejtimin e foljes së fjalisë kryesore *pritnin*, ndërkohë që ajo është nën dominimin e foljes *lexonte* të fjalisë së varur.

4.3. Struktura e frazës kauzative sipas teorisë së parimeve dhe parametrave


Le të marrim tani në shqyrtim frazat kauzative. Struktura kauzative në (1a) ka të njëjtën paraqitje si ajo e ilustruar në (17) me kryefjalën *dëshmitari* në pozicionin e specifikuesit të sintagmës MP, ndërsa struktura në (1b) ka një paraqitje si ajo në (19) me kryefjalën *dëshmitari* e realizuar si adjunkt i sintagmës foljore VP.

Vëmendje të veçantë meriton ndërtimi i dhënë në frazën (2) që e risjellim këtu si (20):

(20) *Çdo trokitje e bënte* ***Benin*** *(që) të shihte orën*

Në këtë strukturë, subjekti logjik i foljes lidhore, jo vetëm që shfaqet me rasën kallëzore, por shfaqet në një pozicion më të lartë se komplementuesi *që,*i cili paraprin fjalinë e varur lidhore. Pra, është e qartë se rasa kallëzore nuk shënohet nga folja lidhore e cila i shënon rasën kallëzore kundrinorit *orën*. Siç u tha më lart, i vetmi element që mund t'i shënojë rasën kallëzore emrit *Ben* është folja kryesore *bëj*, por për këtë është e nevojshme që emri të zhvendoset nga pozicioni SpecMP drejt atij SpecCP. Vetëm këtu ai mund të marrë rasën kallëzore direkt prej foljes kryesore *bëj*:

(21)



Teoria *Parime dhe Parametra* shpjegon arsyen pse, në mungesë të komplementuesit, kryefjala *Lindita* nuk mund të dalë në pozicionin SpecMP; ky është një kontekst në të cilin do t'i shënoheshin tiparet rasore nga dy elemente të ndryshëm: fleksioni i lidhores, që shënon rasën emërore, dhe folja kryesore që kërkon rasën kallëzore. Pra, pozicioni i vetëm ku mund të realizohet kryefjala është ai i adjunktit në sintagmën foljore VP, kui shënohet rasa emërore nga koka T, siç ndodh në (19).

Por kjo teori nuk shpjegonpse përbërësi *Ben* (që është subjekti logjik i foljes lidhore) duhet të lëvizë në pozicionin SpecCP për të marrë rasën kallëzore. Siç është thënë më lart, kryefjala gjenerohet në brendësi të sintagmës foljore VP ku folja i shënon asaj rolin tematik. Pastaj, meqenëse kryefjala merr rasën emërore, për të kontrolluar këtë rasë, ajo duhet të ngrihet në pozicionin e specifikuesit të AgrP ose MP ose të dalë si adjunkt të sintagmës VP. Atëherë, pse subjekti i foljes lidhore merr rasën kallëzore edhe në prani të dy elementeve (MP dhe T) që mund t'i shënojnë rasën emërore? Teoria *Parime dhe Parametra* nuk jep asnjë përgjigje për këtë pyetje.

Sipas kësaj teorie, të tria strukturat që lidhen me frazën kauzative (1a-1b, 2) janëstruktura sipërfaqësore tëderivuara nga e njëjta strukturë e thellë me anë të rregullës transformuese 'lëviz' që ndërrojnë rendin e foljes (nga V tek T dhe Agr) dhe atë tësubjektit logjik të foljes lidhore duke e lëvizur nga SpecVP në SpecMP, ose në pozicion adjunkti,apo nëSpecCP. Pra, kemi një strukturë të thellë, në të cilën të gjitha elementet janë në vendin e tyre origjinar dhe tri struktura sipërfaqësore të ndryshme në të cilat ndryshon vendi i subjektit të foljes në lidhore.

5. Konceptet bazë të Minimalizmit

Një risi themeloree Programit Minimalist (Chomsky 1995) është eliminimi i strukturës së thellë dhe i strukturës sipërfaqësore. Ndërtimi i fjalisë bëhet duke bashkuar një element leksikor me një element tjetër për të formuar ndërtime sintaksore më të mëdha nga njësi më të vogla.Ky veprim njihet si *Merge* (bashko). Pra, nëse në teorinë e Parimeve dhe Parametrave jepej pema, pastaj në të futeshin elementet leksikore duke krijuar strukturën e thellë dhe nga struktura e thellë derivohej struktura sipërfaqë-

sore me anë të rregulles 'lëviz', në modelin minimalist, struktura derivohet hap pas hapi, nga poshtë lart, me anë të rregullës *Merge*.

Përveç veprimit *Merge*, njihet një veprim tjetër, *Agree* (përshtatje), i cili nënkupton kontrollin e tipareve. Në saje të këtij veprimi, realizohet lidhja mes dy gjymtyrëve të një sintagme, kështu që njëra gjymtyrë merr treguesit gramatikorë që i cakton gymtyra tjetër ose realizohet caktimi i rasës.

Kur është i nevojshëm kontrolli morfologjik i tipareve, mund të zbatohet një veprim i tretë që njihet si *Move* (lëviz). Pra, *Move* është veprimi që përgjigjet për lëvizjen e elementeve në fjali.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm në këtë teori është që çdo strukturë ndërtohet nga elemente që mbartin që në zanafillë kategoritë e duhura gramatikore si gjini, numër dhe rasë. Gjatë procesit të derivimit, çdo element duhet të vendoset ose të zhvendoset në një pozicion të përshtatshëm për t'i kontrolluar këto tipare.

Në programin minimalist,Chomsky redukton edhe numrin e kategorive funksionale që mund të projektojnë një sintagmë duke braktisur kategorinë Agr. Pra, në formimin e fjalive mbeten vetëm kategoritë C, T e V.

5.1. Analiza e frazave kauzative sipas Minimalizmit

Siç thamë më sipër, në modelin minimalist, çdo frazë ndërtohet nga poshtë lart, hap pas hapi, me anë të rregullave *Merge*, *Move* dhe *Agree*. Për formimin e një fjalie si *Gjykatësi bëri që dëshmitari ta lexojë betimin,* merren nga leksikoni të gjithë elementet e fjalisë të pajisura me tiparet e tyre. Së pari, veprimi Merge bashkon foljen *lexojë* me kundrinorin *betimin*.

(22) [[*lexojë* [*betimin*]]

Në këtë fazë, folja kontrollon rasën kallëzore të emrit *betimin.*


Pastaj, folja me kundrinorin bashkohen me kryefjalën *dëshmitari* duke formuar objektin sintaksor VP:

(23) $_{VP}$[[*dëshmitari* [*lexojë betimin*]]

Më tej, sintagma VP bashkohet me kokën T. Folja ngrihet në pozicionin T ku kontrollohen tiparet e saj me anë të rregullës Agree. Koka T


kontrollon edhe rasën emërore të kryefjalës, e cila për këtë shkak ngrihet në pozicionin SpecTP.Veprimi Merge përsëritet duke bashkuar sintagmën TP me kokën M, ku vendoset formanti ***të*** dhe kontrollohen tiparet modale të foljes. Në këtë fazë, kryefjala ngrihet në pozicionin SpecMP. Veprimi Merge përsëritet sërish duke bashkuar sintagmën MP me kokën C, ku vendoset komplementuesi *që*, e kështu me radhë.

(24)



Le të marrin tani analizën e fjalisë *Gjykatësi bëri ta lexojë betimin dëshmitari,* në të cilën mungon komplementuesi *që* dhe kryefjala shfaqet në fund të fjalisë. Derivimi bëhët si në rastin e mëparshëm deri në momentin e formimit të sintagmës MP. Por meqë në këtë strukturë nuk është marrë nga leksikoni komplementuesi *që*, sintagma MP nuk bashkohet me kokën C, por direkt me kokën kauzative *bëri*.

(25)




Në fund të këtij derivimi, kryefjala *dëshmitari* ndodhet në pozicionin e specifikuesit të sintagmës MP ku i caktohet rasa emërorenga folja lidhore. Ky pozicion përputhet me atë të komplementit të foljes kauzative, që është një pozicion në të cilin kontrollohet rasa kallëzore. Si rrjedhim, kryefjala e foljes lidhore nuk mund të dalë në këtë pozicion. Pra, ajo lëviz brenda sintagmës TP, në pozicionin e adjunktit.

Një strukturë tjetër kauzative si *çdo trokitje e bënte Benin (që) të shihte orën* ndërtohet duke u nisur nga objekti sintaksor VP, ku bashkohen folja lidhore *shihte* me kundrinorin *orën* (të cilit folja i cakton rasën kallëzore) dhe me subjektin logjik *Benin.* Faza e dytë bashkon sintagmën VP me kokën T. Folja lidhore ngrihet në pozicionin T ku kontrollohen tiparet e

saj. Pas foljes lëviz edhe subjekti *Benin*, i cili vendoset në pozicionin SpecTP ku kontrollon tiparet e vetës dhe të numrit por jo ato të rasës sepse emri është marrë nga leksikoni i pajisur me rasën kallëzore që koka T nuk mund të kontrollojë. Pra, emri *Benin* nuk ndodhet në një pozicion ku mund të kontrollojë rasën kallëzore. Si rrjedhojë, veprimi Agree nuk plotësohet. Ndërkohë, Merge vepron duke bashkuar sintagmën TP me kokën M ku vendoset pjesëza *të* e lidhores. Subjekti logjik i foljes lidhore (*Benin*) ngrihet nga pozicioni SpecTP në pozicionin SpecMP, ku plotësohet folja lidhore. Por meqenëse emri është i pajisur me rasë kallëzore, ndërsa në SpecMP kontrollohet rasa emërore, emri *Benin* nuk ndodhet ende në pozicionin e duhur përkundrejt elementit rasëcaktues. Derivimi vazhdon duke bashkuar sintagmën MP me kokën C, ku vendoset komplementuesi *që* dhe pastaj duke bashkuar sintagmën CP me foljen kryesore *bënte*. Në këtë derivim, i vetmi element që mund të kontrollojë rasën kallëzore të emrit *Benin* është folja kauzative *bëj,* e cila është caktuese e rasës kallëzore. Atëherë, ky emër ngrihet në SpecCP, i vetmi pozicion ku mund të krijohet struktura kokë-komplement dhe ku rasa kallëzore e emrit mund të përshtatet me tiparet e foljes:

(26)



Megjithëse programi minimalist e ka reduktuar shumë aparatin teorik të gramatikës, ai shpjegon në mënyrë më të kënaqshme ato derivime që teoria e Parimeve dhe e Parametrave nuk arrin t'i shpjegojë.

Bibliografi

Chomsky, N.(1981) *Lectures on Government and Binding.* Foris, Dordrecht.
Chomsky, N.(1986a) *Barriers.* The MIT Press, Cambridge, Mass.
Chomsky, N.(1986b) *Knowledge of Language.* Praeger, New York.
Chomsky, N.(1995) *The Minimalist Program*, The MIT Press, Cambridge, Mass.
Pollock, J.-Y. (1989) "Verb movement, UG and the structure of IP", *Linguistic Inquiry* 18: 85-111.

Giuseppina TURANO (Università di Venezia)

FROM **THE THEORY OF PRICIPLES AND PARAMETRES** TO **THE THEORY OF MINIMALISM**: THE CAUSATIVE PHRASE

Summary

In this short paper, I look at three different Albanian causative sentences which differ in the position of the embedded subject. The first sentence is the type esemplified by *Gjykatësi bëri që **dëshmitari** ta lexojë betimin.* The embedded subject has nominative case and realizes in preverbal position. The second type is esemplified by *Gjykatësi bëri ta lexojë betimin **dëshmitari*** with the embedded subjet in final position. The third sentence is esemplified by *Çdo trokitje e bënte **Benin** (që) të shihte orën.* Here the embedded subject has accusative case and follows the causative verb. I investigate the internal structure of the three different types by using, first, the Principle and Parameters Approach (Chomsky 1981, 1986a. b) and then the Minimalist Program (Chomsky 1995).

Teuta ABRASHI, Prishtinë

A KA FJALI NJËGJYMTYRËSH (PA KRYEFJALË) NË GJUHËN SHQIPE? REFLEKSION RRETH SINTAKSËS SË MEHMET ÇELIKUT

KDU 811.18'3 67
811.18 - 26

Fjalët çelës: *Subjekti*, *predikati*, *fjalia*, *thënia*, *sintaksa*

1. Hyrje

Së voni (2012), në Tiranë, doli nga shtypi: 'Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)' që, siç pohon autori Mehmet Çeliku dhe nëntitulli i po këtij libri, është një sintaksë e gjuhës shqipe me një vështrim të ri teorik. Autori dhe recensentët e librit: Remzi Përnaska dhe Rami Memushaj, në të tri parathëniet e tyre të veçanta, e paralajmërojnë lexuesin se vështrimet në këtë sintaksë përfshijnë edhe rrafshet e tjera gjuhësore: fonetikën, morfologjinë semantikën dhe pragmatikën. Thënë ndryshe, kjo sintaksë tenton të ketë një qasje funksionale dhe provon të mos lë anash edhe qasjen formale. Supozon dy njësi sintaksore: (i) përbërësit sintaksorë dhe (ii) fjalinë si dhe trajton skemat e lidhjeve dhe konfigurimin e tyre. Por në këtë qasje funksionale, përveç përfshirjes tipike të rrafsheve të tjera gjuhësore, autori shkon edhe një hap më tutje: merr në konsideratë arritjet e deritashme të sintaksës strukturaliste perëndimore (Chomsky, Tesnière), mbështetet në modelin e perspektivës funksionale të fjalisë (Mathesius), në të arriturat e gjuhësisë lindore (sovjetike) si dhe në sintaksën tradicionale shqiptare. Në këtë mënyrë, autori përjashton çdo mundësi që qasja e tij funksionale të burojë nga ndonjë motiv ideologjik (p. sh. antigjenerativist), që karakterizon disa modele të gramatikës funksionale (Lambrecht 1994: 10). Por siç duket motivi i autorit qëndron diku tjetër. Ai tenton të jetë koherent me gjuhësinë ndërkombëtare dhe, siç pohon në parathënie dhe gjetiu në këtë libër, nuk është i kënaqur me qasjen e deritashme duke zbatuar "mekanikisht teoritë e huaja në gjuhën shqipe" (f. XI) si dhe ekspozimin e këtyre teorive të huaja "nëpërmjet përkthimeve e përshtatjeve, duke i ilustruar me shem-

buj nga shqipja" (f. XII). Madje, ai konsideron se arritjet e modeleve strukturaliste perëndimore nuk janë të afta të përfshijnë të gjitha karakteristikat e sintaksës së shqipes (f. 36).

Libri i Çelikut padyshim ka vlera shkencore e didaktike, por ai ka ngritur edhe diskutime. Këto diskutime, siç pohojnë edhe recensentët, karakterizohen me mospajtime rreth disave nga tezat e guximshme të Çelikut. Një rrjedhë e tillë nuk është e papritur nëse preket njëra nga çështjet më të diskutueshme në gjuhësi: fjalia. Por edhe fakti, se në analizë sintaksore përfshihen të gjitha rrafshet gjuhësore dhe huazimi i koncepteve nga modele të ndryshme gramatikore. Prandaj, edhe sikur të mos ngatërrohen fare interpretimet e njërit rrafsh me tjetrin, apo konceptet e njërit model me tjetrin, është shumë e vështirë të shmangen diskutime të përcjella me pajtime e mospajtime.

Edhe autorja e këtyre rreshtave është e pajtimit se, ashtu siç janë paraqitur në këtë libër, disa nga tezat dhe konstatimet kërkojnë diskutime dhe sqarime shtesë, sidomos nga fakti se libri synon të bëhet tekst themelor universitar i sintaksës së gjuhës shqipe. Mjerisht, autori në këtë botim ka vendosur (për çudi) që "për të ruajtur caqet e një teksti universitar shënimet, citimet, debatet e hollësira të ndryshme" (f. XIII) të lërë jashtë këtij libri. Nuk jam e sigurt se (mos)pajtimet, po të mos mbeteshin jashtë librit shënimet dhe citimet, do të ishin më të shumta a më të pakta, por jam e sigurt që së paku debati do të ishte më i fokusuar dhe po supozoj më produktiv. Përndryshe, i mbetet secilit të referohet në burime për të cilat konsideron se janë mjaft kompetente për të ndihmuar debatin dhe eventualisht t'i dilet në mbështetje apelit të autorit për "vërejtje dhe sugjerime" (f. XIV).

Në këtë libër janë disa pohime të Çelikut si p.sh. (i) "Në sintaksë parësore janë kuptimi, marrëdhëniet kuptimore, ndërsa ndërtimi, shprehjet gramatikore janë dytësore" (f. 3); (ii) "...në qendër të analizës sintaksore është *thënia*, që zbërthehet në *temë + remë"* (f. 9); (iii) "përbërësi kryefjalë është qendra drejtuese në rrafshin formal gramatikor... ndërkaq përbërësi kallëzues është qendra kryesore në rrafshin semantik" (f. 8); (iv) "Numri i valencave të çdo foljeje nuk është në çdo rast i fiksuar: ai varion në varësi të strukturës semantike të foljes" (f. 4) etj., por edhe disa analiza e teza konkrete, a) ekzistimi i fjalive njëkryepërbërëse në gjuhën shqipe, të cilat i

"mundëson pasuria e sistemit eptues të foljeve" (f. 14), e lidhur me këtë edhe ekzistimi dhe mosekzistimi i kryefjalës zero (f. 14-15 dhe f. 137), b) dallimi strukturor ndërmjet *Unë i shkrova*[1] dhe *I shkrova*, (f. 36), c) barazimi i fjalisë dykrypërbërëse me strukturën informative *temë-remë* (f. 86), e lidhur me këtë edhe konstatimi se "kufiri i gjymtyrëve varet nga konteksti e situata" (f. 40), d) Shprehja e kryefjalës me emër të pashquar *Maki"në ndaloi para universitetit* (f. 95, 139), e) emri i shquar në shembullin *Ata u njohën në fshatin e lindjes* "pikërisht se është i shquar, humb vetëmjaftueshmërinë për t'u lidhur me foljen... prandaj nuk funksionon dot vetëm për vetëm as si gjymtyrë..." (f. 40), f) "trajtat e shkurtra nuk janë kundrinorë, nuk rimarrin kundrinorin në fjali, por janë formante gramatikore të domosdoshme..." (f. 169) etj., që, sipas mendimit tim, kërkojnë sqarime shtesë dhe diskutime teorike dhe gjithsesi dëshmi shtesë empirike.

Për shkak të kufizimit në hapësirë disa nga çështjet e listuara më lart mund të jenë eventualisht objekt reflektimi herëve të tjera, mirëpo disa prej tyre autorja do të tentojë t'i përfshijë në rreshtat e mëposhtëm.

2. Subjekti dhe Predikati

Subjekti dhe predikati janë dy kategori që kryejnë funksione të ndryshme dhe në fjalitë e thjeshta subjekti i referohet emrit, kurse predikati i referohet foljes:

(1) a) Agimi është student.

b) *Agimi* - Subjekti

c) *është student* - Predikati

Te fjalia pohuese (1a) *Agimi* është subjekti, kurse predikati është pjesa e mbetur e fjalisë kur asaj ti hiqet subjekti (Zifonun 1997:683), si në (1c). Me kohë, ky përkufizim u përvetësua edhe te fjalitë në të cilat gjymtyrët e saj nuk lidhen me këpujë:

(2) a) Agimi lexon librin.

b) *Agimi* - Subjekti

c) *lexon librin* - Predikati

[1] Me germa të mëdha në këtë punim do të shënohen fjalët e theksuara të thënies.

Ideja se subjekti dhe predikati dallojnë (esencialja kundrejt joesenciales) daton qysh nga Platoni dhe Aristoteli: predikati pohon ose kallëzon diçka për subjektin. Në pikëpamje epistemologjike subjekti tregon se për kë bëhet fjalë, kurse predikati tregon se ç'thuhet për atë (subjekt) në fjali (Heusinger 1999: 105). Lidhja ndërmjet subjektit dhe predikatit është, pos tjerash, lidhje gramatikore me përshtatje tek e cila subjekti identifikohet me formën e vet rasore në nominativ, kurse folja bashkëpërshtatet me subjektin duke marrë nga ai kategorinë gramatikore të vetës dhe numrit. Por këtu duhet të shtojmë, për dallim nga Çeliku, se jo gjithnjë veta e numri janë të përcaktuar në mënyrë të pavarur, pra pa ndikimin e faktorit pragmatik:

(3) a) Sekretarja ime dhe bashkëpunëtorja jote **është** gati për t'u nisur.

b) Sekretarja ime dhe bashkëpunëtorja jote **janë** gati për t'u nisur.

Në (3a) sekretarja dhe bashkëpunëtorja shënojnë të njëjtin individ, kurse në (3b) sekretarja dhe individi shënojnë individë të ndryshëm. Përderisa gjuhë të tjera (si p.sh. gjuha gjermane) përdorin mjete të tjera për të kodifikuar numrin e referentëve (apo individëve) në një ngjarje[2] si në shembullin (3), në gjuhën shqipe vetëm nëpërmjet kongruencës kontekstuale të foljes **jam** mund të konkludojmë se a është sekretarja dhe bashkëpunëtorja personi i njëjtë (3a) apo dy persona të ndryshëm (3b). Prandaj, pjesërisht mund të pajtohemi me Çelikun se "qendra drejtuese në rrafshin formal gramatikor "(f. 8) është "përbërësi kryefjalë". Por tash të shohim se a është kështu edhe me konstatimin e tij të dytë, të cilin e jep në vazhdim të të parit, e që thotë: "përbërësi kallëzues është qendra kryesore në rrafshin semantik".

Dallimi ndërmjet subjektit dhe predikatit është i rëndësishëm edhe në logjikë. Në këtë fushë ekzistojnë dy pikëpamje të konceptimit të strukturës së fjalisë: pikëpamja e Aristotelit (logjikës tradicionale) dhe pikëpamja e Frege-s (logjikës moderne). Sipas konceptit tradicional, subjekti dhe predikati janë të lidhur me këpujën *është* (*Agimi është student* ose *S është P*). Pikënisja e pohimit është subjekti (prandaj duhet të jetë i shquari/ i njohuri), i cili përcillet nga predikati apo tipari (i pashquari/ i panjohuri). Predikati përbëhet nga këpuja dhe nga një entitet tjetër, i cili quhet objekti

[2] Në gjuhën gjermane kur është fjala për një individ, shfaqet vetëm një nyjë e shquar, kurse në rastin e dy individëve nyja e shquar shfaqet dy herë.

(*student*). Kurse koncepti modern si pikënisje ka foljen, sepse te disa ngjarje të shënuara me folje transitive, në trajtën pësore rolet e subjektit dhe objektit mund të ndërrohen. Gjithashtu, ngjarjet mund të përfshijnë jo vetëm dy entitete si në rastin e *leximit* (***Agimi*** *lexon* ***librin***), por ato mund të përfshijnë më shumë se dy, p. sh. ngjarja e *dhënies* (***Agimi*** *ia dha* ***librin mësuesit***. Këto dhe fakte e tjera[3] shtynë Frege-n për të konceptuar një strukturë të fjalisë bazuar në relacionin ndërmjet funksionit (foljes) dhe argumenteve (emrat, përemrat)[4]. Tesnière përvetësoi këtë koncept, pra relacionin (siç e quante ai) ndërmjet predikatit (funksionit) dhe aktantëve (argumentëve) të tij (Zifonun 1997: 683) dhe përfshiu konceptin (metaforik) të valencës në gjuhësi[5]. Sipas këtij modeli, secila folje, kur përfshihet në ligjërim, hap pozicionet (sikurse elementet kimike) për t'u lidhur me plotësat e vet. Subjekti është njëri nga plotësat e foljes, pa ndonjë status të veçantë sintaksor. Për dallim nga koncepti aristotelian, pikënisjen apo rolin kryesor nuk e ka më subjekti, por folja. Subjekti barazohet me objektin. Por meqë secili argument merr një rol të caktuar semantik, subjekti zakonisht karakterizohet me rolin e vepruesit (agensit), kurse objekti me rolin e pësuesit (patientit) apo me ndonjë rol tjetër. Në ngjarjen e *dhënies* subjekti (*Agimi*) ka rolin e vepruesit (agensit), kundrina e drejtë (*librin*) rolin e instrumentit, kurse kundrina e zhdrejtë (mësuesit) ka rolin e përfituesit.

Gjatë shek. 19 u zhvilluan polemika të shumta rreth subjektit dhe predikatit (Seuren 1998). Thelbi i debatit ishte mospajtimi i gjuhëtarëve, filozofëve dhe dijetarëve të tjerë se a janë subjekti dhe predikati kategori gramatiko-gjuhësore, logjike apo shpirtërore (psikologjiko-kognitive). Kështu, von der Gabelnz (1869) dallonte dy pikëpamje në gjuhësi: pikëpamjen psikologjike, që sot njihet si pikëpamje kognitive, dhe pikëpamjen gramatikore (Musan 2010: 59 dhe Heusinger 1999: 106), prandaj ai përveç

---

[3] Faktet të tjera janë: (i) simetria (S është P, P është S), e cila u përmend më lart, nuk qëndron te mohimi dhe (ii) kuantifikimi i shumëfishtë nuk është i mundshëm (*Secili athinas e urren një mbret*) (Heusinger 1994: 105)

[4] Ky koncept i Frege-s, bazuar në strukturën funksion-argument të fjalisë konsiderohet si bazë e semantikës së sotme të fjalisë, sepse ky përkufizim nuk varet nga sintaksa, pragmatika apo psikologjia. (Heusinger: 1999: 107)

[5] Përveç metaforës së valencës, Tesnière futi edhe metafora të tjera për të shpjeguar dukuritë në sintaksë. Kështu p. sh. ai i konsideron akantët si aktorë të një pjese të vogël teatrale (*petit drame)*, në të cilën aktanti kryesor është bartës i veprimit, aktori i dytë është mbështetës i këtij veprimi, kurse aktanti i tretë është përfituesi ose pësuesi i këtij veprimi (Votteler: 2007: 35)

subjektit dhe predikatit gramatikor, merrte parasysh edhe subjektin dhe predikatin psikologjik. Me **subjekt psikologjik** ai nënkuptonte sendin për të cilin folësi dëshiron ta bëjë dëgjuesin të mendojë gjegjësisht t'ia drejtojë vëmendjen apo ta fokusojë drejt një sendi të caktuar, kurse **predikati psikologjik** i kallëzon dëgjuesit se çka duhet të mendojë për këtë send (subjektin psikologjik) (Musan 2010: 26).

(4) Mit Speck fängt man Mäuse. Me proshutë kapen minjtë.

Kështu, në shembullin (4), që është një fjalë e urtë gjermane, subjekti gramatikor *man* (përemër i pacaktuar), nuk është sendi për të cilin bëhet fjalë apo porosia e fjalisë. Porosia e fjalisë është: *me mjete joshëse mendjelehtit bien në kurth*. Andaj në (4) *proshuta*, si mjet joshës, është sendi i vërtetë për të cilin bëhet fjalë, prandaj ai është subjekti (psikologjik) i fjalisë.

Në këtë frymë, Hermann Paul (Lohnstein 2011: 379) e supozon fjalinë si një shprehje gjuhësore e cila i ndërlidh disa koncepte psikologjike në mendjen (apo shpirtin) e folësit. Paul pohonte se secila fjali përbëhet nga dy elemente: subjekti dhe predikati, të cilët si kategori gramatikore lidhen edhe me një relacion (shtesë) psikologjik. Andaj, konstatonte ai, duhet shikuar raportin ndërmjet subjektit gramatikor dhe subjektit psikologjik, sepse jo gjithnjë këto raporte përputhen me njëri tjetrën. Për këtë arsye ai zhvilloi edhe provën (apo testin) se si të verifikohet qartësisht një raport i tillë, që po e paraqesim më poshtë. Le të marrim fjalinë si vijon:

(5) Agimi udhëton nesër në Prishtinë.

Varësisht se si e formulojmë pyetjen subjekti (psikologjik) do të ndryshojë:

(6) a) Kush udhëton nesër për në Prishtinë? *AGIMI* udhëton nesër në Prishtinë[6].

b) Ku udhëton nesër Agimi? *Agimi* udhëton nesër NË PRISHTINË.

c) Kur udhëton Agimi për në Prishtinë? *Agimi* udhëton NESËR në Prishtinë.

Përderisa në (6a) subjekti gramatikor (kursiv) dhe subjekti psikologjik (i spikatur) përputhen (AGIMI), në (6b) e (6c) ata nuk janë të njëjtë.

[6] Germat e mëdha tregojnë se fjala është theksuar; me anë të intonacionit shënohet informata e re, e panjohur deri në at moment për dëgjuesin.

Në të parin bëhet fjalë për vendin në të cilin *do të udhëtojë Agimi* (PRISHTINË), kurse në të dytin për kohën kur *do të udhëtojë Agimi* (NESËR). Paul konstaton edhe një fakt shumë të rëndësishëm: gjymtyra fonetikisht më e theksuar e fjalisë është ajo pjesë e fjalisë (apo shprehjes) të cilën folësi e konsideron si pjesë më të rëndësishme të fjalisë. Për të paraqitur theksimin fonetik, në shembullin tonë janë përdorur germat e mëdha. Vërejmë se duke përdorur mjetet prozodike, subjekti psikologjik nuk duhet patjetër të vendoset gjithnjë në ballë të fjalisë për të siguruar statusin e saj (primar) informativ. Kështu në (6a) do të theksohet AGIMI, në (6b) NË PRISHTINË dhe në (6c) NESËR, sepse ata ende nuk janë shfaqur (apo përmendur) në diskursin gjuhësor, prandaj potenca e tyre informative është më e madhja. Thënë ndryshe, secila nga këto gjymtyrë sjell diçka të re (Krifka 2006: 3), që në fakt e përbën thelbin e porosive të përgjigjeve në (6). Von der Gabelenz dhe Paul (Seuren 1998: 128 dhe Heusinger 1999: 107-108) e përvetësojnë qasjen tri-partite të subjektit, sepse përveç subjektit gramatikor e psikologjik dallojnë edhe subjektin logjik, i cili mund të mos përputhet me subjektin gramatikor:

(7) a) Cezari kapërceu rubikonin.

b) Rubikoni u kapërcye nga Cezari.

Në fjalinë (7a) subjekti gramatikor dhe subjekti logjik (*Cezari*) përputhen, kurse në fjalinë (7b), e cila është trajta pësore e fjalisë (7a), subjekti gramatikor është *Rubikoni*, kurse subjekti logjik është *Cezari*.

Për të mos u ngatërruar me konceptet e ndryshme të subjektit të cekura deri tash, këtu po paraqesim shkurtimisht se çka nënkuptohet me secilin prej tyre:

• **Subjekti gramatikor** merr për bazë (vetëm) tiparet gramatikore. Kështu p. sh. në gjuhën shqipe e gjuhën gjermane nëse një sintagmë nominale (apo emri) është në nominativ, atëherë ajo konsiderohet subjekt gramatikor i fjalisë[7].

[7] Natyrisht, ekzistojnë edhe kushte të tjera, por ky është njëri nga kushtet për tu kualifikuar një gjymtyrë për të siguruar statusin e bartësit të këtij funksioni. Meqenëse një çështje e tillë është jashtë kuadrit të ravijëzuar të këtij punimi, këtu nuk po merremi më me këtë çështje.

• **Subjekti logjik** është aktori apo agensi i ngjarjes (*Cezari* në fjalitë (7a) dhe (7b))[8]

• **Subjekti psikologjik** është ***çështja për të cilën bëhet fjalë***. Po themi çështja, sepse, siç pamë më sipër në shembullin (6), fjala mund të jetë për individin (emër), vendin (parafjalë) apo kohën (ndajfolje) e ngjarjes. Madje, ajo mund të përfshijë edhe vetë ngjarjen, sepse nëse bëjmë pyetjen: *Çka do të bëjë nesër Agimi*? Përgjigjja do të ishte: *Agimi **UDHËTON** nesër në Prishtinë*. Pra, fjala është për *udhëtimin e Agimit në Prishtinë* e jo për një udhëtim i cili mund të jetë kudo.

Është e qartë se këto tri lloje të subjekteve nuk janë sinonimike, por secili përcakton një koncept të ndryshëm[9]. Pyetja është se a mundet subjekti të përfshijë të gjitha këto koncepte përnjëherë dhe t'ia ngarkojë ato vetëm njërës gjymtyrë? Nëse u referohemi shembujve të paraqitur më lart vërejmë se në disa raste është e mundshme, por vërejmë gjithashtu se në disa raste një gjë e tillë nuk është e mundshme. Halliday, një gjuhëtar funksionalist, konsideron se kur merret parasysh të folurit dhe variacionet e mundshme (ndryshimi në rendin e elementeve, veprorja, pësorja etj.), atëherë nuk do të jetë më e mundur të pohojmë se këto tri koncepte janë thjesht aspekte të ndryshme të një nocioni të njëjtë dhe të përgjithshëm. Ato do të duhej të interpretoheshin si tri funksione të ndara, me kuptime hollësisht të dallueshme dhe të ndryshme[10]. Duhet të ekzistojë arsyeja pse folësi (në një moment të caktuar) përzgjedh një renditje të caktuar (të fjalëve) për t'ia përcjellë dëgjuesit. Prandaj, secila nga këto tri forma, paraqet nga një organizim të ndryshëm funksional të fjalisë, të cilat prodhojnë tri konfigurime (funksionale) të kuptimit të fjalisë (8).


---

[8] Teoria e valencës, ashtu siç është paraqitur nga Tesnière, është kryesisht teori sintaksore, mirëpo Tesnière bën edhe karakterizimin e aktantëve të foljes në bazë të funksioneve të tyre semantike (Votteler: 2007: 35).

[9] Prandaj, Amman (1928), për t'i dalluar këto koncepte, fut termat e rinj: **Tema** dhe **Rema**. *Rema* është huazuar nga tradita gramatikore greke dhe i referohet foljes, për dallim nga *onoma* që i referohet emrit apo subjektit. Më vonë këta terma u përvetësuan nga Mathéisus (shkolla e Pragës) për t'i përdorur ata në modelin e tij të *perspektives funksionale të fjalisë*. (von Heusinger 1999: 108)

[10] Halliday (2004: 57) i emërton kështu:
(i) Subjekti gramatikor = Subjekti
(ii) Subjekti logjik = Actor (Vepruesi)
(iii) Subjekti psikologjik = Tema

(8)



Në frymën funksionaliste, Halliday (2004: 58), këto konfiguracione kuptimore i përkufizon si vijon:


(i) 'Subjekti psikologjik' funksionon në fjali si një porosi. Fjalia ka kuptimin e një porosie, pra është një kuant informativ. Prandaj, subjekti psikologjik' është pikënisja e porosisë apo elementi i përzgjedhur nga folësi për të krijuar bazën apo fundamentin e asaj porosie (në atë mesazh).

(ii) 'Subjekti gramatikor (apo sintaksor)' funksionon në fjali si një shkëmbyes. Fjalia bën shkëmbimin (apo më mirë të themi ndërshkëmbimin) ndërmjet folësit dhe dëgjuesit. Prandaj, 'subjekti gramatikor' është garant i këtij ndërshkëmbimi, ai është elementi për të cilin folësi kujton se është "përgjegjës" për korrektësinë (gjuhësore) të asaj që është duke thënë.

(iii) 'Subjekti logjik' funksionon në fjali si një paraqitje apo pasqyrim. Fjalia pasqyron apo projekton një proces a ngjarje në rrafshin gjuhësor. Prandaj, 'Subjekti logjik' është pjesëmarrës aktiv në këtë proces, ai është elementi i portretizuar nga folësi si bërës (apo bartës) i një procesi.

Konstatimi se (vetëm) përshkrimi sintaksor i fjalisë nuk mjafton për të përfshirë të gjitha aspektet e kuptimit të fjalisë nuk është i ri. Një konstatim i tillë u evidentua qysh në shek. 19 (Heusinger 1994: 113). Dallimet kuptimore të fjalisë iu ngarkuan një strukture të brendshme psikologjike, sepse supozohej që fjalët janë koncepte psikologjike apo ide mentale, kurse kuptimi i fjalisë ishte në harmoni me operimin e atyre ideve. Për ta shpjeguar se për çka ishte fjala, po e ilustrojmë me një perceptim pamor:

(9) a) b)





Në (9a) pamja është e strukturuar në figurë dhe prapavijë (e zezë), duke na lënë mundësi ta shohim në dy mënyra: ose si kupë (figura) ose si dy portrete femrash (prapavija). Kurse, në (9b) figura është një saksofonist, ndërkaq prapavija (e bardhë) është një fytyrë femre[11].

Para se të vazhdojmë me tutje, duke u nisur nga fakti se fjalia "prodhon" në secilin rrafsh gjuhësor kuptime të ndryshme, po japim një vërejtje të bërë nga Garver (1967) dhe dallimin ndërmjet subjektit dhe predikatit. Sipas Garver (1967: 285) gjërat ngatërrohen nëse tentohet që dallimi ndërmjet subjektit dhe predikatit të merret parasysh vetëm në njërin rrafsh, sepse, siç u pa më lart, ata janë disa. Por ai këshillon që ngatërresat shtohen nëse dallimi në njërin rrafsh i referohet dallimit në rrafshin tjetër. Pra, nëse lidhim specifikat e subjektit gramatikor me ato të subjektit psikologjik apo të atij logjik (shiko edhe Heusinger 1999: 104), e aq më tepër (siç u pa më lart) kur një gjymtyrë e vetme është bartëse e të gjitha llojeve të subjektit.

Tash të provojmë pohimin e Çelikut lidhur me rolin e predikatit në rrafshin semantik. Ai pohon se predikati e kontrollon subjektin semantikisht (f. 8). Më konkretisht: "Folja-kallëzues sipas natyrës së saj semantike kërkon e kufizon semantikisht krahas kundrinorëve, edhe kryefjalën" (f. 22). Po supozoj se për Çelikun kryefjala është ekuivalente me subjektin gramatikor që parashtruam këtu, sepse ai përmend veçmas subjektin logjik (f. 25) dhe predikatin logjik (f. 26), ani pse nuk i shtjellon më hollësisht. Ai thotë se fjalia:

(10) Treni kritikoi nxënësit.

nuk mund të thuhet, sepse "folja **kritikoj** kërkon për kryefjalë një emër frymori, si p. sh. *mësuesi*, *prindi*, etj. *Mësuesi kritikoi nxënësit"* (f. 22). Natyrisht, një konstatim i tillë është në pajtueshmëri të plotë me mësimet gjuhësore, mirëpo në aspektin formal, fjalia (10) (përjashto semantikën) gramatikisht është plotësisht korrekte. Pra, ngjashëm siç pohon Çomski me fjalinë e tij tashmë të famshme: *Colorless green ideas sleep furiously* (*Idetë e gjelbra pa ngjyrë flenë të tërbuara*), e cila nuk ka kuptim fare (sepse *idetë* nuk *flenë* e as që janë *të gjelbra*), por nga pikëpamja fonetike e sintaksore është plotësisht korrekte. Por meqë Çeliku e konsideron *thënien* si esencia-

[11] Lidhur me ngjashmëritë pamore dhe gjuhësore dhe teorinë Gestalt (Gestalttheorie), si emërues i përbashkët i këtyre analogjive, shih Abrashi (pregatitje për shtyp).

le për sintaksën në të cilën faktori pragmatik luan rol të rëndësishëm, atëherë, nuk do të duhej që modeli i tij të mos lejonte situata hipotetike, të cilat mund të shfaqen në një film multiplikativ, ku, p. sh. *treni* do të kishte rolin e *një mësuesi* imagjinar që kritikon nxënësit. Apo së paku të parashikoheshin rregullat se si t'u qasemi situatave të tilla. Ngjashëm mund të konstatohet edhe për shembullin e marrë nga Çeliku rreth kontrollimit të kundrinorëve nga folja:

(11) Mësuesi e vendosi librin


Shembulli padyshim, siç pohon edhe Çeliku, kërkon rrethanorin '*në raft*' për ta përmbyllur fjalinë (M*ësuesi e vendosi librin në raft*.). Mirëpo, edhe këtu mund të parafytyrohet një situatë kur nxënësit, për shkak të shtatshkurtësisë së tyre nuk mund t'i vendosin librat *në raft*, por vetëm *mësuesi* dhe (ta zëmë) *sekretari*, të cilët janë mjaft të gjatë për t'i vendosur ato. Kështu, në pyetjen: *kush e vendosi librin*, përgjigja fare lehtë mund të ishte: *Mësuesi e vendosi librin*, natyrisht me kusht që i pranishëm të jetë edhe intonacioni përmbyllës i fjalisë. Në fakt, Çeliku nuk e përjashton korrektësinë e shembullit në (11). Përkundrazi, ai insiston, sepse disa faqe më tutje (f. 39) thotë se gjymtyrët duhet analizuar "sipas vlerës kumtuese" dhe për të dëshmuar merr shembullin: *Makina ndaloi në qendër të qytetit* dhe pohon se *në qendër të qytetit* përbëhet nga "një *gjymtyrë* dhe dy *përbërësa*[12]" sepse "numri i gjymtyrëve varet nga situata konkrete ligjërimore e vetë *thënies*". Por në një situatë të njohur, p. sh. nëse *makina* është nisur *në Tiranë*, do të kishim dy gjymtyrë dhe dy përbërës, kështu që *Makina ndaloi në qendër* do të ishte fjali korrekte.

Pra, mund të konstatohet se predikati i kontrollon pjesërisht semantikisht plotësat e vet. Po themi mund, sepse është një çështje zgjedhëse dhe jo e detyrueshme, për dallim nga kongruenca kontekstuale të cilën e përmendëm më lart. Mirëpo, nëse në analizë është përfshirë *thënia* apo struktura informative e fjalisë (siç quhet në literaturën e re), atëherë duhet të sqarohet se ku është vendosur, pozicionuar ajo, në rrafshin: sintaksor, semantik apo pragmatik. Për shkak se varet nga konteksti, disa e vendosin në rrafshin pragmatik dhe kanë krijuar mjete për të, siç është p. sh. valenca pragmatike (Helbig: 1992, Agel 2003), në të cilën vendosen të gjithë plo-

[12] Rreth njësive sintaksore të përdorura nga Çeliku shiko në vijim paragrafin 4.

tësat rrethanorë të detyrueshëm siç u diskutua në shembullin (11). Te modeli gjenerativist ajo paraqitet nëpërmjet imtësimit të konfiguracionit të periferisë së majtë të strukturës së drurit dhe postulimit të tri shtresave strukturore të fjalisë[13] (Rizzi 2000: 261 apo Koleci/Turano 2011: 94), të paraqitura në (12):

(12)



3. A ka gjuha shqipe fjali të thjeshta njëkryepërbërëse?

Çeliku njeh dy kryepërbërësa[14]: subjektin dhe predikatin. Për këtë ai mbështetet në konceptin tradicional të fjalisë ku predikati është pjesa e mbetur e fjalisë kur t'i hiqet subjekti:

(13) a) Mësuesi kritikoi nxënësit.

b) *Mësuesi* - **subjekti**

c) *kritikoi nxënësit* - **predikati**

Siç u tha më herët, numri dhe veta e foljes përcaktohet (pjesërisht) nga subjekti me anë të kongruencës, kurse a do të ketë subjekti p. sh. Tiparet semantike [+/- njerëzor] ose [+/- frymor] apo ndonjë tjetër, varet (pjesërisht) nga predikati. Thënë ndryshe, prania e njërit apo tjetrit reflektohet në

[13] Kjo do të thotë se thënia është e përfshirë në modelet e gjuhësisë strukturaliste perëndimore. Pohimi Çelikut se ky model paraqet një risi (f. 36) nuk qëndron.

[14] Jo **kryegjymtyrë**, sepse sipas tij gjymtyra është kategori funksionale (21) dhe kufiri i saj varet nga thënia (f. 39-41). Sipas Çelikut, **thënia** është po ashtu kategori funksionale dhe dallon nga fjalia, e cila është kategori formale (sintaksore). Një fjali mund të ketë disa thënie, e kjo e fundit përbëhet nga dy pjesë: **tema** (subjekti psikologjik) dhe **rema** (predikati psikologjik).

njërin apo tjetrin, por në mënyrë të anasjelltë. Në fakt ata jo vetëm që janë pranë njëri tjetrit, por (ç'është më e rëndësishmja) ata tashmë kanë hyrë në marrëdhënie të ndërsjellë, e cila eventualisht prodhon tri konfigurime të kuptimit ashtu siç u paraqit më lart.

Sipas Çelikut, gjuha shqipe ka "edhe tipin e fjalive pa kryefjalë e pa kallëzues, por edhe fjalitë me një përbërës kryesor... një kryepërbërës të vetëm. Fjalitë e ndërtuara mbi këtë bazë do të quhen... **fjali njëkryepërbërëse**" (f. 13). Pikërisht këto të fundit janë temë diskutimi në vijim. Për të ilustruar pohimin e tij ai merr disa shembuj (f. 14) dhe thotë se: "Në të gjitha këto fjali... nuk ka, as mungon, as nënkuptohet...as nuk vendoset dot një kryefjalë formale, prandaj teoretikisht as nuk mund të thuhet se kemi një kryefjalë zero" (f. 14-15). Në mesin e këtyre shembujve janë edhe këta:

(14) a) Vranë Halim Xhelon! (ata).

b) Djalin e morën ushtar. (ata)

c) Natën trokitën. (ata)

d) Nisemi (ne)

e) Pranoj ofertën (unë)

f) Mos parko (ti)

Lista e Çelikut është më e gjatë, por në (14) janë paraqitë vetëm disa prej tyre. Është e padiskutueshme që në (14) nuk ka nevojë për praninë e kryefjalës. Mirëpo a mund të thuhet se ajo nuk nënkuptohet? Nisur nga shembujt në (14 a-14f), përgjigja nuk është e thjeshtë dhe së paku kërkon sqarime shtesë. Para se të vazhdojmë, duhet thënë se Çeliku nuk e përjashton shfaqjen e subjektit zero: "kryefjala zero njihet në struktura ... *Mjeku hyri brenda. Ndezi dritën. U ul në tavolinë*." (f. 15). Ai i konsideron fjalitë me kryefjalë zero si fjali dykryepërbërëse jo të plota. Sipas tij "kjo ndodh kur ajo është thënë një herë më parë dhe nënkuptohet lehtë nëpërmjet kontekstit a situatës" (f. 137). Por Çeliku nuk tregon se ku duhet të jetë i pozicionuar dëftori anaforik (kryefjala zero) në gjuhën shqipe për të realizuar funksionin e tij koheziv të tekstit. Sidoqoftë, le të bëjmë pyetjen (e zakonshme) për të gjetur subjektin: *Kush e vrau Halim Xhelon*?, e cila mund të pasojë pasi dikush të ketë thënë: *Vranë Halim Xhelon*. Përgjigja e mundshme do të ishte: *ata*. Prandaj shembujt mund të modifikohen si vijon, duke

vepruar në mënyrë të ngjashme (me pyetje përgjigje) edhe me shembujt e tjerë, të cilët japin përgjigje të mundshme përemrat përkatës në (14) shënuar në kllapa përbri secilit shembull:

(15) a) Ata vranë Halim Xhelon!

b) Ata e morën djalin ushtar.

c) Ata trokitën natën

d) Ne po nisemi.

e) Unë (po) pranoj ofertën

f) Ti mos parko, por ai.

Për Çelikun besoj nuk është diçka e paditur se ka nevojë për sqarime shtesë për të përkufizuar kushtet se kur nuk mund të nënkuptohet kryefjala. Përkundrazi, në f. 134 lidhur me format e pashtjelluara të foljes '*punoj*', '*punuar*' (pjesorja) dhe '*duke punuar*' (përcjellorja), ai thotë: "janë folje, forma të pashtjelluara ... që emërtojnë një veprim të caktuar, por nuk merret vesh nëse shprehin një veprim real apo joreal... *nuk kuptohet se kush e kryen veprimin* (nënvizuar nga T. A.)... forma e shtjelluar punoj nëpërmjet mbaresës... tregon një veprim ... që *kryhet nga folësi* (nënvizuar nga T. A.)...". Gjatë këtij konstatimi ai nuk përmend kryefjalën zero (anaforike). Nga ana tjetër, ai është i vetëdijshëm lidhur me faktin se: "një nga çështjet e diskutueshme të sintaksës në përgjithësi dhe të sintaksës së shqipes është njohja apo jo e fjalive njëkryepërbërëse" (f. 36) dhe se "ato i mohonte sintaksa tradicionale... duke i barazuar... me fjalitë dykryepërbërëse të paplota" (po aty). Prandaj, për ta mbështetur tezën e tij, si argument shtesë, merr *thënien*, realizimin gjuhësor konkret të fjalisë, e cila "i përket sistemit abstrakt gjuhësor" (f. 33). Sipas tij del se shembujt në (14) dhe (15) nuk kanë strukturë ekuivalente. Për të ilustruar këtë ai merr shembullin:

(16) a) U"në i shkrova.

b) I shkro"va.

Shembujt (16a) dhe (16b) nuk janë të ndërkëmbyeshëm sepse: "ndërtimi gramatikor dhe kuptimi i këtyre dy fjalive është krejtësisht i ndryshëm" (po aty). Arsyeja është se ata përdoren në situata dhe diskurse të ndryshëm, të cilët (diskurse) Çeliku i krijon duke bërë pyetjen: *Ku"sh i shkroi nënës?*, përgjigja do të mund të ishte vetëm (16a) apo *U"në*, por jo

(16b). Për Çelikun (16b) është përgjigja në pyetjen *I shkro've letër nënës*? Prandaj, konkludon Çeliku: "...këto janë ndërtime me dallime të rëndësishme formale gramatikore, intonacionore dhe kumtuese" (f. 37).

Pa diskutim, dallimi ndërmjet fjalive me përemra vetorë të zëshëm dhe të shurdhët si në (16a) dhe (16b) është evident. Kështu është edhe në gjuhë të tjera me eptim të pasur të foljes (spanjisht, italisht etj.). Gjuhë të tjera, si p. sh. gjermanishtja, kanë vetëm variantin me përemra të zëshëm: *Ich habe meine Mutter geschrieben*. Mirëpo si te shembulli i foljes '*puno,j*', i referuar nga Çeliku, që me mbaresat e saj tregon se kush është bërësi i veprimit, edhe folja '*shkrova*' tregon se bërësi është folësi vetë. Edhe sikur të mos shfaqej fare përemri vetor në (16a), dëgjuesi do të (nën)kuptonte se bërësi i këtij veprimi është folësi. Kam frikë se në argumentimin e Çelikut disa gjëra po ngatërrohen në frymën e Garver-it (1967). Së pari, kur thuhet kuptimi, atëherë do të duhej që ai të specifikohet: kuptimi në pikëpamje semantiko-logjike apo në pikëpamje informative. Të rikujtojmë, kuptimi semantik ka dy pjesëmarrës: atë që shkruan (unë) dhe atë të cilit i dedikohet shkrimi (nëna). Prandaj, (16a) edhe (16b) do të duhej të kishin strukturë semantike të njëjtë: *unë* (agensi) dhe *nëna* (recipient), sepse jo vetëm në gjuhën gjermane (e cila patjetër kërkon vetorin në të dy rastet), edhe në gjuhën shqipe nevojiten dy pjesëmarrës për të realizuar ngjarjen e shkrimit të letrës. Së dyti, informata e re (apo e vjetër) brenda fjalisë nuk është e thënë se është informatë e re (apo e vjetër) në kuadër të diskursit (apo tekstit) (Heusinger 1999:102). Në kuadër të fjalisë informata është e spikatur nëse ka qenë deri atëherë e panjohur, pra e re. Kurse te diskursi, informata më e spikatur është ajo që kualifikohet për të licencuar relacionet anaforike (më tutje) në tekst. Çeliku nuk e dallon informatën e re në kuadër të fjalisë dhe në kuadër të diskursit. Në literaturë testi me anë të pyetjeve, të cilin e përdor edhe Çeliku, lidhet me diskursin (Heusinger 1999: 103). Së treti, nëse është fjala për informatë të re të cilën e merr dëgjuesi, siç ndodh në shembullin (16a), duhet përsëri që kjo informatë e re të jetë më e specifikuar, sepse struktura informative ka disa dimensione e jo vetëm **temën** e **remën** (Musan 2004)[15]. Kështu, mund të shtrohet pyetja: a është informatë

[15] Kohën e fundit thënia apo struktura informative ka përjetuar një zhvillim të hovshëm, duke përfshirë shumë studius që i përkasin shkollave të ndryshme të cilët kanë zbuluar dimensione të ndryshme të thënies. (Musan (2004)

e re në pikëpamje **referenciale** apo në pikëpamje **relacionale**? (Gundel 2003). Siç dihet, njëri ndër funksionet e përemrave është t'i zëvendësojnë emrat në situata të ndryshme, referenti i të cilëve është i njohur. Ata gjithashtu përdoren për të shënuar sende të cilat janë të njohura (apo kanë referencë) për folësin dhe dëgjuesin ose shënojnë entitete të cilat janë fizikisht të dukshme apo të pranishme për folësin dhe dëgjuesin. Pra, kur përdoret përemri, folësi dhe dëgjuesi e dinë se për kë është fjala, kështu që përemrat konsiderohen si referentë të njohur në kuadër të diskursit. Rrjedhimisht, *unë* si referent është i njohur, por si informatë mund të jetë informatë e panjohur. Këtë e vërteton dhe theksimi fonetik i përemrit U"në në (16a).

Kështu mund të nxirret ky pfundim: fjalitë (16a) dhe (16b) nuk kanë dallim në strukturën logjiko-semantike, subjekti (logjik) në (16b) është i nënkuptueshëm, përemri *unë* nuk sjell në diskurs ndonjë informatë shtesë referente. Dallimi ndërmjet (16a) dhe (16b) është në rrafshin fonetik dhe në rrafshin pragmatik, ku supozojmë se është e vendosur struktura informative e fjalisë (Lambrecht 2004), ashtu që në këtë të fundit, fjalitë dallohen vetëm në nivelin relacional, në të cilin shfaqet informata e re, e panjohur deri atëherë për dëgjuesin.

Kjo më së miri mbase mund të shpjegohet me strukturën e drurit. Në shtresën e poshtme folja 'shkruaj' i licencon rolet e veta semantike, duke hyrë në relacion me subjektin, me të cilin përshtatet në shtresën e mesme duke marrë nga caktuesori i kësaj shtrese tiparet e vetës dhe numrit. Nëse subjekti nuk është i shurdhët, pra është një informatë e re relacionale, ai kalon nga shtresa e përshtatjes (AGR) në shtresën e lartë për të plotësuar kënaqur nevojën e diskursit. Përndryshe, nëse subjekti është i shurdhët, ai do të përjashtohet nga struktura, kurse tiparet e vetës dhe numrit nga antecedenti i kualifikuar për të licencuar relacionet anaforike do të barten te subjekti zero (anaforik). Se përshtatja është e pranishme e dëshmon forma e foljes, e cila në të dy rastet është identike. Thënë shkurt: *U"në* është i vendosur në majën e drurit, në shtresën më të lartë të strukturës.

Këtu pra, divergjojmë me Çelikun i cili kujton se qëndrimi i "sintaksës logjiciste shqiptare e të huaj, e cila kërkonte domosdo kryefjalë... duke barazuar kështu fjalinë me gjykimin" (f. 38) është qëndrim i vjetruar, sepse "ai nuk e njeh sintaksën e *thënies*". Mirëpo, analiza e bërë më lart më

shumë flet se këtu mund të jetë fjala për ngatërrime të rrafsheve dhe niveleve nga ana e Çelikut (në frymën e Garver-it (1967)).

Mirëpo për shkak se mund të pohohet se analiza, sidomos ajo që i referohet drurit sintaksor dhe shtresave hierarkike në (12) mund të jenë të bazuara në supozime interne të modelit gjenerativist, po bëjmë edhe një analizë me një qasje alternative. Siç u tha më lart, nga krahasimi ndërmjet (16a) dhe (16b) themi se forma e foljes mbetet e pandryshuar me apo pa subjekt. Por nëse në vend të përemrit *unë* e vendosim përemrin *ti*:

(17) a) TI **i shkrove.**

b) **I shkrove**.


Forma e foljes ndërron nga *shkrova* në *shkrove*, por përsëri vërejmë se nuk ka dallim ndërmjet formës së foljes në (17a) dhe (17b), me apo pa praninë e subjektit, që dëshmon për një situatë të ngjashme si në (16). Pyetja është se a kemi si në fjalitë nën a) ashtu edhe në fjalitë nën b) relacion ndërmjet subjektit dhe predikatit? Në gjuhën shqipe dukuria e përshtatjes edhe kur subjekti është i shurdhët është e pranishme edhe te strukturat e tjera. Më konkretisht: te rasti i predikateve dytësore me mbiemra depiktiv. Sipas gramatikës së Akademisë (1995), në gjuhën shqipe "nyja e mbiemrit, në rasën kallëzore të njëjësit, si dhe në rasën emërore e kallëzore të shumësit (pa dallim gjinie) del me dy trajta, *të* dhe *e*. Trajta *e* del atëherë kur mbiemri vjen pandërmjetshëm pas një emri të shquar. Në rastet e tjera del trajta *të*. Pra, trajta *të* del kur mbiemri vjen pas një emri të pashquar si dhe atëherë kur midis tij dhe emrit të shquar **ndodhet një fjalë tjetër** (nënvizuar nga T. A.). Trajta *të* del edhe kur mbiemri i nyjshëm përdoret në funksion kallëzuesor" (Gr. e Ak. 1995: 171).

(18) a) Agimi hëngri supën **e** ftohtë. Lidhje atributive

b) Agimi hëngri supën **të** ftohtë. Lidhje predikative

Shembujt në (18) dallojnë jo vetëm për nga forma, por edhe për nga struktura, sepse nyja e mbiemrit në (18b) është *të*, e jo *e* si në (18a). Meqë emri në të dy rastet është i shquar (*supën*), themi se në (18b) ndërmjet emrit dhe nyjës së mbiemrit është ndërkallur një fjalë tjetër, e cila në këtë rast është e padukshme apo e shurdhët.

(19)



Në diagramin (19), përbërësi PRO paraqet 'fjalën e padukshme', e cila në fakt është subjekti i sifjalisë si rezultat i lidhjes predikative të emrit me mbiemrin. Indeksi '*i*', i pranishëm tek emri (*supën*) dhe te PRO shënon lidhjen anaforike që ekziston ndërmjet këtyre dy elementeve. Se është kështu e dëshmon edhe analiza e Buchholz (1987:462), sipas së cilës një fjali që në vete ngërthen një atribut predikativ (siç e quan ajo mbiemrin depiktiv), ka një strukturë të brendshme që përbëhet prej dy fjalive:

(20) (I) një fjali të plotë dhe

(II) një fjali të përbërë: SUBJEKTI+është+predikati dytësor,

Kështu për shembullin (17b) themi se predikati depiktiv i referohet objektit nëse subjekti i fjalisë (II) është identik me objektin e fjalisë (I)

(21) (I) Agimi e hëngri **supën** dhe

(II) **Supa** ishte/qe e ngrohtë.

Shembulli i predikateve dytësore tregon se relacioni ndërmjet subjektit dhe predikatit nuk prishet edhe nëse kryefjala është e padukshme, sepse është mbaresa e vetës ajo që siguron praninë e subjektit. Kështu madje pohon tërthorazi edhe Çeliku: "forma e shtjelluar punoj, nëpërmjet mbaresës (mjet gramatikor formal), tregon një veprim real, që **kryhet nga folësi** (nënvizuar nga T. A.) në kohën e tashme dhe veprimi i saj është i lidhur me realitetin" (f. 134). Për të përforcuar tezën e vet, Çeliku pohon se ekziston një dallim struktural ndërmjet fjalive dykrypërbërëse dhe njëkrye-përbërëse: "në fjalitë njëkryepërbërëse mund të flitet vetëm për predikativitet e jo për kallëzuesi" (f. 136), sepse relacioni send + tipar i kallëzuesisë "... është një shfaqje e predikativitetit në një tip të caktuar fjalish, siç janë fjalitë dykryepërbërëse" (f. 135). Sipas tij, secila fjali (pa dallim) me apo pa

kryepërbërës, ka tiparin e predikativitetit[16]. Një konstatim i tillë i Çelikut është në harmoni me konceptimin e fjalisë nga ana e Vinogradovit (Admoni 2002: 135, Moskalskaja[17] 2004: 214). Ky gjuhëtar rus pohon se për dallim nga fjala dhe togfjalëshi të cilët janë vetëm shënues të sendeve, fjalia përmban një indikacion mbi marrëdhënien e asaj që thuhet në fjali dhe realitetit[18]. Është pikërisht ky indikacion, i shprehur gjuhësisht me: modalitetin, kohën dhe vetën, që nga fjalët "e vdekura" prodhon gjuhën "e gjallë". Për këtë arsye disa gjuhëtarë rusë e konsiderojnë predikativitetin si një "forcë" (krijuese të fjalisë), kurse modalitetin e fjalisë si treguesin më të spikatur të tij. Modaliteti shprehet nëpërmjet formës së shtjelluar të fojes (kategorisë gramatikore të mënyrës) dhe foljeve modale. Mirëpo ai paraqitet edhe p.sh. te fjalia *Dimër ...* te vargjet e Pushkin-it: *Зима. Что делать мне в деревне* (*Dimër. Çdo të bëj në fshat?*). Te kjo fjali njëkryepërbërëse, predikativiteti shprehet, siç pohon edhe Çeliku, "nëpërmjet situatës, kontekstit dhe sidomos nëpërmjet intonacionit të përfunduar". Pra, modaliteti nuk lidhet vetëm me një dukuri gramatikore, por me një varg dukurish edhe të rrafshit pragmatik. Mirëpo lidhja me realitetin është një lidhje që nuk mund të (për)kufizohet saktë dhe rrjedhimisht mund të ketë interpretime të ndryshme. Kështu, sipas Admoni-t (2002: 136), modaliteti shfaqet edhe te togfjalëshat, sepse edhe këta e bëjnë "vlerësimin" e realitetit. Kjo u pa edhe tek predikatet dytësorë[19]. Gjithashtu, fjalët modale nuk modifikojnë vetëm fjalinë (*Ju duket **ndoshta** se kjo nuk mund të jetë e vërtetë.*), por edhe togfjalëshin (*Ndër të gjitha këto gjera të çuditshme apo gjëra **ndoshta** ogurzeza të shkon mendja tek imazhi i pafajshëm i një fëmije të vdekur*). Nga ana tjetër, Gladrow/ Kosta (1999: 192)[20] supozojnë se tipari i

[16] Tipari i predikativitetit në modelin gjenerativist ka si ekuivalencë frazën forcë (ForceP)

[17] Sipas Moskalskaja (2004: 221), kategorinë e predikativitetit e futi gjuhëtari rus Viktor Vinogradov, i motivuar nga përkufizimi i fjalisë të bërë nga John Ries, një gjuhëtar gjerman (Junggrammatiker), i cili përkufizoi fjalinë duke lidhur përmbajtjen e saj me realitetin.

[18] Krahaso p. sh. *ardhja e delegacionit* (grup fjalësh) me *delegacioni erdhi* (fjali).

[19] Shiko Admoni 2002: 136, lidhur me predikatin atributiv.

[20] Als typologisches Spezifikum des Russ ergibt sich, daß neben zweigliedrigen Strukturmustern, die aus grammatischen Subjekt und grammatischen Prädikat bestehen, auch emgliedrige Strukturmuster existieren, die kein gramm.. Subjekt explizieren. Die das Merkmal der Prädikativität signalisierende Komponente des eingliedrigen Satzes, die als Basisprädikat bezeichnet wird, unterscheidet sich vom Prädikat des zwelgiiedrigen Satzes darin, daß sie konstruktiv-sy'ntakt autonom eineen Satz repräsentiert und daß ihre morpholog Form fixiert ist Während die Form der Person, des Numerus und des Genus im zweigliedrigen Strukturnmüsler von grammat Subjekt diktiert wird. Ist das Basisprädikat im eingliedrigen Strukturmuster auf die 3 Pers Sg Neutr bzw. auf die 3.

predikativitetit te fjalitë njëkryepërbërëse e merr rolin e një predikati themelor, ashtu që e fikson tiparin e vetës dhe numrin në vetën e tretë njëjës ose në vetën e tretë shumës, për dallim nga fjalitë dykryepërbërëse te të cilat veta e numri diktohen nga subjekti nëpërmjet relacionit subjekt-predikat. Thënë ndryshe, nëpërmjet predikatit themelor, edhe te fjalitë njëkryepërbërëse ekziston relacioni i kallëzuesisë, ndonëse në një variant më të thjeshtuar. Pra, kontra Çelikut, i cili pohon se te fjalitë njëkryepërbërëse nuk ekziston relacioni i kallëzuesisë. Ai nuk përmend ndonjë predikat themelor dhe as fiksim të vetës, sepse në shembujt e tij (f. 136) të gjitha foljet janë të shtjelluara (*Ikim*, *Erdha. Mbahu fort pas meje. Vranë Halim Xhelon* etj.). Se relacioni i kallëzuesisë ekziston, kjo mbështetet edhe nga pohimi i Aleksander Potebnja-s, gjuhëtar e filozof rus (Admoni 2002: 165), i cili thotë se në shumicën e rasteve është folja ajo që domosdo e kërkon vepruesin, kështu që nëpërmjet vetës mund të bëhet projeksioni semantik i subjektit. Prandaj Admoni (po aty) flet për një "dykryepërëbërësi" morfologjike. Koncepti i "dykryepërbërësisë" morfologjike është integruar tashmë në teorinë e valencës dhe ai njihet si realizim mikrovalentor i subjektit, i cili madje mund të haset edhe tek gjuhët të cilat kanë vetëm fjali dykryepërbërëse, si gjuha gjermane: në imperativ *ess-t*! (*hani*!), *iss*-Ø (*haje*!) apo te stilet telegrafike *ankomm-e 12 Uhr* (*vij në ora 12*). Sipas Agel (2003: 414) këto fjali nuk është që nuk kanë aftësi "të mbajnë" subjektin, ato thjeshtë nuk mund të japin plotësa makrovalentorë në nominativ.

Sidoqoftë, besoj që është e qartë se këtu nuk është qëllimi i mohimit të predikativitet. Përkundrazi, ai është i pranishëm, por kam frikë se baza e tij teorike nuk është e qëndrueshme. Së paku jo aq e qëndrueshme sa është baza teorike e *forcës ilokutore* e fjalisë[21], koncept ky tashmë i etabluar në fushën e pragmatikës gjuhësore[22]. Qëllimi ishte të dëshmohej se predikativiteti dhe kallëzuesia janë të pranishme te të dy llojet e fjalive dhe, siç pohon Admoni (2002: 166), ata ndërveprojnë me njëri tjetrin dhe në këtë frymë duhet të pajtohemi se predikativiteti si tipar është kategori morfologjike, kurse kallëzuesia si relacion realizohet ndërmjet dy komponentëve të caktuar.

Pers Pl festgelegt.

[21] Këtu nuk po e komentojmë pse Çeliku zgjedh nocionin e predikativitetit e jo forcën ilokutore, por vetëm po shtoj se literatura për të parin (si specialitet rus) është shumë më modeste se për të dytin.

[22] Shiko p. sh. Hengeveld (2004)

4. Njësitë sintaksore, përkufizimi dhe tipizimi i tyre

Çeliku njeh dy njësi sintaksore: përbërësin dhe fjalinë. Përbërësi mund të jetë i thjeshtë (p.sh. *djali*), i thjeshtë i zgjeruar (*ky djalë*; kur emri nuk mund të qëndrojë vetëm ai kërkon dëftorin), i zbërthyeshëm (*në qendër të qytetit*, zbërthehet në dy përbërës: (i) *në qendër* dhe (ii) *të qytetit*). Përbërësat mund të jenë: emërorë (PE), foljorë (PF), mbiemërorë (PMb), numërorë (PN) dhe përemërorë (PPr). Kryefjala dhe kallëzuesi janë **kryepërbërësa**. Emërtimin **përbërës** Çeliku e merr nga sintaksa strukturaliste perëndimore, që është përkthim i termit anglisht **constituent**, për çka Çeliku na drejton tek Crystal-i (2008: 104) dhe fjalori i tij i gjuhësisë. Ai gjithashtu ia bën me dije lexuesit se **constituent** "është shumë i njohur nga gjuhësia perëndimore në kuptimin e përgjithshëm 'komponent'" (f. 6). Sigurisht ka menduar **component** me **c** e jo **komponent** me **k**, por sidoqoftë, fjala komponent në fjalorin e Crystal (2008: 95) nuk figuron se është ndonjë term konceptual i posaçëm në gjuhësi e, aq më tepër, aty thuhet se ajo shënon komponentet e modelit gramatikor gjenerativist (*phrase structure component*, *transformational morhophonemic component*). Kujtoj se i mbetet autorit ose të japë shpjegime shtesë ose ta bëjë modifikimin e duhur në ndonjë botim eventual të ardhshëm.

Sipas Çelikut, përbërësi sintaksor është njësi kuptimore, strukturoregramatikore dhe fonetiko-intonacionore, që konceptohet "si njësi sintaksore me një shtrirje të papërcaktuar, duke qenë njëfjalëshe, dy a më shumë fjalëshe a sifjali" (f. 3). Ai sugjeron që "lexuesi i këtij libri sa herë do të ndeshet... me termin '**përbërës sintaksor**'... do të nënkuptojë termin '**frazë**', që përdoret në gjuhësinë angleze-amerikane, termat '**sintagmë**' e '**grup fjalësh**' që përdoren në gjuhësinë frënge, gjermane, italiane, etj." (f. 2). Sipas tij, termi përbërës sintaksor është më i përshtatshëm, sepse termat e sipërm "të japin idenë e dy a më shumë fjalëve, duke përjashtuar rastin e shprehjes së tyre me një fjalë të vetme" (f. 18), kurse termi togfjalësh nuk mund të merret në konsiderim për shkak të konceptimit jo korrekt të tij (f. 17). Kushti i parë që duhet të plotësojë një fjalë për të qenë përbërës sintaksor është të jetë fjalë emërtuese (f. 53). Pra, fjalët funksionale nuk e kanë një privilegj të tillë. Ndoshta kjo e ka shtyrë Çelikun (f. 1) të pohojë se "Termi **përbërës sintaksor** ... është gati-gati barasvlerës (nënvizoi T. A.) i

termave '**sintagmë**', '**frazë**' a '**grup fjalësh**'... ", sepse ai e përjashton ekzistimin e përbërësit parafjalor, e siç dihet gjuhësia perëndimore bashkëkohore e ka njohur frazën, sintagmën a grupfjalëshin parafjalor (f. 15). Sipas tij, në gjuhën shqipe, "funksioni i drejtimit rasor të parafjalës është ndihmës, dytësor" (f. 16). Kushti i dytë "është aftësia e fjalës për t'u futur në lidhje dyshe" (f. 54). Kjo realizohet drejtpërdrejt nëse ajo ka formë të vetëmjaftueshme (p. sh. ***djali*** në fjalinë: ***Djali*** *u shërua në spital*) ose, nëse ka formë të pamjaftueshme, me ndihmën e caktuesorëve (p. sh. ***djalë*** në fjalinë: ***Një djalë*** *u shërua në spital*).

Sipas mendimit tim këto dy kushte nuk janë të përcaktuara sa duhet dhe ndoshta këtu qëndron burimi i inkonsistencave të modelit të Çelikut. Ja disa: (1) Në faqen 10 ai e përmend **përbërësin kokë**[23], kurse në f. 64 thotë: "Çdo përbërës sintaksor përmban një fjalë **kokë** ..., e cila kontrollon fjalët e tjera që lidhen me të dhe quhen **caktuesorë**...". Më lart e pamë se për të realizuar përbërësin emëror (PE) emri në trajtën e pashquar duhej të ndihmohej nga nyja jopërcaktuese *një*, kurse në trajtën e shquar ai ishte i vetëmjaftueshëm sepse nyjën e shquar ai e konsideron si pjesë të emrit. Nëse nuk është e pranishme nyja, caktuesor mund të jetë ndonjë përemër: ***ai*** *djalë*, ***atë*** *djalë*, ***ky*** *djalë* etj. Sipas tij, "Koka bart pjesën qendrore të informacionit, ndërsa caktuesorët janë bartës të <u>një informacioni special shoqërues</u> (nënvizoi T. A.)" (f. 64). Këtu mund të shtrohen pyetjet: (i) Pse emri i pashquar është i pavetëmjaftueshëm, a ka bazë kognitive për një pohim të tillë? (ii) Cili është ky <u>informacion special</u> i caktuesorit? dhe (iii) Pse nuk është kokë fjala shërbyese, ngase përveç bartjes së informacionit special, prania "e caktuesorëve u jep fjalëve një kuptim konkret" (f. 54). Madje, përemri, për dallim nga emri në trajtë të pashquar, është i vetëmjaftueshëm dhe mund të qëndrojë edhe vetëm. Mirëpo Çeliku vazhdon edhe më tutje në këtë drejtim: "në situata të caktuara ligjërimore edhe një emër i pashquar pa nyjë joshquese <u>mund të jetë përbërës sintaksor</u>, ... (nënvizoi T. A.)" (f. 57):

(22) a) **Makinë** ndaloi para portës.

(23) b) Para portës ndaloi **makinë**.

[23] Përbërësi kokë paraqitet edhe në faqen 20.

Sepse (pas tij) "Në këtë thënie flitet për llojin e sendit që ka ndaluar para portës (*makinë* e jo *karrocë*) dhe jo për një ekzemplar që përfaqëson një klasë sendesh homogjene... theksi logjik bie mbi emrin *maki"në*". Pohimi i Çelikut, edhe nëse nuk është korrekt, dëshmon qartë se kushti i dytë nuk është i përcaktuar si duhet. Ai duhej të përfshinte edhe rastet e pohuara nga ai. Pavarësisht nga kjo, pohimi i tij, ai së paku dy herë është në kontradiktë me modelin e Çelikut. Së pari, nëse theksi bie mbi emrin *maki"në*, atëherë emri është në domenin rematik e jo tematik. Së dyti, nëse kryefjala është në domenin rematik, atëherë si mund të themi se kemi *thënie*, nëse pikënisja e kësaj *thënieje* (kryefjala) është e pacaktuar gjegjësisht e panjohur? Si duket Çeliku është i bindur se kryefjala mund të shprehet "me emër të pashquar, njëjës a shumës, pa nyjat joshquese" (f. 139).

Kur është fjala rreth tipizimit të përbërësve bie në sy se përveç përbërësit emëror, mbiemëror e ndajfoljor, modeli i Çelikut e ka edhe përbërësin përemëror dhe numëror (f. 64). Meqë përemri është fjalë funksionale, mbetet e paqartë se si e fitoi statusin e elementit kryesor, kur ai nuk mund të jetë madje as përbërës. Sikur të ishin listuar kriteret lidhur me çështjet statusore të fjalëve funksionale (përbërës - jopërbërës; kokë - jokokë), atëherë do të kishte mundur të provohej statusi edhe i fjalëve të tjera funksionale. Ngjashëm është edhe me **përbërësit e thjeshtë të zgjeruar** dhe **përbërësit e zbërthyeshëm**. Kështu, nuk dihet pse "emra që tregojnë shumësi sendesh+emër në rrjedhore (një kope dhensh, një mori njerëzish...)" (f. 59) janë përbërës të thjeshtë të zgjeruar, kurse "emër+emër në rrjedhore (dru ahu, gotë uji...)" (f. 61) janë përbërës të zbërthyeshëm. Apo pse "emërtimet e përbëra nga dy a më shumë fjalë (Liqeni i Pogradecit, Maja e Hekurave...)" janë përbërës të thjeshtë të zgjeruar, kurse "emër i shquar+emër në gjinore (...lumi i Drinit, mali i Dajtit)" janë përbërës të zbërthyeshëm.

5. Literatura

Abrashi, Teuta (2013): *Sprach vs. Bild Perspektivierung-Strukturelle Ähnlichkeiten und Differenzen*, në Die Sprache im Bild – Das Bild in der Sprache/ Brikena Kadzadej, Mario de Matteis, Jenny Kraja-Priester, Jürgen Röhling/ Wilhelm Schellenberg (Hrsg.) 1. Aufl. ATHENER-Verlag, 101-109.

Admoni, Wladimir (2002): *Sprachtheorie und deutsche Grammatik-Aufsätze aus den Jahren 1949-1975*, Niemeyer, Tübingen

Agel, Vilmos et. al. (2003): *Depedency and Valency-An International Handbook of Contemorary Research*, De Gruyter, Berlin

Buchholz, O./ Fiedler W. (1987): *Albanische Grammatik.* Leipzig: Enzyklopädie Verlag.

Crystal, David (2008): *A Dictionary of Linguistics and Phonetics-Sixth Edition*, Oxford, Blackwell Publishing

Çeliku, Mehmet (2012): *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit Sintaksorë) - Vështrim i ri teorik*,

Fromkin, Victoria A. Ed.(2000): *Linguistics-An Introduction to Linguistic Theory*, Oxford, Blackwell Publishers Ltd.

Garver, Newton 1967. *Subject and Predicate*. In: P. Edwards (ed.). *The Encyclopedia of Philosophy Vol. 7*. New York: MacMillan Publishers, 33-36.

Gladrow, Wolfgang/Kosta, Peter (1999): *Syntax und Syntaxkonzeptionen.* Në: Jachnow, Helmut et al. (eds.). *Handbuch der sprachwissenschaftlichen Russistik und ihrer Grenzdisziplinen*. Wiesbaden. 386-424.

Gundel, Jeanette K. (2003): *Information Structure and Referential Givenness Newness: How Much Belongs in the Grammar?*, Proceedings of the HPSG03 Conference Michigan State University, East Lansing, CSLI Publications, http://csli-publications.stanford.edu/.

Halliday, M.A.K/Christian M.I.M. Matthiessen (2004): *An Introduction to Functional Grammar*-third edition, Arnold Hodder, London.

Helbig, Gerhard (1992): *Probleme der Valenz-und Kasustheorie*, Niemeyer, Tübingen

Hengeveld, Kees (2004): Illocution, mood, and modality. Në: Booij/ Lehmann/ Mugdan/ ·

Herbst, Thomas/ Katrin Götz-Votteler (2007): *Valency- theoretical, descriptive, and cognitive issues*, Berlin, De Gruyter.

Heusinger, von Klaus (1999): *Intonation and Information Structure*, Habilitations-schrift,

Jungen, O./H. Lohnstein (2006): *Einfürung in die Grammatiktheorie*, Wilhem Fink Verlag. München, UTB 2676.

Koleci, Flora/ Giuseppina Turano (2011): *Hyrje në Sintaksën Gjenerative të Shqipës*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar (SHBLU), Tiranë.

Krifka, Manfred (2006: 3): *Informationsstruktur: Prosodische, syntaktische, semantische, pragmatische Aspekte-Vorlesung*, Institut für deutsche Sprache und Linguistik, Humboldt-Universität zu Berlin, SS 2006.

Lambrecht, Knud (1994): *Information Structure and sentence form-Topic, fokus and mental representations of discourse referents*, Cambridge University Press, New York

Li, Charles (ed.) 1976. *Subject and Topic*. New York: Academic Press.

Lohnstein, Horst (2011): *Formale Semantik und Natürliche Sprache*, Berlin, De Gruyter

Moskalskaja, O. I. (2004): *Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, ACADEMIA, Moskva.

Musan, Renate (2010): *Informationsstruktur*, Heidelberg, Universitätsverlag Winter

Rizzi, Luigi (2000): *Comparative Syntax and Language Acquisition*, Routledge, London/ New York.

Seuren, Pieter A.M (1998): *Western Linguistics: an historical introduction*, Oxford: Blackwell Skopeteas: *Morphologie- Ein internationales Handbuch zur Flexion und Wortbildung*, Tiranë, Shtëpia botuese, Shtypshkronja ILAR University of Konstanz.

Van Valin, Robert D. Jr. (2004): *An Introduction to Syntax*, Cambridge University Press, Cambridge.

Votteler, Katrin Götz (2007): *Describing semantic valency*, Në: Herbst, Thomas/ Katrin Götz-Votteler (2007): *Valency- theoretical, descriptive, and cognitive issues*, Berlin, De Gruyter, f. 37-61 Walter de Gruyter, Berlin-New York.

Zifonun, G/ Ludger, H../Strecker, B. (1997): *Grammatik der deutschen Sprache*, Walter de Gruyter · Berlin · New York.

Teuta ABRASHI, Prishtinë

ARE THERE MONOMIAL SENTENCES (WITHOUT SUBJECT) IN ALBANIAN? REFLECTIONS ON MEHMET ÇELIKU'S SYNTAX

Summary

The recently (2012) published *Syntax of the Albanian language (Syntactic Ingredients)*' by Mehmet Çeliku, as pointed out by the reviewers of the book, raises some controversy discussions, like the structure of the Albanian sentence, especially the zero subject sentences.

The main objective of the article is opposing Çeliku's claim that in these sentences neither overt nor covert subject is present, arguing the presence of covert (morphological) subject which is shown through the grammatical feature of person at the verbal morphology. Consequently, similar to sentences with overt subject, the structure of these sentences show also the presence of the predicative relation and predicatively which refer to the "Russian" conceiving of the sentence illocunary force. In this sense, due to the weak theoretical bases and lack of the literature and references, the article suggests to adopt illocunary force instead. The concluding remarks of the paper is concerned with inconsistencies and consequent weakness of defining the syntactic units as the result of the unclear definition of criteria's why some functional items are qualified and some rejected to constitute the syntactic constituent, which (in this book) represents the equivalence of the phrase.

Sahadete LIMANI - BEQA, Prishtinë

METODOLOGJIA E ANALIZËS KRITIKE TË DISKURSIT PËR KËRKIMET NË FUSHËN E TRANSFORMIMEVE SHOQËRORE-POLITIKE. NJË VËSHTRIM KRITIK.

KDU 811:316

Abstrakt

Në kërkimet mbi raportin në mes të diskursit publik medial dhe pushtetit e politikës në shoqëri një vend të rëndësishëm zë teoria dhe metoda e analizës kritike të diskursit (AKD). Termi diskurs këtu i referohet gjuhës së përdorur në tekste të shkruara, gojore e pamore. Teza themelore nga e cila niset analiza kritike e diskursit është se gjuha e folur dhe e shkruar jo vetëm që reflekton realitetin dhe marrëdhëniet shoqërore, por edhe i konstrukton ato. Përderisa studiuesit e kësaj fushe kanë të përbashkët këtë tezë, ende nuk kanë arritur të zhvillojnë metodologji kërkimore e cila në mënyrë të njësuar dhe të mjaftueshme do ta mbështeste atë me empiri të bazuar dhe gjithpërfshirëse. Ndër sfidat kryesore ende mbetet ajo se hipotezat e ngritura mbi raportin gjuhë e praktikë shoqërore, diskurs e transformim kërkojnë analizë të një korpusi të madh tekstesh, nëse duam të arrjmë te gjetje, të cilat përfshijnë edhe dimensionin sinkronik, i cili është i pashmangshëm kur bëhet fjalë për hulumtimin e transformimeve politike e shoqërore, të cilat nuk janë ekskluzivisht gjuhësore. Përderisa deri më tani shumica e gjetjeve janë të bazuara në analizën e tekstit si metodë cilësore që kërkon analizë të nivelit mikro që bën të papërballueshme analizën e një korpusi të gjerë. Sfiduese për AKD-në mbetet ende se instrumentariumi i zhvilluar për t'ju qasur transformimeve nga aspekti gjuhësor mbetet i panjësuar, autorë të ndryshëm propozojnë modele të ndryshme dhe kategori të ndryshme analitike të nivelit mikro, mezo dhe makro, por këto kategori nuk kanë emërtime, konceptualizime të njësuara dhe nuk janë të hierarkizuara. Të gjitha këto e vënë në pyetje parimin e reprezentativitetit dhe validitetit të gjetjeve kërkimore të arritura duke zbatuar AKD-në si metodë. Pyetja se si të arrihet përmes analizave mikrolinguistike deri te përgjithësimet që vlejnë për fenomene që nuk janë eksluzivisht fenomene gjuhësore ende nuk ka marrë një përgjigje të shteruar. Në këtë punim do të prezantojmë një model të përshtatshëm për analizë kritike të diskursit të shoqërive në transformim. Ky model është efikas në kuptimin që përmbledh gjetje në aspektin sinkronik të bazuara në analiza makro dhe mikrolinguistike duke vënë në lidhje metoda sasiore e cilësore.

Hipotezat e AKD-së për raportin gjuhë – politikë

Analiza kritike e diskursit ka orientim praktik, qëllimi i përfaqësuesve të kësaj teorie është të shpjegojnë procesin e përdorimit të gjuhës dhe ligjërimit publik gjatë konstruktimit të marrëdhënieve të pushtetit në shoqëri, si dhe të vetëdijësojnë publikun për këtë. Përfaqësuesit e AKD në stu-

dimet e tyre mëtojnë të dëshmojnë e shpjegojnë ndërvarshmërinë në mes të gjuhës, kulturës e politikës dhe vënë bazën për një vështrim kritik të përdorimit të gjuhës e komunikimit në politikë. Nga perspektiva e sistemit gjuhësor M. A. K. Halliday i vë gjuhës dy metafunksione shoqërore: gjuhën si reflektim mbi gjërat dhe gjuhën si diçka që vepron mbi gjërat. I pari është siç e quan ai, komponenti ideacional i kuptimit dhe i dyti komponenti ndërpersonal (Halliday 1978: 2). Këto dy funksione që Halliday ia cakton gjuhës e bëjnë gjuhën të jetë në qendër të veprimit politik si praktikë shoqërore.

Procesi i krijimit të vullnetit, i cili për politikën në kohërat moderne është shumë i rëndësishëm, ndodh përmes komunikimit. Komunikimi si i tillë realizohet përmes shenjave gjuhësore. Me këtë politika bëhet në një pjesë të madhe përmes gjuhës. Sipas Grünert (1974: 3) i tërë veprimi politik hartohet, prezentohet dhe zbatohet përmes gjuhës. Si mjet themelor i komunikimit në këtë aspekt gjuha ka një rol instrumental për politikën, ajo qëndron në shërbim të veprimit politik.

Ky funksion realizohet në politikë përmes selektimit të shenjës gjuhësore dhe organizimit të saj në tekste. Kress, një përfaqësues i teorisë së përdorimit të gjuhës, thotë lidhur me këtë "relacioni i shenjuesit me të shenjuarin në të gjitha sistemet semiotike njerëzore është çdoherë i motivuar nga interesat e prodhuesit të atij shënjuesi dhe nga karakteristikat e objektit" (Kress 1993: 173). Është interesi ai që determinon se cilat karakteristika të zgjidhen dhe të reprezentohen. Ky selektim i shenjave gjuhësore me qëllim të ushtrimit të veprimeve është një diskurs. Këtë pikpamje e mbrojnë edhe N. Fairclough dhe R. Wodak (1997) të cilët diskursin e definojnë si "përdorim gjuhe në tekst e të folur - si një formë e praktikës shoqërore".

Ndikimi i gjuhës në marrjen dhe ushtrimin e pushtetit nuk bëhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë, por përmes instancave ndërmjetësuese. Si instanca ndërmjetësuese përfaqësuesit e analizës kritike të diskursit përmendin ideologjitë[1]. Praktika diskursive bazohet në konvencione të cilat natyralizojnë raporte të caktuara të ideologjive, dhe këto konvencione për vetvete e mënyrat e artikulimit janë lufta për pushtet. Roli i gjuhës qëndron në

[1] Për më tepër lidhur me marrëdhënien në mes të pushtetit në formë të sundimit, ideologjisë e diskursit shih Wodak 2001, 2005; Fairclough 1989, 1992; Van Dijk 1993, 1998.

faktin se ajo është vendi ku ndodh lufta për dominim ideologjik. Grupe me ideologji të caktuar dominojnë shoqëritë duke i bërë ato hegjemone. Këtë hegjemoni që e ushtrojnë grupe të caktuara, e që Teun van Dijk e quan dominim dhe e definon si në vazhdim: "ushtrimi i pushtetit shoqërorë nga elitat, institucionet apo grupet që rezulton në pabarazitë shoqërore përfshirë pabarazitë politike, kulturore, klasore etnike, racore dhe gjinore" (van Dijk 1993: 250).

Përmes vëzhgimit kritik të përdorimit të ligjërimit, analistët e diskursit përpiqen që me ndihmën e mjeteve gjuhësore të shpjegojnë se si përmes diskursit transportohen identitete dhe role shoqërore e gjithashtu edhe mendime, qëndrime dhe sisteme vlerash. Në qendër të studimeve janë dekodimi dhe dekonstruktimi i marrëdhënieve të pushtetit dhe ideologjive përmes gjuhës. Lidhja mes diskursit dhe praktikave shoqërore është dialektike, ndryshimet shoqërore sjellin ndryshime në diskurs, por diskursi është parakusht për ndryshime shoqërore. Përfytyrimet shoqërore të realietit të cilat rrjedhin nga ideologji të caktuara nuk mund të shihen si statike. Ideologjia e një grupi dominues ka një masë fleksibiliteti. Siç tregojnë zhvillimet historike, ideologji të grupeve të caktuara asnjëherë nuk kanë arritur të bëhen totalisht hegjemone, nuk kanë arritur një integrim të plotë të të gjithë shoqërisë në kuptimin e përqafimit të dieologjisë së atij grupi nga e tërë shoqëria. Kjo sipas Fairclough (1986: 86) nuk mund të arrihet asnjëherë, për arsye se divergjenca e ideologjive është e pashmangshme. Në vazhdimësi ka një ballafaqim të grupeve për të dominuar njërën apo tjetrën ideologji dhe ky ballafaqim ndodh në diskurse. Në tekste mund të vërehet se ndodh një diskrepancë në mes të prodhuesit të tekstit dhe interpretuesit të tij. Për interpretuesin realiteti i cili shpërfaqet nga prodhuesi i tekstit është tjetër nga ajo që ka provuar ai. Kjo të çon tek ajo që Fairclough (1989: 171) e quan 'disorders in discourse' (çrregullime në diskurs) të një shoqërie. Diskurset e vjetra destrukturohen, ndërsa ato të rejat ristrukturohen dhe kjo ndodh përmes një strategjie e cila përzien diskursin e vjetër me atë të riun derisa të konvencionalizohet i riu.

Duke u nisur nga kjo pikëpamje me analizën kritike të diskursit mund të matet nëse një shoqëri ka filluar të transformohet në aspektin politik. Në studimet e bëra deri tani përmes AKD është vrojtuar transformimi në kuptimin e depërtimit të vlerave perëndimore në shoqëritë mo-

derne bashkëkohore, vlera këto të subsumuara nën etiketën e demokracisë ose procesit të demokratizimit. Organizata ndërkombëtare si Banka Botërore, apo Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe në Evropën Juglindore Bashkimi Evropian, zhvillojnë strategji për zbatim të politikave neoliberale ekonomike, të cilat pastaj duhet t'i adoptojnë këto vende. Adoptimi i këtyre politikave sjell ndryshim në jetën shoqërore të këtyre shoqërive dhe përmes analizës së ligjërimeve publike mund të vërehet nëse këto norma janë përbrendësuar në një shoqëri gjë që implikon shkallën më të lartë të adoptimit të këtyre normave dhe hegjemonizimin neoliberal të këtyre shoqërive. Sipas studiuesve të AKD-së këto norma perëndimore janë diskurs dhe adoptimi i këtij diskursi nga shoqëritë lindore po bëhet me vështirësi. Procesin e ndryshimeve shoqërore të imponuar nga akterët e jashtëm Fairclough e shpjegon si në vazhdim: "... në situatë të krizave apo jostabilitetit shoqëror, grupe të ndryshme të agjentëve shoqërorë zhvillojnë strategji të ndryshme për ndryshime, të cilat përfshijnë diskurse që projektojnë përfytyrime dhe narrativa për forma të reja të jetës shoqërore. Këto narrative më vonë konstruktojnë marrëdhënie pak a shumë koherente dhe plauzibël në mes të asaj se çfarë kishte ndodhur në të kaluarën dhe çfarë mund të ndodhë në të ardhmen".

Këto strategji do të mund të jenë efektive nëse zbatohen dhe përbrendësohen nga shoqëria. Me zbatim nënkuptohen ndryshimet të cilat i sjellin diskurset në aktivitete dhe institucione. Me përbrendësim kuptohet indoktrinimi d.m.th efekti që ka transformimi në identitetet e subjekteve (shih Fairclough 2005: 4; Van Dijk, Chilton 2004: 3)

AKD mbështet tezën se nuk ka garancion se diskurset e reja eksterne mund të përbrendësohen plotësisht. Se cilat narrative e përfytyrime kanë sukses, bëhen hegjemone dhe operacionalizohen si realitete të reja varet nga një sërë parakushtesh. Mund të ndodhë që diskurset e reja të zbatohen dhe përbrendësohen vetëm në mënyrë retorike apo strategjike. Një mënyrë e operacionalizimit të diskurseve të reja është rikontekstualizimi i tyre në fusha të caktuara shoqërore, në institucione, organizata, vende, lokalitete etj. Ky rikontekstualizim varet nga marrëdhëna e akterëve internalë me ata eksternalë dhe marrëdhënia në mes vetë akterëve internalë. Në varësi të këtij konteksti rikontekstualizimi të diskursit mund të manifestohen nivele të pasivitetit. Sado që të jetë aktiv procesi i përshtatjes nuk mund të presim

që ky rikontekstualizim mund të ndodhë në mënyrë të barabartë në të gjitha praktikat e kontekstit. Transformimet e shoqërive të kuptuara si adaptim i normave të shoqërive dhe vlerave perëndimore zhvillohen si një proces që ndodh më shumë nga lart poshtë, do të thotë që elitat politike e kulturore si akterë janë bartëset kryesore të këtyre proceseve.

Mangësitë e AKD-së si metodë kërkimore

Për të vëzhguar nëse këto procese adoptimi vlerash të reja kanë ndodhur apo jo, përfaqësuesit e AKD-së kanë zhvilluar edhe metodologji dhe teknika kërkimi që konsistojnë apo janë të ndërlidhura me analizën e teksteve duke përfshirë edhe kontekstin si tekst, të bazuar në tezën themelore se ideologjitë realizohen dhe hegjemonizohen përmes teksteve. Por përkundër kësaj teze që kanë si pikënisje të gjithë përfaqësuesit e kësaj teorie ata nuk kanë ndonjë model të njësuar për të vëzhguar. Vetë përfaqësuesit e kësaj teorie refuzojnë metodë të njësuar (shih Meyer/ Wodak 2002: 22 dhe Titscher etj. 1998: 34). Autorë të ndryshëm kanë krijuar modele të ndryshme vetanake për të ndërmarrë kërkime empirike, gjë që vë në dyshim objektivitetin, reprezentativitetin e gjetjeve dhe për më tepër të shtrohet pyetja nëse këta autorë i kanë zhvilluar këto modele sa për të mbështetur tezat vetanake. Ekzistojnë disa sfida të cilat janë të ndërlidhura me metodologjinë e përdorur deri më tani në AKD dhe të cilat nuk janë zgjidhur ende. [2]

Sfida e parë nëse vendosim të përdorim AKD për t'iu qasur materialit empirik është se ajo si metodë cilësore nuk është e përshtatshme për analizën e një sasie të madhe tekstesh. Procesi i konstruktimit të botëkuptimeve që dominojnë në një shoqëri nuk përqëndrohet në një kohë të caktuar, por është një proces i vazhdueshëm. Botëkuptimet nuk mund të formohen e formësohen brenda një dite apo gjatë një ngjarjeje diskursive të vetme, por ato ushqehen nga diskurse në të gjitha fushat shoqërore dhe përgjatë tërë kohës. Për këtë arsye studimi i transformimeve politike kërkon një analizë sinkronike që sejll me vete grumbullimin e një korpusi të madh për nga sasia. Teknika kërkimore të njësuara se si të menaxhohet një korpus i madh nuk i gjejmë te shumica e autorëve. Te shumica e studimeve

[2] Shih Fairclough 1992, f. 230 dhe Jäger 2001, 71-172.

ekzistuese nuk mund të gjendet përgjigje për atë se si të arrijmë konkluzione të përgjithshme e të vlefshme, duke u nisur nga rezultate të kërkimeve të pakta, pra si të përgjithësohet për të arritur përfundime, të cilat do të ishin të vlefshme edhe për kontekste, institucione, respektivisht grupe të mëdha të tjera shoqërore.

Kur studiohen ligjërimet përmes analizës së tekstit për të përndritur transformimet politike është e pashmangshme të zgjidhim këto probleme. Një mundësi do të jetë zhvillimi i një modeli për analizë, duke kombinuar teknika kërkimore të përdorura nga autorë të ndryshëm. Sigfried Jäger propozon një teknikë për kombinimin e metodave sasiore e cilësore gjë që është e pashmangshme për analizën e një sasie të madhe tekstesh. Sipas tij korpusi duhet ndarë duke parashtruar pyetje kërkimore në mënyrë precize dhe duke u nisur nga formësimi përkatës i diskursit. Një mënyrë tjetër është përcaktimi për analizën e një sektori të caktuar të një fushe diskursive (p.sh. në rastin e diskursit politik të një sektori medial siç është televizioni apo gazetat ditore) apo përqëndrimi diakronik në disa ngjarje diskursive. Një tjetër teknikë është që gjatë analizës empirike të mbështetemi në tufën e diskurseve apo në prerjet sinkronike të tufave të diskurseve. Përzgjedhja e materialit sipas kësaj teknike është kuptimplotë për arsye se mund të themi që ky material është i përshtatshëm për të përfshirë apo përmbajtur diskursin e përgjithshëm.

Tjetri problem është se analiza kritike e diskursit i analizon transformimet si praktikë shoqërore përmes analizës së fenomeneve mikrolinguistike, e kjo kushtëzon analizën e kontekstit në të cilin përdoret gjuha. Analiza e diskursit është ndërdisiplinare. Sipas Van Dijk: "Analiza kritike e diskursit (…) kërkon multidisiplinaritet dhe të merret parasysh ndërvarshmëria e natyrshme ndërmjet tekstit, të folurit, njohjeve shoqërore, pushtetit, shoqërisë dhe kulturës".[3]

Për të zgjidhur këtë problem modeli më i përshtatshëm është ai i Fairclough-it, sepse përmes tij sigurohet lidhja ndërmjet tekstit dhe kontekstit, respektivisht praktikës shoqërore. Sipas këtij modeli të quajtur Modeli i analizës së diskursit të orientuar nga teksti (TODA), çdo ngjarje diskur-

[3] Van Dijk, Teun, Principles of critical discourse analysis**, Discourse & Society**, Vol. 4 (2). London,1993, 253.

sive duhet të shihet si tekst, si praktikë diskursive e gjithashtu si praktikë shoqërore. Këto tri fusha kanë ndikim të ndërsjellë në njëra-tjetrën. Praktika shoqërore përmes praktikës diskursive lë gjurmët e saj në tekst dhe anasjelltas tekstet përmes praktikës diskursive ndikojnë në praktikën shoqërore. Transformimet diskursive mund të vërehen gjatë analizës së teksteve. Ato paraqiten në formë të gërshetimeve të ligjërimeve dhe gjedheve të ndryshme të teksteve, të cilat me kalimin e kohës ndikojnë në ndryshimin e raportit ndërmjet praktikave diskursive të ndryshme brenda institucioneve dhe në këtë mënyrë lëvizin kufijt e rendeve të deriatëhershme të diskurseve.[4] Analiza e teksteve përmbledh analizën e tipareve linguistike dhe organizimit të tij nga të cilat nxirret kuptimi i tij. Këtu duhet të venerojmë përzgjedhjen e fjalorit, formave gramatikore, kohezionin dhe strukturën tekstore. Analizimi i ngjarjeve diskursive si praktika diskursive përfshin të kuptuarit e diskursit që prodhohet, shpërndahet dhe pranohet në mënyrë shoqërore. Këtu do të duhej të shqyrtoheshin aspekte të procesit të prodhimit dhe receptimit të tekstit si procese institucionale. Dimensioni i tretë, ai i praktikës shoqërore ka të bëjë me efektet ideologjike dhe proceset hegjemoniale mbi të cilat vepron diskursi. Për të analizuar tekstet dhe efektet e tyre nevojitet analiza e kontekstit situativ dhe e kontesktit më të gjerë të praktikave të institucionalizuara shoqërore, kulturore në të cilat ndodh ngjarja diskursive.

Problemi tjetër me të cilin do të sfidohemi nëse përdorim analizën e diskursit si metodë janë kategoritë analitike. Shembuj të ndryshëm në literaturën e AKD-së ofrojnë një inventar të pasur të këtyre kategorive, inventarë që përshkruajnë tekstet në tërësinë e tyre dhe i përfshijnë fenomenet në nivelin e tekstit, fjalisë dhe fjalëve. U kushtohet rëndësi edhe veçorive gjuhësore si modaliteti, nominalizimi, pasivizimi, pastaj atyre gramatikore, sintaksore, semantike e leksikologjike, figurave stilistike etj. Sa i përket emërtimit, konceptimit, terminologjisë dhe hierarkizimit të këtyre kategorive në kuadër të analizës nuk ekziston një pajtim ndërmjet përfaqësuesve të AKD-së. Përshkallëzimet në sistemin e kategorive ndryshojnë në bazë të njohjeve që mëtohet të arrihen dhe strukturimit të ndryshëm

[4] Fairclough*, N.;* Wodak, R., *Critical discourse analysis,* në T. Van Dijk (Hg.): **Discourse. Studies: A Multidisciplinary Introduction. Vol. 2.** London: Sage, 1997, 265.

të korpusit.[5] Fairclough zhvillon një model analize i cili është shumë i pasur në nivelet mikrogjuhësore, por i cili nuk është i përshkallëzuar. Sipas këtij modeli me tekst nënkuptohen edhe fenomenet si kohezioni, modaliteti, perspektivimi e mirësjellja. Dimensionet e ndryshme të cilat e lidhin tekstin me strukturat shoqërore janë praktika diskursive, interdiskursiviteti, diskursi e zhanret.[6] Sigfried Jäger nuk i hierarkizon kategoritë, por i grupon ato. Ai dallon sipërfaqen e tekstit, në të cilën përfshin edhe qëllimin argumentativ, të cilin ai e barazon me qëllimin e veprimit, si dhe mjetet retorike. Sipërfaqja e tekstit sipas tij është struktura e përgjithshme e analizës, ndërsa mjetet gjuhësore-retorike janë pjesë e mikroanalizës. Sipërfaqes së tekstit i takojnë kategoritë, si qëllimet e argumetimit dhe strategjitë e argumentimit. Mjeteve retorike gjuhësore u takojnë sintaksa dhe leksiku.[7] Van Dijk operon në strukturën sipërfaqësore të teksteve me terma si stili dhe retorika. Sipas tij stili paraqet mendimin personal të autorit dhe retorika përfshin mjetet me të cilat mëtohet të ndikohet publiku.[8]

Qasja metodike në grupin e Ruth Wodak-u karakterizohet në përshkallëzimin e kategorive përmes një sistemi shumëdimensional të kategorive. Konceptet linguistike si korniza, skema, modeli dhe skripti sipas Wodak-ut i takojnë kategorisë së strategjisë.[9]

Një model më të kristalizuar për analizë tekstesh mikro- dhe makrozhvillon Gerlinde Mautner. Ky model ofron koncepte më të qarta dhe një skemë më logjike dhe më të përndritur në krahasim me modele të tjera të AKD-së. Me ndihmën e këtij modeli krijohet një lidhje midis analizës cilësore e sasiore të teksteve, për shkak se ky model zgjerohet më tutje dhe përfshin metoda të analizës së korpusit linguistik. Përdorimi i programeve softuerike mundëson kërkimin në tërë korpusin e fjalëve, frazave dhe ndriçimin e ambientit të tyre gjuhësor. Këto programe paraqesin konkordanca

---

[5] Për më tepër për këtë problematikë metodologjike të AKD-së shih Mautner 2000.

[6] Fairclough, po aty, f. 26-30.

[7] Jäger Sigfried, **Kritische Diskursanalyse**. Eine Einführung, aktual, Neuauflage. Duisburg: DISS, 2001, f.209.

[8] Van Dijk, Teun, The interdisciplinary study of news as discourse. Në K. Bruhn-Jensen & N. Jankowksi (Eds.), **Handbook of Qualitative Methods in Mass Communication Research**. *Fq.* 108-120. London: Routledge, 1991, f. 209.

[9] Wodak, Ruth /de Cillia, Rudolf/ Reisigl, Martin/Liebhart, Karin, **The discursive construction of national identity**. Übersetzung von Hirsch Angelika u. Mitten Richard. Edinburgh: Edinburgh University Press 1999, f.34.

në të cilat paraqiten fjalët (shih Mautner 2000: 100). Mautner i hierarkizon kategoritë duke i ndarë ato në strategji, motive, forma argumentative të konvencionalizuara dhe mjete gjuhësore të cilat i realizojnë këto strategji.

Model për eliminimin e mangësive

Kombinimi i këtyre modeleve mundëson zhvillimin e një modeli tjetër empirik për të ndërmarrë analizë diskursi të transformimeve shoqërore-politike, e cili është më efikas, eliminon në masë më të madhe problemet të cilat i prezentuam këtu më lart dhe përmes të cilit arrihen gjetje të cilat janë ndërsubjektive dhe gjithpërfshirëse. Ky model përfshin një dizajn analize të ndarë në disa faza:

Faza e parë: mbledhja e të dhënave dhe përgatitja e tyre për analizë

Hapi i parë: përzgjedhja e korpusit. Tekste[10] të bëra publike për ngjarje të caktuara diskursive në të cilat gjejnë vend ligjërime të elitës për çështje të ndryshme në komunikimin publik. Diskurset mediale janë më të përshtatshmet për arsye se e kanë një audiencë më masive se sa p.sh. tekstet shkollore, të institucioneve politike të caktuara etj. Këto paraqesin mostrën e diskursit për analizë.

Hapin e dytë: Përgatitja e teksteve në mënyrë elektronike për t'u analizuar nga softuere për analizë tekstesh. Mjaft frytëdhënës dhe lehtë të manipulueshëm janë treguar softuerët Mini Longman Concordance dhe ATLAS.

Hapi i tretë: Korpusi të ndahet në bazë të audiencës parësore të cilës u drejtohen këto tekste.

Faza e dytë: Analiza e të dhënave

Hapi i parë: duke u bazuar në modelin TODA të Fairclough ndriçohet konteksti në të cilin gjen vend diskursi i analizuar. Vrojtohen konteksti i gjerë, konteksti institucional dhe ai situacional. Konteksti i gjerë përfshin një trajtim historik. Konteksti institucional përshkruan praktikën institu-

[10] Me tekst këtu nënkuptohen tekste gojore, me shkrim e pamore.

cionale të diskursit, ndërsa ai situacional përfshin të dhëna si korniza zyrtare, shkaku i ngjarjes diskursive, vendi, pjesëmarrësit, grupi të cilit i adresohet teksti. Analiza e këtyre niveleve të kontekstit bëhet me qëllim që të thellohet analiza e përgjithshme dhe të bazohet e interpretohet analiza gjuhësore, të cilave pothuajse është e pamundur t'u qasemi vetëm përmes kategorive linguistike. Përveç kësaj konteksti i shërben shpjegimit të kushteve shoqërore dhe funksionit të thënieve.

Hapi i dytë: analiza sasiore përmbajtësore. Kur kemi të dhëna të shumta është më se e nevojshme një prerje vertikale e korpusit për të arritur rezultate të përgjithësuara të bazuara në mënyrë empirike. Kjo analizë shërben për të gjetur përmbajtjet që përfliten më së shpeshti në diskursin publik, dhe për të krahasuar nëse diskursi ekstern ka depërtuar si përmbajtje. Kjo bën të mundur përgatitjen e një liste të fjalëve çelës me denduri më të madhe dhe që paraqesin njëkohësisht temat e diskursit publik.

Hapi i tretë: analiza cilësore e diskursit. Kjo u përgjigjet pyetjeve se si deklarohen përfaqësuesit publikë për përmbajtjet dhe si e bëjnë këte. Fillohet me analizimin e mjeteve linguistike të përdorura e vazhdohet me kategoritë më të larta si format argumentuese, motivet dhe strategjitë. Sipas Mautner-it (2000: 82) mjetet gjuhësore "paraqesin gurët linguistikë nga të cilët përbëhen njësitë më të mëdha kuptimore, siç janë motivet dhe strategjitë dhe strukturat më të mëdha formale, siç janë format argumentuese". Në këtë mënyrë bëhet e mundur të analizohet se si komponente të ndryshme të diskursit luajnë rolin e tyre në arritjen e një qëllimi të caktuar. Analizohen mjetet gjuhësore me të cilat aktorë të jetës publike realizojnë motive dhe forma argumentimi që çojnë në shpërfaqje të caktuara të temave të ndryshme. Përmes këtyre arrihen përfundime për strategjitë me të cilat politikanët fitojnë pushtetin e tyre. Fillohet me fjalët çelës, për të identifikuar përmbajtjet tematike, vazhdohet me kërkimin e fushës semantike të këtyre fjalëve e pastaj analiza zgjerohet në nivel të fjalisë dhe të tekstit. Për analizë teksti shërbejnë kategori të shumta gjuhësore leksikore, sintaksore e semantike, struktura tekstore (kohezioni, koherenca, shtjellimi tematik), intertekstualiteti, perspektivimi, transitiviteti, koha, aspekti e modaliteti, pasivizimi e nominalizimi dhe figurat stilistike. Përmes këtyre kategorive i qasemi korpusit për të deshifruar kuptimet e këtyre teksteve dhe strategjitë që qëndrojnë pas tyre.

Bibliografia

Chilton, Paul, Analysing political discourse. Theory and praxis. London u.a: Routledge, 2004.

Dieckmann, Walther, Sprache in der Politik. Einführung in die Pragmatik und Semantik der Politischen Sprache,Carl Winter Universitätsverlag, Heidelberg 1969.

Fairclough, N.; *Wodak*, R. ,Critical discourse analysis, në T. Van Dijk (Hg.): **Discourse. Studies: A Multidisciplinary Introduction. Vol. 2.** London: Sage, 1997.

Fairclough, Norman, Political Correctness: the Politics of Culture and Language, në **Discourse & Society (2003) Volume: 14, Issue: 1,** Sage Publications.

Fairclough, Norman, Critical Discourse analysis, në: **Marges linguistiques. M.L.M.S. Numéro 9,** Mai 2005, Saint Chamas.

Fairclough, Norman, Discourse and social Change. Cambridge: Polity Press, 1992.

Jäger, Siegfried : Kritische Diskursanalyse. Eine Einführung, Duisburg: DISS, 2001.

Jäger, sigfried/ Link, Jürgen, Die vierte Gewalt. Rassismus und die Medien. Diss, 1993.

Kress, Gunther, ***Against arbitrariness: The social production of the sign as a foundational issue in Critical Discourse Analysis, në*** Discourse & Society, Vol. 4(2). London,1993.

Mautner, Gerlinde 2000: Der britische Europa-Diskurs. Methodenreflexion und Fallstudien zur Berichterstattung in der Tagespresse. Wien: Passagen Verlag.

Van Dijk, Teun, Discourse Studies. A multidisciplinary introduction. 2 vols. London, Sage, 1997.

Van Dijk, Teun, ***Principles of critical discourse analysis,*** **Discourse & Society**, Vol. 4 (2). London,1993.

Van Dijk, Teun, Denying racism. Elite discourse and racism. Në: **Racism and migration in Ëestern Europe.** Oxford: Berg, 1993.

Van Dijk. Teun , The interdisciplinary study of neës as discourse, në K. Bruhn-Jensen & N. Jankoëksi (Eds.), **Handbook of Qualitative Methods in Mass Communication Research**. London: Routledge, 1991.

Wodak, Ruth., Critical Linguistics and Critical Discourse Analysis, në Handbook of Pragmatics. Amsterdam u.a.: John Benjamins, 2006.

Wodak Ruth 2001: What CDA is about . A summary of its history, important concepts and its developments. In: Wodak, Ruth/Meyer, Michael (Hrsg.): Approaches to Critical Discourse Analysis. London:

Wodak, Ruth /de Cillia, Rudolf/ Reisigl, Martin/Liebhart, Karin. The discursive construction of national identity. Übersetzung von Hirsch Angelika u. Mitten Richard. Edinburgh: Edinburgh University Press, 1999.

Sahadete LIMANI - BEQA, Prishtinë

METHODOLOGY OF DISCOURSE ANALYSIS OF RESEARCHES IN AREA OF SOCIAL-POLITICAL TRANSFORMATIONS -- A COMPREHENSIVE REVIEW

Summary

This article aims at presenting a model of empirical studies in the field of political transformation, by employing a critical analysis of discourse. The use of language as a practical social tool to achieve non-linguistic objectives is defined as discourse. Discourse and politics get intertwined through mediating instances, as is the ideology. The modern social and political transformations perceived as opening out or efforts for the domination of the western values and compressed into the esthetics of democracy are studied by using the research techniques of the discourse analysis. So far these techniques have shown to have shortcomings, thus putting into a question the hitherto validity of the findings because those findings are not based at an agreeable extent on the facts and also due to the failure of to synthesize and provide hierarchical order of those categories.A practical model that would contribute to the elimination of those omissions should be based on different models of analyses developed so far. Such a model could involve an interface between the qualitative and quantitative methods, which is unavoidable in analyzing the transformation processes through the text analyses.Selection case study materials would be made through a selection of events or certain discursive clusters, by focusing on one genre of the text.In order to put into the same context the linguistic phenomena with those not exclusively linguistic ones, one needs to do at another stage analyses of the historic, institutional, and actual contexts.In order to ensure methodological propriety, it could be useful using a hierarchic model of analytical categories at the macro, medium, and micro levels.The use of computer software for text analyses could help in identifying or highlighting analytical categories for the entire selected corpus, which would provide for meeting the representation criteria of the analyzed data. In order for the model to be… one needs treating the definition and denomination of the analytical categories at the micro -lingual level, which are extremely useful, but since the framework of this study does not provide for an exhausting more comprehensively this issue, it remains to be treated in the next publication.

Blertë ISMAJLI, Prishtinë

FORMAT FOLJORE NË SHQIPEN: MËNYRË, FOLJE MODALE, KOHË?

KDU 811. 18'367.625

Abstrakt

Në fokus të këtij artikulli janë format analitike të foljes në shqipen dhe ndarja e tyre në kategoritë gramatikore: mënyrë, kohë, folje modale. Format foljore të trajtuara si mënyra lëvizin nga gjashtë në "Gramatikën e gjuhës shqipe" të AShSh (Demiraj 2002), në tetë në gramatikat e Oda Buchholz/Wilfried Fiedler (1987) si dhe Leonard Newmark et al. (1987), deri në dhjetë mënyra te Walter Breu (2010). Janë sidomos format analitike të posibilitativit, obligativit, kondicionalit dhe admirativit që kategorizohen herë si mënyra, herë si konstrukte me folje modale, habitorja përshkruhet si formë evidencialitet (Friedman 2004) ose si kategori shtesë paralele me mënyrat (Fiedler 1966, Buchholz/Fiedler 1987), ndërsa kushtorja si kohë (Bucholz/Fiedler 1987). Nga të gjitha format foljore që konsiderohen mënyra në shqipen, dëftorja, lidhorja, dëshirorja dhe urdhërorja janë të padiskutueshme si të tilla.

Fjalët çelës: *mënyrë, folje modale, forma analitike, realis, irealis.*

Modaliteti dhe mënyra si mjet gramatikor për shprehjen e tij paraqesin objekt kompleks studimi për shkak të ndërthurrjes së faktorëve jashtëgjuhësorë. Kur është fjala për kategorinë morfologjike të mënyrës së foljes, në gramatikat e gjuhës shqipe hasim një shumllojshmëri vështrimesh. Numri i mënyrave lëviz nga gjashtë, sa janë paraqitur në *Gramatikën e gjuhës shqipe* të ASHSH-së,[1] në tetë te *Albanische Grammatik*[2] dhe *Albanian Grammar,*[3]deri në dhjetë mënyra sa përmend Walter Breu[4] së fundmi, por edhe Selman Riza në *Sistemin foljor të letrarishtes shqiptare bashkëkohore*[5], i cili, ndryshe nga të tjerët, në grupin e mënyrave të foljes përfshin edhe format e pashtjelluara të foljes. Por të ndalemi fillimisht te nocioni "mënyrë" dhe përkufizimi i tij.

Për shkak të formave të shumta foljore dhe funksioneve që mbulon termi mënyrë në gjuhë të ndryshme, në studimet gramatiore universale dhe

[1] Demiraj 2002.
[2] Buchholz/Fiedler 1987.
[3] Newmark et al. 1977.
[4] Breu 2010: 447ff.
[5] Riza 1997.

tipologjike synohet përkufizimi sa më përgjithësues i mënyrës. Ekziston një pajtueshmëri në konceptimin e mënyrës: ajo është kategori morfologjike e foljes për realizimin e kategorisë semantike të modalitetit[6]. Kjo kategori morfosintaksore e foljes realizohet përmes fleksionit të foljes, pra vendoset në radhën e kategorive të tjera foljore (kohës, aspektit, vetës, numrit dhe diatezës). Lyons mënyrën e përkufizon si mjet për shprehjen e

> "[…] përkushtimit të folësit ndaj statusit faktual të asaj që thotë (sigurinë e tij emfatike, pasigurinë e tij ose dyshimin etj.) […]"[7],

që realizohet përmes fleksionit të foljes ose përmes "ndihmësve" ("auxiliaries").

Në botimin e parë të studimit të tij "Mood and Modality" F. R. Palmer[8] përshkruan nocionin mënyrë si realizim formal të kategorisë semantike të modalitetit:

> "[…] termi "mënyrë" tradicionalisht është i kufizuar te një kategori e shprehur në morfologjinë foljore. Formalisht është kategori morfosintaksore e foljes si koha dhe aspekti […]"[9].

Por Palmer e sheh si problematik kufizimin e termit "mënyrë" në kategoritë foljore morfologjike-sintaksore sepse modaliteti nuk shprehet vetëm me forma foljore, por edhe me mjete si foljet modale dhe pjesëzat. Problemi është se "mënyra" nuk mund të jetë më një nocion i përgjithshëm për të gjitha sistemet gramatikore që shprehin modalitet. Problemin tjetër të përkufizimit tradicional të mënyrës ai e sheh në përdorimin e kufizuar të tij për lidhoren, urdhëroren dhe dëshiroren. Gjuhët që kanë sistem mënyrash, mund të kenë, përveç këtyre tri formave, edhe kategori të tjera (p.sh. kuotativ). Në botimin e dytë të rishikuar të veprës së tij Palmer nuk hyn më në diskutimin për nocionin mënyrë, por i ndan mjetet gramatikore për shprehjen e modalitetit në *mënyra (mood)* dhe *sisteme modale (modal systems)*.[10] Përkufizimi i mënyrës si realizim në fleksionin foljor të kategorisë semantike të modalitetit përkatësisht nënkategorive të tij mbetet edhe në studimet e

[6] krhs. Palmer 1986, Bybee 1985, Bybee/Fleischman 1995, Thieroff 2010. Lyons 1968.
[7] Lyons 1968: 307.
[8] Palmer 1986: 21ff.
[9] Palmer 1986: 21.
[10] Palmer përfshin në grupin e sistemeve modale edhe mjete tjera për shprehjen e modalitetit: foljet modale, pjesëzat (2001: 4ff).

mëvonshme[11].

Në studimet tipologjike ashtu si në përshkrimet gramatikore të gjuhëve të veçanta që kanë sistem mënyrash – e këtu nuk bën përjashtim as gramatika e shqipes – mënyrat definohen në kundërvënie me dëftoren si mënyrë e pamarkuar. Në këtë kontekst dëftorja korrelon me realitetin dhe lidhorja me irealitetin: termi "realis" përdoret për situatat që kanë ndodhur ose që janë perceptuar nga folësi; termi "irrealis" u referohet situatave që nuk kanë ndodhur, që janë kontra-faktuale ose që nuk janë perceptuar nga folësi. Kjo ndërlidhje e lidhores me irealitetin dhe e dëftores me realitetin kritikohet në studimet gjuhësore tipologjike sepse ndarja shihet si shumë e përgjithësuar për të përfshirë materialin gjuhësor[12]. Diferencimi "realis/ irrealis" nuk është i mjaftueshëm për klasifikimin e dëftores dhe të lidhores meqë në disa kontekste gjuhët lejojnë përdorimin e të dy mënyrave: dëftoren për situata ireale dhe lidhoren për situata reale.

Për shkak të shkollave dhe traditave të ndryshme të përshkrimit të gjuhëve, nuk ka kritere uniforme për emërtimin e formave të ndryshme morfologjike të foljeve, emërtimet nuk përdoren çdo herë për kategorinë e njëjtë tipologjike gjuhësore. Siç vëren Thieroff[13], emërtimet e mënyrave duhen kuptuar vetëm si etiketa për dallimin e tyre nga dëftorja, nuk është fjala për emërtime që përshkruajnë semantikën ose tipat e përdorimit të mënyrave. Kjo është vështirë e mundshme meqë për disa mënyra është e vështirë të gjendet kuptimi themelor. Përkufizimi i mënyrës përkatëse bë-

[11] krhs. Bybee 1985: 165ff: "*Modality* designates a conceptual domain which may take various types of linguistic expression, while *mood* designates the inflectional expression of a subdivision of this semantic domain. […] *mood* is a marker on the verb that signals how the speaker chooses to put the proposition into the discourse context"; Bybee / Fleischman 1995: 2ff: "[…] **mood** refers to a formally grammaticalized category of the verb which has a **modal** function. Moods are expressed inflectionally, generally in distinct sets of verbal paradigms, e.g. indicative, subjunctive, optative, imperative, conditional, etc., which vary from one language to another in respect to numbers as well as to the semantic distinctions they mark."; Spencer/Zwicky 1998: 29: "Mood is a category of morphosyntactic properties which […] distinguish the ways in which a proposition may relate to actuality (in the speaker's mind)."; Thieroff 2010: 2: "Mood, or, more precisely, morphological mood, […] is a morphological category of the verb, just as are the verbal categories person, number, aspect, tense, and voice. Mood categories express modalities such as orders, wishes, (non-)factivity, (non-)reality and the like." Për një interpretim gjenerativist shih Quer 1998: 20ff: „[…] the grammatical role of mood is to overtly mark the sort of model a proposition must be interpreted in […]."

[12] Giorgi / Pianesi 1997: 193ff

[13] Thieroff 2010: 4ff

het thjesht duke i numëruar funksionet e saj. Dallime ka edhe në mënyrën se si klasifikohen format morfologjike në kategori foljore. Këto dallime shfaqen sidomos në rastin e formave analitike. Shembull për këtë është shqipja.

Pa dashur të thellohem në diskutimin teorik për kategorinë e mënyrës, po përmend shkurt se në studimet gjuhësore të fundit të shek. XX kjo qasje është kritikuar dhe janë bërë tentime për të arritur një përkufizim abstrakt të mënyrës në rrafshin e gjuhës (*langue*). Në këtë vazhdë duhet të përmendet edhe kritika e S. Rizës për konceptin traditional të mënyrës dhe përkufizimet e mënyrave të tjera në raport me dëftoren. Përmes korrelacionit dëftore = realitet sipas Rizës krijohet një varshmëri e përkufizimit të mënyrave të tjera nga dëftorja meqë dëftorja është mënyra që shpreh realitetin. Prandaj Riza propozonte përdorimin e konceptit *ekzistencë* në vend të atij *realitet,* të cilin e konsideronte të ngushtë. Megjithë tentimet për përkufizim abstrakt dhe shmangie të nocioneve realitet/ irealitet në studimet që e vendosin fakticitetin e thënies në plan të parë duke shmangur qëndrimin e folësit, shkëputja nga përkufizimi tradicional i mënyrës del e vështirë.

Siç u tha në fillim, gramatikat e shqipes janë heterogjene kur flitet për mënyrat e foljes. Kështu sipas gramatikës normative të shqipes, *Gramatika e gjuhës shqipe* e ASHSHsë,[14] folja në gjuhën shqipe mund të dalë në gjashtë mënyra: dëftore, lidhore, habitore, dëshirore, kushtore dhe urdhërore. Këto gjashtë mënyra përgjithësisht pranohen si mënyra në gjuhësinë shqiptare të gjysmës së dytë të shek. XX.[15] Por gjendja është e ndryshme në gramatikat e shqipes të hartuara nga autorë të huaj. Format e dëftores, lidhores, urdhërores dhe dëshirores përgjithësisht paraqiten si mënyra edhe në këto shqyrtime gramatikore të shqipes[16]. Newmark et al. dhe Riza krahas habitores radhisin edhe lidhore-habitoren, e cila nuk haset as në *Gramatikën e gjuhës shqipe* e as në ndonjë nga studimet e tjera që morëm në shqyrtim këtu. Pikërisht kombinimi i formave të habitores me ato të lidhores, pra markimi i dyfishtë i një forme foljore, janë argumenti i Fiedler-

[14] Demiraj 2002: 273.

[15] Një përjashtim këtu bën Riza i cili i përfshin edhe format e pashtjelluara të foljes (përcjellorja, pjesorja dhe paskajorja) në grupin e mënyrave. Riza 1997: 127.

[16] Këtu janë marrë në shqyrtim Buchholz/ Fielder (1987) *Albanische Grammatik,* Newmark et al. (1977) *Standard Albanian* dhe artikulli nga Walter Breu (2010) *Mood in Albanian.*

it për mostrajtimin e formave të habitores si mënyrë[17]. Edhe në *Albanische Grammatik* të Buchholz/Fiedler këto forma paraqiten si forma paralele me dëftoren[18]. Në studimet e fundit, sidomos në ato të Friedman-it, bazuar në funksionin e saj të referativitetit, habitorja shihet si formë evidencialiteti, pra si një trajtë përmes së cilës folësi shpreh burimin e informatës[19]. Derisa dëftorja, lidhorja, urdhërorja e dëshirorja nuk paraqesin vështirësi në trajtimin e tyre si mënyrë meqë dëshmojnë si forma gramatikore ashtu edhe funksione të caktuara qartësisht të dallueshme, kushtorja paraqet vështirësi për shkak të formave të saj. Format e saj në *Gramatikën e gjuhës shqipe* klasifikohen dyfish, si mënyrë dhe si kohë (e ardhme e së shkuarës), me vërejtjen se bëhet fjalë për forma homonime.[20] Format e kushtores janë kombinim i dy morfemave kohore: morfemë e së ardhmes + morfemë e së shkuarës (*do të vija – do të kisha ardhur*). Kriter themelor klasifikimi në morfologji është forma dhe qëndrimi i përgjithshëm në të cilin mbështetem është se format që përmbajnë morfemat e njëjta duhet të klasifikohen sipas morfologjisë së tyre[21]. Pra, në rastin e kushtores së shqipes kemi të bëjmë me forma kohore që shprehin edhe modalitet. Sipas Thieroff-it[22] tipologjikisht ekzistojnë dy kushtore: ajo "perëndimore" dhe ajo "lindore". Kushtorja "perëndimore" (këtu bëjnë pjesë gjuhët gjermanike, romane dhe kelte, por edhe format e shqipes, baskishtes, armenishtes dhe gjeorgjishtes) është formë kohore që përdoret për të shprehur modalitet. Meqë këto forma përbëhen nga një morfemë e së shkuarës dhe një morfemë e së ardhmes, janë thjesht forma të së ardhmes në të shkuarën. Kushtorja "lindore" është mënyrë meqë nuk përmban morfemë të së ardhmes e shumë shpesh as të së shkuarës. Në këtë grup bëjnë pjesë gjuhët sllave, lituanishtja, finlandishtja, estonishtja dhe hungarishtja. Format e kushtores së shqipes edhe kur përdoren për të shprehur kondicionalitet nuk e humbasin tiparin primar të tyre, temporalitetin, siç mund të shihet nga krahasimi i fjalive në vijim:

Do të vija po të kisha kohë.
Do të kisha ardhur po të kisha pasur kohë.

[17] Fiedler 1966: 563.
[18] Buchholz/Fiedler 1987: 154.
[19] Friedman 2004: 343-351.
[20] Breu 2010: 459, Riza 1997: 135
[21] Thieroff 2010: 6ff
[22] Thieroff 2010: 1-28.

Si në shembullin e parë, ashtu edhe në të dytin krahas kondicionalitetit, vazhdon të shprehet edhe temporaliteti. Futurët në përgjithësi kanë tendencë të shprehjes së modalitetit meqë për veprimet ose ndodhitë në të ardhmen zakonisht nuk mund të flitet në mënyrë neutrale. Këto veprime në të ardhmen janë të dëshirueshme, të pritshme, të parashikueshme ose edhe folësi mund të ketë frikë nga to[23]. Prandaj shfaqen veti modale të futurit gramatikor, gjë që shkakton dyshime gjatë kategorizimit të këtyre formave.

Krahas mënyrave në *Gramatikën e gjuhës shqipe* si mjete të tjera gramatikore për shprehjen e modalitetit klasifikohen edhe foljet modale *mund, duhet* dhe *do*. Por te Breu dhe Buchholz / Fiedler këto forma i gjejmë të klasifikuara si mënyra: posibilitativ (*mund+folje në lidhore)*, obligativ (*duhet+folje në lidhore)*, volitiv (*do+folje në lidhore)*, jusiv (*le+ folje në lidhore).* Këtij grupi i shtohet dhe mënyra hipotetike (*në*+folje në dëftore, dëshirore ose lidhore, p.sh. *Dhe <u>në kafshoftë</u> s'ka rrezik*.). Siç mund të shihet, dallimet në këto dy klasifikime shfaqen te format e përbëra të cilat në shqipen dalin dy llojesh: plotësisht të gramatikalizuara ose me kuptimin e tyre leksikor të ruajtur. Ky dallim duhet pasur parasysh kur flitet për mënyrat e shqipes.

Siç u tha, mënyra foljore realizohet përmes fleksionit. Këtu shqipja bën dallim nga shumë gjuhë duke pasur parasysh format foljore që përbëhen nga pjesëza e paflektuar dhe folja e flektuar siç është rasti i lidhores që formohet me pjesëzën *të*. Prandaj format e përbëra duhet të ndahen në dy grupe: a) në kontruksione me folje modale dhe b) në mënyra që janë konstruktione me pjesëza:

a) Format *mund, duhet* dhe *do* janë folje modale, siç i gjejmë edhe në *Gramatikën e gjuhës shqipe*. Në këtë rast është folja modale ajo që shpreh modalitetin. Këto folje në të folmet gege përdoren të zgjedhuara e në kombinim me paskajoren: *mundem me ardhë.* Në këto raste folja bart markuesit e kategorive gramatikore. Klasifikimin e tyre si mënyrë e sheh të vështirë edhe W. Breu:[24]

[23] Palmer 1986: 216ff.

[24] Breu 2010: 460, Fusnota 26: "klasifikimi i posibilatativit si mënyrë vihet në dyshim. Si obligativi dhe volitivi […] do të mund të konsiderohej si nënkategori pak a shumë e gramatikalizuar e modalitetit e shprehur përmes foljeve modale".

> "The classification of the possibilitative as a mood is questionable. Like the obligative and the volitive, […], it could just as well be conceived as a member of a separate more or less grammaticalized subcategory of modality expressed by modals."

b)Format analitike që përbëhen nga pjesëzat dhe format e zgjedhuara foljore janë të shpeshta në gjuhën shqipe. Ndryshe nga foljet modale, në rastin e pjesëzave kemi të bëjmë me forma të gramatikalizuara të cilat nuk kanë funksion jashtë formës foljore. Si shembull po përmend këtu pjesëzën *le* që përdoret për formimin e lejores e që është formuar nga urdhërorja e foljes *lër,* por që nuk ka më funksion në paradigmën e vjetër. Në këtë grup do të mund të shiheshin edhe format që Breu dhe Buchholz/Fiedler i quajnë mënyrë hipotetike – *në/po + folje në dëftore, dëshirore dhe lidhore.*

Përfundim: Në *Gramatikën e gjuhës shqipe* të ASHSH duhet të qartësohen kriteret sipas të cilave kategorizohen format foljore. Kur kemi të bëjmë me përshkrim morfologjik duhet të vlejnë kriteret morfologjike, pra klasfikimi duhet të bëhet sipas formës. Ndjekja e kritereve morfologjike do ta mundësonte klasifikimin e qartë të formave analitike duke shmangur klasifikimin e dyfishtë si në rastin e kushtores, por edhe duke mundësuar përfshirjen e mënyrës lejore (jusivit) edhe në gramatikën normative të shqipes.

Bibliografia

Breu W. 2010. *Mood in Albanian.* Në Rothstein B., Thieroff R. (redaktorë). Mood in the languages of Europe. Amsterdam/ Philadelphia: John Benjamins Publishing Company, 447-472.

Buchholz O., Fiedler W. 1987. *Albanische Grammatik***.** Leipzig: VEB Verlag Enzyklopädie Leipzig.

Bybee, Joan. 1985. Morphology: A Study of the Relation between Meaning and Form. Amsterdam and Philadelphia: John Benjamins.

Bybee, Joan and Suzanne Fleischman (eds.) 1995. *Modality in grammar and discourse*. Amsterdam: John Benjamins.

Demiraj Sh. (redaktor). 2002. *Gramatika e gjuhës shqipe 1. Morfologjia.* Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Fiedler W. 1966. *Zu einigen Problemen des albanischen Admirativs*. Në Zeitschrift der Karl-Marx-Universität Leipzig: Gesellschafts- und Sprachwissen-schaftliche Reihe, 15/3. Leipzig: Karl-Marx-Universität Leipzig, 561-566.

Friedman V. A. 2004. *Studies on Albanian and other Balkan Languages*. Pejë: Dukagjini.

Giorgi A., Pianesi F. 1997. Tense and aspext: from semantics to morphosyntax. New York: Oxford University Press.

Lyons John 1968. Introduction to theoretical linguistics. Cambridge: Cambridge University Press.

Newmark L., Hubbard Ph., Prifti P. 1982. *Standard Albanian*. Stanford: Stanford University Press.

Palmer F.R. 1996. *Mood and Modality*. Cambridge: Cambridge University Press.

Palmer F.R. 2001. *Mood and Modality*. Second Edition. Cambridge: Cambridge University Press.

Riza S. 1997. *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Vepra 2. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

Quer J. 1998. *Mood at the interface.* The Hague: Holland Academic Graphics.

Spencer A., Zwicky A. M. (redaktorë). 1998. *The handbook of morphology.* Oxford: Blackwell.

Thieroff R. 2010. *Moods, moods, moods.* Në Rothstein B., Thieroff R. (redaktorë). Mood in the languages of Europe. Amsterdam/ Philadelphia: John Benjamins Publishing Company, 1-29.

Blertë ISMAJLI, Prishtina

VERBFORMEN DES ALBANISCHEN: MODUS, MODALVERB, TEMPUS?

Zusammenfassung

Die analytischen Verbformen des Albanischen und die grammatischen Kategorien, denen sie zugehören - Modus, Tempus, Modalverb – stehen im Mittelpunkt dieser Arbeit. Die Anzahl der Verbformen, die als Modus eingestuft werden, ist unterschiedlich: in der Normgrammatik des Albanischen ("Gramatika e gjuhës shqipe" të ASHSH (Demiraj 2002)) sind es sechs Modi, in der "Albanischen Grammatik" von Buchholz/Fiedler (1987) und "Standard Albanian" von Leonard Newmark et al. (1987) sind es acht, bei Walter Breu (2010) sind es zehn Modi. Mit Außnahme von Indikativ, Konjunktiv, Optativ und Imperativ, sind die anderen analytischen Formen unterschiedlich Zugeordnet: als Modus, Modalverbkonstruktionen oder Tempus, wie im Fall des Konditionals. Morphologisch bestehen die Konditionalformen aus zwei Tempusmarkern, daher sind sie (anders als in der Normgrammatik) nur als Tempus einzustufen. Der Admirativ stellt einen Sonderfall: er wird bei Buchholz/Fiedler als eine zusätzliche Kategorie parallel zum Indikativ dargestellt, bei Friedman als eine Evidentialitätsform. Die Schwierigkeiten bestehen bei den susammengesetzten Formen, die im Verbalsystem des Albanischen reichlich vorkommen. Diese Formen lassen sich in zwei Gruppen aufteilen:

a) Die Konstruktionen mit mund, duhet und do sind als Modalverbkonstruktionen einzustufen. In diesen Fällt äußert das Modalverb die Modalität.

b) Die zusammengesetzten Formen können aus einem unflektierten Partikel und dem flektierten Verb bestehen – z.B. im Konjunktiv të shkosh. Die hier verwendeten Partikel sind grammatikalisierte Formen, die außerhalb der Verbform keine Funktion haben. Bei diesen Formen handelt es sich um Verbmodi.

Ina ARAPI, Vjenë

MËSIMI I GJUHËS SHQIPE NË UNIVERSITETIN E VJENËS (fundi i shek. XIX - 2010)[1]

KDU 811. 18:37 (436) (091)

Fjalët çelës: Mësimi i gjuhës shqipe, Universiteti i Vjenës, Gjergj Pekmezi, Kolë Rrota (Nikolaus Rotta), Norbert Jokl.

1. Fillimet


Unterricht in:
Albanisch, Arabisch, Bulgarisch, Chinesisch, Neugriechisch, Neuhebräisch, Persisch, Polnisch, Portugiesisch, Rumänisch, Russisch, Serbokroatisch, Spanisch, Tschechisch, Ungarisch, und Türkisch.

Pas përfundimit të izolimit 45-vjeçar të Shqipërisë më 1990 çështja e mësimit dhe e mësimdhënies së gjuhës shqipe mori një rëndësi të veçantë duke u bërë objekt diskutimi e studimi jo vetëm i institucioneve përkatëse shkencore, por i të gjithë shoqërisë shqiptare. Në trojet shqiptare kjo çështje kishte të bënte në radhë të parë me modernizimin e teksteve ekzistuese të gjuhës dhe letërsisë shqipe, që përdoreshin në shkolla nga nxënësit shqipfolës, ndërsa në vendet e tjera në Evropë dhe në botë u krijuan brenda pak kohe dy grupe të rinj përdoruesish, kërkesat e të cilëve mezi prisnin që të plotësoheshin: së pari, fëmijët e emigrantëve të porsaardhur, të cilët sipas vendeve arrinin shpesh një numër shumë të madh dhe të cilët iu bashkangjitën fëmijëve ekzistues të familjeve të emigruara nga Kosova dhe trojet e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, si dhe grupi i përdoruesve të huaj, që për arsye nga më të ndryshmet (punësimi, bashkëjetese me shqiptarë etj.) u

[1] Ky punim është një variant i plotësuar i kumtesës me të njëjtin titull të mbajtur në konferencën shkencore "Mësimdhënia bashkëkohore e gjuhës dhe letërsisë shqipe / Contemporary Teaching of Albanian language/ Настава албанског језика као страног", organizuar nga Universiteti i Beogradit më 29 mars 2012.

duhej të mësonin gjuhën shqipe. Kështu, nga njëra anë u shtua shumë nevoja për tekste specifike që do t'u shërbenin fëmijëve të emigrantëve shqiptarë për të përvetësuar në shkallë të ndryshme gjuhën e tyre amtare dhe nga ana tjetër për metoda të reja, më të modernizuara dhe më të sofistikuara për mësimin e shqipes nga të huajt. Fusha e parë ishte deri në vitin 1990 krejt e panjohur, ndërsa e dyta ishte lëvruar në mënyrë minimale duke qenë se numri i të huajve që dëshironin të mësonin shqip deri në atë kohë ishte shumë i vogël. Gjatë këtyre 20 viteve shumë probleme, sidomos me karakter didaktik, janë zgjidhur, por shumë të tjera ekzistojnë ende ose probleme të reja kanë lindur, si p. sh. ai i një organizimi më të mirë institucional të mësimit të gjuhës.

Në Austri mësimdhënia e gjuhës shqipe ka filluar që në gjysmën II të shekullit XIX dhe është zhvilluar nëpër shkolla të larta e privatisht. Sipas të dhënave që kam deri tani kurset e para të gjuhës shqipe janë hapur në të ashtuquajturën "Shkolla publike p. m.[2] për gjuhët orientale" (K. K. Öffentliche Lehranstalt für Orientalische Sprachen)[3]. Në internet gjendet një afishe[4] e kësaj shkolle, që i përket vitit 1929 dhe që ruhet në Bibliotekën Ko-

[2] "Perandorake dhe Mbretërore"(K.K.) ishin atributet e Monarkisë Austro-Hungareze, që i referoheshin, i pari Austrisë si perandori dhe tjetri Hungarisë si një mbretëri e barasvlershme me të.

[3] Në shtator 1753 me vendim të perandoreshës Maria Terezia në Vjenë u themelua Akademia Orientale (gj. Orientalische Akademie), që u hap më 1 janar 1754 (Erlach 1988: 63). Nxënës i kësaj shkolle ka qenë dhe Alfred Rappapport, konsull i ardhshëm në Shqipëri, i cili më 1891 është nderuar me "Çmimin e Perandorit" (Kaiserpreis), një medalje e artë që i jepej çdo vit nxënësit më të mirë të vitit të fundit (Erlach 1988: 82). Në vitin 1873 kurset e gjuhës u veçuan nga Akademia dhe u vunë nën varësinë e Ministrisë së Kulturës dhe Arsimit si "Shkolla publike për gjuhët orientale "(Erlach 1988: 65, sh. 152). Të dhënat në **literaturë** për vitin e krijimit dhe emërtimin e kësaj shkolle nuk përputhen. Disa e quajnë thjesht "Shkolla për gjuhët orientale". Pekmezi (shih më poshtë) e quan "Shkolla perandorake dhe mbretërore për gjuhët orientale".

Me sa duket në fillim emërtimi i shkollës ishte "Shkolla perandorake dhe mbretërore për gjuhët orientale", emërtim i cili pas Luftës së Parë Botërore duhet të jetë kthyer në "Shkolla publike për gjuhët orientale", që vazhdoi të funksiononte deri më 1948. Këtë shkollë mund ta ndiqte kushdo dhe ishte pak a shumë si institutet për përkthyes në kohën tonë.

[4] Ja përshkrimi i afishes sipas Bibliotekës Kombëtare të Austrisë:
Öffentliche Lehranstalt/ für orientalische Sprachen/ 9. Boltzmanngasse 16 (Konsular - Akademie) (...) / Unterricht in: /Albanisch, Arabisch, Bulgarisch, / (...) /Jede Sprache wird in zwei Jahrgängen von Mitte/ Oktober bis Ende Juni, wöchentlich vier Stunden/ (...) / Die Einschreibung wird vom 10. September bis 10. Oktober an/ (...). Wien, Österreichische Nationalbibliothek, Grafiksammlung, Inventar-Nr. 16315386. Në shqip: Shkolla Publike/ për gjuhët orientale/ Boltzmanngasse 16, lagjia 9 (Akademia Konsullore) (kjo është adresa - I. A.)/ Mësim në:/ shqip, arabisht, bullgarisht,/ (...)/ Çdo gjuhë mësohet në dy cikle prej mesit/ të tetorit deri në fund të qershorit, katër orë në javë/ (...) / Regjistrimi bëhet prej 10 shtatorit deri në 10 tetor në/ (...). Vjenë, Biblioteka Kombëtare e Austrisë, Koleksioni i grafikave, nr. i inventarit: 16315386.

mbëtare të Austrisë, ku shënohen të gjitha gjuhët që mësoheshin atje përfshirë shqipen (shih më poshtë).

Fillimisht të interesuarit ishin kryesisht diplomatë e dijetarë dhe më pak njerëz privatë. Mësimi i gjuhës shqipe në Austrinë e asaj kohe lidhet sidomos me emrin e dr. Gjergj Pekmezit. Ai dhe bashkëpunëtorët e tij hartuan brenda disa viteve veprat kryesore didaktike për mësimin e gjuhës shqipes në këtë periudhë. Këto ishin:

1. Gramatika e gjuhës shqipe[5] që u botua në vitin 1908, një vepër monumentale, e vetmja gramatikë e shqipes e hartuar deri më sot nga një shqiptar në gjermanisht. Autori na sqaron në parathënie, e cila daton "Vjenë, Rushaje 1907", që është mbështetur më shumë në vrojtimin e gjuhës së gjallë se në veprat e shkruara, prandaj gramatika do t'i shërbejë sidomos mësimit praktik të gjuhës. Ai thekson se "Das Studium selbst muss natürlich an der Hand der Lektüre und Konversation betrieben werden, woneben als grammatisches Lehrbuch (so z. B. an der k. k. Lehranstalt für orientalische Sprachen) vorliegendes Werk gedacht ist. Die Chrestomathie dazu ist in Vorbereitung"[6] (Pekmezi 1908: IV). Kështu, autori na dëshmon se kjo gramatikë përdorej si tekst edhe për nxënësit e kësaj shkolle.

2. Guida gjuhësore me titull Guidë gjuhësore për mësimin e shpejtë të gjuhës shqipe[7] në bashkëpunim me Franz Manek[8] dhe Hilë Mosi. Schmidt-Neke (2005: 142) pohon se "Laut Vorwort wurde dieser Sprachführer bereits nach Gründung des Vereins geplant, verzögerte sich aber wegen des Alphabetstreits, danach wegen der ständigen Aufstände, die einen Reiseverkehr nach Albanien verhinderten. Dies habe sich durch die Unabhängigkeit Albaniens entscheidend geändert. Das Vorwort ist auf den 15.7.1913 datiert, also zwei Wochen vor der internationalen Anerkennung der Unabhängigkeit durch die Londoner Botschafterkonferenz"[9].

---

[5] Në origjinal*: Grammatik der albanesischen Sprache (Laut- und Formenlehre)*, Dr. Pekmezi, Wien, Verlag des Albanesischen Vereines Dija,VIII., Strozzigasse 37,1908,296 f.

[6] Të mësuarit duhet bërë natyrisht nëpërmjet leximit dhe konversacionit, ndërsa si libër gramatike (p. sh. në Shkollën Perandorake dhe Mbretërore për Gjuhët Orientale) është menduar vepra në fjalë. Krestomacia që lidhet me të është duke u përgatitur.

[7] Në origjinal: G. Pekmezi, Hil Mossi, Franz Manek, *Sprachführer zur schnellen Erlernung der albanischen Sprache*, St. Norbertus-Verlag, Wien 1913, 100 f..

[8] Franz Manek dhe Alfred Stotz ishin bashkautorë të Gj. Pekmezit edhe në veprën *Albanesische Bibliographie*, që u botua në Vjenë më 1909.

[9] "Sipas parathënies kjo guidë gjuhësore ishte planifikuar menjëherë pas themelimit të shoqatës[9], por u

3. Po atë vit Pekmezi boton së bashku me M. Lambercin *Libër mësimi dhe leximi i gjuhës shqipe*[10]. Kjo është metoda e parë e gjuhës shqipe për nxënësit gjermanishtfolës. Sipas Schmidt-Neke-s (2005: 143) Lamberci ndikoi në mënyrë vendimtare për zëvendësimin në gjermanisht të italianizmave *Albanese* dhe *Albanesisch* me *Albaner* dhe *Albanisch*.

4. Më 1914 Pekmezi boton së bashku me Kolë Rrotën *Thënie dhe shprehje shqip*[11]. Botimi i këtyre tre manualeve brenda dy viteve lidhet me situatën politike të kohës. Siç dihet në këtë periudhë Shqipëria përbënte një prioritet për politikën e jashtme të Monarkisë. Gjatë Luftës së Parë Botërore ushtria austro-hungareze pushtoi Shqipërinë e Veriut dhe atë të mesme. Nevoja për një guidë gjuhësore ishte pasojë e këtij angazhimi diplomatik intensiv në Shqipëri dhe për çështjen shqiptare.

2. Përpjekje për një biografi të Gjergj Pekmezit

Po kush ishte Gjergj Pekmezi? Një biografi e tij mungon edhe në vepra klasike për periudhën, si p. sh. J. Faensen, *Die albanische Nationalbewegung* (Berlin 1980). Një biografi të tij, ndoshta të parën në shqip, e kam gjetur në revistën *Perpjekja shqiptare*, nr. 14-15, shkurt-mars 1938 (drejtor Branko Merxhani), f. 144-145, në rubrikën *Muaji shqiptar* me rastin e vdekjes. Si autor shënohet redaksia (redk.), por përbërja e redaksisë në këtë numër nuk jepet. Meqenëse ky material është shumë i vështirë për t'u gjetur, po e riprodhoj pikë për pikë:

DR. GJ. PEKMEZI

Më 24 shkurt, ndroi jetë në kryeqytetin e Austris Dr. **Gjergj Pekmezi**, i cili kish rënë sëmur para disa ditësh nga një plevit i dyanëshmë. Dr. Gjergj Pekmezi lindi më 23 Prill 1872 në Ohri. Shkollën e parë e kreu në vendlindjen e tij. Më 1884 mbaroi studimet e mesme në Gjimnazin grek të Manastirit. Më 1890 e (fillon f. 145) gjejmë në Beograd, ku kreu shkollën theollogjike dhe më 1894 u regjistrua në Universitetin e Vjenës, ku plotsoi

vonua për shkak të grindjeve për alfabetin, pastaj për shkak të kryengritjeve të përhershme, që i pengonin udhëtimet në Shqipëri. Kjo gjendje ndërroi rrënjësisht pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Parathënia mban datën 15.7.1913, pra dy javë para njohjes ndërkombëtare të pavarësisë nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër

[10] Max Lambertz, Georg Pekmezi, *Lehr- und Lesebuch des Albanischen*, A. Hartlebens Verlag, Wien, Leipzig (1913), 180 f.

[11] Gj. Pekmezi, N. Rotta, *Albanische Sprüche und Redensarten*, Wien, Koller Verlag, 1914, 56 f.

studimet e filosofis më 1898. I ndieri është marë me çështjen kombëtare që në djalërin e tij. Përpara, si edhe pas luftës balkanike kish zhvilluar një veprimtari politike reth çështjes kombëtare dhe u përdor nga qeveria Perandorake Austro-Ungarese në detyra përkatëse. Pas shpalljes së pamvarësis kombëtare dhe duke qëndruar kurdoherë në Vjen u ngarkua atje me misione politike e kulturale të ndryshëm edhe nga ana e Qeveris shqiptare. Dr. Pekmezi veç veprimtaris politike, ka zhvilluar edhe një veprimtari letërare-kulturale mjaftë interesante. U muar përgjithësisht me çështje të gjuhës dhe i detyrohet iniciativës së tij caktimi i një kathedre për gjuhën shqipe n'Institutin Oriental të Vjenës, që u themelua në vitin 1903. Më 1920 u emërua Inspektor i studentve shqiptarë në Austri, Gjermani e Çekosllovaki. Më 1928 i ngarkohet barra e mbledhjeve të dokumentave të historis kombëtare nëpër arqivat e Vjenës. Dr. Pekmezi është një nga fytyrat më me rëndësi që luan një rol në historin shqipëtare të këtyre pesëdhjetë vjetëve të fundit. Prandaj jeta e tij publike, si edhe veprimtaria e tij kulturale, është një themë që vlen të zhvillohet gjer e gjatë. Shpresojmë se për së afërmi do të gjejmë mundësin për të studiuar pak më gjerë veprimet e tija kulturale.

Ndërkaq i çojmë familjes së ndierit ngushëllimet t'ona. – **(**redak**.)**

Në këtë nekrologji ka disa të dhëna biografike jo të sakta për Gj. Pekmezin, siç del nga krahasimi me jetëshkrimin e paraqitur prej atij vetë që po japim më poshtë. Shohim gjithashtu që konfuzioni lidhur me katedrën e gjuhës shqipe në Vjenë, konfuzion që vazhdon të ekzistojë ende, ka filluar shumë kohë më parë. Ka mundësi që në vitin 1903 Gj. Pekmezi të ketë filluar mbajtjen e kurseve të gjuhës shqipe në shkollën publike për gjuhët orientale. Jokl-i dëshmon se "Në fillim, d. m. th. në pranverën dhe verën e vitit 1908 mora leksione private nga dr. G. Pekmezi duke arritur kështu që në tetor 1908 të futem menjëherë në kursin e lartë të Shkollës Publike p. m. për Gjuhët Orientale "(shih më poshtë f. 19). Por nuk ka asnjë të dhënë për ngritjen e ndonjë dege të albanologjisë në Institutin Oriental. Shumë i saktë është përcaktimi se Gj. Pekmezi ka luajtur një rol të dorës së parë në historinë shqiptare të kohës dhe se aktiviteti i tij politik, kultural e shkencor duhet të bëhet objekt i një studimi të veçantë, çka vazhdon të mbetet një desideratum për shkencën shqiptare.

Në Arkivin e Universitetit të Vjenës gjendet ky jetëshkrim autograf në gjuhën gjermane që po e riprodhojmë:

Curriculum Vitae

I nënshkruari la lindur më 1 prill 1871 në Ohër (Turqi) nga prindër të besimit ortodoks grek, ndoqi shkollën fillore prej katër klasash të Ohrit, më pas po atje shkollën greke me katër klasa, pas kësaj gjimnazin grek me gjashtë klasa në Manastir (në origj. Bitolj). Më pas ai vazhdoi për katër vjet studimet e tij në Fakultetin Teologjik të Beogradit. Prej këndej erdhi në Universitetin e Vjenës, ku ndoqi për tre semestra si student i parregullt filologjinë sllave dhe gramatikën e krahasuar, duke u pranuar me dekretin ministror të 12 qershorit 1896, nr. 13067 si student i rregullt ndoqi po këtu në mënyrë të rregullt studimet dhe mori dëshminë për përfundimin e tyre më 19 korrik 1899 (Gjerm. Absolutorium shih shën. 32).

Vjenë, 20 prill 1901 Georg Pekmezović Student përfundimtar i Filozofisë në Universitetin p. m. të Vjenës.

Megjithëse vinte prej një province të prapambetur të Perandorisë Osmane, ai i kreu me sukses dhe brenda një kohe rekord të gjitha shkallët e sistemit të shkollimit perëndimor, duke marrë edhe titullin "Doktor". Gramatika e gjuhës shqipe e botuar më 1908 dhe bibliografia shqiptare e botuar një vit më vonë tregojnë se ai i kishte të gjitha mundësitë shkencore, njësoj si kolegët e tij, që të punonte në fushë të gjuhësisë, por angazhimet në jetën politike shqiptare e penguan që ta vazhdonte punën në këtë drejtim. Nga ana tjetër për çështjen shqiptare dhe shtetin e mëvonshëm shqiptar kontributi i një intelektuali të klasit të parë, siç ishte Gj. Pekmezi, ishte i një rëndësie të jashtëzakonshme. Nga shqyrtimi i katalogëve të leksioneve del se dr. Gj. Pekmezi nuk ka ligjëruar kurrë në Universitetin e Vjenës.

Më 19 prill të vitit 1901 Gj. Pekmezi 30-vjeçar i drejtohet nga Vjena Dekanatit të Fakultetit Filozofik me lutjen për ta lejuar që të japë provimet e doktoratës me titull *Die charakteristischesten Unterschiedsmerkmale der beiden albanesischen Hauptdialekte: des Gegischen und Toskischen*[12] (drejtues P. Kretschmer e V. Jagić), të cilën e mori më 31.12.1903. Me sa duket në shkaqet që përcaktuan temën e këtij disertacioni dhe në përfundimet e nxjerra prej tij duhen kërkuar edhe arsyet e vendimit të mëvonshëm të Komisisë Letrare për ta vendosur nëndialektin e Elbasanit në bazë të gjuhës letrare shqipe. Edhe në parathënien e gramatikës ai vë në dukje se "das zentrale Albanien sprachlich noch gar nicht erforscht ist, obwohl das von größter Wichtigkeit wäre"[13]. Prandaj edhe pikënisja në këtë gramatikë është gjuha shqipe e Shqipërisë së Mesme (vom Mittelalbanesischen ausgeht) (Pekmezi 1908: III).

3. Mësimi i gjuhës shqipe në Universitetin e Vjenës

Nga shqyrtimi i katalogëve të leksioneve (gjerm. Vorlesungsverzeichnis) që janë mbajtur në Universitetin e Vjenës deri në semestrin e fundit, d.m.th. semestrin e verës të vitit 2012, dhe i dosjeve të zyrës së kuadrit (Philosophischer Akt) rezulton se lektori i parë i shqipes në këtë Universi-

[12] Dallimet më karakteristike të dy dialekteve kryesore të gjuhës shqipe: gegërishtes dhe toskërishtes.
[13] Shqipëria Qendrore nuk është hulumtuar fare nga pikëpamja e gjuhës, megjithëse kjo ka një rëndësi maksimale.

tet ka qenë Nikolaus Rotta[14], i cili për herë të parë ka mbajtur një kurs të gjuhës shqipe në semestrin e dimrit të vitit akademik 1944/45, pra pak para përfundimit të luftës. Konkretisht në rubrikën "Për dëgjues të të gjitha fakulteteve" (Für Hörer alle Fakultäten)[15] njoftohet për një kurs të gjuhës shqipe për fillestarë, gjithsej dy orë që do të mbahet çdo të hënë e të enjte nga një orë në Institutin Oriental[16] prej lektorit Rotta.[17] Në semestrin e ardhshëm të verës 1945 programi i mësimdhënies në Universitet paraqitet shumë i reduktuar dhe shqipja mungon, por rikthehet në semestrin e dimrit 1945/46 dhe vazhdon kështu për pesë semestra, pra për dy vjet e gjysmë, deri në semestrin e dimrit 47/48, kur shtohet dhe një kurs për të përparuarit. Prej semestrit të dimrit 47/48 deri në semestrin e verës të vitit 1957 ofrohen 4 orë në javë për mësimin e shqipes.[18] Në semestrin e dimrit 57/58 Rotta nuk përmendet më dhe me të përfundojnë dhe kurset e gjuhës shqipe. Pra, Kolë Rrota ka punuar gjithsej 25 semestra, domethënë 12 vjet e gjysmë si lektor i gjuhës shqipe në këtë universitet. Me sa duket ai nuk kishte asnjë titull shkencor dhe përveç veprës "Thënie dhe shprehje shqip" që botoi më 1914 në bashkëpunim me Gjergj Pekmezin nuk kam arritur të zbuloj kontribute të tjera të tij në lëmin e gjuhësisë. Fakti që kurset janë afishuar së bashku me orarin dhe jo me shënimin n.Ü.[19] tregon se dihej që në fillim se ato do të ndiqeshin nga një numër i caktuar studentësh.[20]

---

[14] Për jetën e Kolë Rrotës (23.8.1880 në Shkodër -15.2.1965 në Vjenë) në përgjithësi shih P. Logoreci (2011: 21).

[15] Kjo rubrikë përfshinte ligjërata me tematikë të përgjithshme, për të cilat mendohej se u interesonin të gjithëve dhe jo vetëm studentëve të një specialiteti të caktuar. Pjesa më e madhe e tyre ishin kurse të gjuhëve të huaja.

[16] Instituti i Indoevropianistikës (gjerm. Institut für Indogermanistik) qe deri në vitin 1923 pjesë e Institutit Oriental, i cili u themelua më 5 mars 1886 prej përshtatjes së ambienteve të dikurshme të Seminarit të Matematikës ("Mathematisches Seminar"). Afirmimi i tij si një institut i veçantë i dedikohet rastësisë. Kjo ndodhi kur Instituti Oriental në vitin 1923 u transferua në ambiente te reja, ndërsa indoevropianistika mbeti në godinën qendrore të Universitetit. Atëhere drejtori i atëhershëm i Institutit të Indoevropianistikës, prof. P. Kretschmer, kërkoi krijimin e një instituti të veçantë, që u miratua nga ministria. Një institut i tillë ekzistonte në Grac prej më se 20 vjetësh (Pffeifer 2001:3-4).

[17] Në origjinal: Albanische Sprache. Albanisch für Anfänger, 2 st., Mo. Do. 18-19; Orient. Inst., Lekt. Rotta. Nikolaus Rotta ishte emri i gjermanizuar i shkodranit Kolë Rrota.

[18] Prej WS 51/52 përmirësohet dhe renditja. Deri në këtë moment kurset e shqipes në listën për dëgjuesit e të gjitha fakulteteve gjendeshin pothuajse në fund, ndërsa tani renditen midis greqishtes së re dhe rusishtes.

[19] Shkurtim për "nach Übereinstimmung" (sipas marrëveshjejes midis mësimdhënësit e studentëve).

[20] Arsyeja pse ai e mori përsipër këtë detyrë në moshën 64-vjeçare dhe e vazhdoi derisa u bë 77 vjeç mund të ketë qenë pamundësia për të gjetur një lektor tjetër ose shkaqe personale. Nga formulari i

Një fazë të re në mësimdhënien e gjuhës shqipe shënon semestri i verës i vitit 1952, kur në Institutin e Indoevropianistikës vjen Karl Treimer. Në rubrikën e gjuhësisë së përgjithshme dhe indoevropiane ofrohen për këtë semester 5 leksione, dy nga W. Havers, i cili përqëndrohet sërish te keltologjia dhe tre nga Treimer për shqipen. Që nga fillimi, objekt i mësimdhënies së tij do të jetë vetëm gjuha shqipe. Ja ligjëratat që ka mbajtur ai:

1) SS 1952: Die slawisch-albanischen Beziehungen, 1 st., n. U.[21]; Albanische Rechtsaltertümer, 1 st., n. Ü.; Übungen zur albanischen Volkskunde, 1 st., n. Ü.

2) WS 52/53: Die linguistische Balkaneinheit, 1 st., n. Ü.; Übungen aus dem Bereiche des Illyrerproblems (nur f. Fortgeschr., 1 st., n. Ü.)

3) SS 1953: Einführung in die albanische Sprachgeschichte, 1 st., n. Ü.; Lektüre leichter toskischer Texte, 1 st., n. Ü.

4) WS 53/54: Die Entstehung der ethnologischen Balkaneinheit, 1 st., n. Ü. Kursorische Lektüre und Interpretation des P. Bogdani L'infallibile verità della fede catt., 1 st., n. Ü.

5) SS 1954: Altgegische Literaturdenkmäler, Cuneus prophetarum (Forts.), Kursorische Lektüre und Interpretation, 1 st., n. Ü; Dialektologie des Kosmet und des makedonischen Westgebietes, 1 st., n. Ü.

6) WS 54/55: Anleitung zu wissenschaftlichen Arbeiten, 1 st., n. Ü.

7) SS 1955: Albanische Ethnogenese, 1 st., n. Ü.

8) WS 55/56: Die Stellung des Albanischen innerhalb der Balkansprachen, 1 st., n. Ü .

9) SS 1956: Konversatorium der Albanologie, 1 st., n. Ü.

10) WS 56/57: Albanologisches Konversatorium II, 1 st., n. Ü.

11) SS 1957 Konversatorium der Albanologie, Lektüre und Besprechung neuester albanischer Literatur, 1. St., n. Ü.

12) WS 57/58 Repetitorium der albanischen Sprach- und Volkskunde, 1 st., n. Ü. (p. A).

13) SS 1958: Albanologisches Praktikum, 1 st., n. Ü. S 20.

14) WS 58/59: Grundfragen der albanischen Sprach- und Volkskunde, 1. St., n.

---

parë i të dhënave personale, firmosur nga Rotta më 1 qershor 1945, mësojmë se ka pasur deri më 13. 3.1938 shtetësinë shqiptare, datë kur duhet të ketë paraqitur dokumentet për të kërkuar shtetësinë austriake, se është emëruar lektor i shqipes në Institutin Oriental me dekretin e datës 27.4.1944, adresën e shtëpisë dhe se ka qenë neutral ndaj partisë naziste (NSDAP). Në formularin e dytë, që është firmosur më 21 mars 1950, shënon përsëri si lektor i gjuhës shqipe në Institutin Oriental të Universitetit të Vjenës (Wien IX, Berggasse 7), i ve, pa fëmijë, ka tashmë shtetësinë austriake, ka maturuar më 13 korrik 1907 në Vjenë. Rubrikat për doktoratën dhe docenturën janë lënë bosh, çka tregon se nuk ka bërë as doktoratë as docenturë. Sqaroj se lektor është rangu më i ulët ndër mësimdhënësit e një universiteti.

[21] SS është shkurtimi për Sommersemester "semestri i verës" dhe WS për Wintersemester "semestri i dimrit"; 1st. = 1 Stunde "1 orë"; n. Ü. = Nach Übereinstimmung "sipas marrëveshjes", shkurt "s. marr." Kjo e fundit do të thotë se orari i leksioneve do të vendoset në marrëveshje me studentët, çka ndodh zakonisht kur numri i studentëve është shumë i vogël.

Ü. (p. A.)

15) SS 1959: Hat nicht angekündigt.

16) WS 59/60: Lektüre gegischer Texte, besonders aus den Ausgaben der Propaganda, 2 st., n. Ü.

17) SS 1960: G. Fishta, Lahuta e malcis. Lektüre und Interpretation, 2 st., n. Ü.

18) WS 60/61: Besprechung neuester Literatur, 2 st., n. Ü. dhe Univ.-Doz. O. Haas: Die Sprachen der Balkanländer im Altertum, 2 st.

19) SS 1961: Besprechung neuester Literatur, 2 st., n. Ü. dhe O. Prof. Kronasser: Die Illyrer, ihre Geschichte und Sprache, 1 st., MO. 16-17; Hs. 35b.

20) WS 61/62: Hat nicht angekündigt, por për herë të parë del Univ.-Doz. G. R. Solta me një leksion për gjuhët ballkanike: Balkanlateinische Probleme. Instituti i Ballkanologjisë (gjerm. Institut für Balkankunde) nuk përmendet më.

21) SS 1962: Probleme der Albanologie, 2 st., n. Ü. dhe Solta: Charakteristik des Balkanlateins, 1 st.

22) WS 62/63: Albanalogische (sic!) Repetitorium, 2 st., n.Ü.; Besprechung der neuesten albanologischen Literatur, 2st., n.Ü.; Übungen aus der albanischen Dialektologie, 2 st., n.Ü.

23) SS 1963: Lektüre und Interpretation Varibobis, 2 st., n. Ü.; Die fremden Bestandteile des Albanischen, 1 st., n. Ü.; Dialektologische Übungen, 2 st., n. Ü.; Geschichte der Albanologie, 1 st., n. Ü.

24) WS 63/64: Hat nicht angekündigt. Por Univ.-Doz. Solta: Die Stellung des Albanischen im Kreise der indogermanischen Sprachen, 2 st., Mo. Mi. 17-18; Hs. 35b. Shfaqet "Institut für allgemeine und indogermanische Sprachwissenschaft "(Universität, Hauptgebäude, Tel. 332661)

25) SS 1964: Vergleichende Grammatik des Albanischen, 3 st., n. Ü.; Lesung leichter bis schwieriger Texte, 2 st., n. Ü.; Folklorische Übungen (nur nach Voranmeldung), 1 st., n. Ü.

26) WS 64/65: Lektüre und Interpretation von altgegischen und älteren toskischen Texten, 2 st., n. Ü.; Praktische Übungen in der modernen Literatursprache, 2 st., n. Ü.; Elemente der albanischen Volkskunde, 1 st., n. Ü.

Në shqip:

1) SS 1952: Lidhjet sllavo-shqiptare, 1 orë, sipas marrëveshjes; Mbeturina arkaike në drejtësinë shqiptare, 1 orë, s. marr.; Ushtrime mbi etnologjinë shqiptare, 1 orë, s. marr.

2) WS 52/53. Njësia gjuhësore ballkanike, 1 orë, s. marr.; Ushtrime mbi problemet ilirike (vetëm për të përparuarit, 1 orë, s. marr.)

3) SS 1953. Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, 1 orë, s. marr.; Lexim i teksteve toske të lehta, 1 orë, s. marr. Treimer mban tani titullin docent privat.

4) WS 53/54 Lindja e njësisë etnologjike ballkanike, 1 orë, s. marr.; Lexim pa detaje dhe interpretim i veprës së P. Bogdanit "L'infallibile verità della fede catt.", 1 orë, s. marr.

5) SS 1954[22]: Monumente të letërsisë së vjetër gege, Cuneus prophetarum (të përparuarit), lexim pa detaje dhe interpretim, 1 orë, s. marr.; Dialektologjia e Kosmet-it dhe pjesës perëndimore të Maqedonisë, 1 orë, s. marr.

6) WS 54/55: Udhëheqje për punët shkencore, 1 orë, s. marr.

7) SS 1955: Etnogjeneza shqiptare, 1 orë ., s. marr. Përpara kësaj ai kishte përfunduar në vitin 1951 punimin e docenturës "Die slawische Ethnogenese" (Etnogjeneza sllave, 77 f.) dhe kishte botuar veprën "Ethnogenese der Slawen" (Etnogjeneza e sllavëve, Vjenë 1954, Shtëpia Botuese Gerold, 115 f.).

8) WS 55/56: Vendi i shqipes në kuadrin e gjuhëve ballkanike, 1 orë, s. marr. Që nga ky semester leksionet e Treimer-it në Katalogun e Ligjëratave njoftohen me nëntitullin e veçantë: **Albanische Sprachwissenschaft und Volkskunde** (Gjuhësi dhe etnologji shqipe).

9) SS 1956: Konversatorium i albanologjisë, 1 orë, s. marr. Treimer mban tani titullin Univ. Doz. (docent universitar).

10) WS 56/57: Konversatorium albanologjik II, 1 orë., s. marr.

11) SS 1957: Konversatorium i albanologjisë, lexim dhe diskutim i letërsisë moderne shqiptare, 1 orë., s. marr.

12) WS 57/58: Repetitorium i njohurive për gjuhën shqipe dhe etnologjinë shqiptare, 1 orë, s. marr. (regjistrimi direkt te referuesi)

13) SS 1958 Praktikum i albanologjisë, 1 orë, s. marr. S 20.-[23]

14) WS 58/59: Çështje bazë të gjuhës shqipe dhe etnologjisë shqiptare, 1 orë, s. marr., (regjistrimi direkt te referuesi)

15) SS 1959 – Nuk ka vënë njoftim

16) WS 59/60: Lexim i teksteve gege, sidomos nga botimet propagandistike, 2 orë, s. marr.

17) SS 1960: Gj. Fishta, Lahuta e malcis. Lexim dhe interpretim, 2 orë, s. marr.

18) WS 60/61: Diskutim i literaturës aktuale, 2 orë, s. marr. Krahas tij: Univ.-Doz. O. Haas: Gjuha e vendeve ballkanike në lashtësi, 2 orë.

19) SS 1961: Diskutim i literaturës aktuale, 2 orë, s. marr. Krahas tij: O. Prof. Kronasser: Ilirët, historia dhe gjuha e tyre, 1 orë, të hënën prej 16.00 -17.00, salla 35b.

20) WS 61/62: Nuk ka vënë njoftim. Por herë të parë Univ.-Doz. G. R. Solta me një leksion për gjuhët ballkanike: Probleme të latinishtes ballkanike. Instituti i Ballkanologjisë (gjerm. Institut für Balkankunde) nuk përmendet më në katalogun e leksioneve.

---

[22] Në semestrin e verës të vitit 1954 shfaqet për herë të parë edhe G. R. Solta, ballkanologu i ardhshëm, si lektor me lëndët: Indogermanische Dialektologie II: Italisch und Keltisch, 2 st., n. Ü (Dialektologji indoevropiane II: gjuhët italike dhe kelte, 2 orë, s. marr.). Që prej WS 54/55 ai mban titullin docent privat dhe më vonë profesor. Megjithëse nxënës i Jokl-it dhe njohës shumë i mirë i situatës së gjuhëve ballkanike, të cilave u kushtohet dhe vepra kryesore e tij "Hyrje në gjuhësinë ballkanike me një trajtim të posaçëm të substratit dhe latinishtes ballkanike" (Einführung in die Balkanlinguistik mit besonderer Berücksichtigung des Substrats und des Balkanlateinischen, Darmstadt 1980), në të cilën shqipes i kushtohet një nënkapitull i veçantë, Solta rrallë ka mbajtur leksione për gjuhën shqipe, pothuajse gjithmonë për indoevropianistikën.

[23] Kërkohen 20 shilinga, ndoshta për të blerë materialet.

21) SS 1962: Probleme të albanologjisë, 2 orë, s. marr. dhe Solta: Karakteristika të latinishtes ballkanike, 1 orë.

22) WS 62/63: Repetitorium i albanologjisë, 2 orë, s. marr.; Diskutim i literaturës aktuale, 2 orë, s. marr.; Ushtrime nga dialektologjia e gjuhës shqipe, 2 orë, s. marr.

23) SS 1963: Lexim dhe interpretim i Varibobës, 2 orë, s. marr.; Elementet e huaja të shqipes, 1 orë, s. marr.; Ushtrime dialektologjike, 2 orë, s. marr.; Histori e albanologjisë, 1 orë, s. marr.

24) WS 63/64: Nuk ka vënë njoftim. Por prof. Solta referon për: Vendi i shqipes në gjirin e gjuhëve indoevropiane, 2 orë, të hënën dhe të mërkurën prej 17.00 - 18.00, salla 35b. Shfaqet për herë të parë në katalogun e leksioneve "Instituti i gjuhësisë së përgjithshme dhe indoevropiane "(Universitet, Ndërtesa Qëndrore, tel. 332661).

25)SS 1964: Gramatikë e krahasuar e shqipes, 3 orë, s. marr.; Lexim tekstesh të lehta deri të vështira, 2 orë, s. marr.; Ushtrime folklorike (nevojitet regjistrim paraprak), 1 orë, s. marr.

26) WS 64/65: Lexim dhe interpretim i teksteve të vjetra gege dhe toske, 2 orë, s. marr.; Ushtrime praktike në gjuhën letrare moderne, 2 orë, s. marr.; Elemente të etnologjisë shqiptare, 1 orë, s. marr.

Nga akti i provimit për doktoratën (gjerm. Rigorosenakt), që ndodhet në Arkivin e Universitetit të Vjenës, mësojmë se Karl Treimer ka lindur më 10.10 1892 nga prindër gjermanë në Bërno të Moravisë, Çekia e sotme. Në moshën 22-vjeçare ka paraqitur disertacionin me titull "Beiträge zur albanischen Sprachgeschichte" (Kontribute për historinë e gjuhës shqipe). Referentë kanë qenë P. Kretschmer dhe W. Meyer-Lübke. Në referatin e tij për disertacionin që mban datën 24.5.1914 P. Kretschmer thotë se ai "ist ein Miscellaneaaufsatz, dessen erste Artikel sich auf die albanische Lautlehre beziehen, während die übrigen etymologische Fragen behandeln. Die Arbeit bekundet Beherrschung der sprachwissenschaftlichen Methode, besonders der langgeschichtlichen, und Kenntnis der einschlägigen Literatur. In dem etymologischen Teil werden vielfach zu gewaltsame Bedeutungswandel angenommen… Von dieser Schwäche abgesehen… sie als ein genügendes documentum eruditionis bezeichnet werden darf".[24] Nga jetëshkrimi i hartuar prej atij vetë del se Treimer ka ndjekur leksione te shumë profesorë, ndër të tjerët te Jokl dhe te të dy referentët.

[24] Është një miscelanea, artikujt e parë të së cilës janë për fonetikën shqipe, ndërsa të tjerët trajtojnë çështje etimologjike. Punimi dëshmon se autori e zotëron metodën shkencore, sidomos atë për historinë e hershme dhe e njeh literaturën përkatëse. Në pjesën për etimologjinë supozohen shpesh ndryshime shumë të guximshme të kuptimit. Duke lënë mënjanë këtë dobësi… punimi mund të konsiderohet si një dëshmi e mjaftueshme kualifikimi.

Pas vitit 1962 Treimer mbajti deri në katër leksione për shqipen në semestër. Duke parë 16 leksionet e mbajtura në tetë vjet, ai paraqitet si një albanolog me formim të gjerë, si njohës i letërsisë së vjetër dhe të re shqipe, i historisë së gjuhës shqipe, i marrëdhënieve të saj me gjuhët ballkanike e në veçanti me ato sllave, i së drejtës zakonore, i dialektologjisë, etnologjisë e etnogjenezës shqiptare. Pika e dobët e tij duhet të ketë qenë etimologjia, sepse për këtë kritikohet shpesh dhe ashpër nga bashkëkohësit. Sidoqoftë, këto ishin dhe orët më të lumtura për albanologjinë në Universitetin e Vjenës. Dukej sikur më në fund ishin krijuar mundësitë që ajo të bëhej një degë më vete ose të përfshihej në planin mësimor të degëve ekzistuese. Mirëpo zhvillimet e ardhshme politike shkatërruan gjithçka. Izolimi gjithnjë e më i madh i Shqipërisë dhe ndërprerja e të gjitha marrëdhënieve me shtetet e tjera evropiane e larguan atë nga vëmendja e publikut evropian. Pas largimit të Rrotës dhe Treimer-it duket se s'ka qenë e mundur as gjetja e një lektori ose referuesi të ri për shqipen. Kështu vazhdoi për dhjetëra vjet me radhë derisa më në fund në vitin 1981 filloi punën lektori i ri, dr. Skënder Gashi. Ja çfarë kujton ai lidhur me emërimin e tij si lektor i shqipes në Institutin e Indoevropianistikës të Universitetit të Vjenës:

> "Gjatë kohës kur isha në Vjenë duke mbledhur material për tezën time të doktoraturës, me rekomandimin e të ndjerit prof. G. R. Solta mbajta një kurs gjuhe (një semestër) pa pagesë. Besoj se kjo do të ketë ndodhur në vitin 1978. Në fund të semestrit, kur duhej të kthehesha në Prishtinë, Prof. Solta më pyeti nëse do të isha i gatshëm ta zë vendin e lektorit të rregullt të gjuhës shqipe. Iu përgjegja se këtë punë do ta pranoja me kënaqësi nëse kjo bëhet me kërkesën e Universitetit të Vjenës drejtuar organeve kompetente në Prishtinë. Prof. Solta më sqaronte se Universiteti i Vjenës u ishte drejtuar disa herë për dhjetë vite me radhë autoriteteve kompetente në Tiranë që kjo e fundit ta dërgonte një lektor në këtë Universitet. Tirana nuk ishte përgjigjur asnjëherë. Ndodhi që kah fundi i vitit 1979 qëndrova në Tiranë, si mysafir i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Me kuadro autoritative e bisedova këtë çështje. M'u tha se Shqipëria nuk e kishte ndërmend të dërgonte ndonjë lektor atje dhe se Shqipëria s'ka gjë kundër nëse unë e marr atë post. Pasoi marrëveshja midis Universitetit të Vjenës dhe Sekretariatit Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme të Prishtinës dhe unë ia fillova punës në fillim të vitit 1981. Që nga atëherë deri në fund të vitit 2002 (d.m.th. të vitit akademik 2001/2002 - I. A.) kam mbajtur rregullisht dy kurse gjuhe: për fillestarët e për të avansuarit. Përkrah këtyre, disa vite kam mbajtur ligjërata nga fusha e historisë së gjuhës shqipe, një semestër histori të letërsisë shqipe dhe disa semestra gjuhësi ballkanike" (E-mail 9.3.2012).

Pas largimit të S. Gashit, gjatë semestrit të dimrit 02/03 kurset e shqipes u drejtuan nga dr. Kurt Gostentschnigg. Interesi nga ana e studentëve ishte i vakët. Në semestrin e verës 2003 u bë një pauzë derisa në semestrin e dimrit 03/04 erdhi si lektore autorja e këtij shkrimi, e cila vazhdoi punën deri në fund të semestrit të verës 2010, kur Instituti i Indoevropianistikës nuk e përfshiu më shqipen në programin e ofruar prej tij.[25] Gjatë kësaj kohe kam ofruar kurse të ndryshme, shpesh e imponuar kjo nga rregullat e reja në kuadrin e Procesit të Bolonjës, por që kanë patur në thelb mësimin e gjuhës shqipe për fillestarët dhe më të përparuarit. Interesi nga ana e studentëve ka qenë i konsiderueshëm. Në këto kurse kanë marrë pjesë studentë nga degë të ndryshme të shkencave shoqërore, teknike dhe artistike. Ka pasur shumë pak interes nga ana e studentëve të vetë Institutit, d.m.th. nga gjuhëtarët e ardhshëm, të cilët ishin në numër minimal, dhe kjo ishte dhe arsyeja zyrtare pse kurset e shqipes nuk u ofruan më.

Përveç studentëve të zakonshëm nga vende të ndryshme, sigurisht shumica austriakë, interes kanë treguar edhe studentët shqipfolës nga viset e ndryshme shqiptare, sepse edhe ata mund ta llogaritnin shqipen si lëndë zgjedhore (Wahlfach). Meqenëse kombinimi i tyre me studentët austriakë në të njëjtin kurs ishte i pamundur, kam ofruar për studentët shqipfolës kurse shtesë pa pagesë, në mënyrë që edhe ata të mund të jepnin provime në përputhje me nivelin e tyre. Me këta studentë kam bashkëbiseduar për çështje të gramatikës e dialektologjisë shqipe, të drejtshkrimit dhe të letërsisë së vjetër shqipe e asaj të periudhës së Rilindjes.

Që prej fillimit deri në semestrin e verës 2009 unë kam ofruar dy kurse, gjithsej 4 orë në javë. Në dy semestrat vazhdues u lejua vetëm një kurs derisa u hoq fare.

Përveç kurseve të rregullta të drejtuara nga lektorët, që ishin të gjithë bashkëpunëtorë të jashtëm të Institutit, janë ftuar të referojnë për çështje të ndryshme albanologjike edhe shkencëtarë nga vende të tjera. Deri më tash nuk kam arritur të përcaktoj ende se sa herë kanë qenë ftuar si "Gastprofessor" Eqrem Çabej në periudhën e pasluftës. E bija më kumton se lidhja e

[25] Në semestrin e dimrit 05/06 dhe atë të verës 2006, për shkak se unë isha e sëmurë, njërin nga të dy kurset e drejtoi Mag. Hereida Dani. Përfundimi i mësimdhënies së shqipes përkon me daljen në pension të drejtuesit të Institutit të Indoevropianistikës, prof. Heiner Eichner. Drejtorja aktuale është prof. Melanie Malzahn.

parë pas Luftës u vendos në shtator të vitit 1963 (mesazh elektronik nga B. Çabej më 22.11.2012). Ai ishte ftuar edhe më përpara disa herë, por nuk ishte lejuar të vinte. Solta (1984: 6) flet për një vizitë disamujore në nëntor - dhjetor të vitit 1979. Kësaj radhe shoqërohej nga dr. J. Thomaj. Prof. Wilfried Fiedler ka qenë gjithashtu i ftuar si "Gastprofesor" në vitin akademik 1996/1997.

As.-prof. Stefan Schumacher, bashkëpunëtor i rregullt i Institutit, ka mbajtur dy herë leksionin me titull "Historische Sprachwissenschaft des Albanischen" (Histori e gjuhës shqipe), në semestrin e dimrit 02/03 dhe në semestrin e dimrit 05/06 (sipas mesazhit të tij elektronik më 26.03.2012).

Në kundërshtim me çka lexohet shpesh në shtypin shkencor dhe të përgjithshëm shqiptar, në Universitetin e Vjenës nuk ka pasur kurrë një katedër të gjuhës shqipe, gjë që do të nënkuptonte konkretisht krijimin e një dege (Studienrichtungen) të albanologjisë në Institutin e Indoevropianistikës ose të Indogjermanistikës, siç quhet në terminologjinë gjermane. Mësimdhënia e shqipes këtu ka qenë deri në fund në nivelin e një lektorati.

Fakti që mbajtja e ligjëratave albanologjike në Universitetin e Vjenës pas Luftës së Dytë Botërore ka qenë e kufizuar duke u reduktuar shpesh në nivelet më të ulta, siç janë kurset e gjuhës, shpjegohet sipas mendimit tim me këto arsye:

1. Me interesin e paktë të indoevropianistëve për këtë gjuhë. Shqipja, me dokumentimin e saj shumë të vonë, konsiderohet edhe sot si gjuhë pa interes për gjuhësinë e krahasuar indoevropiane, megjithëse ndër gjuhëtarët e sotëm ka dhe të tillë që e kanë kundërshtuar këtë pikëpamje.[26] Kështu duke ndjekur zhvillimet në Institutin e Indoevropianistikës të Universitetit të Vjenës që nga krijimi i tij shihen qartë përpjekjet që janë bërë gjatë shekujve për zhvillimin e keltologjisë në këtë institut deri në aprovimin e

[26] Matzinger (2008: 4-5) sqaron arsyet e këtij qëndrimi dhe arrin në përfundimin se "Eine gezielte Untersuchung des Albanischen unter Anwendung der neuen indogermanistischen Methoden zeigt nämlich, daß das Albanische sich wohl in den Rahmen des rekonstruierten indogermanischen Modells fügt und neben durchhaus vielen Innovationen letzlich auch Bewahrung altindogermanischer Gegebenheiten aufweist" (Një hulumtim me një synim të caktuar i shqipes duke përdorur metodat e reja indoevropianistike na tregon se shqipja përshtatet mirë në kuadrin e modelit të rikonstruktuar indoevropian dhe krahas shumë inovacioneve të sigurta dëshmon në fund të fundit edhe ruajtje të fakteve të vjetra indoevropiane). Gert Klingenschmitt gjithashtu ka analizuar në shkrimet e tij kontributin e shqipes për gjuhësinë i.e.

saj si një degë e veçantë studimesh. Shqipja nuk u përfshi asnjëherë në planin e detyruar të leksioneve (gjerm. Studienplan) që duhet të ndjekin studentët e Degës së Indoevropianistikës dhe ata të Keltologjisë, dy degët që përfshin ky institut. Ajo është ofruar gjithmonë në kuadrin e të ashtuquajturave shërbimeve publike që bënte instituti dhe ndjekja e një kursi për gjuhën shqipe ishte krejt vullnetare. Pra, varej thjesht nga dëshira e individit nëse ndiqte një kurs për shqipen apo jo. Kështu që mësimdhënia e shqipes në kushtet kur ajo nuk arriti të bëhej kurrë lëndë e detyruar mësimore në asnjërën prej degëve të Institutit ishte e destinuar të dështonte. Në vitin 2010, kur planet mësimore në bazë të procesit të Bolonjës nuk lejonin më shmangie, shqipja u hoq fare me preteksin se orët e përgjithshme të mësimdhënies në Institut u shkurtuan dhe se kishte shumë pak studentë të këtij instituti që ndiqnin kurse për shqipen. Shumica vinte nga degë të tjera jashtë institutit. Por pyetja është: si mund të kishte studentë, kur ata nuk ishin të detyruar dhe kur dihet që ka tepër pak studentë të interesuar për një formim të plotë? Shumica duan të përfundojnë sa më shpejt studimet dhe të fillojnë punën. Përveç kësaj pjesa më e madhe e studentëve në Austri janë të detyruar të punojnë gjatë periudhës së studimeve për të siguruar jetesën. Edhe ata që s'janë të detyruar, punojnë, sepse kjo iu siguron një nivel më të lartë jetese. Nëse shqipja do të ishte futur si lëndë e detyrueshme, p. sh. për dy semestra në planin mësimor të të dyja degëve të institutit, atëhere ky problem do të ishte zgjidhur.

2. Me fatin e keq dhe tragjik të N. Jokl-it. Jokl-i ishte i vetmi profesor, që duke pasur një formim të gjithanshëm si indoevropianist, sllavist, romanist dhe fino-ugrist iu kushtua tërësisht studimit të gjuhës shqipe. Më 1913 Jokli mori titullin docent privat për "Gjuhësinë indoevropiane i specializuar për shqipen, gjuhët balte dhe sllavishten". Por situata e tij shoqërore si çifut nuk e lejoi të bënte për shqipen atë që bëri p. sh. prof. Wilhelm Havers për keltologjinë.[27] Në një artikull të M. Yvon botuar në katalogun e ekspozitës së Bibliotekës Kombëtare Austriake për librat e sekues-

[27] W. Havers si o. P. (= ordentlicher Professor "Profesor i rregullt" dhe drejtor i Institutit të i. e.) ka dhënë këto leksione për keltologjinë duke nisur nga semestri i verës 1939: Altirische Grammatik. Eine Einführung in das Studium des Keltischen, 3 st.; WS 39/40: Altirische Texte, 2 st.; Trimestri I 1940: Alt- und mittelirische Texte, 2 st.; Trimestri II: Einführung ins Mittelirische, mit Lektüre von Fled Bricrend, 2 st. (në këtë trimestër fillon punën si bibliotekar në Institut edhe dr. Georg Solta). Trimestri III: Einführung ins Mittel-Kymrische, 1 st.

truar gjatë sundimit nazist përshkruhen vuajtjet dhe mundimet e Jokl-it gjatë periudhës pas pushimit nga puna deri në vdekjen e tij gjatë deportimit. Pak muaj pas aneksimit të Austrisë nga Gjermania naziste në 12 mars të vitit 1938, konkretisht në maj të atij viti, Jokl-i u dëbua nga puna dhe në qershor e detyruan të dilte në pension. Njëkohësisht atij iu ndalua përdorimi i bibliotekave (Yvon 2013: 2).

3. Me zhvillimet politike pas Luftës së Dytë Botërore dhe sidomos me izolimin e gjithanshëm të vendit nga diktatura komuniste në Shqipëri.

Në homepage-n e Institutit të Gjuhësisë të Universitetit të Vjenës (Institut für Sprachwissenschaft), pjesë e të cilit është dhe Instituti i Indoevropianistikës (Institut für Indogermanistik), rubrika mbi studimin (Studium) hapet me këtë frazë lapidare: An der Universität Wien können Sie - in verschiedenen Instituten - an die achtzig Sprachen studieren, von Englisch bis Tibetisch, von Ungarisch bis Hausa[28]. Mendoj se kjo frazë e pasqyron më mirë se çdo gjë tjetër gjendjen në të cilën jemi dhe tregon qartë se arsyet e këtij problemi nuk janë vetëm ekonomike. Këtu "është harruar "gjuha e një vendi pothuajse fqinjë, gjuha e 7 milionë njerëzve që banojnë në të njëjtin rajon, e më shumë se 80.000 shqiptarëve të emigruar në Austri pas Luftës së Dytë Botërore, të cilët jo vetëm që kanë të drejtën dhe nderin të jetojnë e të punojnë në këtë vend, por paguajnë rregullisht dhe taksat e nevojshme. Me sa di unë shqipja është e vetmja gjuhë indoevropiane dhe më tej evropiane, së bashku me gjuhën baske, për të cilën në Universitetin e Vjenës, mungojnë jo vetëm kurset e mësimit të gjuhës, por dhe çdo lloj tjetër informacioni, siç do të ishin p. sh. leksionet mbi historinë e gjuhës shqipe, marrëdhëniet e saj me gjuhët fqinje etj.

4. Përpjekje për një biografi shkencore të Karl Treimer-it

Ka lindur në Bërno të Moravisë më 10.10.1892. Nga autobiografia del se ka ndjekur leksione te shumë profesorë, midis të tjerëve Jokl, Kretschmer, Meyer-Lübke. Në moshën 22-vjeçare ka paraqitur disertacionin me titull *Beiträge zur albanischen Sprachgeschichte* (Ndihmesa për historinë e gjuhës shqipe). Punimi është vlerësuar nga dy ekspertë, ose refe-

[28] "Në institutet e ndryshme të Universitetit të Vjenës mund të studioni deri në 80 gjuhë, nga anglishtja te gjuha tibetiane, nga hungarishtja deri te hausa".

rentë, siç quheshin në atë kohë: P. Kretschmer dhe W. Meyer-Lübke. Në akt gjendet vetëm vlerësimi i Kretschmer-it, që mban datën "Vjenë, 24 maj 1914". Sipas tij kemi të bëjmë me një Miscellanea, artikujt e parë të së cilës i kushtohen fonetikës shqipe, kurse të tjerët etimologjisë. Punimi tregon që autori e zotëron metodën e punës shkencore në gjuhësi, sidomos atë historike dhe e njeh literaturën përkatëse. Por në pjesën për etimologjinë pranohen shpesh "ndryshime tepër të forta të kuptimit". Duke lënë mënjanë këtë dobësi ai e vlerëson punimin si një dëshmi të mjaftueshme për kualifikimin e kandidatit.

Mbrojtja e disertacionit nuk i hapi Treimer-it rrugën për një karrierë universitare. Siç del nga një dëshmi shëndetësore (Ärztliches Zeugnis) e datës 9.6.1939 ai vazhdon të jetojë në Bërno dhe është që prej vitit 1914 mësues në shkollë të mesme. Në pyetësorin e plotësuar një ditë më vonë, më 10.6.1939 dëshmon se është anëtar i partisë naziste.[29] Këta dokumenta janë paraqitur, sepse më 5 prill 1939 ai ka kërkuar nga Bërno nisjen e procedurës për marrjen e titullit "Docent" (Dr. phil. habil.). Kërkesës i janë bashkangjitur shumë shtojca, midis të cilave njëra me titull "Versicherung über frühere Habilitationsversuche" (Dëshmi të sigurta mbi përpjekje të mëparshme për të marrë docenturën). Më 11.12.1939 i kërkon dekanit V. Christian që fusha e habilitimit të ishte "Indoevropianistika me përqëndrim te sllavistika dhe albanologjia", meqë kjo fushë kishte pasur si përfaqësues derisa ndodhi përmbysja në një profesor jo të rregullt (me këtë ka parasysh Jokl-in). Si punim mund të merrej artikulli i fundit mbi tingullin *f* në shqipet që ishte botuar në "Kuhns Zeitschrift" të vitit të shkuar. Kërkesa nuk pranohet. Prof. W. Havers në ekspertizën e tij të datës 26.10 1939 thotë se është në kundërshtim me urdhëresën nëse dikush që ka disertuar në fushën e gjuhësisë së krahasuar mbron docenturën në fushën e letërsisë.

Pas Luftës, në vitin akademik 1946/47 Treimer i kërkon Kolegjit të Profesorëve të Fakultetit Filozofik të Gracit që t'i jepet e drejta të mbajë leksione për filologjinë sllave. Kësaj kërkese i është bashkangjitur punimi *Germanische Literatureinflüsse auf Julius Zeyer* (Ndikime të letërsisë gjermane te Julius Zeyer, Breslau 1933, f. 543-595) si punim docenture. Më

[29] Në origjinal: NSDAI (= Nationalsozialistische Deutsche Arbeiterpartei), SA-Reiterei, Kyffhäuser. Në shqip: Partia Gjermane Nacionalsocialiste, Kalorësia SA në malsinë e quajtur Kyffhäuser.

10.10.1947 Kolegji i Profesorëve e miraton kërkesën e tij dhe i jep të drejtën të ligjërojë në lëndën filologji sllave. Në letrën që i drejton Kolegjit ai e mohon që ka qenë anëtar i partisë naziste, duke përfituar nga rasti që ishte i regjistruar në Bërno dhe jo në Vjenë dhe kërkon tolerancë për kërkesën që kandidati duhej të kishte shtetësinë austriake. Pra, në këtë kohë nuk e kishte marrë ende shtetësinë austriake. Më së fundi, pas shumë përpjekjesh e kërkesash, dr. K. Treimer lejohet të nënshkruajë më 22.1.1948 kontratën për të dhënë lëndën e historisë së gjuhës dhe letërsisë çeke. Ai emërohet "Docent privat i filologjisë sllave" në Universitetin e Gracit.

Nga letra e dekanit më 1.4.1948 mësojmë se Ministria Federale e ka aprovuar më 18.3.1948 vendimin e Kolegjit të Profesorëve të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Gracit të dt.10.10.1947 për t'i dhënë titullin docent privat në lëndën e filologjisë sllave në Universitetin e Gracit. Një muaj më vonë Treimer i lutet Kolegjit të Profesorëve të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Vjenës "um Erteilung der Lehrbefugnis für slawische Philologie im Grunde der Bestimmungen der Habilitationsnorm vom 9. Juli 1945".[30]

Dekani lëshon një rekomandim më 5.2.1948 që ta ndihmojë në marrjen e shtetësisë. Por vlerësimi i prof. R. Jagodistch më 29.2.1948 është negativ. Ai e kritikon Treimer-in se lavdërohet "Durch die Schaustellung einer universalen Belesenheit und Kenntnis vieler Sprachen...".[31]

Por vlerësimi i prof. Bleichsteiner për punimin "*Etnogjeneza sllave"* më 24.1.1950 është tepër pozitiv dhe kjo është ndoshta e vetmja herë kur Treimer merr një vlerësim të tillë. Nga letra drejtuar Kolegjit të Profesorëve në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Vjenës më 18.4.1950 vërtetohet se ai ka paraqitur trajtesën *Die slawische Ethnogenese*. Ai kërkon nëpërmjet një avokati që në komisionin që do të shqyrtojë kërkesën e docenturës të shtohet edhe prof. Richard Pittioni. Provimi u bë më 5 mars 1951 në orën 11.00. Për leksionin provë (Probevortrag) Treimer ka propozuar këto tema: 1. Tabuja në shqip 2. Vuk Karaxhiq dhe albanologjia 3. Ali Pashë Tepelena. Pra, pozita e veçantë e shqipes në këto vite i kushtohet këm-

[30] Për t'i dhënë të drejtën e mbajtjes së leksioneve në lëndën filologji sllave sipas rregullave të normës së docenturës të datës 9 korrik 1945.

[31] Duke u mburrur me atë që kam lexuar gjithçka dhe faktin që njeh shumë gjuhë.

bënguljes së një shkencëtari të huaj në Austri dhe faktit që ai nuk mundi të merrte docenturën në fushat e dëshiruara prej tij. Kërkesa e prof. Günther Wytrzens më 20.6.1967 për t'i dhënë titulli "Prof. inordinar" u tërhoq më 27.11.1967.

Në pyetësorin për gjendjen civile të personelit që mban datën 10.10. 1957 Treimer shënon si adresë: Wien 39, Moissigasse 17. Pra, mesa duket jeta e tij ishte e predestinuar të ishte e lidhur me Shqipërinë dhe shqiptarët [AUW, Philosophische Fakultät der k. k. Universität Wien, Rigorosenakt des Karl Treimer (Nr. 3895); Philosophischer Akt Treimer (Nr. 3469)].

5. Norbert Jokl-i dhe periudha para Luftës së Dytë Botërore

Në të vërtetë interesimi për botën shqiptare dhe për çështje të albanologjisë në Universitetin e Vjenës kishte nisur që në shek. XIX, pra shumë kohë përpara kurseve të mirëfillta të gjuhës të ofruara nga lektori K. Rrota dhe leksioneve të Karl Treimer-it. Nga hulumtimet e bëra deri tani më rezulton se i pari që ka mbajtur një leksion me karakter albanologjik është o. ö. Prof.[32] Dr. Josef Const. Jireček në semestrin e verës 1898 me titull: *Mazedonien und Albanien im Mittelalter in geographischer Übersicht*, 2 stündig, Montag 8-10 (Vështrim gjeografik mbi Maqedoninë dhe Shqipërinë në mesjetë, 2 orë, të hënën 8-10). Dy vjet më vonë, në semestrin e verës 1900, privatdocent dr. Mathias Murko në rubrikën "Slavische Philologie" referon për ilirizmin. Ndoshta dhe këtu mund të ketë rënë fjala herë pas here edhe për shqiptarët, por në këtë punim do të përqëndrohemi vetëm te ato ligjërata që merren krejtësisht me çështje albanologjike. Në semestrin e dimrit 1907/1908, përsëri në kuadrin e sllavistikës, o. ö. Prof. Dr. Jireček referon në një leksion njëorësh për Shqipërinë në mesjetë (Albanien im Mittelalter, 1 stünd., Freit. 11-12; Saal 16). Dy vjet më vonë ai referon 5 herë në javë nga një orë për shtetet dhe popujt ballkanikë në shek. XII – XV, derisa në semestrin e verës 1913 shfaqet për herë të parë Norbert Jokl-i, që ofron dy orë për lexim dhe analizë tekstesh në gjuhën shqipe. Njoftimi në kopjen e katalogut të leksioneve që ruhet në Arkivin e Universitetit është bërë më dorë, çka tregon se vendimi për mbajtjen e leksionit

[32] Do të thotë "ordentliche österreichische Professor "(profesor austriak i rregullt).

është marrë me vonesë, pas afatit zyrtar të miratimit. Sigurisht, do të ishte interesante të dinim se sa dëgjues kishte Jokl-i në leksionet e tij dhe cilët ishin ata, por kjo gjë nuk mund të zbulohet. Përmendim shkurt se anëtari i mëvonshëm i Komisisë Letrare, dr. Rajko Nachtigall, do të zhvillojë si lektor kurse të ndryshme të gjuhëve sllave duke filluar prej WS 1911/ 1912 me rusishten, por asnjëherë nuk do të referojë diçka për shqipen.

Dr. Norbert Jokl-i kishte disa vjet që interesohej për shqipen. Siç njofton Pfeiffer (2001: 8) ai mbrojti në vitin 1907 disertacionin me titull *Ein urslawisches Entnasalierungsgesetz*, i cili u aprovua nga Jagić dhe Kretschmer. Mbrojtja e disertacioneve në Universitetin e Vjenës kishte filluar në vitin 1872, sepse deri atëherë nuk kërkohej hartimi i një disertacioni. Pas disa vitesh Jokl-i do të vazhdojë me docenturën (Habilitation)[33], duke mbetur i vetmi docent për lëndën e indoevropianistikës deri në vitin 1923, kur instituti u mëvetësua.[34] Peiffer sjell këto raporte mbi jetën dhe veprimtarinë shkencore të Jokl-it në këtë periudhë:

> Raportin e dekanit (Staatsarchiv, AVA Unterricht, 4Phil, N. Jokl, ZL.11757) (sipas Pfeiffer 2001: 8-9, që citon dokumentin origjinal që gjendet në Arkivin e Shtetit)
>
> Nr. 1652 ex 1911/12Vjenë, 8 mars 1913
>
> Ministrisë p. m. për Fenë e Arsimin!
>
> Z. dr. Norbert JOKL i është drejtuar me anë të kërkesës së bashkangjitur Kolegjit të Profesorëve të Fakultetit Filozofik për t'i njohur të drejtën e mbajtjes së ligjëratave (gjerm. venia legendi) në fushën e gjuhësisë indoevropiane.
>
> Kërkesa iu caktua për shqyrtim një komisioni të përbërë nga profesorët Kretschmer, Meyer-Lübke, Jireček, v. Rešetar, Vondrak, Bittner, Much dhe Grobben.

[33] Shkalla e dytë e kualifikimit shkencor në Universitetin e Vjenës, që synon marrjen e titullit docent privat.

[34] Po këtu Pfeiffer jep dhe një statistikë të disertacioneve që janë mbrojtur nga fusha e "Gjuhësisë së përgjithshme dhe indoevropiane" (Allgemeine und indogermanische Sprachwissenschaft) gjatë kohës së Kretschmer-it, d.m.th. prej emërimit të tij në tetor 1899 deri në themelimin e institutit të pavarur më 1923: gjithsej 22 punime, prej të cilave 13 për greqishten dhe dialektet e saj, 2 për shqipen, 3 për balto-sllavishten, 1 për keltishten dhe 3 për indoevropianistikën në përgjithësi. Nuk e kam shumë të qartë se çfarë numërohen këtu si disertacione për shqipen, sepse disertacioni i Jokl-it është në fakt për gjuhët sllave. Disertacioni tjetër është mbrojtur nga Treimer (shih më poshtë). Përsa u përket docenturave, të tjerë docentë privatë ishin Julius Pokorny, i cili kishte doktoruar më 1911 për filologji kelte dhe mori titullin docent po për filologji kelte në vitin 1913 duke qenë i pari docent privat në këtë fushë në Universitetin e Vjenës, si dhe Rober Bleichsteiner, që kishte mbrojtur më 1914 disertacionin për filologji orientale. Ai mori titullin docent privat më 1921 duke iu dhënë e drejta të ligjërojë për gjuhësinë kaukaziane.

Në mbledhjen e Kolegjit të Profesorëve të datës 9 nëntor 1912 z. prof. Kretschmer paraqiti në emër të komisionit referatin e bashkangjitur dhe kërkesën për lejimin e regjistrimit në shkallët e mëtejshme të docenturës, e cila u pranua me 30 vota pro, 4 kundër dhe 2 abstenime. Më 30 nëntor u zhvillua kolokuiumi dhe më 7 shkurt të këtij viti ligjërata provë mbi temën e zgjedhur nga komisioni: "A ka pasur një njësi gjuhësore balto-sllave?" në praninë e të gjithë anëtarëve të komisionit. Të dyja ishin konfrom kërkesave ligjore.

Në mbledhjen e Kolegjit të Profesorëve të datës 1 mars 1913 z. dr. Norbert Jokl iu njoh e drejta për të mbajtur ligjërata në fushën e gjuhësisë indoevropiane duke pasur si tema bazë shqipen, baltishten dhe sllavishten me 39 vota pro, 2 kundër dhe 2 abstenime.

Dekani si nënshkrues i kësaj shkrese kërkon nga ministria p. m. që dr. Norbert Jokl-it t'i aprovohet me dashamirësi leja për mbajtjen e ligjëratave.

Dekani i Fakultetit Filozofik (Schroeder m.p.[35])

Këtij akti i është bashkangjitur edhe jetëshkrimi i Jokl-it i hartuar nga ai vetë:

Unë, Norbert Jokl, kam lindur në Bizenc (gjerm. Bisenz) në Moravi (qarku Hradish-i hungarez)[36] më 25 shkurt 1877 si djali i tregtarit (më vonë qiramarrës i një bujtine) Heinrich Jokl, dhe bashkëshortes së tij Emilie Haas. Pas vdekjes së babait më 1898 vendin e tij e zuri daja im, tregtari Alexander Haas. Me gëzim deklaroj se nëna ime jeton ende. - Unë i përkas fesë çifute. Gjuha amtare dhe kombësia ime janë gjermane. - Deri më 1887 ndoqa shkollën fillore në vendlindje, prej 1887 vazhdova në gjimnazin shtetëror p. m. duke pasur si gjuhë mësimi gjermanishten në Hradisch-in hungarez. Në këtë institucion mora në korrik 1895 provimin e maturës me vlerësimin "Shkëlqyeshëm". Po atë vit në vjeshtë nisa universitetin. Në atë kohë nuk munda ta realizoja dëshirën time për t'iu kushtuar studimeve gjuhësore dhe filologjike, prandaj, nën presionin e kushteve të jashtme, më duhej të kënaqesha me studimin e drejtësisë dhe shkencave shtetërore. Më 1897 mora provimin shtetëror për historinë e drejtësisë me vlerësimin "Shkëlqyeshëm", më 1899 mbarova studimet.[37] Në vitet 1900 dhe 1901 dhashë provimin shtetëror të jurisprudencës dhe shkencave shtetërore me vlerësimin "Shkëlqyeshëm" dhe njëkohësisht të tria provimet përkatëse (gjerm. Rigorosum), pas të cilave mora titullin "Doktor i drejtësisë". Më pas hyra si praktikant i drejtësisë në Gjyqin p.m. të Qarkut të Vjenës në shërbimin avokator përgatitor. Por koha e ushtrimit praktik të drejtësisë do të zgjaste vetëm disa muaj. Që gjatë studimeve në juridik kisha ndjekur disa leksione për gjuhësinë dhe isha përpjekur ta përdor kohën time të lirë për leximin e veprave gjuhësore. Gjatë praktikës në gjykatë studimi i gjuhësisë u shty edhe më tepër në qendër të interesave të mia, dhe kështu vendosa më në fund

[35] Ka kuptimin: manu propria.

[36] Në çekisht Uherské Hradiště.

[37] Në gjerm. Absolutorium. Kjo do të thotë që studenti ka përfunduar studimet dhe i mbetet për të bërë vetëm diplomën.

në moshën 25 vjeçare, t'i jap drejtësisë përgjithmonë lamtumirën dhe t'i kushtohem tërësisht studimit të gjuhësisë. Pas kësaj ndoqa leksionet e profesorëve dhe docentëve: v. Armin, Bormann, Hauler, v. Jagić, Jellinek, Jodl, Kreibig, Kretschmer, Meyer-Lübke, Much, Müllner, v. Schroeder, Sklenář, Szanto, Vondrák. Me ndihmën e dr. Zomarides fillova të mësoj greqishten e re. Leksionet e profesorëve Kretschmer dhe v. Jagić u dhanë drejtim studimeve të mia. Në ushtrimet e drejtuara prej tyre kam marrë pjesë vazhdimisht me referate kritike dhe interpretime. Në fund të vjeshtës të vitit 1903 hyra si praktikant në shërbim të Bibliotekës p. m. të Universitetit të Vjenës. Falë aprovimit të Ministrisë së nderuar p. m. për Kulturën e Arsimin dhe liberalizmit të shefit tim të dikurshëm, Këshilltarit të Oborrit (Hofrat) dr. Wilhelm Haas, munda të ndjek rregullisht leksionet dhe ushtrimet edhe pas punësimit në bibliotekë. - Më 1906 u botua në revistën e Jagić-it "Arkiv për filologjinë sllave" (Archiv für slavische Philologie) studimi im i parë: *Një ligj mbi humbjen e nazalitetit në sllavishten e vjetër* (Ein urslavisches Entnasalierungsgesetz), i cili më 1907 u pasua nga një artikull plotësues për të njëjtën temë. Të dy artikujt, të përpunuar në një të vetme, u pranuan si disertacion nga Fakulteti Filozofik i Universitetit të Vjenës. Në dhjetor të vitit 1907 dhashë provimin kryesor (gjerm. Hauptrigorosum) nga fusha e gjuhësisë së krahasuar në lidhje me filologjinë sllave, historinë e antikitetit dhe gjuhën e letërsinë gjermane me vlerësimin: "Pa përjashtim shkëlqyeshëm". Në mars 1908 munda t'i shtoj këtij provimin e dytë (Nebenrigorosum) nga fusha e filozofisë me të njëjtat rezultate. Më 26 mars 1908 u promovova si Doktor i Filozofisë.

Studimin e shqipes e kisha nisur që më 1907. Pas promovimit tim si dr. phil. iu kushtova në radhë të parë studimit të kësaj gjuhë ende pak të hulumtuar. Në fillim, d.m.th. në pranverën dhe verën e vitit 1908 mora leksione private nga dr. G. Pekmezi duke arritur kështu që në tetor 1908 të futem menjëherë në kursin e lartë të Shkollës Publike p. m. për Gjuhët Orientale. Gjatë mësimeve të mia të mëtejshme albanologjike, të bëra vullnetarisht, u përpoqa që vëmendjen kryesore t'ia kushtoj njohjes sa më të plotë të teksteve të vjetra, të cilat ende janë pak të studiuara, bile pjesërisht nuk janë studiuar fare, si dhe letërsisë bashkëkohore, e cila ofron një material të pasur për gramatikën dhe leksikun, deri tani të pashfrytëzuar. Shumë shkrimtarë shqiptarë nga Shqipëria dhe diaspora më kanë mbështetur në këtë punë duke më dërguar shkrime që mezi gjenden. Përveç kësaj jam përpjekur ta zotëroj këtë gjuhë edhe nga ana praktike. Për shkak të turbullirave të vazhdueshme m'u desh të hiqja dorë hëpërhë nga plani për të shkuar në Shqipëri, por jam ushtruar në konversacion me pjesëtarë të kolonisë shqiptare në Vjenë, bile në të dyja dialektet kryesore: gegërisht me z. Jozef Harapi nga Shkodra në verën e vitit 1909, toskërisht me z. Themistokli Kasapi nga Berati më 1911 dhe 1912. Si fryt i parë i studimeve të mia albanologjike doli në vëllimin XXXI të "Arkivit për filologjinë slave" më 1909 një recension për gramatikën e gjuhës shqipe të Pekmezit. Por edhe studimet për sllavistikën jam përpjekur mos t'i lë pasdore: botimi jubilar për z. Këshilltar të Oborrit v. Jagić, mësuesin tim të nderuar, që doli më 1908, përmban edhe një artikull etimologjik nga unë; më 1910 doli në vëllimin XXVII të "Hulumtimeve

indoevropiannistike" (Indogermanische Forschungen) një shkrim *Mbi "anarkinë në etimologji" dhe luftën kundër saj*. - Të tjera studime albanologjike që kam botuar janë: *Studime për etimologjinë dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe* (Studien zur albanischen Etymologie und Wortbildung) më 1911 (Sitzungsberichte der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften, Vjenë, Phil.-hist. Klasse 168/1) dhe *Ndihmesë për gramatikën e gjuhës shqipe* (Beiträge zur albanischen Grammatik) më 1912 (Indogermanische Forschungen, 30, 192-210).

Në postin tim zyrtar u bëra në nëntor të vitit 1909 amanuensis (klasa IX e nëpunësve shtetërorë p. m.), emërtim i cili në vjeshtën e vitit 1911 u kthye në "Bibliotekar i klasës II" (Pfeiffer 2001: 9-11).

Sipas Pfeiffer-it (2001: 12) referati i Kretschmer-it që përmendet më sipër është hartuar më 9 nëntor 1912 dhe bën pjesë në dosjen e zyrës së kuadrit (Personalakt) për Jokl-in që gjendet në Arkivin e Universitetit të Vjenës. Ai përsërit të dhënat biografike të Jokl-it dhe kalon pastaj në vlerësimin e rezultateve të punës së tij shkencore:

Si fusha kryesore të punës së tij shkencore ai zgjodhi gjuhët sllave, balte dhe shqipen dhe fitoi për to njohuri solide dhe të thelluara. Studimi i tij kryesor dhe njëkohësisht punimi i docenturës, *Studien zur albanesischen Etymologie und Wortforschung* (Studime për etimologjinë dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe), që u botua në raportet e mbledhjeve (Sitzungsberichte) të Akademisë sonë, (Phil.-hist. Klasse, 168. Band, 1911), dëshmon për njohuritë e tij dhe dhuntinë për t'i kombinuar gjërat, çka e bën atë të aftë sidomos për hulumtimet etimologjike. Ky punim na çon përtej fjalorit etimologjik bazë të Gustav Meyer-it, sepse atje tregohet se me të vërtetë Meyer-i kishte përcaktuar për shqipen tepër shumë huazime dhe tepër pak material të trashëguar. Disertacioni i Jokl-it nuk mbeti pa u kundërshtuar, por tregon megjithatë njohje goxha të madhe të gjuhëve sllave.

Dhjetë vjet pas docenturës një komision nën drejtimin e Kretschmer-it merrej përsëri me Jokl-in. Më 18.11.1922 ai kërkonte që Jokl-it t'i njihej titulli i profesorit pa katedër. Raporti i komisionit, që mban datën 10.2. 1923, gjendet në Arkivin e Universitetit, në dosjen e zyrës së kuadrit, dhe citohet si më poshtë nga Pfeiffer (2001: 12-13) duke lënë jashtë të dhënat biografike, tashmë të njohura:

(Jokl-i si docent privat)... ka merita dhe për faktin që në semestrat e fundit, kur filologjia sllave në Universitetin tonë mbeti fare keq për shkak të largimit të prof. Vondrak, e mbushi në njëfarë mase këtë boshllëk nëpërmjet ligjëratave për sllavishten e vjetër kishtare.

Veprimtaria e tij botuese është përqëndruar që nga koha e docenturës kryesisht mbi shqipen dhe ai është bërë në këtë fushë, e cila para mbarimit të luftës ishte për ne politikisht dhe gjeografikisht shumë e afërt, por që dhe tani ende bën pjesë në

rrethin e interesave tona shkencore, një nga specialistët më të shquar. ... Artikujt e tij për gramatikën shqipe në "Indogermanische Forschungen" të vitit 1912, 1916 dhe 1917 ndihmuan në zgjidhjen e çështjeve të fonetikës dhe lakimit. Në historinë e gjuhësisë indoevropiane nga Streitberg ai ka trajtuar me kompetencë të veçantë pjesën për shqipen (1917). Vepra e tij kryesore *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen*, rreth 23 fashikuj e trashë, është në shtyp dhe do të botohet së shpejti.

Kohët e fundit ai është marrë dhe me çështjen e rëndësishme të raportit të fino-ugrishtes me trungun gjuhësor indoevropian dhe ka trajtuar në një artikull të përfshirë në botimin jubilar për Beaudouin (sic!) de Courtenay fino-ugrishten si burim të dhënash për historinë më të vjetër të gjuhës indoevropiane duke mbajtur edhe ligjërata për këtë çështje. Artikujt e tij të tjerë, prej të cilëve dy i takojnë sllavistikës, po i përmend vetëm shkurt. Dr. Jokl-i karakterizohet nga një erudicion i shumanshëm, i shoqëruar me aftësinë për t'u shkuar thellë gjërave dhe për të gjykuar në mënyrë të pavarur ...

Kërkesa e komisionit u pranua nga fakulteti me 38 vota pro, 3 kundër dhe 3 abstenime. Sipas shënimit në dosjen e zyrës së kuadrit më 28. 3.1923 Presidenti i Republikës e emëroi Jokl-in "Profesor pa katedër", titull[38] të cilin e mbajti deri në fund të jetës (Pfeiffer 2001: 13).

Siç duket qartë nga këto dokumente N. Jokl-i ishte nëpunës i Bibliotekës së Universitetit, që mbante ligjërata të ndryshme për gjuhën shqipe si lektor dhe më vonë si profesor i jashtëm. Krahas kësaj ai mbante leksione edhe për gjuhë të tjera. Nxënësit e tij do të ishin E. Çabej dhe G. R. Solta, i cili e vizitoi dhe mori mësime prej tij deri në momentin e fundit duke e furnizuar edhe me literaturën e nevojshme. Autorja e këtij studimi ka mbajtur kontakte me prof. Soltën deri pak vite para vdekjes dhe ka pasur rastin të bisedojë me të edhe për N. Jokl-in. Kjo ka ndodhur sidomos rreth viteve 2000, kur ajo u angazhua për vendosjen e një pllake përkujtimore në fasadën e pallatit ku kishte banuar dikur Jokl-i, në adresën Neustiftgasse 67 të lagjes nr. 7 të Vjenës. Më se njëherë prof. Solta më ka treguar se fati e ndihmoi duke e bërë të largohej nga banesa e Jokl-it vetëm një orë para se të arrinte atje Gestapoja rreth orës 21. 00 të mbrëmjes. Përndryshe situata do të kishte qenë problematike edhe për të. Nuk e kuptoj pse vazhdon të diskutohet ende për momentin e arrestimit të Jokl-it (Yvon 2013: 8), kur prof. Solta e thoshte qartë se ai është arrestuar në orën nëntë të darkës, në

[38] Titulli i tij i saktë ishte Pd. (a. P.), d.m.th. Privatdozent dhe außerordentlicher Professor "docent privat dhe profesor inordinar". Këta janë tituj privatë dhe jo vende pune të planifikuara e të paguara.

kohën që ai vetë ishte larguar që andej në orën tetë, çka është e besueshme duke pasur parasysh rregullat etike të bashkëjetesës në kryeqytetin austriak. Bashkë me prof. Solta-n kemi vajtur të shohim edhe pllakën përkujtimore në gjermanisht e sllovenisht të vendosur për nder të Franz von Miklosich-it[39] pranë banesës së Jokl-it. Por me gjithë këmbënguljen time pllaka përkujtimore nuk arriti të vendosej. Më kujtohet se një pengesë përbënte fakti që në fasadën përkatëse kishte edhe shumë tabela të tjera informuese ose përkujtimore, siç mora vesh nga drejtori i atëhershëm i Institutit të Indoevropianistikës, i cili duhej të paraqiste kërkesën te arkitekti i Bashkisë për të bërë ndryshimet e duhura, me qëllim që t'i hapej vend edhe pllakës përkujtimore të Jokl-it të shkruar në dy gjuhë, gjermanisht dhe shqip, dhe e cila do të ishte e para pllakë publike në gjuhën shqipe që vendosej në kryeqytetin austriak. Por edhe sot mbishkrimi i hartuar fillimisht nga S. Gashi në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës fle diku në sirtarët e shumtë të arkivave të këtij universiteti. Duke qenë se për 8 vjet rresht kam banuar në të njëjtën rrugë me shkencëtarin fatkeq, konkretisht ai diku nga fillimi dhe unë krejt në fund, kaloja të paktën një herë në ditë me autobus para ndërtesës ku kishte banuar dikur ai dhe kisha vërtet dëshirën e mirë që të ndihmoja me të gjitha mundësitë për t'i dhënë atë që meritonte.

Nga ana e tij prof. Solta, i cili ndër të tjera ishte edhe një besimtar katolik i devotshëm, nuk ua fali kurrë kolegëve përgjegjës vdekjen tragjike të N. Jokl-it.[40] Përpjekjet e tij për ta nderuar aktivitetin shkencor të albanologut të shquar kanë qenë të shumta. Në 28 shtator - 3 tetor 1972 u zhvillua në Insbruk një kolokuium albanologjik në kujtim të Norbert Jokl-it, ku morën pjesë shkencëtarë shqiptarë dhe të huaj. Organizatori kryesor i këtij aktiviteti ishte prof. Hermann Ölberg. Në nëntor të vitit 1979, kur E. Çabej ishte ftuar të mbante leksione në Institutin e Indoevropianistikës, u organizua një takim në Ministrinë Austriake të Shkencës dhe Hulumtimit shkencor, ku u diskutua për mënyrën e nderimit publik të N. Jokl-it dhe përpu-

[39] Slloven, themelues i sllavistikës moderne. Për të u ngrit në vitin 1849 e para katedër e filologjisë sllave në Universitetin e Vjenës.

[40] Autorja e këtij studimi është përpjekur ta shprehë respektin e saj dhe të gjuhësisë shqiptare ndaj kontributit të prof. Soltës për shkencën albanologjike me pjesëmarrjen në meshën mortore të tij ku lexoi edhe një poezi nga Nënë Tereza.

nimin e veprave të pabotuara të tij. Me këtë rast u ngrit edhe një grup pune (Solta 1984: 6). Në mbledhjen e dt. 3 mars 1982 grupi i punës mori vendimet përfundimtare për nderimin publik të figurës së N. Jokl-it, si përpilimi i kërkesës që do t'i drejtohej Senatit Akademik të Universitetit të Vjenës për ta përfshirë emrin NORBERT JOKL në Tabelën e Nderit të Fakultetit Filozofik, çka dhe u plotësua (Solta 1984: 6). U vendos gjithashtu edhe botimi i një artikulli në dorëshkrim, që në mbledhjen e parë të grupit të punës ishte përcaktuar si provë. Këtu është vendi të theksojmë se, siç sqaron edhe botuesi i këtij artikulli, prof. O. Pfeiffer, i cili ka bërë edhe traskriptimin e materialit, botimi i dorëshkrimeve të Jokl-it paraqitet si një punë pothuajse e parealizueshme, për shkak se ai gjithandej dhe kudo në shkrimet e veta ka përdorur sistemin stenografik të tipit Gabelsberger të panjohur për ne sot. Prandaj botimi i shkrimit të tij *Ndihmesa gjuhësore për paleoetnologjinë e Gadishullit Ballkanik* (1984) ishte një sukses që nuk u përsërit më. Parathënia e hartuar nga G. Solta hapet me këtë përcaktim:

> NORBERT JOKL war einer der bedeutendsten Sprachwissenschaftler, die je an der Universität Wien gewirkt haben (NORBERT JOKL është një ndër gjuhëtarët më të rëndësishëm që kanë zhvilluar aktivitetin e tyre në Universitetin e Vjenës). Dhe më poshtë: In das Studium der albanischen Sprache hat sich JOKL selbst eingearbeitet und nahm damit die Tradition eines GUSTAV MEYER (Graz) auf. Er hat es in diesem Fach zu einer Meisterschaft gebracht, die bis heute nicht übertroffen ist[41]. Ai ka arritur në këtë fushë një mjeshtëri të tillë, që deri më sot nuk ka mundur ta tejkalojë askush (Solta 1984: pa numr.)
>
> Në vijim lista e leksioneve të mbajtura nga Norbert Jokl:
>
> 1.SS 1913: Në rubrikën "Vergleichende Sprachforschung und orientalische Philologie": Jokl Norbert Priv. Doz. Dr - Lektüre leichter albanischer Texte mit sprachwissenschaftlichen Übungen. 2 stündig (me shkrim dore). K. 4.20
>
> 2.WS 1913/14: Jokl Norbert, Privatdoz. Dr.: Vergleichend-historische Grammatik des Albanesischen, 2 stündig, nach Übereinkunft (në fund të rubrikës së lartpërmendur). Jireček Josef Konst., o. ö. Prof. Hofr. Dr.: Albanien im Mittelalter, 1 stünd... K. 2.10 në rubrikën "Slawische Philologie".
>
> 3.SS 1914: Jokl Norbert, Privatdoz. Jur. et Ph. Dr.: Einführung in das Altpreußische, 2 stündig ... K 4, 20.
>
> 4.WS 1914/15: Litauische Grammatik mit Übungen, 2 stünd...
>
> 5.SS 1915: Litauische Grammatik mit Übungen (Fortsetzung), 2 stündig, Sa.2-4;
>
> 6.WS 1915/16: Albanesische Grammatik mit Übungen, 2 stünd., nach Übereinkunft K 4.20 (i është hequr viza me dorë dhe është vënë shënimi: abgesagt)

[41] Jokl-i u stërvit vetë në studimin e gjuhës shqipe duke përvetësuar kështu traditën e G. Meyerit (Grac).

7.SS 1916: Jokl Norbert, Privatdoz. . . wird nicht lesen. Në fund, në listën ku shënohet numri i studentëve sipas vendit nga vijnë për semestrin e kaluar, d.m.th. për WS 1915/26, përmendet për herë të parë edhe Shqipëria: Albanien: 1 (ordentliche Hörer an der medizinischen).

8.WS 1916/17: Albanesische Grammatik mit Übungen, 2 stünd., nach Übereinkunft K 4.20. Në listë: Albanien: 1 (ordentliche Hörer an der medizinischen) për SS 1916.

9.SS 1917: Indogermanisch und Finnisch-Ugrisch (mit besonderer Berücksichtigung des Magyarischen), 2 stündig, nach Übereinkunft K 4. 20 (është fshirë me dorë plus shënimi: abgesagt). Sipas listës semestrin e kaluar nuk ka pasur asnjë student shqiptar.

10.WS 1917/18: wird vielleicht später ankündigen. Asnjë student shqiptar për semestrin e kaluar.

11.SS 1918: Die slawischen Elemente des Rumänischen, 2 stündig, nach Übereinkunft K. 4. 20. Lista e studentëve: 2 (ord. Hörer an der medizinischen WS 1917/18). Për SS 1918: 1 (ord. Hörer an der juristischen).

12.WS 1918/19: Litauische Grammatik mit Übungen, 2 stünd., nach Übereinkunft K 4. 20. Nuk ka më listë për prejardhjen e studentëve sipas vendeve.

13.SS 1919: Lettische Grammatik (mit Übungen), 2 stündig, nach Übereinkunft. Në këtë semestër ka një statistikë të studentëve sipas vendlindjes për semestrin e kaluar, WS 18/19. Për Serbinë dhe Shqipërinë: Ordentliche Hörer: Juridicum (4), Medizin (5); Philosofische Fakultät (1). Außerordentliche Hörer: 1 (unter Frequentanten); 2 (unter Philosophischen u. zw. / A. o.).

14.WS 19/20: Vergleichend-historische Grammatik des Albanischen mit Übungen, 2 st., n. Übereink. Për Serbinë dhe Shqipërinë në SS 19 regjistrohem: 4 (jur.); 5 (med.), 2 (philosophische), 1 (Med./Freq.), 3 (philosophisch/A. o.).

15.SS 1920: Vergleichend-historische Grammatik des Albanischen (Fortsetzung), 2 st., n. Übereink. Deri tani leksionet zhvillohen vetëm në Institutin e Orientalistikës (gjerm. Orientalisches Institut).

16.WS 20/21: Litauische Grammatik mit Übungen (Fortsetzung), 2 st., nach Übereink.

17.SS 1921: Litauische Grammatik mit Übungen, 2 st., nach Übereink. Që nga ky semestër Shqipëria nuk përmendet më në listën e studentëve sipas prejardhjes.

18.WS 21/22: Finnisch-Ugrisch u. Indogermanisch, 2 st., n. Ü.

19.SS 1922: Einführung i. d. Altkirchenslawische (mit Übungen), 2 st., n. Ü.

20.WS 22/23: Einführung i. d. Altkirchenslawische, Fortsetzung, 2 st., n. Ü.

21.SS 1923: Albanische Grammatik, 2 st., n. Ü.

22.WS 23/24: Albanische Grammatik, Fortsetzung, 2 st., n. Ü.

23.SS 1924: Ausgewählte Kapitel aus der linguistischen Paläoethnologie Mittel- u. Osteuropa, 2 st., n. Ü. Ky semestër sjell disa ndryshime të rëndësishme: E para, Jokl-i mban tani titullin "Profesor pa katedër" (A. P.), ndërsa në Universitet janë themeluar edhe dy Institute të reja, ku do ishte i mundur studimi i shqipes: Instituti i Ballkanologjisë (gjerm. Institut für Balkanologie, në adresën: I,

Liebiggasse 5, kryetar Prof. Patsch) dhe Instituti i Indoevropianistikës (gjerm. Institut für Indogermanistik, I, Universität, me kryetar Porf. Kretschmer).

24.WS 24/25: Sprachwissenschaftliche Einführung in das Tocharische, 2 st., n. Ü., që është anulluar, me sa duket prej tij.

25.SS 1925: Lettische Grammatik, 2 st., n. Ü.

26.WS 25/26: Lettische Grammatik (mit Übungen) II, 2 st., Do. 5-7; Hs. 45 (III. St.), verlegbar.

27.SS 1926: Albanische Grammatik, 2 st., Do. 5-7 (verlegb.); Hs. 47.

28.WS 26/27: Vergleichende albanische Grammatik (mit Übungen) II, 2 st., nach Vereinb,; Orient. Inst.

29.SS 1927: Litauische Grammatik, 2 st., Mi. 5-7 (verlegbar); Orient. Inst.

30.WS 27/28: Vergleichende litauische Grammatik (mit Übungen) II, 2 st., nach Vereinb.; Orient. Inst.

31.SS 1928: Die Slawenwelt im sprachlich-kulturellen Austausch mit den Nachbarn, 2 st., Mi. 5-7 (verlegbar); Orient. Inst.

32.WS 28/29: Vergleichend-historische Grammatik des Albanischen, 2 st., n. Ü.; Orient. Institut.

33.SS 1929: Vergleichend-historische Grammatik des Albanischen II, 2 st., n. Ü.; Orient. Institut.

34.WS 29/30: Finnisch-ugrisch und Indogermanisch, ein Überblick über ihre ältesten Beziehungen, 2st., n. Ü.; Orient. Inst.

35.SS 1930: Einführung in die altpreußischen Sprachdenkmäler, 2 st., n. Ü.; Orient. Inst.

36.WS 30/31: Vergleichend-historische Grammatik des Albanischen (mit Übungen), 2 st., n. Ü.; Orientalisches Institut. Në këtë kohë në Universitetin e Vjenës ka këto institute ku do të mund të studiohej gjuha shqipe: Institut für Balkankunde (I., Liebiggasse 5, Kryetar Prof. Patsch), Indogermanisches Institut (Prof. Kretchmer, I., Universität), Orientalisches Institut (I., Universität, Prof. Kraelitz).

37.SS 1931: Vergleichend-historische Grammatik des Albanischen II, 2 st., n. Ü.; Orient. Inst.

38.WS 31/32: Die Slawenwelt im Spiegel der Lehnbeziehungen, 2 st., Zeit und Ort n. Ü.: oriental. Institut.

39.SS 1932: Die Slawenwelt im Spiegel der Lehnbeziehungen II, 2 st., Zeit und Ort n. Ü.: oriental. Institut.

40.WS 32/33: Einführung in die vergleichend-historische Grammatik des Litauischen, 2 st., n. Ü.: Oriental. Inst.

41.SS 1933: Einführung in die vergleichend-historische Grammatik des Litauischen II, 2 st., n. Ü.: Oriental. Inst.

42.WS 33/34: Vergleichend-historische Grammatik des Albanischen, 2 st., n. Ü.; oriental. Inst.

43.SS 1934: Vergleichend-historische Grammatik des Albanischen, II. Teil, 2 st., n. Ü.; oriental. Inst.

44.WS 34/35: Finnisch- ugrisch und Indogermanisch, 2 st., n. Ü.; orient. Institut.

45.SS 1935: Einführung in die altpreußische Sprachdenkmäler, 2 st., n. Ü.; orient. Institut.

46.WS 35/36: Sie Slawenwelt im Spiegel des Lehnwortschatzes, 2 st., n. Ü.; orient. Institut.

47.SS 1936: Die Slawenvelt im Spiegel… II, 2 st., ebenda.

48.WS 36/37:Einführung in die vergleichend-historische Grammatik des Albanischen, 2 st.,

49.SS 1937:Einführung in die vergleichende historische Grammatik des Albanischen II,2 st.

50.WS 37/38: Einführung in die vergleichend-historische Grammatik des Litauischen, 2 st., FR. 18-20; Hs. 17

51.SS 1938: Einfürhung in die vergleichend-historische Grammatik des Litauischen II, 2 st. Në maj 1938 ai u pushua dhe në qershor nacionalsocialistët e detyruan Jokl-in të dilte në pension.

Në shqip:

1.SS 1913: Në rubrikën "Gjurmime gjuhësore krahasuese dhe filologjia orientale"[42]: Jokl Norbert Priv. Doz. Dr - Lexim i teksteve shqipe të lehta me ushtrime gjuhësore. 2 orë (shtuar me shkrim dore). Pagesa: 4.20 krona.

2.WS 1913/14: Jokl Norbert, Privatdoz. Dr.: Gramatikë krahasuese-historike e shqipes, 2 orë, s. marr. (në fund të rubrikës së lartpërmendur). Jireček Josef Konst., o. ö. Prof. Hofr.[43] Dr.: Shqipëria në mesjetë, 1 orë... Pagesa K. 2.10 në rubrikën "Filologji sllave".

3.SS 1914: Jokl Norbert, Privatdoz. Jur. et Ph. Dr[44].: Hyrje në prusishten e vjetër, 2 orë . K 4, 20

4.WS 1914/15: Gramatikë lituaneze me ushtrime, 2 orë...

5.SS 1915: Gramatikë lituaneze me ushtrime (vazhdim), 2 orë, të shtunën 2-4;

6.WS 1915/16: Gramatikë shqipe me ushtrime, 2 orë., s. marr. K 4.20 (i është hequr viza me dorë dhe është vënë shënimi: anulohet)

7.SS 1916: Jokl Norbert... nuk do të ligjërojë. Në fund, në listën ku shënohet numri i studentëve sipas vendit nga vijnë për semestrin e kaluar, d.m.th. për WS 1915/26, përmendet për herë të parë edhe Shqipëria: 1 (nxënës i rregullt në mjekësi).

8.WS 1916/17: Gramatikë shqipe me ushtrime, 2 orë., s. marr. K 4.20. Në listë: Shqipëria: 1 (student i rregullt në mjekësi) për SS 1916

9.SS 1917: Indoevropianisht dhe fino-ugrisht (duke u përqëndruar sidomos te hungarishtja), 2 orë, s. marr. K 4.20 (është fshirë me dorë plus shënimi: anulohet).

---

[42] Më poshtë nuk do ta përmend titullin e rubrikës që përsëritet çdo semestër.

[43] Ka marrë dhe titullin Hofrat "Këshilltar i Oborrit".

[44] Ky është titulli përfundimtar deri në marrjen e titullit profesor, prandaj më poshtë nuk do të përsëritet.

Sipas listës semestrin e kaluar nuk ka pasur asnjë student shqiptar.

10.WS 1917/18: ndoshta do të njoftojë më vonë. Asnjë student shqiptar për semestrin e kaluar.

11.SS 1918: Elementet sllave të rumanishtes, 2 orë, s. marr. K. 4.20. Lista e studentëve: 2 (studentë të rregullt në mjekësi WS 1917/18). Për SS 1918: 1 (student i rregullt në juridik).

12.WS 1918/19: Gramatikë lituaneze me ushtrime, 2 orë., s. marr. K 4.20. Nuk ka më listë për prejardhjen e studentëve sipas vendeve.

13.SS 1919: Gramatikë letoneze (me ushtrime), 2 orë, s. marr. Në këtë semestër ka një statistikë të studentëve sipas vendlindjes për semestrin e kaluar, WS 18/19. Për Serbinë dhe Shqipërinë: Studentë të rregullt: Juridiku (4), Mjekësia (5); Fakulteti Filozofik (1). Studentë të parregullt: 1 (midis frekuentuesve[45]); 2 (të parregullt te filozofia).

14.WS 19/20: Gramatikë krahasuese-historike e shqipes me ushtrime, 2 orë, s. marr.

Për Serbinë dhe Shqipërinë në SS 19 regjistrohen: 4 (jur.); 5 (mjek.), 2 (te Filozofia), 1 (Med./ Frek.), 3 (te filozofia/të parregullt).

15.SS 1920: Gramatikë krahasuese-historike e shqipes me ushtrime (vazhdim), 2 orë, s. marr.

16.WS 20/21: Gramatikë lituaneze me ushtrime (vazhdim), 2 orë, s. marr.

17.SS 1921: Gramatikë lituaneze me ushtrime, 2 orë, s. marr. Që nga ky semestër Shqipëria nuk përmendet më në listën e studentëve sipas prejardhjes.

18.WS 21/22: Fino-ugrisht dhe indoevropianisht, 2 orë, s. m.

19.SS 1922: Hyrje në sllavishten e vjetër kishtare (me ushtrime), 2 orë, s. m.

20.WS 22/23: Hyrje në sllavishten e vjetër kishtare, vazhdim, 2 orë, s. m.

21.SS 1923: Gramatikë shqipe, 2 orë, s. m.

22.WS 23/24: Gramatikë shqipe, vazhdim, 2 orë, s. m.

23.SS 1924: Kapitull i zgjedhur nga paleoetnologjia gjuhësore e Evropës së Mesme dhe Lindore, 2 orë, s. m. Ky semestër sjell disa ndryshime të rëndësishme: E para, Jokl-i mban tani titullin "Profesor pa katedër" A. P.), ndërsa në Universitet janë themeluar edhe dy institute të reja, ku do ishte i mundur studimi i shqipes: Instituti i Ballkanologjisë[46] (Institut für Balkanologie, Lagjia I, Liebiggasse 5,

[45] Sipas Wahrig 1975: häufiger, regelmäßiger Besucher "vizitor i shpeshtë ose i rregullt".

[46] "Wien mit seiner 1847 gegründeten Akademie der Wissenschaften sowie der Universitäts- und Nationalbibliothek stellte ohne Zweifel den Ausgangspunkt und die traditionell zentrale Forschungsmetropole der Balkanlinguistik dar, äußerlich dokumentiert durch die mehr als hundertjährige Tradition der „Balkanschriften" der Balkan-Kommission. Eng mit Wien verbunden sind für den Balkanologen Namen wie Bartholomäus Kopitar (1780-1844), Franz Miklosisch (1813-1891), Vatroslav Jagić (1823-1923), Konstantin Jireček (1854-1918) und Nikolai Trubetzkoy (1890-1938), die in Wien gewirkt haben und für die Entstehung und Entwicklung der Balkanologie entscheidend waren (Vjena me Akademinë e Shkencave të themeluar më 1847 dhe Bibliotekën Kombëtare e atë të Universitetit paraqiste padyshim fillimin dhe tradicionalisht qendrën kryesore kërkimore të ballkanologjisë, që dokumentohej së jashtmi me traditën mëse njëqindvjeçare të "Shkrimeve për Ballkanin" që nxirte Komisioni Ballkanik. Për ballkanologun janë të lidhur ngu-

kryetar Prof. Patsch) dhe Instituti i Indoevropianistikës (Institut für Indogermanistik, Lagjia I, Universität, me kryetar Prof. Kretschmer).

24.WS 24/25: Hyrje në gjuhësinë e tokarishtes, 2 orë, s. m., që është anuluar, me sa duket prej tij për mungesë studentësh, meqë nuk ofrohet më.

25.SS 1925: Gramatikë letoneze, 2 orë, s. m.

26.WS 25/26: Gramatikë letoneze (me ushtrime) II, 2 orë, të enjten 5-7; Auditori 45 (Shkalla III), orar i ndryshueshëm.

27.SS 1926: Gramatikë shqipe, 2 orë, të enjten 5-7 (e ndryshueshme); Auditori 47.

28.WS 26/27: Gramatikë shqipe e krahasuar (me ushtrime) II, 2 orë, s. marr; Inst. Orient.

29.SS 1927: Gramatikë lituaneze, 2 orë, të mërkurën nga 5-7 (e ndryshueshme); Inst. Orient.

30.WS 27/28: Gramatikë e krahasuar e lituanishtes (me ushtrime) II, 2 orë, s. marr.; Inst. Orient.

31.SS 1928: Bota sllave gjatë shkëmbimeve gjuhësore-kulturore me fqinjët, 2 orë, të mërkurën nga 5-7 (e ndryshueshme); Inst. Orient.

32.WS 28/29: Gramatikë krahasuese-historike e shqipes, 2 orë, s. m.; Institut. Orient.

33.SS 1929: Gramatikë krahasuese-historike e shqipes II, 2 orë, s. m.; Institut. Orient.

34.WS 29/30: Fino-ugrishtja dhe indoevropianishtja, një pamje e përgjithshme e lidhjeve të tyre më të vjetra, 2orë, s. m.; Inst. Orient.

35.SS 1930: Hyrje në monumentet gjuhësore të prusishtes së vjetër, 2 orë, s. m.; Inst. Orient.

36.WS 30/31: Gramatikë krahasuese-historike e shqipes (me ushtrime), 2 orë, s. m.; Instituti Oriental. Në këtë kohë në Universitetin e Vjenës ka këto institute ku do të mund të studiohej gjuha shqipe: Institut für Balkankunde (I., Liebiggasse 5, Kryetar Prof. Patsch), Indogermanisches Institut (Prof. Kretchmer, I., Universität), Orientalisches Institut (I., Universität, Prof. Kraelitz).

37.SS 1931: Gramatikë krahasuese-historike e shqipes II, 2 orë, s. m.; Inst. Orient.

38.WS 31/32: Bota sllave nga këndvështrimi i marrëdhënieve huazuese, 2 orë, ora dhe vendi s. m.: Institut. oriental.

39.SS 1932: Bota sllave nga këndvështrimi i marrëdhënieve huazuese II, 2 orë, koha dhe vendi s. m.: Institut. oriental.

40.WS 32/33: Hyrje në gramatikën krahasuese-historike të lituanishtes, 2 orë, s. m.: Inst. Oriental.

---

shtë me Vjenën emra si Bartholomäus Kopitar (1780-1844), Franz Miklosisch (1813-1891), Vatroslav Jagić (1823-1923), Konstantin Jireček (1854-1918) e Nikolai Trubetzkoy (1890-1938), të cilët kanë punuar në Vjenë e kanë lozur një rol të dorës së parë për lindjen e zhvillimin e ballkanologjisë (Kahl & alii 2012: 2-3).

41.SS 1933: Hyrje në gramatikën krahasuese-historike të lituanishtes II, 2 orë, s. m.: Inst. Oriental.

42.WS 33/34: Gramatikë krahasuese-historike e shqipes, 2 orë, s. m.; Inst. oriental.

43.SS 1934: Gramatikë krahasuese-historike e shqipes, Pjesa II, 2 orë, s. m.; Inst. Oriental.

44.WS 34/35: Fino-ugrishtja dhe indoevropianishtja, 2 orë, s. m.; Institut. Orient.[47]

45.SS 1935: Hyrje në monumentet gjuhësore të prusishtes së vjetër, 2 orë, s. m.; Institut. Orient.

46.WS 35/36: Bota sllave nga këndvështrimi i marrëdhënieve huazuese, 2 orë, s. m.; Institut. Orient.[48]

47.SS 1936: Bota sllave nga këndvështrimi… II, 2 orë, po aty.

48.WS 36/37: Gramatikë krahasuese-historike e shqipes, 2 orë,

49.SS 1937: Hyrje në gramatikën krahasuese-historike të shqipes II, 2 orë.[49]

50.WS 37/38: Hyrje në gramatikën krahasuese-historike të litaunishtes, 2 orë, të premten nga 18-20; Aud. 17.

51.SS 1938: Hyrje në gramatikë krahasuese-historike të litaunishtes II, 2 orë. Në maj 1938 Jokl-in u pushua nga puna dhe në qershor nacionalsocialistët e detyruan të dilte në pension.

Yvon (2013: 2) thotë se Jokl-i ka botuar 67 punime shkencore dhe ka mbajtur 42 leksione për të cilat është nderuar me shumë çmime. Në fakt, siç del nga katalogët e leksioneve, ai ka referuar 48 herë. Disa nga leksionet përsëriten, por ndoshta të ndryshuar a të plotësuar.

Por Jokl-i nuk ishte i pari që tregonte interes për shqipen. Shumë vite para tij, një tjetër gjuhëtar i kishte hyrë kësaj rruge që në vitet '80 të shekullit XIX, në një kohë kur interesi per gramatikën e krahasuar të gjuhëve indoevropiane kishte arritur kulmin. Ky ishte polaku Jan Hanusz. Pfeiffer (2001: 62-63) citon autobiografinë e tij (në origj. Vita) nga dosja e zyrës së kuadrit që gjendet në Arkivin e Universitetit:

Kam lindur më 13 korrik 1858 në fshatin Kołodziejówka pranë qytetit Stani-

[47] Në këtë kohë drejtor i Institutit të Ballkanologjisë është prof. Trubetzkoy.

[48] Për një krahasim po përmendim se në këtë semester lektorja e rumanishtes, dr. Alice Scarlates, mban 2 kurse, gjithsej 4 orë. Për serbo-kroatishten ofrohen gjithashtu dy kurse: njëri për fillestarë dhe tjetri për të përparuar. Ka kurse edhe për japonishten, të cilat vijnë duke u shtuar në vitet e ardhshme, çka duhet të lidhet me koniunkturën politike në prag dhe gjatë luftës. Mësimdhënia e këtyre gjuhëve vazhdon në vitet e ardhshme pa ndërprerje.

[49] Kjo duhet të jetë kohë kur në skenë shfaqen nxënësit e ardhshëm të Jokl-it: E. Çabej, G. Solta dhe V. Georgiev. Që kishte një numër studentësh të interesuar e tregon fakti që leksioni afishohet me një orar fiks: Fr. 18-20, Hs. 17 (të premten prej orës 18.00-20.00 në sallën 17).

sławów (gjerm. Stanislau)[50] në Galici, ku mora dhe mësimet e para. Pas kësaj ndoqa gjimnazin në Stanisławów ku mbarova "Shkëlqyeshëm" maturën në vitin 1877. Menjëherë pas kësaj shërbeva si vullnetar për një vit pranë regjimentit XIII p.m. të këmbësorisë dhe më 1 nëntor 1878 u gradova toger në rezervë. Njëkohësisht u regjistrova në Universitetin p. m. të Krakovit ku studiova tetë semestra (1877-81) në Fakultetin e Filozofisë. Iu kushtova veçanërisht shkencave filologjike dhe ndoqa ligjëratat e profesorëve Brandowski, Bratranek, Iskrzycki, Malinowski, Morawski, Straszewski, Szujski, u. Tarnowski. Pastaj shkova si bursist i qeverisë së nderuar të landit të Galicisë në Lajpcig, ku studiova tre semestra në Universitet dhe mora titullin "Doktor i Filozofisë". Studimin e sanskritishtes dhe gramatikës së krahasuar të gjuhëve indoevropiane, të cilin kisha pasur fatin ta realizoj te profesorët Brugmann, Curtius, Leskien, Windisch, e vazhdova në Universitetin e Berlinit, ku studiova dhe një semestër si student i rregullt i Fakultetit të Filozofisë te profesorët Oldenberg, Joh. Schmidt dhe A. Weber.- Në vjeshtën e vitit 1883, pas kthimit në Krakov, dhashë me sukses provimin shtetëror në latinisht, greqisht dhe polonisht para Komisionit p. m. të provimeve për kandidatët e mësuesisë në gjimnaz dhe u aprovova si kandidat mësuesie për gjimnazet. - Pas kësaj u emërova anëtar i Komisionit të Gjuhësisë të Akademisë së Shkencave në Krakov.- Në semestrin e verës të vitit 1884 erdha në Vjenë, ku ndoqa disa nga leksionet e profesorëve G. Bühler, v. Miklosich dhe Fr. Müller. Deri më tash kam hartuar mjaft punime për filologjinë klasike dhe atë sllave, si dhe për gramatikën e krahasuar të gjuhëve indoevropiane, që kanë dalë kryesisht në serinë e botimeve të Akademisë p. m. të Shkencave të Krakovit dhe në "Archiv für slavische Philologie" (Berlin).[51]

Në Berlin kam punuar për dorëshkrimet në prākrit të një teksti xhaina[52], të cilin dëshiroj ta botoj. Përveç këtyre në Krakov kam mbledhur shumë material për fjalorin e polonishtes së vjetër, botimi i të cilit po përgatitet nga Akademia e atjeshme e Shkencave. Po kështu kam përgatitur së bashku me profesorin Bobrzyński botimin e shumë dokumentave të polonishtes së vjetër.

Wien, më 19 shtator 1884 Dr. Joh. Hanusz

Për të parë se çfarë ofronte një profesor i gjuhësisë së përgjithshme dhe indoevropiane (gjerm. Allgemeine und indogermanische Sprachwissenschaft) në këtë kohë po japim dhe programin e leksioneve që synonte të mbante në fillim, të cilin ia ka bashkangjitur autobiografisë së tij (Pfeiffer 2001: 63-64):

1.) Gramatikë elementare e gjuhës sanskrite sipas manualit të prof. Bühler. Sipas rastit dua t'i drejtohem për krahasim edhe greqishtes, sllavishtes dhe

[50] Ky qytet quhet sot Ivano-Frankivsk dhe ndodhet në Ukrainë.

[51] Pfeiffer (2012:63) shënon që në këtë vend të autobiografisë pason një listë e botimeve me 14 tituj dhe disa të dhëna për artikujt më të vegjël, por listën vetë nuk e jep.

[52] Xhainizmi është një prej feve të përhapura në Indi.

gotishtes. Pas kësaj do të dëshiroja të kaloja në leximin e teksteve të lehta në sanskritisht.

2.) Hyrje në Rig-veda. Një vështrim i përgjithshëm i letërsisë vedike me shënimet përkatëse historike-letrare, më pas gjërat më të rëndësishme për gjuhën dhe metrikën e vedave, në fund shpjegim i disa hymneve të zgjedhura të Rigvedës.

3.) Gramatikë e krahasuar e gjuhëve indoevropiane. Në trajtimin e fonetikës dhe gramatikës dua t'i përfshij të gjitha grupet gjuhësore indoevropiane përnjëherë; pra nuk dua të ofroj një gramatikë paralelesh, por një gramatikë të vërtetë krahasuese. Për krahasim nuk duhet të merren vetëm përfaqësueset më të vjetra të gjuhëve indoevropiane, por atje ku është e nevojshme, edhe dialektet indoevropiane moderne.

Siç duket, synimi për t'u marrë me studimin e shqipes erdhi si pasojë e këtij qëndrimi të dr. Hanusz se në krahasim duhet të përfshihen edhe dialekte të tjera indoevropiane dhe jo vetëm ato më të vjetrat.

4.) Gramatikë e lituanishtes. Në sqarimin e formave gjuhësore të veçanta do të marr parasysh jo vetëm letishten dhe prusishten e vjetër, por edhe sllavishten, sanskritishten dhe, po të jetë e nevojshme, edhe gjuhë te tjera indoevropiane. Por meqë ky leksion ka si qëllim edhe mësimin praktik të lituanishtes, më vonë do të kaloj në leximin e teksteve në lituanisht.

5.) Gramatikë e krahasuar e gjuhëve greke dhe latine. Do të jetë fjala në radhë të parë për raportin e të folmeve jonike-atike me ato latine, por po të jetë e nevojshme, do të merren parasysh edhe dialekte të tjera greke dhe italiane, si dhe sanskritishtja e disa gjuhë të tjera indogjermane.

6.) Skicë e historisë së letërsisë indiane. Një vështrim i shkurtër i letërsisë vedike dhe asaj klasike në sanskritisht, si dhe diçka për tekstet Pāli dhe Xhaina.

Vjenë, më 29 shtator 1884 Dr. Joh. Hanusz (Pfeiffer 2001: 63-64).

Në raportin e Komisionit të docenturës, që gjendet po aty, gjejmë këtë vlerësim për veprën e Hanusz-it: "Sa i përket studimit *Ueber das allmälige Umsichgreifen der n-Declination im Altindischen* (Mbi përhapjen shkallë-shkallë të lakimit me n- në indishten e vjetër), që është hartuar posaçërisht për marrjen e docenturës, mund të thuhet sipas vlerësimit të të dy specialistëve, prof. Bühler dhe F. Müller, se dëshmon njohuri të thella dhe një njohje të admirueshme të letërsisë vedike. Përveç kësaj është shkruar qartë dhe në mënyrë të kuptueshme: ato që mund të cilësohen si mangësi, nuk kanë të bëjnë me hartuesin, por me atë drejtim (të ashtuquajturën Shkollë të Gramatikanëve të Rinj[53]), me të cilën ai është njohur në Lajpcig

[53] E njohur ndryshe dhe si "Shkolla e Lajpcigut" (gjerm. Leipziger Schule). Në vitet '70 të shek. XIX në Lajpcig u krijua një grup gjuhëtarësh, të cilët fillimisht u cilësuan me ironi si "Gramatikanët e Rinj" nga gjenerata më e vjetër, që i konsideronte pa përvojë dhe radikalë. Ata u morën kryesisht

nëpërmjet mësueve të tij" (Pfeiffer 2001: 64-65).

Shihet këtu mosbesimi që shfaqet në fillim në Universitetin e Vjenës ndaj njërës prej rrymave më të suksesshme të gjuhësisë së krahasuar dhe përfaqësuesve të saj. Njëkohësisht duket qartë që në krahasim me kolegët e tij Hanusz ishte kandidati më i plotësuar në formimin e tij për këtë fushë studimesh. Të gjitha këto të dhëna dëshmojnë se ekzistonin premisat për një karrierë të shkëlqyer të docentit të ri, por një letër e rektorit që i drejtohet më 2 gusht 1887 dekanit të Fakultetit Filozofik njofton se dr. Johann Hanusz ka vdekur në Paris më 26 korrik (Aktet e Senatit, Z. 2246 ex 1886/7. Pfeiffer 2001: 65)

Po aty Pfeiffer sjell edhe atë pjesë të biografisë së Hanusz-it të hartuar nga M. Karaš dhe të botuar në Polski Słownik Biograficny IX, Wrocław et alii. 1960-61, 284-285, ku përshkruhet ajo pjesë e jetës së Hanusz-it pas mbrojtjes së docenturës deri në vdekjen e tij. Këtu bëhet fjalë edhe për studimet e tij për shqipen: "...prej semestrit të verës të vitit 1885 dha sanskritisht, lituanisht, keltisht dhe gramatikë të krahasuar në Universitetin e Vjenës. Por ai interesohej edhe për armenishten, prandaj në shtator të të njëjtit vit drejtoi një ekspeditë studimore për këtë gjuhë në Kuty. Në verë të vitit 1886 studioi dialektet çajkave në të ashtuquajturin bregdet kroat. Për shkak të sukseseve të rëndësishme shkencore ai mori në vitin 1887 bursën shkencore Sniadecki të Akademisë së Shkencave (prej Fondacionit Galezowski) dhe u nis për një udhëtim në Itali, Francë dhe Angli për të hulumtuar shqipen dhe keltishten. Në Itali u mor sidomos me dialektet e vendbanimeve shqiptare, greke dhe sllave. Pas kësaj u nis për Paris, ku vdiq më 26 korrik 1887 nga tifoja. Vdekja e papritur e pengoi atë të merrte drejtimin e katedrës së sanskritishtes dhe gramatikës së krahasuar në Universitetin Jagielloński. Spektri i gjerë i interesave të tij shkencore përfshinte fusha të ndryshme të gjuhësisë indoevropiane, prej filologjisë në kuptimin e ngushtë deri te hulumtimi i dialekteve dhe ekspeditat në terren. Edhe çështjet teorike nuk i linte mënjanë... " (Sipas Pfeiffer 2001: 60-61).

Me vdekjen tragjike të Hanusz-it mori rrugë dhe historia e pafat e

---

me studimin e historisë së gjuhëve indoevropiane dhe arritën rezultate të shquara në këtë drejtim duke u bazuar sidomos në postulatin e veprimit absolut dhe pa përjashtime të ligjeve fonetike.

albanologjisë në Universitetin e Vjenës sipas asaj fjalës së urtë "Peri i hollë, këputet". Lënia pas dore e shqipes dhe orientimi drejt keltologjisë u bë edhe në përputhje me kushtet e reja politike që u krijuan në Evropë. Keltologjia ofronte më shumë mundësi bashkëpunimi e komunikimi, njohjeje e karriere, si dhe përfitimi material e dëfrimi për ata që merreshin me të. Ndërsa Shqipëria ishte fshirë pothuajse fare nga harta e Evropës dhe angazhimi për studimin e gjuhës shqipe nuk mund t'u sillte studiuesve ato përfitime që u sillte p. sh. studimi i keltishtes.

Burime

Archiv der Universität Wien (AUW): *Vorlesungsverzeichnisse* 1894-1900; 1907-1965; *Rigorosen des Georg Pekmesović* (Nr. 1382); *Personalakte Rotta*; *Rigorosenakt Treimer* (Nr. 3895); *Philosophischer Akt Treimer* (Nr. 3469).

Bibliografi

Erlach, Daniela. 1988. *Die Orientalische Akademie in Wien*. Diplomarbeit an der Geisteswissenschaftlichen Fakultät vorgelegt von Daniela Erlach. Wien, im Mai 1988. (*Akademia Orientale në Vjenë*. Punë diplome e paraqitur në Fakultetin e Shkencave Shoqërore nga Daniela Erlach. Vjenë, maj 1988).

Franz Manek, G. Pekmezi & A. Stotz. 1909. *Albanesische Bibliographie*. Bibliografija shqipe. Wien. Verlag "Dija".

Jokl, Norbert. 1984. *Sprachliche Beiträge zur Paläo-ethnologie der Balkanhalbinsel (Zur Frage der ältesten Griechisch-albanischen Beziehungen)*. Aus dem Nachlass herausgegeben von Oskar E. Pfeiffer [*Ndihmesa gjuhësore për paleoetnologjinë e Gadishullit Ballkanik (Mbi çështjen e marrëdhënieve greko-shqiptare më të hershme)*. Nxjerrë nga fondi i pabotuar dhe përgatitur për botim nga Oskar E. Pfeiffer . Vjenë. Verlag der Österreichischen Akademie der Wissenschaften.

Kahl, T., Metzeltin, M. & Schaller H. (Hg.). 2012. *Balkanismen heute-Balkanisms Today – БАЛКАНИЗМЫ СЕГОДНЯ*. LIT Verlag. Berlin/ Wien. S. 275 - 299.

Logoreci, Pjetër. 2011. *Kolë Rrota. Zbulohet jeta e panjohur në Vjenë e patriotit shqiptar*. Në "Gazeta Shqiptare", e hënë 17 tetor 2011. F. 21.

Maximilian Lambertz & Georg Pekmezi. 1913. *Lehr- und Lesebuch des Albanischen* (*Metodë dhe libër leximi i shqipes*). Wien-Leipzig. A. Hartleben (=Die Kunst der Polyglottie).

Pekmezi. G., Mossi Hil & Manek, Franz. 1913. *Sprachführer zur schnellen Erlernung der albanischen Sprache* (*Guidë gjuhësore për mësimin e shpejtë të gjuhës shqipe*). Wien. St. Norbertus- Verlag.

Pfeiffer, Oskar E. 1996 [2001ë . *75 Jahre Institut für Sprachwissenschaft der Universität Wien – und wie es dazu kam* (*75 vjet jetë e Institutit të Gjuhësisë të Universitetit të Vjenës dhe si u themelua ai*). Në: Die Sprache. Zeitschrift für Sprachwissenschaft. Band 38. Heft 3 (Sonderheft). Chronicalia Indoeuropaea 38. Wiener Sprachgesellschaft. Harrassowitz Verlag. S. 3-70.

Pfeiffer, Oskar E. 1997 [2002ë . *Die Früh- und Vorgeschichte der Sprachwissenschaft in Wien - Fakten und Akten zu Anton Boller und seiner Umgebung* (*Historia e gjuhësisë*

së hershme dhe pararendëse në Vjenë – Fakte dhe akte për Anton Boller dhe për situatën rreth tij). Në: Die Sprache. Zeitschrift für Sprachwissenschaft. Band 39. Heft 3 (Sonderheft). Chronicalia Indoeuropaea 39. Wiener Sprachgesellschaft. Harrassowitz Verlag. S. 25-78.

Schmidt-Neke, Michael. 2005. *Mit Skipetaren sprechen - Sprachführer für das Albanische bis 1945* (*Të flasësh me shqiptarët – guida gjuhësore për shqipen deri më 1945*). In: Genesin, Monica & Matzinger, Joachim. Albanologische und balkanologische Studien. Festschrift für Wilfried Fiedler. Hamburg. Verlag Dr. Kovač. S. 139-149.

Solta, Georg R. 1984. Vorwort (Parathënie). Në: Jokl, Norbert. 1984. *Sprachliche Beiträge zur Paläo-ethnologie der Balkanhalbinsel* (shih më lart te Jokl).

Yvon, Mechthild: *Das Schicksal des Albanologen Norbert Jokl und seiner Bibliothek* (Fati i albanologut Norbert Jokl dhe bibliotekës së tij), 15., URL: web.archive.org/web/20070221211230/http://www.stadtbibliothek.wien.at/sammlungen/digital/yvon-mechthild-schicksal.pdf [Stand: 16.11.2013].

Mehmet Halimi, Prishtinë

MBI DISA TOGJE BASHKËTINGËLLORESH NË TË FOLMEN E KARADAKUT

KDU 811. 18' 282.3

Në të folmen e Karadakut ndeshim një varg togjesh bashkëtingëlloresh, që e karakterizojnë këtë si një e folme e veçantë. Këtu do të bëjmë fjalë për të gjitha grupet e mundshme bashkëtingëllore, ruajtjen e tyre dhe ndërrimet, evolucionin e tyre deri në ditët e sotme. Te këto togje bashkëtingëlloresh paraqiten laramani të ndryshme, sepse ndodh që nga i njëjti subjekt të ketë lëkundje shqiptimi. Mirëpo, megjithë lëkundjet, mund të nxirren rregulla të përgjithshme e të veçanta, që këtë të folme e bëjnë specifike. Togjet që i ndeshim në këtë të folme janë: *tj, dj, mb, nd, nt, ng, nk, ngj,fsh, shq, shk, shkr, tsh, ts, bn, vn, bz, gz, vc, nx,* etj., për të cilat këtu më poshtë do të sjellim shembuj se kur përdoren dhe ç'pozita zënë në fjalë.

Togjet tj, dj. –

Në të folmen e Karadakut paraqitet laramani e madhe në shqiptimin e tyre. Këtu ka lëkundje nga fshati në fshat, nga lagjja në lagje, ndeshim luhatje edhe tek i njëjti subjekt shqipfolës, i cili në ligjërimin e vet përdor të dy trajtat, herë njërën, herë tjetrën. Prandaj, mund të themi se në këtë të folme bashkëjetojnë të dy variantet e togjeve *tj, dj* dhe shkrirjen e tyre në *ç, xh (*ć, ǵ). Madje, kjo sipas llogarive të mia statistikore përdoret 70% në favor të kalimit *tj, dj* në qiellzoret paragjuhore, e vetëm 30% të rasteve, këto togje konsonantike ruhen. Këtë konstatim e kam nxjerrë nga shembujt konkretë, nga subjekte të fshatrave të ndryshme anembanë Karadakut.

Togu *tj.* - Dëgjohet si i këtillë, por më shpesh e ndeshim të asimiluar në *Ç* (Ć), për shembull: I njëjti subjekt (Sarë Ballabani) nga Stublla e Epërme përdorte: // Soll ǵak i shtike n'at *ćetren* so:b // Edhe n'at *tjetrën* so:b // Kur i ćuen *atje* i majtën tri vjet // Dom Mikeli na i pruni do germa *tjera* pej Vjene // Përfshini edhe ćera maha:ll // etj.

Zhegër: Il Na martomi me ćera maha:ll / me ćera fise // Godeni ći ã atje // Kjo ćetra ćetu shkon për Llashti:c // T'rejat kan pa:s ćeter ve:sh // t're-jat lidhshin tjera //atje pare duhet me pre: // ćika del n'ćeter meteh / del aće // Vi:n kta tjert // Mreti e muer e ćoj atje // (nga Demush Haziri); *Depcë: //* Tani e ka ble ćetrin harć //.

Togu *dj* – **P**ërdoret **paralelisht me tj.** Edhe në shqiptimin e këtij togu ndeshim të njëjtën dukuri që e vumë në spikamë më parë.

Stubëll e Epërme·. // Pa e lujt kamen e djatht // Malići me dy < djëm // E kam ni xa:l // (Shih edhe toponimin: Arat e shpi:s ǵegme //

Zhegër: // Msit bahet akrabaja i ćikes ose i *y*alit // ǵali i folun // Nish-ki t'the:rr n't'xatht / E ǵët xali i ćetrit mrët // A e mërr ti djalin tem // ćika edhe djali // Tahiri a ko:n me katër djëm // Miǵo zgidhe njanin ǵa:l pi katër xemve // Zgidhe njanin dja:l cillin du:sh // Edhe Kosumit kur ju ǵëg shpija / nana n'tã ju ka dje:g // Edhe Idriz Seferit ja kan pa' ǵe:g shpijen //

Grupin *tj* nuk e ndeshim të asimiluar te shembujt *tjerr-i, mushtje:rr, shtjerra.* Nuk është asimiluar as në pershendetjen *Jungjatjeta,* kurse në ndajfoljen *matuče* për *më* tutje asimilohet.

Si përfundim mund të konstatojmë se paralel me trajtat e kryeher-shme: *atje, tjetër, djalë, djãth, djep, djegë,* ndeshim të përdoren edhe trajtat e qiellzorizuara: *ače, ćeter,* ǵ*a:l,* ǵ*ãth,* ǵ*ëp,* ǵ*e:g,* etj., por edhe *gial, giãth* e *gjieg, dieg* e *giep, djëp,* ǵ*ëp* e *k*ʲ*ert, ak*ʲ*e* e *tjerr, tierr* **e k**ⁱ**err, etj.**

Sipas mendimit tim fenomeni i qiellzorizimit ka filluar në fillim të shekullit XX, sepse te shqipfolësit e moshuar ende ruhen togjet *tj, dj,* ndër-sa te të rinjtë ato shumë rrallë përdoren. Fshatrat që bëjnë pjesë në komu-nën e Preshevës e Bujanocit[1]; ruajnë dy çiftet e guturaleve, kurse fshatrat e Karadakut jugperëndimor, që gravitojnë në drejtim të Moravës së Epërme kanë përfunduar në një çift guturalesh, vetëm në afrikatet *ć,* ǵ *(ç,* xh).

Togjet *mb, nd, nt.* - Në të folmen e Karadakut në të shumtën é raste-ve, me përjashtime të rralla të atykëtushme, këto togje nuk ruhen. Para se të japim konstatime përmbledhëse, po marrim në shqyrtim veç e veç secilin prej këtyre togjesh bashkëtingëlloresh.

[1] I. Ajeti, Rreth disa tipareve gjuhësore të ligjërimeve shqiptare të Kosovës, në Gjurmime albano-logjike, nr. 1, 1969, f. 161.

Togu *mb.* - Në të folmen tonë ky tog është reduktuar në elementin e parë, në m, kurse elementi i dytë nuk shqiptohet fare, vetëm në ndonjë rast përjashtues. Kështu pra, ndeshim Fjalët vetëm me elementin e parë, si: *mret, mas, shemell, ka:m, i mra:m, me maru:, përmi, me mrri, thum, me bumllu, kumlla*, etj. Togu *mb* nuk ruhet as në fjalët kompozitore, si për shembull: *tremdhe:t, pesmdhe:t, ɣashmdhe:t, kamkryć, permas, mazdore* (lloj buke), etj.

Thjeshtimin e togut *mb* në *m* e dëshmojnë edhe shembujt që do të sjellim më poshtë të shënuar në kontekst të fjalëve në fjali: // Halla Li:z ka ardh pej Turkie ɣashmdhe:t vjet // Tremdhe:t ka shkue // a ɣashmdhet:t ka ardh // Masanena / kamkryć // Jan mle:dh burrat n'Prizren // (Stublla Epërme). // Shemell i çuditshum // E kom pri:t sahatin e mra:m // Pa e lujt kamen e diatht // Plěć mi dy fije gajtan // Simas takatit // bo:j pembe // Ktynihěr krejt hecshin kam // (Zhegër) // Me marue ćylym e jăn // Kur ka mrrĭ ushtria turke // (Stançiq) // Bani dua mretit // (Lubishtë) // Kumlla pozhege // kumlla t'bardha // Ku bumllon toka // Thumat i rreh me çekiq / se s'ka de:r nry // sh // (Stubëll e Poshtme).

Te fjalët *pram* (nga mbramë, mbrëmë), *me hu:p, i hupt, hupca,* m'u pru:jt etj., më parë ka rënë *m*-ja, si element i parë i këtij togu, kurse *b*-ja është shurdhuar në bilabialen e shurdhët p, do të thotë në korresponduesen e saj të shurdhët *b=p: pram* (nga mbramë), *djeprãma, nesërprama, me hup* (me humb), *i hupt* (i humbur) dhe *hupca* (nga humbësa<hupsa<hupca) me kalimin e *s*-së në *c, prujt* (nga mbrojtje).

Togu *nd.* - Nuk ruhet i plote në tërë trevën gjuhësore të Karadakut, por në anën verilindore të saj, kryesisht në fshatrat që gravitojnë në komunat e Preshevës e të Bujanocit, do të thotë në fqinjësi me të folmen e Moravicës. Ndërkaq në pjesën jugperëndimore të Karadakut, që gjendet në fqinjësi me të folmen e Moravës së Epër, togu *nd* nuk shqiptohet i plote. Ai është reduktuar apo është shkrirë, në fillim në një *nn* të dyfishuar (geminate), e pastaj në një n <= eksplozive vazhduese, veçanërisht hetohet ndër pjesëtarët e besimit katolik derisa ka përfunduar në *n* të thjeshtë. Me përjashtim të fjalëve: *kundak, koma:nd, komandant, kumandir*, por përballë tyre rrallë e tek mund të dëgjojmë dhe trajtat pa *d: komanant-i, kumanir-i*, etj.

Për ta konkretizuar pohimin tonë, këtu më poshtë po sjellim shembuj

të nxjerr nga konteksti bisedor i ligjërimit të natyrshëm e spontan, ku mund të pasqyrohen më besnikërisht trajtat autentike të përdorura nga shqipfolësit e fshatrave të ndryshme të Karadakut:

//N'at vaktin to:n u mbledhshin gra:t krejt shka kishin mènden me ardhen // ćiken e ungjshin n'sandali / e ja ngjitshin kanen ndersy grave // (Bërçec);

// N'shpatza i shpojshim birat / me at guxhmen ja nojshe ndyten bir // Shti zhegren p'i ja non knena // Gjyna^{h} ã me ja nu: zhegren e hekrit // Nusja ja ka dha:n ni minil // (Gosponicë) // Rrin mrenda // Kur t'vi:n dhandri ja msho:jn do grushta shpindes // (Bilnicë) // Nandhe:t ve:t jan vra: n'Lubi:sht // I kom nie pleć t'u thanën // (Stublla Epërme); // Me santraç ja dhenmi thunrat / edhe ja maroj si kuner // (Stublla Poshtme); Nuk kena mu:jt kurrćysh me kapërcy: nryshi // Kur ka hĩ turki / Çuŋurit ja nrru:n emnin Ali // S'ka nej n'Përzeren // (S. Epërme).

Pra, në përdorimin e togut ND ĸemi dy variante: varianti i parë, ku ruhet nd-ja; *menden, sandali, ndërsy:, ndre:ç, dhandër, drandafill, tande, mrenda, shpinda, ndrrue, mundash, ndi^{h}ma$_{9}$* etj., përballë trajtave, ku nuk ruhet *nd-ja, si: anena, knena, minil, kinla, huna, nrysh, sanak, nandhe:t, nie, thuner, kuner, venos e vnu, e nalume, katun, ćinrue, munsi, mnash, knoj, nre;ç, shnët, dhanër etj.*

Shënim. Është interesant të përmendim se në këtë të folme kemi ndeshur trajtat *me nue* dhe *me ndue*, që janë tipike për të folmen e Rrafshit të Dukagjinit dhe të Moravës së Poshtme (Përlepnicë).

Togu *nt.* - Nuk ruhet në të folmen e Karadakut. Atë e gjejmë të reduktuar në *t,* si: *dhẽt, mẽt, ćẽt, ćobãt, Te Shurdhãt, i smüt, i shperdhĩt.* Edhe mẽt po hupin // (Stançiq) // Dalshin ćobãt //.

Togu *ng.* - Shqiptohet me një artikulím të veçantë, duke dhënë një tingull krejtësisht të ri, që i mungon alfabetit të shqipes, ku kufiri ndërmjet *n-ë*s dhe g-ës është vështirë të dallohet, por që të dyja këto përbëjnë një fonemë në vete. Këtu kemi të bëjmë me një shkrirje të mirëfilltë të togut *ng* në një tingull të veçantë, që e kemi shënuar me shenjën grafike ŋ. Pra, në vend të trajtave: *Çunguri, hingllon, Ngillan, nguc, hanger, ngusht, mengez, ngarkojn, ngatrresë, ngat, cung, gu:ng, malluing, thingij, peng, penge:s apang, rang, lang, mang, cingáre, ngul, pingul, pingalë* etj. dëgjohen

format fonetike *ŋ: Çuŋuri, Hiŋllon, ŋillɑŋ, ŋuc, haŋer, ŋusht, meŋez, ŋarkojn, ŋatrres, ŋat, cuŋ, guŋ, malluŋ, shlluŋ, thiŋij, peŋ, peŋes, apaŋ, raŋ, laŋ, maŋ, ciŋare, ŋul, piŋul, piŋale*, etj. Këtu, në këtë hulli, bëjnë pjesë edhe këto fjalë: *i ŋurt, me ŋurrue, i ŋurravt, // ŋe:l, ŋɑllu;, ŋalli:c, ŋɑllmu:, me ŋujue, çepeŋe, ŋae, (ŋajali), buŋ, ŋihem, ŋordh, shtaŋ, shtruŋ, deŋ, praŋa, ziŋin, kuŋi, kuŋullu:r, caŋull, draŋue,* etj.

Togu *nk.* – Ky tog që ndeshim në gjuhën letrare dhe në disa të folme, si: *qenka, lënka,* e në disa të tjera *konka,* në të folmen e Karadakut nuk ruhet, por thjeshtësohet në *k*, p.sh: *koka //* Nuk i kish pas besue se koka k:on si dhã^{o}ns i shyptarit // lãka, i thoka Llukit kusherina e tina // Gjergj Kastrioti thoke i kish pas dy bira nersjetlla sa bira gjylpanes // // (S. Epërme), Jolja Prëkit, etj., që kanë fizionominë e habitores, *thojka, thojke dhe kɑ̃jkatar* (nga kangatar < kankatar < kajkatar), *banka, tenka*, ku dëgjohet një *n* e rrëgjuar. Do theksuar që sipas E. Çabejt grupet e vjetra *nt, nk* me kohë janë reduktuar në shqipet

Ndërsa fjalët *ngutu, ngadalë*, elementi i parë *n* bie krejtësisht, nuk shqiptohet fare, po ndeshim trajtat: *gutu, kadale, kadalëz, kadaldale, m'u kadalue* etj. Madje te fjala *kadale* kemi të bëjmë me shurdhimin e g-ës në *k.*

Do theksuar që sipas E. Çabejt grupet e vjetra nt, nk me kohë në shqipet dhanë nd, ng dhe nd intervokalike e lashtë pavarësisht nga theksi, nëpërmjet të një trajte – un- ka dhënë – n[2].

Togu *ngj.* - Në këtë të folme ruhet në të tri pozicionet e fjalës: në ballë të fjalës, në mes dhe në fund, si: *ngja:ll, ngji:t, ngjeti, ngje:sh, inxhe, dengji, penxhere, tenxhere, shingjergj, zingjir, frengji, kingj, pengj* etj. // Ja nxesim ni emen tjetër // Ishin unx́ kamkryć // Ishin ko:n ćaty unxun // Jelekit i nxitshin sumilla // I nxyjshim bo:j pembe // Kshnellat t'nxallnit e shelbusit t'botës // Enxi Zefit / Luzi Enxit //.

Ky tog bashkëtingëllor ka shtrirje gjeograflke edhe në shumë të folme të tjera dialektore, siç janë të folmet fqinje: E folmja e Moravës së Epërme[3]. E folmja e Moravës së Poshtme[4], E folmja e Kabashit të Priz-

[2] E. Çabej, Grupet ND, NG në gjuhën shqipe, në BUSHSH, nr.4, 1953, 36-38.
[3] M. Halimi, Kërkime dialektografike, f.122
[4] M. Halimi, vep. cit. f. 236

renit[5] e ndeshim edhe në të folmen e Kaçanikut[6], që është një e folme fqinje, në të folmen e Hasit[7], në tërësi[8], etj., do të thotë i kalon caqet e kufijve të së folmes në fjalë. Në këtë të folme nuk ndeshim kalimin e *ngj-è*s në *nj* siç e ndeshim në disa të folme veriperëndimore, në të folmen e Ulqinit, të Kastratit[9], të Malësisë së Madhe dhe të Plavë-Gucis[10]; (si: njeshi, nja:l, njiti, me njye, i njesin emnin, kij at etj. nga ngjeshi, ngjala, ngjiti, me ngjye, ngjesin, kingjat.

Togu *fsh.-* Rrafshimi i këtij togu bashkëtingëllor në këtë të folme është një ndër tiparet më specifike, që e dalion të folmen e Karadakut, jo vetëm nga të folmet fqinje me të cilat kufizohet, por me mbarë të folmet të gegërisë verilindore, duke u afruar në këtë pikë me të folmet e Gegërishtes Veriperëndimore, i cili është thjeshtuar në *sh* të thjeshtë: *shisë* (fshisë), *munash* (mëndafsh), *k'osha* (qofsha)[11]. Togu *fsh* në këtë të folme nuk ruhet i plotë, por elementi i parë bie krejtësisht jo vetëm kur gjendet në pozitë mesore dhe fundore të fjalëss, por shpesh edhe në ballë të fjalës.

Në pozitë nistore: *fshï:s //* Me fshi:s fshi:jm // Nän rejat me fshisa n'do:r //.

Mirëpo, ndeshim rastet kur bie fjala edhe në pozitë nistore të fjalës, si për shembull: *me shî: //* Me shî:s shly;jm // I kish shî: lämt n'oborr *II* Me shi: lamen me kuaj. Shih edhe në këngën popullore, ku togu *fsh* në pozicion nistor reduktohet në *sh:* "Tuj shî lotët e me zã tuj kja: / tuj shî lotët si ujët e gurres[12].

Këtu vlen të theksojmë se togu *κj* nuk është karakteristikë për këtë të folme, por këngëtari popullor nën ndikimin e gjuhës së priftërinjve të ndikuar nga shkodranishtja e të folmet veriperëndimore, ka inkuadruar në vargjet e veta të këndimit të këngës në fjalë edhe togun *kj* që s'ekziston në të folmen e Karadakut.

---

[5] M. Halimi, vep. cit. f. 311
[6] Fadil Raka,
[7] Xh. Gosturani, E folmja e Hasit, DSH, III, Tiranë 1975, f. 224.
[8] Mr. Imri Badallaj, E folmja e Hasit (tezë e doktoraturës dorëshkrim), Prishtinë 1989, f.104
[9] Gjovalin, Shkurtaj, e folmja e Kastratit, SF, nr.2, 1967, f.43
[10] M. Ahmetaj, E folmja shqipe e Plavë dhe Gucisë, SGJ, II (dialektologji), Prishtinë 1989, f. 259
[11] Dr. Jorgji Gjinari, Dialektet e gjuhës shqipe, Tiranë 1989, f. 56.
[12] Gjergj Gj. Gashi, Martirët shqiptarë gjatë viteve 1846-1848, f.252.

Ja disa shembuj ku togu *fsh* kalon në *sh,* si: *ko:sh-a* (lat. coxa për kofshë-a) *..ko:sht e pules // lasha* (lasha e pules *II* Ćysh n'bishen knohet kjo kaŋ // (Myçibabë) // N'koshi de:k / Zoti ju pjoekt n'xhenet // (Myçibabë) // Me rrashi:t lavren me vlla:ç // Ni kashore bük / kashoj / etj.

Reduktimin e togut *fsh* e ndeshim kryesisht në trajtat e foljeve të mënyrës dëshirore: *t' pasha, t'rasha* dhe në urime: *u gxosh, u gxoshi, u shtoshi, koshi shnosh, ì pisha uj për shnet,* në namë e mallkime: *Kur dit mos pash Kurr mos u shtoshi* Në ngushëllime: *xinja koshin! Koshi shnosh!* (Bërçec); *Kurr hajr mos bash! Zanin ta njesha / sõt kurr mos t' i pasha!*

(Ranatoc), por e ndeshim edhe në sharje, kur folësit karadakas e shfryjnë mllefin e vet: // *Ja čisha nanen // Ta losha, ta ladrosha!* etj.

Edhe në pozicion fundor togu *fsh* reduktohet në *sh: rrăsh //* Nuk äsht kodër // po ãsht rrăsh // E bleva ni plĩs t'rra:sh // (Zhegër), *mnash* (shih mundash në fshatrat e Moravicës: Raincë, Rahovicë etj.) // Hajr bãsh // (Kokajt).

Ky fenomen i tejkalon caqet gjeografike të së folmes së Karadakut. E ndeshim më tepër në të folmet dialektore të Gegërishtes Veriperëndimore. Si duket ky fenomen fonetik ka një shtrirje të gjerë gjeografike, duke filluar që nga fshatrat e Karadakut të Bujanocit e Gjilanit kalon nëpër Kaçanik e nëpërmjet fshatrave malore të Ferizajt vazhdon deri në Rrethin e Bjeshkës, e arrin deri në Nikaj-Mertur[13] e shtrihet edhe në Theth, Kastrat, Pukë, ndërpritet te krahinat Krasniqe, Gash, Bytyç e Tropoje[14].

Shikuar nga aspekti diakronik *f, m* te trajta e foljes *fshe(h), mshef* sipas Idriz Ajetit janë prefikse foljore, e kjo do të thotë se trajta fillestare shqiptohej: *sheh<shef; fsheh:mshef* [15]në të folmen e Këlmendif[16], ku përveç trajtave të foljeve të mënyrës dëshirore: *t'pasha, t'rasha, e gxosh,* etj., fenomeni në fjalë edhe në raste tjera si: *mnash:mëndash; ko:sh > ko:fsh;*

Togu *shq.* - Në të folmen tonë grupin *shq* pothuaj rregullisht e ndeshim të reduktuar në *sh.* Shembuj: *shypta.r, n'gu.h shype, shypõ.j, Shypni,*

---

[13] E. Lafe, E folmja e Nikaj-Merkurit, SF, nr. 3, 1964, f. 136.

[14] Gjinari, Vërejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës, BUSHT nr. 4 1963, f. 179.

[15] I. Ajeti, Zhvillimi historik i së folmes gege të arbneshëve të Zarës, Vepra 1, botim i ASHAK, XVI, libri 12, Prishtinë 1997, f. 53.

[16] Gj. Shkurtaj, E folmja e Këlmendit, f.29.

yshym, me rrshit // ti rrshet // e më rrallë ndeshim edhe trajtat dublete *krushći* e *krushi-t; peshqir* e *peshir* (por edhe peshkir), etj. // U shkatrrue n'gu:h shype // E treta liber i ka pa:s históriát e popllit shyptarr // Çou se poplli shyptar ɳ'Shypni shkoj posht krějt // Fućia shyptare vazhdojke // (Stublla Epërme) // E lidhke peshirin n'kry: // Dhi:t i yshejshim me kron // Shyp ma për shkurti i kan ra // Sikurse m'u yshy: insani // (Stançiq).

Se togu *shq* rrudhet në *sh* dëshmon edhe fakti se shpesh herë edhe qiellzorja *ć* alternohet me shtegoren *sh*, si për shembull: *kshy:r* (nga kqyrë) dhe *krushi* (nga krushći).

// Kshyr andej s'ka / kshyr knej s'ka // Ai sefte kshyr nihere se ka^{h} i bje e premja // (Stançiq).

// Kur bje n'xàk delmja ja kshyrmi ve:sht se ve:sht i nxehen // (Depcë) // N'shum vena ka vorre t'krushve //.

Do theksuar se kjo dukuri nuk është vetëm tipař i së folmes së Karadakut, por ajo ka shtrirje pothuaj në të gjitha të folmet e Kosovës në përgjithësi.

Togjet *shk, shkr.* - Në të folmen tonë ruhen mire këto togje, duke mos u shkëmbyer asnjëherë me togjet *çk* e *çkr,* që janë tipare të së folmes së Gallapit'[17], të së folmes së Shalës së Bajgorës[18] e të folmeve të Llapit, të Drenicës e të disa të folmeve tjera të Kosovës.

Në të folmen e Karadakut ndeshim rregullisht trajtat: *shka, dishka, shke.p, shkeka, shkarkoj, shkatrrue,*

Më besnikërisht flasin vetë shembujt e nxjerrë nga konteksti bisedor i informatorëve që mora gjatë qëndrimit tim në Karadak: // Konopin vět e mjellshim / vět e shkulshim / vět e rexshim // (Binçë) // Tirćit me shkeka // Na Ballabant shka jena ko:n // U shkatrrue n'gu:h shype // Ato libra shkrujshim Shkodër // Shkollës shka i takon // ćeshit boje t/shkrume // Shoken, e kena shkrue // Dishka me tha:n // (Stublla Epërme) // Dikur pi:n shka pi:n // Shka kan errmi:h temele e kan ǵe:t tublla ťmoćme // Japin llakum ja dishka ćeter // Tana ajo sa mujke me shke:p // Sha kini fo:l // (Zhegër) // Kta sha kên mashkì // Shá po ban / sha je tu tha:n // Çapla:jk i tho:jn nifar drrase

[17] Z. Munishi, pun. cit. f. 155-172
[18] L. Mulaku, E folmja shqipe e Shalës së Bajgorës, DSH, VI, f. 204.

shkado ko:ft // (Stançiq) // Edhe bugari dy:t sha ke // A me kshy:r me xallnu: dishka a shka me maru: // (Stançiq).

Kështu *sh-ja* dhe *zh-ja* parashtesore në të folmen në shqyrtim ruhen të plota edhe në togjet sekondare, jo të mirëfillta shp, shpr, *zhb, zhg* te fjalët: *shpaloj, shploj, shpï* (me), *shpërthy:, shpoj, shpengoj, shpërdhĩt* dhe te fjalët *shpejt, shpesh; shpri:sh, shpra:z; zhbaj, zhbij, zhbiroj, zhgandërr, zhgozhdoj, zhgojoj, zhge:dh.*

Shënim. Edhe z-ja parashtesore ruhet në grupet *zb, zg,* si: *zba:rdh, zbu:t, zbe^{h}t; zga:t, zge.dh* (me), *zgërdhï* (me u), *zgu:r (zgor), i zguravt* (lis), e nuk ndeshim me *x\ xbardh, xga:t, xgi.dh, xgodha*, etj., siç e ndeshim përballë trajtave: *çploj, çpaloj, çpij, çpoj, çpërthej, çpraz* e *xhbaj, xhbiroj*, etj., që i ndeshim në të folmen e Gallapit[19], Llapit, Shalës së Baigorës[20], e në të folme të tjera të Kosovës.

Alternimi *sh/ç* ndodh kryesisht në pozicion parashtesor, duke përfshirë këtu grupet e bashkëtingëlloreve, që lidhen me to. Mirëpo, bashkekzistenca e *sh-'ës* me *ç*, nga njëra anë, si variante të pakushtëzuara brenda një të folmeje në disa treva dialektore të shqipes, dhe nga ana tjetër, përhapja gjeografike e tyre, duke mbizotëruar përdorimi i njërës në areale të caktuara dialektore dhe përdorimi i tjetrës në një areal tjetër, tregojnë se për historinë e tyre në mbarë gjuhën shqipe është i drejtë mendimi i A. Xhuvanit e i E. Çabejt, të cilët në studimin e tyre për parashtesa të gjuhës shqipe[21] thonë se duket të ketë pasur që në balle të kohës dy parashtesa të ndryshme *(sh* dhe ç)[22] Lidhur me përdorimin e *ç-'ës* si parashtesë apo edhe si tingull i fjalës së parme. Jorgji Gjinari supozon: "Me sa duket, me kohë, për shkak të barazimit të vlerës funksionale të këtyre dy parashtesave diku u tërhoq nga përdorimi parashtesa *sh* për t'i lënë vendin parashtesës *ç-,* duke mbetur vetëm në disa fjalë, ku sot nuk ndjehet më si parashtesë, të paktën si parashtesë me funksion antonimik, kurse në një trevë tjetër dialektore u tërhoq ç-ja në të mire të *sh*-së plotësisht ose vende-vende, duke mbetur vetëm në një numër shumë të kufizuar fjalësh. Megjithatë ky prob-

[19] M. Halimi, Skicë e së folmës së fshatrave Mramuer dhe Marec, KD, Prishtinë 1985, f. 387.
[20] I. Mulaku, po aty, f. 204
[21] A. Xhuvani – E. Çabej, Parashtesat e gjuhës shqipe, BSHSH, nr. 4, 1956, f. 97.
[22] J. Gjinari, Mbi parashtesen SH-Ç, të gjuhës shqipe, Buletin i punimeve shkencore të Fakultetit Filozofik të Prishtinës, IX, 1972, f. 85.

lem mbetet akoma i errët, sepse është vështirë të përcaktohen rrugët nëpër të cilat u krye ky proces në njërën ose në tjetrën të folme dhe faktorët e tjerë, që mund të kenë ndikuar në këtë gjë[23]

Kështu parashtesën *sh-* e ndeshim edhe në grupet bashkëtingëllore sekondare *shf, shfr, shl,* etj., siç dëshmojnë shembujt: *shfar //* Shfar feje jan ko:n s'e dĭ kush // S'e di shfar kohe ä ko:n // Shfar derti ki be? *// Shfajsim, shfarosje, shfry:j, shli:r, shliroj, shly.j, shlodh* etj.

Togjet *tsh* e *ts.* - Janë shkrirë ne *ç,* përkatësisht në *c* në këto fjalë: *i moçum, vjeç, viç* (sh. vjeta), *i meçum //* E kam ći:t mas meć *//*, *përpeç*[24] *balçak, tamëlçak* dhe mënyra dëshirore e foljes me pasë: *paça, paç, paçi*, që e heqin zanafillën e tyre gjenetike nga trajtat parësore: *i motshëm, vjetsh, vitsh* (khs. me trajtën diç (ditsh, që e ndeshim te Buzuku)[25], *i mentshëm' mirëmetsh, përpetësh, baltës = baltak = balcak = balçak, tamëltshak, patsha, patsh, patshi* etj. Ndërsa togu *tsh* ruhet te fjalët: *i gatshëm, i mërzitshëm, i sotshëm,* përballë trajtave: *i gaçëm, i mërziçëm, i soçëm* në disa të folme shqipe, si në të folmen e Ulqinit e ndonjë tjetër.

Togun ***ts*** e ndeshim të shkrirë në *c* te fjalët: *moc, mocanik, bucina, tuc* nga mots (mot+s+anik), (butë+si+në = bucine), (tutë+s < tuts < tuc).

Në të folmen në shqyrtim kemi ndeshur edhe një varg togjesh konsonantike, që ruhen besnikërisht si të tilla ose pësojnë ndryshime të rralla.

Togun *bn* e ndeshim edhe si të tillë në toponimin *Vërbnica* në fshatin Zhegër, por e ndeshim edhe të evoluar nga *bn* në *mn* tek emri i fshatit *Remnik* nga *Ribnik* analog me pesë fshatra (tri në Vushtrri dhe dy në Llap) me emrin Dumnicë (Dubnicë nga sllavishtja *dub* "vishkull, lis", ku togu *bn* është asimiluar në *mn* apo edhe hidronimi *Rimi:c-a* (nga Ribnica, ndoshta edhe patronimi *Simnica* i disa familjeve shqiptare në rrethinat e Vushtrrisë, që janë shpërngulur pas vitit 1878 nga fshati *Sibnice* të Toplicës, që sjell L

[23] J. Gjinari, po aty, f. 85.

[24] Sipas mendimit tim emri përpeç njëlloj trajti me droçka, kulloshtër ose gjizë përbrenda, pastaj i mbuluar petë për petë ka ndjekur këtë evoluim zhvillimi për + petë + sh përpesh < përpeç, ku togu tsh dhe ç, si te fjalët: i moçëm, vjeç, paç! etj. Kështu dallohen: përpeç me droçka, përpeç me voe, përpeç me kulloshtër, përpeç me gjizë (gjizanik), përpeçecite, por në parim të gjitha përbëhen nga petë të tëholluara me tëholluese e me harç përbrenda.

[25] E. Çabej, Studime për fonetiken historike të gjuhës shqipe, Tiranë 1988, f. 69 (Kështu gjejmë dhe te Buzuku eççim (etshim) mbas dy diç (ditsh) etj. apo shteç, me u la shteç që i sjell I. Ajeti.

Mulaku kur bën fjalë për të folmen e Shalës së Bajgorës[26] Fenomen ky, që është tipar evolutiv i brendshëm i shqipes, sepse ndodh edhe te fjalët thjesht shqipe si: *Ishoj dhĕt mallim* // Ja dha malit mallim // E pre:n malin mallim // që nëpërmjet togut *mb* m(m+ballë+im = mballim=mallim).

Edhe togu *vn*, ka evoluar nëpër fazat *vn<mn<m*, që dëshmon toponimi *Ramirid* në fshatin Kokaj, që ka kaluar nëpërmjet trajtave *Ravnirid* < *Ramnirid* < *Ramirid* analog me trajtën *Rami:sht* nga *Ravni:sht* < *Ramni:sht* < *Rami:sht* dhe *Ramidejë* nga *Ravnidell* < *Ramnidejë* < *Ramidejë*, në fshatin Cernicë të Moravës së Epërme[27] ku ll-ja alternohet me *j* krahaso *Novosejê*[28] nga *Novosellë, Gumnishtë, Sllamnik* nga *Guvnište, Sllavnik* etj., apo nga *Skrovná* < *Skromna* < *Skroma*, që sjeli L. Mulaku[29]. Siç u pa nga shembujt, që sollëm më lart kjo dukuri i tejkalon caqet gjeografike të shtrirjes së saj të së folmes së Karadakut, duke u bërë një dukuri e mbarë shqipes, por që evoluimi ndodh në kuadër të të folmeve dialektore e të folmet dialektore na hepojnë në diakroni historike.

Edhe togjet *bz, gz* i ndeshim shpesh, si: *krrabza, kabza, vegza, rrogza,* por edhe me trajtë metatetike *rrozga* // rrozga ći ngjiten për tirći // (Zhegër).

Edhe togu *veç* i sllavishtes në të folmen e Karadakut, kryesisht në ojkonime, ka përfunduar në fazën përfundimtare *-c,* si: *Bijanoc, Leskoc, Tërrnoc, Bukoc, Miratoc, Bukuroc*, etj., (nga sllavishtja Bujanovac < Bujanovc < Bujanofc < Bujanoc e Bijanoc, do të thotë ka kaluar nëpër fazat: -ovac-ovc-oc)[30].

Togun *nx* e ndeshim në disa shembuj të kësaj të folmeje, si: *xinxare, menxi* (nga memzi), *me nxã:η* // Tamlin e nxã kos // Ai nxë nja dy(tré vetë // (Stançiq) // P'e nxã ẋathin me ata t'kinẋit // (S. Epërme) // *menxe, i nxe^{h}t* //Sa mujke m'i nxa:n kerri // (Zhegër).

Mirëpo, ndeshim edhe alternimin e x-ës me *z: rru:nz* e *rrunzak* (por

[26] L. Mulaku, vep. cit. f. 209.
[27] M. Halimi, Kërkime diaktologjike, f. 123.
[28] Sh. Hoxha, E folmja e Arnit, DSH, VI, 1990, f. 68.
[29] L. Mulaku, po aty, f. 211
[30] Sh. Berani, Drejtshkrimi i emrave të përveçëm të lakimit të parë të gjuhës serbokroate në gjuhën shqipe, Onomastika e Kosovës (Simpozium mbajtur më 25-27 shkurt 1977), Prishtinë 1979, f. 253; shih edhe I.

edhe rrunak). Nga ana tjetër ndeshim trajtën me *z* pa togun *nx* siç e dëshmojnë shembujt: *e zuni, e ka zã:n, zanc-i*, etj. //Shteti e zuni si dõst // anmiku sun e ka zã:n // Zanci i mullinit e na:l ŭjt//

Togjet *kl, gl, Ik.* - Togjet e vjetra *kl, gl* në këtë të folme nuk janë ruajtur, por kanë përfunduar në velare të thjeshta ***k, g.*** Madje ky evoluim sipas mendimit tim është bërë drejtpërdrejt, duke mos kaluar nëpër fazat e konstruktuara nga gjuhëtarët: *kl>kĭ>kj>q* dhe *gl>gi>gj*. Sepse në këtë të folme po të kishin qenë në përdorim fazat e ndërmjetme të togjeve në fjalë, së paku do të gjendej ndonjë shembull i skutuar në shprehje frazeologjike, në toponime ose në leksik të pasivizuar, siç e ndeshim në të folmet veriperëndimore *kj gi,* që përfaqësojnë fazën e ndërmjetme të evolucionit *kl<q* dhe *gil<gj*. Përjashtim mund të bëjnë në këtë të folme dy huazimet sllave *klyç, kyç* dhe *globë<gjobë<gobë*. Sipas E. Çabejt "këto thjeshtime, kalime nga grupe tingujsh në tinguj të thjeshtë, në zhvillimin e gjuhëve zakonisht kryhen me një valë, po me shkallë të ndërmjetme"[31].

Ndërkaq grupi *Ik* si duket ka evoluar nëpër fazat *ulk<ujk<uk*, shumësi *učˇ* dhe paralelisht me emrin e gjinisë mashkullore u zhvillua edhe ai i gjinisë femërore: *ulkĭ<ujkĭ<ukĭ,* sepse në raste të rralla ndeshet edhe trajta *ulko:j* (me *б* hundore) dhe emërtim vajzash me emrin *Ulkĭ:* dhe *Ukĭ:, Ik* në *j к* është ruajtur në patronime, si p. sh.: *Lini Ujkut, Prena Ujkit, Marta Ujkit* në fshatin Terziaj.

Ndërsa, fjalën *bujk* që vjen nga trajta e kryehershme *bulk e nga kjo bulsi,* në këtë të folme e ndeshim të ketë hyrë vonë nga gjuha letrare, e prej saj edhe fjala e prejardhur *bujqësi.* Emri *alkë<ajkë,* që në këtë të folme e ndeshim edhe në trajtën *jajkë* // Jajka leshit //. Pra, j-ja te emri *ajkë* e heq zanafillën nga l-ja e kryehershme siç ka ndodhur edhe me emrin *pylkë <pyjk<pykë,* duke përfunduar në trajtën pa *j: py:k* // Рука pykën e shtõn // Secilin lis e shky:n рука vet //.

Togu *qt.* - Ky tog në të shumtën e rasteve ne të folmen e Karadakut ruhet, përveç fjalëve: bŭk e kallamojt (nga bŭk e kallamoqt, ku qt dha jtˇ) dhe shoćisho.jn (nga shoqishoqin<shoqishoqn<shoćisho:jn). Ndërsa rregullisht ndeshim trajtat: plećt, mićt.

[31] E. Çabej, Studime për fonetikën historike në gjuhën shqipe, Tiranë, 1988, f. 63.

Grupi *ct* i latinishtes në të folmen e Karadakut në vend të tri drejtimeve apo tri varianteve, u reflektua në dy drejtime, në *ft* dhe *jt* nga variantet tjera që i ndeshim në gjuhën shqipe ct<ft; ct<jt; dhe ct<qt^[32] dhe *kt* në disa të folme (lekturë-a, thupra të holla për të lidhur bashkë një tufë kallinjsh, shkarpash, etj[33] ndërsa në të folmen e Llapit, të Gallapit, të Drenicës, pjesërisht edhe të Moravës së Poshtme përdorin fjalën *liktyrë-a,* në Kërçovë (fshati Tuhin) *lidhnje,* ndërsa në të folmen e Karadakut *ft: liftyra* e *lyftyra, lu:ft* (liftue), *tafta:r; ct<jt: i drejt, me drejtu:, me pajtu:, pajtimtar, trajt-i* (hae, pite e bërë me brumë), *fty:r //* njéri jeton për fiy:r //. Ndërkaq, reflektimi i tretë *ct<qt* në të folmen e Karadakut, fshatrave të të cilit i kam rënë kryq e tërthuer në pesë-gjashtë ekspedita shkencore në intervale të ndryshme kohore brenda njëzet vjetësh, përveç trajtave: *me ndre:ć* e *nre:ć* (nga me drejtue me ndreqtue, që është rezultat i grupit ct<qt, ku duke rënë t-ja fundore është përftuar trajta *ndreć* e *nreć* (nga latinishtja directus *(n)dreq(t)* = dreqtue e drejtue), ku *n*-ja ishte vënë në funksion parashtesor, ndërsa *t*-ja fundore me kohë ka rënë, nuk e kemi ndesh në ndonjë rast tjetër, gjë që nuk do të thotë se nuk ndeshet edhe në ndonjë fjalë tjetër. Kjo na bënë kureshtar të bëjmë kërkime të mëtejme, veçanërisht te shqipfolësit e besimit katolik të kësaj treve, ku mund të ndeshen shembuj në fjalë të rralla, të pasivizuara, e që mund të jenë specifike vetëm për sferën e jetës kishtare.

Përfundim

E folmja e Karadakut sikur edhe të folmet tjera, përveç bashkëtingëlloreve të thjeshta ka edhe togje bashkëtingëlloresh të përbëra nga dy fonema. Derisa togjet konsonantike ruhen mirë ne të folmet toske, ato në të

---

[32] I. Ajeti, Sur la substitution *ct* latin en albanais, Zeitchrift für Balkanologie III, Wiesbaden 1965, 1-3 (ct: ft: lucta<lufta; trocta<trofta; tractarium<t(r)aftar; directus<drejt; rum. drejt fructus<fruqit, fryt; lactem<la[ti; tractem<traiti; Lat. *et* shqip *ft* (qt), *jt, t:* paqtoj, paqoj, që lidhen me pajtoj me lat. pactare; fatura fëtyrë dhe sot me *y* të patheksuar *fytyrë ftyrë* (shënim im). Kështu në disa të folme edhe brenda shqipes qt<jt: *plejt, zoit, të kejt* (nga pleqt, zoqt, të keqt), Bardhi: i *kujth* (Dictionaire, 136); lat. tracta shq. trajtë; biqt (bik't) dhe biét për bijt (djemt); pascal<paskaj(ë); paskaq, greq. pasqali forma greke (sk<sp), ku l<j: golë<gojë; *Golamadi* sh. *golë+madhi;* lat. *vitula*<shq ftulë<ftujë; familja<fëmijë; kollaq<kollaj, sqetullsjetull; sjap<cjap<sqap, ku q palatale para *t, n, sh, ç, th*, dha *j* ku *ç, th* dha *j* p.sh. ct<qt: i ndrejtë, i drejtë dhe i dreqt, ndret, dret, në Zarë ndret.

[33] Spiro Floqi, Skicë e së folmes së Dangëllisë, BUSHT, nr. 3, 1958, f. 144.

folmet gege ruhen shumë pak, ndaj edhe në të folmen e Karadakut i ndeshim pothuaj kryesisht të rrafshuara.

Togjet më të shpeshta, që i ndeshim në këtë të folme janë: *tj, dj, mb, nd, nt, ng, nk, ngj,fsh, shq, shk, shkr, tsh, ts, bn, vn, bz, gz, vc,, nx,* etj. Për të cilat në studimin tonë sollëm shembuj konkretizimi se kur përdoren këto togje dhe ç'pozitë zënë në fjalët përkatëse.

Nga vrojtimet tona kemi vënë në spikamë se këto togje bashkëtingëlloresh paraqesin laramani te ndryshme, e ç'është më karakteristike ndodh që i njëjti subjekt të ketë lëkundje të shqiptimit. Mirëpo përkundër lëkundjeve të mëdha në mbështetje të shembjuve të përdorur dhe frekuencës së tyre kemi arritur *të*^{r} nxjerrim rregulla të përgjithshme dhe të veçanta, që e shquajnë këtë të folme si një e folme me tipare specifike.

Nga aspekti konsonantik dhe nga përdorimi i togjeve bashkëtingëllore, E folmja e Karadakut na paraqitet si një e folme kalimtare apo ndërmjetësore me të folmet e Karadakut të Shkupit, të folmeve të Pollogut të Tetovës, të Gostivarit, të Rekës së Epërme, të Dibrës, të Matit e të Lumës, nga njëra anë dhe të folmeve fqinje me të cilat rrethohet, si e folmja e Moravës së Epërme, Moravës së Poshtme, E folmja e Moravicës, ku përfshihen edhe të folmet e Shqiptarëve të Bujanocit e të Preshevës, nga ana tjetër.

Mehmet HALIMI, Prishtina

ON SOME SYLLABIC UNITS OF SPOKEN LANGUAGE OF KARADAK

Summary

This paper treats some syllabic units of the spoken language of Karadak region by illustrating it with specific use of such units.The study shows that they often get contracted and rarely endure in all three positions of a word.

Anton BERISHAJ, Prishtinë

SEMIO–ETIKA E LETËRSISË SË EKZISTENCËS NEGATIVE

KDU 821.18 (419).09
008 (=18:419)

LETËRSIA E DIASPORËS DHE EKZILIT

Abstrakt

Në këtë studim trajtohen disa nga çështjet qendrore të letërsisë së diasporës, migracionit dhe ekzilit, mbështetur te qasjet aktuale teorike dhe praktika bashkëkohore letrare *shqiptare*. Problematika e modelimit semiozik të realiteteve diasporike dhe ekzilante ngërthen në vete çështjet e përgjithshme poetike, po edhe ato që janë të veçanta dhe specifike vetëm për këtë letërsi. Strategjitë e reja identitare, identitetet hibride si forma të veçanta të interaksionit diskursiv, kulturor e semiotik, përfaqësojnë bërthamën e shqyrtimeve të propozuara këtu.

Fjalë çelësa: diaspora, ekzili, çrrënjosja kulturore, imagjinariumi diasporik, dyzimi i subjektit, dialogjiciteti, semio-etika, etika diskursive

1. NOCIONET

Kategoritë *diaspora* dhe *ekzili*, mund të thuhet gati pa mëdyshje, janë bërë një *locus communis* në studimet bashkëkohore letrare e humanistike përgjithësisht, posaçërisht në kontekstin e teorisë dhe kitikës letrare postkoloniale. Ato në vete bartin një potencial semantik tepër kompleks, nisur edhe nga kontekstualizimi i tyre historik, ose nga shumësia e përvojave bashkëkohore diasporike e ekzilante të komuniteteve dhe individëve. Nocionet *ekzili* dhe *diaspora* janë parë shpesh në një lidhje të ngushtë me nocionin *exodus*, i cili nga ana tjetër bart vulën e përvojës paradigmatike historike e teologjike të hebrenjve. Të jetosh nën detyrim jashtë *Tokës së Shenjtë* do të shndërrohet në një simbol origjinar për *imagjinariumin e atdheut* e diasporave të kohërave moderne dhe letërsisë së tyre.

Sipas Baummanit, "nocioni 'ekzil' është rezonant me idetë e emigrimit të dhunshëm, zhvendosjes, margjinalizimit social e politik të një individi ose grupi" dhe është i lidhur ngusht me "përvojën e vetmisë, të të qenit i huaj, nostalgjisë dhe mallit të përhershëm për ri-emigrim në vendin e

origjinës."[1] Në anën tjetër, ndërkaq, sipas tij gjatë viteve '60 të shekullit të kaluar, nocioni *diaspora* "denoton një grup nacional, kulturor a religjioz që jeton në një vend të huaj"[2]. Diasporat, të krijuara nëpërmjet migrimit dhe ekzilit, rëndom duke iu nënshtruar dhunës dhe detyrimit të *historisë*, me statusin e tyre specifik të të qenit të zhvendosua, të mospërkatësisë dhe mospranimit në "vendin nikoqir", përfaqësojnë një gjendje papërcaktueshmërie, jo-stabiliteti, fluiditeti dhe të një lëvizjeje të vazhdueshme (posaçërisht imagjinare). Ndoshta nocioni *nomadizëm* është figura që më së miri do të mund t'i ofronte disa nga domethëniet dhe afiliacionet kuptimore të një gjendjeje të tillë.

Edhe pse të përdorura shpesh si nocione sinonimike, nocioneve *diaspora* dhe *ekzili* gjithnjë e më shpesh u atribuohen kuptime të ndryshme dhe specifike. Përderisa, siç pohon Rushdie*, diaspora* shenjon *një komunitet personash të zhvendosur*[3], të cilët janë të rrënjosur njëkohësisht në vendin e prejardhjes dhe në botën imagjinare të transnacionalitetit[4], *ekzili* gjithnjë e më shumë ndërlidhet me individë të *ç-rrënjosur*, të cilët edhe në rastet e *mërgimit vullnetar*, jetojnë dhe krijojnë në një lloj *"hapësire të ndërmjetme"* kulturore e semiotike, në "dheun e askujt", prandaj nocioni i ekzilit u atribuohet kryesisht individëve të spikatur/intelektualëve, personave që posedojnë të ashtuquajturin *kapital kulturor*. Ekzili kështu shpesh konsiderohet si një "gjendje e zgjedhur, posaçërisht për intelektualët, shkrimtarët dhe artistët që mund të ushqejnë ndjenjën se atdheu i tyre u ka vënë tepër kufizime në relacion me vetërealizimin e tyre artistik."[5] (Mund të thuhet se ky *definicion* do të mund të përfshinte pjesën më të madhe të shkrimtarëve dhe shkrimtarëve shqiptarë, të cilët e kanë "zgjedhur" ekzilin si një *modus të ekzistencës* pas viteve '90 të shekullit të shkuar. Sigurisht,

---

[1] Baumman, Martin, *Exile*, in: Kim Knott and Sn McLoughlin (eds.), *Diasporas – Concepts, Intersections, Identities*, Zed Books, London and New York, 2010, p.19.

[2] Ibid., p.22.

[3] Lakshman, Nirmala,*"A Columbus of the Ner-At-Hand"*, in *Salman Rushdie Interviews*, ed. Pradyumna S. Chauhan, Westport, CT: Greenwood, 2001, p. 283.

[4] Trousdale, Rachel, *Nabokov, Rushdie, and the Transnacional Imagination – Novels of Exile and Alternate Worlds,* Palgrave – Macmillan, 2010, p. 13.

[5] Quayson, Ato, *Postcolonialism and the Diasporic Imaginary*, in *A Companion to Diaspora and Transnationalism*, eds. by Ato Quayson and Girish Daswami, Blackwell Publishing, 2013 p. 152.

ka edhe të atillë te të cilët dominojnë "motivet" e detyrimit të vrazhdë (si p.sh. Koliqi, Camaj, Pipa, Xhaferri e të tjerë), ose të atillë që i përkasin të ashtuquajturës *diasporë viktimë*, siç është për shembull diaspora e arbëreshëve, kryesisht në jug të Italisë po edhe gjetiu. Në të vërtetë, edhe dikotomia *vullnetare/jovullnetare (voluntary/ involuntary)* ka në vete një hapësirë të tërë të dykuptimësisë, ambivalencës dhe papërcaktueshmërisë semantike, si edhe nocionet të cilave u referohet.)

Në kohën më të re, në kontekstin e globaliz(i)mit dhe *rivlerësimit të të gjitha koncepteve*, gjithnjë e më tepër flitet për zhdukjen e ekzilit, respektivisht për një gjendje metaforike dhe letrare të llojit të veçantë[6], prandaj nocioni ekzil është zëvendësuar me *format e reja të ekzistencës negative – azilantët, migrantët ilegalë, refugjatët dhe emigrantët.*[7] Ekzili, sipas Teeuwenit (i cili e parafrazon titullin e tekstit të famshëm të Walter Benjaminit), "më në fund ka hyrë në erën e riprodhimit mekanik dhe kështu e ka humbur aurën e tij."[8]

Shumësia, pluraliteti dhe thuajse diferencimi i *pakufishëm* i përvojave të letërsisë diasporike dhe ekzilante e bën gati të pamundur "mbulimin" e saj kritik e diskursiv gjithpërfshirës. Prandaj, reduktimi "metodik" i *materialit* për shqyrtim është i nevojshëm dhe i domosdoshëm.

2. POETIKAT

Debatet lidhur me poetikën/poetikat e letërsisë së diasporës/ekzilit/ migracionit zhvillohen kryesisht duke marrë në konsideratë si pikënisje situatat specifike sociale e kulturore të akterëve letrarë, në relacion me të cilat bëhen përpjekje për definimin e tipareve të veçanta strukturale të kësaj letërsie. Definimi i poetikës së saj gjithpërfshirëse ndoshta edhe nuk është i domosdoshëm, megjithëse sipas të gjitha gjasave mund të jetë edhe një mision i pamundshëm, pikërisht duke marrë në konsideratë vetë pikënisjen e definimit të asaj letërsie si të tillë.

---

[6] Teeuwen, Rudolphus, *Fading into Metaphor: Globalizaton and dhe Disappearance of Exile*, in *Creativity in Exile*, ed. Michael Hanne, Rodopi, Amsterdam-New York, 2004, p. 292.

[7] Ibid., p. 292.

[8] Ibid., p. 293.

Megjithatë, një nga përpjekjet më konsistente për ta bërë një gjë të tillë përfaqëson vepra e Søren Frankut *Migracioni dhe letërsia*.[9] Premisat e tij teorike ai i bazon tek ideja e Lukacsit mbi ndërvarësinë e sferës sociale e estetike, respektivisht tek konstatimi se ajo që është "në letërsi njëmend sociale është forma", respektivisht se "Çdo formë është vlerësim dhe gjykim mbi jetën dhe ajo e nxjerr këtë fuqi dhe forcë nga fakti se në themelet e saj më të thella forma është gjithnjë ideologji. […] Botëkuptimi është postulat formal i çdo forme."[10] Franku, në këto gjurmë, shpalos argumentet se "nocioni i migracionit funksionon si një urë që lidh estetikën dhe sociologjinë, sepse migracioni ka të bëjë si me temën ashtu edhe me formën."[11] Pra, duke ndjekur idenë e Lukacsit të hershëm mbi ndërvarësinë e sociologjisë dhe estetikës do të mund të flitej për poetikën, midis tjerash edhe të romanit, që do të bazohej te gjendjet jostabile kulturore, sociale, por edhe të subjekteve dhe vetjeve, e që janë karakteristike për gjendjet paradoksale të diasporës, ekzilit dhe migracionit në përgjithësi. Kjo premisë mund të zhvillohet më tej dhe të shqyrtohet në shfaqjen specifike të *shenjave të jetës* (Sebeok), konfigurimit të tyre që buron nga pozita liminale semiozike, kulturore dhe imagjinare e autorit, botëve dhe subjekteve të modeluara, por gjithsesi edhe të "përgjigjes" së lexuesve të tyre. Sipas Frankut, migracioni sinjalizon *procese oshiluese dhe të pambaruara,* të cilat manifestohen në nivele të ndryshme të veprës letrare: në relacion me identitetin personal, nacional e kulturor, gjuhën, formën narrative dhe ndërtimin formal.[12] Për më tepër, sipas tij, migracioni përfaqëson një *koncept epokal* (edhe pse është i vetëdijshëm për karakterin *historik* dhe *transhistorik* të këtij nocioni), i cili i determinon segmentet e kontinuumit të të gjitha teksteve letrare.[13] Në rrafshin semantik, me anë të logjikës mimetike, strategjive narrative dhe retorike, letërsia e migracionit i modelon *botët fiksionale* të ekzilit, migracionit, diasporës, si dhe gjendjeve sociale e kulturore transnacionale.

E konsiderojmë të nevojshmë ta citojmë në tërësi modelin shpjegues

[9] Frank, Søren, *Migration and Literature*, Palgrave/Macmillan, New York, 2008. Frank me nocionin *migracioni* i përfshin dhe/ose i nënkupton edhe nocionet *diaspora, ekzili* etj.
[10] Ibid., p. 5.
[11] Ibid.
[12] Ibid., p. 8.
[13] Ibid., p. 10.

të letërsisë migrante që ofron Franku, i cili megjithatë është ofruar në formë të një dysie binare:

"Niveli social (tema, mimetizmi, jashtëtekstualiteti):

- biografia e autorit (migrant, ekzilant: humbje/fitim, i përkohshëm/i përhershëm)

- biografia e karakterit (migrant, ekzilant: humbje/fitim, i përkohshëm/i përhershëm)

- kombi dhe nacionalizmi (identiteti hibrid nacional)

- Europa dhe letërsia europiane (shekullarizmi, migrantët dhe letërsia botërore)

- globalizimi (mobiliteti, paradokset inherente)

Niveli stilistik (forma, parimi konstruktiv, intratekstualiteti):

- diksioni (perspektiva vagabonde, zëri i huaj, vetëkorrektimi)

- forma kompozicionale e narrative (e papërfunduar, rizomatike, multidimensionale)

- gjuha (heteroglosia, papastërtia, të-qenit-ndërmjet)."[14]

Në të vërtetë, autori është i vetëdijshëm se ky model nuk ofron një *definicion totalizues dhe të tërësishëm*, si dhe për natyrën metodike dhe vlefshmërinë relative të këtij modeli shpjegues të strukturës letrare (romaneske) në formë dysie binare, sepse ato nivele (*pikat fokale tematike* dhe *strategjitë tekstuale,* siç i përcakton ai më tej) gërshetohen në strukturat e tekstit, madje edhe atëherë kur kanë karakter transgresiv.

Ka edhe teoricienë të tillë që letërsinë e ekzilit e shqyrtojnë jo vetëm si një koncept "gjeografik", i cili ndërlidhet me përvojën e çrrënjosjes që buron nga të jetuarit jashtë atdheut, në *dhé të huaj*. Kështu, Hong Zeng e zgjeron fushën e hulumtimit të tij edhe jashtë fushës tradicionale të letërsisë së ekzilit te *shkrimtarët e ç'atdhesuar, shkrimtarët që janë bërë ekzilantë në atdheun e tyre për shkak të peripecive të historisë, poetët që janë zhvendosur në ekzil të detyruar brenda përvojës së tyre poetike, romancierët që janë konsideruar si romantikë, por që në të vërtetë janë të mërguar nga ideali i tyre romantik, shkrimtarët e ekzilit kozmik në kohë*

[14] Ibid., p. 21.

dhe shkrimtaret gra, ***ecriture feminine*** *e të cilave rrëfen një vetarratisje esenciale në përvojën femërore, të shprehur jashtë rendit simbolik.*[15] Një zgjerim i këtillë i fushës së hulumtimit rrezikon që koncepti i ekzilit në letërsi të bëhet gjithpërfshirës dhe t'i fshijë ashtu kufijtë specifikë të "fushës disiplinare" duke iu afruar në formë implicite premisës heideggeriane mbi *ekzilin si një gjendje universale të ekzistencës së njeriut*. Insistimi i Zengut, do të thosha, te *hapësirat e brendshme të përvojës semiotike*, në formë të *çarjes brenda unit, persnaliteteve të shumëfishta, maskave dhe doppelgangerit*, si dhe tek ekzili si një "përvojë liminale e vetëtëhuajësimit dhe vetëdezintegrimit"[16], e gjen modelin e vet projektiv te relacionet specifike fragmentare dhe diferenciale ndërmjet diskurseve kulturore, si dhe te *poetika e shpër/puthjes, poetika dekonstruktive dhe me qendër të zbrazët, shenjues pluskues/rrëshqitës, simulakrumi dhe fragmentimi*[17], si tipare kryesore të letërsisë bashkëkohore të ekzilit.

* * *

Edhe pse mund të pohohet se një pjesë e madhe e letërsisë shqipe mund të konsiderohet si letërsi e diasporës, ekzilit dhe migracionit që nga fillet e saj, me fenomene letrare tepër interesante, posaçërisht te *diaspora romantike*, ne megjithatë, duke u nisur nga premisat teorike të shtruara më sipër, në këtë studim do të përpiqemi t'i shpjegojmë dhe interpretojmë disa nga fenomenet më interesante të letërsisë bashkëkohore shqiptare të diasporës dhe ekzilit.

3. DIASPORA DHE FIGURAT E IDENTITETEVE HIBRIDE – ABATE

"*... Nëse për gjermanët vazhdoja të isha një i huaj, për të huajt e tjerë isha një italian; për italianët isha një jugor ose njeri i jugut; për jugorët isha një kalabrez; për kalabrezët isha një shqiptar ose "ghieghiu", siç i quajnë ata arbëreshët; por për arbëreshët isha një gjermanik ose një nga Trento; për gjermanikët ose banorët e Trentos isha një pa rrënjë,*

[15] Zeng, Hong, *The Semiotics of Exile in Literature*, Palgrave Macmillan, New York, 2010, p. 1, 2.
[16] Ibid., p. 3.
[17] Ibid., p. 2.

ndërsa unë për veten time isha unë, një sintezë e gjithë këtyre përcaktimeve, një person që jetonte në shumë kultura dhe me shumë gjuhë, aspak pa rrënjë, madje me shumë rrënjë, edhe pse ato më të rejat nuk ishin ngulur akoma thellë në tokë, por valëzonin në ajër."[18] Ky është një fragment nga tregimi-ese i Karmine Abates *Të jetosh pa kufij*, autorit që i përket diasporës bashkëkohore, origjinarisht mesjetare, arbëreshe.[19]

Si narratori autorial dhe rezonues tek Abate, i cili *shenjat e jetës* dhe identitetet e veta fluide dhe *jostabile* i kërkon dhe identifikon në përftesën e përhershme procesuale, bashkë-kundër-vënien (Lotman) semiozike dhe semio-etike, ashtu gati të gjithë akterët e narracioneve dhe romaneve të tij (*Shtegimi i unazës, Midis dy detesh, Festa e kthimit, Motoçikleta e Skënderbeut...)* janë në kërkim të *figurave të identitetit* të tyre, të cilat Abate i quan *figura hibride.* Natyrisht, ai kërkim merr shpesh një kuptim paradoksal dhe ambivalent, duke shenjuar ashtu edhe *dysinë/çarjen* sociale, politike e kulturore. Kështu për shembull, një nga personazhet e tij, "Merikani i rremë", siç e emërton narratori, para se të niset në migracion (i cili për të përfaqëson një *ekzil të dy/tre/shumëfishtë*) i jep këshilla të birit, protagonistit kryesor të romanit "*Shtegtimi i unazës*", Konstantinos: "*Mëso mirë italishten, se është gjuha që do të japë bukë; dhëntë zoti edhe anglishten, se një ditë mund të të hyjë në punë, por arbërishtja ç'të hyn në punë?! Dhe qesharakja ishte se të gjitha këto porosi, përfshirë edhe të fundit, më të rëndësishmen, i bëri në arbërisht: të më zësh vendin,* ***bir****, se tashmë je i madh dhe gjyshi tepër plak."*[20]*,* duke shpërfaqur tërthorazi *përvojën e traumës*, si dhe *tëhuajësimin endemik dhe fragmentimin e sub-*

[18] Abate, Karmine, *Të jetosh pa kufij dhe udhëtime të tjera,* Toena, Tiranë, 2011, ff. 142, 143. Botimi italian: Carmine Abate, *Vivere per addizione e altri viaggi*, Arnoldo Mondadori Editore S.r.I., 2010. Citimet nga kjo, por edhe nga veprat e tjera të këtij autori do të jepen sipas botimeve shqip edhe në përputhje me praktikën dhe idenë e autorit mbi shumësinë e gjuhëve, si pjesë e patëhuajsueshme e identitetit/identiteteve të tij.

[19] Në të vërtetë, diaspora arbëreshe, sipas mendimit tim, është një nga *diasporat komplekse*, origjinarisht *diasporë viktimë (victim diaspora),* më interesante europiane. Ndryshe nga diaspora romantike arbëreshe dhe ekzili i saj i dyfishtë: kthimin drejt imagjinariumit mesjetar dhe *Motit të Madh* mitik të Skënderbeut, si një burimi simbolesh dhe gjenesh syzheore dhe në funksion të utopisë imagjinare të *përfytyrmit/mendimit të kombit*, në diasporën aktuale arbëreshe tropet, figurat dhe toposet analoge janë në funksion të markimit të identitetit/diferentitetit kulturor kundruall kulturës së "nikoqirit".

[20] Abate, Karmine, *Shtegtimi i unazës*, Dukagjini, Pejë, 1994, f. 149.

jektivitetit.[21] Bëhet fjalë, pra, për kërkesën për *harrimin* e gjuhës, të cilën Abate në një vend tjetër do ta quajë *gjuhë e zemrës,*[22] me të cilën markohen korporealiteti dhe spiritualiteti diasporik. *Heteroglosia* është imanente për personazhet e tij. Te *Prologu* i romanit të tij "*Shtegtimi i unazës", zëri autorial* midis tjerash rrëfen: "Në shtëpi flisnim *si neve*, në gjuhën arbëreshe dhe pastaj në shkollë, nga mosha gjashtë vjeç, fillonim të mësonim *litisht,* domethënë italisht." Personazhet e romaneve të tij rregullisht e vënë në funksion të ashtuquajturin *code-switching*[23]*,* ku gjuha arbëreshe (e cila shërben si një marker kulturor, emocional dhe identitar i llojit të vet) u kundër-vihet jo vetëm gjuhëve italiane dhe gjermane, por në atë mënyrë edhe diskursit sundues kulturor e ideologjik, të pushtetit e të fuqisë. Madje edhe mësuesi Stratigo (i cili po ashtu i përket asaj diaspore, "një plak arbëresh nga Shën Kolli") u drejtohet "me diksion kërcënues" nxënësve të tij të vegjël: "*Ç'Arbëri, more! Ne jetojmë në Itali. Arbëri i thënçin! Po ju gomerë jeni. S'dini të flisni as italisht dhe s'ju merr vesh koka që s'duhet, me ligj s'duhet, në shkollë të paktën, të flisni shqip. Gomerë jeni!"* ("*Shtegtimi i unazës",* ff. 25, 26.) Kjo jo vetëm që flet për pluralitetin e vet diasporës, por edhe për moduset paradoksale të inskriptimit social e kulturor të atij diskursi të fuqisë.

Tekstualitetin e romaneve të tij po ashtu e karakterizon një *dialogjizëm radikal.* Ai është i thurrur prej fragmentesh mitopoetike folklorike, historike e letrare, po nga e njëjta *lëndë* është i ndërtuar edhe imagjinariumi i personazheve të tij. Narratori i tij autodiegjetik më një rast do të pohojë: *"Nuk kisha libra, përveç librave të bezdisshëm të shkollës dhe librin mbi jetën e shkurtër të Skënderbeut, që mamaja kish në kokën e saj dhe ma lexonte vazhdimisht me zë të lartë."*[24] Tek Abate, gati rregullisht në të

---

[21] Kabir, Ananya Jahanara, *Diasporas, literature and literary studies*, in: Kim Knott and Sean McLoughlin eds., *Diasporas – Concepts, Intersections, Identities*, Zed Books, London and New York, 2010, p. 146.

[22] Abate, Karmine, *Motoçikleta e Skënderbeut*, Botimet Toena, Tiranë, 2012, f. 78.

[23] "Code-switching is a strategic and eminently controllable communicative device, in which speakers choose to switch between the languages of their repertoire within a particular speech event for identity-reinforcing reasons, or for other reasons such as topic of conversation, interlocutor status, stylistic nuance and so on." Jaine Beswick, *Diasporas and language*, in: Kim Knott and Sean McLoughlin eds., *Diasporas – Concepts, Intersections, Identities*, Zed Books, London and New York 2010, p. 137.

[24] Abate, Karmine, *Motoçikleta e Skënderbeut*, p. 114.

gjitha romanet e tij, nëpërmjet *citatësisë ludiste* të fragmenteve etno/mito poetike dhe teksteve të tëra e subzhanreve (fjala vjen, baladat mesjetare), shpesh të vendosura në ko(n)tekste analogjie karnevaleske, realizohet fragmentimi i "atdheut të mitologjizuar" në *botët alternative* të romanit, duke e bërë edhe *atdheun e tij alternativ, fiksional*[25], por duke e fuqizuar ashtu karakterin metafiksional dhe transnacional të fiksionit të tij.

Duke shqyrtuar *imagjinariumin diasporik të letërsisë,* Ato Quayson do të konstatojë se për konstituimin e atij imagjinariumi letrar (do të shtoja edhe kulturor) janë të rëndësishme tri elemente: *vendi, nostalgjia dhe kërkimi/kujtesa gjenealogjike*.[26]

"*Përtej horizontit, një ditë gushti si sot, me det të qetë, nisen tri galera me të mërguar: e para është plot me djelmosha, e dyta me vasha dhe e treta me bukë e verë. Zbresin në bregun e Marinës, të prirë na shqipja e madhe me dy krerë që i ka udhëhequr e mbrojtur ditë e natë, që kur u detyruan të braktisin Arbërinë e pushtuar nga turku. Ne kemi një gjak me ata njerëz."*[27] Janë këto fjalët e Nani Lisandros, bartësit dhe përcjellësit të imagjinariumit kulturor, drejtuar personazhit kryesor Konstantinos, të cilit me t'i mbushur tetëmbëdhjetë vjet do t'i *shfaqet si në epifani* shqipja dykrerëshe. Po këto personazhe, të cilët e kujtojnë me *nostalgji* atdheun e tyre të braktisur para pesë shekujsh, të detyruar në migrim të përhershëm, me po të njëjtën *nostalgji* do t'i kthehen Horës, atdheut të tyre të ri (në Italinë e jugut), duke dëshmuar kështu edhe për një *dysi nostalgjike,* e cila është një nga shenjat e kompleksitetit të kësaj diaspore dhe imagjinariumit të saj. Në të vërtetë, këtë nostalgji për atdheun, të cilin as që e kanë parë dhe të cilin e (për)kujtojnë nëpërmjet *narracionit* dhe *fragmenteve mito-poetike*, do të mund ta quanim "post-memorie" të ekzilit.[28] Nga ana tjetër, gati të gjitha personazhet e romaneve të Abates gjithnjë lëvizin në rrjetin diskursiv të *kërkimit/kujtesës gjenealogjike*, duke u figuruar sipas një

---

[25] Trousdale, Rachel, *Nabokov, Rushdie , and Transnational Imagination – Novels of Exiled and Alternate Worlds*, Palgrave, Macmillan, 2010, p. 17.

[26] Quayson, Ato, *Postcolonialism and the Diasporic Imaginary* in: *A Companion to Diaspora and Transnationalism*, eds. Ato Quayson and Girish Daswani, Wiley Blackwell Publishing Ltd., 2013, p. 148.

[27] Abate, Karmine, *Shtegtimi i unazës*, f. 17.

[28] Quayson, Ato, Ibid., p. 149.

modeli gati obligativ në relacionet *ati/ biri/ gjyshi/të parët*, të cilët midis tjerash përfshijnë edhe "çështjet e të parëve, etnicitetit, traditës dhe kulturës", të cilat e *ofrojnë një të kaluar të njohur për personin ose komunitetin, përfshirë këtu edhe rrëfimet lidhur me atë se "si-kemi-arritur-këtu"*[29]

Njëkohësisht, ato personazhe janë në lëvizje të përhershme, *gjendje nomadike*, ashtu si edhe Giovani Alesio te romani *Motoçikleta e Skënderbeut*: "*'Dove' (ku): kjo fjalëz e mallkuar dyrrokëshe, dy bashkëtingëllore, dy zanore, dy shpirtra, si unë: dëshira për të qëndruar në një vend të çfarëdoshëm dhe dëshira për të bekuar një vend të pagjindshëm. Ose më mirë: besoja se e kisha gjetur për një ditë, apo për një muaj, apo për një vit, e më pas një lloj mjegulle më mbyste e më terratiste çdo lëvizje timen. Ku?Ku? – pyesja veten, dhe nuk gjeja paqe."* (f. 7) E markuar në këtë mënyrë, bota konfuze e heroit, i cili gjendet diku në hapësirën liminale midis narratorit fiktiv dhe autorit real, dhe për të cilin megjithatë *e kaluara është dhé i huaj,* ashtu siç *është njësoj e huaj edhe e tashmja*[30]*,* e tëra është e thurrur nga ndjenja, gjuhë, qëndrime të bashkë-kundër-vëna, nga *ëndrra, vizione fragmentare, ballafaqim me pasqyra të thyera, "fragmentet e të cilave kanë humbur në pakthim."*[31] Do të shtoja se edhe mundësia e paraqitjes/ krijimit të sërishëm të tërësisë është e humbur pa mundësi kthimi.

4. EKZILI DHE FIGURAT E AUTSAJDERËVE, TRUPIT TË VDEKUR – CUFAJ DHE KYÇYKU

Autsajderët, të përjashtuarit dhe *figurat e autsajderizmit*, si një nga moduset e modelimit të realitetit ekzilant, janë elemente dominante poetike te romanet "*Shkëlqimi i huaj"* i Beqë Cufajt[32] dhe "*Engjëjt e tepërt"* i Ardian Christian Kyçykut.[33]

Te Cufaj *tropet ekzilante*, siç janë nostalgjia kulturore, humbja e

[29] Ibid., p. 151.
[30] Rushdie, S., *Imaginary Homelands*, Granta Books/Penguin Books, London, 1992, p. 9.
[31] Ibid., pp. 10, 11.
[32] Cufaj, Beqë, *Shkëlqimi i huaj*, Dukagjini, Pejë, 2003. Autori nga vitet '90 jeton në migracion/ekzil në Shtutgart, ngjashëm si heronjtë e tij fiktivë nga ky roman.
[33] Kyçyku, Ardian Christian, *Engjëjt e tepërt*, Buzuku, Prishtinë, 2001. Edhe ky autor po ashtu jeton në migracion/ekzil në Bukuresht, ku zhvillon një aktivitet të begatë letrar dhe intelektual.

ndjenjës për realitetin, dysia e subjektit[34], modelohen nëpërmjet dyfishimit të personalitetit, pikëshikimit/perspektivës narrative, zërave narrativë, ndërsa *heronjtë negativë* dhe *autsajderët socialë* të tij nga mileu i skajshëm social përftojnë një imazh të errët të "botës së ftohtë" dhe "shkëlqimit të huaj" të ekzilit, jetës së pakuptimtë, të gënjeshtrës dhe krimit. Akterët e romanit të tij ballafaqohen me një lloj të veçantë ekzili që në vendlindje – shfaqet si nevojë ose detyrim për të ikur, për t'u larguar/arratisur (ngjarjet janë vendosur në kontekstin e viteve '90, kur Kosova ishte nën regjimin policor serb). Zh-vendosjes psikologjike i bashkohet edhe zh-vendosja gjeografike, e cila e përcakton edhe "nostalgjinë imagjinare" të tyre prej të ç-atdhesuarish. Ajo gjithsesi nuk është e orientuar vetëm ndaj "atdheut", "nënës së vdekur" që shfaqet si një *trop i trishtë*, i cili e përcakton qëndrimin auto-destruktiv të Arben Dukës, heroit kryesor dhe alter-egos së vetë autorit, por edhe ndaj *atdheut ideal të lirisë,* "Amerikës", të cilën më kot e gjakon me plot pasion Rifati/Riki, heroi i "dytë" *i dyzuar* i rrëfimit (për këtë dyzim flet edhe emri i tij i dyzuar), por që për të mbetet e paarritshme gjer në fund. "*Riki jetonte në këto dy botëra. Njëra ishte ajo e Rikit – siç e quanin të gjithë jashtë shtëpisë së tij dhe tjetra botë ishte ajo e gruas dhe e babait të tij, të cilët, si gjithmonë, vazhdonin ta thërrisnin me emrin që ia kishin dhënë që fëmijë: Rifat.*"[35] Përkundër dyzimit ekzistencial të Rikit, (për)çarja e brendshme e Arben Dukës ka më shumë përbërës metafizikë: "*Arben Duka ishte i vetëdijshëm që di aq pak për jetën. E dinte që në botën e tij janë dy jetë: ajo e vërteta dhe ajo e librave që kishte lexuar.*"[36] Duka, në njërën nga seancat e tij të dehjes së pafund nëpër *vrimat prej kafenesh* të botës së migrantëve, e thyen gotën ("botën") mbi tryezë në manierën filmike të "Borës së bardhë" (peronazhit rom) nga filmi i njohur *Mbledhësit e purpurit*, me çka *autori* e ndërlikon edhe më tej figurimin intersemiotik të të qenit i përjashtuar, i hedhur, të pakënaqësisë dhe zhdukjes së realitetit. Alter egoja e shkrimtarit sikur do që me këtë ta shenjojë statusin e vet fiksional të dyfishtë.

Picaro-të e lloji të veçantë të Cufajt, Riki dhe Arben Duka, vazhdi-

[34] Zeng, Hong, *op. cit*., p. 7.
[35] Cufaj, Beqë, *op. cit.,* p. 165.
[36] Ibid., p. 184.

misht lëvizin nëpër hapësirat e skajshme, margjinale dhe të ndërmjetme, nga bodrumet e burgjeve policore në bregdetin malazias, anija ilegale e refugjatëve (e cila si një lloj *anijeje të çmendurish* i shpie në detin e mnerës dhe të të panjohurës), kampet e refugjatëve, deri te dhomat e errëta e të lira të moteleve periferike të Shtutgartit (në të cilat gjallojnë persona *të harruar*, "të dëbuar" nga shoqëria) dhe bodrumeve të klubeve të natës, në të cilat ata "dalin në gjah pas lumturisë". Këto *loci* narrative sikur e figurojnë gjendjen e të qenit të përjashtuar të *trupave ekzilantë.* Te Cufaj, akterët në deskripsionin narrativ modelohen sipas *gjedhes së fotografisë* – lexuesit i përshfaqen "portretet tipike" (përshkrimi i syve, flokëve, fytyrës, hundës... etj.) "*Ajo kishte veshur ca 'jeans' të ngushtë bojë qielli. Flokët i kishte të gjatë. Ia mbulonin supet dhe shtriheshin deri poshtë ijeve. Sytë i kishte të mëdhenj dhe të zez. Vetullat e holla. Kishte një bukuri të lënduar në fytyrën e saj.*"[37] Nga njëra anë, kjo *poetikë e përshkrimit* përfaqëson ballafaqimin "imagologjik" me Tjetrin – i cili rregullisht reduktohet në trup dhe funksione korporale – femrat shihen ekskluzivisht si objekte seksuale, por edhe si një mundësi e projektuar për ndryshimin e statusit social (gjithashtu nëpërmjet dimensionit "material"). Nga ana tjetër, këto figura të diskursit udhëzojnë te fotografia si *një formë e ngrirë e jetës*[38] dhe në analogjinë barthesiane me vdekjen. Sepse, duke u shkëputur nga komuniteti i tyre origjinar, ngjashëm me *shkëputjen e aktorit të parë nga kori duke luajtur rolin e të vdekurit*[39]*,* Riki dhe Arben Duka vazhdimisht ballafaqohen me *përkeqësimin progresiv* të vetëkontrollit të tyre, prandaj përfundojnë në *indinjatën shkatërrimtare* të "vdekjes" së tyre – në krim dhe burg (Riki), autodestruksion dhe alkoolizëm (Arben Duka). Teatri i tyre i ekzilit ndodh ashtu në *botën e hijeve*, të banuar me "njerëz të ftohtë". *Filozofimet vagabondeske* të Rikit gëlojnë nga stereotipat negativë ndaj Tjetrit, duke filluar nga *imago*-ja e vendit nikoqir: "*E hëna është muti më i madh në Gjermani! Çdo gjë është këtu mut, por e hëna posaçërisht!*"[40], ndaj migrantëve të tjerë: "*Tasosi është grek. Dhe grekët janë si serbët.*"[41] Madje edhe "inter-

[37] Ibid., p. 73.
[38] Zeng, Hong, *op. cit.,* p. 10.
[39] Ibid., p. 11.
[40] Cufaj, Beqë, *op. cit.,* f. 197.
[41] Ibid., f. 213.

pretimi" i tij i luftërave (edhe të atyre ballkanike) pikënisjen e gjen te diskursi etnocentrik dhe stereotipat që do të mund t'i quanim *ballkanizma*: "P*se Millosheviqi i vret kroatët e boshnjakët sot dhe nesër do të na vrasë ne shqiptarëve, sepse e ka ndjenjën e frikës që populli i tij i madh serb, nesër apo pasnesër, do ta humbasë farën duke u përzier edhe më tej me këta popuj. Pse nuk na duan ne sot gjermanët dhe fuqitë e tjera? Sepse ne jemi tashmë hebrenjtë e tyre dhe nëse vazhdojmë të vijmë edhe më shumë në këto vende, do t'ua përziejmë gjakun dhe do t'ua humbasim sojin.*"[42] Riki, me "rezonimin postkolonial" të këtillë, në të vërtetë markohet si një karakter fiksional me *trup monstruoz*, respektivisht *mendje monstruoze.*

Bildungsromani i përmbysur i Cufajt edhe në tekstualitetin e tij është i tëri në zonën e fragmentaritetit: vazhdimisht alternohet perspektiva e diegjezës narrative – Riki dhe Arben Duka rrëfejnë për veten në vetën e parë, për të kaluar pastaj në narracionin në vetën e tretë (por që gjithnjë fokalizohet te njëri nga akterët kryesorë të rrëfimit), shënime ditari dhe në modusin tipik dramatik, herë-herë duke e ndjekur me ngathtësinë dhe mangësinë e vet teknike vetë "*ndërtimin*" e heronjve të vet.

* * *

Për heroin kryesor, *të pa-emër*, të romanit "*Engjëjt e tepërt"* të Kyçykut, *ekzili është një përvojë akute, liminale e vetë-tëhuajësimit dhe vetë-dezintegrimit, për ç'gjë vdekja është metaforë e vetme adekuate*.[43] Atë sikur e ndjekin në mërgim dhe ekzil shtytja metafizike dhe fati, i parë në dimensionin e tij fatalist. "*Qe bindur se ishte nga ata që, edhe po të donte, nuk vdiste dot në Shqipëri. Qe tronditur pastaj se askush nuk e kish ndalur të ikte sërish jashtë. Askush nuk e kish ndalur ndonjëherë: as të kthehej në atdhe, as të kthehej në mërgim. Ndofta qysh atëhere kish nisur t'i hidhte rrënjë në kokë vetëvrasja*."[44] Gjendja e dyzimit, të-qenit-ndërmjet i definojnë koordinatat e tij ekzistenciale. Ai ka ardhur në qytezën Callatis, në breg të Detit të Zi, i cili dikur ishte "njëfarë parajse e ikanakëve, e dezertorëve dhe të përndjekurve të Perandorisë Romake", ku "i madhi Ovidiu

[42] Ibid., f. 195.
[43] Zeng, Hong, *op. cit.,* p. 33.
[44] Kyçyku, Ardian Christian, *op. cit.,f.* 16.

kishte dhënë shpirt."[45] Në dritën e një reminishence të tillë intertekstuale, narratori autodiegjetik konstaton: "*Zor të gjeje një vend më të mirë për t'ia bërë gropën vetes*." (f. 19.) Në atë vend, ku *kish ardhur për ta vrarë veten*, ai është i ndrydhur/kapërthyer ndërmjet vetëperceptimit imagologjik negativ të unit, i cili për të është njëkohësisht edhe i Huaj (*Fytyra ime prej sjqiptari, tha ai me vete. As në botën tjetër, mes kafkave, nuk do të arrij të jem binjak me njeri.*), por gjithashtu edhe të perceptimit negativ nga ana e Tjetrit (*Një shqiptar?! Një refugjat i rëndomtë, pa din e pa iman, pa punë e pa të ardhme, bartës fatkeqësish.* f. 41.), është i privuar nga gjithçka, madje edhe nga dokumentet personale dhe pasaporta. Në një gjendje të tillë të pashpresë, atë madje "*e tmerronte mendimi se diçka mund t'ia zgjonte atë shtazën e quajtur shpresë*."[46] Në veçimin e tij të përhershëm, margjinalitetin, në gjendjen *askund, hapësirën ndërmjet,* ku *"atdheu i tokës dhe ai i qiellit përziheshin",* duke lëvizur midis autsajderësh dhe të përjashtuarish, porosit revolen prej Oscuros, njërit nga ata, i cili figuron terrin metafizik dhe ekzistencial të të qenmit të tij. Në bisedë me të dashurën e tij të fundit, Narcisën, në dysinë e vet (duke u prezentuar rrejshëm si vrasës i porositur dhe duke e projektuar veten te një *doppelganger fiktiv*) ai i projekton ndjenjat e veta te Tjetri: "*Nuk i foli gjatë për shqiptarin që duhej të zhdukte. Ishte një djalë rreth të tridhjetave, mërgimtar. Dy arratitë e para në Perëndim i kishin dështuar. Herën e tretë kishte sosur në Rumani. Nuk dinte ndonjë gjë të hollësishme për dashritë e tij, në kish pasur, e as për ëndrrat. Gjithsesi, një gjë ishte më se e qartë: përderisa porosiste vdekjen e vet, duhej të ndihej pezull. Si pezull?! Domethënë as në tokë, as në qiell, i paaftë të kthehej në atdhe, i paaftë për të jetuar si njeri aty ku ishte. E përderisa ishte i gatshëm të vdiste, madje të bashkëpunonte me vdekjen e vet, duhej të qe bindur se nuk jetonte dot më. Mbase ndihet i shterur, tha Narcisa. Mbase i ka përjetuar të gjitha ngjarjet e veta gjer në skaj, me fund, si i thonë, dhe tani sheh se të rejat kanë mbaruar, ose nuk është i aftë t'i përjetojë. Mbase, tha ai. Jam e bindur se është kështu, ngulmoi ajo. Jam vetë në të njëjtën gjendje.*"[47] Ky projeksion i shtrembëruar i ndërsjellë i dy akterëve udhëzon te *potenciali semiotik i pasqyrës*, do të mund të thuhej i *pasqyrës*

[45] Ibid., f. 18.
[46] Ibid., f. 34.
[47] Ibid., f. 85.

së lakuar e të errësuar,[48] ku *shihet vetja Tjetër dhe Tjetri në-dhe-si-vet-vetja*, por edhe te transgresiviteti struktural drejt rrezatimit mitopoetik e simbolik të *mitit të Narcisit*. Në fund të romanit e gjejmë si *korp të zhveshur* para një pasqyre madhësie të trupit (ende njerëzor) të tij: "*Ngjiti tytën e revolverit në tëmthin e majtë. Ai i pasqyës e ngjiti në tëmthin e djathtë. Trutë e secilit, pas së shtënës, do të brofnin në drejtime të kundërta. Por pyetja që e mundoi para tërheqjes së këmbëzës ishte tjetra. Cili nga të dy do të vdiste, do të kalonte nga jeta në ëndërr, në zhgjëndërr, apo anasjelltas, pas shkrepjes së revolverit?!*"[49] Kjo "lojë" para pasqyrës mashtruese, në të cilën trupi i vdekur mund të humbasë në hapësirat e *hijeve të hijeve platoniste*, ndoshta në botët e hapësirat e ndërmjetme të botëve të mundshme engjëllore, në të vërtetë na shpie te hija e vetë Autorit ekzilant, për të cilin *"afrimi i vdekjes të afronte me letërsinë. Dhe me natyrën e vërtetë të njeriut"*.[50]

5. ENGJËLLI I HISTORISË – FIGURAT E IKJES SË PAMUNDSHME NGA HISTORIA

Ndeshtrashat e historisë në romanin *Angelus novus*[51] e Bashkim Shehut shfaqen si determinanta të *ekzilit të brendshëm* dhe të *gjithmbarshëm* të akterëve të tij "fiktivë". Në romanin e tij gjithçka i nënshtrohet dyzimit universal, lojës së pasqyrave, shlyerjes së kufijve midis ëndrrës dhe zhgjëndrrës, jetës dhe vdekjes, dritës dhe territ, fiksionit dhe realitetit, narratorit dhe autorit, letrarësisë dhe dokumentaritetit. Narratori dëshiron ta rrëfejë *biografinë hakmarrëse flaubertiane* të mikut të tij Mark Gjokës, respektivsht Mark Shpendit, nga kampi/burgu famëkeq stalinist ë Shqipërinë komuniste, ku kanë qenë të burgosur si *armiq të popullit*: Marku për shkak të tentimit të arratisjes nga atdheu, ndërsa narratori për faktin e thjeshtë që ishte i biri i kryeministrit të *vetë/vrarë* të Shqipërisë, Mehmet Shehut, në spastrimet e njohura enveriste në manierën staliniste.

---

[48] Levin, Jurij, *Pasqyra si objekt semiotik potencial*, Aleph, Tiranë, 2000, f. 104.
[49] Kyçyku, Ardian Christian, *op. cit.,* f. 139.
[50] Ibid., f. 57.
[51] Shehu, Bashkim, *Angelus novus*, Toena, Tiranë, 2005. Autori jeton në migracion/ekzil që nga mesi i viteve '90 në Barcelonë, ku e ka shkruar këtë roman-ese, kryeveprën e tij.

Tmerret e historisë modelohen nëpërmjet lojës së projeksionit të *pasqyrave të thyera të dyfishta* të "dy" personazheve: Mark Shpendit dhe Walter Benjaminit. Fatet e tyre të (pa)ngjashme i lidh *Engjëlli i historisë*, siç do ta quante Benjamini në esenë e tij të famshme mbi *kuptimin e listorisë* tablonë *Angelus novus* të Paul Kleesë (e cila na shfaqet edhe si titull i romanit). Komenti i Benjaminit i kësaj tabloje, respektivisht *palimpsesti i dyfishtë* i narratorit/autorit në trajtën e *citatit sipas kujtesës* të atij komenti, që gjithsesi e presupozon edhe *transformimin e paqëllimtë* të tij, përfaqëson matricën hermeneutike të rrjetit rizomatik narrativ të këtij romani. "*Shëmbëlltyra e paraqitur në këtë tablo është engjëlli i historisë, i shtyrë gjithmonë lart dhe përpara nga një forcë e padukshme ashtu si erërat, por me fytyrën gjithmonë të kthyer mbrapa, drejt së shkuarës, dhe duke shikuar pirgjet e gërmadhave të kohërave të moçme e të reja, grumbuj që sa vijnë e zmadhohen*."[52] Rrjedha kryesore narrative shtrihet në dy *locus*-e, në burgun e Burrelit (ku akteri kryesor i rrëfimit *bën përpekje* për ta vrarë veten), drejt të cilit është e kthyer *fytyra/maska e engjëllit* (e cila, sipas narratorit, i përngjan fytyrës së Markut) me *sytë e fiksuar në të shkuarën*, dhe Port Bou, qytezë në kufirin franko-spanjoll, ku Benjamini pas arratisjes së pasuksesshme do të *kryejë* vetëvrasje. Të dy këto *locus*-e do ta indorporojnë dyzimin semiotik të tyre, duke shenjuar dhunën dhe fatalitetin *e kohërave të vjetra e të reja,* "hapësirën e përtejme të pasqyrave të kujtesës" dhe nomadizmin ekzilant të narratorit autorial. Në të vërtetë, ekziston të paktën edhe një *locus i tretë* (me relevancë narrative), Barcelona, që i lidh narratorin historik dhe "personazhin e tij fiktiv", Walter Benjaminin, i cili do të kalojë nëpër Barcelonë në vitin 1932, *dhe po atë verë do shestojë për të vrarë veten, në një hotel të Nisës*.[53]

Bota fiktive e Mark Shpendit fluktuon midis *imago mundi* të projekttuar te Burgu i Burrelit "*me kthina të ndara ashtu si një seri botësh paralele, jo më pak të veçuara e të largëta nga njëra-tjetra se vetë burgu ndaj pjesës tjetër të gjithësisë*"[54] dhe botëve të shumëfishta onirike e alegorike: "*Duke e përfytyruar Shqipërinë si një ishull, ta zëmë se ky ishull*

[52] Ibid., f. 16.
[53] Ibid., f. 75.
[54] Ibid., f. 81.

po lundron përmes detit dhe po bashkohet me Europën. Ta zëmë se u bashkua. Po ja, unë e shoh veten në ëndërr prapëseprapë në një ishull midis detit të paanë, një copë e ishullit lundrues, shkëputur prej tij, dhe që dalëngadalë po fundoset. Zgjohem, dhe ishulli nuk po fundoset, po sidoqoftë jam në copën e shkëputur nga ishulli lundrues, prapëseprapë qenkam në ëndërr, në një ëndërr brenda ëndrrës, që më përpin dhe nuk dal dot prej saj dhe vazhdoj të fundosem brenda saj. Gjendem fill vetëm në një ishull të shkretuar, dhe rreth e rrotull meje gjithandej shoh gjarpërinj të ngordhur."[55] Ashtu edhe Benjamini në *fuga mundi*-n e tij e përshkruan në një nga letrat përvojën e tij onirike të zbritjes në botën e nëndheshme, si aq *të mërguar mitikë* të tjerë, për të përfunduar në fund në *varrin nr. 363*, figurë kjo e botëve paralele të asgjësë.

Edhe njëri dhe tjetri *dëshirojnë të mbledhin gjithçkanë e shkapërderdhur*, të realizojnë *apokata'stasis*, *rimëkëmbjen ose kthimin e të gjitha gjërave*, por secili prej tyre *përjeton ikjen e pakthyeshme të gjithçkaje*. Sepse aty është, megjithatë, *engjëlli i historisë*, ajo "*kimerë e padukshme dhe e gjithëpranishme, bisha e apokalipsit, që vetëm gjurmët mund t'ia shohësh dhe ti ecën pas tyre duke e kërkuar, dhe befas ndjen dikur në zverk dihatjen e saj të akullt*."[56]

Romani i Bashkim Shehut përfaqëson një dialog marramendës të botës fiksionale, botës reale dhe metafiksionalitetit, një rrjet rizomatik fragmentesh të diskurseve letrare, teologjike, filozofike, historike... në hapësirën liminale midis realitetit dhe fiksionit. Për këtë arsye, *kërkesat imagjinative* drejtuar lexuesit[57] nuk ftojnë që libri i tij të lexohet vetëm si fiksion ose si prozë faktuale, por e ftojnë t'i besojë pjesëmarrjes imagjinative, duke u shndërruar edhe ai në ekzilant, pjesëmarrës në *ekperimentin e kulturës së fuzionit, hibriditetit dialogjik dhe kategorive alternative identitare*[58], që përfaqësojnë disa nga tiparet e *fiksionit transnacional*.

[55] Ibid., ff. 137, 138.
[56] Ibid., f. 125.
[57] Trousdale, Rachel, *op. cit.,* p. 27.
[58] Ibid., p. 15.

Bibliografia

Abate, Karmine (1994): *Shtegtimi i unazës*, Dukagjini, Pejë.
Abate, Karmine (2010): *Festa e kthimit*, Botimet Toena, Tiranë.
Abate, Karmine (2011): *Të jetosh pa kufij dhe udhëtime të tjera*, Botimet Toena, Tiranë.
Abate, Karmine (2012): *Motoçikleta e Skënderbeut*, Botimet Toena, Tiranë.
Barthes, Roland (1981): *Camera Lucida,*Hill and Wang, New York.
Bhabha, Homi K. ed. (1990): *Nation and Narration*, Routledge, London.
Chambers, Jain (1994): *Migrancy, Culture, Identity*, Routledge, London and New York.
Cobley, Paul, ed. (2010): *The Routledge Companion to Semiotics*, Routlefdge, London and New York.
Cufaj, Beqë (2003: *Shkëlqimi i huaj*, Dukagjini, Pejë.
Frank, Søren (2008): *Migration and Literature*, Palgrave/Macmillan, New York.
Hanne, Michael, ed. (2004): *Creativity in Exile*, Rodopi, Amsterdam-New York.
Knott, Kim and McLoughlin, Sean, eds. (2010): *Diasporas – Concepts, Intersections, Identities*, Zed Books, London and New York.
Kyçyku, Ardian Christian (2001): *Engjëjt e tepërt*, Buzuku, Prishtinë.
Quayson, Ato and Daswani, Girish eds. (2013): *A Companion to Diaspora and Transnationalism*, Blackwell Publishing Ltd.
Rushdie, Salman (1992): *Imaginary Homelands*, Granta Books/Penguin Books, London.
Said, E. W. (2001): *Reflections on Exile and Other Essays*, 2nd edn, Harvard University Press, Cambridge, MA.
Shehu, Bashkim (2005): *Angelus novus*, Boimet Toena, Tiranë.
Trousdale, Rachel (2010): *Nabokov, Rushdie , and Transnational Imagination – Novels of Exiled and Alternate Worlds*, Palgrave, Macmillan.
Zeng, Hong (2010): *The Semiotics of Exile in Literature*, Palgrave Macmillan, New York.

Anton BERISHAJ, Prishtina

SEMIO–ETHICS IN LITERATURE OF NEGATIVE SURVIVAL - LITERATURE OF DIASPORA AND EXILE

Summary

This paper treats some of the key issues of the literature of diaspora and exile, by referring to the actual theoretical approaches and the contemporary Albanian literature practices.The issue of semiotic modeling of the diaspora and asylum realities involves general poetical aspects, but at the same time being specific and uniqueness of only this type of literature.The new identity strategies, the hybrid identities as the identifiable forms of the discursive, cultural, and semiotic interaction are in the core of contemplations made here.

Kujtim M. SHALA, Prishtinë

TEKSTET PA KONTEKSTE

KDU 821.18.09

Abstrakt

Tekstet pa kontekste shenjon e provon fenomenin e tekstit si *ontos* në vete, përkrah ekzistencës e jetës së gjallë, që në letërsinë shqipe merr shenja autentike të ndarjes nga ideologjitë e mëdha e të hyrjes në modernitet. Vërtet, ky është një fonomen universal, që duket edhe më fort përballë *teksteve me kontekste*, të lidhura për mimezën dhe efektet e relaes në literaturë.

Korpusi i teksteve pa kontekste çon drejt një estetike të brendshme, ndoshta drejt një historie letrare të brendshme, që s'do evidenca, por esenca letrare, që lidhen në estetika apo hapen në sensibilitete.

I TEKSTET PA KONTEKSTE

Tekstet pa kontekste, si formulim e si kërkim, do të provojë një fenomen universal, tekstet në jetën e tyre të brendshme, këtu të kërkuar në letërsinë shqipe të shekullit XX në të cilin ajo provoi shkolla e forma, njohu autorë krejt të ndryshëm ndërmjet vete dhe prodhoi vepra që shenjojnë poetika, së bashku me epokën. Kështu, kërkimi i fenomenit të tekstit pa kontekst në shekullin XX është tepër i ndërliqshëm. Po ashtu, tekstet pa kontekste, nënvizojnë më fort tekstet *me* kontekste e *në* kontekste si fenomene që lidhen me jetën sociale e politike, pra me jetën nacionale, të përftuar në literaturë përmjet imitimit.

Moderniteti i dha rrugë ikjes nga kontekstet në letërsinë shqipe, meqë nisi dhe u shtri si ikje nga ideologemat e mëdha, qoftë të religjionit, qoftë të nacionit. Politika humbi ngjyrat dhe i lëshoi vend poetikës, mësimet u bënë rrëfime të dhimbjeve personale, pastaj të ideve e të filozofive të përthyera në individin, në formimin e në kulturën e tij.

Nuancat fillestare të ikjes nga lavdi e himni drejt modernitetit u artikuluan si kritikë kulturore e letrare nga Faik Konica, që u përthyen si satirë e si ironi nistore. Kjo iku në dy cepa, kur u bë letërsi personale, si te Poradeci, apo shkrim ekspresionist te Migjeni. Në të dy rastet, format dhe poetika që i lënë kontekstet ose i nxijnë ato aq sa të mos njihen. E vënë nën

mbretërinë e fiksionit e të dhimbjeve personale, loja me efektin e reales bëhet e madhe.

I lakuar dhe i thelluar përfundimisht te letërsia e Anton Pashkut, moderniteti shmangu veprimin ideologjik, hapi faqet e mëdha të estetikës dhe shenjoi vetë leximet në shenjat estetike, pra leximet e esencave të artit.

Në ndryshim nga tekstet e porosive të mëdha, tekstet pa kontekste çojnë te *poetika* e letërsisë shqipe, si një *histori* e brendshme e saj.

Autorët që do të përshkruhen këtu, Poradeci, Koliqi, Kuteli, Pashku, Podrimja e Hanxhari do ta provojnë fenomenin në variante konkrete.

II PORADECI: METAFORA

Etimologjia, retorika e historia e metaforës, si dhe e shkrimit metaforik, e provon një raport zhvendosjeje ndërmjet gjuhës (poetike) e kuptimeve, madje ndërmjet letërsisë e jetës së gjallë, historisë etj. Gjuha e metaforës, e tropit mbretëror, është gjuha e zhvendosjes mbretërore. Aty ku ka zhvendosje, s'mund të ketë përfaqësim, por krijim, jo mimesis, por poiesis. Këtë e provon fort dhe si esencë të veten në letërsinë shqipe poezia e Lasgush Poradecit, e lidhur në shenja personale dhe e hapur në gjuhë metaforike. Teksti i tij është një metaforë e hapur, ashtu si shprehja, vargu, ciklet, madje librat e lidhur.

Zhvendosja poetike e tillë, nga trashëgimia simboliste, e nxjerr veprën e Poradecit në modernitetin letrar të shekullit XX, përtej etikës së prerë dhe mësimit ideologjik, tek estetika si esencë e veprës letrare. Kujtojmë përcaktimet e Eqrem Çabejt për poezinë e Poradecit si *moderne*, përballë letërsisë shqipe me ngjyrim të fortë politik, dhe shpalljen e tij Poet nga ana e Kutelit, për gjuhën e tij (poetike) shqipe, kur Poeti nacional (në trajtën e një Dichter-i) po kërkohej me zjarr, i lidhur për temat e mëdha nacionale.

Në gjuhën e Poradecit esencat e jetës bëhen shenja tejkohore, kalojnë kontekste dhe jetojnë si esenca të ekzistencës universale. Gjuha tret shenjat e kontekstit dhe hap shenjat e esencave (universalieve), qoftë kur këndohet a vajtohet dashuria (*Vallja e yjeve*), qoftë kur thuren shkallët e ekzistencës së universit e të njeriut në një teogoni poetike të pashoqe (*Përjetësia*). E zbutur në emocione, e kaluar nëpër fijet e një elegjie të hollë e të pashpallur, kënga, vërtet vaji i Poradecit, shtrihet përtej temave të dashu-

risë, për t'i dhënë krejt veprës së tij tonet e një përkushtimi personal. Në këtë frymë, heronjtë e kulturës, si Naim Frashëri e Asdreni, apo heronjtë e veprimit nacional, si Dedë Gjo Luli, këndohen në metafora të mungesës e të përkushtimit, me një përmallim të fortë, që largon fort shenjat e kushtrimit. Poradeci përmallohet edhe kur lavdëron dhe kjo e lë pa e shkruar himnin, edhe kur e bën përkushtimin.

Por poezia e Poradecit është përplot jetë shqiptare, tjetër se metaforat e tij vetëm sa e shenjojnë, ndërsa ikja nga ideologjia e universalizon atë. Shqipja e pastër bëhet trezori e pasqyra e saj, një shqipe, që, e kthyer në cilëndo gjuhë tjetër, do të humbte esencat e saj, një provë kjo për pretendimin e Kutelit, po një fatalitet për poezinë e Poradecit në planin e një letërsie të krahasuar. Vetë gjuha është ideja shqiptare e Poradecit. Jeta shqiptare e Poradecit nuk manifestohet si kontekst, por si rrjet esencash që bëhet gjuhë e jeton si gjuhë. Po kujtojeni zjarrin naimian të Lasgushit kur këndon gjuhën shqipe, për ta njohur zjarrin lasgushian të lidhur me esencat shqiptare!

Tekstet pa kontekste mimetike të Lasgush Poradecit janë tekste të esencave tejkohore, si dashuria e qenia. Tekstet pa kontekste të Poradecit janë tekste moderne, me të cilat provohet moderniteti shqip, por dhe kulmi i poezisë moderne shqiptare. Asnjë s'u bë poet *sa* Lasgush Poradeci, sepse asnjë nuk mund të jetë poet *si* Lasgush Poradeci.

Nën këtë shenjë, e kërkuar gjatë, e metaforizuar, thuajse e papërkthyeshme, vetë gjuha (estetike) e Poradecit bëhet një shenjë ideologjike, shenjë identiteti letrar e shqiptar. Tjetër se konteksti nuk hyn këtu.

III KOLIQI: IDENTITETI

Kontekstet, qoftë historike, qoftë të ekzistencës, nuk arrijnë të japin identitetin që do Ernest Koliqi në kërkimin e paharruar te (*Shtatë*) *Pasqyrat e Narçizit* (1934).

Koliqi shkroi tregimet e *Hijes së Maleve* (1929) me tema të vendit, pra të kontekstit, të lidhura me moraliteten e vendit, Malësisë, pra të kontekstit, por dhe të jetës autentike, të përthyera si psikologji e veprime. Shkroi *Tregtar flamujsh* (1935) me tema urbane, me vend tjetër, pra kontekst tjetër, Qyteti. Ndërsa, identitetin e kërkoi fort te *Pasqyrat e Narçizit*,

në tekstet e thurura prapa mjegullave të simbolizmit e të formave të kërkuara me durim parnasisti. Lakimi i tillë i temës, shenjon kthimin e autorit nga vetja, për t'u vetënjohur së brendshmi, kur njohja së jashtmi s'e jep tërë pamjen. Kthimi i tillë e përcakton edhe gjuhën (stilin), duke e bërë atë, si edhe tekstin, atributive, një shenjë e fortë kjo e modernitetit letrar, si dhe e mistikës letrare.

Por çfarë kërkon e çfarë gjen Koliqi?

Në shtatë proza të shkurtëra, si në shtatë pasqyra, Koliqi/Narcisi kërkon e zbulon fytyrën e vet, herë në pamje e herë në esenca, për të shkuar drejt vetënjohjes, mësim që merret thellë vetes, vetes së bërë vepër, letërsi. Po pra, Koliqi e nis aventurën e kërkimit në ambientin autentik, e lakon në historinë e gjakut e në trashëgiminë e etikës, e provon me kulturën e tjetrit, që kurrë nuk bëhet e jotja, dhe e mbyll me zbulimin e vetes në veprën e vet letrare. Të gjitha pamjet e tjera, pa veprën, lidhen me kontekste, ndërsa identiteti që qetëson Koliqin shtrihet në faqet e fiksionit të zgjedhur, në shenjat që lë autori në letër. Mësimi i madh i Koliqit thuhet përnjëherë: identiteti rri përjetë në vepër. Ndoshta edhe në veprime.

Pasqyrat e Narçizit e Koliqit, e lidhur simbolikisht me Mitin e Narcizit, ashtu siç ndodh përherë në leximet që ndjekin rrjetin intertekstual, përftesat e esencat e këtij rrjeti, të çon te një lexim i ri i mitit, i hapjes së *mythos*-it të tij si rrëfim për dramën e kërkimit të identitetit dhe tragjikën e zbulimit të tij. Narcisi mitik shikon fytyrën e vet në pasqyrën e ujit dhe e dashuron atë përnjëherë. Digjet për ta prekur, por po e preku, pasqyra trazohet e pamja humbet qartësinë dhe bukurinë.

Narcisi i Koliqit vetënjihet, pasi ka njohur ambient e trashëgimi, në veprën e vet. Ky zbulim mbyll dramën e kërkimit të identitetit dhe kërkuesi qetësohet. Një Narcis ndryshe, Narcis që vetënjihet deri në fund, *në vete*.

IV KUTELI: GJENEZA E VEPRËS

Mitrush Kuteli aventurën më të gjerë letrare e pati te *Tat Tanushi i Bubutimës* (1947), që, vërtet, është një vepër e shkurtër.

Rrjeti i gjerë intertekstual, i përftuar si tekst në tekst e frymë në tekst, i shtrirë nëpër kulturën biblike e të krishterë dhe si tekst me frymën e literaturës popullore e të shkruar, e bën *Tat Tanushin*... një vepër të hapur.

Po rrjeti intertekstual e provon tekstin pa kontekst të jashtëm (mimetik) dhe literaturën si amzë të veprës letrare. Gjeneza nuk ndodhet jashtë, në jetë e në histori, por në letërsi. Çdo tekst konkret buron nga letërsia dhe i provon diskurset potenciale letrare si diskurse të shkrira e të shkruara si vepër letrare konkrete.

Vepra e Kutelit ka dy tituj: *Tat Tanushi i Bubutimës*, që lidhet me heroin e veprës dhe me ambientin e veprimit e të historisë së tij, që, vërtet, është shenjë përkatësie; dhe *E madhe është gjëma e mëkatit...*, formula që shenjon moralin e krishterë, bashkë me një vetëdije të krishterë për jetën, sjelljen e vdekjen: larg mëkatit!

Ky mësim s'e bën *Tat Tanushin...* vepër normuese të sjelljes, po një provuese të normës përmjet fiksionit letrar, rrëfimit, situatave e dramave të thella. Mësimi themelor i veprës provohet nga historia e jetës së heroit të saj, Tat Tanushit.

Tat Tanushi, prifti ilirian i ritit të Lindjes, sjell nga Judeja Noemin, e kthen në besë të vet dhe e pagëzon Kalije. Kjo i shënohet në Librin e jetës si një vepër e mirë. Kalija bëhet dashuria e dytë e Tatës, pas asaj për Hyjin. Por Kalija bie sëmurë, ngadalë shuhet e vdes. Tata i merr mëri Hyjit dhe s'e pranon veprën e tij. Ngadalë tret përkorjen. Nga këtu nis jetën jashtë rrugës së Hyjit. Bën kora me Kalijen si me Shenjtit. Madje *njeh*, në kuptimin biblik, një grua tjetër dhe pas asaj mban meshën. Ky është fundi i veprave në zinxhirin e tij të mëkateve. Hyji e shpall *anaksios*, Tata nuk bindet. Hyji e mallëkon: Kurrë mos vdeksh!, Tata, me zemërim ilirian, ia kthen: Aty mbeç! Engjëlli i Zotit ngujohet nga mallkimi i Tatës, sepse Tata mban hirin e priftërisë, ashtu si errësira që ka brenda dritën.

Tata nis jetën pa fund, në shekuj që ikin e ai nuk vdes. Bëhen luftëra, bien popuj, kodrat bëhen fusha e fushat kodra, Tata po ai. Historia e tij e erosit bëhet histori e jetës, meqë rruga për te Kalija është vdekja, e ky nuk ka si vdes. Që të jetojë, duhet të vdesë. Duket paradoksale.

Shpëtimi është pajtimi me Hyjin. Po pajtimi është humbje e erosit përballë normës. Tata nis rrugën e gjatë e të rëndë të spastrimit, deri në çastin e përballjes me Hyjin, në Ditën e të Verbrit, kur Hyji fal Tatën e Tata liron engjëllin e tij. Konvenca fiton, rruga për te dashuria e jetës është dashuria e përjetshme e përkushtimi për Hyjin. Që të dy shenja të përkorjes

e të përuljes pa fjalë, që vetë bëhen shenja të një kulture. Ky është morali i krishterë i veprës së Kutelit, i thurur në një retorikë të krishterë, madje shoqëruar nga tekste biblike e parabola të krishtera.

Amza e *Tat Tanushit*... të Kutelit është Libri, pra *Bibla*, një amzë universale si kulturë, etikë e mitologji letrare. Amza përtej kontekstit mimetik provohet edhe nga funksioni i gjuhës së personazheve, që është i tipit biblik: gjuha si veprim. Gjuha ka fuqinë e veprës, thuhet dhe bëhet. Këto janë shenjat e shenjtërimit të saj. Por Kuteli shenjtëron dhe gjuhën poetike, të çliruar nga kontekstet e veprimi i ideologjive, e bën vetë atë vepruese. Tjetër se veprimi i saj shtrihet në katrorët e estetikës.

V PASHKU: ELIPSA

Se si *krijohen* kontekstet në *ontos*-in estetik të letërsisë provë e madhe është vepra e Anton Pashkut, e krijuar nën mbretërinë e imagjinatës, të figurës e të kulturës së rrallë. Madje vepra e tij, në ikjen pafund nga mimesis-i, jetën, historinë, mitologjinë e vendit, të lidhura së bashku në rrëfime, situata, veprime e ide i nxjerr nga figura. Sepse nuk bëhen kontekstet figurë, por figura i prodhon kontekstet, teksti bën kontekstin. Një parim ky që përmbys pasqyrën e lakmuar nga literatura mimetike kudo e kurdo.

Pasqyra, figura e Pashkut te romani *Oh* (1971), që e jep botën përmbys, shenjon parimin e tekstit që prodhon kontekstin. Gjithçka në pamjen që jep rrëfimi (pasqyra). Në kuptimin letrar, si parim estetik, figura e pasqyrës shenjon "pamjet" e diskursit letrar që duket ndryshe e ligjëron ndryshe, në shtresa, regjistra e hone që leximi s'mund t'i kapë përnjëherë. Pasqyra pashkiane vërtet është rrjet figurash, që bën tekstin e figurshëm, rrjet rrëfimesh të përqendruara si mythos e diskurs, që ndjek një semiologji shkrimi me rrënjë tek elipsa, jo vetëm si figurë, por edhe si kulturë ligjërimi, e identifikueshme me substancialitetin.

Me figurën e elipsës përshkruhet teksti i Pashkut edhe në planin e ideve, që nuk thuhen, por sugjerohen, që nuk bëhen mësim, po duhet të zbulohen e të lexohen duke u lexuar situatat, që, po ashtu, burojnë nga figurat dhe thuhen në figura. Pashku flet pak e thotë shumë.

Elipsa pashkiane është figura e kultura që buron nga tradita autentike popullore, që lakohet si ligjërim i formulësuar, si skemë e reduktuar në

plan informacioni dhe e hapur semantikisht, por tirret fort në shembullin e kulturës së shkruar, të librit, të shkrimit që do esencat.

Kultura popullore e Pashkut, por dhe diskursi i tij, të çojnë te një autor tjetër që do bashkë *fjalën* (popullore) e *librin* (kultura e shkruar), Ernest Koliqi, një mësues i hershëm i Pashkut. Nën këtë shenjë, Pashku, edhe kur i referohet një konteksti, ai kontekst kulturor, i bërë fjalë e rrëfim popullor.

Elipsa bëhet figurë karakterizuese edhe për veprën e Pashkut në tërësi, madje shenjë metode për ta lexuar atë. Elipsa pashkiane bën që edhe tekstet për atë të ndjekin parimin eliptik të kërkimit e të shkrimit, që ndjek e jep esencat, duke qenë edhe vetë esencial. Për Pashkun nuk mund të shkruhet "përreth".

Sa për të shenjuar lakimin e figurës në diskurs dhe në planin e ideve, po rikujtojmë se figura e pasqyrës lakohet si pasqyrë me dy faqe, në rrëfimin për Batot e Ilirisë, në kryengritjen kundër Romës, që tash shenjon dyfytyrësinë e tradhtinë, për të shenjuar një fenomen nga i cili buron e keqja njerëzore. Dy faqe, dy fytyra, dyfytyrësi. Kështu i përqendron diskursin, kuptimet dhe idetë Anton Pashku ynë.

VI PODRIMJA: LUM LUMI

Ali Podrimja, te kryevepra e tij, *Lum Lumi* (1982), në tekstet e rralla personale, ashtu siç do e bën letërsia moderne, universalizon kontekstin personal, referencat e rënda të jetës, tragjedinë e humbjes së djalit e dhimbjen që s'mbaron kurrë. Kjo poezinë e tij personale e bën universale, dhimbjen e babës, dhimbje që mbështjell universin, rrëfimin e dhimbjes, figurë që shenjon jetën.

Teksti i prerë në blloqe të një kronike që shoqëron sëmundjen e djalit hapet i ftohtë e i zymtë, shenja që bëjnë *ontos*-in e tij. Ky *ontos* na largon nga referencat e para të shkrimit e të dhimbjes, drejt dhimbjes që hapet në leximin e secilit, qoftë dhe kur lexuesi s'e njeh kontekstin personal të veprës së Podrimjes.

Shenjat e mëdha letrare e emocionale, *Lum Lumin* e çojnë në katrorin e elegjisë, që kryqëzohet me dhimbjen. Por gjëma nuk ndihet në zë, meqë shtrihet në figura, në zymtësinë e diskursit, në paradoksin e shkrimit

që do ta zbrazë dhimbjen kur e shkruan duke e "fshehur "figurave. Hapjen më të madhe gjëma e Podrimjen e ka kur zbulohen figurat ambientale, të cilat janë plot me kulturën fatidike të vajit e të gjëmës shqiptare. Këto shenja sikur duan të thonë se letërsia si kjo e Podrimjes ruan iluzionin për ta bërë dhimbjen kulturë, kur e shkruan atë si kulturë. Nëse e pakëson kur e shkruan, tepër e vështirë të thuhet e të shkruhet.

Në anën tjetër, tradita tridhjetëvjeçare e leximit të kësaj vepre, paprerë e ka parë atë në kontekstin personal e nën shenjat e së vërtetës së jetës së Podrimjes. Tema e rëndë dhe fara personale e literaturës leximin e tillë e kanë lidhur me biografinë, që, vërtet, është një lidhje me kontekstin personal të autorit, pa e zbritur në lexime sociale e ideologjike. Duket hapur në leximet me shkrim të *Lum Lumit* se vepra e ka transmetuar fort zinë e dhimbjen e shkruar, madje të jetuar.

Lum Lumi ka katër cikle. I dyti, *Të jetosh*, është më i bukuri poetikisht e më i rëndi tematikisht. Ai është një perlë e zezë e veprës, ndërtuar nga poezitë për Lumin e përfshirë në qerthullin e vdekjes. Lumi e kapërcen këtë kufi, "derdhet "tej, ndërsa baba/poeti e provon vdekjen për së gjalli.

Figurat e Podrimjes te ky cikël burojnë nga emocioni, nga dhimbja. Kur hapet figura, takohet emocioni e njihet thellë dhimbja. E shoqëruar nga një fatalitet pa rrugë të dytë, figura e Podrimjes merr shenjën e një figure mitike. Vaji i Podrimjes bëhet vaj i qyqes, si në etosin e dhimbshëm shqiptar. Figura e tillë s'është dekor i temës e i strukturës, por esencë e tyre. Kur lexohet figura, lexohet zemra e qerthujve semantikë të poezisë së Ali Podrimjes.

Lum Lumi i bashkohet rrjetit të elegjive për njerëzit e dashur, të shkruara kudo e në çdo kohë. Por si të gjitha veprat e tilla, *Lum Lumi* e provon se askush nuk mund të vajtojë për Lumin si Ali Podrimja. Kjo vepër vetëm përjetohet nga të tjerët, më shumë a më pak, në leximet e secilit. Ajo hapet me frymën e me zinë e saj para shpirtit që ndjen. Emocioniet e rënda reflektojnë ide të rënda, që, përtej racios, nisen drejt shpirtit të lexuesit. Kush e lexon *Lum Lumin* i hyn aventurës së rëndë për ta njohur Ali Podrimjen, gurët e rëndë të jetës së tij, frymën e dhimbjen, Ali Podrimjen e kthyer nga vetja, madje nyjën universale të poezisë së tij.

Kthimi nga vetja është hyrje në vetënjohje, shpalim i qenies në *ontos*

poetik, në një estetikë të rrallë, që e rrallë është edhe pse tekstin e bën *quid unicum*, një ontos të cilit i mjafton vetja e hapet për të tjerët. Në këtë estetikë, leximet më autentike janë ato të teksteve pa kontekste.

VII HANXHARI: YLLI I DASHURISË

Vjersha e gjatë e Mihal Hanxharit, ndoshta më e bukura e tij, *Aldebaran* (2001), këndon dashurinë si frymë ekzistence, si ekzistencë vetë, disi në frymën semantike e filozofike të Poradecit, me shenja të tij dhe me emocionalitetin e thellë të autorit. Ikja në metafizikën e kësaj teme vërtet është kthim në esencat e ekzistencës, në erosin si përjetësi dhe në kozmosin e tij.

Vjersha është strukturuar në tetë njësi, hapet me një ekspoze, vijon me njësi të lidhura suksesivisht, si hallkat e një kërkimi apo si pamje të një teme, ndërsa mbyllet me një epilog. Njësitë janë ndërtuar në struktura të rregullta strofike, me nga pesë vargje, në të cilat vargu i fundit përsërit të parin, bëhet kurorë e strofës, por edhe i shërben strukturës ritmike të njësisë.

Vargjet janë të matura, të ndara në dysh nga cezurat, mbyllen me rima. Vargu ndahet në dysh nga cezura. Gjithë këto kushtëzojnë edhe ritmin e leximit, frymën e thënies së tekstit, qoftë edhe në një recitim të brendshëm (pa zë).

Secili varg i tekstit të Hanxharit është një metaforë, secila strofë një lidhje metaforash, secila njësi tekstore një tërësi metaforike, e gjithë poema - një metaforë e zgjeruar. Çdo strukturë i nënshtrohet figurës e retorikës së poezisë. Struktura e tillë krijon përgjasimet e lidhura të Universit, për t'u mbyllur në një Univers të ri, të gatuar e të drejtuar nga Dashuria. Shenja këto që tretin çdo kontekst dhe vjershën e lidhin me esencat ahistorike e akronike.

Aldebaran është vjershë e mistikës personale dhe universale të dashurisë, vjershë e mallit dhe e dhimbjes personale e humane. Vjershë e kërkimit të Dashurisë, si kërkim i kuptimit të jetës. Dashuria është metafora e jetës, esenca e ekzistencës. Misteri e fshehtësia mbështjellin Dashurinë si ekzistencën. Njëra e tjetra njihen e jetohen me shpirt.

Dashuria e ideologjisë së Hanxharit s'është dashuri për personin konkret, por ndjenjë që buron nga qenia, që rrëniet i ka te gjeneza e tek ekzistenca e Universit. Dashuritë konkrete mbyllen, fillojnë e rifillojnë; Dashuria universale mbetet, jeton e manifestohet në secilën qenie, në secilën

grimcë e send të Universit.

Në metaforat e pashoqe të *Aldebaranit*, Hanxhari thur aventurën e kërkimit e të definimit të Dashurisë. Dashuria është fshehtësi. Teksti i Hanxharit do të hapë palat e saj, për ta shijuar e për ta jetuar. Kjo aventurë e shpie tek yjtë, për ta gjetur dritën më shkëlqimtare, e zbret në histori e mitologji, e përplas në vetënjohje, në shpalim e çlirim të shpirtit të tij. Dashuria ndodhet kudo e kurdo, si esencë e pazhbëshme, si *njësi* e jetës. Ajo vetëm merr e jep fytyrën e gurit, të lumit, bëhet zjarr, dorë e ngrirë…

Aldebaran e provon Hanxharin poet e njeri që kërkon kuptimet e jetës përtej një konteksti konkret, në kontekstin universal të njeriut e të qenies. Më së thelli provon krijuesin e lidhur përjetë me artit, që zgjedh tinguj, rrokje e fjalë, që lidh ritmin e tekstit në një melodi të rrallë, që thur metaforat e befta, për të provuar përnjëherë fuqinë e shpirtit e të gjuhës. Struktura, sensibiliteti e ideologjia përnjëherë e bëjnë *Aldebaranin* një Aldebaran të poezisë së Mihal Hanxharit.

VIII TEKSTE E KONTEKSTE

Raporti i teksteve letrare me kontekstet, të cilin të vjetrit e njihnin si raport ndërmjet *kulturës* e *natyrës*, tradicionalisht është përshkruar përmjet mimesis-it. Keqkuptimin e parë e ka prodhuar vetë termi, i identifikuar gabimisht me *pasqyrimin*, por që, së paku, Zherar Zhenetit i ka dalë i identifikueshëm me *trillimin*.

Raporti i *letërsisë* me *jetën*, me ndodhitë, me njerëzit është ai i dy mediumeve, i pari i ngjan të dytit, por asnjëherë nuk është i dyti, pastaj, paradoksalisht, i dyti nis dhe e përsërit të parin, si te prozat e paharrueshme të Borhesit. I parë kështu, ky raport vë përkrah dy *ontos*-e, jetën si *ekzistencë e jetuar* dhe letërsinë si *ekzistencë e krijuar*. Kështu, nuk kemi këtu përjashtim a priori, por diferencim që garanton *ontos*-in estetik të letërsisë.

As këto shenja s'e përjashtojnë fuqinë determinuese që kanë kontekstet në raport me një kategori tekstesh, të cilat e forcojnë referencialitetin, sikurse që e theksojnë fuqinë njohëse të letërsisë, që, edhe kur nis nga kontekste konkrete, universalizohet dhe bëhet ahistorike. Kështu provohen shenjat e *ontos*-it letrar, ashtu sikurse që provohet se, po u treten këto shenja, rrezikohet ky *ontos* dhe teksti fiton *ontos* e funksion tjetër.

Meqë edhe fenomenet letrare provohen konkretisht, do të lidhemi këtu për raste konkrete në letërsinë shqipe, me të cilat provohet mimeza dhe ndarjet e letërsisë me kontekstet.

Gjuha poetike e Gjergj Fishtës është *substanciale* (Lasgush Poradeci), e lidhur me copat e jetës, që i merr apo që e ka iluzionin se po i merr në vete ato copa. Fishta niset nga kontekste konkrete, e shkruan tekstin e rastit, me synimin për të ndërhyrë në situatat nacionale. Por kjo gjuhë bart gjithë emocionet e emotivitetin e autorit, kur përthyhet në kritikë e nemë, për ta provuar se teksti është një lexim, pra një interpretim autorial i kontekstit. Kështu provohet se kemi të bëjmë me raport ndërmjet *ontos*-esh: letërsia e konteksti, dhe jo me subordinim të një *ontos*-i ndaj tjetrit. Ndërsa shenjat e reales, si kudo literaturës, bëhen efekt i reales, që tashmë është realja e letërsisë, e fiksionit.

Migjeni, në ekspresionizmin e tij, kur do të ketë kontekstet sociale në tekst, madje ta japë tekstin si kontekst, pahetueshëm e krijon *ontos*-in e konteksteve të përmbysura. Ekspresionizmi nga imitimi kapërcen te realja e nxirë. Migjeni shkon përtej konteksteve, tek *ontos*-et e krijuara, që janë universale. Kjo e shpëton tekstin e tij. Varfëri e të varfër kishte para Migjenit, atëherë e sot. Migjeni vetëm sa e provon këtë. Prandaj lexohet. Jo për dëshminë, por për sugjerimin.

Aventurën më të madhe utopike për ta dhënë "njeriun e ri" në "jetën e re" socialiste e jetoi socrealizmi. Në aventurën e përballjes së "personazheve pozitive socialiste" me "negativët reaksionarë", tekstet socrealiste përherë, përkundër ç'ndodh në jetë, i nxjerrin triumfues të parët. Kështu, socrealizmi niset të "pasqyrojë "realitetin "me besnikëri" e "qartësi" dhe rrëshqet në krijim realiteti skematik në gjithë korpusin e teksteve që prodhoi vetë.

Qoftë edhe socrealizmi, shkolla më skematike në letërsinë shqipe, e dëshmon se letërsia përherë prodhon variante edhe kur do të jetë referenciale me kontekste konkrete, edhe kur hapet në imagjinatën paskaj.

Tekste e kontekste është një formulë që zbulon ekzistencë të letërsisë në raport me jetën e gjallë. Por konteksti duket fort në lexime, atëherë kur tekstet "e djeshme" lexohen në kontekste të sotme. Kjo mund të çojë te lexime ideologjike, si dhe ta mbajë leximin te një dialogjizëm i lakmuar.

Kujtim M. SHALA, Prishtinë

TEXTS WITHOUT CONTEXTS

Summary

Texts without contexts prove a universal phenomenon, which the phenomenon of the texts within their internal life that were sought in the Albanian literature of the 20th century. In addition, texts without contexts make a stronger emphasis on the text with contexts and in the context they are phenomena linked to the social and political life, which is a nation's life. Modernity offer to the Albanian literature pathways for escaping from context, as a way of detaching from big ideologies. Political nuances give way to poetics, lecturing becomes part of one's individual suffering and the philosophic ideas entailed in individuals, devising their culture, and so on.

This study seeks to prove that the relationship between the literature and life, the events, and the people is that of the two mediums: the former resembling the latter, but it never becomes the latter, then, paradoxically, the latter starts replicating the former. Seen and tried in this way, this relationship puts two *onthoses* alongside each other, the life as a lived existence and literature as a produced existence.

However, neither these signs nor this study exclude the determining power they have in the contexts in relation to category of texts which strengthen the referentiality just like they emphasize the cognitive power of literature, which, viewed from the concrete contexts become universal and non-historic. This proves the signs of the literary onthos, just like it is proven that if these signs disappear, the onthos is endangered and the text gains another onthos or function.

Shaban SINANI, Tiranë

"MALLI I SHTAMPËSË" SI MIT ILUMINIST

KDU 821.18.09

"*Ratiō pro Natio* "

I.

Në fillimin e vitit 1990, kur, për herë të parë, duke shkruar parathënien e monografisë së I. Rugovës "*Vepra e Bogdanit*", m'u duk me vend të shtroja pyetjen "*Humanisti i fundmë apo rilindësi i parë*", nuk e dija se ndërkaq, në rrethet shkencore albanologjike, kryesisht ndër arbëreshët, ishte shtruar pyetja për një hershmëri më të madhe të fillimeve të Rilindjes Kombëtare, me të cilën në historiografinë letrare tradicionale njësohet iluminizmi shqiptar[1].

Për një kohë të gjatë në studimet shqiptare ka sunduar dhe ende vazhdon të sundojë mendimi se, pas dështimit të kryengritjes antiosmane të shqiptarëve që shpërtheu në sinkroni me luftën austro-turke (1689); pas dështimit të përpjekjeve të kryengritësve autokratë shqiptarë për autonomi (Ali pashë Tepelena, Kurt pasha i Beratit, Bushatllinjtë); deri në dekadën e tretë të shekullit 19, më saktë deri në shpërthimin e protestave kundër reformave të Tanzimatit (të njohura me emrin "*dekret i Gülhane*-së", 1831); jeta në katër vilajetet shqiptare hyn në një krizë shekullore. Kjo është quajtur "*kohë e rehatimit të elitave kulturore osmane në Shqipëri*", "*shekulli i heshtjes së madhe*", "*shekulli i krizës*"[2]. Në fundin e viteve 1970, kur, me mbështetjen e drejtpërdrejtë të A. Budës, u bë një përpjekje "*për të avancuar fillet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare nga vitet 1840 në vitet 1830*", ideja u kundërshtua rreptë, sepse "*ky avancim binte ndesh me dy kolosët e historisë: kushërinjtë S. Pollo dhe K. Frashëri"* dhe një tezë

[1] Për më shumë shih për këtë: Sh. Sinani, *Nga Rilindja e parë tek e dyta*, hyrje botimit *Vepra e Bogdanit* të I. Rugovës, Tiranë 1990. Idem: *Midis dy Rilindjeve: Pjetër Bogdani dhe vepra e tij "Cuneus prophetarum "në studimin monografik të dr. Ibrahim Rugovës dhe në disa studime tjera - sprovë për një vëzhgim krahasimtar*, në *Nëntori*, Tiranë 1991/1, f. 116-133.

[2] Shih F. Altimari, *Nuk kanë qenë askurrë shekujt e heshtjes*, intervistë *Shekulli*, 9 janar 2013.

disertacioni për doktoratë me këtë pretendim u votua kundër nga njëri prej anëtarëve të jurisë, me argumentin "*për mungesë të bazës ideologjike*"[3]. Mund të përfytyrohet lehtësisht se sa do të ndërlikohej pyetja nëse do të propozohej jo një ndryshim kalendari prej dhjetë vjetësh, por për një shekull, siç lejojnë faktet dhe dëshmitë e shërbyera së fundmi.

Kësaj pikëpamjeje, si argument kulturor, shpesh i është shtuar fakti që në fillimin e shekullit të 18-të tradita e shkrimeve të vjetra të autorëve veriorë vjen e shuhet, ose së paku nis të humbë vijueshmërinë, për t'ia lënë vendin një shqipeje më popullore, si ajo që zhvilluan një shekull më vonë fretnit franceskanë në Veri, sipas orientimeve të doktrinës "*cultus protectorati*", që kishte nisur të vepronte menjëherë pas *Traktatit të Pasarović*-it (1718). Ndërkaq, sa i takon iluminizmit, pikëpamja e trashëguar është se "*në Shqipëri lindi në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të*"[4].

Zbulimet arkivistike të kohëve të fundme, sidomos nga kërkimet e studiuesve arbëreshë; si dhe rivlerësimi i disa traditave të njohura edhe më herët në kushtet e shoqërisë së hapur, heqja dorë prej temave tabu, kanë çuar në qendrime kritike ndaj përcaktimit të kësaj periudhe si "*shekulli i krizës*". Në të kundërtën, me të drejtë e me argumente, propozohet teza, gjithnjë e më e përshëndetur, se kjo është periudha e një "*rilindjeje të vogël"* që përgatiti Rilindjen Kombëtare, sidomos në pikëpamje të formimit të vetëdijes etno-identifikuese të shqiptarëve dhe të homogjenizimit kombëtar të tyre. Kjo "*rilindje para Rilindjes"* ka një përtakim jo vetëm kalendarik me "*le siècle des lumières*".

Një fakt i tillë merr shumë rëndësi për shkak se letërsia shqipe në të shumtën e kohës gjatë pesë shekujve të jetës së saj e ka humbur sinkroninë me rrjedhat dominuese europiane. Përmasën europiane që ajo e fitoi përkohësisht në periudhën e humanizmit të Renesancës nuk e rifitoi më deri "*në shekullin e modernitetit*".

II.

Ishte fundi i shekullit të 17-të kur, për herë të parë, në veprën e njohur "*Cuneus prophetarum*", Pjetër Bogdani shqipton si qëllim të librit

[3] Shih Petrika Thëngjilli, *Aleks Buda dhe brezat e rinj të historianëve*, në *Aleks Buda - një jetë për albanologjinë*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 2012, f. 181.
[4] Z. Xholi, *Iluminizmi*, në *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, vëll. II, Tiranë 2008, f. 981.

të tij "*mallin e shtampësë*"[5]. Bogdani, në "*Të primëtë përpara letteraritë*", shenjon jorastësisht se "*prashtu dergjetë dheu ndë robī errëtë e verbuem, me dÿ palë niegulla të zeza mbë faqe, qi janë mpkati e të pādijtunitë*"[6]. Shkrimtarët e mëpërparshëm përmendin jo një nevojë të brendshme krijuese, por mungesën e Shkrimeve të Shenjta shqip, fatin e keq të gjuhës amtare që po "*bdarej e basthardhonej*". Prej Buzukut, deri atëherë, fjala "*Auctor* "kishte kuptimin e *Krijuesit të lartë*, *Bāsit*, ndërsa autorësia ishte një koncept jokanonik[7]. Ndërsa në poezinë e Nicolò Chetta-s ka një vetëkushtim, në të cilin autori lëvdon veten si autor, origjinën e tij "*farje së nderme*", arbëreshët, Arbërinë:

Farje së nderme *ndë Kundisë u bī*
Kolë Ketta, Vllastār i t'Arbrit dhē*;*
Shkoi Palermë, prā, ***tek e Arbrit shpī****,*
Ç'e reshti, si zogun rep ndë folē.
E veshi e ngjeshi ndë zakon, nd' urtsī;
Për ndë vapt e përtrijti ndënë hjē,
Si të veshkurin rrëmp stolis një dhrī;
E nani prift klisha kurorë i vē.
Si zog i bjerrë pra të di kraht çoi
Palermë e Kundisë, po ktej e atej;
Nderm' e Arbreshet *të gjith gramt kërkoi.*
Si krimp mundafshi gjith u zvis vethei
E ktë vistār tuar, qëndisi e shkroi,
Se të qosëj gjith Arbrin ndjer përtej[8].

---

[5] "*Ma unë, tue pasunë mālln' e shtampësë, gjithë atyne u ktheva faqenë, veç ju lutshë të më shtampohej libri, ashtu qi kur të kthenje prej dheut sinë të keshe nji qirī ndezunë n dorë*". Shih për një kontekst më të gjerë Anila Omari, *Pjetër Bogdani: Cuneus prophetarum (Çeta e profetëve)*, Tiranë 2005, f. XVIII.

[6] Po aty, f. XIV.

[7] Shih E. Paci, *Sistemi mbiemëror në Mesharin e Gjon Buzukut*, Tiranë 2011, f. 48: "*Krijuesi* emërtohet *Autore*: *O Autore, kujtou ɲ së shelbuomit sinë, qi ɲ motit së shkuom formë more ɲdë korp uman, me vertyt tande me lēm ɲ Virgjënet;* gjithashtu, te *Meshari, vep. e cit.,* f. 19/b: "*Rekordou, o Bāsi i gjithë shekullit, ɲ së shelbuomit sinë, qi ɲ motit së shkuom more formë ɲdë korp uman me vertyt tande me lēm ɲ Virgjënet*"; "*O ɛot baaſi hi ħiẓe ſeculit tuu teh clofsah truõ ħi meh atet emeh ſpirtine ſegñte ħelin e iet: per ħiẓe iete teh ieteſſe* "(Buzuku, *Missale*: 111 (248, 69, 068r, 078r).

[8] Matteo Mandalà, *Profilo storico-antologico della letteratura degli Albanesi di Sicilia*, volume I, Caltanissetto 2005, p. 616.

Pikërisht *vetëdija e autorësisë* më kishte çuar, më shumë se dy dekada më parë, në pyetjen se ç'ndodhi "*ndërmjet dy Rilindjesh*". Veprën e tij *Ghiella e Shën Mëriis Virghiër* (Romë 1762) G. Variboba e paraprin me një kushtim Hyjlindëses dhe me një tjetër kushtim për lexuesin, me titull: "*Oi ti cië diavasën* / *O ti që më lexon*", që shenjon kalimin prej kolofonit tek parathënia dhe prej "*mallit të shtampësë* "në veprën si projekt letrar.

Eshtë për t'u vërejtur se kjo vetëdije autorësie, e cila në thebin e vet ishte joanaloge me procesin e rregulluar kishtarisht për botimet, shfaqet edhe tek një rrjedhë tjetër letërsie shqipe, tek ata që shkruanin me alfabete orientale, një prej të cilëve shkruante:

"*Divan, kush pat folurë shqip?*
Ajan e bëri Nezimi!".

Ka disa *dukuri etnobashkuese* që shfaqen pikërisht në këtë periudhë në gjithë hapësirën ku jetonin shqiptarët, proces që për herë të parë del përmbi *dukuritë etnodalluese*, që nuk ishin të pakëta: qoftë historike, qoftë etnokrahinore, qoftë fetare. Në gjuhën e termave, një proces i tillë shenjon fillimin e krijimit të një ndërgjegjje bashkësie, të *vetidentifikimit kombëtar* të një populli.

1. Kur shfaqet për herë të parë në botën arbërore qëllimi "*Ratiō pro Natio"* - të mendosh për kombin? Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 17-të dëshmohet për herë të parë se arbëreshët e ndarë prej dheut të të parëve dhe arbërit që jetonin këndej Adriatikut fillojnë të mendojnë për njëritjetrin. Të paktën tri herë, në tri kohë të ndryshme, kryeparët e Himarës dhe të gjithë Shqipërisë së poshtme, në jug të Vjosës, i drejtohen me letra dhe lutje Selisë së Shenjtë, duke kërkuar prej saj marrjen e kishës së tyre në mbrojtje dhe varësi, duke u betuar në fund se nuk do të njihnin asnjë lidhje tjetër apostullimi përveçse përmes Papës[9]. Ndonëse Papati nuk e pëlqeu,

[9] Qysh më 1577, sipas N. Borgia-s, në librin "*I monaci basiliani in Albania, appunti di storia missionaria secoli XVI-XVII*", Roma 1942, himariotët kishin dhënë shenjën e parë të rieorientimit të tyre, me një dërgatë nisur Selisë së Shenjtë, që përcillte në kryeqendrën e krishterimit roman këtë kumt:

Jesus † Christus, *Papës së Shenjtë, kryetar i Romës së Lashtë, At i Jetimëve dhe Ngushëllues i atyre që Ju drejtohen,*

O Papë Suprem i Romës së Lashtë, o Zot i Shenjtë i pranuar nga të tërë, o At i Jetimëve dhe Ngushëllues i të huajve,

ose së paku nuk e inkurajoi nismën për t'u dhënë himariotëve të njëjtin status që kishin kishat arbëreshe, statusin e një *kishe unite*, me rit lindor e vartësi romane, kjo është koha kur për herë të parë lind interesimi i kishës shqiptare tek arbëreshët për shqiptarët e krishterë në këtë anë të Adriatikut[10]. Por kjo nuk pengoi që misionarë basilianë, kryeqendra e të cilëve

---

Ne, nga Himara e Epirit, priftërinj, klerikë, laikë dhe tërë shteti, gjunjëzohemi vullnetarisht duke i paraqitur nderimet Shenjtërisë Suaj.

Ju e dini, o At i Shenjtë, se që nga koha e trimit Skënderbej, Mbretit tonë të nderuar, i mbiquajtur Kastriot, askush, madje as vetë armiku i fesë së krishterë, turku i egër dhe i pabesë, me tërë fuqinë e tij të pamasë, megjithëse ditë e natë nuk na le të qetë me luftëra të vogla, për të na shkaktuar dëmtime të mëdha dhe humbje të njerëzve qoftë të vrarë në betejë apo të shpënë në robëri, nuk kishte arritur, sikundër sot, të sulmojë tri herë selinë e peshkopit, dhe më pas edhe t'i vërë flakën. Tashmë ne jemi në mjerimin më të madh: nuk kemi asnjë mjete për t'i rezistuar armikut, për të rindërtuar qelën e peshkopit, qytetet dhe rajonet e tjerë të afërm nuk janë në gjendje të na ndihmojnë. Për këtë arsye, Nikollë Gjika dhe Jorgji Katas [Ghika Niccola e Giorgio Catasë , bashkatdhetarë tanët, do të drejtohen pranë Shenjtërisë Suaj si përfaqësuesit tanë, dhe atyre, Ju kërkojmë përulësisht, Ju mund t'u jepni prova të mirësisë dhe bujarisë Suaj, që, përmes një ndihme të shpirtmadhësisë Suaj, të kemi mundësi të rindërtojmë shtëpinë e peshkopit tonë dhe të blejmë armë për të mundur t'u rezistojmë të pafeve. Mos na i lini pa plotësuar kërkesat tona, i Shenjtëruar Atë, sepse ne nuk besojmë tek askush tjetër veç tek Biri i vetëm dhe i pandarë i Trinitetit të Shenjtë dhe të Pandarë dhe tek Shenjtëria Juaj, si vikar i vetë Krishtit, në të cilin kemi pranuar emrin, edhe Ju lutemi të tërë të na plotësoni kërkesat e të dërguarve tanë.

Zoti Ynë i dhëntë lumturi Shenjtërisë Suaj dhe i sjelltë ç'ka Ju dëshironi.

Nga Himara (Chimara), d.m.th. nga Epiri i shqiptarëve, 12 korrik 1577, të devotshëm dhe në shërbim të Shenjtërisë Suaj,

Shqiptarët, klerikët dhe laikët dhe tërë shteti ynë.

Shenjtërisë dhe të dërguarit nga Zoti, Papës së Lartë të Romës, Babait të Jetimëve dhe Ngushëlluesit të atyre që i drejtohen për ndihmë.

[10] Ja përgjigjja ndaj letrës së parë të himariotëve e bregdetasve nga Papa Gregori XIII (përkthim i dr. Kristaq Jorgjit, në studimin e tij *"Misionarët basilianë në Himarë - faza I"):*

Bijve të dashur Aleks Protonotari, pleqve, popullit dhe këshillit të Himarës

Papa Gregori XIII

Të dashur bij, përshëndetje dhe bekime apostolike,

E morëm letrën nga të gjithë Ju, dhe mësuam akoma më tepër kur biri i dashur Nikolla Zahna na tregoi me hollësi. Kemi admiruar besimin, vendosmërinë dhe devocionin tuaj ndaj Selisë sonë Apostolike dhe është vërtet e papërshkrueshme sa jemi gëzuar.

I jemi mirënjohës pafund Zotit dhe me zemër ju kemi përqafuar si bij të Krishtit tepër të dashur, duke ju uruar, sepse është e drejtë që të përgëzohen dhe të lëvdohen ata që me sinqeritet dhe me respekt nderojnë Zotin, kur pranojnë dhe ruajnë të pacënuar besimin që nga apostujt e shenjtëruar i është kaluar Kishës së Shenjtë dhe Katolike të Romës, që praktikohet në çdo kohë nga priftërinjtë dhe besimtarët e tërë kohëve, që kanë për zemër shpëtimin e tyre. Kemi falënderuar Zotin dhe e falënderojmë kurdoherë, dhe ju mbajmë në zemër si bijtë nga më të mirët. I kemi dhënë Nikollës shumë gjëra që, sipas nesh, do t'ju shërbejnë shumë, dhe ai do t'jua sjellë. Ndaj ju rrini në pozitat e mira që ju ka dhuruar Zoti, dhe këmbëngulni në sinqeritetin e fesë dhe shenjtërinë e jetës dhe të zakoneve tuaja; por këtë vazhdueshmëri, që është një dhuratë e madhe e Zotit, kërkojani Zotit, sepse është Ai që jua ka dhënë vullnetin dhe që do t'ju japë ndihmën për ta përmbushur dhe çdo ditë e më tepër do t'ju mbushë me hiret dhe favoret e tij. Edhe ne do t'ju kujtojmë, sikundër ju urojmë gjithë të mirat, sikurse nuk do të rreshtim së luturi për këtë ndaj Zotit tonë.

Nga Roma, afër Shën Pjetrit, nën Unazën e Peshkatarit, më 22 dhjetor 1582 të Pontifikatit tonë XI.

ishte *manastiri i Grottaferrata*-s, me a pa pëlqimin e Selisë së Shenjtë, jo vetëm të vizitonin Shqipërinë, sidomos zonën bregdetare, prej Durrësit deri në Himarë; jo vetëm të relatonin në selitë kishtare që i kishin dërguar për gjendjen kishtare të vendit, por dhe të merrnin përsipër të kryenin detyra dhe misione të larta klerikale. Çasti kur himariotët dalin në histori me njëfarë *heterodoksie*[11], duke vlerësuar mbrojtjen e territoreve të tyre prej dhunës otomane më të rëndësishme se vartësia dhe rituali kishtar, gjithashtu shpreh një kapërcim të shenjuar drejt një identiteti bashkësie kombëtare. Në kushtet e një vendi të robëruar prej një perandorie teokratike dhe ushtarake, nuk mund të pritej një ndryshim kopernikan idesh dhe sistemesh të menduari. Por ato pak shenja *heterodoksie* që vërehen gjatë dy shekujve para Rilindjes Kombëtare janë shenja ecjeje kah etnotipi shqiptar, identiteti dhe vetëdija etnike[12]. Sikurse vërente shumë kohë më parë Vassa Effendi, shqiptarët "*n'ushëtrimin e fes ishin të lirë, çështjet familjare i shikonte kisha e tyre dhe çështjet civile dhe penale i shikonin pleqt' e vendit duke pasur në mes të tyre një gjyqtar tradisional që dinte mirë kanunin e Lek Dukagjinit: gjithë katolikët e Shkodrës, ortodoksët e Himarës, të Sulit, të Lunxhërisë, të Zagorisë e të Rrëzës formonin grupe kësodoret*"[13].

Shqiptarët bregdetas, të gjendur gjithnjë e më në tkurrje, për shkak të veprimit të ligjit "*dy për një* "të perandorisë osmane, disa herë iu drejtuan edhe perandoreshës ruse Ekaterina e Madhe dhe fuqisë së saj perandorake, për të siguruar mbështetje e simpati, ndonëse Stambolli ishte kryeqytet i perandorisë dhe njëherësh dhe i kishës bizantine. Ideja e *uniatizmit*, e një kishe të ngjashme me atë të arbëreshëve, me rit bizantin dhe varësi romane, u përhap si tek shqiptarët këndej, ashtu dhe tek misionarët klerikalë arbëreshë andej Adriatikut. Murgjit basilianë, Nilo Catalano dhe Neofit Rodotà, jo vetëm krijuan urën e parë përmbi Adriatik, duke bashkuar shqiptarët e vjetër me të mërguarit e hershëm. Nilo Catalano u shugurua kryepeshkop i

[11] Sh. Sinani. *Himara: identiteti i bashkësisë dhe etnotipi*, në: *Himara në shekuj*, bot. i Akademisë së Shkencave, Tiranë 2006, f. 327.

[12] Jo vetëm në vijën bregdetare, por dhe në *hinterland*, kisha lindore shqiptare e ndjeu të nevojshme të mbante korrespondencë dhe të kërkonte mbështetje prej Selisë së Shenjtë. Ndërmjet viteve 1671-1699 një letërkëmbim i tillë vërehej midis Patrikut të Ohrit dhe Papatit, sikurse në të njëjtat vite murgj kretienë ushtronin misione në fshatrat shqiptare në Italinë e Jugut, si Mezzojuso. Shih: Bruno Lavagnini, "*Monaci cretesi a Mezzojuso*", Κρητι 1963, p. 48-52.

[13] Vassa Effendi [Pashko Vasa] ,*E vërteta mbi Shqipninë dhe shqiptarët*, përkthim me komente i Mehdi bej Frashërit, Tiranë 1935, f. 72.

Durrësit dhe vikar apostolik i *Himarës* më *1693*, gjë që nuk kishte ndodhur kurrë më parë. Por në kontributet e tij është dhe fillimi i shkollimit shqip në hapësirën sufragane të asaj arkipeshkvie, një vektor i dukshëm iluminist. Këtij vektori i bashkohet hartimi prej tij i një "*Fjalori shqip-italisht dhe italisht-shqip"* shoqëruar me një gramatikë të shkurtër të gjuhës shqipe ["*Vocabolario albanese-italiano ed italiano-albanese*"ë , që mbeti gati një shekull në dorëshkrim dhe do të zbulohej shumë vonë, prej pasuesit të tij në detyrë G. Schirò prosenior, i cili do të njoftonte se Nilo Catalano kishte pasur në dorë veprat e F. Bardhit, P. Budit dhe P. Bogdanit, madje i "*kishte kompiluar* "fjalorin dhe gramatikën e tij prej tyre (dëshmuar prej *përzierjes së toskërishtes me gegërishten*), duke shenjuar dhe një herë se ndërkomunikimi mes shqiptarëve mbi Adriatik ishte më i hershëm se koha e zbulimit të "*Mesharit* "prej Gjon Nikollë Kazazit dhe se aktet *Kuvendi i Arbënit*. Tashmë dihet se në fjalorin që la në dorëshkrim, Nilo Catalano pati përfshirë dhe dy vjersha prej *Cuneus prophetarum* të P. Bogdanit, një provë se kishte filluar ndërkomunikimi me autorët e letërsisë humaniste të veriut të Shqipërisë. Ndërsa poezia popullore kushtuar heroit të epokës së Skënderbeut, *Pal Golemit*, përmban 37 vargje dhe është ndër*tuar mbi motivin e mirënjohur të trimit të plagosur që le porositë e fund*me[14]. Nilo Catalano, megjithëse klerik, mund të cilësohet i pari mbledhës i folklorit shqiptar, me "*Këngën e Pal Golemit"* dhe disa këngë tradicionale arbëreshe, që i tejshkroi me alfabetin greqisht dhe që janë pjesë e fjalorit dhe gramatikës së tij. Vëmendja ndaj një kulture laike si tradita gojore shenjohet si tipar i iluminizmit. Nilo Catalano, ndonëse nuk i përkiste gjenetikisht botës italo-arbëreshe (megjithëse u mësoi shqip arbëreshëve të Mezzojuso-s - Munxifsi-t), qe edhe vetë krijues. Ai shkroi disa poezi himnodike fetare, po dhe rituale-laike në gjuhën arbëreshe: *Këngë e Shën Mrīs Virgjërë Panamome*, *Këngë se s'bij shī në majt*, *Çë u kleve e zëri, o mjeri Njerī*, *Njetrë këngë Krishtit Zotinë*[15]. Kjo ndërthurje e laikes me parrokialen, e folklorit me letërsinë, theksohet në veprën e G. Varibobës, në të cilën Shën Mëria *albanizohet* si një nënë shqiptare dhe vargjet e këngës së saj për Krishtin, të

[14] Shih për më shumë: A. N. Berisha, *Në mbretërinë e simbolikës dhe të metaforave*, botuar në *Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë*, Cosenza 2008, f. 44.

[15] Shih: Matteo Mandalà, *Profilo storico-antologico della letteratura degli Albanesi di Sicilia*, volume I, Caltanissetto 2005, p. 247-253.

ngjashme me *kalimeret* tradicionale arbëreshe, nuk dallojnë as në metrikë, as në shprehjen poetike, nga nina-nanat popullore[16]:

"Zgjou, bîr, jo më gjum', Gjeq si lozën, si këndonjën,
Zgjou, se më fjëjte shum', Dhên e dêtin çëmonjën.
Jeta ime, via, m'u zgjo, Karramunxa e fishkarol,
Zgjou se bëre nino. Surdullina e rrusinjol
Vjen një lleg pekurâr Mîr bukur u nguallâr,
Pruçësjon' të vizitâr O çë vjersh të rrikrjâr!".

Duke iu përmbajtur parimit që e vërteta ndërtohet duke i vendosur faktet në një kalendar të përpiktë, ngjan se nuk ka kurrfarë rastësie që pikërisht rreth e qark kësaj date referenciale Francesco Maria da Lecce, një prelat i kishës romane, që kishte autoritet në veriun e Shqipërisë; i konsideruar prej shumëve edhe si autor i akteve të *Kuvendit të Arbënit*, do të hartonte fillimisht një *Fjalor italisht-shqip*, duke qenë i pari i huaj që ndërmjetëson shqipen me një gjuhë tjetër; dhe pastaj edhe *Vërejtje gramatikore për gjuhën shqipe*.

Sa i takon vijimësisë së klerit italo-arbëresh në viset bregdetare të Arbërisë nën autoritetin e kishës lindore, kjo zgjat afro dy shekuj dhe mjaftojnë mbiemrat patronimikë për të provuar etnicitetin e tyre: prej Neofit Rondinò-it (1628-1642) tek Basilio Matranga (1715-1721), Giuseppe Schirò prosenior (1718-1729-1741), Lorenzo Guzzetta (1730-1732), Filippo Matranga (1730-1732)[17]. Kryesimi i kishës bizantine në vijën bregdetare shqiptare dhe një orientim i saj drejt Perëndimit të sjell në mendje vargjet e N. Frashërit një shekull e ca më vonë: "*Pa jakë o dritë e diturisë / Që lind andej nga perëndon!*". Se çfarë rëndësie historike-kulturore dhe fetare kishte kjo urë ndërshqiptare dhe mbirituale në dy anët e Adriatikut në shekullin 17 dhe 18, mjafton të vërehet se ç'konkurrencë, sa e fshehtë po aq e vrazhdë, për "mbrojtjen" e numrit të besimtarëve ka ekzistuar midis kishës lindore greke dhe asaj arbëreshe në jugun e Italisë deri në vitet 1920[18].

[16] Për më gjerë për këto lidhje shih dhe Sh. Sinani, *Mitologji në eposin e kreshnikëve*, Tiranë 2000, f. 221-222.

[17] Conrad Eubel, *Hierarchia Catholica Medii et Recentioris Aevi*, vol. IV, Monasterii MCMXXXV (a Pontificatu Clementis PP VIII (1592) usque Pontificatum Alexandri PP VI 1667); vol. V, A pontificatu Clementis pp. IX (1667) usque ad pontificatum Benedicti pp. XIII (1730), Patavii 1952.

[18] S. Parenti (*studio introduttivo ed edizione con appendice di documenti editi e inediti a cura di*),

Relacionet e C. Karalevskij-t për raportet ndërkishtare ndër besimtarët e ritit lindor në viset e banuara prej arbëreshësh e grekësh në Italinë sicilo-kalabreze, të mbetura sekret deri dy vjet më parë, nuk linin jashtë vështrimit dhe gjendjen fetare në Himarë e në përgjithësi në vijën bregdetare shqiptare[19]. Kërkimet për rolin e misionarëve basilianë në Shqipëri në shekullin e 17-të e në vijim janë edhe sot një çështje hetimi shkencor ndërdisiplinar prej mjaft dijetarësh[20].

2. Pikërisht në këtë kohë në tri kryeqendrat e arbëreshëve të Italisë hapen kolegjet kishtare, që më vonë u bënë të mirënjohur në histori: seminari greko-arbëresh i Palermos (1735) i themeluar nga At Giorgio Guzzetta, i cilësuar "*un ideologista albanese*", një prekursor i asaj dukurie që në periudhën e Rilindjes do të quhej prej romantikëve "*l'albanesità*"; dhe kolegji i Shën Adrianit në Kalabri (Shën Dhimitër Korona). Në këto kolegje do të studionin edhe shqiptarë të "*Arbërisë së vjetër*". Këto dy kolegje, të konsideruar kryesisht institucione kulti, për një kohë të gjatë ishin jashtë vëmendjes së kërkuesve nga Shqipëria shtetërore. Madje pikërisht rritja e autoritetit të institucioneve kishtare në fushën e edukimit përbënte një fakt parësor për ta cilësuar shekullin e 18-të shekull të krizës. Mirëpo roli i këtyre institucioneve, megjithëse mund të ngjajë paradoksale, qe pikërisht një rol iluminist. Ato përgatitën jo vetëm klerin që duhej të ndironte kishën lindore të Shqipërisë gjithnjë e më në rënie, por dhe shkrimin shqip, vëmendjen ndaj traditës etnike, duke shkuar deri tek pyetja se çfarë jemi e nga vijmë, që është pyetja kufitare midis iluminizmit dhe romantizmit. Se çfarë dukurie ishte kjo në pikëpamjen terminologjike, *iluministe*, *postiluministe a pararomantike*, kjo mbetet një çështje e hapur për kërkime të mëtejshme[21]. Ajo që mund të pohohet me siguri është se mitet themelore të roman-

---

Cirillo Korolevskij, L'eparchia di Lungro nel 1921: relazione e note di viaggio, Fondazione Universitaria "F. Solano "2012.

[19] Cirillo Karalevskij, *La Missione greco-cattolica della Chimarra nell'Epiro nei secoli XVI-XVIII*, në *Bessarione* serie III, anno XV, fasc. V-VI (1910-1911), p. 440-483.

[20] Antonis Fyrigos, *Considerazioni sulla preparazione culturale e attività pastorale di Joannes De Camillis da Chios, futuro vescovo di Munkács (1641-1706)*, në *Da Roma in Hungaria: Atti del convegno nel terzo centenario della morte di Giovanni Giuseppe De Camillis, vescovo di Munkács/ Mukačevo (1689-1706)* - (a cura di Véghseő Tamás) Nyíregyháza 2009, *Collectanea Athanasiana* - I, Studia 2.

[21] Matteo Mandalà, *Vepra e pabotuar e at Gjergj Guxetës dhe fillimet e albanologjisë në shek. XVIII*; në *Studime filologjike*, nr. 1-2/2006, p. 11-41; *Padre Giorgio Guzzetta e la cultura del suo tempo*, Piana degli Albanesi, mars 2007; *Roli i kolegjit të Shën Adrianit në marrëdhëniet shqiptaro-ar-*

tizmit shqiptar: miti i lashtësisë, miti pellazgjik[22], miti i gjuhës amtare[23], miti i lavdisë së kryehershme, lindën bashkë me këto seminare dhe kolegje, ku kufiri midis dogmës dhe shekullares nuk ishte aq i përcaktuar. Kësaj periudhe i takon një prej fakteve më të rëndësishëm të historisë së kulturës shqiptare. Në vitin 1736 G. Schirò prosenior u emërua arkipeshkv i kishës ortodokse shqiptare prej Durrësit, Vlorës e Himarës dhe më në jug. Në këtë detyrë ai i drejtoi Papa Benedicti-t XIV katër letra shqip e latinisht. Vetë ky fakt "*siguron vërtetësinë e pohimit të bërë nga vetë Skiroi në kujtimet e tij, se ai qe i vetmi në atë asamble [kishtareë që u dëgjua të votojë në tri gjuhë të ndryshme: latinisht, epirotisht (= shqip) dhe greqisht*"[24]. Ky ndryshim statusi i raportit të shqipes me latinishten në një letërkëmbim zyrtar me hierarkinë e lartë të Selisë së Shenjtë shenjon një *kapërcim historik pararilindës*. Për herë të parë autoriteti i shqipes rritet në shkallën e barazisë së plotë me latinishten. Për më tepër, latinishtja nuk është më gjuhë e garancisë, është një lehtësi komunikimi. Në afro tre shekuj *letërsi të impenjuar*, letërsi të shërbesës kishtare, kjo nuk kishte qenë e mundur. Pavarësimi i shqipes nuk është rastësor në këtë kalendar. Qysh në fundin e shekullit të 17-të dhe në fillimin e shekullit të 18-të kishte nisur *epoka e alfabeteve, fjalorëve dhe gramatikave* të gjuhës shqipe, që provojnë ndërveprimin e saj me gjuhë të tjera[25]. Nilo Catalano më herët kishte arritur të hapte dhe shkolla shqip, në shtëpinë e Bixhilëve në Himarë.

Në të quajturin "*shekull i dremitjes"* ndodhën zhvillime historike europiane që kishin prekjen e tyre në Ballkan. Më i rëndësishmi prej tyre ësh-

bëreshe, në: *Shkodra, arbëreshët dhe lidhjet italo-shqiptare*, Shkodër 2010; *Sul dizionario etimologico inedito di Marco la Piana*, në: *50 Jahre Albanologie an der Ludwig-Maximilians-Universität München*, Muenchen 2011, p. 21-22.

[22] Shih: Matteo Mandalà, *Prejardhja e mitit pellazgjik: Jeronim De Rada dhe Giovanni Emanuele Bidera*, në: *Gjurmime filologjike për letërsinë romantike arbëreshe, Tiran*ë 2012, f. 42-70.

[23] Shih, për shembull, kushtimin me të cilin G. Variboba i drejtohet Shën Mërisë me lutjen për t'ia pranuar veprën në gjuhën amtare: "*Kjo çë të rrëfien gjith gjellën tënde, gjith harêt edhe dhulluret e gozhdët çë të shpuan zëmërën kûr ishe ndë ktë jet'. Nj' atër kënk si kjo çertu se ne e kê pasur maj, ne mëngë t'Arbëresht e kanë pandehjur. Ësht gjuha arbërisht aq frushkullorea, aq çota, aq e përbëtalëmea, sâ me të duket se jo jatër fjalë mund thuhen, mose mallkime, nëm', të shara, o veramende për turp. Ma për racjona, për predhika, për shërbise spirituâll e për urtërî ndë do të beç të qeshënjën sa ze fill e fol arbërisht".*

[24] B. Demiraj, *Zef Skiroi (prosenior) dhe shkrimet e tij shqip drejtuar Papë Benediktit XIV*, në ANASH, viti I, nr. 2/2006, f. 9.

[25] B. Demiraj, *Zef Skiroi (prosenior) dhe shkrimet e tij shqip drejtuar Papë Benediktit XIV*, në ANASH, viti I, nr. 2/2006, f. 7-14.

të apostullimi në krye të Selisë së Shenjtë i *Papa Clemente XI*, i mbiquajtur "*Albani*", nismëtar i tri veprave bazale për historinë, të shkuarën dhe të ardhmen e shqiptarëve: botimi i *Illyricum Sacrum* [Riceputi, Farlati, Coletti] në nëntë vëllime, që me të drejtë është konsideruar një *enciklopedi e botës iliro-shqiptare*; mbajtja e Kuvendit të Arbnit në Mërqi të Mirditës dhe emërimi i Vinco Zmajević-it arbëresh në krye të arkipeshkvisë së Tivarit.

Thuajse në këtë periudhë perandoria napoleoniane u shtri në gjithë faqen bregdetare të Adriatikut, deri në Shkodër, duke u dhënë mundësi popujve vendës të zgjoheshin. Në Kroaci shpërtheu "*iliridsko vstanie* "- "*kryengritja ilirike"* dhe heronjtë e saj lëvdoheshin duke i quajtur "*ti, hrvat, s iliridskom srdce"* - "*ti, kroat, me zemër ilire*". Tek shqiptarët ishte gjeneralizuar etnonimi i ri, *shqiptar*, që ishte përdorur për herë të parë në shkrime në vitin 1702. Të fundit që u larguan nga vendi i lindjes me etnonimin e vjetër, *arbëresh – arbënesh*, qenë shqiptarët e ngulimit të Zarës. Të mërguarit e mëvonshëm: në Mandrica, në Odesë, quhen shqiptarë. Kleri katolik, i ndjerë disi më i mbrojtur prej "*capitulationes"* që iu njohën perandorisë biqefale "*të shenjtë romake*", u gjallërua. Duke lënë mënjanë kronikat historike dhe udhëpërshkrimet e konsujve dhe pelegrinëve të huaj, eposi *Alipashaida* i Shehretit të Devlinës, me mbi 10 mijë vargje, njofton se "*veziri i Janinës* "bisedonte me perandoritë e mëdha për një Arbëri tërësore. Një dekadë e ca më vonë, më 9 gusht 1830, do të ndodhte masakra e Manastirit, ku humbën jetën pabesisht, të thirrur në një "*kuvend pajtimi"* 800-1000 krerë e kapedanë shqiptarë kryengritës[26], ngjarje që e ka përshkruar në gjithë përmasën e saj tragjike shkrimtari I. Kadare në novelën *Komisioni i festës* (*Pashallëqet e mëdha*, 1981). Një fakt tjetër që nuk është trajtuar prej historiografisë shqiptare meriton vëmendje: në këtë kohë kufijtë administrativë të sanxhaqeve osmane në hapësirën shqiptare u shthurën: kufij të tjerë vepronin: tri pashallëqet - i Janinës, i Beratit dhe i Shkodrës e kishin prishur hartën administrative të sulltanit. Para despotëve shqiptarë, kufijtë e Perandorisë i kishin dërrmuar *kleftët*, *hajdukët* dhe *komitët*[27]. Disa autorë madje kanë shkruar që herët jo për pashallëqe, por për "*republika*

[26] Miranda Vickers, *The Albanians: A Modern History*, edit. I. B. Tauris 1999, p. 24. Gjithashtu: *Historia e popullit shqiptar*, bot. i ASH, vëll. I, kreu *Shqiptarët nën sundimin osman*, nënkreu *Pashallëqet e mëdha shqiptare*, f. 452, Tiranë 2002.

[27] I. Koçollari, *Policia sekrete e Ali pashës*, vëll. I, Tiranë 2004, f. 33-150.

shqiptare", të lindura në kushtet e rënies së autoritetit të Perandorisë Osmane, të zgjimit të popujve ballkanas dhe të ndikimit të Francës napoleoniane[28].

Shqiptarëve emrin e pararadhësve të tyre ua kishin zënë kroatët. Në mesjetë ata e quanin veten epirotë ose maqedonas. Brendapërbrenda tyre ishin bashkuar në etnonimin e ri, "*shqiptar*"[29]. Por si do të njiheshin në botë? Nëse Rilindja Kombëtare Shqiptare e gjeti të zgjidhur këtë problem, siç gjeti të gatshëm mitin e origjinës, kjo i kushtohet pikërisht lëvizjes mendore që kishte lindur më herët tek arbëreshët. Qysh më 1777 Nicolò Chetta shkruante: "*Fallem nddersë t'Arbrit/ ggiacu't culluam farëmirit"*[30]. Dy veprat e tij: *Vocabolario albanese della parlata arbëreshë di Sicilia* (i mbaruar në një variant të parë me 240 fletë dhe i përmbyllur më vonë me 640 fletë, ku janë shenjuar rreth 10 mijë fjalë) dhe *Vocabolario etimologico della lingua albanese*, shkrimet letrare dhe etnografike, një sonet (i pari në shqip)[31] dhe mbi të gjitha përpjekja për të gjetur një *prius parens* shumë të hershëm të shqiptarëve dhe arbërve, deri tek pellazgët, ishin veprime përgatitëse të një epoke të mëvonshme iluministe[32].

Tezën e prejardhjes pellazge të arbërve e kishte trajtuar qysh në vitin 1834 dhe Giovanni Schirò, në librin *Rapporti tra l'Epiro e il Regno delle due Sicilie: memorie*, një tekst i shkurtër me 35 faqe, shtojcë e veprës *Sugli Albanesi: ricerche e pensieri* dhe e pandashme nga *Memoria su di alcuni costumi degli antichi greci*[33]. Nga N. Chetta kemi dhe: *Barisia e gjith Rruzullimit*, poemë e plotë me motive fetare me 76 strofa tetëvargëshe dhe prozën e gjatë teozofike *Ndëlgisa e Barisisë të gjith Rruzullimit*, dhe 14 vjersha të tjera[34] heterometrike, heterostrofike, heteroritmike, provë e një dhuntie krijuese poetike e retorike të kultivuar. *Rruzullimi*, si fjalë-çelës,

---

[28] Në librin e tij *Albania: Past and Present*, New York 1919, p. 44, duke përshkruar vështirësitë e sundimit të Ali pashës, përmend refuzimin e "*the Christian Albanian Republic of Suli*", dhe mosbindjen e pashallarëve shqiptarë të veriut.

[29] Më gjerësisht në studimin e B. Demirajt *Albanian - Shqiptar*, Tiranë 2010.

[30] Nicolò Chetta, *Tesoro di Notizie su de'Macedoni*, § 250.

[31] U botua për herë të parë në vitin 1777, në ballinën e librit të tij *Tesoro di notizie su de' Macedoni*.

[32] Krhs: G. De Rada, *Divinazioni Pelasgiche*, 1840; E. Bidera, *Quaranta secoli - Racconti su le due Sicilie del Pelasgo*, Napoli 1846-1847.

[33] U botua në Palermo më 1834.

[34] Matteo Mandalà, *Profilo storico-antologico della letteratura degli Albanesi di Sicilia*, vëllimi I, Caltanissetta 2005, p. 506-651.

vjen në poezinë shqipe nga P. Bogdani te N. Chetta, prej këndej te Pjetër Zarishi, i cilësuar si më i hershmi i rilindësve[35]. Në njërën prej poezive të N. Chetta-s, në tetë vargjet që përmban, emri i vjetër i shqiptarëve përmendet tetë herë:

*Kush **Arbërit** së ruan krahtë me gjak, edhè*
__Arbr__ s'isht, e gjakunë e dhelprësë ka,
*I ndritm **Arbr**, e i nderm, kurrë thënë kle*
*Kush të huajt ndih, përkëmb **Arbrinë** tha.*
*Përse **Arbri** ndien dhunë, ka nder, e he,*
__Arbri__ qime ndërroi, zakonë s'e la.
*Me kordhë, me tifek, **Arbri** përble,*
*Për gjakun e tij po gjak **Arbri** dha*[36].

3. Në anën e këndejme të Adriatikut po ndodhnin gjëra të ngjashme. Shekulli i 18-të me të drejtë është cilësuar "*shekulli i Voskopojës*"[37]: me akademinë e vet [Hellênikon Frontistêrionë , shtypshkronjën, kodikët, librat e shumtë që u shtypën; me fizikën, metafizikën dhe mbi të gjitha *Protopeiri-n*ë[38] [*Πρωτοπειρία*, *Fillestar*, libër leximi, Venezia 1770], *Logjikën*, *Metafizikën*, *Fizikën* dhe fjalorin trigjuhësh me mbi njëmijë fjalë të shqipes të T. Kavaliotit[39]; me *Isagogjinë* [*Εισαγωγια* - *Mësimet elementare*, Venezia 1802ë të Daniel Adhamit; me alfabetet, me fjalorët dy- e tregjuhësh të M. Boçarit dhe me gramatikat e para të shqipes, një prej të cilave ajo e Jani Velarait (Ιωάννης βηλαράς), që u hartua për t'u dhënë mundësi grekëve të mësojnë shqip[40]; me bibliofilinë dhe bibliofilët, me "*miqtë e dijes dhe të*

[35] Milazim Krasniqi, *Soneti në poezinë shqipe*, Prishtinë 2005, f. 42-45.

[36] Matteo Mandalà, *Profilo storico-antologico della letteratura degli Albanesi di Sicilia*, vëll. I, Caltanissetta 2005, p. 617; edhe: G. Schirò-Clesi, *Il termine "Arbër "in una poesia inedita di Nicola Chetta*, në *Shêjzat*, 1966/9-12.

[37] Për karakterizimin e kësaj periudhe më gjerësisht shih: P. Xhufi, *Shekulli i Voskopojës: 1669-1769*, Tiranë 2010.

[38] "*This lexicon was republished by the German scholar Johann Thunmann from Halle with a Latin translation in 1774 and is of linguistic interest for students of both Albanian and Aromanian*". Shih Robert Elsie, Historical Dictionary of Albania second edition, *The Sacrecrow Press*, United Kingdom 2010, p. 227.

[39] A. Uçi, *Filozofia e Teodor Anastas Kavaliotit*, Tiranë 2004. Sh. Sinani (bot.): *Kodikët e Shqipërisë*, Tiranë 2003.

[40] Mjek në oborrin e Ali pashë Tepelenës prej vitit 1801, poet i njohur grek, Iani Velarai është autor i shenjimeve gjuhësore greqisht-shqip në trajtën e një gramatike. Shkroi shqip me një alfabet prej 30 grafemash me sistem bazë atë të latinishtes, plotësuar me shenja të greqishtes. Dorëshkrimi i tij ruhet në Bibliotekën Kombëtare të Parisit (suppl. gr. nr. 251, p. 138-187). Për më shumë shih: Jorgo Panajoti, *Të dhëna nga kultura popullore shqiptare në një dorëshkrim të Jani Vellarait (1801)*, në *Kultura popullore*, Tiranë 1999, nr. 1-2, f. 33-39.

artit "si mitropoliti i Beratit Anthim Aleksudi[41]. Në po atë kohë në Janinë themelohet gjimnazi "*Zosimea*", me prirje të njohura iluministe[42]. Akademia e Re e Voskopojës nuk ishte thjesht një gjimnaz fetar[43], aq më pak "një qendër ortodoksie" apo një dukuri kulturore greke. Protopeiria përmbante rreth 1200 fjalë shqip-greqisht dhe arumanisht dhe ishte "libër shkollor", që do të thotë se mësohej dhe shqip[44]. Kavalioti njihte drejtpërsëdrejti iluministët francezë, citonte Dekartin dhe Laibnicin[45]. Librat e kësaj akademie botoheshin në Venecia dhe mësimdhënia ishte trigjuhëshe. Eshtë shekulli i fjalorëve (Francesco Maria da Lecce, Marko Boçari), që të kujtojnë enciklopeditë e iluminizmit europian; i akademive (si ajo e Voskopojës), i bibliotekave të dorëshkrimeve dhe botimeve, i gjimnazeve, seminareve dhe kolegjeve; i gramatikave, i tipografive, i "*mallit të shtampësë* "që kishte shpallur me kohë P. Bogdani. Në këtë periudhë Jani Evstrat Vithkuqari (†1822) harton një fjalor trigjuhësh prej afro dymijë fjalësh, shqip-greqisht dhe anglisht, për të cilin Martin Leake do të shkruante me simpati duke e përmendur si burim parësor në botimin që i bëri në përbërje të veprës së tij Travel in Northern Greece, në shtojcën gramatikore[46]. Gjatë viteve të udhëtimit nëpër Shqipëri (1806), konsulli francez François Ch. H. L. Pouqueville pati në Përmet një udhërrëfyes shumë të ditur, që ia lehtësoi kërkimet, jo vetëm sepse njihte shkëlqyeshëm gjuhën frënge, por edhe sepse ishte një mendimtar i qytetëruar. Ai quhej Kostandin Duka dhe ishte formuar si iluminist në bulevardet, kafenetë dhe rrugët e Parisit, ku kishte jetuar bashkë me protagonistët e "*le siècle des lumiere*". Pak gjë dihet për këtë figurë, përveçse që bënte pjesë në këshilltarët e Ali pashës dhe inkurajonte idenë e një shteti shqiptaro-grek, jashtë Perandorisë Osmane. Por

[41] Pierre Batiffol, *Les manuscripts grecs de Bérat d'Albanie et le Codex Purpureus* Φ, Imprimerie Nationale, Paris 1886. Citohet sipas botimit shqip në *Kodikët e Shqipërisë*, Tiranë 2003, f. 25.

[42] "The similar to academies known to have existed in Bucharest, Iaşi, Constantinople, Metsovon, Janina, Mt. Athos, and Patmos". Shih Robert Elsie, Historical Dictionary of Albania second edition, The Sacrecrow Press UK 2010, p. 477.

[43] "The New Academy was not an exclusively theological institution. Idem, ibidem, p. 477.

[44] Idem, ibidem, p. 227.

[45] "He was been familiarizing himself with the works of Descartes, Malebranche, and Leibniz". Idem, ibidem, p. 227.


[46] "The greater part of the information upon which the following remarks are founded, was derived from Evstratio of Viskuki, who holds the rank of Hieroceryx in the Greek church, and had been many years school-master in Moskhopoli "(Voskopoja). Shih Robert Elsie, Historical Dictionary of Albania second edition, The Sacrecrow Press UK 2010, p. 270.


dihet mirë se mbiemri *Duka* del në Frashër qysh në regjistrimet më të hershme të popullsisë prej administratës osmane. Ai e zhvilloi veprimtarinë e tij në të njëjtën kohë me "*shekullin e Voskopojës*". Sipas K. Frashërit, Kostandin Duka ishte shkolluar në Paris dhe e la pa mend Pouqueville-in jo vetëm me formimin e tij në frymën e enciklopedizmit europian, por dhe me pragmatizmin e tij të habitshëm: thellësisht antidespotik në bindjet e tij iluministe, ai i shërbente një despoti si Ali pasha, duke argumentuar se kjo ishte më e mira për shqiptarët. Në vëllimin e dytë të *Historisë së Shqipërisë* emri i tij përmendet me një fjali, si mendimtar iluminist dhe organizator ushtarak e komandant në kryengritjen e prijësve nacionalistë rumunë në vitin 1821. Me dituritë e tij ndikoi në suksesin e udhëpërshkrimeve të Pouqueville-it njësoj si Thimi Mitko në rastin e konsullit austriak J. G. von Hahn. Kësaj kohe i takon *Dittionario Italo-Albanese* i Francesco Maria da Lecce-s[47], *Kuvendi i Arbënit*, *Gjella e Shën Mërisë së Virgjër*. Në këtë kohë shpallet interesimi i *International Bible Society* për përkthimet ungjillore në shqip me alfabete greqishte dhe më vonë shqip. Kjo sinkroni midis shqiptarëve, në formën e një zgjimi dhe evokimi të kujtesës historike, gjuhësore dhe kulturore, a nuk mund të quhet pikërisht një ndriçim iluminist i njëkohshëm me atë europian, kryesisht francez? E quajtur *një rilindje e vogël* para Rilindjes së madhe, kjo periudhë shenjon rivendosjen e urave përmbi Adriatik, e tejkalimit të zhvillimeve të ishullzuara të deriatëhershme. Pikërisht duke qenë një periudhë e tillë, e sunduar prej idesh iluministe në atë kuptim si kuptohej *le siècle des lumières* në Francë, ajo nxiti zhvillime shpirtërore konvergjente, njësuese, që në periudhën e Rilindjes u bënë dominuese. Dhe kjo është arsyeja pse kjo periudhë meriton vëmendje shkencore në kuadër të qindvjetëshit të shtetit shqiptar. Miti i shtampës, miti i librit, miti i tipografisë, i akademive, i gramatikave dhe fjalorëve; i kolegjeve dhe seminareve; i identitetit dhe lashtësisë, si dhe rifillimi i lidhjeve midis shqiptarëve në dy faqet e bregdetit; bëjnë të kuptohet se dukuria e iluminizmit nuk ka qenë ishullore, por me një përhapje ndërballkanike. Të gjitha këto ndodhën prej *mallit të shtampësë* (1685) deri kur, një shekull e ca më vonë, pikërisht shtampa do të bëhej tribuna e mendimit romantik shqiptar, e lëvizjes mendore kombëtare, e riorientimit përfundimtar të

[47] Francesco Maria da Lecce Shkodër 2009.

shqiptarëve kah vetja, me përfytyrimin iluminist kah *gjithëmësonjëtoreja* dhe akademia; me veprimin praktik për një shkollë dhe një alfabet. E nisur zakonisht prej *Enciklikës* së Naum Veqilharxhit (1846), në historiografinë letrare shqiptare ka pasur shpesh tejkalime të kriterit të kronologjisë, duke mos vënë në vendin e merituar një emër si ai i arbëreshit Vincenzo Torelli, botues i ardhshëm i veprave të De Radës, i cili qysh më 1833 kishte themeluar revistën *Ombinus*; pastaj Francesco Crispi me *L'Oreteo* (1838-1839), për të ardhur tek *L'Albanese d'Italia* që themeloi De Rada pikërisht në vitin revolucionar të bashkimit të Italisë, më 1848, e para tribunë e mendimit atdhetar shqiptar.

Duke qenë se historia e letërsisë, si çdo histori tjetër, ka si parim themelor renditjen kronografike të fakteve dhe periodizimin e tyre sipas kritereve kohorë, faktet e reja që kanë dalë në dritë mund të bëjnë të detyrueshëm një periodizim të ri të saj, që do të përfshinte shekujt ndërmjet letërsisë humaniste dhe asaj romantike, prej Bogdanit tek De Rada, një periudhë e mbushur me fakte të rëndësisë kulturore parësore, ku bashkohen dukuri iluministe, postiluministe dhe pararomantike. Hipoteza jonë ka në thelb propozimin që raportet e zhvillimeve shqiptare me iluminizmin francez të shihen me të njëjtin elasticitet si raportet e shkrimeve të para shqipe me Reformën e Kundërreformën: letërsi humaniste në gjuhët popullore, por pa protestanizëm, pa lëkundje të pozitës kishtare, si në vendet e Europës Qendrore.





Një nga letrat greqisht të Patrikut të Ohrit Atanasio II drejtuar Selisë së Shenjtë më 1669. Për letrat e himariotëve drejtuar Papatit shih ilustrimet (fac-simile) në: Sh. Sinani, art. cit., "*Himara: identiteti i bashkësisë dhe etnotipi*".

DEPËRTIMI DHE PËRSHTATJA E HUAZIMEVE ANGLEZE NË GJUHËN SHQIPE

Materialet e tryezës shkencore të organizuar nga Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 27 qershor 2013 në Prishtinë botohen sipas renditjes së leximit në Tryezën shkencore.

Rexhep ISMAJLI, Prishtinë

PSE TË SHTROHET TANI DHE KËTU NJË TEMATIKË E KËTILLË?

KDU 811.18'373.45

Në historinë e gjatë të kontakteve me gjuhë të tjera gjuha shqipe ka marrë fjalë, shprehje e mjete që i janë nevojitur komunikimit midis folësve të saj në rrethana të ndryshme. Me kohë fjalët e huazuara që janë bërë pjesë e bërthamës shqipe u janë shtruar ligjësive të zhvillimit të saj dhe i kanë humbur shenjat dalluese e të qenit fjalë e huaj. Kështu p.sh. vetëm ata që kanë njohuri filologjike mund ta dinë se fjalë si *drapër, lakër, presh* janë nga greqishtja e vjetër, *gjel, qen, peshk, mriz* apo *qelq* nga latinishtja, ndërsa *rend, grusht, porosi* nga sllavishtja, sakohë që më lehtë e shohin se fjalë si *domaqin, opçinë,* janë nga sllavishtja më e re, *penxhere, xhezve, fiqir* a *shehër* nga osmanishtja, e shumë të tjera nga gjuhët romane (italiane, frënge, spanjolle, por edhe romane të përbashkëta), nga gjermanishtja, etj.

Historiku i huazimeve, kontekstet dhe fushat semantike në të cilat janë përfshirë ato më së shumti flasin për rrethanat në të cilat bashkësia shqipfolëse ka ndjerë nevojë të merrte fjalë në momente të caktuara dhe për kontekste përkatëse pikërisht nga njëra gjuhë dhe jo nga të tjerat.

Konteksti i anglicizmave

Kontaktet e shqipes me anglishten tashmë kanë një histori krejt specifike në kuadër të tërësisë së kontakteve të shqipes me gjuhë të tjera: derisa me italishten ka pasur dhe vazhdon të ketë kontakte të pandërmjetme fqinjësore me epërsi prestigji kulturor e tjetër të italishtes mbi 10 shekuj, ashtu si me greqishten bizantine e të re, në të dy rastet dhe me diferencime hapësinore brenda shqipes sa i përket intensitetit të ndikimit, me gjuhët sllave të jugut njësoj, me turqishten me shtrirje në tërë arealin, paçka se edhe në atë shtresë pasqyrohen ndonjëherë dallimet dialektore të shqipes, ndërsa kontaktet me gjuhët e tjera moderne nxjerrin në pah diferencime të ndryshme: të orientimit kulturor brenda hapësirës shqiptare e të intensitetit të kontakteve të tjera; deri nga fundi i shekullit 20 vijonte tradita e ndi-

kimeve romane – italiane e frënge, sidomos në fushën e ndërkombëtarizmave; gjuhët sllave të jugut (serbishtja e maqedonishtja) kanë ushtruar ndikime të ndjeshme në shqipen në Kosovë, në Maqedoni, në Luginën e Preshevës e në Mal të Zi, në saje të situatës në të cilën statusi i shqipes nuk ishte i barabartë me këto gjuhë, ndërsa në Shqipëri është ndjerë ndikimi i rusishtes në periudhën e komunizmit për pasojë orientimi ideologjik; greqizmat janë ndjerë kryesisht në Shqipëri, ndërsa në Kosovë dhe ish-Jugosllavi është ndjerë më shumë ndikimi i gjermanishtes, qoftë përmes serbokroatishtes, apo edhe përmes kontakteve direkte pas viteve ,60 të sh. 20, kur u krijua një shtresë folësish të gjermanishtes, në fillim midis gastarbajterëve, më vonë tek brezi i ri dhe diaspora e fuqishme në vendet gjermanishtfolëse.

Në përmasat që kanë sot, anglicizmat në gjuhën shqipe janë fenomen i ri dhe ky fenomen i gjithpranishëm tash u detyrohet rrethanave: kontakte të pandërmjetme dhe kryesisht pësuese te diaspora tashmë një shekull në Amerikë, ndërsa kontakte edhe kohësisht të përthyera me trungun ballkanik: deri në vitet ,90 të shekullit të kaluar kryesisht të reduktuara, ndërsa pas rënies së Murit të Berlinit më të gjera dhe me epokën e globalizmit tani të përgjithësuara. Sot pak a shumë e tërë bota shqiptare ka kontakte intensive me gjuhën (apo gjuhët) angleze në të gjitha rrafshet. Ndryshimet që ndodhën në dy dekadat e fundit në botë, në përgjithësi, dhe në botën shqiptare, në veçanti, proceset e globalizimit, përgjithësimi i komunikimeve elektronike, demokratizimi i shoqërisë shqiptare dhe proceset e integrimit të saj në rrjedhat demokratike europiane, çlirimi dhe pavarësimi i Kosovës, prania protektorale e mekanizmave të Kombeve të Bashkuara dhe ndërkombëtare në Kosovë pas Luftës së vitit 1999, hapja, normalizimi dhe intensifikimi i komunikimeve të botës shqiptare në Ballkan me diasporën, rritja e veprimtarive kulturore, proceset e integrimeve ekonomike dhe orientimi drejt integrimeve të përgjithshme në ekonominë e tregut dhe në botën euro-atlantike i tërë botës shqiptare, kanë krijuar një hapësirë shumë të gjerë të qarkullimit të dendur të fjalëve, të shprehjeve dhe të mënyrave të të folurit të gjuhës angleze dhe me to edhe të tjera ndërkombëtare në gjuhën shqipe në një shkallë që ajo nuk e ka njohur më parë. Francezët, spanjollët, gjermanët e të tjerët, që kishin qenë në raporte intensive me botën britanike e tejoqeanike më herët, e kishin hetuar këtë prani dhe trysni

mbi gjuhët e tyre me kohë. Për të shënuar proceset e tilla ishin krijuar madje edhe shprehje të veçanta si Franglais, Spanglish, Denglish, etj. Përdorimet e anglishtes në Kosovë në dy dekadat e fundit kanë qenë shumë të dendura: në saje të statusit të mekanizmave ndërkombëtarë politikë, ekonomikë e ushtarakë të pranishëm dhe për shumëçka drejtues të rrjedhave zhvillimore në vend e në rajon, ashtu si dhe të statusit të gjuhës edhe formalisht zyrtare në Kosovë në periudhën e UNMIK-ut, të gjuhës faktikisht zyrtare në vijim, të gjuhës së dokumentacionit që në shumë situata bëhet burimor në versionin anglisht, në përdorimet e shqipes në hapësirat administrative, politike, e me komunikimet elektronike edhe gjerësisht kulturore, prania dhe ndikimet e anglishtes në gjuhën shqipe janë bërë të kudondodhshme.

Mungesa e mekanizmave të organizuar dhe efikasë për kontrollimin e tyre në raport me rrjedhat zhvillimore të shqipes në gjerësinë aktuale të përdorimit ndërkombëtar dhe të përballjes me këto realitete jo vetëm në Kosovë ka bërë që këto ndikime shpesh të duken dhe të dalin përtej rrjedhave normale të ndikimit për pasojë kontaktesh. Në shumë aspekte këto rrjedha po reflektohen drejtpërsëdrejti në zhvillimet e shqipes standarde dhe tjetër në të gjitha përdorimet e saj, me pasoja tashmë të hetueshme.

Kontaktet e drejtpërdrejta me botën britanike e amerikane: më shumë me botën amerikane përmes diasporës, ndërsa sot të intensifikuara në këtë drejtim edhe për rrjedhojë të rritjes së kontakteve me botën dhe administratën amerikane në të gjitha drejtimet e fushat në Shqipëri e në Kosovë. Anglishtja e kontakteve tona vjen nga të gjitha burimet dhe me të gjitha varietetet: britanike, amerikane, madje edhe indase në kohën e UNMIK-ut, anglishtja e europianëve dhe të tjerëve.

Ndërkombëtarizmat

Kemi një situatë ndërkombëtarizimi në të cilën anglicizmat hyjnë jo vetëm përmes kontaktit të drejtpërdrejtë, po edhe përmes gjuhëve të tjera: përmes italishtes (handikapat), përmes serbishtes, përmes rusishtes më herët, apo përmes burimeve të tjera ndërkombëtare.

Kemi ndërkombëtarizma që vijnë si anglicizma apo me ndërmjetësim tjetër, po edhe *angloromanizma*, të cilat shprehin dhe historinë e raporteve romano-angleze, në një anë, dhe romano-shqiptare, në anën tjetër.

Në Kosovë terma si *ekspres, viadukt, telegram, centrifugë, tunel, trampa, lift, vagon, stjuardesë, propeler, komfor, lokomotivë, kabinë, pulman, buxhet, trust, çek, standard, prolongim, rekord, partner, bojkot, shtrajk, shou, tabu, intervistë, intervju, raport,* etj. kanë hyrë me rrugë të ndryshme, shpesh vështirë të identifikueshme, me rrugë kulturore, me ndërmjetësim gjuhësh të tjera, si romanizma, anglicizma, ndërkombëtarizma, etj. Ndërkaq, veçohen qartë si anglicizma: *blof, blef, autsajtder, poker, pullover-pulover, set, sllogan, sprej, sprint, ten-tank, taksi, trend, trendi, uikend,* etj. Rrugët e depërtimit dhe veçoritë e përshtatjes së anglicizmave në gjuhën shqipe duan parë sipas fazave të ndryshme dhe kohëve në të cilat ka pasur kontakte eventuale. Ta zëmë, në fushat e sportit kishte më shumë huazime të tilla në faza më të hershme, ndërsa në fushat e elektronikës, të kompjuterizmit, të ekonomisë së tregut, të filmit, të muzikës argëtuese moderne e të shou biznesit ka më shumë në kohët e vona dhe kryesisht nga burime amerikane. Megjithatë, në kohën tonë fushat e depërtimit të anglicizmave janë aq të shumta sa nuk e vlen të veçosh vetëm ndonjë syrersh. Hyjnë edhe fjalë të tilla si *asamblist, bitnik, kornfleks, dajxhest, xhoging, kamping, hobi, xhob, song, kull,* etj.

Dhe fjalët që zakonisht i gjejmë të huazuara në shqipen në mënyrë kaq stihike dhe të pakontrolluar sot, pak më herët i gjenim nëpër gjuhët e ndryshme europiane, madje në frëngjisht e gjermanisht, prandaj ka të rinj që ndonjëherë flasin për *Kosovaenglish*, sipas modelit *Franglais, Denglish, Spanglish*, etj.

Derisa në kompjuterizëm gjendja është vërtet e atillë që shpesh të rrëmben pesimizmi, gjendja nuk është krejtësisht e kënaqshme as në fusha të tjera si, ta zëmë, gjuhësia: më herët në këtë fushë studimesh kishim më shumë terminologji sipas traditës greko-latine e europiane në hullitë frënge e romane, pjesërisht gjermane, në një kohë të caktuar sllave (kryesisht ruse e serbokroate për periudhat e gjuhësisë tradicionale), për të vazhduar me traditat europiane në hapësirat e gjuhësisë strukturale, me depërtimin e

rrymave sociolinguistike dhe sidomos të gjenerativizmit ende margjinal, kemi vërshimë të re të anglicizmave edhe aty.

Sidoqoftë, midis të ashtuquajturve anglicizma shpesh dallojmë **latinizma**: *sensor, skript, stagflacion, status*, **angloromanizma**: *sajentologji, serial, sesion, singëll, snobizëm, sofistikuar, special, spiritual, sintetajzer,* apo **përkthime**: *borë, opera sapuni, vetëshërbim*, etj.

Për shkak të intensitetit vështirë të asimilueshëm të huazimeve të anglicizmave në situata dhe fusha të caktuara në një kohë të shkurtë, shpesh ndodh që një fjalë në një moment të ketë hyrë dhe pak më vonë vërejmë se nuk përdoret më: p.sh. *brejk* përdorej në gjuhën e distancës vonë fare, shpesh madje edhe për snobizëm nga ndonjë politikan njësoj në Tiranë e në Prishtinë, sot më nuk ngjet ashtu. Nuk është gjithnjë e lehtë të thuhet me saktësi se kur konsiderohet një fjalë e huaj e integruar në gjuhën shqipe, pra pjesë e gramatikës dhe e leksikut të saj bërthamë. Ta zëmë, të gjithë e dimë se *qofte, fabrikë, rend*, janë fjalë të huazuara të integruara në shqipen dhe sillen sipas rregullave të saj bazë. Por ç'të themi për fjalë si *pasta, lejdi, trendi, amajzing, kull, kuller*, etj.

Në rrugën e gjatë të studimit të anglicizmave të shqipes del e nevojshme të dallojmë *europeizmat* dhe *ndërkombëtarizmat*, *romanizmat* dhe *angloromanizmat*, të hetojmë rrugët e depërtimit përmes gjuhëve ndërmjetëse si serbishtja a italishtja dhe sidomos të shfaqim kujdes të veçantë për tiparet strukturore të shqipes në raport me përshtatjen e anglicizmave – në aspektin gramatikor e fjalëformues dhe edhe më shumë në aspektin tingullor dhe të theksit. Për ta hetuar ndërliqësinë po veçoj dy aspekte të një detaji. Prapashtesa dhe fundja e anglishtes *-er* në gjuhën shqipe zakonisht hyn me formën *-er* dhe sakohë që identifikohet si prapashtesë mund të marrë edhe theks, edhe pse në anglishten nuk e ka: *start-stárter (start-startér), sprint-sprínter (sprintér), repórt-repórter (reportér)*, e kjo vijon pastaj tek *kompjutér-kompjútër*, *bulldozér-bulldózer*, *aktér*, *provajdér-provájder*, etj. Derisa në anglishten theksi anon të bjerë sa më përpara drejt fillimit të fjalës, në shqipen ai në fjalët shumërrokëshe që kanë fleksion zakonisht lidhet me rrokjen që mbyll temën e fjalës: p.sh. *púnë, punëtór, punëtorí*. Në shqipen në Kosovë kjo rregull respektohet gjerësisht jo vetëm në fjalët angleze, po edhe në fjalë të tjera, prandaj kemi *pullovér, kompjutér, snajpér, startér,*

rokér, jo *pullóver, kompjúter, snájper, stárter,* por edhe *biznés* jo *bíznes*. Masa e fjalëve të tilla shtron një çështje: do të normohen duke ruajtur theksin e gjuhës dhënëse, apo do t'i shtrohen theksimit të shqipes? Në Shqipëri vërehet një tendencë tjetër: në shumë fjalë të tilla theksi vendoset në fillim, kështu që rrokjet në vijim gjatë fleksionit reduktohen ose bien, sepse vendi i theksit në shqipen nuk lëviz gjatë fleksionit, prandaj do të kishim: *kompjútër, kompjútra*, në vijim *kompjutríst*, etj.; *snájper-snájperista*, *pullóvër-pullóvrin, bíznes-bíznesin*, ashtu si te modeli *ópera, kámera*, disa madje thonë edhe *Gjílan*, ndryshe nga *muzíkë-música*. Për më tepër, nëse segmenti *-er* identifikohet si prapashtesë, e në frëngjishten ajo zëvendësohet shpesh, jo gjithnjë, me *-eur*, çka në shqipen jepet me *-or*, na dalin disa ngatërrime: ang. *act-er*, fr. *act-eur*, shq. *aktor* (kuptimi i kësaj fjalë në frëngjisht është si i anglishtes, pjesëmarrës në *akt*), *auteur* - *autór*, por shqip *aktànt,* ndaj dhe *aktèr*, pra vetëm pjesëmarrës, jo aktor i teatrit. Në disa raste të tjera kjo prapashtesë përkthehet me përkatësen shqipe: *startues*, jo *starter*, etj. Pra kemi fushë komplekse hulumtimi që duhet të marrë parasysh strukturat e të dy gjuhëve, por edhe elemente të tjera si proceset angloromanike, angloeuropeizmat, etj.

Ne kemi nevojë të flasim në radhë të parë për fjalët angleze të përdorura apo të përdorshme nga shqiptarët midis tyre dhe në media, duke lënë anash termat tepër teknikë. Duhet të përpiqemi të dallojmë fjalët përdorimi i të cilave motivohet nga lehtësia e komunikimit dhe ato të cilat përdoren në radhë të parë për snobizëm. Refuzimi i përpjekjes për të gjetur një barasvlerë shqipe, që nuk është çdo herë e gatshme, është problematik. Huazimet nga anglishtja, si të gjithë të tjerët mund t'i shohim si të domosdoshëm, praktikë, por edhe të padobishëm, pasojë të përtacisë, groteskë, etj. Ndonjëherë ikim tek skaji tjetër dhe flasim për përparësitë shprehjore të anglishtes në raport me shumëfjalësinë e kotë të shqipes a ndonjë gjuhe tjetër: p.sh. *liftboj* - çunaku i ashensorit, *stand by* - udhëtar në pritje, *tweeter* - altoparlant me zë të mprehtë, etj. Në këto shqyrtime është më mirë të lirohemi nga paragjykimet dhe të nisemi nga qëndrimi që s'ka fjalë *non grata*, po vetëm fjalë më të përshtatshme e më pak të përshtatshme për komunikimin tonë. Udhërrëfyes në këtë punë mund të na dalë çështja e të kuptuarit.

A kemi mekanizma për çfarëdolloj parandalimi të kësaj vërshime të anglicizmave në shqipen e sotme? Mekanizma specifikë që të merreshin me çështjet e përshtatjes apo të përkthimit të fjalëve të huaja që duhet t'i kemi në komunikimin tonë nuk ka. Nuk kemi bërthama institucionale për terminologjitë që na kanë vërshuar gjithandej: në recetat e barnave që na shiten, në listat e preparateve të ndryshme që qarkullojnë në ministritë e bujqësisë, të termave ekonomikë të ministrive të ndryshme, të termave elektronikë, të termave shoqërorë, etj. Duket e nevojshme që përpjekje të tilla të bëhen në mënyrë të organizuar përmes bërthamave për terminologji nëpër ato institucione fillimisht, dhe në institucionet e shkencës po ashtu. Është i nevojshëm përqendrimi i vëmendjes shoqërore tek këto probleme me peshë.

Vesel NUHIU, Prishtinë

DEPËRTIMI DHE PËRDORIMI I ELEMENTEVE GJUHËSORE TË HUAJA NË GJUHËN SHQIPE

KDU 811.18'373.45
811.111'362:811.111

Përshëndetje të gjithë të pranishmëve dhe ju uroj sukses në punën e sotme.

Dihet se nuk ka gjuhë pa huazime. Ato dallojnë vetëm nga fakti se disa kanë më shumë e disa më pak sish.

Deri në vitin 1999, huazimet angleze depërtonin në gjuhën shqipe ngadalë dhe duke u filtruar në ndonjë gjuhë tjetër, sepse Kosova nuk kishte kontakte të drejtpërdrejta me vendet ku flitet anglishtja. Elementet gjuhësore të anglishtes në Kosovë rëndom depërtonin përmes serbokroattishtes, ku edhe bëhej përshtatja e tyre fonetike (shkrimi dhe shqiptimi) dhe përshtatja gramatikore dhe semantike. Rrallë ndodhte që ato të pësonin ndonjë ndryshim të dukshëm në gjuhën shqipe. Një numër i tyre në ndërkohë ishin bërë ndërkombëtarizma.

Në parim, huazimet e përshtatshme ndihmojnë për begatimin e gjuhës. Jeta dhe veprimtaritë e ndryshme gjatë zhvillimit të tyre vijnë duke u pasuruar me nocione e koncepte të reja, të cilat duhet të emërtohen. Dihet se huazimet kryesisht depërtojnë në gjuhë për të plotësuar mangësitë semantike. Por ato depërtojnë, natyrisht më pak, edhe për modë, për "çallëm" a për të shitur mend, edhe atëherë kur nuk nevojiten për emërtime të reja. Natyrisht duhet mbështetur kryesisht të huazuarit e elementeve gjuhësore që plotësojnë mangësi semantike.

E dimë se pas vitit 1999 Kosova u bë një rast i veçantë sa u përket rrethanave të gjithmbarshme edhe për depërtimin e elementeve gjuhësore të anglishtes. Me vendosjen e UNMIK-ut, të OSBE-së, të USAID-it dhe të të gjitha atyre organizatave të tjera ndërkombëtare që u turrën në Kosovë, u krijuan kushte për depërtimin e fjalëve dhe shprehjeve angleze në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pakontrolluar.

Neve, duke qenë të papërgatitur për të përballuar një gjendje të tillë

me praninë e anglicizmave, thuaja se u habitëm dhe u gjendëm të paorganizuar në mënyrë institucionale për të ndërmarrë masa përkatëse për kontrollimin dhe pranimin normal të të gjithë atyre elementeve gjuhësore angleze në gjuhën shqipe.

Ndonjë përpjekje individuale e paraqitur publikisht nuk pati ndikim të dukshëm në parandalimin e depërtimit të tyre as në përzgjedhjen e tyre në shqipe.

Gjendja e depërtimit dhe e përdorimit të elementeve gjuhësore angleze në gjuhën shqipe tani ka arritur në një shkallë kritike. Numri i tyre është jashtëzakonisht i madh. Që nga fillimi i shekullit 20 deri në gjysmën e dekadës së tetë, kishin depërtuar gjithsej më pak se 500 anglicizma. Kurse brenda këtyre 14 vjetëve deri tani kanë depërtuar thuaja dyfish më shumë, vetëm sipas evidencës sonë, e cila nuk i përfshin që të gjitha. Prandaj, mendojmë që është kohë e fundit që ekspertët gjuhësorë dhe institucionet gjuhësore kompetente ta shqyrtojnë seriozisht këtë gjendje dhe të ndërmarrin masa përkatëse mbrojtëse për ta ruajtur gjuhën shqipe nga ndikimet e gjuhëve të huaja, sidomos nga anglishtja, para se të bëhet edhe më vonë.

Për çështjet e përgjithshme teorike të të huazuarit tashmë ka shumë shkrime gjithandej në gjuhë dhe përvoja të ndryshme botërore, prandaj nuk e shoh të arsyeshme që për to të bisedohet sot në hollësi. Ky aspekt i trajtimit mund dhe duhet të përfshihet më vonë kur të fillohet me analizimin praktik e të hollësishëm të huazimeve.

Hapat e parë të punës mbi depërtimin dhe përvetësimin e përshtatjen e fjalëve dhe shprehjeve, madje edhe strukturave gramatikore angleze, mendojmë se duhet të jenë që të identifikohet se çka duhet të bëhet me vetë faktin se kaq shumë elemente të kësaj gjuhe të huaj kanë depërtuar në shqipe gjithandej. Si duhet t'i qasemi dukurisë së të huazuarit sidomos të elementeve gjuhësore angleze në gjuhën shqipe.

Një ndër masat e para mendojmë se duhet të jetë që institucionet përkatëse, përkatësisht Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, të miratojnë ligjin mbi gjuhën shqipe. Tashmë ekziston një ligj mbi gjuhën, por ai ka të bëjë vetëm me çështjet se cilat gjuhë duhet të përdoren në administratën e Kosovës dhe për statusin e atyre gjuhëve. Ligji që propozojmë të miratohet duhet të sigurojë dhe të mbrojë gjuhën shqipe standarde si dhe të parashi-

kojë dhe masat që duhet marrë në këtë kontekst, b.f. për përdorimin e drejtë, përkatësisht mospërdorimin e kësaj gjuhe standarde në medie të shkruara dhe elektronike, po edhe në veprimtari të tjera të komunikimit publik, ashtu siç kanë bërë në gjuhët e vendeve me popullatë shumë më të madhe sesa ne shqiptarët dhe që i kanë shumë më të stabilizuara gjuhët e tyre standarde, siç janë frëngjishtja, turqishtja, italishtja etj. Ata kanë krijuar mekanizma shtetërorë për të mbrojtur gjuhët e tyre nga ndikimet e pakontrolluara të gjuhëve të tjera. Këtu nënkuptojmë detyrimin e institucioneve publike që të punësuarit e tyre, sidomos të mjeteve të informimit publik, të mos shkelin normat e gjuhës standarde shqipe. Me depërtimin e pakontrolluar të huazimeve nga gjuhët e huaja, sidomos të anglishtes, gjuhës shqipe mund t'i kanoset edhe ekzistenca e saj në një të ardhme jo të largët.

Ne sot mund të shprehim mendime dhe të japim individualisht propozime të vlefshme, po ndoshta edhe jo shumë të qëlluara, por në fund duhet të arrijmë një pajtim të qëllimeve që duhet t'i kemi po dhe të detyrave që duhet të merren për të arritur ato qëllime. Do t'i kisha ftuar të gjithë të pranishmit që, përveç kumtesave të tyre të vlefshme që kanë paraqitur për këtë tryezë gjuhësore, të japin kontribut edhe për zgjidhjen e kësaj çështjeje kaotike që sot ekziston në gjuhën shqipe.

Do të ishte shumë e nevojshme dhe mbase e domosdoshme që kjo punë të bëhej jo vetëm nga një pjesë a trevë e gjuhës shqipe. Këtu duhet të jenë tok institucionet gjuhësore, arsimore dhe kulturore të Shqipërisë, të Kosovës dhe të Maqedonisë, e mbase edhe të trevave të tjera shqiptare, që të veprohet me një politikë unike dhe në mënyrë të njëjtë për të arritur kontrollimin dhe kanalizimin e depërtimit dhe të përshtatjes së huazimeve në shqipen standarde.

Kjo gjendje mendojmë se kërkon që të formohet një ekip, grup a komision ekspertësh, a sido që ta quajmë, si trup i përbashkët i këtyre tri vendeve ku gjuha shqipe gëzon status shtetëror, i cili do të merrej në vazhdimësi me këto çështje gjuhësore. Do të ishte më së mirë që në krye të kësaj veprimtarie të qëndronin Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Shqipërisë, mbase edhe ndonjë institucion tjetër përkatës dhe i nevojshëm, si një trup i **përhershëm** për t'u marrë me këto çështje në mënyrë të vazhdueshme. Themi të vazhdueshme,

sepse çështja e të huazuarit gjuhësor nuk pushon.

Kur insistojmë që ekipi i kësaj pune të përbëhet nga të gjitha këto treva të gjuhës shqipe, kemi parasysh përvojën e deritashme, e cila ka dëshmuar se ka dallime të dukshme midis Kosovës dhe Shqipërisë sa i përket përvetësimit të elementeve gjuhësore të huaja, shikuar si nga aspekti i përzgjedhjes ashtu dhe nga mënyra e përshtatjes së tyre fonetike e gramatikore, por edhe nga aspekti semantik - i ngarkimit të tyre me kuptime përkatëse.

Gjuha shqipe standarde duhet të jetë objektivi i studimit, sepse ajo ka nevojë të ndihmohet dhe të forcohet si dhe të mbrohet nga ndikimet e padëshiruara të elementeve gjuhësore të huaja. Natyrisht që gjuha shqipe standarde ka nevojë të pasurohet, të përmirësohet dhe të ecën në vazhdimësi drejt përsosjes së saj.

Ne mendojmë që ekipi a komisioni i zënë ngoje më sipër për studimin e huazimeve do të kishte shumë detyra, ndër të cilat:

- Të mbledhë korpusin e elementeve gjuhësore të huaja. Në këtë detyrë do të ishte mirë që anëtarët e ekipit a ekipeve t'i ndanin detyrat e tyre, në mënyrë që secili individ apo grup të mblidhte materialin nga një fushëveprim i veçantë, në të cilin ai ka ekspertizë. Kështu nuk do të dyfishoheshin fjalët e strukturat e njëjta te anëtarët studiues të ndryshëm, dhe secili do të kishte mundësi të thellohej pak më shumë në fushën e vet më të ngushtë.

- Praktika e hulumtimeve në fushën e huazimeve gjuhësore ka dëshmuar se elementet gjuhësore të huaja a huazimet analizohen dhe përpunohen kryesisht në këto tri kategori gjuhësore:

a) në përshtatjen fonetike;

b) në përshtatjen gramatikore dhe

c) në përshtatjen semantike.

Këto janë disa nga fushat që duhet të studiohen:

1. Është një numër huazimesh angleze të reja që kanë zëvendësuar huazimet e mëhershme angleze, si: tender në vend të ankandit, interes në vend të kamatës, auditim në vend të inspektimit ose revizionit etj.

2. Huazimet në fushën e TI-së paraqesin një problem të veçantë dhe

shumë të vështirë, sepse ka numër të madh të tyre. Mendojmë se specialistë të rryer të fushave përkatëse do të duhej të merreshin me to. Dhe mendojmë se janë tri rrugë për zgjidhjen e tyre: a) të zëvendësohen me ndonjë fjalë shqipe, gjë që ka pak gjasa; b) të përkthehen, një çështje që po ashtu është e vështirë, c) të huazohen, por të përshtaten fonetikisht, dhe ç) të merren të papërshtatura?

3. Huazimi i akronimeve a shkurtimeve është një çështje specifike me te cilën duhet të merremi. Deri tani ka pasur disa kontribute gjuhësore, në të cilat janë trajtuar akronimet, por mendojmë se ka ende punë për t'u bërë në këtë lëmi.

4. Emrat e përveçëm anglezë, po edhe të tjerë, paraqesin një çështje më vete. Ekzistojnë zgjidhjet që kanë ofruar rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, por përvoja e pas viteve 2000 ka dëshmuar shumë shmangie nga ato, ndonjëherë edhe me vetëdije.

Për të gjitha këto çështje të përmbledhura më sipër shumë shkurtazi duhet të bisedohet në grupe ekspertësh veç e veç deri në hollësi dhe pastaj, pa u vonuar shumë, duhet të fillohet me zbatimin e punëve një nga një.

Jani THOMAI, Tiranë

ANGLICIZMAT NË FJALORËT SHPJEGUES TË GJUHËS SHQIPE

KDU 811.18’373
811.18'362:811.111

Ka disa studime rreth anglicizmave në gjuhën shqipe, kryesisht në vështrim terminologjik, por jo sistematike e të plota dhe jo në vështrim leksikografik, që nuk arrijnë gjithnjë disa herë në zgjidhje të njësuara, të përligjura shkencërisht bindshëm e përfundimtare. Çështja e anglicizmave në gjuhën shqipe është shtruar edhe në mbledhjen e Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, më 7 mars 2012 në Tiranë, me një material të gjerë të përgatitur nga grupi përkatës i punës, por më shumë me përsjatje në aspektin teorik, të shoqëruar me një listë anglicizmash, me rekomandime për zëvendësimin e disave prej tyre dhe me propozime më të përgjithshme, si për hapjen e rubrikave në revistat shkencore, ku të jepen këshillime për zëvendësimin e anglicizmave me fjalë shqipe ose për drejtshkrimin e drejtshqiptimin e tyre, për hartimin e fjalorëve të anglicizmave në shqipe, për ngritjen e një grupi të përbashkët e të përhershëm për njësimin e terminologjisë në gjuhën shqipe etj. As mund të mendohet që materiali dhe diskutimet në këtë mbledhje e mbyllën çështjen, përkundrazi, e zbuluan më shumë dhe kjo ndoshta ishte ndihmesa më e rëndësishme e këtij diskutimi. Pas kësaj nuk ka pasur ndonjë zhvillim të mëtejshëm a ndonjë zgjidhje praktike. Edhe kur në studime e diskutime janë dhënë zgjidhje të vlefshme për praktikën gjuhësore, në fusha kryesore të zbatimit (si dokumentacioni administrativ, tekstet mësimore, publicistika - e shkruar, auditive e vizuale), përgjithësisht nuk njihen a nuk përfillen.

Objekt kryesor i studimeve leksiko-terminologjike të sotme janë bërë kryesisht anglicizmat e 2-3-dhjetëvjeçarëve të fundit, prandaj zënë (e duhet të zënë) vend kryesor në trajtimin të huazimeve leksikore në shqipen e sotme dhe në variantin standard të saj. Por dihet që trajtimi i anglicizmave në shqipe është problem shumë më kompleks: fonetik, drejtshkrimor, drejtshqiptimor, morfologjik, leksikologjik e leksikografik, terminologjik, semantik, normativ, rrjedhimisht kërkohet bashkëpunimi i specialistëve të

këtyre fushave. Në shprehje më konkrete, është e nevojshme të thuhet më shumë ç'duhet bërë sesa ç'është bërë.

Në fillim duhet të nënvizojmë që çfarëdo *fjalor shpjegues i përgjithshëm* nuk mund të përfshijë të gjithë anglicizmat që janë përdorur e që përdoren në shqipe, qoftë edhe vetëm për funksionin e për vlerën e përgjithshme që kanë. Veç kësaj, fjalorët shpjegues nuk kanë detyrë parësore të zgjidhin në çdo rast trajtën shkrimore e shqiptimore të të gjithë anglicizmave, detyrë kjo e fjalorëve specialë, si fjalorët terminologjikë, fjalori i anglicizmave në shqipe etj., ose detyrë e komisioneve të posaçme terminologjike. Fjalorët shpjegues pranojnë zgjidhjet e dhëna në vepra të tjera kodifikuese. E më tej, problemi i anglicizmave në gjuhën shqipe do të mbetet i hapur sa kohë do të ketë zhvillime të tjera në të gjitha fushat e veprimtarisë, në trojet gjithëshqiptare, sa kohë nuk do të jetë arritur ai njësim i domosdoshëm në mbarë shqipen.

Në vështrim të përgjithshëm edhe anglicizmat ndër fjalorët shpjegues të shqipes janë trajtuar si gjithë huazimet e tjera leksikore pak a shumë të së njëjtës periudhë huazimi. Ndërkaq, kufizimi i përfshirjes së tyre në këta fjalorë kushtëzohet nga rrethanat e kohës kur janë hartuar dhe nga disa kritere e kushte leksikografike: janë pasqyruar më gjerë anglicizmat e huazuar më herët dhe që janë ngulitur në leksikun e shqipes përmes pranimit e përdorimit më të gjerë në praktikën gjuhësore të shkruar e më pak të folur, anglicizmat e shtresës leksikore të përdorimit të përgjithshëm e më pak terminologjike, përveç atyre që i kanë kapërcyer kufijtë e fushës terminologjike e janë shtrirë në përdorim të gjerë, anglicizmat që nuk kanë pasur leksema konkurruese të fuqishme thjesht shqipe ose nuk janë zëvendësuar dot me të tilla nën trysninë e fortë e të përhershme të prirjes së "planifikimit gjuhësor" "a "të normativizimit" thuajse të detyruar për të ruajtur pastërtinë e fjaloit të shqipes ose për ta pastruar atë nga lënda e huaj e panevojshme etj.

Që nga fjalori i parë shpjegues i gjuhës shqipe i vitit 1954 e deri te fjalori më i fundit i vitit 2006, ndër dy funksionet kryesore, atij *informues* e atij *normëzues,* ka sunduar i dyti, me një zbutje të lehtë nga një fjalor në tjetrin të kësaj kundërvënieje në procesin përzgjedhës të glosarëve, varësisht edhe nga vëllimi i fjalorëve e nga burimet e lëndës për shqipen e

shkruar e të folur. Prirja për ta parë leksikun edhe si shprehje të veçorisë kombëtare në aspektin gjuhësor, në pajtim edhe me frymën e kohës, i ka shtyrë hartuesit e fjalorëve më shumë drejt leksikut "popullor", çka ngushtonte hapësirat për leksikun e huazuar, përfshirë edhe anglicizmat, madje u jepte fjalorëve një ngjyrim disi "folklorik". Me këtë nuk dua t'i gjykoj për keq ata fjalorë, që kanë dhënë mjaft fjalë shqipe, shprehje e kuptime të ligjërimeve të folura popullore, pasuri gjuhësore kombëtare e çmueshme, e brumit amtar, por të motivoj çfarë u përmirësua në fjalorin e parë elektronik të gjuhës shqipe dhe çfarë mendoj se duhet bërë më tej me raportin *funksion infomues – funksion normativ* në fjalorët shpjegues të ardhmë, lidhur me huazimet leksikore në përgjithësi e me anglicizmat në veçanti.

Në *Fjalorin e gjuhës shqipe* të vitit 1954[1], është e kuptueshme, janë përfshirë pak anglicizma, rreth 25, natyrisht të huazuar herët e të ngulitur përfundimisht në shqipe. U takojnë shtresave leksikore të përdorimit të përgjithshëm, por edhe pak fuashave terminologjike, si sporti, tregtia, financat etj. (*basketboll, biftek, boks, boksier, buxhet, çek,* (mungon *dollar*), *futboll, gol, kross* "vrapim "(me dy *s!*), *park, radar, raketë, sekser, ski, spiker, sport, sterlinë, trafik, tunel, vagon, vinç* (mungon *volejboll*).

Në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* të vitit 1980[2], i cili mund të mbahet sot jo vetëm si fjalori i parë i tipit të mesëm, por edhe si i pari i hartuar sipas kritereve leksikografike bashkëhore dhe i mbështetur në një bazë të gjerë lëndore objektive (Kartoteka e leksikut të shqipes), më i ploti e më sistemori në glosar e në strukturimin semantik të fjalëve për kohën e për kushtet kur u botua, ka mbi 70 anglicizma të huazuar deri atëherë, të fushave të ndryshme të veprimtarisë dhe të rrafsheve të ndryshme të ligjërimit, si: *basketboll, balast, bar* "lokal i vogël...", *biftek, biznes, blister, bojskaut, boks, boksier, buding, buldozer, bum (ek.), bumerang, bunker, buxhet, çek (fin.), dok* (*det.*), *doker*, *dollar, futboll, gol, golf, hendboll, hipi, hokej, jaht, jard, konvejer, kilovat, kloun, koks, koktej, kros, legë, lord, miting, park, penallti, radar, raketë, rekord, rul, sekser, ski, snajper, spiker, sport, sterlinë, sherif, shik, tenis, tenist, trafik, tramvaj, trolejbus, volejboll, xhaul, xhaz, xhol, xhungël* etj.

[1] *Fjalor i gjuhës shqipe,* Tiranë, 1954.
[2] *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe,* Tiranë, 1980.

Ndërkaq, me një vështrim kritik, duhet të pohojmë atë që shohim sot te ky fjalor edhe për anglicizmat e kohës: mungesat në paraqitjen e anglicizmave thyejnë në disa raste sistemorësinë, si nga ana e fushave leksikore e nga tipi e pesha e fjalëve, ashtu edhe nga zhvillimi fjalëformues në anglishte e brenda shqipes. Kështu:

a) Mungojnë anglicizma të njohur edhe në vitet '70 të shekullit të kaluar, si: *grejfrut, handikapat, holl, huligan, kauboj, kek, klering, kompjuter, lider, lob* (*anat., soc.*), *marketing, njuton* (*fiz.*), *paund, poker, poster, printer, raund, sanduiç, skaner* (*mjek., inform.*), *skrap, smog, sprint (sport), staf, starking, stres, shok* (*mjek.*), *tik (mjek.), trust, xhin, xhinz* etj.

b) Nuk jepen për disa anglicizma derivatet e zhvilluara brenda anglishtes, si: *biznesmen (<biznes), kamping (<kamp), kultivar (<kultivator), parking (<park), training (//trajner), bojkot (>bojkotoj), míster (//mis)* etj.; kjo ndodh edhe me prejardhjen brenda shqipes, si: *stopoj, stopim (<stop), trafikoj, trafikim (<trafik), trajnoj, trajnim (//trajner)* etj.

c) Nuk jepen në disa raste fjalët referente të anglicizmave të pranuar, si: *nokdaun (//nokaut), finish (//start)* etj.

Fjalori i shqipes së sotme i vitit 1984[3] dhe varianti i tij i vitit 2002[4] nuk patën ndryshime të ndjeshme në pasqyrimin e anglicizmave.

Gjithsesi shqipja para viteve '90 të shekullit të kaluar shquhej ndër gjuhët evropiane për pak huazime nga anglishtja në shtresën e përgjithshme të leksikut[5], por kishte huazuar relativisht mjaft terma specialë. Janë veçuar rreth 120 njësi (terma), disi të ngulitur në shtresën terminologjike të fushave si mekanika, sporti, tregtia, elektronika, shkencat ekzakte, muzika etj.[6]

Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 2006[7] solli një pasurim të lehtë, por të dukshëm, me anglicizma të huazimit më të vonshëm, kryesisht nga informatika, biznesi, financa, politika etj., si: *biznesmen, boiler, internet, kek,*

[3] *Fjalor i shqipes së sotme,* Tiranë, 1984.
[4] *Fjalor i shqipes së sotme,* Tiranë, 2002.
[5] Shih Androkli Kostallari, *Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës shqipe,* në "Studime filologjike", Tiranë, 1982, 2.
[6] Agron Duro – Fatmir Vrapi, *Veçori të termave me burim nga anglishtja në gjuhën shqipe,* në Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe – Probleme dhe detyra, Tiranë, 2009, f. 191-211; shih edhe Agro Duro, Studime gjuhësore, Tiranë, 2012, f. 156-171.
[7] *Fjalor i gjuhës shqipe,* Tiranë, 2006.

kesh, kliring, klikoj, klonoj, kolaps, kompjuter, marketing, maus, menaxhoj, míster, paund, poster, printer, raund, risk, set (sport.), skaner, snob, snobizëm, stres, shok (mjek.), tender, terminal, xhin, xhinset, xhungël etj.

Pasurimi i mëtejshëm i këtij fjalori bëhet edhe me dy rrugë të tjera: a) me fjalët e prejardhura në shqipe nga anglicizmat; p.sh. *klikim, kompjuterizoj, kompjuterizim, i kompjuterizuar, printoj, printim, i printuar, riskoj, riskim, i riskuar, skanoj, skanim, i skanuar, stresoj, stresim, i stresuar, shokoj, shokim, i shokuar, tenderoj, tenderim, trafikoj, trafikim, i trafikuar, trafikues, i trafikueshëm, trafikant* etj.; b) me zgjerim të strukturave kuptimore; p.sh. te *bord,-i,* përveç kuptimit "1. faqja anësore e anijes a e barkës; pjesa e sipërme e anijes, e sheshtë dhe e zbuluar, kuvertë", jepet edhe kuptimi "2. *libr.* grupi drejtues në një institucion, në një shoqatë etj."; te *shok,-u,* përveç kuptimit teminologjik në fushën e mjekësisë e të psikologjisë" 1. gjendja e organizmit kur ka rënë menjëherë e gjithë veprimtaria jetësore nga shqetësime a nga ngacmime të fuqishme", jepet edhe kuptimi i figurshëm "2. emocion i fuqishëm dhe i papritshëm; tronditje e fortë shpirtërore"; te *trafik,-u,* përveç kuptimit "1. lëvizje e njerëzve a e mjeteve të ndryshme me rrugë tokësore, detare e ajrore; rrjeti i qarkullimit të tyre", jepet edhe kuptimi "2. trafikim", d.m.th. "tregtimi në mënyrë të paligjshme i mallrave të ndaluara, i sendeve me vlerë etj., duke i kaluar fshehurazi në kufirin shtetëror; shitje me mashtrim a në mënyrë të palejueshme", kuptim që e ka gjithë çerdhja e fjalës *trafik* (*trafikoj, trafikim, i trafikuar, trafikues, i trafikueshëm, trafikant*) etj.

Por zgjerimin më të madh me anglicizma ky fjalor e pati në variantin e tij elektronik të vitit 2012[8], me një pasurim të ndjeshëm me mbi 50 anglicizma të fushave të reja të zhvillimit, të huazuar kryesisht këta dy dhjetëvjeçarët e fundit, si: *akses, autist, autizëm, bajt, bold, databeiz, desktop, draft, emergjencë, fail, feisbuk, haker, handikap, handikapat, imeil, impakt, insert, investigoj (investigim), italik (kompj.), kilobajt, klip, kampus, lider, lidership, lob (loboj, lobim), lobing, licensë, megabajt, memo, nominoj (nominim), pasuord, remitancë, recesion, resurs, resort, samit, selektoj (selektim), sponsor (sponsorizoj, sponsorizim), staf, supermen, teletekst, uikend, videoklip* etj. E ndërkaq mbeten edhe shumë anglicizma të tjerë të kohëve

[8] *Fjalor i gjuhës shqipe (fjalori i parë elektronik),* Tiranë, 2012.

të fundit që ende nuk janë përfshirë në fjalorë shpjegues të gjuhës shqipe. Një fjalor i tipit të mbimesëm ose të madh do të duhet të përfshijë edhe anglicizma të tillë, si: *apdejtoj (apdejtim) (edhe fig.), bajpas (mjek. e ndërt.), bekgraund, bestseller, bigmarket, bipartizan, bluxhinz, bodigard, bos, bulldog, çekin, derbi, doping, draft, eksitpoll, fans, flesh, gej, gigabajt, grejfrut, harddisk, harduer, hobi, holl, hotdog, huligan, impakt, kamping, kauboj, keçap, kompaktdisk, lajv, laptop, logo, marins, market, minimarket, modem, monitor, monitoroj (monitorim), njuton (fiz.), okej, pab, panel, parking, performancë, ramstek, regbi, rep (muz.), rok (muz.), rokendroll, sanduiç, seksi, selektoj, serf, servër, skrap, smog, softuer, shoping, topmodel, ufo, vip* etj. Ky grup fjalësh do të zgjerojë funksionin informues të fjalorëve. Ndërkaq, një grup anglicizmash të tjerë, terma tepër specialë ose huazime fare rishtake a të zëvendësueshme me fjalë shqipe, mendoj se nuk janë lëndë e fjalorëve të përgjithshëm shpjegues, por e fjalorëve specialë, terminologjikë, të fjalëve të huaja etj., të tillë si: *alokoj (alokim), audit, aut (jam aut), autput, bejbisiter, blekaut, çat (çatoj, çatim), displej, djutifri, drajv, fizibël, fold, fri, folkmen, input, involvoj (involvim), insert, kibord, mikroçip, muzikholl, non-stop, peixhmekër, pin, plejof, popkorn, relaks (relaksohem, relaksim), skup (televiziv), spajdërmen, suing, superstar, topshou, trendi, uebsajt, uorkshop, vip, videogejm* e dhjetra anglicima të tjerë në shumë fusha, bashkë me anglicizma të rinj, që, sipas prirjes së huazimit në shqipen e sotme, do të shtohen në të ardhmen.

Në strukturën e brendshme të ndërtimit të fjalorëve sipas kritereve leksikografike, që mund të nxirren edhe në mënyrë empirike, nuk duket të ketë ndonjë qëndrim të vaçantë të vetëdijshëm për anglicizmat, nësoj si edhe për huazimet leksikore nga gjuhë të tjera, veç vlerësimit sipas statusit të arritur nga huazimi ose sipas prirjes për t'u ngulitur në sistemin leksikor të shqipes dhe në ligjërimin e folur e të shkruar, si edhe sipas kronologjisë së huazimit si motiv i vjetërsisë e i përvetimit në përdorim. Rruga e huazimit, drejtpërdrejt nga gjuha dhënëse a nëpërmjet një gjuhe tjetër, nuk ka ndikuar as në përzgjedhjen e tyre, as në mënyrën e paraqitjes grafike. Ndërkaq, përkundrazi, kanë ndikuar edhe tipare të tjera, si përkatësia në shtresat leksikore (fjalë të leksikut të përgjithshëm apo të fjalorit terminologjik, të ligjërimit të shkruar apo edhe të folur, të përgjithshme apo të shtresave të caktuara sociale e kulturore ose të ligjërimeve a të stileve të ve-

çanta etj.), shtrirja gjuhësore (ndërkombëtarizma apo vetëm të shqipes, të mbarë shqipes a vetëm në Shqipëri), gjerësia dhe denduria e përdorimit etj.

Për veprat leksikografike (fjalorë shpjegues a dygjuhësh, të përgjithshëm a terminologjikë), lidhur me anglicizmat, mendoj se ka përpara katër probleme të përgjithshme e të përbashkëta:

1. Përzgjedhja e pasqyrimi i anglicizmave në sistem, në përputhje *me tipin e kriteret e fjalorëve,* në përputhje me një raport të drejtë *funksion informues – funksion normëzues,* me raportin *fjalë e huaj – fjalë shqipe* dhe me raportin *e shtresave leksikore.* Gjithsesi, konkurrenca *fjalë e huaj (anglicizëm) – fjalë shqipe* mbetet një faktor veprues, që nuk mund të shpërfillet. *Fjalori – Për pastërtinë e gjuhës shqipe,* i vitit 1998, në 1440 fjalë vetëm 4 identifikon qartazi si huazime nga anglishtja, që do të thotë se ende nuk gjen shumë anglicizma si të panevojshëm e të zëvendësueshme me fjalë shqipe. Jepen këtu *bord* "këshill, komision", *finish* "mbërritje", *penallti (sport.)* "njëmbëdhjetëmetërsh "e *start* "nisje"[9]. Por mundësitë e përballjes të disa anglicizmave me fjalë shqipe janë më të mëdha dhe konkurrimi mund të mbetet i hapur për shumë kohë, sado që të duam të mbështesim fjalët shqipe; p.sh. *apdejtoj* – përditësoj, *autput* – nxjerrje, *bipartizan* – dypartiak, *bodigard* – truprojë, *çekin* – kontroll, *draft* – paraprojekt, *fri* – i lirë, falas, *fulltajm* – kohëplotë, *impakt* – ndikim, *input* – futje, *involvoj* – zhvilloj, *kidnapoj* – rrëmbej, *killer* – vrasës, *lajv* – drejtpërdrejt, *lider* – udhëheqës, *lidership* – udhëheqësí, *luk* – pamje, hijeshi, *maç* – ndeshje, *maus* – miush, *on-lajn* – në linjë, *partajm* – kohëpjesshëm, *pasuord* – fjalëkalim, *profit* – fitim, *presing* – trysni, *resurs* – burim, *risk* – rrezik, *sejvoj* – ruaj, *selektoj* – shenjoj, *spiker* – folës, *star* – yll, *stopoj* – ndal, *shou* – shfaqje, *shougërll* – paraqitëse, *shoumen* – paraqitës, *samit* – mbledhje, *uikend* – fundjavë etj.[10] Në terminologjinë sportive zëvendësimi ka qenë më i qëndrueshëm: *bek* – mbrojtës, *centërfor* – qendërsulmues, *hence* – goditje dënimi, *korner* – goditje këndi, *penallti* – njëmbëdhjetëmetërsh, *refer* – gjyqtar (loje) etj.

---

[9] *Për pastërtinë e gjuhës shqipe – Fjalor,* Tiranë, 1998. Fjalori përmban huazime të burimit kryesisht neolatin; edhe *arbitër* e *pas (pasim, pasoj)* duket të kenë hyrë në shqipe nëpërmjet gjuhëve neolatine.

[10] Ndër autorët që janë marrë me zëvendësimin e anglicizmave me fjalë të shqipes, po përmendim Hajri Shehun, *Mbi zëvendësimin e disa huazimeve angleze,* në Gjuha jonë, Tiranë, 1989, 1.

2. Zgjidhja e "figurës" gjuhësore në *shkrim* e në *shqiptim* e anglicizmave: dihet që anglishtja është gjuhë me zanore me shqiptim bivokal: *i=ai (ipad), a=ej (change), o=ou (open), y=aj (my)...* ose me dy shqiptime të mundshme: *e = e (enter)* ose *i (email), oo=o (door)* ose *u (foot), y=i (liberty)* ose *aj (baterffly), th=th (think)* ose *dh (father)...* Po të shtohet këtu edhe dallimi ndërmjet shqiptimit anglez e amerikan (si: *databejz / detabejz, manaxher / menaxher, handikap/ hendikap, laptop / leptop, sanduiç / senduiç...*), çështja e drejtshkrimit dhe e drejtshqiptimit të anglicizmave në shqipe vështirësohet edhe më shumë.

3. Njësimi në gjithë trojet e shqipes dhe variantet e saj ligjërimore, stilistike etj. mbetet gjithashtu një detyrë e ngutshme.

4. Së fundi, në leksikografi, ngushtimi i hapësirës ndërmjet funksioneve *informues e normëzues* në fjalorët shpjegues, në dobi të të parit, duke përcaktuar njësinë e cilësuar si jonormë jo me përjashtim nga fjalori, por me teknikat e brendshme leksikografike (me referim, me shënime të posaçme kufizuese etj.), ka vend të kthehet në kriter të hartimit të tyre.

Për fjalorët shpjegues normativë çështja rëndohet për shkak të kufizimit të mëtejshëm të shtresave të kufizuara në përdorim të leksikut (si, f.v., terminologjia), por edhe për shkak se për çdo njësi kërkohet një trajtë e vetme drejtshkrimore e drejtshqiptimore, pra, zgjidhja e trajtës fonetikogramatikore për çdo anglicizëm të pranuar nga shqipja është e domosdoshme, sepse në këta tipa fjalorësh ai mund të jepet vetëm në një variant, kur në mjete të tjera të shkruara (tekste, gazeta etj.) edhe mund të dalë në 2-3 variante. Në fjalorët dygjuhësh anglisht-shqip, siç dihet, ka mënyra të pasqyrimit të anglicizmave që ruajnë grafinë e gjuhës dhënëse dhe shënojnë shqiptimin në shqip me alfabetin ndërkombëtar, por kjo praktikë leksikografike nuk mund të përdoret rregullisht në fjalorët shpjegues normativë, sepse implikon gjithë shtresën e huazimeve leksikore nga çdo gjuhë, klasike e të gjalla.

Po përmend vetëm disa raste të thjeshta, por gjithsesi problemore edhe për hartimin e fjalorëve shpjegues:

1. Tipi *pub, show, live, big-brother...* do të jepen kështu si shkruhen, apo sipas shqiptimit në shqip: *pab, shou, lajv, bigbradhër...?*

2. Shkurtesat: *CD, DVD, DJ...* do të kenë shqiptimin anglisht (*sidi,-ja, dividi-ja, dixhej,-i...*) apo shqiptimin sipas modelit *BE-ja, NATO-ja, OKB-ja, SHBA-të...* (d.m.th. *cëdë,-ja, dëvëdë,-ja, dëjë,-ja / dëxhë,-ja...*)?

3. Si do të veprohet me anglicizmat e paasimiluar, si: *top-story, show-biz, exit-poll, one stop shoop, wi fi...?*

4. Si do të veprohet me anglicizmat e rastit a efemerë, si: *open, close, push, fifty-fifty, single, take-way...?*

Flasim këtu për zgjidhjet leksikografi, por edhe të përdorimit të anglicizmave në ligjërimin e shkruar a të folur. Në këtë fushë një rrethanë jo e favorshme është mungesa krejt e përgjegjësisë dhe e kujdesit të institucioneve shtetërore e shkencore për terminologjinë në përgjithësi dhe për anglicizmat e dy dhjetëvjeçarëve të fundit (shembulli i termave të strukturave të Bashkimit Europian, të NATO-s dhe të veprimtarisë së tyre etj.). Prandaj është propozuar disa herë që të ngrihet një komision i përbashkët i terminologjisë, i cili:

1. Të ketë të drejtën që për anglicizmat në shqipe të marrë vendime të zbatueshme në praktikën gjuhësore.

2. Të punojë për njësimin e terminologjisë, përfshirë edhe anglicizmat, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni etj.

3. Të ushqejë rubrika të veçanta në revistat gjuhësore me rekomandime për trajtimin e anglicizmave në shqipe, në përbërje të të gjithë shtresës së huazimeve leksikore.

4. Të organizojë ndërmarrjen e hartimit të glosarëve normativë, sipas strukturës leksikografike: a) termi i zgjedhur (shqip e anglisht); b) grafia; c) shqiptimi; ç) kuptimi; d) fusha e përdorimit; dh) çerdhja fjalëformuese; e) sinonimet e mundshme. Në rend të parë për të filluar vijnë informatika, ekonomia, financat, biznesi.

5. Të hartojë e të botojë një thirrje a kërkesë drejtuar të gjitha institucioneve e organeve për zbatimin e zgjidhjeve të propozuara: ministrive të arsimit, universiteteve, shkollave, shtypit e televizioneve, hartuesve të teksteve mësimore, përkthyesve etj.

Jani THOMAI, *Tirana*

ANGLICISMS IN EXPLANATORY DICTIONARIES OF THE ALBANIAN LANGUAGE

Summary

From the first explanatory dictionary of the Albanian language *Fjalor i gjuhës shqipe* (1954) up to the most recent general electronic dictionary *Fjalor i gjuhës shqipe* (2012) (see endnotes), of the two main lexicographic functions, *informing* and *standardizing*, the latter has dominated, which has had the effect of narrowing the space devoted to the borrowed lexicon, including anglicisms. This is explained by the circumstances of the times in which the dictionaries were compiled, by the actual state of the Albanian language, and by the inclusion criteria and aims of the dictionaries themselves. An almost complete corpus of anglicisms in these dictionaries together with the semantic fields of these borrowings is presented in this paper. The progressive increase in their inclusion from one dictionary to the next (and especially in the most recent dictionary) is examined - all of this represents new lexicographic territory for the Albanian language.

In particular, the explanatory dictionaries compiled before the 1990s are critically surveyed and some paradigmatic anomalies are noticed: some well-known anglicisms are excluded from these dictionaries, even ones well-established in the Albanian language at the time; some members of semantically related pairs of anglicisms are absent (e.g. *start* is included, but its antonym *finish* is not); derivatives from the same stem are absent (e.g. *biznes* is included, but *biznesmen* is not); derivatives within Albanian are also absent (e.g. *trafik* is included, but *trafikoj*, *trafikim*, *i trafikuar*, *trafikant* are not); etc.

Developments in more recent dictionaries are separately analysed: thus *Fjalori i gjuhës shqipe* (2006) and *Fjalori elektronik i gjuhës shqipe* (2012), which have markedly increased the inclusion of anglicisms (especially in semantic fields characterized by rapid innovation, such as information technology, business, finance, culture, sport, etc.), both morphological borrowings (and their derivatives, both in English and in Albanian) and semantic borrowings (showing an extension of meaning, usually in figurative use), etc.

Further, some classifications are made: anglicisms which should be included in a dictionary bigger than a medium-sized one by reason of their spread and integration in usage; specific anglicisms for terminological dictionaries, or for dictionaries of foreign words; phonetically and grammatically assimilated anglicisms and anglicisms not yet assimilated; ephemeral anglicisms (e.g. *jam**out***), etc. At the end of the paper, some suggestions are made as to the inclusion of anglicisms in future explanatory dictionaries of Albanian, specifically on their systematic inclusion, in accordance with the type and criteria of the dictionnaries, their informing and standardizing functions, the relation between foreign word and Albanian word, their degree of assimilation, etc.; on the solution of the orthographic and orthoepic *figure* of anglicisms (e.g. *pub* / *pab*); on their unification in Albanian as a whole; on the reduction of the space between the informing and the standardizing function in a dictionary, in favour of the former; etc. Proposals are also made as to the creation of a joint commission of terminologists for the Albanian language and its duties regarding the treatment of foreign terms, including those borrowed from English, or those which may be borrowed in future.

Shykrane GËRMIZAJ, Prishtinë

SFIDAT DHE REZULTATET E KONTAKTEVE TË SHQIPES ME ANGLISHTEN

KDU 811.18'373.45
811.18'362.811.111

Përmbledhje

Në këtë kumtesë shqyrtohen rrjedhat dhe prirjet e ndikimit të anglishtes në shqipen duke u përqendruar në veçanti në huazimet dhe akronimet, si procese fjalëformuese më prodhimtare dhe ndikimin e tyre në diskursin e shkruar dhe të folur të gjuhës shqipe.
Përmes një analize të gjithanshme, autorja e këtij studimi mëton të hetojë dhe të paraqesë ndikimet pozitive dhe negative të kontakteve të anglishtes me shqipen, duke hedhur dritë mbi një varg faktorësh që ndikojnë në pasurimin, por edhe në degradimin e shqipes, që rezulton sa në lehtësimin e komunikimit nga njëra anë, po aq edhe në vështirësimin dhe pengimin e tij nga ana tjetër.
Qëllimi përfundimtar i këtij studimi është parandalimi i pasojave largvajtëse negative për gjuhën shqipe.

Fjalët çelës: *akronim, anglishtja, huazim, ndikim, shqipja*

1. Dy fjalë në vend të hyrjes

Dihet mirëfilli se gjuhët, sikundër edhe kulturat, rrallëherë janë të vetëmjaftueshme (Sapir, 1921). Gjuha shqipe nuk paraqet përjashtim. Që nga lashtësia ajo ka qenë e ndikuar nga gjuhët në fqinjësi të saj dhe kjo është pasqyruar në radhë të parë në leksikun, por edhe në strukturën e saj. Mirëpo, në kohën tonë, falë lehtësimit të lëvizjes së njerëzve përkatësish të ndryshme etnike dhe kulturore dhe zhvillimit të teknologjisë, shqipja është në kontakt të vazhdueshëm me një varg gjuhësh gjeografikisht jo shumë të afërta. Përveç kësaj rol tejet të rëndësishëm për hapjen e rrugëve për ndikime të jashtme në shqipe s'do mend ka krijimi i realiteteve të reja gjeopolitike e socioekonomike në nënqiellin dhe arealin tonë gjuhësor.

1.1. Duke mos e anashkaluar faktin se procesi i ndikimit kushtëzohet nga rrethanat historike, shoqërore e politike (Sankoff, cituar te Trudgill at al, 2001), pasi që ky është një studim sinkronik, në këtë kumtesë do të përqendrohem në sfidat dhe rrjedhojat e kontatkit të shqipes me anglishten në rrafshin leksikor. Kjo kumtesë është rezultat i interesimit tim të vazhdue-

shëm për shkallën e ndikimit të anglishtes në shqipen. Të dhënat që do t'i paraqesë këtu janë pjesë e një studimi më të gjerë për vlerësimin e shumanshëm të gjendjes në shqipen e sotme dhe i një varg hulumtimesh që përqendrohen në aspekte të caktuara të ndikimit të anglishtes në shqipe. Studimi mbështetet në një varg pohimesh:

E para: huazimi leksikor nga anglishtja është proces tejet produktiv si rrjedhojë e kontakteve të përditshme të shqipes me anglishten;

E dyta: akronimia po ashtu është proces fjalëformues tejet produktiv dhe është pasojë e kontaktit gjuhësor; shtresëzimi dhe identifikimi i saktë i akronimeve merr kohë;

E treta: huazimet dhe akronimet depërtojnë në shqipe përmes gjuhës së shkruar;

E katërta: ndikimi i anglishtes në gjuhën e folur është në rritje e sipër;

E fundit dhe me shumë rëndësi: huazimet dhe akronimet shkaktojnë vështirësimin, e në disa raste edhe pamundësimin e komunikimit.

1.2. Korpusi dhe metodologjia

Për t'i vërtetuar hipotezat e parashtruara, duke pasur parasysh aspektin gjithpërfshirës, korpusi është vjelë nga mediet e shtypura që botohen në Kosovë e Shqipëri (2000-2013), nga mediet elektronike, përfshirë këtu shiritat lëvizës dhe programet televizive që u dedikohen grupmoshave të ndryshme e që transmetohen në televizionet kabllore të Shqipërisë (ALSAT, Albanian Screen, Vision PLUS), të Kosovës (RTK, KTV, TV21, KLAN KOSOVA) dhe të Maqedonisë (ALSAT M), si dhe nga bisedat e rastit të regjistruara nga autorja (2003-2013).

Përveç këtyre burimeve, të dhënat janë mbledhur përmes një anketimi me qëllim të konstatimit të shkallës së njohjes së akronimeve nga publiku i gjerë si dhe nga një grup i caktuar i popullacionit (2010), dhe po ashtu kemi ndërmarr një hulumtim empirik për hetimin e procesit të krijimit të akronimeve (2013).

Duhet theksuar faktin se vjelja e të dhënave që do ta përbënin korpusin e studimit nuk doli të ishte proces i mundimshëm pasi që burimet e

përzgjedhura ofronin material të begatë. Po të shikohen vetëm emërtimet e disa kanaleve televizive që transmetohen përmes televizionit kabllor, del se edhe ato do të mund të shfrytëzoheshin si material i vlefshëm gjuhësor. I njëjti konstatim vlen edhe për emërtimet e programeve të ndryshme televizive (Interaktiv, Target, Aldo Morning Show, Express, etj.).

2. Tiparet e shqipes së shkruar dhe të folur

Pas analizës së hollësishme të korpusit të vjelë del qartë se shqipja vlon nga huazimet që janë shtresëzuar në leksikun e saj, mirëpo krahas tyre vazhdimisht depërtojnë edhe huazime të reja, në veçanti anglicizma të cilët prijnë në numër e denduri përdorimi. Për hir të së vërtetës duhet përmendur faktin se anglishtja, duke qenë e hapur ndaj prurjeve nga gjuhët e tjera, ka huazuar shumë fjalë në periudha të ndryshme. Mirëpo mbetet i pamohueshëm fakti se sot këto fjalë burimesh të ndryshme në shqipe depërtojnë përmes anglishtes, prandaj edhe shihen si anglicizma. Duke e marrë parasysh këtë, shtrohet nevoja për përkufizimin e kritereve të qarta për përcaktimin e anglicizmave.

2.1.Gjykuar sipas rezultateve të hulumtimit për praninë e anglicizmave në shtypin ditor në Kosovë brenda periudhës 2000-2009 që është zhvilluar nën udhëheqjen time (shih tabelën 1, 2, 3), del se për çdo vit në shtypin ditor kosovar depërtojnë mesatarisht rreth gjashtëdhjetë anglicizma të rinj, si dhe faktin se gjuha e folur është më e hapur ndaj ndikimeve të jashtme, duket se hovi i dukurisë nuk ka të ndalur. Të përmendim vetëm disa nga huazimet që i lexojmë dhe i dëgjojmë nga dita në ditë: **abandonim:** abandonoj: abandonuar; **abuzim:** abuzoj: abuzuar**; adoloshencë:** adoleshent; **adresim:** adresoj: adresuar; **akceptim:** akceptoj: akceptuar; **akses, aprincial, aset, atitudë, blu, couple, cool:** cooler; **dispersim:** dispersoj: dispersohem; **ekzagjerim:** ekzagjeroj: ekzagjeruar; **eveniment, event, evoluim, fans, fasilitim,** fasilitoj, fasilitator; **fiks;** fiksoj, fiksuar; **gri, hacker, indipendencë, instituim:** instituoj; **involvim:** involvoj**,** involvuar; **implementim:** implementoj; **inxhinier civil shërbyes civil, kek, kompeticion,** kompetitor; **kurrikul:** kurrikulum; **listim:** listoj**,** listuar**; live, obesitet, pozitë, pozicion, pub/ pab, provider, resurs,** resurse **humane; rimbursim,** rimbursoj**; sensitivizim,** sensitivizoj, sensitivizuar; **single,**

surprizë: surprizoj: surprizim; **syllabus, suport:** suportim: suportues: suportoj; **target:** targetoj: targetuar; **tax-free, teenage, trajnim:** trajnoj, trajner: **apdejtim**: apdejtuar: **vulnerabël, workshop...**

Viti	Emra	Mbiemra	Folje	Ndajfolje	Parafjalë	Total
2000	**57**	**31**	**18**	\	\	**106**
2001	**36**	**14**	**3**	\	\	**53**
2002	**24**	**6**	**3**	\	\	**33**
2003	**21**	**6**	**3**	\	\	**30**
2004	**14**	**6**	**2**	\	\	**22**
2005	**14**	**5**	**1**	\	\	**20**
2006	**12**	**2**	**2**	**2**	**1**	**19**
2007	**16**	**5**	**3**	\	**1**	**25**
2008	**15**	**17**	**3**	\	\	**35**
2009	**142**	**63**	**30**	**1**	**1**	**237**
Total	**351**	**155**	**68**	**3**	**3**	**580**

Tabela 1 – Pasqyra numerike e huazimeve në shtypin ditor të Kosovës (2000-2009)

Natyrisht, gjithë anglicizmat, sikundër mund të përfundohet edhe nga shembujt që u përmendën më parë, nuk janë në fazë të njëjtë përshtatjeje. Një pjesë e madhe e tyre (rreth 80%) janë përshtatur dhe janë shtresëzuar në gjuhën shqipe, në shtresën e veçantë të ndërkombëtarizmave. Nga ana tjetër, siç është e pritshme, gjatë periudhës së analizuar numrin më të madh të huazimeve e përbënin emrat (60%), që ndiqeshin nga mbiemrat (27%) dhe foljet (12%). Megjithatë, mbetet e shtrirë dukuria që sapo të huazohet një formë, me ose pa arsye, shumë shpejt pason formimi i gjithë gjedhes nga rrënja e njëjtë. Mirëpo ajo që unë e çmoj brengosëse është fakti se pas shumë thirrjeve të gjuhëtarëve për pastrim, ekologjizim të gjuhës shqipe, për zëvendësim të huazimeve me fjalët ekzistuese të gurrës shqipe, jo vetëm se kjo nuk po ndodh, por po ndodh edhe tjetra, që krahas huazimeve të shtresëzuar, në shqipe po depërtojnë edhe të tjerat që po nxjerrin nga përdorimi si fjalët shqipe, ashtu edhe huazimet e përshtatura.




Tabela 2 – Anglicizmat e regjistruar për herë të parë




Tabela 3 – Numri i përgjithshëm i anglicizmave krahasuar me numrin e anglicizmave të regjistruar për herë të parë

2.2. Përveç qëndrimit të tejtheksuar liberal të folësve burimorë të shqipes ndaj ndikimeve të huaja, burim tjetër i gjendjes së sotme në shqipen e folur është edhe kujdesi i pamjaftueshëm për përdorimin e gjuhës standarde në përdorimet publike të saj. Dialektizmat, krahinarizmat, lokalizmat janë bërë pjesë përbërëse e programeve të folura. Duke mos e mohuar faktin se fjalët e këtyre shtresave të leksikut janë një pasuri e pamohueshme e leksikut të shqipes, duhet parë dhe vlerësuar çfarë ndikimi kanë ato në përdorimet publike të saj? Cili stil dhe cili model komunikimi po promovohet?

Marrë në përgjithësi, modelet e komunikimit që ofrohen dhe ndiqen e përvetësohen janë tejet joformale për t'u cilësuar si komunikim publik. Kur kihet parasysh shtrirja dhe ndikimi i medieve elektronike dhe roli i tyre për informimin, por edhe formësimin gjuhësor të publikut, për përhapjen e modeleve, qofshin ato pozitive ose negative, është e qartë se kujdesi individual dhe kolektiv për këto çështje është i pamjaftueshëm (Gërmizaj, 2011).

2.2.1. Si rrjedhojë e gjendjes së tillë, komunikimi shpesh po zhvillohet me vështirësi e pengesa natyrash të ndryshme. Kjo sjell moskuptime, keqkuptime dhe keqinterpretime. Por ajo që ma merr mendja se duhet të nënvizohet në veçanti janë rastet në të cilat folësit burimorë të shqipes pengesat në komunikim përpiqen t'i kapërcejnë përmes anglishtes dhe, për habi, ia dalin! Një ilustrim i qartë i këtij pohimi është një dialog mes udhëheqësit (pra, moderatorit) dhe mysafirit në një program argëtues:

Po citoj:

A: A jeni beqareshë?

B: (Hesht, nuk jep përgjigje)

A: A jeni **single**?

B: Jo, nuk jam singël, jam e fejuar...

3. Përveç huazimeve, që nga periudha e pasluftës akronimet po ashtu e kanë vërshuar shqipen. Në një studim të mëhershëm, duke i trajtuar çështjet e përdorimit të akronimeve në gjuhën tonë, pata vënë në dukje disa rregullsi, por edhe shmangie, që hetoheshin në formimin dhe përdorimin e akronimeve në gjuhën shqipe (Gërmizaj, 2003). Ndërkaq, në një studim të datës më të vonë (Gërmizaj, 2007) qenë rishqyrtuar prejardhja e akronimeve, tipet, klasifikimi në lakime, çështjet e drejtshkrimit dhe të drejtshqiptimit, si dhe efektet e gjithmbarshme për lexueshmërinë, qartësinë dhe lehtësinë e transmetimit, përkatësisht të absorbimit të informacionit. Atëherë pata parashikuar shtrirjen më të vrrullshme të dukurisë dhe përhapjen e saj që shtronte domosdoshmërinë e përdorimit të emërtimeve të plota krahas akronimeve.

Gjykuar nga të dhënat tona, ashtu siç patëm parashikuar, përdorimi i akronimeve po bëhet gjithnjë e më i dendur. Akronimet janë të pranishme në të gjitha gazetat e përditshme që botohen në Kosovë e në Shqipëri. Numër i madh akronimesh hasen edhe në ueb faqet e institucioneve shtetërore. Ato janë të pranishme edhe në mediet elektronike, si në diskursin e folur ashtu edhe në atë të shkruar.

3.1. Po të kundrrohet prejardhja e akronimeve, bëhet e qartë se vazhdojnë të përdoren akronime të gurrës së huaj krahas akronimeve të gurrës vendore. Madje, disa syresh, edhe pse janë shqipëruar dhe kanë qenë në përdorim, tani janë shndërruar në **anakronime** duke u zëvendësuar plotësisht me barasvlerëset me burim të huaj (khs. MUP-i i Serbisë /MPB, ICO/ ZCN/ZNC). Mirëpo duhet nënvizuar faktin se edhe akronime të tjera janë shndërruar në anakronime për shkaqe të arsyeshme (khs. PSSP/ SRSG: (shef i) ICO-së; SHPK: PK; TMK: FSK; MSHP: MAP, etj.)

Në mediet e shtypura, akronimet paraqiten kudo: në tituj e mestituj, por edhe brenda artikujve. Dendurinë e përdorimit të akronimeve e dëshmojnë titujt në vijim:

- …kërkon ndihmën e **NATO-s** për **FSK-në** (Zëri 18 mars 2010)
- … kryetar i **GP** të **LDK-së** (Inforpress 25 prill 2010)
- Suhareka injoron udhëzimet e **MASHT-it**, vepron sipas **MAPL-it** (Koha Ditore 5 qershor 2010)

- **NATO-ja** e shqetësuar me praninë e **MUP-it** në veri (Koha Ditore 25 qershor 2010)
- **OEAK-u** dhe **USAID-i** arbitrazh për investimet e huaja (Kosova Sot, 15 korrik 2010)
- **PD** sfidë **PS**, kërkon **SHISH** dhe buxhetin (Shekulli 27 korrik 2010)
- Ligji i **SHISH-it** mbetet për shtator (Telegraf, 26 korrik 2010)
- Dekretet **PS** e **PD** e refuzuan Topin (Gazeta Shqip, 27 korrik 2010)
- Serbia nuk pranon marrëveshje me **BE-në** dhe **SHBA-në** (Kosova Sot, 13 gusht 2010)
- Vendimi i **DAP - DAP-i** nuk e ka miratuar…Vendimi **KSHC - …** "Kthim në punë, në **MBUMK**…nuk e zbatoi vendimin e **KSHC**… (Gazeta Shqip, qershor 2013
- **KGJK E KQZ,** shkel ën kushtetutën e Kosovës (Gazeta Express, qershor 2013
- **KVV:** Situata e qet**ë**, ka disa parregullsi (Shekulli, qershor, 2013)
- …ndaj kandidatit t**ë** PD… (Gazeta 55, qershor 2013)
- Dritë jeshile Kosovës për **MSA** (Zëri, qershor 2013)
- Dritë jeshile Kosovës për **MSA-n**ë (Koha Ditore, qershor, 2013)
- Anzanloneresearch: **PD** 42%, **PS** 40% në rang kombëtar (Bota Sot, qershor 2013)
- **BSCK** shpërblen më të mirët (Kosova Sot, qershor 2013)
- **KDI: MI** favorizon kompanitë për mirëmbajtjen e rrugëve (Kosova Sot, qershor 2013)

3.1.1. Përveç në titujt, për motive të tërheqjes së vëmendjes së lexuesit dhe të ekonomizimit me hapësirën, akronimet përdoren dendur edhe brenda teksteve të artikujve të shtypit ditor. Për ilustrim po sjellim një shkëputje nga shtypi ditor ku vetëm brenda dy paragrafëve (me përsëritje) numërohen gjithsej dhjetë akronime:

Përgjegjësi i **ZIP-it** i **KK-së**...hapësirat janë dhënë në shfrytëzim përkohësisht me vendim të **KK-së**, pjesë e të cilit ka qenë edhe Mehmeti i **LDK-së**...

Shefi i **ZIP-it** i Komunës ka thënë se... me një vendim të **KK-së**, pjesë e të cilit ishte edhe A. Mehmeti i grupit opozitar të **LDK-së**, njëherësh shef i **GK** të **LDK-së** në **KK** të Gjilanit. (Koha Ditore, 5 qershor 2010).

…i kutive të votimit rreth **KZAZ-ve** dhe dorëzimi i procesverbaleve (Gazeta Shqip, qershor 2013)... zëdhënësja e **KQZ-së**... nga **KZAZ-të**…komisionerëve të **KQV-ve** (Koha Jonë, qershor 2013)

Duke i shqyrtuar akronimet e përdorura brenda tekstit, patjetër duhet të vihet në dukje fakti se emërtimet e plota jepen brenda tekstit, zakonisht në fillim, megjithëse, për hir të vërtetës, duhet thënë se ka edhe ndonjë shmangie nga kjo rregull, siç dëshmon titulli në vijim:

INPO-ja paralajmëron rrezikun nga pompat e benzinës (K.D. 17 prill 2010) me ç'rast emërtimi i plotë nuk paraqitet askund në tekst, por jepet vetëm shpjegimi në fillim të artikullit se bëhet fjalë për një organizatë joqeveritare.

3.2. Derisa drejtshkrimi i akronimeve me vizë lidhëse po stabilizohet, luhatjet ende hetohen në kategorinë e shquarsisë dhe atë të numrit. Mirëpo një çështje tjetër që po del në shesh është fakti se derisa në vitin 2007 ishte e qartë se tipar dallues i akronimeve në gjuhën shqipe ishte shkrimi i tyre me shkronja të mëdha, si fazë e (para)fundit e procesit fjalëformues,[1] dy akronime që i kemi regjistruar në shtypin ditor në vitin 2010 bien ndesh me këtë rregullsi. Bëhet fjalë për përdorimin e të dy radhëve të shkronjave brenda akronimit të njëjtë: RrGGK dhe MSh.[2] Po të përligjej kjo metodë e shkrimit të akronimeve, kjo doemos do të kishte rrjedhoja të shumëfishta. Me rëndësi të veçantë do të ishte rishqyrtimi i drejtshkrimit të të gjithë akronimeve të tjerë që përmbajnë dyshkronjësha (khs. GJND, GJKK, KGJK, MSHP, SHBA, SHISH, SHIK, etj.).

3.3. Përkundër rekomandimeve të gjuhëtarëve për përdorim ekskluziv të akronimeve në gjuhën e shkruar, duke përjashtuar nga kjo frymorët, hulumtimi ynë tregon se gjuha e folur po ashtu shfaq shtimin e dendurisë së përdorimit të akronimeve dhe ndërlikimet e ndikimeve të huaja. Ato po bëhen përditshmëri në stacionet tona televizive, siç tregojnë shembujt në vijim:

- KTV: ...sipas zyrtarëve të **u-pë-s**; **gjë-në-dë-ja** rast për të dëshmuar ndasitë e **bë-es**; Ekuidistanca e **ai-si-o-s** e dëmshme; Mbyllet në **u-pë** hapet në **a-a-bë** (19.7) Pse përfaqësuesi special i **o-kë-bë-ve** nuk e anuloi (22.7) ...kishte sulmuar një **ti-vi** stacion ... (23.7) ... në reagimin e **o-vë-lë-s** së **u-çë-kë-s**... (28.7.) A do të arrijë **bë-e-ja** ...? (16.8.) **xhi-pi-es-i** (21.8)
- RTK: Në mbledhjen e kryesisë së **lë-dë-dë-s**; ...cili do të jetë vendimi i **gjë-në-dë-s;** Presidenti … dhe shefi i **ai-si-o-s**... (19.7.)
- TV21: Cili është mendimi i **më-pë-jë-s** pas vendimit të **gjë-në-dë-s** (13.7.); Kryeministri Thaçi u kthye nga **shë-bë-a-t**; **a-a-kë** kritikon qeverinë për gjendjen në veri (26.7); **a-e-zhe-ja**; **berzh-i; fë-së-bë-kë** fajëson qeverinë; **dak** anëtare e **onal**; ...irritojnë **shë-bë-a-në** (21.8)
- ALSAT: Yjet e **en-bi-ei** spektakël
- Klan Kosova: …zyrtar i **map** (29.8.)

[1] Në përgjithësi konsiderohet se akronimet së pari formohen si shkurtime me shkronjat nistore që ndahen me pikë (p.sh. K.E.K.). Duke u shtrirë dhe duke u shtuar denduria e përdorimit të akronimit të caktuar, pikat bien (KEK), kurse shkronjat e mëdha mund të zëvendësohen me të vogla pas depërtimit të akronimit në shtresën e përgjithshme të leksikut (khs. Radio Detecting And Ranging: R.A.D.A.R.: RADAR: radar)

[2] Në vitin 2007 po ashtu patëm hetuar prirje të përdorimit të dy radhëve shkronjash si p.sh. BprAL por ky tani më është shndërruar në anakronim.

As gjuha e folur në përdorimet private nuk bën përjashtim në këtë aspekt. Për ta vlerësuar ndikimin e akronimeve në komunikim dhe shkallën e njohjes së tyre dhe zbërthimit të saktë të kuptimit të tyre nga publiku i gjerë dhe nga një mostër e caktuar e popullacionit e ndërmorëm një anketim. Pohimi nistor ishte se akronimet nuk njihen nga publiku i gjerë, andaj dhe shkaktojnë pengesa në komunikim, si dhe keqkuptime dhe keqinterpretime. Mosgatishmëria për pjesëmarrje në anketim ishte një tregues i qartë që në fillim dhe kjo e përforconte bindjen tonë se nga krijimi deri te përfundimi i procesit të shtresëzimit të akronimeve në leksikun e shqipes duhet të kalojë një periudhë e caktuar kohore. Mbështetur në rezultatet e anketimit, hipoteza e hulumtimit se duhet kohë për finalizim të procesit u tregua e saktë. Anketimi dëshmoi se akronimet që përdoren për një kohë relativisht të gjatë identifikohen në përqindje të lartë nga publiku, ndërkaq të tjerat që janë formuar dhe kanë hyrë në përdorim kohëve të fundit dhe nuk kanë arritur të shtresëzohen, nuk identifikohen me saktësi as nga punonjësit e institucioneve përkatëse shtetërore.

Gjithsej akronime në pyetësor 150	**Numri i akronimeve të identifikuar**	**Përqindja e akronimeve të identifikuar**	**Shkalla e identifikimit të akronimeve**
	7	**4.6%**	**50% - 92%**
	12	**8%**	**28% - 46%**
	14	**9.3%**	**10% - 24%**
	40	**26.6%**	**2% - 8%**
	79	**52.6%**	**0%**

Tabela 4 – Shkalla e identifikimit të akronimeve

Ajo që duhet të nënvizohet është se nga 150 akronime të radhitur në pyetësor, vetëm shtatë (pra 4.6%) identifikohen saktë nga mbi 50% (50-92%) të respondentëve (MASHT, KEK, OJQ, MEF, UP, MTI, AUK). Këtu duhet përmendur akronimin **AAK** e cila nga 78% të respondentëve identifikohet me partinë politike në vend të homonimit: Agjencia për Akreditim e Kosovës. Dymbëdhjetë akronime të tjera (8%) shfaqin shkallë të njohjes prej 28% - 46%, katërmbëdhjetë syresh (9.3%) prej 10% - 24%, nën 10% (2-8%) janë 40 akronime të tjera (26.6%), kurse mbi gjysma e numrit të akronimeve të radhitur në pyetësor (52,6%) tregojnë shkallë zero të njohjes nga respondentët.

Një tjetër hulumtim që është zhvilluar me studentët dhe është reali-

zuar nga studentët e Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Angleze[3] ka dëshmuar hipotezën se akronimet mund të krijohen nga secili përdorues i gjuhës në mungesë të njohurive për ekzistencën e akronimeve të caktuara. Nga studentët, pjesëmarrës në hulumtim, është kërkuar të përkthejnë emërtimet e plota të shoqëruara me akronimet gjegjëse të institucioneve, organizmave dhe organizatave të ndryshme në shqipe dhe nga shqipja. Rezultatet e hulumtimit empirik vërtetojnë hipotezën tonë, gjë që mund të përfundohet nga shembujt e dhënë në vijim:

American Chamber of Commerce (ACC) – DHTA (Dhoma e Tregtisë Amerikane)
(Dhoma Tregtare Amerikane) DHAT (Dhoma Amerikane e Tregtisë)
ZAT (Zyra Amerikane e Tregtisë)
OEA (Oda Ekonomike Amerikane)
OTA (Oda Tregtare e Amerikës)
OAT (Oda Amerikane e Tregtisë)
DHKA (Dhoma Komerciale e Amerikës)
Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil – DASHC
SA (Department of Civil Service Administration)
ADCS (Administrative Department of Civil Service)
CSAD (Civil Service Administration Department)
ACSD (Administrative and Civil Service Department)

Sikundër mund të përfundohet nga shembujt, nga mungesa e njohurive për ekzistencën e akronimit të shqipëruar (OEA), janë krijuar edhe gjashtë akronime të tjera. Është shumë e gjasëshme se po të publikoheshin akronimet - rrjedhojë e përkthimit të pasaktë, do të hapej rruga për shtrirjen e tyre dhe krijimin e hutisë së mëtejme, që do të sillte pengesa shtesë në transmetimin dhe pranimin e informacionit.

4. Në vend të përfundimit. Po bëhen plot dy shekuj që nga kohët e kontakteve të para të shqipes me gjuhën angleze dhe kulturën anglishtfolëse, fillimisht përmes udhëpërshkrimeve (Hobhouse, 1813) e ndonjë sprove

[3] Hulumtimi është zhvilluar në prill të vitit 2013 nga studentët e vitit të tretë të Seksionit të përkthimit dhe interpretimit të Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Angleze si pjesë përbërëse e programit të studimeve Bachelor.

në rrafshin gramatikor e leksikografik (Leake, 1814), përballje këto të cilësuara si dinjitoze (Mansaku, 1996). Sot kur shqipja përballet me anglishten në kushte kontakti të drejtpërdrejtë nga dita në ditë, kërkohen përpjekje të përbashkëta dhe kujdes më i madh për shqipen. Kërkohen përpjekje të përbashkëta dhe ndihmesë e vazhdueshme institucionale dhe individuale nga gjithë ne: gjuhëtarët, institucionet arsimore, mediet, por edhe gjithë folësit burimorë të gjuhës shqipes. Mirëpo krahas përpjekjeve tona janë të domosdoshme edhe burimet përkatëse të referencës: fjalorë njëgjuhësh dhe dygjuhësh, të përgjithshëm dhe të veçantë, të shtypur edhe elektronikë, me fjalës shumë më të pasur se ata ekzistues, në mënyrë që shqipja të vazhdojë komunikimin e saj me anglishten në mënyrë dinjitoze, ashtu siç i ka hije kësaj gjuhe të lashtë, që ajo të mbetet 'mahnitëse' (Joseph, 2009), ashtu siç në vazhdimësi cilësohet nga studiuesit e huaj të shqipes.

Bibliografia

Bota Sot - e përditshme, e pavarur

Cambridge Advanced Learner's Dictionary, Third Edition, Cambridge University Press, 2009

Epota e Re – e përditshme e pavarur

Express – e përditshme e pavarur

Fischer, Roswitha and Hana Pulaczewska: Anglicisms in Europe: Linguistic Diversity in a Global Context, Cambridge Scholars Publishing, 2008

Fjalor i Gjuhës së sotme Shqipe, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980

Fjalor i Gjuhës Shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006

Gazeta Shekulli – e përditshme e pavarur

Gazeta Shqip – e përditshme e pavarur

Gërmizaj, Shykrane, Përballja e anglishtes me shqipen – Begatim apo varfërim, Java e Shkencës, Prishtinë, 2012, pp.127-132

Gërmizaj, Shykrane, Shqipja e shekullit XXI, AKTET, 2011, Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca,v. V, Nr. 4, f. 731-736

Gërmizaj, Shykrane, Akronimet në diskursin e folur dhe të shkruar, Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca, v. IV- 2010, f. 745-751, Tiranë.

Gërmizaj, Shykrane, Anglishtja dhe shqipja - Përqasje dhe kundërvënie, Prishtinë, 2009

Gërmizaj, Shykrane, Kontaktet e anglishtes dhe shqipes – përparësitë dhe rreziqet, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 27/1, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2008

Gërmizaj, Shykrane, Formimet akronimike në gjuhën shqipe, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 26/1, Prishtinë, 2007.

Gërmizaj, Shykrane: Translation Theory in the Classroom, Prishtina, 2005

Gërmizaj, Shykrane, Përdorimi i akronimeve në gjuhën shqipe, në Kulturë e gjuhës 1,

Shoqata e Gjuhës Shqipe e Kosovës, Prishtinë, 2003, f. 79-87
Hoti, Ilir: Fjalor enciklopedik për bankën, biznesin, bursën, ekonominë, Anglisht- Italisht-Shqip, Tiranë, 2001
Jackson, Howard and Amvela, Etienne Ze, Words, Meaning and Vocabulary, An Introduction to Modern English Lexicology, London, New York, 2000
Joseph, Brian, Preface në Anglishtja dhe shqipja – Përqasje dhe kundërvënie, Prishtinë, 2009
Hobhouse, J.C., A Journey through Albania and other Provinces of Turkey in Europe and Asia, to Constantinople, during years 1809 and 1810. London, 1813
Koha Ditore - e përditshme, e pavarur
Koha Jonë - e përditshme, e pavarur
Kosova Sot – e përditshme, e pavarur
Leake, W. M., Researches in Greece. London, 1814
Mansaku,S., Kontributi i studiuesve rumunë për historinë e gjuhës shqipe, në Kontribute të albanologëve të huaj për studimin e gjuhës shqipe, Studime shqiptare 5, Universiteti i Shkodrës, Shkodër, 1996
Mehdiu, Festime, Anglicizmat në shtypin ditor të Kosovës në periudhën 2000-2009, Punim i masterit i mbrojtur në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2010
Munday, Jeremy: Introducing Translation Studies, Routledge - New York, 2006
Nuhiu, Vesel: Ndikimet ndërgjuhësore, Rilindja, Prishtinë, 1990
Qesku, Pavli: Fjalor Anglisht – Shqip, EDFA Tiranë, 2000
Sapir, Edward, Language: An Introduction to the Study of Speech, New York, Harcourt Brace and Company, 1921
Sopjani, Valentina, Shkurtimet dhe shkurtesat në gjuhën angleze dhe shqipe, punim i masterit i mbrojtur në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, Fakulteti i Filologjisë, 2010
Shekulli – e përditshme e pavarur
Thomaj, Jani, Leksikologjia shqipe, Universiteti i Prishtinës, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Prishtinë; Leksikologjia e gjuhës shqipe, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë, 1984; ribotim, 2001

Jashar KABASHI, Prishtinë

DEPËRTIMI I PAKONTROLLUAR I ANGLICIZMAVE – SFIDË PËR GJUHËN SHQIPE

KDU 811.18'362:811.11
811.18’36-112

Hyrje

Rëndësia e gjuhës angleze për zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor të një vendi është e padiskutueshme. Të flasësh anglisht sot nuk është asgjë e veçantë, tani kjo është bërë një parakusht a “conditio sine qua non” për çdo person që do të gjejë një punë të mirë apo të bëjë karrierë profesionale.

Anglishtja sot është bërë ‘lingua franca” globale dhe njëra prej shenjave kryesore të globalizimit dhe ndikimit në gjuhët e botës. Arsyet kryesore për ndikimin e shtuar të anglishtes në gjuhët e tjera, sidomos në gjuhët e Evropës, është zhvillimi i shpejtë i Britanisë e veçmas i SHBA-së, e cila pas Luftës II Botërore pati ndikim të madh në tërë globin. Si rezultat i këtij ndikimi, ajo e zëvendësoi frëngjishten si gjuhë e komunikimit ndërkombëtar, e cila gjatë pushtimeve normane pat ndikuar mjaft në gjuhën angleze.

Në aspektin linguistik huazimet leksikore kanë qenë e janë proces i natyrshëm dhe dobiprurës për pasurimin e leksikut të një gjuhe. Huazimet jo vetëm nga anglishtja, janë të mirëseardhura, meqë ato e lehtësojnë dhe e pasurojnë gjuhën dhe komunikimin ndërgjuhësor.

Ndikimi ndërkombëtar në rritje e sipër i anglishtes është i mirëpritur nga një pjesë e madhe e vendeve dhe popujve në botë, e veçmas nga vendet e vogla dhe ato në zhvillim, siç është Kosova. Ka të tjerë që anglishten e shohin edhe si kërcënim të mundshëm ndaj gjuhëve dhe kulturave të tyre. Deri në shekullin 19 kritika ishte e drejtuar ndaj gjuhës frënge, e më vonë, veçmas pas Luftës II Botërore, anglishtja doli në plan të parë.

Duke marrë parasysh nivelin e zhvillimit, të përdorimit dhe normën e standardit, anglishtja sot nuk mund të paraqesë kërcënim për gjuhën shqipe, por përdorimi i pakontrolluar dhe pa kriter i huazimeve angleze mund të dëmtojë rëndë çdo gjuhë, e rrjedhimisht edhe gjuhën shqipe.

1. Pse huazohen fjalët e huaja?

Shtrohet pyetja: përse njerëzit huazojnë fjalë të huaja? A nuk janë gjuhët mjaft të pasura për ta shprehur realitetin që i rrethon, pa ndihmën e fjalëve të huaja? Një përgjigje e thjeshtë në këto pyetje mund të jetë: Njerëzit huazojnë, sepse jetojnë në një botë të globalizuar. Por një përgjigje më të plotë lidhur me këtë çështje e ka dhënë kolegu im, profesor Vesel Nuhiu (2013), duke konstatuar:

'Nevoja për t'u kuptuar dhe për të komunikuar në mes njerëzve është aq e vjetër sa edhe gjinia njerëzore. Njerëzit gjithmonë kanë pasur kontakte midis tyre. Ata kanë këmbyer gjësende materiale e shpirtërore, kanë pushtuar territore të reja, kanë vizituar vende të huaja etj. Në atë mënyrë, ata kanë bartur prej njërit te tjetri përvojën dhe diturinë e tyre, dhe së bashku me to edhe një pjesë të gjuhës së tyre'.[1]

Ka shumë arsye për huazimin e fjalëve të huaja. Sipas Jacomine Nortier, profesoreshë për multilingualizëm dhe sociolinguistikë në Institutin e Linguistikës në Utreht (Utrecht), Holandë, tri arsye të tjera janë:

1. *Paraqitja e koncepteve të reja*, duke përfshirë fjalët që përdoren për ato koncepte. Terminologjia angleze lidhur me shkencën kompjuterike dhe teknologjinë, por edhe me sportet dhe futbollin, kanë hyrë në shumë gjuhë së bashku me konceptet e tyre.

2. Një arsye tjetër është *për të bërë dallime që ndryshe nuk kanë mund të bëhen*. Përmes huazimit të fjalëve nga gjuhë të tjera mund të bëjmë dallimin, p. sh. të llojeve të shtëpive: *apartment* (apartament), *bungalow* (shtëpi banimi, zakonisht me dërrasa).

3. Në studime shpesh konkludohet se *përdorimi i fjalëve të huaja është rezultat i kontaktit gjuhësor*. Gjuhët vazhdimisht ndryshojnë. Pavarësisht nga masat apo shumat e parave që shpenzohen për politika gjuhësore, politikat e tilla nuk kanë sukses nëse njerëzit nuk janë të gatshëm t'i pranojnë propozimet për ta mbajtur gjuhën e tyre të pastër.[2]

Ekzistojnë shumë arsye të tjera për përdorimin e huazimeve që li-

[1] Vesel Nuhiu (2013) *Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*, ASHAK, Prishtinë, f. 21.

[2] http://www.multilingualliving.com Loan Words and Borrowing: A Kind of Code-Switching, by *Jacomine Nortier*

dhen me kontaktin gjuhësor dhe gjuhësinë kontrastive në përgjithësi, të cilat janë elaboruar nga linguistë dhe ekspertë të kësaj fushe. Në nivel ndërkombëtar vlen të përmenden: Eduard Sapir (1921)[3], Einar Haugen (1950)[4], Uriel Weinreich (1953)[5], R. Filipović (1971)[6], Sarah Thomason (2001)[7] etj., ndërsa në Kosovë V. Nuhiu (2013)[8]. Mirëpo, duke pasur parasysh natyrën e kësaj teze shkencore, nuk ia vlen të zgjerohemi më shumë.

2. Huazimet angleze në disa gjuhë evropiane

Fjalët angleze kanë depërtuar dhe depërtojnë në shumë gjuhë botërore, e veçmas në gjuhët evropiane. Huazimet angleze në gjuhët e tjera njihen si "anglicizma". Fjala 'anglicizëm' nënkupton një fjalë, frazë a idiomë karakteristike të gjuhës angleze.

Në dekadën e fundit të këtij mileniumi vërehet një fluks huazimesh angleze në të gjitha veprimtaritë shoqërore, kulturore, shkencore, ekonomike dhe sidomos tekniko-teknologjike në gjuhët e shteteve evropiane. Ky depërtim i huazimeve angleze ka gjetur shprehje veçanërisht në fushën e informatikës, ku teknologjia ka shënuar një bum të vërtetë. Për shkak të shpejtësisë me të cilën teknologjia po ndryshon dhe po depërton në tërë botën, në shumicën e këtyre vendeve ka tendencë që më parë të huazohen fjalët angleze për inovacionet teknike dhe idetë e reja se të shpiken terma a fjalë të reja në gjuhët e tyre amtare.

Depërtimi i anglicizmave në këto vende, qofshin të mëdha a të vogla, shihet qartë edhe nga huazimi i fjalës 'kompjuter'. Në shumicën e këtyre gjuhëve ekziston fjala burimore për 'kompjuter' (p. sh. në frëngjisht, spanjisht, suedisht, hungarisht, turqisht dhe në pjesën dërrmuese të gjuhëve sllave), por një pjesë e madhe e gjuhëve evropiane kanë parapëlqyer përdorimin e fjalës angleze 'computer'. Megjithatë, shumë fjalë angleze vazhdojnë të depërtojnë në gjuhët e vendeve të zhvilluara evropiane, siç është

---

[3] Edward Sapir (1921) *Language: An Introduction to the Study of Speech*, Chap. IX. How Languages Influence Each Other, Harcourt, Brace and Company, New York.
[4] E. Haugen (1950): *The Analysis of Linguistic Borrowing*, *Language* Vol.26, No.2 (Apr.-Jun, 210-231.
[5] Uriel Weinreich (1953) *Languages in Contact: Findings and Problems*, New York, 1953, Reprint, Mouton, The Hague –1963
[6] Rudolf Filipović (1971) *Kontakti jezika u teoriji i praksi,* Zagreb.
[7] S. Thomason (2001) *Language Contact. An Introduction,* Edinburgh University Press.
[8] Vesel Nuhiu (2013), vep. e cit.

gjermanishtja dhe frëngjishtja. Në gjermanisht, p. sh., kanë hyrë fjalët: *aftershave, scanner*, *projector*, *adapter, hacker*, *jackpot*, *alien*, *poker*, *USB* etj., edhe pse për shumicën e këtyre termave ka pasur fjalë të barasvlershme në gjermanisht me vite të tëra. Nga kjo shihet se gjermanët nuk kanë huazuar vetëm terma të rinj, por kanë zëvendësuar edhe fjalë të zakonshme gjermane me fjalë angleze. Këta terma anglezë, që kanë hyrë në gjuhën e përditshme gjermane, ata i quajnë neologjizma.[9]

Aktivitete të organizuara për pastrimin e gjuhës frënge dhe gjermane nga ndikimi anglo-sakson ka pasur në vazhdimësi, që nga fundi i shekullit 19, e sidomos fillimi i shekullit 20. Sot Franca është ajo që njihet më së shumti si vend i purizmit të organizuar institucional, i drejtuar kundër infiltrimit të anglicizmave. Qeveria franceze është haptazi kundër, siç thonë ata, 'ndotjes' gjuhësore, e për këtë qëllim ata shpenzojnë shuma të mëdha parash për masat e ashtuquajtura 'puriste' kundër (sipas tyre) huazimeve të rënda. Shumica e pjesëtarëve të gjeneratës së vjetër të francezëve e shohin ndikimin e gjuhës dhe kulturës anglo-saksone në gjuhën e tyre të lashtë si sulm në identitetin e vetë shtetit.

Pavarësisht nga angazhimi institucional i qeverisë franceze për pastërtinë gjuhësore dhe nga fakti se në Francë ekzistojnë 18 komisione qeveritare për terminologji dhe për eliminimin e anglicizmave nga frëngjishtja, veçmas nga shkollat e mesme dhe kolegjet, francezët nuk kanë arritur ta pengojnë depërtimin e anglicizmave në 10 vjetët e fundit. Përkundrazi, brenda kësaj dekade kanë depërtuar më shumë huazime në gjuhën frënge se në 100 vjetët e mëparshëm.[10]

3. Huazimet në gjuhën angleze

Edhe pse sot është gjuhë dominuese në botë, gjatë zhvillimit të saj anglishtja ka huazuar shumë nga gjuhët e tjera, veçmas nga latinishtja e frëngjishtja. Vlerësohet se mbi 80% e leksikut të gjuhës angleze është huazuar nga gjuhë të tjera. Shumë fjalë janë bërë aq të zakonshme sa që sot ka

[9] www.langconnect.com The Influence of English on Other Languages (and vice versa) by Marcell Haller

[10] http://www.dailymail.co.uk French traditionalists up in arms as younger generation uses 'cool' Anglicisms.

pak anglishtfolës burimorë që i konsiderojnë ato fjalë të huaja, si, b. f. *Kindergarden* (gjermanisht), *government, royal, confession, couch, carol, melody* (frëngjisht), ose *armada, cafeteria* apo *coyote* (nga spanjisht).

Shtrohet pyetja: Sa është e rëndësishme ruajtja e gjuhës amtare nga depërtimi i fjalëve të huaja? Kuptohet, gjuhët kurrë nuk kanë qenë statike, ato vazhdimisht kanë ndryshuar dhe vazhdojnë të ndryshojnë. Gjatë periudhave të ndryshme historike gjuhët kanë ndikuar në njëra-tjetrën. Pra edhe vetë anglishtja është ndikuar shumë nga gjuhët e tjera, veçmas nga latinishtja dhe frëngjishtja, aq sa sot folësit burimorë anglezë i përdorin këto huazime pa menduar se po e dëmtojnë gjuhën e tyre amtare.

4. Huazimet angleze në gjuhën shqipe

Edhe gjuha shqipe, si shumë gjuhë të tjera, ka huazuar dhe vazhdon të huazojë fjalë angleze. Një numër i madh fjalësh tashmë janë bërë të zakonshme në përdorimin tonë të përditshëm. Vlen të përmenden vetëm disa si, për shembull, fjalët *compjuter, adapter*, *parking, e-mail,* të cilat janë pranuar pa kurrfarë kundërshtimi dhe janë bërë pjesë përbërëse e leksikut të shqipes, për shkak se kanë qenë të nevojshme për t'i emërtuar inovacionet dhe konceptet e reja tekniko-teknologjike.

Megjithatë, në 15-20 vitet e fundit ka ndodhur një vërshim i paparë i anglicizmave në gjuhën shqipe. Pothuajse çdo ditë dëgjojmë dhe lexojmë fjalë angleze në shtypin ditor dhe në mediet elektronike që po e zvetnojnë gjuhën shqipe. Këtë e dëshmojnë edhe tri huazimet vijuese nga korpusi, me shembujt e kontekstit dhe barasvlerësve të tyre në shqipen standarde:

1. Ndihet e *abandenuar* nga ...Ndihet e *braktisur* nga...
2. Komunat e reja të krijuara artificialisht ... *janë delienuar* më parë në përshtatje me...
   Komunat e reja të krijuara artificialisht ... *janë përcaktuar* më parë në përshtatje me ...
3. Ndërkaq në rastin e ndonjë *objeksioni* ... nga Ministria për Arsim e Kulturë...
   Ndërkaq në rast të ndonjë *kundërshtimi* ... nga Ministria për Arsim e Kulturë...

Kur një fjalë huazohet, ajo integrohet në gjuhën marrëse në shkallë të ndryshme të përshtatjes fonetike, leksikore dhe gramatikore.[11] Mirëpo kur dëgjon a lexon trajta të shëmtuara fjalësh të shfytyruara të huazimeve si

[11] Roswitha Fischer (2008) *Anglicisms in Europe: Linguistic Diversity in a Global Context*, Cambridge Scholars Publishing, p. 3

në shembujt e mësipërm, ndjehesh i fyer, jo vetëm pse shqipja ka fjalë përkatëse dhe barasvlerës të përshtatshëm për këto huazime, po edhe për

	Anglisht	**Shq. në kontekst**	**Shqip**
1.	abandon	*abandonoj*	lë, braktis
2.	adaptable	*adapt*	i përshtatshëm
3.	adequacy	*adekuaci*	aftësi, mjaftueshmëri
4.	Affect	*afektoj*	ndikoj, dëmtoj
5.	Agility	*agjilitet*	shkathtësi, zhdërvjelltësi
6.	allocate	*alokoj*	caktoj, ndaj
7.	attitude	*atitudë*	qëndrim, pikëpamje
8.	beneficiary	*beneficiari*	përfituesi
9.	Cool	*kull*	i qetë, i mirë, në hap me modën
10.	delineate	*delienoj*	përcaktoj, përshkruaj
11.	devotion	*devocion*	besnikëri, devotshmëri, përkushtim
12.	disfavour	*në disfavor*	në dëm të
13.	distinction	*distinksion*	dallim
14.	dissolution	*dissolucion*	shpërbërje, prishje, shkatërrim
15.	efficiency	*efiçiencë*	efikasitet, efektshmëri
16.	establish	*establishoj*	themeloj, krijoj
17.	Facilitato	*fascilitator*	lehtësues
18.	glamour	*glamur*	atraksion, bukuri, emocion
19.	adjudicate	*judikoj*	gjykoj, jap gjykim, marr vendim
20.	initiation	*iniciacion*	nisje, fillim, futje (në përdorim)
21.	Include	*inkludoj*	përfshij, përmbaj
22.	inconsistent	*inkonsistent*	papajtueshëm, kontradiktor
23.	interfere	*interferoj*	ndërhyj, pengoj, përziej
24.	invalidate	*invalidoj*	zhvlerësoj, bëj të pavlefshme
25.	campaign	*kampanjë*	fushatë
26.	Clause	*klauzë*	dispozitë, nen, artikull
27.	competition	*kompeticion*	garë, konkurs, konkurrencë
28.	construction	*konstruksion*	interpretim, mendim, kuptim
29.	flash news	*flash news*	lajme të shpeejta
30.	hard copy	*hard copy*	kopje (material, tekst) i shtypur
31.	lead	*lideroj*	udhëheq, drejtoj
32.	look	*lluk*	pamje, dukje
33.	negotiate	*negocioj*	diskutoj, zhvilloj bisedime, etj.
34.	nice	*nais*	mirë, bukur, i këndshëm
35.	nullity	*nuliteti*	pavlefshmëria
36.	objection	*objeksion*	kundërshtim
37.	occupy	*okupoj*	zë vendin (e dytë...)
38.	operation	*operacion*	punë, veprim, funksionim
39.	opportunity	*oportunitet*	mundësi, shans
40.	partnership	*partnership*	partneritet, ortaki
41.	perfidiously	*perfidisht*	pabesisht (në mënyrë perfide)
42.	presumption	*presumpsion*	supozim, pandehmë, hamendje
43.	probable	*probabile*	e besueshme, e mundshme
44.	provision	*provizion*	dispozitë, klauzolë
45.	stipulation	*stipulim*	parashikim, përcaktim, specifikim
46.	Stipulate	*stipuloj*	parashikoj, përcaktoj, specifikoj
47.	Support	*suport*	përkrahje, mbështetje
48.	supportable	*suportues*	përkrahës, mbështetës
49.	Vulnerable	*vullnerabël*	i rrezikuar, i pambrojtur

shkak të përshtatjes së gabuar fonetike, gramatikore e leksikore.

Shtrohet pyetja se a mund të ndërmerret ndonjë masë për ta ndryshuar këtë gjendje. Fatkeqësisht përgjigjja nuk është fort premtuese, meqë

globalizimi ka ndikuar dhe po ndikon shumë edhe në gjuhën shqipe, e kjo është për keqardhje.

A do të thotë kjo se anglicizmat duhen pranuar si një fakt i thjeshtë i jetës moderne? Përgjigja është jo, ngaqë ka mundësi për të mbikëqyrë dhe parandaluar depërtimin e panevojshëm të anglicizmave në gjuhën shqipe. Tekefundit, të vetmit që mund të ndërmarrin ndonjë masë mbrojtëse janë gjuhëtarët dhe studiuesit e tjerë të gjuhës letrare shqipe. Por nëse edhe ata e nënvlerësojnë këtë gjendje dhe nuk ndërmarrin asgjë për ta mbrojtur gjuhën shqipe nga përdorimi i panevojshëm i fjalëve të huaja, dikur mund të bëhet vonë.

Për këtë gjendje të palakmueshme pat shkruar Vesel Nuhiu para katër vjetësh, duke theksuar: "Shqipja siç ka mbetur sot, ka vërtet nevojë për një përkujdesje më të madhe nga shumë anë, prandaj edhe në çështjet e të huazuarit gjuhësor"[12].

5. Korpusi dhe metoda e punës

Materiali për këtë tryezë shkencore është mbështetur në gjuhën e shkruar dhe të folur, por më tepër në gjuhën e disa gazetave të përditshme ditore në Kosovë. Megjithatë, më së shumti janë shfrytëzuar gazeta e përditshme "Kosova sot" e, pjesërisht, edhe 'Koha Ditore", si dhe një buletin vjetor i Korporatës së KEK-ut – Buletini nr. 6. Materiali për huazimet në gjuhën e folur është marrë nga mediet elektronike, gjegjësisht nga disa TV kabllore të Kosovës dhe Shqipërisë. Një numër i vogël shembujsh është marrë edhe nga kontaktet e drejtpërdrejta me folësit përkatës.

Korpusi përbëhet nga 55 trajta fjalësh (apelative) dhe 1 kalk. Fjalët janë marrë në kontekstet përkatëse, ashtu siç janë përdorur nga autorët, në të gjitha format morfologjike, grafologjike e fonetike dhe aspektet e tyre kuptimore. Nga ky numër fjalësh, janë 'përshtatur' 48 huazime të thjeshta (d.m.th. me temë njërrënjëshe) dhe 1 sintagmë emërore; ndërsa të papërshtatura janë: 2 huazime njërrënjëshe, 1 sintagmë emërore dhe 1 kompozitë sintagmë.

[12] Vesel Nuhiu (2013), vep. e cit., ff. 130-131, botuar më parë në Thesis Kosova, nr. I, ff. 111-129, 2008, Universiteti AAB .

Më poshtë po japim listën komplete të huazimeve angleze në gjuhën shqipe, të përshtatura dhe të papërshtatura (që janë shumë pak - 4 gjithsej).

Pasqyra 1

Huazime të përshtatura shqip

Pasqyra 2

Huazime të papërshtatura shqip

	Anglisht	**Shq. në kontekst**	**Shqip**
50.	target	target	synim, qëllim
51.	event	event	ndodhi, manifestim, ngjarje

Pasqyra 3

Sintagmë parafjalore e përshtatur

	Anglisht	**Shq. në kontekst**	**Shqip**
52.	in appearance	në aparencë	në dukje, në shikim të parë

Pasqyra 4

Sintagmë emërore e papërshtatur

	Anglisht	**Shq. në kontekst**	**Shqip**
53.	full frame sensor	full frame sensor	sensor me kornizë të plotë

Pasqyra 5

Kompozitë sintagmë e papërshtatur

	Anglisht	**Shq. në kontekst**	**Shqip**
54.	hard copy flash news	hard copy flash news	tekst (material) i shtypur në letër lajme të shpejta

Pasqyra 6

Kalk (sintagmë foljore)

	Anglisht	**Shq. në kontekst**	**Shqip**
55.	take a test	marr një test	hyj në provim (test), i nënshtrohem testit

Përfundim

Shtrohet pyetja sa është e rëndësishme të mbrohen gjuhët nga ndikimi i gjuhëve të tjera. Kuptohet, gjuhët nuk kanë qenë kurrë statike dhe si rrjedhojë ato vazhdimisht kanë ndryshuar. Varësisht nga periudhat kohore

edhe gjuha shqipe është ndikuar nga greqishtja, latinishtja, turqishtja dhe gjuhët sllave, e sot ne përdorim shumë fjalë të huaja pa qenë të vetëdijshëm se ato janë fjalë të huazuara. Megjithatë, huazimi i fjalëve të huaja duhet të bëhet me kujdes dhe në përputhje me sistemin fonemik dhe gramatikor të gjuhës marrëse, në këtë rast të gjuhës shqipe.

Duke marrë parasysh nivelin e zhvillimit, të përdorimit dhe normën e standardit të shqipes, anglishtja sot nuk mund të paraqesë kërcënim për gjuhën shqipe. Megjithatë, përdorimi i pakontrolluar e pa kriter i huazimeve angleze dhe i fjalëve të huaja në përgjithësi mund të dëmtojë rëndë çdo gjuhë, e rrjedhimisht edhe gjuhën shqipe.

Duke pasur parasysh këtë fenomen negativ të huazimit gjuhësor, konsiderojmë se do të ishte mirë që në nivel të institucioneve përkatëse gjuhësore (letrare e kulturore), siç janë Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, ose ndonjë institucion tjetër përkatës, p.sh. Instituti Albanologjik apo Fakulteti i Filologjisë, të formohet një komision, ekip a trup pune për terminologji dhe anglicizma, për të përcjellë çështjet e huazimit gjuhësor në përgjithësi, e në veçanti huazimet angleze.

Nëse francezët kanë mundur të angazhojnë njerëz të shquar të penës e të politikës, që nga themelimi i Akademisë Franceze më 1635 (me një ndërprerje të vetme në vitin 1793 gjatë Revolucionit Francez), b.f. Volterin, Viktor Hygonë dhe presidentin e mëparshëm Zhiskar Desten pse në shekullin 21 ne nuk mund të formojmë një komision të përhershëm që do të merrej me këto çështje.[13]

Nëse *nuk mund të formohen 3 komisione, atëherë le të formohet së paku 1 sish, në Kosovë dhe në Shqipëri, por jo në nivel të MASHT-it, meqë një gjë e tillë nuk do të funksiononte, jo vetëm për shkak të mungesës së mjeteve financiare, por edhe për shkak të shmangieve të mëdha nga standardi që po bëhen çdo ditë në mediat elektronike dhe të shkruara në Kosovë dhe Shqipëri.*

[13] http://www.telegraph.co.uk/news France's Académie française battles to protect language from English, by Henry Samuel

Detyra ose misioni i këtij komisioni do të ishte:

1. Të përcjellë depërtimin e huazimeve angleze dhe të ofrojë alternativa në gjuhën shqipe,

2. Të përpilojë një listë të huazimeve të reja 'zyrtare' që konsiderohen të pranueshme dhe të përshtatshme për pasurimin e shqipes dhe 'bërjen' e saj gjuhë funksionale për të shprehur realitetin e ri gjuhësor.

3. Ky komision do të dilte herë pas here me kumtesa ose edhe me botime të veçanta, nëpërmjet të cilave do të informonte opinionin publik dhe institucionet përkatëse shkencore, arsimore, e të tjera, me zgjidhjet dhe propozimet e reja.

4. LITERATURA E KONSULTUAR DHE BURIMET SHTESË

Filipović, Rudolf (1971) *Kontakti jezika u teoriji i praksi, Školska knjiga, Zagreb.*

Haugen, Einar (1950) "The Analysis of Linguistic Borrowing", LANGUAGE Vol. 26, No. 2 (Apr – Jun.), pp. 210-231

Nuhiu, Vesel (2013) *Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*, ASHAK, Prishtinë.

Roswitha, Fischer ed. (2008) *Anglicisms in Europe: Linguistic Diversity in a Global Context*, Cambridge Scholars Publishing, p. 3.

Sapir, Edward (1921) *Language: An Introduction to the Study of Speech*, Chap. IX. How Languages Influence Each, New York: Harcourt Brace.

Thomason, Sarah (2001) *Language Contact. An Introduction,* Edinburgh University Press,

Uriel Weinreich (1953) *Languages in Contact: Findings and Problems*, New York, 1953, Reprint, Mouton, The Hague –1963

http://www.dailymail.co.uk French traditionalists up in arms as younger generation uses 'cool' Anglicisms

http://www.multilingualliving.com Loan Words and Borrowing: A Kind of Code-Switching, by *Jacomine Nortier*

http://www.telegraph.co.uk/news France's Académie française battles to protect language from English, by Hanry Samuel

www.langconnect.com The Influence of English on Other Languages (and vice versa) by Marcell Haller

Jashar KABASHI, Prishtinë

UNCONTROLLED INFLUX OF ANGLICISMS – A CHALLENGE FOR ALBANIAN

Summary

The aim of this article was to draw attention to the influx of English borrowings in Albanian, known also as "Anglicisms "or loanwords. Apart from this, attention has also been focused on the need for adaptation of English borrowings, and on how to supervise and manage uncontrolled infiltration of English terms in Albanian language.

Nowadays, English has a strong influence on other languages, because it has become a "lingua franca "– a global language. The main reason for this influence is the rapid economic and cultural development of Britain and, in particular, USA, which after World War II emerged as a global superpower and cultural giant, also leading the way in scientific research and technological innovation. As a result, English replaced French as an international language, which, during the Norman invasions had influenced English to a great extent.

With the use of English as an international language of communication throughout the world, the influence of English on the vocabulary of other languageshas been especially intensified in the last 15-20 years; hence, Albanian language, in both Kosovo and Albania, is no exception.

The material for this article was based on the written language of some daily newspapers in Kosovo, especially "Kosova Sot" and "Koha Ditore", and Bulletin No. 6 of Kosovo Power Corporation, while the data for spoken English loanwords were collected from some TV providers in both Kosovo and Albania.

In order to administer and handle the influx of English borrowings in Albanian, a suggestion was made to establish a committee, team or working group for terminology and Anglicisms in both Kosovo and Albania. This committee would exist at the level of both Kosovo Academy of Sciences and Arts and Albanian Academy of Sciences, the Institute of Albanology or the Faculty of Philology, but not at the Ministry of Education, Science and Technology of Kosovo, because that would not work.

The task or mission of this committee would be to:

1.Follow the use of English terms and offer alternatives in Albanian.

2.Compile a list of new "official "borrowings, which are considered acceptable and suitable for the enrichment of Albanian language, and making it a functional language to expresses the new language reality, and

3.Come out, from time to time, with papers or special publications, through which the public and the relevant scientific and educational institutions would be informed about their new solutions and proposals.

Arta TOÇI, Tetovë

ANGLICIZMAT NË MEDIAT ELEKTRONIKE NË SHQIPËRI, KOSOVË DHE MAQEDONI

KDU 811.135/.18(497)'362

Abstrakt

Në këtë studim synohet analiza e rolit të huazimeve angleze në mediet elektronike në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni, si dhe dhënia e përgjigjes për pyetjet vijuese: a i përdorin mediet shqiptare në këto tri vende të njëjtat huazime angleze dhe nëse këto huazime shfaqen në konteste të njëjta apo të ngjashme. Studimi është kryer në një periudhë njëmujore në dy kanale televizive të secilit prej këtyre vendeve lidhur me kontekstiet e huazimeve angleze në shqipen..

Fjalë çelës*: huazime, media, gjuhë, ekspertë*

Pasurimi i gjuhës është një proces i vazhdueshëm i cili duhet kryer me ndërhyrjen e drejtpërdrejt të gjuhëtarëve. Ky proces bëhet më kompleks kur faktorët publik siç është media nuk mund të injorohen për arsye të sjelljes dhe krijimit të vlerave të reja në shoqëri. Media, sidomos ajo elektronike, po bëhet gjithnjë e më globale, interaktive, lokale dhe personale. Gjuha e përdorur në këto media është gjuha e gazetarëve, politikanëve, prezantuesve dhe personave tjerë publikë. Duke pasur parasysh numrin e njerëzve të ekspozuar në mediat elektronike, është me rëndësi që protagonistët kryesorë në këtë proces ta kuptojnë rolin e tyre në promovimin e vlerave gjuhësore. Para se të analizohet ndikimi i mediave në zhvillimin gjuhësor, duhet përgjigjur së pari pyetjes se a thua gjuha e përdorur në mediat elektronike kontribuon në lindjen e një gjuhe të re krahasuar me atë të komunikimit tradicional, siç janë librat. Në këtë drejtim Marshall Meklajën (1989) shkon edhe më larg duke thënë: "mediat elektronike përdorin një gjuhë të re, gramatika e së cilës është akoma e panjohur për gjuhëtarët".

Anglicizmat po zënë një vend të rëndësishëm në gjuhën shqipe sidomos në gjuhën e folur dhe atë të shkruar në mediat në përgjithësi. Shumë fjalë të huaja të cilat përdoren në gjuhën shqipe e kanë ekuivalentin e vet në po këtë gjuhë, por ndodh shpesh që në aspektin semantik ato të ndryshojnë në nuanca të vogla dhe pikërisht kjo mund të jetë edhe arsyeja që

fjalët shqipe zëvendësohen me ato të anglishtes. Dihet mirë se gjuha angleze historikisht ishte 'huazuesi' më i madh i fjalëve të huaja. Trask (1996), thekson se më tepër se gjysma e fjalëve të gjuhës angleze janë të huazuara nga gjuhë të tjera, gjuhë të cilat në kohë konsideroheshin si 'gjuhë të prestigjit', siç ishin gjuha frenge dhe ajo gjermane. Blumfild (1993) shton se prestigji i një gjuhe është një ndër arsyet e huazimit të fjalëve nga gjuhët tjera dhe se është një rregull i përgjithshëm që gjuhët më pak prestigjioze të huazojnë nga ato më prestigjiozet. Gjuha, përpos detyrimit parësor të vendosjes së komunikimit verbal, paraqet një strukturë sociale e cila e përcakton pozitën shoqërore të atij që e perdor gjuhën e tjetrit. Lufta e padukshme e dominimit me anë të gjuhës reflekton mbi tendencat e dominit në përmasa më të mëdha. Është vështirë të gjenden shembuj të përdorimit të gjuhës së pakicës nga ana e shumicës; shembuj të përdorimit të gjuhës së të zive nga të bardhët; gjuhës së të pushtuarit nga ana e pushtuesit. Ne më mirë i njohim këto rrethana, sepse jemi protagonist të përdorimit të shumë gjuhëve dhe futjes së shumë fjalëve të huaja në gjuhën për të cilën me krenari themi se është më e vjetra në Evropë.

Fjalët e huaja kanë qenë gjithmonë prezente si në gjuhën shqipe poashtu edhe në gjuhët tjera. Mirëpo duhet cekur se në mediat në gjuhën shqipe po përhapen huazimet e reja duke e tejkaluar në masë të madhe numrin e huazimeve tanimë të njohura në gjuhën tonë. Këto huazime janë kryesisht fjalë të gjuhës angleze të cilat futen në kontekstin e shqipes, me fonetikën e pandryshuar, mirëpo me morfologjinë dhe sintaksën e shqipes. Bejtëns-Berdsmur(1982) theksojnë se shkalla dhe mënyra e përdorimit të anglicizmave varet nga prejardhja sociale e përdoruesit të huazimeve, prejardhja gjuhësore si dhe ndjeshmëria e përgjithëshme ndaj përdorimit të drejtë të strukturave gjuhësore.

Në shoqëritë në të cilat gjuha po 'bastardhohet' me fjalë të huaja, paraqitet revolta e atyre që me çdo kusht mundohen ta ruajnë pastërtinë e gjuhës. Megjithatë trendi i huazimit bëhet faktor dominues për arsye se 'gjuha e prestigjit' flitete nga shtresat me influencë të cilat kanë ndikim në masat e gjerë shoqërore. Në këtë mënyrë përdorimi i fjalëve të huaja, respektivisht të gjuhës angleze në gjuhën shqipe krijon efekte sociolinguistike dhe e përcakton pozitën shoqërore të individit në shoqërine shqiptare.

Shumë vite më parë në gjuhën tonë janë adoptuar fjalë turke, më vonë fjalë nga gjuha frenge, më pas nga ajo italiane, kurse një pjesë e madhe e trungut shqiptar e rrethuar nga gjuhët sllave, mbeti e pambrojtur nga ndikimi i këtyre gjuhëve në gjuhën e shkruar e sidomos atë të folur. Viteve të fundit me zhvillimin e teknologjisë, epokës së kompjuterëve dhe internetit, bëhet evident ndikimi i gjuhës angleze në të gjitha gjuhët e botës, duke përfshirë këtu edhe gjuhën shqipe. Gjatë analizës së përdorimit të huazimeve do të konstatojmë se ndikimi i ekspozimit në një gjuhë është faktor i rëndësishëm dhe i pashmangshëm i cili krijon një koncept të ri mbi gjuhën.

Duke iu kthyer përsëri kulturës së përdorimit të gjuhës, do i kthehem kulturës së përgjithshme dhe përhapjes së saj nëpërmjet mediave. Njerëzit e mediave bëhen persona publikë të cilët ndodh edhe të imitohen nga një strukturë njerëzish, duke e kopjuar në këtë mënyrë sjelljen, pamjen dhe sidomos gjuhën e tyre. Kështu, ndërtohen normat dhe vlerat e reja shoqërore shpesh duke hapur një hendek kulturor dhe gjuhësor. Për studim më të thelluar të përdorimit të anglicizmave në mediat elektronike në gjuhën shqipe kam bërë një analizë të disa progrmave në gjashtë shtëpi televizive në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Ky studim ka për qëllim:

- ta analizojë përdorimin e anglicizmave në mediet elektronike në gjuhën shqipe në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

- t'i analizojë ngjashmëritë dhe dallimet e anglicizmave të përdorura në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

Duke qenë se media është prezantues i një kulture të caktuar, ky studim i hulumton disa të dhëna të cilat vërtetojnë se media është një faktor i rëndësishëm i cili ndikon në komunikimin mes njerëzve. Ky studim gjithashtu ka për qëllim ta ngrejë vetëdijen e gazetarëve dhe njerëzve të tjerë publikë për sa i përket përdorimit te drejtë të gjuhës shqipe.

Procedura

Janë analizuar televizione private dhe shtetërore:

Shqipëri: Top Channel dhe Vizion+; Kosovë: RTK dhe KTV; Maqedoni: TVM e Alsat M

Studimi ka zgjatur për një muaj dhe janë analizuar programe të zhanreve të ndryshme:

1. Një edicion i lajmeve në ditë nga secili televizion

2. Shou programe:


Top channel: "Wake up "dhe "E diel"; Vizion Plus: "Chic+ "dhe "Next"
RTK: "Imazh "dhe "Pro et Contra"; KTV: "Express summer "dhe "038"
Alsat-M: "Pizzicato "dhe "Busted"; RTM 2: "Morning show "dhe "Fun show"

3. Program propagandues që shfaqet para dhe pas edicionit të lajmeve qëndrore.

Të dhënat në vijim e ilustrojnë përdorimin e anglicizmave në mediat elektronike ne gjuhën shqipe në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni:

Rezultatet e përgjithshme

	Top Channel	Vision Plus	RTK	KTV	Alsat-M	RTM 2
Anglicizmat	94	72	68	81	76	47
Performance	V	V	V	V	V	V
Menaxhoj	X	V	X	X	V	X
Diversitet	X	V	X	X	X	X
Kapacitet	X	V	X	X	X	X
Memorje	X	V	X	X	X	X
Narrative	X	V	X	X	X	X
Vizion	X	V	X	X	X	X
Nostalgji	X	V	X	X	X	X
Interpretim	X	V	X	V	V	V
Spektakël	X	V	X	X	X	X
Plan	V	V	V	X	X	V
Sociale	X	V	X	X	X	X
Eksperiencë	X	V	V	V	X	X
Adekuat	X	X	X	V	X	X
Promocion-promovim	X	X	X	V	X	X
Lider	X	X	V	V	V	X
Trajnim	X	X	V	V	X	V
Profit	X	X	X	V	X	X
Ekzagjerime	X	X	X	V	X	X
Presidenti	V	X	X	X	V	X
Divorcuar	V	X	X	X	X	X
Event	X	X	V	X	X	X
Substanciale	X	X	X	X	V	X
Negociata	X	X	X	X	V	X
Opinion	X	X	X	X	X	V
Fans	X	X	V	X	X	X



Paraqitja grafike1: Numri i përgjithshëm i anglicizmave i përdorur sipas shtëpive tv

Të dhënat nga shou programet

Tabela 1: Anglicizmat e përdorur në shou programet

	Top channel	Vision plus	Rtk	Ktv	Alsat-M	RTM2
Anglicizmat	99	66	65	72	81	60
Aplikoj	V	V	X	X	X	X
Debate	V	X	X	X	V	X
Favor	V	X	X	X	X	X
Efekti	V	X	X	X	X	X
Kosto	V	X	X	X	X	X
Impakt	V	X	X	X	X	X
Akuzoj	V	V	V	X	X	X
Produkte	V	X	X	V	X	X
Frekuentoj	V	X	X	X	X	X
Publikoj	V	V	V	V	V	X
Fokusoj	V	X	X	X	X	X
Social	V	V	X	X	V	X
Sektor	V	X	X	X	X	X
Presion	V	X	X	V	X	X
Justifikim	V	V	X	V	X	X
Negociata	V	V	X	V	X	X
Nostalgji	V	X	X	X	X	X
Akomodim	V	X	X	X	X	X
Konkluzion	X	V	V	X	X	X
Religjioze	X	X	V	V	X	X
Promovim	X	X	V	V	X	X
Menaxher	X	X	V	V	X	X
Opinion	V	V	V	V	V	V
Influencë	V	V	V	V	V	V
Diskutim	V	V	V	V	V	V
Spektator	X	X	X	X	V	X
Arrestim	V	V	V	V	V	V
Adekuate	X	X	X	V	V	V
Vikend	V	V	V	V	V	V

Të dhënat nga edicionet e lajmeve

Tabela 2: Anglicizmat e përdorur në edicionet e lajmeve

Të dhënat nga reklamat

Anglicizmat	Top channel	Vision plus	Rtk	Ktv	Alsat-M	RTM 2
	15	16	11	12	15	10
Kingu	V	X	X	X	X	X
Mesazhe	V	V	V	V	V	V
Ëhat's up	V	V	X	X	X	X
Sms	V	V	V	V	V	V
Back up	V	V	X	X	X	X
Shoë	V	V	V	V	V	V
Ultra	V	V	V	V	X	X
Preferoj	X	X	X	V	X	X
Best ëay	X	X	X	X	V	X
Home	V	V	V	V	V	V
Fusion	X	X	X	x	V	X
Fresh	V	V	V	X	V	X
Totale	X	X	V	X	X	X
Movie	V	V	X	V	X	X
Platformë	V	V	V	X	X	X
Produkte	V	V	V	V	V	V
Extra	V	X	X	X	X	X
Dizajn	V	V	X	X	X	V
Check up	X	V	X	X	X	X
Avantazh	X	V	X	X	X	X
Persekutim	V	V	X	X	X	X
Sponsor	V	V	V	V	V	V
Easy talk	X	X	X	x	x	V

Tabela 3: Anglicizmat e përdorur në programet propaganduese

Konkluzionet:

1. Mediat në gjuhën shqipe përdorin fjalë të huazuara jo vetëm nga anglishtja

2. Mediet në Shqipëri përdorin fjalë të huaja më tepër se mediet në gjuhën shqipe në Kosovë dhe në Maqedoni.

3. Në secilin edicion të lajmeve përdoren më tepër se 50 fjalë të huaja.

4. 5 fjalët që gjejnë përdorim më të shpeshtë në mediet elektronike janë: *performance, management, sense, look, background*.

5. Mediat në Shqipëri po i zëvendësojnë huazimet italiane me ato angleze.

6. Sa më i madh ndikimi i personit që perdor një anglicizëm, aq më i shpejtë është përdorimi i të njëjtit nga masat e gjera.

7. Anglicizmat në mediat elektronike në gjuhën shqipe janë emra, folje dhe mbiemra.

8. Fjalët e përbëra nuk paraqiten si anglicizma.

9. Mediet në gjuhën shqipe në Maqedoni përdorin anglicizma në numër më të vogël, por duhet theksuar se në to akoma gjenden sllavizma.

10. Sintaksa e medieve në gjuhën shqipe në Maqedoni është e ndikuar nga sintaksa e maqedonishtes

Rekomandimet për të ardhmen

Në interes të ruajtjes dhe mbrojtjes së gjuhës nga ndikimet e jashtme është më se e domosdoshme që Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës të formojnë një grup punues, në të cilin do të inkuadron edhe ekspertë shqiptarë nga Maqedonia, i cili do të ketë për detyrë që të japë rekomandime, autorizime dhe sugjerime të vlefshme për planifikimin e politikave gjuhësore. Duke pasur parasysh shpërndarjen gjeografike të shqiptarëve dhe dallimet gjuhësore që vijnë si pasojë e kësaj shpërndarjeje, ky grup punues duhet t'i synojë këto qëllime:

- pastrimin e gjuhës nga të gjitha huazimet;

- ripërtëritjen e fjalëve shqipe tanimë të zëvendësuara me fjalë të huaja;

- reformat gjuhësore, siç do të ishte rishikimi dhe thjeshtëzimi i gramatikës shqipe;

- modernizimi i leksikut, i cili do t'i plotësojë hendeqet e krijuara mes gjuhës ekzistuese dhe terminologjisë që lind si pasojë e zhvillimit të teknologjive moderne.

Bibliografia

Akmajian,A.,Demers,A.,R.,Farmer,A.,K.,Harnish,R.,M.,(2001).*Lingustics (An introduce-tion to language and Communication),* The MIT press, Cambridge, Massachusetts, London England.

Croteau,D.,&Hoynes.W.,(2002). *Media and Society,* Pine Forge Press.Third edition

Eastman, Carol. *Language Planning: An Introduction*. San Francisco: Chandler, 1983.

Hohenhaus, Peter. "Standardization, Language Change, Resistance and the Question of Linguistic Threat: 18th-Century English and Present-Day German". *Standardization:*

Studies from the Germanic Languages. Eds. Andrew R. Linn and Nicola McLelland. Amsterdam: John Benjamins Publishing Company, 2002.

Krzeszowski, T. P. (1990) *Contrasting languages*: *the scope of contrastive linguistics.* Berlin: Mouton De Gruyter.

Lee,Th.L., (2012). *History and development of mass communications*.University of Nebraska-Lincoln USA http://www.eolss.net/sample-chapters/c04/e6-33-02-01.pdf Retirived on 27th september 2012

Odlin, T. (1989) *Language Transfer:* cross-linguistic influence in language learning. Cambridge: Cambridge University Press.

Rakipllari,XH.,(February 20, 2012). *Gjuha Shqipe dhe Media* (article) http://fryma.blogspot.com/2012/02/per-nje-fjalor-te-ri-te-fjaleve-te.html Retrived on 21 of March 2012.

Willie,M.(1979*) 'The Mass Media and Language Development',* Australian, Journal of Teacher Education;Vol 4;Iss.2, Article

Trask, R. (1996), *Historical Linguistics,* The MIT press, Cambridge, Massachusetts, London England

Arta TOÇI, Tetovë

ENGLISH BORROWINGS IN THE ELECTRONIC MEDIA IN ALBANIA, KOSOVO, AND MACEDONIA

Summary

English borrowings have an important role in the Albanian language, partcularly in the spoken and written language of the media in general. Many Albanian words that have an equivalent in the Albanian language are used in English. It is wellknown that English was the biggest borrower of loanwords, especially from French and German, the two languages that were considered as the most prestigious languages at that time. The enrichment of languages is a continuous process which needs to be done under direct supervision of experts in the field. This process becomes even more complicated and complex when the role of the media cannot be ignored due to the fact that it brings new values in the society. Media, especially the electronic one, becomes more global, inetactive, local and personal. The language in this media is the language used by the journalists, politicians, presenters and by people of the public life. Taking into account the number of people expossed to the electronic media, it is very important for the main characters in this process to understand their role in the promotion of new language values.

This study aims to analyze the role of English borrowings in the electronic media in Albania, Kosovo and Macedonia, as well as to give answer to the following questions: Do the Albanian media in these three countries use the same English loanwords and if these loan words are put in the same or similar context. The study was conducted in a period of a month when two TV channels from each of these countries were investigated in terms of the context of English borrowings in the Albanian language.

Valter MEMISHA, Tiranë

DEPËRTIMI I EMËRTIMEVE TË SHKURTUARA NË SHQIPE PREJ ANGLISHTES

KDU 811.18'373.45
811.111

Nga kontaktet e shumëfishta, të shumanshme, të pandërprera e gjithnjë në rritje me anglishten si një gjuhe ndërkombëtare dhe tepër trysnuese, shqipja ka huazuar prej saj shumë njësi leksikore që dalin si huazime gjuhësore (foresterizma ose të njohura ndryshe me termin anglicizma) dhe si huazime historiko-kulturore (për të cilat ajo ka nevojë).

Ky proces huazues vërehet edhe në fushën e emërtimeve të shkurtuara. Këto lloje emërtimesh, ashtu si në anglishte, dhe në shqipe janë realitete gjuhësore dhe formojnë një grupim paradigmatik njësish, të cilat, duke ndjekur prirjet e gjuhës, vijnë duke u shtuar me ritme të shpejta. Këto lloj emërtimesh në gjuhën tonë dhe jo vetëm në këtë gjuhë, i gjen gjithandej dhe kanë krijuar tashmë një sistem të qartë strukturoro-funksional, Ato formojnë një klasë heterogjene, e cila përfshin njësi që mund të grupohen në tipa, nëntipa, grupe, nëngrupe etj.

Por përdorimi i tyre, jo rrallë, shpërfaq pasaktësi e mangësi që lidhen me të gjitha rrafshet, madje dhe me atë onomasiologjik (ka të bëjë më shumë me pasaktësinë e përdorimit të terminologjisë). Sot përdoren, por dhe ngatërrohen, termat shqip *emërtim i shkurtuar, shkurtim* dhe *shkurtesë*, si dhe termat e huaj *abreviacion, abreviaturë, akronim, inicializëm, alfabetizëm, shkrirje* etj., edhe pse në literaturën shkencore janë terma të diferencuar semantikisht.

Termi *emërtim i shkurtuar* është përdorur nga ne si term përfshirës, hiperonimik. Në klasën e njësive nën këtë emërtim futen *shkurtimet* dhe *shkurtesat.*

A. *Shkurtimet* janë paraqitje shkronjore e një fjale a një grupi fjalësh në trajtë të shkurtuar për nevoja të ekonomizimit shkrimor. Prej këtej del se procesi i shkurtimit lidhet kryesisht me variantin shkrimor të gjuhës.

Shkurtimet, zakonisht, nuk janë fjalë të mëvetësishme[1], nuk kanë kategori gramatikore, nuk funksionojnë si gjymtyrë fjalie, nuk kryejnë funksione sintaksore dhe mbeten thjesht problem nga ana shkrimore (e drejtshkrimit).

Shkurtimet, me të cilat kontakton jo vetëm shqipja e që i ndesh shumë shpesh në të ligjërimin e shkruar, janë të shumta dhe taksonimohen në fusha, nënfusha e mikrofusha. Po përmendim disa grupime, edhe pse vetë anaglishtja një pjesë prej tyre mund t'i ketë huazuar (sidomos nga greqishtja dhe latinishtja):

1. Shkurtime të emërtimeve të titujve shkencorë, të profesioneve etj.: *akad. akademik, prof. profesor, dr. doktor, agr. agronom, arkit. arkitekt* etj.

2. Shkurtime *të emërtimeve administrative,* të kontinenteve, të shteteve etj., që zakonisht mund të jenë formuar nga dy a më shumë shkronja, por dhe nga një shkronjë e vetme, si p.sh. *AL (Albania – Shqipëri), RO (Rumani)* etj. Këtu po futim edhe shkurtimet e emërtimeve të shteteve, që përdoren në targat e makinave, si: *GB (Grand Britain / Britani e Madhe), GR (Greece / Greqi), I (Italy / Itali),* etj.

3. Shkurtime që lidhen me fushën e informatikës: B (bajt) KB (kilobajt), MB (megabait) b (bit), Kb (kilobit). Sot kjo është fusha me prurjet më të shumta në shqipe.

4. Shkurtime *të pikave të horizontit,* si: *N (Veri), S (Jug), E (Lindje), W (Perëndim).* Madje, nga bashkimi i tyre është formuar edhe fjala NEWS që del si homoformë me numrin shumës të New (i ri / e re - lajm) etj.

5. Shkurtime *të emërtimeve të njësive matëse të sistemit britanik*:

a. Shkurtime të *emërtimeve të njësive matëse të gjatësisë*: *in (inch / inç – 25,4mm), ft (foot / këmbë – 30,48 cm); yd (yard / jard – 0,9144 m), mi (milje / milje – 1, 6093 m), NM (nautic milje / milje detare – 1,852 m)* etj.

b. Shkurtime të *njësive matëse të sipërfaqes*: *sq in (square inch / inç – 6,4516 cm^2), sq ft (square foot / këmbë – 0,0929 m^2)* etj.

c. Shkurtime të *emërtimeve të njësive matëse të vëllimit*: *cu in (cubic inch / inç – 16,387 cm^3), cu ft (cubic foot / këmbë – 28,317 dm^3)* etj.

ç. Shkurtime të *emërtimeve të njësive matëse të vëllimit të lëngjeve:*

[1] Sot, veçanërisht në ligjërimin e shkujdesur, po vërehet prirja për të përdorur si fjalë të mëvetësishme edhe shkurtimet, si *tung* (tungjatjeta), *prof.* (profesor) etj.

qt (quart – 1,136 l), gal (gallon – 4,545 l), oil bbl (barrel petrol USA / fuçi nafte -158,970 l) etj.

d. Shkurtime të *emërtimeve të njësive matëse të peshës*: *oz (ounce – 28,349 g), Ib (pound – 0, 454 kg); ton I (long ton – 1,016 t)* etj.

dh. Shkurtime të *emërtimeve të njësive matëse të shpejtësisë*: *mi / h (milje për orë)* etj.

5. Shkurtime të emërtimeve të monedhave shtetërore: *GBP (Paundi i Britanisë së Madhe); CHF (Franga e Zvicrës)* etj.

6. Shkurtime të *emrave e të mbiemrave të njerëzve a të pseudonimeve* të tyre: *Jelo (Jennifer Lopez)* etj.

B. Grupin e dytë të emërtimeve të shkurtuara që kanë depërtuar nga anglishtja në shqipe e krijojnë *shkurtesat*, që, ashtu si në shqipe, janë *fjalë të formuara nga bashkimi i dy a më shumë temave të shkurtuara të një emërtimi togfjalëshor a të një emërtimi të pathjeshtë, duke dalë si një lloj i veçantë kompozitash*[2]. Ndryshe nga shkurtimet, *shkurtesat* funksionojnë si fjalë të mëvetësishme, me rrafshin e shprehjes dhe atë të përmbajtjes, shqiptohen si njësi të njëfjalësuara, marrin tregues gramatikorë dhe kryejnë funksione të ndryshme sintaksore[3].

Edhe shkurtesat e huazuara nga anglishtja janë të tipit *nistor-tingulloro-shkronjor* dhe të tipit *rrokjesor*.

Te shkurtesat e *tipi nistor* po përmendim tri grupe kryesore:

a. Shkurtesa ku përfshihen emërtime që formohen nga bashkimi i tingujve nistorë të fjalëve të një emërtimi të përbërë. Këto shkurtesa në shqipe shqiptohen *si një fjalë e zakonshme*, duke u lehtësuar nga prania e zanoret në përbërjen e tyre: *NATO (North Atlantic Treaty Organisation), UEFA (Union European Football Associations), FIFA (Federation Internationale Footboll Association).*

b. Shkurtesa që formohen nga bashkimi i tingujve nistorë *bashkë-*

---

[2] *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, Tiranë, 2002, f. 74

[3] Procesi i krijimit të një shkurtese është katërshkallësh: *përdorimi* si emërtim i pathjeshtë *i togfjalëshit* që kthehet në shkurtesë, *shkurtimi i emërtimeve* që janë gjymtyrë të emërtimit të pathjeshtë dhe krijimi i shkurtesës, *përdorimi dysh* i emërtimit të plotë edhe i shkurtesës, *përdorimi në ligjërim* i *shkurtesës* si njësi e pavarur, por pa i shkëputur lidhjet, tashmë të pandërmjetësuara, nga togfjalëshi *emërtim i pathjeshtë*.

tingëllorë të fjalëve të një emërtimi të përbërë. Këto bashkëtingëllore duhet të shoqërohen nga zanorja ***-ë***: PBS (Public Broadcasting System/ (lexo Pëbësë, Sistemi publik i radiopërhapjes) etj. Një numër i madh shkurtesash të këtij grupi shqiptohen si në anglishte: *BBC (bibisi - British Broadcasting corporation / Televizioni i Korporatës Britanike për Radiopërhapjen)* etj.

c. Shkurtesa të *nëntipit të përzier* që *mund të kenë dy a më shumë bashkëtingëllore pranë njëra-tjetrës,* që në shqipe shqiptohen të shoqëruara me zanoren ***ë*** si: *UNDP (Unëdëpë - United Nations Development – Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim);* OSCE/ *OSBE (Osëbëe - Organizata për Siguri dhe bashkëpunim në Europë)* etj.

Grup të madh shkurtesash formojnë ato *të tipit rrokjesor,* si: *Frankenfood* (kombinim i *Frankenstein* dhe *food*), *pixel* (*picture* dhe *element*), *staycation* (*stay* dhe *vacation*) etj. Ky grup kohët e fundit është shtuar ndjeshëm, sepse shumë prej tyre përdoren si fjalë ndërkombëtare, si: *Beneluks (Belgium, Netherlands, Luksemburg / Belgjikë, Holandë, Luksemburg); Interpol (Internacional Police – Policia Ndërkombëtare)* etj..

Në anglishte shfaqet një prirje për formime të shumta të emrtimeve të shkurtuara. Kjo, pashmangshmërisht, çon te mjaft formime rastësore (okazionale). Ato huazohen lehtësisht në publicistikë, sepse kanë një sistem të qartë strukturoro-funksional dhe dalin si sendërtim i drejtpërdrejtë i ligjit të ekonimosë gjuhësore. Në këtë grup ndeshen shkurtesa për shtetet e institucionet shtetërore, për partitë politike, për gazetat e stacionet televizive, për ndërmarrje tregtare, për botën e sportit, për mjekësinë, jetën ushtarake, për kiberneitikën e informatikën, për ekonominë e bankat, për institucionet arsimore të larta a shkencore etj.

Cili do të jetë qëndrimi shkencor ndaj huazimit të emrtimeve të shkurtuara në shqipe?

a. Emërtimi i shkurtuar, por sidomos një shkurtesë, hyn nga anglishtja në shqipe në të njëjta kushte kur hyn edhe një fjalë: kur është ndërkombëtare, kur e kërkon një stil i caktuar i gjuhës, kur huazohet së bashku me objektin etj. Shkurtesat si *ndërkombëtarizma* përbëjnë numrin më të madh të shkurtesave të huazuara. Ato lidhen me institucione apo me organizma të ndryshme që veprojnë dhe që njihen në mbarë botën, ndaj dhe përdorimi i tyre në shqipe nuk krijon vështirësi. Këto lloj shkurtesash janë

bërë kaq të zakonshme për përdoruesit shqipfolës, saqë shpesh ata nuk interesohen për formën a kuptimin e emërtimit të plotë dhe, madje, ndonjëherë as nuk i ndiejnë këto njësi si shkurtesa. Të tilla mund të përmenden: *NATO (North Atlantic Treaty Organisation/ Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior), PIN (Personal Identification Number/ Numri i identifikimit vetjak); SARS (Symptome of Acute Respiratory Syndrome/ Simptoma të sindromës së frymëmarrjes akute), SIDA (Acquired Immune Defficiency Syndrome/ Sindromë e Mangësisë së Imunitetit të Trashëguar), UFO (Unidentified Flying Object/ Objekt Fluturues i Paidentifikuar)*, *UNICEF (United Nations International Children's Emergency Fund - Fondi Ndërkombëtar i Emergjencës për Fëmijët pranë Kombeve të Bashkuara), FAO (Food and Agriculture Organisation - Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë)* etj. Për këto shkurtesa nuk është e nevojshme të krijohen shkurtesa të reja nga përkthimi i tyre në shqipe.

b. Në medien e shkruar shqiptare gjejmë jo pak shkurtesa për emërtime të huaja, që dalin si formime kalimtare. Në përdorimin e përditshëm ndeshen, kështu, shkurtesa në dy forma, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, zakonisht në anglisht. Të tilla mund të përmendim: *USA (United States of America)* dhe *SHBA (Shtetet e Bashkuara të Amerikës)*, *OSCE (Organisation for Security and Cooperation in Europa)* dhe *OSBE (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë)* etj. Këto shkurtesa vijnë si përkthim i trajtës së huaj dhe riformim i shkurtesës, tashmë në gjuhën shqipe[4]. Normative, këtu, duhet të jetë përdirimi i shkurtesave shqipe.

c. *Drejtshkrimi i emërtimeve të shkurtuara* paraqest probleme në shqipen e sotme. Po listojmë disa:

Shkurtimet rrokjesore a të pjesshme, mendojmë, se duhet të shkruhen me shkronja të vogla dhe me pikë në fund; p.sh. *prof., dok., agr.* etj.

Probleme që lidhen me normën shkrimore ka edhe te s*hkurtesat e huazuara*. Nqs drejtshkrimi i shqipes pranon përdorimin e *shkronjës së madhe për çdo fjalë të emërtimit të shkurtuar* (edhe pse aty-këtu ka problem me shkronjat dyshe, si *dh, th, sh* etj., për të cilat ne jemi për normën që vetëm shkronja e parë e tyre të jetë e madhe, si FGjSh / Fjalor i gjuhës

[4] F. Agalliu, Z. Karapizi, *Cilat nga shkurtesat e huaja shqipërohen*?, në Gjuha Jonë, 2, 1983, f. 97-99

shqipe), emërtimet e shkurtuara që hyjnë nga anglishtja që në burim, kanë shumë probleme, qofshin formimet si akronime, qofshin ato rrokjesore. Problemet mbarten në mënyrë tepër mekanike dhe në shqipe, sidomos në medien e shkruar.

1. Shumë emërtime të shkurtuara rrokjesore fillojnë me shkronjë të vogël dhe në trup kanë një shkronjë të madhe që të shpie, ose te shkronja e parë e fjalës së shkurtuar, si *iPod, iPad, iPhone* etj., ose te shkronja e parë e një fjale të plotë, si *McDonald, McAndrwe, McCormack* (*Certifikimi i zgjedhjeve kërkon një KQZ me pesë anëtarë*. Dita, 12 qershor 2013).

2. Në shqipe krijojnë probleme, sidomos në shqiptim, *shkurtesat e huazuara* me shkronjën W (që nuk njihet si grafemë e alfabetiti të gjuhës sonë), si *WHO (World health organisation/ Organizata botërore e shëndetit; WIPO (World intellectual property organisation / Organizata botërore e pronësisë intelektuale); WMO (World metereological organisation / Organizata botërore e metereologjisë* etj.). Jemi të mendimit që shkurtesa të kësaj kategorie nuk duhet të lejohen të përdoren në shqipe, sepse gjuha jonë ka krijuar shkurtesat gjegjëse që tashmë e kanë fituar qytetarinë dhe përdorimi i tyre dysh sjell thjesht një konkurrim të pavlerë.

3. Probleme krijojnë edhe shkurtesat e huazuara që kanë në trup një grafemë që e ka edhe shqipja, por që nuk reflekton tipin tingullor të saj, si: NYT (Nyt - New York Times: *Duke rikujtuar marrëveshjen e arritur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë më 19 prill të këtij viti për normalizimin e raporteve midis dy vendeve, NYT vlerëson se ajo është e mrekullueshme si në rrafshin personal, ashtu edhe në atë politik*); PSG / Pi-es-xhi / pësëzhë (Paris Saint-Germain Football Club), PSV / pi-jes-fi / pësëvë) (Philips Sport Vereniging Eindhohen, Holland) etj. AMC (Albanian Mobile Communications). Po kështu të rinjtë shqiptarë flasin për një CD / *sidi* (dhe jo Cëdë apo Këdë etj. Po kështu, CEFTA (cefta): *Në takimin e pestë të CEFTA-s u treguan qëndrimet e Kosovës dhe Shqipërisë lidhur me nënshkrimin (mos-nënshkrimin) e Protokollit për Largimin e Kroacisë nga CEFTA,* (Kosova sot, 20 qershor 2013). Për këtë grup po mbizotëron shqiptimi sipas grafemave të shqipe.

4. Probleme në shqipe paraqesin emërtimet e shkurtuara që dalin herë si akronime shkronjore, herë si formime rrokjesore apo si shkrirje

(blends), të cilat në anglishte dalin: me pika pas çdo shkronje, pa pika, me shkronja të vogla a me shkronja të mëdha në temë etj. shembulli më klasik është PhD/ Pi ejxh di (doktor në filozofi) që del si *Ph.D., PhD, D.Phil., DPhil* madje edhe *Dr.Philos.*

Këtu po përmendim edhe emërtimet e shkurtuara (shkurtime dhe shkurtesa) që kanë ndërtime paralele, dyshe, dhe që kanë hyrë në shqipe po si të tilla, si KB dhe Kbyte (kilobajt), Kb dhe kbit (kilobit). Nëse do t'u nënshtrohen normës gjuhësore të shqipes, të paktën shkurtesat do të shkruhen me shkronja të mëdha, edhe pse krijojnë homonimi grafemore.

5. Në shqipe kanë hyrë shumë shkurtesa, të cilat nuk kanë vlerë emërtuese të mirëfilltë, sidomos shkurtesat për prodhimet kompjuterike, të makinave të transportit etj. Fjala vjen, në një informacion për *iPad Mini* kemi të dhëna, që mund t'i serviren vetëm një informatikani (ose që lidhen me informacione të patentës së produktit): *4G LTE, DC-HSDPA and HSPA support, with 4G LTE support on AT&T, Sprint and Verizon*. Ose *"Mercedes "iu ka ofruar blerësve dy automobila të rinj: bëhet fjalë për modelet "A45 AMG "dhe "CLA45 AMG", të cilët dalin jashtë traditës së repartit sportiv të "Mercedes"-it. "Mercedes" thotë se, nëse përzgjidhet mënyra manuale e ndërrimit të shpejtësisë edhe te ndërruesi automatik me shtatë shpejtësi, "AMG SPEEDSHIFT DCT", atëherë shpejtësitë do të mund të ndërrohen në interval të njëjtë kohor sikur edhe te modeli "SLS AMG". Përpos kësaj, është zhvilluar edhe një sistem i veçantë i tërheqjes "4MATIC", i përshtatur me platformën me tërheqje të përparme, në të cilin është vendosur klasa e re A.* (Kosova sot, 20 qershor).

Por ky informacion është shumë special dhe shkurtesat (si akronime) duhet të shihen më marrëdhënie me kontekstin dhe jo si shkurtesa leksikore.

Menduam se këto çështje e rrokin problemin që donin të ngrinim dhe gjithë sa trajtuam të çon në përfundimin e përgjithshëm se, ndaj hyrjes pa kriter të emërtimeve të shkurtuara nga anglishtja, duhet të tregohemi shumë më të kujdesshëm sesa ndaj fjalës së huazuar. Proceset që lidhen dendur me gjendje dygjuhësie të përdoruesit, nuk duhet të çojnë në hapjen e portave ndaj huazimeve të këti lloji. Përdorimi i shpeshtë, por më tepër, funksioni informativo-ekonimizues, i përcaktuar edhe nga vlera e funksioni i realies që emërtimet e shkurtuara shënojnë, duhet të përcakotjnë edhe praninë e tyre në gjuhën shqipe, madje në një hap tjetër, edhe pasqyrimin leksikografik.

Valter MEMISHA, Tirana

INFLUX OF SHORTENED DENOMINATIONS FROM ENGLISH INTO ALBANIAN

Summary

The Albanian language through manifold, multiple, uninterrupted and always in growth contacts with English language, has lent and is lending of it units that are displayed like linguistic loans and historical and cultural ones, which it needs. This process is also observed in the field of shortened denominations.

The *shortened denomination* is used by us, as a inclusive, hyperonymic term. In the class of units, under this *denomination* are included shortened forms and acronyms.

Shortened forms are literal representation of a word or a group of words in shortened form, in order to economic writing (*acad*. – *academic* etc.). From this point of view results that process of shortening is connected with literal variant of language. Short forms, usually, are not independent words, they have no grammatical categories, they don't function like parts of a sentence; so they don't realise syntactic functions, remaining simply problem of orthography.

Acronyms (abbreviations) are words formed from the joint of two or more shortened stems of a word-group (or a word-combination) being showed so as a special kind of composite (initialisms, acronyms and blends include in this group). In different way, acronyms function like independent words, with their plane of forms and content, they are pronounced as unique units, getting grammatical indexes and realising different syntactic functions.

In Albanian language enter both shortened forms and acronyms. The language is opened for both groups, giving advance to the acronyms.

The *shortened denominations* show some problems in writing and pronunciation. Which has to be the scientific attitude to the group of loans in Albanian language?

- If the acronyms are international forms or terms (which are connected with institutions or organisms, known in international world, as: NATO *(North Atlantic Treaty Organisation), UNICEF (United Nations International Children's Emergency Fund)* etc., they will be lent and so, it not necessary to be created new acronyms from their translation in Albanian language.

- In written media, we find a good number of acronyms in two forms: in Albanian and English, like *USA (United States of America)* and *SHBA (Shtetet e Bashkuara të Amerikës)*, *OSCE (Organisation for Security and Cooperation in Europa)* and *OSBE (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë)* etc. We think that the form of Albanian must be used.

- In Albanian language, some problems are created, especially in pronunciation, from the lent acronyms with **W,** like *WHO (World health organisation* / *OBSH - Organizata botërore e shëndetit)* etc. These types mustn't be used in Albanian, because it has its acronyms.

- Another group in which we have such problems, is the group with graphemes, that

doesn't reflect its sonorous, like *NYT (Nyt - New York Times* etc. In these cases reading is done according to Albanian letters of Albanian language.

We have to be careful in case of entrance without any criterion of shortened denominations from English language. The processes that are connected much frequently with bilingual situations of user, has not to send in opening of doors to loans of this type.

The frequent use, but more the informative and economical function, defined also from value and function of the realies that the shortened denominations note, must determine the presence in Albanian language, even their lexicographical reflection.

Linditë SEJDIU - RUGOVA, Prishtinë

PËRSHTATJA E TRAJTAVE FOLJORE TË GJUHËS ANGLEZE NË GJUHËN SHQIPE

KDU 811.18'362:811.111
811.18-26

Gjuha angleze është përshkruar nga David Crystal-i si një gjuhë huazuese e pangopur dhe sipas tij më shumë se 120 gjuhë botërore kanë shërbyer si burim i fjalësit të sotëm të anglishtes. Megjithatë, anglishtja sot paraqet një dhurues kryesor gjuhësor, një burim themelor të huazimeve në shumë gjuhë të botës. As shqipja nuk bën përjashtim në këtë rrafsh! Fjalët nga anglishtja vazhdimisht adaptohen për t'u përdorur në shqipen.

Juriel Uajnrajhu, në librin e tij *Languages in Contact*, duke folur për mekanizmat e interferencës leksikore përfundon se morfemat mund të kalojnë nga gjuha A në gjuhën B ose mund të përdoren në gjuhën B me funksione të reja, sipas modelit të morfemave të gjuhës A, me përmbajtjen e të cilave identifikohen. (Nuhiu, 1990:59).

Gjuhët e ndryshme, me apo pa rezistencë, varësisht nga shumëllojshmëria e tyre leksikore dhe nga sasia e përkufizimeve në formën e fjalëve, parapëlqejnë të huazuarit e drejtpërdrejtë apo zgjerimet semantike dhe kalket, huazimet e plota apo me zëvendësim të pjesërishëm (Nuhiu,1990: 90).

Ndryshimet e shpejta dhe pothuajse të paarritshme teknologjike kanë bërë që shqipja të huazojë një mori termash nga anglishtja, dhe jo vetëm prej saj. Mënyra e huazimit, koha e huazimit dhe përdorimi i tyre brenda fjalësit shqip janë të vështira për t'u përcaktuar. Nuk ka një kriter të mirëfilltë të pranimit të drejpërdrejtë të disa huazimeve dhe të përjashtimit të të tjerave. Gjuha shqipe ka përvetësuar një korpus të caktuar fjalësh nga anglishtja, duke e përshtatur sa është e mundur fonetikisht dhe gramatikisht!

Depërtimin e tillë të fjalëve nga një gjuhë në tjetrën, e që varet nga aspekti i të të huazuarit, shumë nga sociolinguistët e sotëm e quajnë huazim fonetik, ndryshe nga huazimi semantik, morfemik dhe huazimi i perkthyer fjalë për fjalë (kalk). Huazimet fonetike janë fjalë që huazohen bashkë me drejtshkrimin e tyre, me shqiptimin dhe kuptimin e tyre, duke iu

nënshtruar më pas asimilimit të tingujve të gjuhës marrëse, në rastin konkret tingujve të shqipes. Fjalët si *duet, soprano, opera* janë huazime të tilla të shqipes nga italishtja. Më pas, sa i përket shkallës së asimilimit, huazimet e tilla do të mund të klasifikoheshin më tutje në ato me asimilim të plotë (*startoj*), të pjesshëm *(kimia* nga serbishtja *hemija*, apo *Volkswagen* ku V-ja e gjermanishtes e ruan shqiptimin gjerman edhe në anglishten (*folksvagen*) dhe të paasimiluara (barbarizmat: si *dolce vita* e italishtes në anglishten me kuptimin *life*).

Kur bëhet fjalë për anglicizmat në gjuhët e tjera, përfshirë edhe shqipen, autorë të shumtë mendojnë se në një të ardhme të afërt, falë teknologjisë moderne, gjuhët evropiane do të gjasojnë më shumë me njëra-tjetrën se sa që mund të paramendohet sot, me përjashtim të ndonjë zhvillimi të veçantë gjuhësor. Por nuk është vetëm fusha e teknologjisë që i thith këto huazime. Inovacioni shoqëror dhe kulturor i një shoqërie përcillet me koncepte dhe ngjarje të reja që kërkojnë emërtime të reja! Vetë anglishtja ka huazuar shumë emërtime për llojet e ndryshme të shtëpive nëpër shekuj, p.sh.: *castle, mansion, teepee, igloo, bungalow*). Ka huazuar edhe emërtime të institucioneve kulturore (e.g. *opera, ballet*), apo të atyre politike (e.g. *perestroika, glasnost, apartheid*) (Baker, 1998:78).

Sipas Myers – Scotton, në librin e saj për bilinguizmin të vitit 2006, reagimi i një disk-xhokeji në Paris më së miri flet për situatën e anglicizmave në botë. Ai, duke u përpjekur t'i kundërshtojë prononcimet puriste të pjesëtarëve të Akademisë franceze, thekson se francezët e kanë të pamundur ta gjejnë zëvendësimin e fjalës *cool*! (Myers – Scotton, 2006: 93).

Ndër huazimet morfemike gramatikore, trajtat foljore, ndryshe nga emrat, janë më pak të huazueshme. Zakonisht atyre u prin emërtimi i konceptit: kompjuter / kompjuterizim / kompjuterizoj!

Strukturat foljore të anglishtes, vështruar nga aspekti i fleksionit gramatikor (ndryshe nga shqipja) janë në numër më të pakta (Pullum i dallon 6 trajta themelore të foljes në anglishte, qofshin të shtjelluara apo të pashtjelluara: p.sh.*take* si present simple, *takes, took, take* si infinitiv, *taking* dhe *taken*). Vështruar nga aspekti i fleksionit ndajshtesor, këto struktura foljore janë gjithashtu më të pakta në numër krahasuar me emrat në anglishten. Disa nga parashtesat dhe prapashtesat më të shpeshta foljeformuese

në anglishten janë *-ate(eit), be- (bii), en- (ën), -iffy (ifai), -ise/ize (ajz)*, prej të cilave *ise/ize* është më produktivja dhe shumica krijojnë folje me kuptim shkakorsie dhe vështruar nga aspekti i fjalëformimit nëpërmjet proceseve më pak produktive se ndajshtesimi në anglishten, roli verbalizues i tyre vërehet vetëm te procesi fjalëformues Back-formation *(baby-sit, window-shop, house-keep*) dhe te procesi i konverzionit[1] (*to handbag, bus, book*).

Strukturat foljore të shqipes, ndërkaq, janë shumë më komplekse dhe më të shumta si nga aspekti i klasifikimit të tyre sintagmatik brenda fjalisë ashtu edhe brenda klasifikimit të tyre paradigmatik. Nga aspekti i fleksionit gramatikor, po ta marrim shembull vetëm zgjedhimin e një foljeje të rregullt në të gjitha mënyrat dhe në të gjitha vetat, do të na dilnin më shumë trajta të realizueshme gramatikore se të gjitha versionet e mundshme fjalëformuese të shumë foljeve në anglishten. Sa i përket aspektit fjalëformues, shqipja është mjaft komplekse, por huazimet nga gjuhët e tjera i kanalizon më së shumti te zgjedhimi i parë meqë është edhe më prodhimtari në vetë shqipen (Morfologjia, 1995:278). Kjo vlen për trajtat e shtjelluara (*download*+ formanti *oj=daunllodoj, kodifikoj, skanoj, forwardoj*,), ndërsa ato të pashtjelluarat i përshtat në shqipen kryesisht duke i shndërruar në mbiemra të nyjshëm prejpjesorë *(i daunlloduar* në sintagmën ***informacion i daunlloduar*** (formanti *nyjë* dhe prapashtesa e shqipes *–uar*, krijojnë fjalën e re në shqipen nga folja *daunllodoj,* nëpërmjet nyjëzimit).

Ndonëse në shikim të parë na duket që shqipja i ka përvetësuar shumë fjalë nga anglishtja, nga 1500 hyrje të fjalorit *A Dictionary of European Anglicisms (2001),* redaktuar nga Manfred Görlach, vetëm 7% janë folje e që përpiluesit i kanë konsideruar huazime të anglishtes në shqipen dhe në disa gjuhë të tjera evropiane deri në fillim të 90-ave (konkretisht deri më 1995), para se anglishtja të vihej në statusin e një gjuhe zytrare në Kosovë. Këto folje të huazuara, sipas tyre, janë: *bimoj (beam në Star Track, travelling a long distance in an invisible energy), bllokoj, blofoj (bluff-make confidence to get advantage), bojkotoj, kampoj, kanseloj, centroj, kompjuterizoj, krekosem (crack-yield), krosoj, dekodoj, disenjoj (*sipas autorit

[1] Conversion (Konversioni) është një proces i fjalëformimit sipas të cilit fjala e re krijohet pa e ndryshuar ose duke e ndryshuar pjesërisht formën, p.sh. book (libër dhe book (rezervoj), ose advice (këshillë) dhe advise (këshilloj)!

disenj është fjalë frënge, ndërsa folja është anglicizëm*), drenoj (drain a wound - drenoj plagën), dribloj (dribble), faksoj, filmoj, hack - hakeroj (piratoj* propozohet nga disa gjuhëtarë*), handikepoj, hintoj (*nga *hint, i jap nje indikacion), kidnapoj (*së pari është krijuar emri *kidnapper* ose *kidnapping* e pastaj me *back-formation* është krijuar folja në anglishte dhe është huazuar e veçantë nga emri*), liftoj (fytyrën), logohem, linçoj, menaxhoj, miksoj, parkoj, pozoj, postoj, printoj (*nga *print out), repoj, ricikloj, relaksohem, risetoj, skanoj, servoj (topin), shokoj, shutoj, sponsorizoj, sprintoj, startoj, stopoj, stresoj, surfoj, testoj, trajnoj, zipoj, zumoj;*

Rregullat e shqipes diktojnë që huazimet të shkruhen sipas shqiptimit në gjuhën e origjinalit, ose duke i shkruar si në gjuhën burimore, por duke ua shtuar mbaresat vetore me vizë ndarëse.

Pra, trajtat foljore të anglishtes, kryesisht të formuara në anglishte nëpërmjet të derivacionit (ndajshtesimit) dhe konversionit, në shqipen kryesisht përshtaten duke ju bashkuar foljeve të zgjedhimit të parë të diatezës veprore, me disa përjashtime siç janë foljet e zgjedhimit jovepror (relaksohem, socializohem, etj.).

Duhet theksuar se disa nga trajtat e huazuara foljore duken të jenë anglicizma në sy të parë por kur e vështrojmë etimologjinë e tyre, rezultati del ndryshe. Po të marrim shembull foljen që sapo e përmendëm *socializohem,* ajo rrjedh nga frëngjishtja, por në kuptimin e foljes vjen nga anglishtja në shek 19, apo fjala relaksohem, e cila duket fjalë frënge në radhë të parë me origjinë latine, por në kuptimin "to become less tense" është regjistruar së pari në anglishten në vitet tridhjetë (shih bibliografinë, versioni i fjalorit etimologjik të anglishtes në internet).

Ndërkaq, fjalët *eksportoj* dhe *eksport* kanë prejardhje në dy periudha të ndryshme kohore nga dy gjuhë të ndryshme, *eksportoj* nga latinishtja (fillimi i shek 17) ndërsa emri *eksport* daton nga anglishtja pas viteve 1960. Pra, kemi të bëjmë me periudha të ndryshme kohore të hyrjes së fjalëve të huaja në shqipen në përgjithësi. Një dukuri e tillë do shpjeguar mirë në mënyrë që të mos trajtohet prejardhja e një fjale me kuptim dhe grafi të njëjtë disa herë!

Në Kosovë, pas vitit 2000, vërehet dukuria e huazimit të fjalëve të anglishtes me formant foljeformues të marrë nga serbishtja: p.sh. *çekirati*

imejllat (Kontrolloji e-mail-at!), *zipovate dokumentin, sërfovata në kompjuter,* etj. të cilat nuk janë përdorur fare gjatë kohës së kontaktit intensiv me serbishten, pra, para vitit 2000, por kanë filluar të përdoren pas kësaj periudhe, pra gjatë kontaktit të vazhdueshëm të shqipes me anglishten. Paraqitja e formantit serb te këto folje nuk mund të shpjegohet ndryshe veçse me faktin që përdoruesit e tyre, të cilët i kanë përdorur për herë të parë këto fjalë të anglishtes (*surf, check, zip*, etj) kishin një njohuri të mirë të sistemit gramatikor dhe fjalëformues të foljeve në serbishten! Kjo e tëra ka mund të reflektojë paraqitje të një statusi shoqëror që dëshironte të dallohej brenda një grupi si më elitar kundruall të tjerëve.

Sa u përket trajtave të pashtjelluara të foljes, ato kanë depërtuar në shqipen nga anglishtja kryesisht si trajta të pashtjelluara puro gjerundiale ose si trajta participore (pjesore) të së tashmes, bashkë me mbaresën *-ing: peeling / pilingu, styling / stajlingu, etj.* Megjithatë, në të shumtën e rasteve, janë përkthyer si sintagma emërore për shkak të karakterit emëror të gjerundit në anglishten (*smoking – prija e duhanit / duhanpirja*, ose është huazuar rrënja e fjalës, por jo edhe formanti gramatikor dhe fjalëformues i anglishtes *–ing*: (*testing – testimi, crossing – krosimi, etj.*).

Janë dhjetëra folje të tjera që momentalisht janë në fazën e përkohshme të përdorimit të tyre, kryesisht në shqipen e folur dhe në shqipen e shkruar jozyrtare, me trajtën e imperativit të anglishtes: *dillite por jo diletoj (delete), mastero më shpejt, skajpo në ajfon!,* apo edhe të tilla që tanimë përdoren me formantet e kohëve dhe mënyrave të ndryshme, si: *insertoj / insertova, ataçoj / ataçova*, *postoj / postova, loboj / lobova, resetoj / resetova, selektoj / selektova, editoj / editova, apdejtoj / apdejtova, daunllodoj / daunllodova, draftoj /draftova, e hajlajtoj / hajlajtova*, *etj.* e që së shpejti do të duhej përshtatur dhe futur në fjalësin e shqipes pa ndonjë paragjykim për bastardim të gjuhës, meqë shprehjet e tilla në botë tanimë konsiderohen ndërkombëtarizma për shkak të ndikimit global të anglishtes dhe implikimit të pashmangshëm të teknologjisë në jetën e përditshme dhe meqë këto fjalë të përshtatura brenda kornizës së pranueshme të fjalëformimit të shqipes e paraqesin avancimin dhe zhvillimin e shoqërisë sonë njëkohësisht!

Bibliografia

ASHRSH, Instituti i Gjuhësisë, **Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia**), Tiranë, 1995
ASHRSH, Instituti i Gjuhësisë, **Gramatika e gjuhës shqipe II (Sintaksa**), Tiranë, 1997
HUDDLESTON Rodney, PULLUM Geoffrey K., **The Cambridge Grammar of the English Language**, Cambridge University Press, Cambridge, 2002
JASHARI Ali & ÇITAKU Flutura, Gramatika e gjuhës shqipe 1 (Morfologjia), Artini, Prishtinë, 2009
QUIRK Randolph, GREENBAUM Sidney, LEECH Geoffrey, SVARTVIK Jan, **A Comprehensive Grammar of the English Language**, Longman, Essex, 1985
BAKER Collin & JONES - PRYS Sylvia, Encyclopedia of Bilingualism and Bilingual Education, Multilingual matters, 1998
SCOTTON Carol Myers, Multiple Voices:An Introduction to Bilingualism, Blackwell, 2006
GÖRLACH Manfred, A Dictionary of European Anglicisms, Oxford, 2001
NUHIU Vesel, Ndikimet ndërgjuhësore, Rilindja, Prishtinë, 1990
http://www.etymonline.com/index.php?allowed_in_frame=0&search=social&searchmode=none) (Fjalori etimologjik i anglishtes në Web!)

Linditë SEJDIU - RUGOVA, Prishtina

THE ADAPTATION OF ENGLISH VERB BORROWINGS INTO ALBANIAN

Summary

The present paper aims at giving a short account of the English verb borrowings into Albanian and their adaptation within the linguistic context of spoken and written Albanian in general and in the Kosovar spoken dialect in particular.

When analysing the way of assimilation of Albanian verbal borrowings from English (and from other languages), the following factors have been taken into consideration: a) what group of languages the word was borrowed from, b) if the word belongs to the same group of languages to which the borrowing language belongs, too, c) in what way the word is borrowed: orally or in the written form, d) how often the borrowing is used in the language: the greater the frequency, the quicker assimilation; e) how long has the word been living in the language: the longer it lives, the more assimilated it is.

A list of English verb borrowings has been provided (based on *A Dictionary of European Anglicisms (2001),* edited by Manfred Görlach), together with some explanations regarding their etymological treatment as pure anglicisms.

It should be emphasised that when comparing the borrowed verb forms in Albanian which at first sight appear as anglicisms, one should take into account their etymology first. Some of them, such as the verb *socialize*, are French borrowings with Latin origin. However, they have been introduced as verbs into other European languages exclusively from English.

The recent technological development has paved the way to an increasing number of technical borrowings from English and other langauges into Albanian, some of them being borrowed together with their mophemic changes, too. Consequently, a tendency to borrow English verb root (stem) and its combination with the respective Albanian affix or inflectional suffix appears to be very frequent in the spoken Albanian.

Agron DURO, Tiranë

PËR NJË FJALOR TË HUAZIMEVE ANGLEZE NË SHQIPE

KDU 811.18'373.45=18
811.18'362:811.111

Fjalët çelës: *anglicizëm, fjalor i anglicizmave,kriteri i shqiptimit, kriteri i drejtshkrimit, baza e të dhënave, formatim i të dhënave.*

Problemi i hartimit të një *Fjalori të anglicizmave* lidhet më tepër jo me synimin për të realizuar drejtpërdrejt një vepër të tillë leksikografike, duke e ndërmarrë atë konkretisht, sesa për të paraqitur punën që duhet kryer, duke përcaktuar rrugët se si duhet shkuar shkallë-shkallë drejt hartimit të tij.

Ky përshkallëzim i kësaj pune, që çon deri diku në zgjatjen e procesit të realizimit të një fjalori të tillë si produkt përfundimtar, mund të bjerë ndesh me nevojën e ngutshme për të pasur sa më parë në dorë të përdoruesve një mjet kodifikues që do t'u plotësonte atyre nevojat konkrete në ligjërimin praktik, në të cilën kërkohen zgjidhje nga më të ndryshme, qysh nga ato më të thjeshta (në shkrimin e tyre: *hardware-in* apo *harduer-in*, në përcaktimin e sinonimeve, ku shpesh përplasen anglicizmat si fjalë të huaja me përkthimet shqipe: *maus* apo *mi*, ndonjëherë edhe kur fjala shqipe i përgjigjet barasvlerësisht anglicizmit si: *fjalëkalim* (si e ngulitur) dhe *pasuërd* (që përdoret më pak). Ndonjëherë situata ndërlikohet më shumë, kur fjala e huaj përdoret në vend të një fjale shqipe, e cila ka plotësisht të njëjtin kuptim me anglicizmin, siç flitet e shkruhet kohët e fundit *signatoj* për *nënshkruaj* apo *apdejtoj* për *përditësoj*. Gjendja rëndohet më keq kur një anglicizëm garon apo edhe mbisundon mbi një fjalë tjetër të huaj, e cila nga ana e vet ka barasvlerësin shqip, si: *impakt – influencë* dhe *ndikim*, *apdejtoj – azhurnoj* dhe *përditësoj*, për të mos përmendur më tej rastin pështjellues, kur në "Fjalorin e gjuhës shqipe" (2006) për *mi* që sinonimizon me *maus* takohet edhe *miush*[1], ndonëse kjo e fundit mund të jetë një zgjidhje më e drejtë.

[1] *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.

Megjithatë plotësimi i nevojave të ngutshme për një fjalor të anglicizmave mund të konsiderohej i mundësuar deri diku me shfrytëzimin sidomos nga specialistët e dy fjalorëve të termave të informatikës, në të cilët, sigurisht anglicizmat zënë pjesën dërrmuese të fjalësit të secilit fjalor. Sigurisht ndërmjet tyre, si fjalor më normativ do të konsideronin "Fjalorin e informatikës"[2] (Prishtinë, 2005), hartuar nga një grup specialistësh, N. Caka, etj., i redaktuar nga akad. R. Ismajli. Rreth këtij Fjalori është shkruar një recension shkencor, botuar në revistën "Studime filologjike"[3], ku janë nënvizuar një varg vlerash të tij, por edhe janë nxjerrë në pah edhe mangësi, që lidhen kryesisht me moszgjidhjen siç duhet të problemeve të standardizimit, meqë këtu kemi të bëjmë me termat, si njësi me kuptime specifike, siç janë termat e informatikës. Kështu, p.sh., për *folder* jepen si sinonime *dosje, direktorium* dhe *katalog*. Mund të takohen sinonime si barasvlerëse për një term anglez, si: ***character:*** *shkronjë – numër – simbol,* ***cracker****: thyerës – pirat informatik,* ***smart:*** *inteligjent, i zgjuar,* ***pin:*** *këmbëz, thumb.*

Duke mëshuar në vlerat e Fjalorit në fjalë do të nënvizonim gjithsesi, se si çdo fjalor i kësaj natyre, ai përmban ose nënkupton edhe karakterin preskriptiv (parashkrues), prandaj do të mendonim se ai përbën një pararendës të një "Fjalori të anglicizmave të shqipes", i cili, ky i fundit, do të mëtonte të ishte përveçse gjithëpërfshirës, pra do të përfshinte njësitë terma dhe joterma (fjalët e përgjithshme, si: *pab, disk, dixhej, bluxhinse, bodigard, fans, hitparejd, luk: kompjuter, displej,* ashtu edhe normativ. Si i tillë ai do të zgjidhte problemet e drejtshkrimit të anglicizmave në bazë të një kriteri të vetëm, si, p.sh., supozojmë vetëm mbi kriterin shqiptimor, si *pab* (nga *pub*), *luk* (nga *look*), *softuer* (nga *software*) etj., problemet e konkurrencës sinonimike: *fjalëkalim* dhe *pasuord,* të shumëkuptimësisë: *bunker*$_1$ (usht) – *bunker*$_2$ (bujq.), *trajnoj*$_1$ "stërvit "– *trajnoj*$_2$ (specializoj).

Duke iu afruar gradualisht Fjalorit të anglicizmave, i cili do të ishte gjithëpërfshirës dhe preskriptiv (parashkrues), pra, normativ, do të pohonin se ai do të ishte njëherazi si mjet kodifikues me vlera të drejtpërdrejta referuese. Megjithatë, siç mund të nënkuptohet, nga sa u shprehën edhe më lart, hedhja e hapit drejt prodhimit të tij si produkt leksikografik do ta bënte atë

[2] N. Caka, etj. *Fjalor i informatikës*, Prishtinë, 2005.
[3] A. Duro, *Fjalor i informatikës*, Prishtinë, 2005 (recension); Studime filologjike, 2009/3-4.

një mjet ku do të përmbahej në mënyrë të sintetizuar dhe të përmbledhur gjithë informacioni jashtëgjuhësor. Këtu do të parapëlqehej që ky informacion të jepej në dy rrafshe; në rrafshin vertikal, që me tërësinë e njësive të vendosura alfabetikisht do të përbënte makrostrukturën e Fjalorit, kurse në rrafshin horizontal do të përbënte mikrostrukturën, ku do të përmbahej informacioni i zbërthyer i çdo njësie përmes përkufizimeve të kuptimeve të tyre. Kështu, përkufizimet e njësive do të përjashtonin detyrimisht fjalët sinonime që shprehen të njëjtin kuptim si dysorë, por edhe sinonimet relative, të cilat duhen shpërndarë si njësi më vete sipas kuptimeve që shpreh secila. Kështu, nga njëra anë, si njësi me të drejtë për t'u përkufizuar do të ishte njësia që zgjidhet ndërmjet sinonimeve absolute (dysorëve), ku midis tyre si standarde do të pranohej njësia më e përshtatshme (qoftë vendëse apo e huaj), si ndoshta, *miush* (shih Fj.2006) para *maus* ose *mi, fjalëkalim* para *paswuord,* por mund të paraqiteshin si dy njësi më vete me përkufizimet përkatëse: *trajnoj*$_1$ "stërvit" dhe *trajnoj*$_2$ "specializoj", *bunker*$_1$ "fortesë..." dhe *bunker*$_2$ "mbajtëse kashte" etj.

Gjithçkaje që paraqitëm më sipër, d.m.th, si proces kalimi nga njëri fjalor tek tjetri, do t'i paraprinte një punë me një varg hallkash, që nga evidencimi i tërë anglicizmave që gjallojnë nëpër fjalorë (fjalorë shpjegues, sidomos 1980, 2006), ku pasqyrohen kryesisht anglicizmat standard (shih Fj. 2006): *kompaktdisk, balast, biznes, biznesmen, bojkot, boks, boksier, bord, bos*), fjalorë terminologjikë (sidomos Fjalori i informatikës nga ku janë nxjerrë rreth 200 njësi), tekste të fushave të ndryshme të dijes (nga mekanika janë evidentuar rreth 40 njësi, nga sporti - 40, nga ekonomia - 43 etj., nga fjalësa të ndryshëm, të përftuar nga vjelja (mund të përmendet fjalës anglicizmash prej rreth 350 njësi) etj. Po kështu do të evidentohen anglicizmat e nxjerrë nga Fjalorë të fjalëve të huaja[4], ku ato, sikurse edhe huazimet e gjuhëve të tjera jepen me përkufizimet përkatëse.

Në mënyrë të veçantë gjithë këtyre proceseve do t'i paraprinte puna studimore në fushën e anglicizmave ku përfshihen artikuj shkencorë, punime të gjera deri monografi, të ndërmarra nga gjuhëtarë të njohur si A. Kostallari, H. Shehu, R. Ismajli, Xh. Lloshi etj.

[4] M. Bejta etj., Fjalor i fjalëve të huaja, Prishtinë, 1988; M. Ndreca, Fjalor fjalësh dhe shprehjesh të huaja, Toena, Tiranë, 2007.

Prej këtej duhen përcaktuar disa zgjidhje për probleme që përbëjnë kriteret dhe parimet bazë për trajtimin leksikologjik e, sidomos, leksikografik të anglicizmave në suazën e huazimeve në tërësi, por edhe të vetë anglicizmave në përputhje me natyrën e anglishtes, si gjuhë analitiko-sintetike (si gjuhë dhënëse) dhe të shqipes, si gjuhë sintetiko-analitike (si gjuhë marrëse). Pavarësisht nga zgjidhjet e dhëna deri tani, të pasqyruara edhe në "Fjalorin e termave të informatikës", Prishtinë 2005, ku si bazë e receptimit dhe e përshtatjes së anglicizmave merret parimi shqiptimor si, *fajl, harduer, softuer,* etj., prapëseprapë, zbatimi krahas këtij kriteri edhe i kriterit shkrimor, sidomos të hasur shpesh në ligjërimin e shkruar (tekste, manuale etj. krahas *harduer* dhe *hardware*), bën të domosdoshëm vështrimin e tyre veç e veç, duke u mbështetur në kriteret e pranuara për gjuhët e tjera: italishten, frëngjishten, rusishten etj., duke pasur parasysh edhe natyrën tipologjike-strukturore të secilës prej tyre.

Duhet nënvizuar se vështirësitë më të mëdha që dalin gjatë hyrjes në shqipe të fjalëve angleze, si njësi të huaja, lidhen me mospërputhjen e tyre në format shkrimore e shqiptimore, ku dy format e diferencuara krijojnë probleme në identitetin e fjalëve të futura në shqipe, aq më tepër kur si bazë identifikimi merret herë njëra dhe herë tjetra formë, si *hardware* dhe *harduer*. Nga ana tjetër, kjo vështirësi thellohet më tepër kur njësia angleze e futur në shqipe, aktualisht në procesin e ligjërimit (sidomos në tekst), ku ajo si fakt tashmë jo vetëm i gjuhës (i sistemit), por edhe i ligjërimit (në konceptin sosyrian), përfshihet në rrethin e një strukture leksiko-morfosintaksore. Kështu, njësia angleze, si në formën e shkruar, ashtu edhe në atë të folur futet, nga njëra anë në formësimin morfologjik të shqipes, meqë gjuha shqipe është gjuhë sintetiko-analitike me sistem emëror mbaresor të fortë, sikurse është, p.sh., edhe rusishtja, si në shqipe *file-in* ose *fajl-in,* në rusishte: *fajlla-fajllu*), kurse, nga ana tjetër, në rrethin e mjeteve shërbyese (nyjeve dhe parafjalëve në shqipe dhe parafjalëve në rusishte (i (e) *file-it* ose i (e) *fajl-it* në shq., dhe dlja *fajlla* – k *fajllu* në rus.).

Krahasuar me gjuhë të tjera, si p.sh., me italishten dhe frëngjishten, si gjuhë pa sisteme emërore mbaresore, ky formësim nuk mund të ndodhë, kështu që merret si kriter forma e shkruar. Nga ana tjetër, përfshirja e njësisë angleze në këto gjuhë në rrethin e mjeteve shërbyese, si fakt ligjërimor, shton mundësinë për të marrë si kriter formën e shkruar në anglishte.

Kjo pasqyrohet në të shkruar si *di (del), file/ da (dal) file (*it.), *de (du) file / à (au) file* (fr.). Kjo bën që njësia angleze si fakt i gjuhës (i sistemit) dhe i ligjërimit të futet në këto gjuhë në formën e shkruar si *file, hardware* (it.), *passwor*d (fr.) etj. Kjo do të thotë se ky rreth i thjeshtë strukturor, në të cilën futet njësia angleze në këto dy gjuhë e standardizon më lehtë kriterin e vetëm për paraqitjen në to të njësisë së huaj angleze, kurse në shqipe e ndërlikon zgjidhjen, duke u mbështetur në të dyja kriteret: shkrimor dhe shqiptimor (i (e) *hardware-it/* dhe *i (e) harduer-it*. Vështruar nga kjo pikëpamje, pranimi i këtyre dy kritereve në shqipe, veç të tjerave, çon në humbjen e identitetit të njësisë së huaj, çka nuk vihet re në italishte dhe në frëngjishte, ku mbahet një kriter i vetëm, ai shkrimor, i cili e ruan më fort identitetin e njësisë së huaj. Kjo është shumë e rëndësishme të nënvizohet, sepse në shqipe, ndonëse mund të pranohet si më i përshtatshëm kriteri shqiptimor për shumicën e kategorive të fjalëve angleze si të huaja për të, si *fajl, harduer, softuer*, për një kategori më të kufizuar njësish angleze që shënojnë p.sh., objekte të veçuar (programe, komanda) e që kërkojnë një identitet më të plotë të tyre, mund të zbatohet kriteri shkrimor, kryesisht duke e paraqitur njësinë me formësimin morfologjik, si p.sh. *bluetooth-in, twitter-it, facebook-it* etj. Vështruar nga kjo pikëpamje këto kategori njësish afrohen më shumë me emrat e përveçëm anglezë të futur në shqipe, që shënojnë njerëz, vende etj., ku për hir të identitetit të tyre, do të kërkohej zbatimi i kriterit shkrimor ndonëse në disa raste, për traditë, pranohet përshtatja shqiptimore; kështu për *Shekspir,* sot parapëlqehet *Shakespeare.* Mund të nënvizohet se edhe disa gjuhëtarë në Shqipëri që kanë këmbëngulur me kohë për kriterin shqiptimor edhe tek emrat e përveçëm, sot kanë kaluar në kriterin tjetër, ndonëse vihen re lëkundje si: *Mejer* apo *Meyer.*

Megjithatë, siç u argumentua edhe më sipër, në një Fjalor të anglicizmave me karakter normativ kriteri i shqiptimit do të ishte plotësisht i pranueshëm, me përjashtim të rasteve të mësipërme të tipit *twitter* dhe të emrave të përveçëm.

Siç është theksuar edhe më sipër vështirësia kryesore që e ndërlikon realizimin e shpejtë të idesë së hartimit të një Fjalori të anglicizmave me karakter normativ e kodifikues lidhet jo vetëm me gjendjen kaotike dhe përbërjen heterogjene të leksikut anglez të futur në shqipe, por edhe me rritjen e tyre me përmasa të mëdha e në mënyrë të pandërprerë. Këtu s'du-

het lënë pa përmendur edhe shumë njësi me karakter efemer (kohëshkurtër), që shfaqen e zhduken për një kohë të shkurtër ose edhe një kategori tjetër që edhe mund të nguliten pa nevojë, siç kemi përmendur më sipër *apdejtoj (përditësoj*), *signatoj* (*nënshkruaj*). Kjo gjendje shumë komplekse bën të vështirë sidomos katalogjizimin e lëndës leksikore që qarkullon, meqë në këtë lëndë përzihen fjalë të zakonshme, terma, fjalë specifike, shkurtesa etj. Kjo vështirësi fillon qysh nga mbledhja, regjistrimi, përpunimi, formësimi përfundimtar i lëndës e deri në futjen e saj në Fjalor. Kjo situatë e ndërlikuar që krijon përbërja e këtij leksiku problematik është vërejtur prej kohësh nga studiuesit që merren në mënyrë të veçantë në këtë fushë leksiku. Herë pas here theksohet shqetësimi i tyre, për këtë shtresë leksikore të huaj, çka kushtëzon edhe veprimtaritë e dendura shkencore, të ndërmarra, siç është sot edhe kjo Tryezë e përbashkët e të dy Akademive.

Pa u futur në persiatje të panevojshme rreth sugjerimeve të bëra herë pas here për rrugët e realizimit të këtij objektivi, ku si parësor theksohet zbatimi i metodave kompjuterike për regjistrim e përpunim të lëndës mbi bazën e një databaze të fuqishme etj., në përfundim të kësaj parashtrese, për të dhënë edhe një ndihmë konkrete sado modeste, po paraqesim një format të dhënash, që mund të përfshihen në një databazë të lexueshme nga kompjuteri, duke përdorur një program të posaçëm për krijimin e një banke fjalësh dhe hartimin e një Fjalori përkatës të anglicizmave në shqipe.

Të dhënat kanë një paraqitje gjithëpërfshirëse, çka do të thotë se brenda tyre minimalisht, sipas veçorive që ka çdo njësi angleze si e huaj për shqipen, mund të gjejë vendin në këto të dhëna dhe në mënyrë përzgjedhëse mund të futen në Fjalor.

INSTITUTI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË - QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

FORMATI I TË DHËNAVE

1.	Numri serial (NS)	125 324 728 654
2.	Njësia (NJ)	*fajl pab facebook signatoj*
3.	Fjalë e përgjithshme (FP)	- + + + + +
4.	Term (T)	+ - + +
5.	Fusha (FV)	inf. - inf. drejt.
6.	Shkurtesë (SHk)	- - - -
7.	Angleze e plotë (AP)	file pub facebook to sign
8.	Fjalë hibride (FH)	- - - +
9.	Emër (E)	+ + + -
10.	Mbiemër (MB)	- - - -
11.	Folje (F)	- - - +
12.	Shquarësia (SHQ)	fajl-i pab-i facebook -
13.	Sinonim absolut (SA)	skedar - - nënshkruaj
14.	Sinonim relativ (SR)	dosje lokal - -
15.	Sinonim i papran.(SPP)	dosje - - signatoj
16.	Sinonim i vjetër (SV)	- - -
17.	Konteksti (KO)	
18.	Shpjegimi (SHP)	
19.	Përkufizimi stand.	(PR)
20.	Frëngjisht (Fr.)	fichier pub facebook souscrire
21.	Italisht (It)	file pub facebook sottoscrivere
22.	Hartues (Ha)	
23.	Redaktor (RE)	
24.	Data e hartimit (DH)	

Agron DURO, Tirana

ON THE NEED OF COMPILING A DICTIONARY OF ENGLISH BORROWINGS IN ALBANIAN

Summary

The compilation of a dictionary of anglicisms in Albanian is tied up with the pressing need of prescribing solutions to a series of problems cropping up in the course of discourse, especially when the spelling and pronounciation criteria of anglicisms is called into question (as in *hardware-in* or *harduer-in*), or when you have to choose between two synonymous variants (*pasuërd* or *fjalëkalim*) or when you have to figure out issues of their standardization.

In this paper the idea of compiling such a dictionary is elaborated on the basis of conducting some ongoing research into a solid database that has been painstakingly established from various sources including the exisiting dictionaries, the lexicial items circulating across various textbooks, as well as in various studies surrounding the lexicon in question. In addition, the paper points to the need of closely looking into the solutions around the issue of anglicisms in other languages, especially in French, Italian and Russian. This work needs to be based on a data template, a model of which has been provided towards the end of this paper.

Nebi CAKA, Prishtinë

ANGLICIZMAT NË TERMINOLOGJINË TEKNIKE

KDU 811.18'373
81'36-116.6

Abstrakt

Në këtë punim trajtohen anglicizmat në terminologjinë teknike me theks të veçantë në terminologjinë e informatikës, ku numri i tyre është dukshëm më i madh se në fushat e tjera dhe për shkak të ndikimit të informatikës në të gjitha degët e shkencës e të teknikës, po dhe në jetën e përditshme. Bëhen përpjekje për tipizimin e anglicizmave leksikorë në terminologjinë teknike, duke u bazuar po në terminologjinë e informatikës. Jepen edhe disa sugjerime për rrugët që duhen ndjekur për evidencimin e anglicizmave në gjuhën shqipe dhe për shqipërimin, standardizimin dhe normëzimin e tyre.

***Fjalët çelës*:** anglicizmat, gjuha shqipe, terminologjia teknike, informatika, leksiku

1. **Hyrje**

Zhvillimi i shkencës dhe i teknikës e teknologjisë ka bërë që për çdo ditë të shfaqen produkte të reja, për shënjimin e të cilave nevojiten fjalë të reja a terma të rinj. Terma të rinj nevojiten po ashtu edhe për të shprehur konceptet e nocionet e reja që kanë të bëjnë me prodhimet a shpikjet e reja. Këta terma, pothuajse pa përjashtim, krijohen në gjuhën angleze, meqë produktet e shpikjet e reja vijnë rëndom nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, superfuqi e vetme botërore që nga viti 1989. Vendet që nuk e kanë gjuhë zyrtare gjuhën angleze, ose duhet t'i pranojnë këta terma ashtu si u vijnë, ose duhet t'i krijojnë barasvlerësit përkatës në gjuhët e veta. Kjo gjë nuk është aspak e lehtë, duke pasur parasysh numrin e madh të këtyre termave dhe shpejtësinë me të cilën ata depërtojnë në secilën gjuhë, falë teknologjisë së informacionit e të komunikimit.

Anglishtja ngadalë po merr rolin e gjuhës ndërkombëtare, të ashtuquajturës gjuhë botërore a globale, rol ky që disa shekuj para saj e ka pasur frëngjishtja, e para kësaj të fundit latinishtja.

Në leksikun e secilës gjuhë gjithnjë e më shumë po depërtojnë fjalë angleze a fjalë të krijuara sipas modelit të anglishtes. Këto fjalë, të njohura

si anglicizma, arrijnë të përshtaten herë më shumë e herë më pak, në gjuhët marrëse.

2. Tipizimi i anglicizmave leksikorë që përdoren në terminologjinë teknike

Anglicizmat leksikorë që përdoren në terminologjinë teknike mund të klasifikohen në disa tipa. Këtu është bërë një përpjekje për klasifikimin e anglicizmave leksikorë bazuar kryesisht në terminologjinë e informatikës, në të cilën numri i tyre vjen gjithnjë duke u rritur, e të cilët po depërtojnë gjithnjë e më shumë edhe në degë të tjera të teknikës. Tipizimi është bërë në bazë të përshtatjes fonologjike dhe drejtshkrimore.

2.1 Anglicizmat e tipit: *laptop, printer* dhe *aplet, procesor*

Një numër i anglicizmave terma mund të merren ashtu si shkruhen në anglisht (me përshtatje të vogla grafike, kryesisht të bashkëtingëlloreve të dyfishta, si: *n, p, s* për *nn, pp, ss* etj.) dhe si të tilla përshtaten mirë në sistemin e gjuhës shqipe, si p.sh. termat e mëposhtëm të marrë nga kompjuterika/ informatika:

antivirus, aplet 'applet', baner 'banner', bit, bold, blog, demo, desktop, disk, emulgator, folder, font, internet, intranet, label, laptop, link, monitor, multimedia, operator, palmtop, printer, procesor 'processor', raster, server, terminal, virtual

2.2 Anglicizmat e tipit: *radar, transistor, laser* dhe *MOSFET, PIN, RAM*

Një numër i caktuar i anglicizmave terma janë në fakt shkurtesa. Të tillë janë, për shembull, fjalët-terma ***radar, transistor, laser***, të cilat shënojnë tri pajisje epokale, të shpikura në harkun kohor prej 20 vjetëve, të emërtuara ndryshe nga më parë, jo nëpërmjet greqishtes, por nëpërmjet anglishtes:

– ***radar*** (term i krijuar më 1940, në SHBA – shkurtesë nga: ***ra****dio* ***d****etecting* ***a****nd* ***r****anging* 'zbulimi dhe matja e largësisë me anë të radiovalëve') – shkruhet kështu në të gjitha gjuhët.

– ***transistor*** (term i krijuar më 1947, në SHBA – shkurtesë nga: ***trans****fer res****istor***) – në disa gjuhë: *transistor*, e në disa *tranzistor* (si duket, edhe te ne tash e pas kështu).
– ***laser*** (term i krijuar më 1960, në SHBA – shkurtesë nga: ***L****ight* ***A****mplification by* ***S****timulated* ***E****mission of* ***R****adiation* 'amplifikimi/ përforcimi i dritës me anë të emisionit të stimuluar të rrezatimit') – shkruhet *laser* në shumicën e gjuhëve, përveç në pak gjuhë, si në rusisht, bullgarisht e turqisht, dhe aty-këtu te ne (kryesisht në Shqipëri): *lazer*.
Shkurtesa janë edhe fjalët terma:
– ***bit*** (shkurtesë nga angl. ***bi****nary digi****t*** "numër binar / shifër dyjore")
– **MOSFET** (angl. ***M****etal* ***O****xide* ***S****emiconductor* ***F****ield* ***E****ffect* ***T****ransistor "tranzistor metal-oksid-gjysmëpërçues me efekt fushe"*
– ***PIN*** (shkurtesë nga angl.: ***P****ersonal* ***I****dentification* ***N****umber* "Numri Personal i Identifikimit")
– ***PUK*** (shkurtesë nga angl.: ***P****ersonal* ***U****nblocking/****U****nlocking Key* "çelësi personal për zhbllokim")
– ***RAM*** (shkurtesë angl. ***R****andom* ***A****ccess* ***M****emory* "memorie/kujtesë me akses të drejtpërdrejtë")
– ***ROM*** (shkurtesë angl. ***R****ead* ***O****nly* ***M****emory* "memorie/kujtesë vetëm për lexim")
Këtu mund të fusim edhe shkurtesat e tipit:
– ***kodek*** *'codec'*. (shkurtesë nga angl. ***co****der-****dec****oder 'koder-dekoder'*)
– ***modem*** (shkurtesë nga angl. ***mo****dulator-****dem****odulator*)

Anglicizmat shkurtesa të tipit të mësipërm (2.2) kanë hyrë si fjalë terma në të gjitha gjuhët dhe janë përshtatur mirë edhe në sistemin e gjuhës shqipe, që nuk do të mund të thoshim për anglicizmat shkurtesa të tipit të mëposhtëm (2.3).

2.3 Anglicizmat e tipit: *DVD – dividi, SMS – esemes* dhe *e-mail – email/imajl, i-pad – ajpad/ajped*

Termat e mëposhtëm zakonisht përdoren (ku më pak e ku më shumë) në dy trajta dhe, siç propozon Nuhiu (2013) edhe për disa anglicizma të tjerë, ata "duhet të përcillen dhe pas një kohe të shihet se si përdoren në shqipet".

– ***CD*** – ‘cëdë’/sidi – shkurtesë nga angl. ***C****ompact* ***D****isk* ‘disk kompakt’.
– ***DVD*** – ‘dëvëdë’/dividi – shkurtesë nga angl., fillimisht ***D****igital* ***V****ideo* ***D****isk*, e pastaj ***D****igital* ***V****ersatile* ***D****isc* “disk digjital i gjithanshëm”.
– ***GPS*** – ‘gëpësë’/xhipies – shkurtesë nga angl.: ***G****lobal* ***P****ositioning* ***S****ystem* ‘sistem i pozicionimit global (botëror)’ – sistem për caktimin e pozicionit gjeografik.
– ***Hi-Fi*** – shkurtesë nga angl.: ***Hi****gh* ***Fi****delity* “besnikëri e lartë”.
– ***PC*** – **‘**pësë’/pisi – shkurtesë nga angl.: ***P****ersonal* ***C****omputer* “kompjuter personal”
– ***SMS*** – ‘sëmësë’/esemes – shkurtesë nga angl.: ***S****hort* ***M****essage* ***S****ervice* “shërbim i mesazheve të shkurtra”.
– ***e-mail*** – email/imajl – këtu shkronja fillestare ***e*** shënon ***e****lectronic* ‘elektronike’ (posta elektronike).
– ***i-pad*** **(*ipad*)** – ajpad/ ajped – këtu shkronja fillestare ***i*** mendohet se fillimisht (më 1998, kur është shpikur pajisja që shënonte ky emërtim) ka pasur domethënien ***i****nternet*, e sot ***i***-së i shoqërohen edhe kuptime të tjera, si ‘**i**nteligjent’, ‘**i**ndividual’, ‘**i**magjinativ’ etj.
– ***i-phone*** (***iphone***) – ajfon – edhe këtu shkronja fillestare ***i*** ka po atë kuptim si më lart.
– ***USB*** **– ‘***usëbë’/*juesbi – shkurtesë nga angl. ***U****niversal* ***S****erial* ***B****us* ‘bus/ magjistrale universale në seri’ (term i krijuar në vitet ’90 të shekullit XX).

2.4 Anglicizmat e tipit: *chip – çip, italic – italik, phishing – fishing, web – ueb/veb*

Te ky lloj i anglicizmave kemi të bëjmë me zëvendësimin e disa shkronjave të caktuara të anglishtes me ato të shqipes, si: ***c*** me ***k, ch*** me ***ç,*** ***ph*** *me* ***f***, ***w*** me ***u/v, x*** me ***ks***:
italic *– italik* **‘**kursiv**’**, ***record*** *– rekord*; (më lart: ***codec*** *> kodek*)
chip *– çip,* ***chipset*** *– çipset*
phishing *– fishing*
web *– ueb/veb*
pixel *– piksel,* ***Telex*** *– Teleks,* ***telefax*** *– telefaks*

2.5 Anglicizmat e tipit: *application – aplikacion, cluster – klaster, computer – kompjuter, player – plejer*

Këtu kemi përfshirë anglicizmat që nuk janë përfshirë më sipër e te të cilët zakonisht nuk kemi të bëjmë me zëvendësimin vetëm të një shkronje të anglishtes me atë të shqipes, si:

address *– adresë,* ***application*** *– aplikacion,* ***byte*** *– bajt,* ***chat*** *– çat/ çet,* ***click*** *– klik,* ***cluster*** *– klaster,* ***computer*** *– kompjuter/ kompjutër* (Kosovë/ Shqipëri)*,* ***digital*** *– digjital/ dixhital* (Kosovë/ Shqipëri, më herët 'numerik')*,* ***Facebook*** *– Fejsbuk,* ***file*** *– fajl****, hacker*** *– haker,* ***hardware*** *– harduer/ harduer,* ***hypertexte*** *– hipertekst,* ***joystick*** *– xhojstik****, player*** *– plejer,* ***provider*** *– provajder,* ***resolution*** *– rezolucion,* ***roaming*** *– roming,* ***scanner*** *– skaner/ skener,* ***site*** *– sajt,* ***software*** *– softuer/ softver,* ***spam*** *– spam/ spem,* ***telephone/ phone*** *– telefon,* ***Word*** *– Uord/ Vord****, Windows*** *– Vindouz/ Uindouz*

Word – program kompjuterik aplikativ për shkrimin dhe përpunimin e tekstit dhe ***Windows*** – program operativ, të ***Microsoft-it*** (Majkrosoft), do të duhej të shkruheshin në origjinal me ***w***. Shkronja ***W***, deshëm apo nuk deshëm tashmë ka hyrë në gjuhën shqipe në formë të njësisë për vat (W) dhe të simbolit të elementit volfram (W).

2.6 Anglicizmat të papërshtatur ende në gjuhën shqipe

Disa anglicizma që përdoren sidomos në fushën e informatikës ende nuk janë përshtatur në sistemin e gjuhës shqipe, si p.sh.:

firewall, freeware, multitasking, shareware etj.

3. Përpjekjet për shqipërimin e disa termave të anglishtes

Për një numër të fjalëve angleze që kanë depërtuar në terminologjinë teknike janë bërë dhe po bëhen përpjekje për zëvendësimin e tyre me fjalë shqipe, a shqipërimin e tyre, qoftë duke i përkthyer fjalë për fjalë, qoftë duke i përshtatur bazuar në kuptimin e tyre.

Kështu në fushën e telekomunikacionit për:

–***power budget*** kemi ***buxheti i fuqisë*** – përkthim fjalë për fjalë,
ndërsa për:

–***power penalty*** kemi: ***humbjet e fuqisë*** – përshtatje bazuar në kuptimin e termit, e jo: *penaltia* (ndëshkimi) *e fuqisë*

Në *Fjalori i informatikës anglisht – shqip, shqip – anglisht*, Prishtinë, 2005, të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (Caka 2005a), janë bërë përpjekje për shqipërimin e disa anglicizmave, si:

–***lidhëzor*** për *konektor* (angl. connector), ***ndërfaqe*** për *interfejs* (angl. *Interface*), ***përshtatës*** për *adapter* (angl. *adapter*), ***mbart*** për *ngarkoj* (*upload*) dhe ***zhbart*** për *shkarkoj* (*download*), ***fjalëkalim*** për *pasvord* (angl. *Password*), ***çiftësi*** për ***paritet*** (angl. *parity*), ***ngjeshje*** për *kompresion* (angl. Compression), ***sinjeri*** për *android* (angl. *android*), ***vegëz*** për *lidhje* (angl. *link*) etj.

Në lëmin e bazës së të dhënave është krijuar termi ***regjistresë*** për termin *record* të anglishtes, sipas modelit:

– *regjistroj – regjistrim* (veprim) – *regjistresë* (rezultati i regjistrimit), si në mekanikë*: projektoj – projektim* (veprim) *projektesë* (rezultati i projektimit), përkatësisht sipas gjedhes: *ndërtoj – ndërtim – ndërtesë*.

Në *Fjalor i termave themelorë të mekanikës*, Tiranë, 2002 të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (Duro 2002), hasim disa shqipërime të termave të anglishtes, si:

– ***përcjellës*** (i lëndës) për *biter*, **lëshor** për *starter*, ***ndjesor*** për *sensor*, ***kokë korrëse*** për *heder*, ***gjysmëbosht*** për *semiaks*, ***tejbartës*** për *konvejer*, ***grat*** për *eficiencë*, ***këmishë uji*** për *vaterxhaketë* (angl. *water jacket*), term ky që në një punim në revistën shkencore "Kërkime "(Nr. 12) të ASHAK-ut del madje 12 herë (si: *furra vaterxhakete*) etj.

Bashkëpunimi i ekspertëve të fushave përkatëse me gjuhëtarët e terminologët, është një rrugë që mund të shpjerë te rezultate të kënaqshme. Shembull i këtij bashkëpunimi është, bie fjala, futja në përdorim e fjalës shqipe ***pjerrinë*** për fjalën *ramp* të anglishtes (Konkkola & Demjaha 2002).

Gjatë futjes së termave 'anglisht' ose gjatë shqipërimit të tyre, "duhet shqyrtuar termi shqip në sistemin terminologjik, duke e ballafaquar atë me konceptin që mbulon në sistemin e koncepteve "që termi i propozuar të hyjë në sistemin e caktuar terminologjik (Duro 2001, 2009). Kjo është një ndër arsyet pse parapëlqejmë termin *kompjuter* kundrejt termit të dikur-

shëm *ordinator* (marrë nga italishtja/frëngjishtja), edhe pse kuptimi i termit të dytë më mirë e përshkruan pajisjen përkatëse, meqë ajo nuk përdoret vetëm si llogaritës (kuptimi parësor i fjalës angleze 'computer').

Fjala kompjuter është shumë prodhimtare. Nga fjala *kompjuter* rrjedhin fjalët: *kompjuterizoj, kompjuterizim, i kompjuterizuar, kompjuterik, kompjuterikë*, ndërkaq nga fjala *ordinator* asnjë.

Nga ana tjetër, fjala *laser* në shqip, përveç si emër, përdoret vetëm edhe si mbiemër: *dioda laser = dioda laserike*. Në anglishte, ndërkaq, nga fjala *laser* janë krijuar fjalët: *lasant* 'materiali laserik', *lasering* dhe *lasing* 'gjenerimi i dritës laserike'. Në shqipe ende nuk kemi barasvlerës për këta terma të anglishtes, e as për foljen *lase* "laseroj "(gjeneroj dritë laserike).

Në botë, përpjekjet më të mëdha për zëvendësimin e anglicizmave me fjalë vendi bëhen në Francë, ku procesi i deanglizimit, në nivel institucional (ministror), ka filluar që më 1970 (Örsi 2008).

4. Rrugët për evidencimin e anglicizmave në gjuhën shqipe

Anglicizmave nuk mund t'u vihet ledh për të penguar depërtimin e tyre, por ata mund të evidencohen dhe përdorimi i tyre të shqyrtohet nga specialistët përkatës të ndihmuar nga gjuhëtarët e terminologët. Sa u përket anglicizmave në terminologjitë e caktuara, prijnë ata në terminologjinë e informatikës, për të cilat shkruhen punime shkencore, e mbrohen teza masteri e doktorate, si, b.f. për: rusisht (Fabijanić 2006), gjermanisht (Corr 2003), finlandisht (Mihajlov 2011), kroatisht (Mihaljević 2006; Škifić & Mustapić 2012).

Shqyrtimi i ndikimit të anglishtes në gjuhët e tjera të Europës bëhet edhe nëpërmjet krahasimit të disa gjuhëve. Më 2005 (Görlach 2005) është botuar fjalori i parë i këtij lloji që përfshin gjashtëmbëdhjetë gjuhë të përzgjedhura nga familje të ndryshme gjuhësore: nga gjuhët gjermanike – gjermanishtja, holandishtja, norvegjishtja dhe islandishtja; nga gjuhët romane – frëngjishtja, spanjishtja, italishtja dhe rumanishtja; nga gjuhët sllave – polonishtja, rusishtja, bullgarishtja dhe kroatishtja dhe katër gjuhë të tjera – finlandishtja, hungarishtja, greqishtja dhe shqipja.

Në universitetet e reformuara të mijëvjeçarit të ri nxitet përdorimi i anglishtes si gjuhë globale (= botërore). Kërkohet madje që edhe mësimi të

zhvillohet në anglisht, nëse jo në tërësi në degë të caktuara, atëherë së paku në ndonjë lëndë, me qëllim të mobilitetit (lëvizshmërisë) më të lehtë të studentëve, po dhe të profesorëve, në hapësirën universitare evropiane. Mendohet se kjo do t'u ndihmonte të mos jenë kryesisht vetëm konsumues dhe transmetues të dijes, po dhe gjenerues/ krijues të dijeve të reja.

Nën ndikimin e anglishtes, *Fakulteti i Elektroteknikës* i Universitetit të Prishtinës është bërë *Fakultet i Inxhinierisë Elektrike* (e që të jetë në hap me kohën) *dhe Kompjuterike*.

Fakultetet teknike në mbarë trojet shqiptare regjistrojnë disa mijëra studentë për çdo vit akademik (= shkollor, universitar), e me qindra studentë i mbarojnë studimet *bachelor* (baçelor), *master* ose të doktoratës dhe të gjithë këta duhet të bëjnë nga një punim diplome me të përfunduar të gjitha provimet.

Në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, të Universitetit të Prishtinës, diplomantëve u thuhet se në fillim të punimit të tyre të diplomës duhet të japin Listën e termave të përdorur në punim, që në fakt paraqet një fjalorth terminologjik anglisht – shqip.

Nga këta 'fjalorthë' të diplomantëve të këtij fakulteti, po dhe të fakulteteve të tjera teknike (inxhinierike) në hapësirën mbarëshqiptare, do të mund të përpilohej një listë e termave të fushave të ndryshme të inxhinierisë a teknikës e teknologjisë, e cila do të ndihmonte të përpilohej një listë më e gjerë e termave teknikë.

Nga ana tjetër shfrytëzimi i internetit si korpus gjuhësor, po dhe i korpuseve të tjera gjuhësore të shqipes që janë duke u krijuar aty-këtu do të ndihmonte të përpilohej një listë (fjalor) shteruese dhe gjithëpërfshirëse e anglicizmave në gjuhën shqipe (shih për italishten: Pulcini 2006).

5. Përfundim

Më 14 korrik të këtij viti (2013), në Indi do të dërgohet telegrami i fundit, 144 vjet mbas telegramit të parë, të dërguar në Uashington të SHBA-së nga Samuel Morse, shpikësi i telegrafit. Nuk do të ketë më mesazhe të dërguara me telegram, veçse në kontekstin historik (te ne qeveritarët ende dërgojnë urime shtetërore me 'telegram' edhe pse shërbimi i telegrafit ka pushuar së vepruari me të përfunduar lufta në Kosovë), e nuk do

të ketë më as telegraf, veç se në muze, por do të ketë sms-a (esemes-a) e telefona mobilë (celularë) dhe smartfona (telefona të mençur, inteligjent, të tipit 'i-phone') dhe mesazhe të dërguara me e-mail, prandaj sa më parë duhet ta standardizojmë drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin e këtyre termave dhe të termave të tjerë të huaj (kryesisht anglicizma) që po na vërshojnë përditë.

Bibliografi

Caka, N. (2004). Shqipërimi i disa termave të informatikës. *Koha ditore*, nr. 2612, f. 28. Prishtinë, 18 shtator 2004.

Caka, N. (2004a). Standardizimi i terminologjisë së informatikës. *Koha ditore*, nr. 2689, f. 29. Prishtinë, 4 dhjetor 2004.

Caka, N. (2005). Terminologjia e informatikës në gjuhën shqipe dhe standardizimi i saj në fjalorë. *Leksikografia shqipe – Trashëgimi dhe perspektivë* (Konferencë shkencore, Tiranë, 3 dhjetor 2004). Tiranë.

Caka, N., Dika, A., Rodiqi, S. (2005a). *Fjalor i informatikës anglisht-shqip, shqip-anglisht; Dictionary of Informatics English-Albanian, Albanian-English*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

Corr, R. (2003): *Anglicisms in German Computing Terminology*.

Duro, A. (2001). *Terminologjia si sistem*. Tiranë: Panteon.

Duro, A. (2002) (kryeredaktor). *Fjalor i termave themelorë të mekanikës* (*shqip-anglisht-frëngjisht-italisht-rusisht*). Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Shtëpia Botuese "Shkenca".

Duro, A. (2009). *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe* (*në rrafshin e formës dhe të përmbajtjes*). Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Fabijanić, I. (2006). Ortografija osnovnog oblika anglicizma u ruskoj računalnoj terminologji i aspekt varijabilnosti, *Croatica et Slavica Iadertina* II, Zadar. 161-168, 2006

Görlach A. (2005). *Dictionary of European Anglicisms: A Usage Dictionary of Anglicisms in Sixteen European Languages*. Oxford University Press.

Konkkola, M., Demjaha, B. (Redaktor gjuhësor: *N. Caka*) (2002)., *Problem apo sfidë?/ Problem or a challenge*? Prishtinë.

Mihajlov, P. (2011). *Influence of English on the Finnish of Information Technology – A Study of Contemorary Terminology*, University of Tampere, School of Languages. (Pro Gradu Thesis).

Mihaljević, M. (2006). Hrvatsko i englesko računalno nazivlje. Jezik. *Časopis za kulturu hrvatskoga književnog jezika* 53.2: 41–50.

Nuhiu, V. (2013). *Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

Örsi, T. (2008)."The De-Anglicization of the Vocabulary of Informatics in French", in *Anglicisms in Europe: Linguistic Diversity in a Global Context* (Edited by, R. Fischer and H. Pułaczewska). Newcastle upon Tyne: Cambridge Scholars Publishing, 208-221.

Pulcini, V. (2006). 'A New Dictionary of Italian Anglicisms: the aid of corpora'. In Corino, E.; Marello, C.; Onesti, C. (eds.). *Proceedings of the XII th EURALEX International Congress*. Alessandria: Edizioni dell'Orso. 313-322.

Škifić, S., Mustapić, E. (2012). Anglizmi i hrvatsko računalno nazivlje kroz prizmu jezičnoga konflikta i jezične ideologjie. *Jezikoslovlje*. 13.3: 809-839.

Nebi CAKA, Prishtina

ANGLICISMS IN TECHNICAL TERMINOLOGY

Summary

This paper treats the anglicisms in the technical terminology with special emphasis on computer terminology, which number is significantly higher than in other areas, and due to its impact on all branches of science and technology including daily life. In this regard, efforts are made to do a typological classification of the lexical anglicisms in technical terminology, based on computing terminology. There are also provided some suggestions for the paths needed to be followed to identify the anglicisms in Albanian and their translation and standardization.

Irena PATA KAPO, Tiranë

ANGLICIZMAT NË SHTYPIN SHQIPTAR PAS 1990. VËRSHIMI DHE SJELLJA E TYRE NË KONTEKSTIN SHQIPTAR DHE NË KUSHTET E GLOBALIZMIT

KDU 811.18'362:811.111
811.18-26

Abstract

The influence of the English language on the Albanian language, a phenomenon of the last two decades, seems to be drawing the linguists' attention. A corpus of 511 Anglicisms bears witness to the active life of these English borrowings in the Albanian press after the 1990s. This paper outlines some aspects of anglicisms' life and 'behaviour' in Albanian press language. It deals with some aspects of their morpho-syntactic, phonetic, orthographic and semantic analysis. A distinction is made between pseudoanglicisms and anglicisms as well. The paper also explores some of the linguistic and extra-linguistic factors that enabled the contact between English and Albanian languages and draws a distinction between Anglicisms that have been subjected to the grammatical rules of the Albanian language and those that have entered Albanian keeping their English language properties intact.

A generally positive attitude is held towards the use of Anglicisms in the Albanian press language in order to fill the lexical gaps with words and phrases denoting new concepts and notions or carrying extra connotative meanings rather than their use to duplicate existing lexical units in Albanian, in an effort to preserve the Albanian language identity in this globalization epoch of ours, thus contributing to the linguistic and cultural heritage of the country.

Key-words: English borrowings, Anglicisms, pseudoanglicisms, internationalisms, linguistic and extra-linguistic factors, morphological/ phonetic/ orthographic/ syntactic adaptation

Tashmë është një fakt i pranuar nga shumëkush që prania e anglicizmave në gjuhën shqipe është rritur së tepërmi në 20 vitet e fundit. Gjithashtu është rritur dhe denduria me të cilën hasen në shtypin e shkruar, por dhe më gjerë në të gjitha mediat. Shembujt që kam shkëputur nga shtypi i përditshëm janë shkëputur nga një studim i autores për grumbullimin e anglicizmave në organe të ndryshme të shtypit shqiptar, që në fillim të viteve 1990 e deri sot.

Ka raste kur anglicizmat në shtyp përdoren për të dhënë një fjalë të adoptuar së fundmi në shqipe, e cila në anglisht është më e shkurtër se varianti i saj korrespondues në shqipe, siç është rasti i *census*:

Anketuesit mbërrijnë në dyert e shqiptarëve, starton ***censusi*** (Shqip, 2.10.2011, f. 4).

Ashtu si ka dhe raste kur anglicizmat përdoren si dublues të fjalëve shqipe siç është rasti i *workshop*, që shpeshherë e çuditërisht është më e preferuar se *seminar* e shqipes:

Përveç kompeticionit do të ketë edhe ***workshope*** (Klan,7.12.2007, f. 62).

Në disa raste të tjera anglicizmat janë përshtatur plotësisht sipas grafisë e shqiptimit të shqipes, siç është rasti i *menaxher*:

Megjithatë duket se Jasson, i cili është dhe ***menaxher*** *i saj, nuk e pëlqen idenë e martesës* (Koha jonë, 7.8.2009, f. 14)

Nëse në Europë e më gjerë vërshimi i anglicizmave në gjuhët e tjera dhe studimi i sjelljes së tyre në këto gjuhë është më i hershëm, që nga mesi i shekullit njëzet (me emra të njohur si Rudolf Filipoviçi, Manfred Görlach-u me Fjalorin e anglicizmave europianë, Ivan Klajn etj.), në Shqipëri kjo ndërmarrje është ende në hapat e para; ndërkohë që në Kosovë ka studime më të hershme e më konkrete, të cilat origjinojnë që me hulumtimet për sjelljen fonetike e morfologjike të huazimeve angleze të Vesel Nuhiut, Ismail Mehmetit etj.

Shqipja është përfshirë në studimin e Görlach-ut, ndër 16 gjuhët e tjera europiane dhe shumë herë përgjatë fjalorit përmendet mungesa e studimeve në këtë fushë për shqipen. Bazë për anglicizmat në shqip dhe sjelljen e përshtatjen e tyre janë marrë dy studimet e linguistëve kosovarë të sipërpërmendur të Universitetit të Prishtinës, të cilat datojnë në vitet 1980, por gjithsesi pa një kontribut nga institucionet e shqipes së Tiranës.

Përveç shkrimeve individuale në gazeta e revista apo dhe një sërë shkrimesh në revista shkencore si Studia Albanica, Studime filologjike, Gjuha jonë etj., të gjuhëtarëve të njohur shqiptarë si Xhevat Lloshi, Hajri Shehu etj., për huazimet angleze në gjuhën shqipe është dhe një studim i Rajmonda Këçirës nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në Shkodër, i cili përfshin kryesisht ndikimin e anglishtes në shqipe në fillim të shekullit XX me gazetën 'Laboremus', dhe botimet e tre muajve të Gazetës Shqiptare (nga 31 Marsi deri në 30 qershor 2000).

• Rasti i anglishtes dhe i shqipes nuk është ai që i referohet afërsisë gjeografike. Siç dokumentohet në historinë e shkrimit të shqipes, fjalë anglisht janë ndeshur që në botimet e hershme të saj, duke filluar nga mesi i shekullit XIX e më vonë. Këto botime përfshijnë si tekste shkollore, ashtu edhe gazeta dygjuhëshe si *Dielli, Laboremus* etj. Hapja e shkollës 'Harry Fultz' dhe themelimi i Institutit Shqiptaro-Amerikan të Kavajës në 1925 ishin dy promovues të tjerë të shtimit të fjalëve anglisht në shqipe.

Në shekullin XX, pas amullisë së krijuar nga dy Luftrat Botërore, në krahasim me vendet e tjera, Shqipëria u shkëput akoma më shumë nga arena gjuhësore e ndërveprimit të gjuhëve e kulturave të ndryshme, për shkak të regjimit izolues komunist prej gati një gjysmë shekulli. *Pavarësisht nga izolimi, mësimi i gjuhës angleze në shkolla ishte një prioritet, ashtu si edhe kishte një orientim shumë pozitiv, edhe pse të fshehur, ndaj kulturës, kinemasë, filmit e sporteve me origjinë angleze e amerikane*.

Pas 1990 (vitit që shënoi ndërrimin e sistemeve në Shqipëri), përpjekjet e Shqipërisë për integrimin euroatlantik të saj shënuan dhe kontaktet e njëpasnjëshme me organizma ndërkombëtarë, të cilët u vendosën e kishin veprimtarinë e tyre në Shqipëri. Anëtarësimi në OSBE, Këshillin e Europës, NATO etj., mbështetja veçanërisht e Amerikës ndaj zhvillimeve dhe demokratizimit të shoqërisë shqiptare etj., krijuan përfundimisht kushtet për shkëmbime të ndërsjellta kulturore, politike etj, të Shqipërisë me vendet e tjera, por edhe një ekspozim të plotë të shqipes ndaj gjuhës së globalizmit - anglishtes. Anglisht është edhe gjuha e internetit. Ajo vazhdon të jetë prioritet në shkolla e është kthyer në një kusht të domosdoshëm për punësimin e njerëzve.

• Me krijimin e kushteve favorizuese për 'akomodimin' e huazimeve prej anglishtes, media, e shkruar dhe e folur, u gjend para një vërshimi fjalësh të huaja, të cilat shpesh, siç e përmendëm dhe më lart, përdoreshin e përdoren jo vetëm për nevojë. Gjuha e shtypit ka marrë shumë elemente të ligjërimeve e stileve të tjera. Në funksion të kësaj ndërthurjeje, por edhe të përmbushjes së misionit që shtypi ka (përçimi i lajmit në mënyrë sa më të efektshme e në një kohë e hapësirë sa më të vogël), është dhe përdorimi i një numri të konsiderueshëm huazimesh në të, sidomos atyre nga anglishtja. Ato përdoren si sinonime të fjalëve ekzistuese shqipe, mund të

përdoren për eufemizëm etj. Disa prej tyre madje janë të përkohshme e zhduken pas një kohe të shkurtër. Duket se ato i shërbejnë lajmit përkatës, në kohën që ka ndodhur, dalin nga përdorimi dhe më vonë identifikohen po me të. Të tilla janë *impeachment, exit poll, dance off* etj. Shumë prej lexuesve të gazetave as nuk do ta dinin që ekzistonin terma të tillë si "*dance off*"[1], "*show down* "apo "*sing off* "po të mos shikonim e bëheshim fansa të spektakleve të famshme në shumë vende të botës si "Dancing with the stars "apo "X-Factor".

Një sërë gazetash e revistash që botohen sot në Shqipëri kanë një pamje tërësisht perëndimore, me ngjyrat, imazhet e formatin e tyre, ku edhe emri shpesh është imitim i gazetave më të famshme perëndimore (për shembull *Tirana Observer, Living*, *Standard* apo emra seksionesh në gazeta si *Gossip, In & Out,* etj.).

Një pjesë e huazimeve angleze në shtypin e shkruar fillimisht janë përdorur ***për nevojë*** duke shprehur koncepte të reja me terma të rinj, të cilët shpesh nuk përkthehen për shkak të shpejtësisë me të cilën synohet të jepet lajmi (*abstrakt, badminton, banner, by-pass, gigabajt* etj). Fjala e huaj e godet lexuesin duke mbartur ***një efekt shenjues*** në nivel tekstual. Huazimet angleze kanë jo vetëm një funksion denotativ, por është i rëndësishëm fakti që ato arrijnë të ndërthuren me fjalët shqipe, duke i shërbyer konteksteve të ndryshme me vlerat e tyre ngjyruese ((*big, house, bomber, target, jackpot, raund* etj). Ato vijnë me një ***ngarkesë emocionale të konsiderueshme***, me të cilën gazetari jep një mesazh edhe individual. Kjo shpjegon dhe ngarkesën më të madhe emocionale e stilistikore të fjalëve, si *killer* apo *lider* në krahasim me ekuivalentet shqip *vrasës* e *udhëheqës*.

Nga klasifikimi që kemi bërë vihet re se 80.4% e anglicizmave të grumbulluar shënojnë një fjalë e koncept të ri në shqip, ndërsa 3.9% vijnë me vlera ngjyruese, 10.9% vijnë me vlera shënuese e ngjyruese.

• Një prej çështjeve të komplikuara që lidhet me anglicizmat në shqipe është ***identifikimi*** i tyre. Me anglicizëm i referohemi një fjale të huazuar nga anglishtja e cila gjatë rrugës së transferimit të saj përshtatet në gjuhën pritëse, me qëllim që të integrohet në sistemin e saj linguistik.

---

[1] *Nga ana tjetër, Bigut i takonte të festonte dyfish, pasi ai i shpëtoi "**dance off-it**", ku triumfoi ndaj francezes Eloise le Petit.* (Pa., 14.5.2011, 27)

Për identifikimin e anglicizmave na është dashur të përjashtojmë një sërë kategori fjalësh të ngjashme me to por që nuk janë të tilla siç janë 'pseudoanglicizmat' - 'huazimet false' ose 'fjalë në dukje anglisht, me përbërës anglisht por që në anglisht nuk ekzistojnë'. Si *pseudoanglicizma* konsiderohen shkurtimet apo copëzimet e kompozitave, që përdoren me kuptimin e të tërës. Sipas disa gjuhëtarëve, në momentin që struktura e këtyre fjalëve, të përbëra ose jo, kalon në një proces thjeshtëzimi, pra, bie elementi i parë ose i dytë gjatë përdorimit, huazimet kthehen në pseudohuazime ose pseudoanglicizma[2]: *night* përdoret në vend të *night-club*, *parking* në vend të *parking lot* etj. 'Huazimet e copëzuara' janë dukuri për pjesën më të madhe të gjuhëve europiane; sipas Fjalorit të anglicizmave europianë të Görlach-ut '*parking*', për shembull, përdoret në 12 nga 16 gjuhët e analizuara në këtë fjalor, '*kamping*' në 15 gjuhë europiane (në vend të 'camping site'), '*holding*' në 9 gjuhë etj.

Si pseudoanglicizma janë konsideruar dhe fjalët anglisht të sjella në shqipe nëpërmjet gjuhëve të tjera në kontakt, siç janë italishtja e frëngjishtja. Por *është e vështirë të përcaktohet sakt kufiri mes fjalëve të huazuara drejtpërdrejt nga anglishtja dhe anglicizmave të huazuar nëpërmjet gjuhëve të tjera*. Po ashtu Görlah-u identifikon në Fjalorin e anglicizmave europianë shumë anglicizma si të ardhur në shqipe nëpërmjet frëngjishtes, italishtes, rusishtes etj. Për shembull, *aksion* konsiderohet nga ai si anglicizëm i ardhur në shqipe prej frëngjishtes[3], *apartament* prej frëngjishtes[4], *barelë* nga italishtja[5], *biftek*[6] nga frëngjishtja, *kamp*[7] nga frëngjishtja, *karton*[8] nga italishtja, *kampion*[9] nga italishtja, *shans*[10] nga frëngjishtja, *krem*[11] nga frëngjishtja, *ese*[12] nga frëngjishtja, *profesional*[13] nga italishtja etj.

---

[2] N. Alexieva, How and why are Anglicisms often lexically different from their English etymons?, *Anglicisms in Europe*, Cambridge Scholars Publishing, 2008, f. 46.
[3] M. Görlach, *A Dictionary of European Anglicisms*, Oxford University Press, 2001, f. 2.
[4] M. Görlach, vep.cit., f. 7.
[5] M. Görlach, vep.cit., f. 16.
[6] M. Görlach, vep.cit., f. 20.
[7] M. Görlach, vep.cit., f. 46.
[8] M. Görlach, vep.cit., f. 50.
[9] M. Görlach, vep.cit., f. 55.
[10] M. Görlach, vep.cit., f. 55.
[11] M. Görlach, vep.cit., f. 77.
[12] M. Görlach, vep.cit., f. 106.
[13] M. Görlach, vep.cit., f. 243.

Një kriter shumë i rëndësishëm për identifikimin e anglicizmave e dallimin e tyre prej pseudoanglicizmave është ai fonetik; huazimet mund të kenë thuajse të njëjtën formë grafike, por shqiptimi i tyre është një tregues i qartë i rrugëtimit që kanë bërë për të ardhur në shqipe. Anglicizmi '*sajt*', për shembull, herë gjendet me grafinë e shqiptimin e italishtes e herë me atë të anglishtes:

Në ***sitin*** e Ministrisë së Turizmit janë hedhur disa të dhëna… (*Klan*, nr. 541, f. 27)

Edhe në internet kanë lulëzuar ***site*** të cilat i drejtohen grave… (*Klan*, 21.7.1998, f. 54)

… dhe pas një proçesi përpunimi të materialeve, për të verifikuar autenticitetin, ato publikohen në ***sajt***. (*Klan*, 7.8.2010, f. 5).

Fjala është për Altin Haxhin i cili nënshkroi një kontratë me Anorthis, një lajm që jepet edhe nga ***sajti*** i klubit qipriot. (*Albania*, 26. 6. 2005, f. 23).

Dikur as që mendohej të gjendej një informacion on-line, ndërsa sot çdo njësi në zonat urbane ka ***sajtin*** e saj. (*Albania*, 23.8.2007, f. 22).

Në ***sitin*** zyrtar të grupit nuk figuron asnjë koncert në vendin tonë. (*Koha jonë*, 11.8.2009, f. 15).

Disa nga ***sajtet*** amerikane online e kanë tallur dhe vënë në shënjestër Obamën. (*Shekulli*, 16.8.2010, f. 20).

Një kategori tjetër pseudoanglicizmash janë emrat e përveçëm ose markat e njohura tregtare angloamerikane, të cilat përdoren si emra të përgjithshëm në gjuhët e tjera, si *Gillette* ose *pampers*, që vjen nga emri i markës së njohur të prodhimit të pelenave për fëmijë, por që në shqip është përgjithësuar duke iu referuar vetëm pelenave për fëmijë, jo markës me këtë emër specifik.

Pseudoanglicizma janë dhe ato fjalë që formohen me elemente angleze, por që në vetvete nuk përfaqësojnë fjalë të anglishtes, si për shembull ato me prapashtesën *-man*. Në përgjithësi këto pseudoanglicizma mendohet të kenë lindur nga nevoja për të emërtuar autorin/vepruesin etj. të disa anglicizmave/fjalëve të tjera: rekord – rekordmen (për *record holder*), apo krijimi i shqipes: *bllokmen*, fjalë që në anglisht nuk ekzistojnë.

Përdorimi i një fjale angleze në shqipe, por në *një kategori gra-*

matikore, që fjala nuk e njeh në gjuhën burimore, është një tip tjetër pseudoanglicizmi. Kjo gjë ka ndodhur me anglicizmin mbiemër *snob*, i cili në shqip vjen dhe në trajtën e foljes '*snoboj*' në një kohë që në anglisht kjo fjalë nuk ekziston në kategorinë gramatikore të foljes:

Peqinasit 'snobojnë' kupën, presin merkaton e dimrit (*Panorama* Sport, 13.12.2012, 6).

Ose *soft* që në anglisht është mbiemër, në shqip vjen me një kuptim krejt tjetër: 'program kompjuterik', si shkurtim i fjalës *sofwear*, duke u përfshirë në kategorinë e emrave:

***Softi** tjetër që do ndërtohet për noterët për Tiranën e Durrësin është 300 mijë euro dhe kjo është parashikuar në buxhetin e 2012* (*Shekulli*, 8.12. 2011, fq. 5);

Rastet e mësipërme të tipologjisë së pseudoanglicizmave shfaqen po njësoj dhe në gjuhë të tjera si frengjisht, rusisht, bullgarisht etj.

• Përsa i përket ***sjelljes fonetike*** të huazimeve angleze në shqipe, mund të themi që dhe tek ne, si në të gjitha gjuhët e tjera 'prè' e huazimeve, arrihet në atë që quhet *kompromis fonetik*[14], pra, një produkt, i cili mbart elemente shqiptimi nga të dy gjuhët, por që në shumicën e rasteve, është lehtësisht i dallueshëm që ka statusin e huazimit.

Në disa gjuhë europiane ekziston tendenca për të imituar tingujt e anglishtes, ndërkohë që shumë folës kanë për tendencë të eliminojnë tingullin e fundit të një fjale të huaj ose ta modifikojnë atë. Siç janë shembujt tipikë të shqiptimit të disa fjalëve apo emërtimeve nga anglishtja: *topçena /top çenëll/, kopjuter /kompjuter/, hands /ence/, iparej /hit përeid/*, etj. Apo varianti humoristik i fjalës 'menaxher' për të vënë në dukje shkallën e mosnjohjes së anglishtes nga kategori të caktuara njerëzish: mantanxher /menaxher/ etj. Pra, shqiptimi i huazimeve shpesh bëhet duke u bazuar në perceptimin rastësor dëgjimor dhe jo si rezultat i të mësuarit apo edukimit shkollor e mediatik. Megjithatë pas një procesi relativisht të gjatë përshtatjeje për një pjesë të anglicizmave do të ndodhi ajo që Kristaq Cipo nënvizon: "*Sa herë që përvetëson populli një fjalë të huej me anë të veshit, ajo*

[14] R. Filipović, *The Phonetic Compromise*, Studia Romanica et Anglica, Facultas Philosophica Universitatis Studiorum, Zagreb, Korrik 1958, f. 77.

fjalë do vejë ma parë duke u rrumbullue në gojë të tij gjer sa të vishet me tiparet e shqipes e të mos njihet ma në asht jona apo e ardhme."[15]

• Në kontekstin e ***përshtatjes morfologjike***, korpusi i përzgjedhur prej 511 anglicizmash përmban 87.6 % huazime të kategorisë leksiko-gramatikore të ***emrit,*** rreth 12.7 % ***mbiemra,*** 4.1 % ***folje,*** 0.9 % ***ndajfolje*** dhe 1.5 % ***shprehje emërore***.

Ndër të tjera, një vëzhgim me interes do të ishte gjinia e disa emra frymorësh (të njerëzve dhe të kafshëve) ku themi se ***gjinia lidhet ngushtë me seksin***. Kjo bën që ***gjinia tek emrat e frymorëve*** të mos jetë thjesht një kategori gramatikore, por ***leksiko-gramatikore.*** Në disa nga huazimet emra të glosarit tonë, të cilët shenjojnë frymorë, këto dy elemente (mbaresa gjinore e femërores dhe kuptimi leksikor i mashkullores) janë në kundërshti me njëri-tjetrin:

biznesmen – biznesmene, barmen – barmene, kaubojs – kaubojse, kongresmen – kongresmene, narkoman – narkomane, supermen – supermene, xhentëllmen – xhentëllmene.

Ndërsa një dukuri tjetër që haset brenda kategorisë së shumësit të emrave është ajo ku ***anglicizmi mbart në vetvete dhe formën e shumësit të anglishtes dhe atë të shqipes*** ose thënë ndryshe, tema e shumësit të fjalës angleze shërben si temë e njëjësit të huazimit anglez në shqipe: (*një*) *hacker**s-a**, (një) fan**s -a**, (një) kauboj**s-a**, (një) skorpion**s-a*** etj.

• Dukuria e 'zgjerimit semantik' ka prekur jo vetëm *vetë huazimet angleze*, të cilat vijnë në shqipe me kuptime shtesë apo me kuptime të ndryshme nga ato në gjuhën burimore:

FITNESS – angl.: "aktiviteti/ gjendja e të qenit mirë fizikisht", në shq.: "qendër *fitnesi"*

EXCHANGE – angl. "shkëmbim parash", shq.: "*dyqani*/ *ambienti* ku bëhet këmbimi i parave" etj.

Por kjo dukuri ka prekur edhe disa nga *fjalët e leksikut të shqipes* duke shtuar numrin e kuptimeve të tyre, natyrisht nën ndikimin e gjuhës e kulturës angleze e amerikane:

ABSTRAKT – (mb.) *shq*. "jo konkret", *anglicizmi*: (em.) "ide të për-

[15]K. Cipo, *Fonetika (1949)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2003, f. 43.

gjithshme, përmbledhje"

ANEKS – *shq*.: "shtojcë", *anglicizmi*: "pjesë shtesë e një dokumenti"

AUDIENCE – *shq*.: "pritje zyrtare…", *anglicizmi*: "grup njerëzish të bashkuar për të dëgjuar a parë diçka"

EKSPERTIZË – në *shq*. (mjek.) "hetim a shqyrtim nga eksperti", anglicizmi: "njohuri të specializuara në një fushë të caktuar"

EKSTRAKT – në *shq*. (kim.) "lëndë që nxirret nga bimët, kafshët, etj. me anë të proçeseve kimike e fizike", *anglicizmi*: "pasazh i përzgjedhur nga një poemë etj., pjesë e shkëputur".

METAL – *shq*.: "*kim*. Trup i thjeshtë e i fortë…", *anglicizmi*: "(muzika) metal"

SPIKER – *shq*.: "folës, drejtues i një program televiziv etj.", *angl*. "kryetari/ja i/e parlamentit"

STATUS – *shq*.: "pozit*ë shoqërore, ligjore etj., e dikujt a e diçkaje në marrëdhënie me të tjerët", anglicizmi*: "gjendje/pozicion i dikujt, e deklaruar në rrjetet sociale si *facebook, twitter* etj."

Anglicizmi i fundit në listën e mësipërme, fjala *status*, është një rast i veçantë jo vetëm i zgjerimit kuptimor të fjalës tashmë ekzistuese në shqipe, por dhe i kalimit të saj nga rrafshi libror në atë bisedor të ligjërimit. Siç shihet dhe më lart, i vetmi kuptim që fjala ka në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, është "pozitë shoqërore, ligjore etj. e dikujt a e diçkaje në marrëdhënie me të tjerët, p.sh. *statusi i nëpunësit civil* "dhe përcaktohet si *librore*. Ndërsa Fjalori i Oksfordit, ndër pesë kuptimet që rendit për këtë fjalë, po citojmë "niveli i rëndësisë që i jepet diçkaje, *gjendja e dikujt/diçkaje gjatë një procesi*, etj.", si dhe kuptimi i mësipërm. Përdorimi i ri i fjalës 'status' në shqip, haset gjerësisht në kontekstet ku flitet për tema të tilla si Facebook, Twitter etj., ku përdoret me kuptimin e gjendjes emocionale, shpirtërore etj. të dikujt, që e bën të ditur publikisht në faqet personale të tyre në këto rrjete, siç vihet re edhe në shembullin e mëposhtëm: *Në faqen personale në Facebook ai postoi* ***statuse*** *të ndryshme, ku shprehte adhurim për këtë kafshë inteligjente*. (*Shqip*, nr. 106, f. 22).

• Përsa i përket tipologjisë së **përshtatjes shkrimore të anglicizmave** mund të themi që teorikisht fjalët angleze që hyjnë në shqipe duhet të shkruhen sipas parimit themelor të drejtshkrimit të shqipes, që është

parimi fonetik[16]**.** Por sipas *Fjalorit drejtshkrimor* të shqipes të 1976 për huazimet që nuk kanë pasur një formë të ngulitur të shkrimit të tyre, për to është zbatuar dhe ***parimi etimologjik***, duke zgjedhur atë ortogram që pajtohet ose me shkrimin, ose me shqiptimin e fjalës në gjuhën e burimit

Në korpusin tonë të grumbulluar nga shtypi i shkruar në Shqipëri vihen re këto tipologji të shkrimit të anglicizmave:

- Në ***shkrimin sipas shqiptimit,*** në morinë e anglicizmave të korpusit tonë, vihet re, ndër të tjera, dukuria e ***'thjeshtëzimit' të bashkëtingëlloreve dyshe*** *(dribbling – dribling, massmedia – masmedia, asset – aset etj.; megjith*ëse kemi dhe *jogging, miss* e *trekking* të cilat nuk ndryshojnë*).*

- Në korpus gjenden dhe shumë shembuj anglicizmash të cilat ***ruajnë grafinë angleze:***

Dërgoni SMS me ***text*** *"AMC "në 1519, përfitoni një paketë prej…* (*Shqip*, 9.9.2008, 10)

Balerina është shfaqur në ***topless****, ndërsa dy djemtë …* (*Panorama*, 10.3.2012, 27).

Arnold Schwarzeneger, ylli i ***bodybuilding****, guvernator i Kalifornisë* (Korrieri, 4.7.2005, 23)

- Ashtu si ka edhe shumë raste ku anglicizmat ***ruajnë pjesërisht shqiptimin e pjesërisht grafinë angleze***:

… ajo nuk mund të të ftojë ty që të votojë kandidatura të fushës dhe ***beckgraundit*** *të mirfilltë politik.* (*Panorama*, 5.6.2012, 2)

Ky djalë është një dreq ***hipie*** *që qelbet erë*. (*Panorama*, 5.6.2012, 20)

Kjo CD përmban versionin *unplagged* të këngës (*Koha jonë*, 1.8.2009, 15)

Por është ende e paqartë se si duhet të jetë mënyra e forma finale e shkrimit të huazimeve prej anglishtes. Më lart përmendëm Fjalorin drejtshkrimor të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (1976) dhe parimet përkatëse mbi të cilat bazohet shkrimi i fjalës së huaj. Ndërkohë që po rendisim dhe dy burime të tjera të rëndësishme e orientuese për çështjen në fjalë.

Së pari, kemi fjalorin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë "Për pastërtinë e gjuhës shqipe "(1998). Këtu vetëm sa sinjalizohet vërshimi i huazimeve të tjera, me origjinë të ndryshme nga ç'kishte njohur shqipja më

[16] *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1976, f. 4.

parë dhe listohen vetëm tri huazime nga anglishtja: *bord, brifing* dhe *draft.*

Dhe së dyti, mund të përmendim dhe botimin më të fundit në Shqipëri në këtë drejtim, ndonëse jo nga institucionet përkatëse gjuhësore, Fjalorin Drejtshkrimor të gjuhës shqipe, nga Ali Dhrimo dhe Rami Memushaj (2011), ku thuhet se 'shqiptimi e shkrimi i fjalëve të huazuara është ende i pangulitur'. Megjithatë në të gjithë korpusin e fjalëve që autorët kanë paraqitur aty, përfshihen dhe shumë huazime nga anglishtja.

Aty anglicizmat herë jepen të shkruar *sipas shqiptimit*:

imeil (f. 310), softuer (f. 736), harduer (f. 288), xhentëlmen (f. 891), xhuboks (f. 892) etj. e herë *siç shkruhen në gjuhën burimore*:

web, walkie-talkie, website, weekend, windows, www (f. 925) etj.

Po t'i referohemi *shembujve të korpusit tonë*, nga njëra anë do të shihnim përpjekjet e hershme të gazetarëve për t'i qëndruar besnik *parimit fonetik të shkrimit të huazimeve*_apo fjalëve të huaja (shembujt e parë i përkasin *gjysmës së parë të periudhës* që përfshin ky studim 1990-2000). Ndërsa në shembujt e mëvonshëm, d.m.th. *nga viti 2000 e deri sot*, shkrimi sipas shqiptimit është më i rrallë në numër, pra, dominon *shkrimi sipas gjuhës burimore*:

Në 1998: *Mënyra e pagesës do të jetë **kesh** ose me trasfertë bankare* (*Koha jonë*, 2.12.1998, f. 24);

Në 2005: … *në një kohë kur 80 për qind e parave qarkullojnë në "**cash"*** (*Albania*, 28.6.2005, f. 13); (*cash* del dhe në të gjithë shembujt e mëvonshëm)

Në 1999: *Ministrin…ngjarja e fundit në Tropoje ka një "begraund "politik, dhe këtu ka implikime të qarqeve politike… (Klan*, 8.8.1999, f. 15);

Në 2008: *…në shumë vende që kanë një **background** të shtresëzuar, të niveluar e të matur tradite urbane* (*Gazeta shqiptare*, 13.8.2008, f. 21) etj.

Për të qënë më të saktë, nga rreth 2090 shembuj që rendit glosari ynë, afërsisht 50% e tyre shkruhen sipas grafisë së anglishtes, 32% sipas shqiptimit dhe rreth 17 % shkruhen pjesërisht sipas shqiptimit e pjesërisht sipas grafisë origjinale.

Pra, duke u bazuar në vëzhgimet e mësipërme mendojmë se do të ishte më e udhës që anglicizmat me moshë të re të shkruheshin sipas grafisë së anglishtes e madje me kursive (përkundrejt atyre anglicizmave 'më të

vjetër' të shqipes, forma e të cilave është më e unifikuar sesa pjesa tjetër dhe del herë sipas shqiptimit e herë pjesërisht sipas grafisë origjinale); *fillimisht*, për shkak të numrit të konsiderueshëm të tyre në shqipe. *Së dyti*, nëse të gjithë anglicizmat e glosarit tonë do të shkruheshin sipas shqiptimit, kjo do ta vështirësonte shumë të kuptuarin dhe identifikimin e tyre nga lexuesit; dhe *së treti*, do të vështirësonte tej mase punën e gjuhëtarëve e gazetarëve në transkriptimin e fjalëve anglisht, që nuk është dhe aq i thjeshtë për shumë nga fjalët angleze që përdoren në shtyp.

Në përfundim mund të themi që njerëzit në të gjithë botën e konsiderojnë anglishten si gjuhën e mundësive ekonomike, por në fakt kjo nuk përbën qëndrimin absolut ndaj saj. Ka mendime të tjera sipas të cilave anglishtja shihet si një mjet për shkatërrimin e diversitetit lingustik dhe kulturor. Prandaj dhe *Deklarata e Würzburg-ut për politikën europiane të gjuhëve* shprehet për ruajtjen e diversitetit kulturor dhe linguistik të vendeve europiane dhe për programe mësimdhënieje gjuhësore më intensive duke ruajtur *unitetin brenda diversitetit.*

Vendosja dhe zbatimi i politikave gjuhësore dhe planifikimit gjuhësor në gjithë territorin shqipfolës do të ishte një hap përpara në mirëadministrimin e prurjeve më të fundit nga jashtë në shqipe. Shumë prej anglicizmave kanë ardhur bashkë me konceptet e objektet e reja të shkencës, muzikës, modës, etj., pra, le t'i konsiderojmë ato si plotësuese të nevojave të gjuhës tonë, dhe si kontribuese në modernizimin e saj. Përpjekjet për ta ruajtur nga 'tjetërsimi' janë ende në fazën fillestare.

Bibliografia

Cipo Kristaq, Fonetika, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2003.

Dhrimo Ali, Memushaj Rami, Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe, Infobotues, 2011.

Filipović Rudolf, Semantic Extension Changes in Adaptation of English Loan-Words in Serbo-Croation, Studia Romanica et Anglica, Zagrebiensia, 25-26, dhjetor 1968.

Filipović Rudolf, The Morphological Adaptation of English Loan-Words in Serbo-Croat, Studia Romanica et anglica, Zagrabiensia, tetor 1961.

Filipović Rudolf, The English Element in European Languages, Zagreb, 1982.

Filipović Rudolf, English as a word donor to other languages of Europe, http://www.intellectbooks.com/europa/number5/hart.htm, marrë më 29.9.2006.

Filipović Rudolf, The phonetic Compromise, Studia Romanica et Anglica, Facultas Philosophica Universitatis Studiorum, Zagreb, korrik 1958.

Fischer R., Pulaczewska H., Anglicisms in Europe: Linguistic Diversity in the Global Context, Cambridge Scholars Publishing, 2008.
Fjalor Drejtshkrimor i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, 1976.
Fowler R., Language in the News, Routledge, London, 1991.
Görlach Manfred, English in Europe, Oxford University Press, 2002.
Görlach Manfred, A Dictionary of European Anglicisms, Oxford University Press, 2001.
Hornby A.S., Oxford Advanced Learner's Dictionary, Oxford University Press 1989.
Jorgaqi K., Mbi integrimin leksiko-semantik të italianizmave në shqipen standarde, Studime Filologjike, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1-2, 1998 .
Klajn I., Influssi Inglesi nella lingua italiana, Firence, Olschki, 1972.
Kërçira Rajmonda, Anglicisms in Albanian: A Direct and Mediated Language Contact Phenomenon, Graz, Instituti i Anglistikës, 2005.
Lafe Emil, Gjuha e medias – probleme dhe detyra, Gjuha jonë, 2004.
Lloshi Xhevat, Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2001.
Lloshi Xhevat, Shqipja përballë rrjedhave të globalizimit, Studia Albanica, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2005
Lloshi Xhevat, Raste ndërhyrjesh të huazimeve nga anglishtja', Studime filologjike, nr. 1-2, 2011, fq. 68-75
Për pastërtinë e gjuhës shqipe (fjalor), Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 1998
Shehu Hajri, Rreth anglicizmave në mjetet e sotme të informimit masiv, Studime Filologjike, 3-4, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2002
Shkurtaj Gjovalin, Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folura, Gjuha jonë, 2004
Topalli Kolec, Fonetika historike e gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë e Letërsisë, DITURIA, 2007
Gazeta e revista shqiptare si *Klan, Shekulli, Koha jonë* etj.

Irena PATA KAPO, Tirana

THE INSERTION AND USE OF ENGLISH LANGUAGE ELEMENTS IN ALBANIAN

Summary

The article intends to propose some linguistic approaches and organizational ways in order to control the accept ion and adaptation of English loanwords in Albanian. Following the 1999 war in Kosova, many international governmental and non-governmental organizations came to Kosova to offer emergent aid to the needy population and to establish state organizations in this region.

Therefore English language had a great impact on every level of communication in every field of activity. Earlier English loanwords entered Albanian rarely and in a more systematic way, usually through some other country and language. Now they have entered Albanian in a direct and uncontrolled way.

Accordingly, some organized working groups of language experts are proposed to be established. Systematic research work on these loanwords is also anticipated, as loanwords coming in from a global language like English are a permanent event in a language of less prestige as the Albanian is. Their control and adaptation in Albanian should take place all the time.

Shkumbin MUNISHI, Prishtinë

NDIKIMI I ANGLISHTES NË TERMINOLOGJINË E LEGJISLACIONIT EKONOMIK

KDU 811.18'272
811.18'373.45

1. SFONDI TEORIK

Proceset integruese europiane që kanë marrë hov në këto dy-tri dekadat e fundit, por edhe globalizimi si dukuri e sotme e ndërlidhjes dhe e integrimit botëror në fusha të ndryshme, si në ekonomi, politikë, kulturë, shkencë, sport, art etj. kanë pasur ndikimin e vet edhe në dukuritë gjuhësore në botë. Kur kemi parasysh edhe përparimet në teknologjinë informative dhe rritjen e komunikimeve përmes internetit dhe teknologjisë digjitale në përgjithësi, atëherë është e kuptueshme që dinamizmi i jetës në rrafshin global është bërë përditshmëri dhe mënyrë e jetesës. Të gjithë këta faktorë po ndikojnë edhe në gjuhët që fliten sot në botë, duke i dinamizuar dukuritë gjuhësore përbrenda gjuhëve të ndryshme.

Në hapësirat e sotme gjuhësor, anglishtja tashmë është bërë gjuha kryesore në botë. Supremacia politike, ekonomike dhe kulturore e SHBA-së, por edhe e Britanisë së Madhe, ka bërë që anglishtja të imponohet si gjuhë e komunikimit masiv në nivel botëror, pra të bëhet një *lingua franca* botërore, ngjashëm me latinishten dikur. Por për dallim nga kjo e fundit, për shkak të mundësive të shumta reale e virtuale për komunikim global, shtrirja e anglishtes i tejkalon përmasat e shtrirjes që kishte latinishtja, apo çfarëdo gjuhë tjetër dikur. Sot anglishtja shërben si gjuhë kryesore për komunikim midis folësve që për gjuhë amtare kanë gjuhë të tjera në fusha të ndryshme komunikuese, sidomos në ato formale.

Aktualisht, anglishtja është gjuhë e globalizimit dhe e proceseve që ndërlidhen me të. Përhapja e mediave, e internetit dhe digjitalizimi e bëjnë anglishten në kuadrin e sotëm gjuhësor botëror, gjuhën kryesore në botë. Ajo është bërë gjuhë kryesor e komunikimit përmes internetit. Ndonëse kemi një rënie të përdorimit të anglishtes në internet në krahasim me gjuhët e tjera, ajo ende mbetet gjuha që zë hapësirën më të madhe në internet, jo

vetëm për nga sasia, por sidomos nga cilësia. Deri nga mesi i viteve ’90, më tepër se 80% e materialeve të publikuara në internet ishin në gjuhën angleze (Crystal, 2001; Block, 2004). Më vonë pati një rënie të përdorimit të anglishtes në internet 41% më 2001 dhe 35% më 2004. Konsiderojmë se rënia e përdorimit të anglishtes në internet në raport me gjuhët e tjera, ka të bëjë më tepër me mundësitë që interneti ofron për depërtimin e gjuhëve të tjera, por jo me zvogëlimin e ndikimit që ka anglishtja.

Më tej, anglishtja është gjuhë kryesore e marketingut dhe e reklamave, të cilat i kanë vërshuar jo vetëm hapësirat fizike nëpër vendbanime anekënd botës, por edhe hapësirat digjitale e virtuale. Anglishtja është bërë gjuhë e misioneve ndërkombëtare politike, ekonomike dhe paqeruajtëse nëpër botë (mision language) dhe, në të shumtën e rasteve, është edhe gjuha kryesore e samiteve politike, e simpoziumeve dhe seminareve ndërkombëtare, të cilat organizohen gjithandej nëpër botë.

Kjo shtrirje e anglishtes ka bërë që sot të flitet për anglishten si gjuhë globale (Global English), që lind nga nevoja për të pasur një gjuhë për komunikim botëror. Sipas shpjegimit të David Crystal-it, “Global English” nënkupton përdorimin e anglishtes si gjuhë botërore, por njëkohësisht edhe përdorimin e saj nga folësit burimorë, të cilët i përdorin varietete e ndryshme të kësaj gjuhe. David Crystal thekson se një gjuhë arrin status me të vërtetë global, kur zhvillon një rol të posaçëm që njihet në secilin vend. Sot anglishtja ka status të posaçëm administrativ në më shumë se 70 vende, si: Gana, Nigeria, India, Singapori, Vanutu (Crystal, 1997).

Një prej vendeve ku anglishtja ka pasur status juridik dhe administrativ është edhe Kosova, ku sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe rregulloreve të UNMIK-ut para shpalljes së pavarësisë, anglishtja ka pasur status zyrtar si shqipja dhe serbishtja (Ismajli, 2003; Munishi 2006). Një status ekstraterritorial anglishtja e ka edhe sot në Kosovë për shkak të pranisë së misionit të EULEX-it dhe raporteve të tjera ndërkombëtare në të cilat është e përfshirë Kosova.

Në këtë kuadër, kur po flasim për shtrirjen e anglishtes, Crystal-i është i mendimit se anglishtja është zgjeruar e përhapur aq shumë, sa që është bërë e pavarur nga kontrolli shoqëror. Ky përfundim mbase edhe mund të vihet në dyshim, sepse dukuritë gjuhësore janë gjithmonë brenda

një kontrolli shoqëror, por realisht depërtimi i anglishtes nëpër botë i ka tejkaluar të gjitha parashikimet që ndokush mund t'i ketë pasur para dy dekadave. Ajo ka fituar emërtime e epitete të tilla si, "globish", "panglish "etj.

Ekspansionizmi i anglishtes ka prekur pothuajse të gjitha fushat e jetës në Europë dhe në botë. Në mjediset evropiane ajo ka vënë nën trysni edhe gjuhën frënge, e cila dikur ishte ndër gjuhët më të përhapura në botë. Dikur frëngjishtja ishte gjuhë e kulturës, e ekonomisë, e diplomacisë dhe e politikës në përmasa botërore dhe, madje, ishte gjuhë e oborrit mbretëror anglez. Por sot edhe frëngjishtja mbetet prapa anglishtes. Nën të njëjtën trysni janë edhe gjuhët e tjera të Evropës që kanë folës të shumtë dhe që kanë një prestigj të konsiderueshëm, siç janë gjermanishtja, italishtja, spanjishtja e portugalishtja. Anglishtja sot është duke ndikuar në çdo aspekt të jetës së njerëzve jo vetëm në Europë, por edhe në botë.

Dukuria e globalizimit ka krijuar terren të përshtatshëm për përhapjen e anglishtes në aktivitetet ekonomike europiane. Sot, në Europë, njohja e anglishtes paraqet një përparësi për punësim. Organizatat ndërkombëtare dhe europiane, si p.sh. Asociacioni Europian për Markat, Asociacioni Europian i Distributorëve Kimikë, Asociacioni Europian i Aviacionit të Biznesit dhe Federata Bankare Europiane etj. duke kërkuar nga të punësuarit e tyre të njohin anglishten, në fakt i diskriminojnë folësit e gjuhëve të tjera në favor të folësve burimorë të anglishtes. Në Finlandë anglishtja është duke e zëvendësuar finlandishten si gjuhë e ekonomisë dhe e financave, duke i detyruar përfaqësuesit e korporatave industriale të këtij vendi që ta flasin gjuhën e investitorëve të Nju-Jorkut dhe Londrës. Në Europën e sotme mund të gjesh konkurse për vende pune, në të cilat flitet vetëm anglishtja. Në të gjitha vendet e Europës mësimi i gjuhës angleze pothuajse është bërë i detyrueshëm dhe shihet si një përparësi për karrierën e individit.

Një ndikim të fuqishëm anglishtja është duke e ushtruar në terminologjitë e fushave të caktuara, siç janë ekonomia, politikat publike dhe ligjet. Terminologjia e saj ose po depërton në formë të huazimeve të thjeshta të drejtpërdrejta, ose përmes përkthimeve kalke terminologjike në terminologjitë e shumë gjuhëve të botës. Pa ndonjë përjashtim, kjo dukuri është duke ndodhur edhe në gjuhët e Ballkanit, madje edhe në ato gjuhë të cilat konsiderohen se janë gjuhët që u rezistojnë huazimeve. Në një punim të saj li-

dhur me ndikimin e anglishtes në dy gjuhët sllavojugore, siç janë kroatishtja dhe serbishtja, Nadežda Silaški konstaton se në terminologjinë ekonomike anglicizmat gjenden në të dy këto gjuhë, por janë më të pranishme në kroatishte, sesa në serbishte, e cila është gjuhë që konsiderohet se huazon më tepër se kroatishtja (Silaški, 2009). Kjo dukuri nuk është përjashtuese as për gjuhët e tjera të Ballkanit.

2. NDIKIMI I SOTËM I ANGLISHTES NË SHQIPE

Ndikimi i anglishtes si gjuhë globale sot është i pranishëm në tërë strukturën e shqipes, si dhe në pothuaj të gjitha domenet e stilet e përdorimit të shqipes. Ky ndikim në shqipe shfaqet kryesisht si ndikim kulturor e ideologjik, duke qenë se anglishtja sot është gjuhë e proceseve të globalizimit dhe gjuhë që ka përdorimin më të dendur në teknologjinë e informacionit. Anglicizmat, të përkufizuara si huazime nga anglishtja në gjuhë të tjera, sot hasen dendur në gjuhën shqipe. Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe varet nga konteksti sociokulturor e politik shqiptar dhe në bazë të këtij konteksti ndryshon edhe forma e përmbajtja e këtij ndikimi. Në fakt, për ta kuptuar sa më mirë këtë ndikim, fillimisht duhet të diskutohen pikërisht këto kontekste dhe si i diktojnë ato ndikimet e anglishtes.

Në Kosovë anglishtja ka ndikuar në disa forma dhe ka hyrë nëpër disa rrugë të ndryshme. Pas vitit 1999, ajo ka ardhur si gjuhë e misionit (mission language) bashkë me misionet ndërkombëtare, të cilat qenë vendosur në Kosovë pas përfundimit të luftës, si dhe përmes programeve e projekteve të ndryshme të asistencës teknike, të cilat kishin qëllim të ndihmojnë në ngritjen dhe zhvillimin e burimeve njerëzore të institucioneve qeveritare. Misionet ndërkombëtare dhe personeli ndërkombëtar që ka punuar në këto misione, deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 2008, kanë ndikuar drejtpërdrejt në formimin e institucioneve shtetërore e publike. Pjesëtarët e këtyre misioneve si gjuhë misioni kanë përdorur anglishten si *lingua franca*, qoftë për komunikim përbrenda misioneve, qoftë për komunikim me personelin shqiptar, i cili punonte si personel vendor i këtyre misioneve. Kontakti i përditshëm midis ndërkombëtarëve që flasin anglisht dhe shqipfolësve vendës realizohej edhe në institucionet e dikur-

shme të përbashkëta, të ashtuquajtura Institucione të Përkohshme të Vetëqeverisjes, por edhe më vonë pas shpalljes së pavarësisë, në kuadër të Qeverisë së Kosovës. Kështu, vatra e kontaktit midis shqipes dhe anglishtes nuk kufizohej në formë të ndikimit kulturor të anglishtes, por zgjerohej edhe si ndikim intim i drejtpërdrejtë, si pjesë e ndërkomunikimit të përditshëm midis pjesëtarëve ndërkombëtarë e vendorë të këtyre misioneve. Folësit e shqipes, të angazhuar nëpër program e projekte të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë në veprimtaritë e tyre janë bilingë të plotë, sidomos në domenin e punësimit, pasi që kanë kontakt të përditshëm me folës të anglishtes me të cilët komunikojnë vazhdimisht. Në rrethana të tilla është e natyrshme që ndikimi i anglishtes ka qenë dhe vazhdon të jetë jashtëzakonisht i fuqishëm dhe intensiv. Ndikimi i anglishtes bëhet edhe përmes dokumenteve të shkruara, përmes të cilave përgatiten politikat publike e legjislacionet, edhe në të folur nëpërmjet komunikimit të përditshëm formal e joformal. Këtu duhet pasur parasysh edhe një element tjetër që ka të bëjë me statusin juridik të anglishtes në Kosovë. Përveç statusit ekstraterritorial që ka anglishtja si *lingua franca* gjithandej nëpër botë, në Kosovë, para shpalljes së pavarësisë, në periudhën kur Kosova qeverisej nga Misioni i Kombeve të Bashkuara (UNMIK), anglishtja kishte edhe status ligjor të gjuhës zyrtare, madje të gjuhës kryesore zyrtare, krahas shqipes e serbishtes (Munishi, 2006 dhe 2010).

Në Shqipëri situata paraqitet më ndryshe, për shkak të rrethanave të tjera politike e sociokulturore. Atje ndikimi i misioneve e projekteve ndërkombëtare në institucionet shtetëror e publike është më i kufizuar, sepse shtetit shqiptar funksionon si shtet i pavarur që nga 1912. Misionet e institucioneve perëndimore në Shqipëri më shumë janë të përqendruara për të zhvilluar projekte e programe të ndihmës teknike (technical assistance), të cilat kanë për qëllim që t'u ndihmojnë institucioneve të Shqipërisë t'i hartojnë dhe zhvillojnë politikat publike, si dhe të ndihmojnë për t'i zhvilluar aftësitë profesionale (capacity building) të punonjësve të institucioneve. Përbrenda institucioneve të shtetit shqiptar gjuha shqipe është dominuese. Por edhe aty, në kuadër të projekteve të ndryshme, në të cilat punojnë punonjës ndërkombëtarë e vendorë, krijohen vatra të kontaktit të përditshëm midis folësve të anglishtes dhe folësve të shqipes. Forma kryesore e ndikimit të anglishtes në shqipen institucionale vjen përmes dokumenteve të

ndryshme të shkruara, mbi bazën e të cilave hartohen dhe zhvillohen politikat publike qeveritare. Këto dokumente, bashkë me terminologjinë kryesore të tyre, fillimisht krijohen në gjuhën angleze dhe pastaj përkthehen e adaptohen në gjuhën shqipe, për t'u bërë pastaj përvetësimi dhe zbatimi i përmbajtjes së këtyre dokumenteve në praktikë. Edhe në Shqipëri, në rrethanat të cilat i përshkruam këtu, ndikimi i anglishtes është mjaft i fuqishëm, në domene e stile funksionale të ndryshme.

Format e tjera të ndikimit të anglishtes, të cilat po ashtu janë shumë të pranishme dhe me ndikim të fuqishëm, janë ndikimet përmes medieve audiovizuale e të shtypura dhe përmes internetit. Këto forma sot luajnë rolin kryesor të përhapjes së anglishtes nëpër botë. Mediet dhe interneti, përveç bartjes së elementeve gjuhësore të anglishtes, ndikojnë njëkohësisht edhe në depërtimin dhe përhapjen e këtyre ndikimeve, si dhe në pranimin e tyre. Në fakt, ndonëse fushat e ndikimit të anglishtes janë më të gjera, mediet dhe interneti paraqesin njërin prej mjeteve kryesore të përhapjes së ndikimit të anglishtes.

3. NDIKIMI I ANGLICIZMAVE NË LEGJISLACIONIN EKONOMIK

Në vazhdim të këtij punimi do të përqendrohemi në ndikimin që ka ushtruar anglishtja në terminologjinë e legjislacionit në fushën e ekonomisë dhe financave. Për ta hulumtuar ndikimin e anglishtes në terminologjinë ekonomike kemi marrë si korpus për hulumtim tri ligje kryesore, të cilat i rregullojnë veprimtaritë financiare dhe buxhetore, si dhe menaxhimin e parave publike në Kosovë dhe në Shqipëri. Në Kosovë kemi përzgjedhur Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-116 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 2008 dhe më 2012. Në Shqipëri kemi përzgjedhur Ligjin Nr. 10296, datë 8.7.2010, për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë. Të tri këto ligje janë ligje themelore, të ashtuquajtura ligje organike (edhe ky term i marrë nga anglishtja, organic law), të cilat i rregullojnë çështjet e menaxhimit financiar të parave publike nga institucionet publike (ministritë, agjencitë, ndërmarrjet publike etj.), rregullojnë

procesin e përgatitjes dhe miratimit të buxhetit të shtetit, por edhe i përcaktojnë përgjegjësitë e zyrtarëve kryesorë, të cilët janë përgjegjës për çështje financiare e buxhetore në kuadër të institucioneve qeveritare e publike në Shqipëri dhe në Kosovë. Përderisa në Kosovë këto çështje janë të sanksionuara në një ligj të vetëm, në Shqipëri këto çështje janë ndarë në dy ligje të veçanta, njëri ligj rregullon sistemin buxhetor dhe ligji tjetër rregullon çështjet e menaxhimit financiar publik dhe përgjegjësitë e zyrtarëve për çështje financiare.

Sa i përket ndikimit të anglishtes në këto tri ligje, një analizë sado sipërfaqësore hedh në dritë shumë qartë ndikimin e jashtëzakonshëm që ka pasur anglishtja në to. Ky ndikim pasqyrohet jo vetëm nëpërmjet fjalëve të huazuara, por në masë të konsiderueshme edhe nëpërmjet togfjalëshave kalke që kanë hyrë në gjuhën e këtyre ligjeve si emërtime të përbëra, të cilat shprehin koncepte specifike që kanë të bëjnë me financat dhe buxhetin. Në të vërtetë, forma kryesore e ndikimit, e cila vërehet sheshazi, pasqyrohet nëpërmjet këtyre togfjalëshave kalke, të cilët për nga struktura dhe funksioni janë togfjalësha emërorë dhe hyjnë si njësi të gatshme (konstituentë) dhe pastaj përkthehen në shqipe (loan translation). Sa i përket burimit dhe rrugës që kanë ndjekur këto anglicizma financiare e buxhetore për t'u futur në këto tri ligje, këto dy aspekte janë të ndërlidhura me rrethana jashtëgjuhësore. Ligji i për Menaxhimin e Financave Publike që është në fuqi në Kosovë është hartuar fund e krye nga ekspertë ndërkombëtarë të çështjeve ekonomike, financiare e ligjore në gjuhën angleze dhe pastaj është përkthyer në gjuhën shqipe. Vetëm emërtimi i këtij ligji është dëshmi e qartë se ligji është hartuar së pari në anglishte dhe pastaj është përkthyer (është përkthyer keq) në gjuhën shqipe. Emërtimi i tij në anglishte është *Law on Public Financial Management and Accountability* (përkthimi adekuat do të ishte *Ligji për Menaxhimin Financiar Publik dhe Përgjegjshmëritë*). Edhe te ligjet e Shqipërisë vërehet fuqishëm ndikimi i anglishtes, i cili, siç u tha pak më parë, shprehet jo vetëm me fjalë të huazuara, por shprehet sidomos me togfjalësha kalke. Edhe te ligjet e Shqipërisë, qysh në emërtimet e ligjeve vërehet ndikimi i anglishtes. Njëri ligj është për '*menaxhimin financiar*' (*finacial management*, është përkthyer më mirë), ndërkaq tjetri ligj është për '*menaxhimin e sistemit buxhetor*' (ang. *budget sistem management*).

Edhe në vazhdim të këtyre tri ligjeve vërehen qartë ndikimet e fuqishme të anglishtes, duke filluar nga përkufizimet e termave dhe koncepteve. Pjesa më e madhe e përkufizimeve edhe në ligjin e Kosovës, edhe në ligjet e Shqipërisë, janë të sajuara drejtpërdrejt nën ndikimin e anglishtes dhe në fakt janë kalke.

Në vazhdim po jap disa shembuj të fjalëve dhe togfjalëshave që vijnë si ndikim i drejtpërdrejtë nga anglishtja, ashtu siç janë përkthyer e përshtatur në tekstet në gjuhën shqipe të tri ligjeve.

Fjalë të thjeshta: *asete (assets), auditim, autoritet, afatgjatë, afatmesëm, afatshkurtër, alokim, bonde, bord, buxhetim, departament, deficit, depozitim, detyrim, dividendë, donacion, ekspertizë, ekzekutim, faturë, fizibilitet, fond, format, grant, inkorporim, inpute, instrument, inspektim, investigim, investim, kapitalizim, kompensim, kontabilitet, kontroll, kostim, kosto, likuiditet, manual, mashtrim (fraud), maturim, mbikëqyrje, menaxhim, mjete, ndërmarrje, note, pasuri (edhe asete, mjete) përditësim, politikë, portofol, prioritet, produkte, projekt, prokurim, qarkore, raportim, reduktim, regjistër, rentë, riblerje, risk, rishikim, shpenzime/të dala, status, strategji, subvencion, suficit, supozim, synim, taksë, tarifë, tavan, të ardhura/ të hyra, tender, tenderim, trajnim, transaksion, transferim, transparencë, trust, zotim, thesar, udhëzime, zotim* etj.

Togfjalësha: *auditim i jashtëm, auditim i brendshëm, auditim i përgjithshëm, auditim i pavarur, auditor i brendshëm, auditor i jashtëm, auditor i përgjithshëm, agjenci e pavarur, agjenci ekzekutive, analizë e riskut, autonomi substanciale, autoritet publik (në Shqipëri edhe autoritet përgjegjës), autorizim për investime (të parave publike), buxheti i konsoliduar i Kosovës, deficit i përgjithshëm (buxhetor), deklaratë e aseteve (avanceve, faturave, e konsoliduar, e misionit, e paaudituar, financiare), departament i thesarit (buxhetit, buxhetit komunal), detyrim kontingjent, diagram i llogarive (chart of accounts), drejtor i përgjithshëm (i buxhetit, i thesarit), ekzekutim i kërkesave (detyrimeve), fizibilitet (financiar, i projektit, studim fizibiliteti), fond i konsoliduar, fond i alokuar, fond i obliguar, fond i zotuar (në Shqipëri kemi fond i detajuar, i miratuar, i rishpërndarë, shpërndarë, fond kontigjence, fond rezervë, fond special, fonde të transferuara, grant i përgjithshëm, i emëruar i lartë publik, instrument financiar, inspektim fi-*

nanciar, kategori ekonomike, kategori funksionale, kërkesë për ndarje buxhetore, kërkesë për pagim, komision për buxhet (i granteve, këshillëdhënës), kompetencë komunale, kontratë e ortakërisë publiko-private, kornizë afatmesme e shpenzimeve (në Shqipëri program buxhetor afatmesëm që përkon me konceptin mid-term budget framework), kuadër rregullator, letra me vlerë/bono thesari (treasury bonds), ligj mbi ndarjet buxhetore, ligj për financat e pushtetit lokal, legjislacion buxhetor, llogari e mirebesimit, llogari e vetme e thesarit, mallra dhe shërbime, matricë e rrezikut, menaxher i investimeve, marrëdhënie financiare ndërqeveritare, menaxhim financiar, ndarje buxhetore, ndërmarrje publike, njësia qendrore harmonizuese, normë interesi, organizatë buxhetore, paga dhe mëditje, parashikim ekonomik (buxhetor), paratë publike, pasqyra financiare, pasuri operative, publike (në Shqipëri burime publike), përgatitje e buxhetit, dorëzim i buxhetit, hartim i buxhetit, propozim-buxheti (edhe draft buxheti), përgjegjësi buxhetore, përgjegjshmëri menaxheriale, plane strategjike, politika ekonomike, politika publike, politika monetare, praktika më të mira financiare, proces buxhetor (i buxhetimit), program buxhetor, projekt, qëllim i politikës buxhetore, qeverisje e përgjithshme, qeverisje qendrore e vendore; në Kosovë kemi qeverisje qendrore dhe komunale), kapital, qarkore buxhetore, raport tremujor (në Shqipëri raport periodik), raport vjetor, reduktim i fondeve, regjistër kontabël, marrëveshje e riblerjes, rishikim teknik, rishikim gjashtëmujor i buxhetit, rregullim i ndarjeve buxhetore, sekretar i përgjithshëm, sektor publik, sistem i kontabilitetit, sistem i kompjuterizuar i thesarit (në Kosovë kemi sistem informativ i menaxhimit financiar), sistem i menaxhimit të informacionit, shërbyes civil, stabilitet makroekonomik, strategji e menaxhimit të riskut, (në Shqipëri nëpunës civil), shpenzim faktik, shpenzime (buxhetore, kapitale, operative, rrjedhëse apo në Shqipëri korrente, të paparashikuara, shpenzim i parave publike (në Shqipëri burime publike), sigurim i borxhit, sistem për klasifikim buxhetor, sistem i raportimit, statistika financiare qeveritare, strategji e investimeve, supozim ekonomik (buxhetor), supozime kyçe ekonomike, tavan i shpenzimeve (të ardhurave/ të hyrave), të ardhura të dedikuara (të jashtëzakonshme), transaksion financiar, të ardhura vetanake komunale (own source revenues), vit fiskal, veprimtari programore buxhetore, zyrtar certifikues, zyrtar financiar, zyrtar i prokurimit, zyrtar kryesor administrativ, zyrtar

kryesor financiar, zyrtar publik (në Shqipri nëpunës publik, civil, i autorizuar, zbatues), objektiv strategjik, urdhër për pagesë përfundimtare (final payment order), zbatim i planeve strategjike, zhvillim i qëndrueshëm (ekonomik, social) etj.

Të gjithë shembujt që u paraqitën këtu janë ndikim i drejtpërdrejtë i anglishtes, më konkretisht rezultat i përkthimeve nga anglishtja.

Një analizë e thjeshtë e këtyre shembujve nxjerr në shesh disa dukuri interesante lidhur me strukturën, funksionin dhe kuptimin e këtyre njësive të analizuara. Së pari, shumica e këtyre huazimeve, qoftë fjalët e thjeshta, qoftë togfjalëshat, janë përkthyer dhe përshtatur në shqipe. Përkthimi dhe përshtatja është më e theksuar në ligjet e Shqipërisë, ndërkaq në ligjin e Kosovës vërehet përkthimi fjalë për fjalë, me ç'rast vërehen mangësi strukturore. Huazimet në formë të fjalëve të thjeshta që kanë hyrë sipas modelit origjinal të anglishtes, në përgjithësi janë të përshtatura me grafinë dhe shqiptimin në shqipe p.sh.: *aset, alokim, auditim, bond, departament, donacion, grant, note, input, fizibilitet, donacion, dividendë, kapitalizim, kosto, likuiditet, maturim, manual, menaxhim, politikë, portofol, prioritet, produkte, prokurim, qarkore, raportim, reduktim, rentë, riblerje, risk, rishikim, shpenzime/të dala, status, strategji, subvencion, suficit, supozim, synim, taksë, tarifë, tavan, të ardhura/të hyra, tender, tenderim, trajnim, transaksion, transferim, transparencë, trust, zotim, thesar* etj. Edhe te togfjalëshat e huazuar kemi përkthim dhe përshtatje të tyre me fjalë të shqipes, por të cilat janë drejtpërdrejt reflektim i koncepteve dhe kuptimeve që kanë në gjuhën burimore. Një pjesë shumë e madhe e fjalëve të shqipes me të cilat janë përkthyer format respektive të anglishtes janë fjalë që kanë ekzistuar edhe më parë në shqipe, por që me rastin e përkthimit, qoftë te fjalët e thjeshta, qoftë te togfjalëshat emërorë, kanë zgjeruar kuptimin e tyre semantik, duke reflektuar kuptimet që këto fjalë i shprehin në anglishte. Në disa raste, një pjesë e fjalëve të huazuara nga anglishtja i kanë zëvendësuar fjalët e dikurshme që kanë ekzistuar në shqipe si huazime nga gjuhët e tjera. P.sh. fjala *auditim* ka zëvendësuar fjalën *revizor*, *rishikim i buxhetit* e ka zëvendësuar togfjalëshin që ka ekzistuar më parë *rebalanc i buxhetit*, fjala *asete* ka zëvendësuar në masë të madhe fjalën *mjete* etj.

Më tej, te një pjesë e përkthimeve të këtyre huazimeve vërehet një

paqëndrueshmëri strukturore e kuptimore në format e shqipes dhe kjo pasqyrohet nëpërmjet ekzistencës së dy termave të përkthyer. P.sh. në anglishte dallohen semantikisht format *revenues* and *incomes*, ndërkaq në shqipe kemi *të hyra dhe të ardhura* që shpesh përdoren si sinonime. Pastaj, në anglishte kemi *wages and salaries* që shprehin koncepte të dallueshme në anglishte, ndërkaq në shqipe janë përkthyer si *paga e mëditje*, por që në shqipe mëditje është edhe për *allowances* (p.sh. travel allowances, shq. mëditje udhëtimi). Kjo paqëndrueshmëri terminologjike vërehet edhe te format që shfaqen në ligjet e Kosovës dhe të Shqipërisë. Ndonëse një pjesë e madhe e togfjalëshave emërorë dalin me formë të njëjtë, një pjesë e tyre që në Kosovë dallohen nga forma, por jo edhe nga kuptimi, me format reciproke që përdoren në Shqipëri. P.sh. ang. *civil/public servant* në ligjin e Kosovës është përkthyer *shërbyes civil/shërbyes publik*, në Shqipëri është përdorur termi që ka qenë më parë i ngulitur *nëpunës civil/publik, pastaj edhe* në të gjithë togfjalëshat që në strukturën e tyre e kanë si element përbërës fjalën *nëpunës* (*nëpunës i autorizuar, nëpunës zbatues* etj.). Në përgjithësi, mund të konstatojmë se terminologjia e legjislacionit ekonomik, duke qenë e ndikuar fuqishëm në aspektin semantik nga anglishtja, nuk ka arritur të konsolidohet ende në shqipe.

Njësitë gjuhësore të huazuara, të cilat i përmendëm më lart, pasi që hyjnë në shqipe, vazhdojnë jetën e tyre si çdo huazim i zakonshëm. Ato i nënshtrohen përshtatjes fonetike e morfo-sintaksore, përdoruesit familjarizohen me to dhe gjejnë përdorim në ligjërimin e përditshëm. Përkundër mosngulitjes së plotë në shqipe dhe luhatjes së formave, këto njësi të cilat i përmendëm më lart, duke u futur nëpërmjet legjislacionit ekonomik dhe financiar dhe duke u përdorur në të folurit e punonjësve të institucioneve dhe organizatave qeveritare e publike, të cilët janë përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e politikave publike, për menaxhim financiar e buxhetor, bëhen shënjues të regjistrit profesional të këtyre punonjësve. Gjithashtu, këto njësi të huazuara gradualisht ndikojnë në ndërtimin e tipareve të diskursit publik, që ka të bëjë me çështjet ekonomike, financiare e të politikave publike.

Sa i përket rrugës që kanë ndjekur për t'u futur në shqipe, kjo çështje duhet parë në rrafshin historik dhe ideologjik, si pjesë e ndryshimeve shoqërore-politike e ekonomike, të cilat kanë ndodhur në trevat shqiptare

këtu e më tepër se dy dekada më parë. Ndryshimet politike e ideologjike që kanë ndodhur pas rënies së "perdes së hekurt "dhe pas zhdukjes së blloqeve ideologjike rivale, kanë pasur si rrjedhojë përhapjen dhe dominimin e ideologjisë liberale e neoliberale nga bota perëndimore drejt vendeve që dikur i kanë takuar bllokut komunist. Këto ndryshime ideologjike janë shoqëruar edhe me ndryshimin e koncepteve të politikave ekonomike e financiare dhe me ndryshimin e sistemeve përkatëse. Nga sistemet e politikat ekonomike e financiare të centralizuara e të bazuara në ekonomi të planifikuar, sipas cikleve pesëvjeçare, në të cilat prona private ishte e kufizuar, vendet e ish-bllokut komunist, filluan reformat ekonomike, të cilat synonin kalimin nga një ekonomi e tillë drejt një ekonomie të tregut të lirë dhe të hapur, në të cilën bartës të zhvillimit janë bizneset private. Më tej, në këto dy dekadat e fundit, bota perëndimore është duke bërë përpjekje që nëpërmjet promovimit të standardeve ndërkombëtare t'i standardizojë format e menaxhimit financiar, të procesit buxhetor e të auditimit, duke e nxitur në këtë mënyrë transparencën afariste të ndërmarrjeve publike e private dhe institucioneve qeveritare, me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe parandalimit të dukurive negative financiare ekonomike, siç janë evazioni fiskal, mashtrimet e korrupsioni. Për t'i çuar përpara këto përpjekje dhe për t'i promovuar këto koncepte politike-ekonomike, janë ndërtuar njësitë përkatëse gjuhësore, të cilat i shprehin këto koncepte dhe të cilat e ndërtojnë diskursin ekonomik dhe financiar, si dhe regjistrat përkatës. Pra, ndryshimi ideologjik dhe i politikave ekonomike, shoqëroret me ndryshimin e diskursit publik dhe regjistrave. Pastaj, këto ndryshime dhe diskursi i ri, bashkë me njësitë gjuhësore që e ndërtojnë atë, përhapen nëpërmjet instrumenteve të globalizimit, siç janë institucionet financiare ndërkombëtare (Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Organizata Botërore e Tregtisë dhe bankat ndërkombëtare) dhe nga mediet globale dhe pastaj imponohen në rrafshin ndërkombëtare si vlera politike e civilizuese. Procesi rrjedh tutje dhe vendet në tranzicion detyrohen t'i përvetësojnë këto ndryshime, si pjesë e reformave politike, ekonomike e shoqërore, të cilat synojnë që ekonomitë e këtyre vendeve t'i përshtatin me ekonomitë e vendeve të zhvilluara. Reformat bëhen të domosdoshme edhe si pjesë e përpjekjeve të këtyre vendeve për t'u integruar në organizata ndërkombëtare e kontinentale. Si rrjedhojë e këtij procesi, bashkë me reformat imponohet edhe

diskursi dhe njësitë e tij gjuhësore. Një gjë e tillë ka ndodhur edhe me ndikimin e anglishtes në terminologjinë e politikave publike, ekonomike e financiare në gjuhën shqipe. Ndikimet e anglishtes në shqipe, sidomos në fushat të cilat po i diskutojmë këtu, kanë ardhur bashkë me diskursin ideologjik liberal e neoliberal, për t'i shprehur kuptimet e konceptet, të cilat janë krijuar në rrethana historike, kulturore e politike specifike, të cilat janë zhvilluar në botën perëndimore.

PËRFUNDIME

Ndikimi i anglishtes në terminologjinë e legjislacionit ekonomik, buxhetor e financiar në Kosovë dhe në Shqipëri është mjaft i fuqishëm. Ky ndikim manifestohet nëpërmjet huazimeve të anglicizmave profesionale ekonomike, të cilat për nga forma mund të ndahen në dy grupe: në fjalë të thjeshta dhe në togfjalësha emërorë. Këto huazime, në radhë të parë, kanë hyrë nëpërmjet përkthimit, apo përshtatjes së legjislacioneve ekonomike dhe zbatimit të tyre në institucionet e ndërmarrjet e ndryshme në Shqipëri dhe në Kosovë. Pjesa më e madhe e huazimeve që kanë hyrë në legjislacionin ekonomik dhe financiar, ose janë përshtatur në gjuhën shqipe, ose janë përkthime kalke. Përkundër këtij vërshimi, ngulitja e tyre nuk është ende krejtësisht e qëndrueshme, vazhdon përshtatja e tyre dhe ka luhatje në përdorimin e tyre.

Ndikimi i anglishtes dhe anglicizmat që kanë hyrë në shqipe vijnë bashkë me tiparet e diskursit ideologjik liberal e neoliberal, i cili është krijuar në ambientin politik dhe ekonomik-kulturor perëndimor, nëpërmjet instrumenteve të globalizimit, siç janë institucionet financiare ndërkombëtare dhe mediet globale, si pjesë e shtrirjes së dukurisë së globalizimit. Kjo dukuri nuk është karakteristikë e izoluar në gjuhën shqipe, por haset edhe në shumë të tjera të botës.

Referencat

Block, David. (2004). Globalization, Transitional Communication and the Internet, International Journal on Multicultural Societies (IJMS), Vol.6, No.1.

Crystal, David. (1997). The language that took over the World, The Guardian, 22 February, 1997, 21, në Internet: http://www.davidcrystal.com/DC_articles/English39.pdf, qasja për herë të fundit më 21.08.2008.

Crystal, David. (2001). Languages on the Internet, Lingua Franca, March 2001, ABC, në Internet: http://www.davidcrystal.com/DC_articles/Internet11.pdf, qasja për herë të fundit më 23.08.2008.

English will turn into Panglish in 100 years, Telegraph.co.uk, në Internet: http://www.telegraph.co.uk/news/uknews/1582954/English-will-turn-into-Panglish-in-100-years.html), qasja për herë të fundit 21.08.2008.

Fairclough, Norman. (2006), Language and Globalization, Routledge, Taylor & Francis Group, London and New York.

Giddens, Anthony. (2004). Sociologjia, Çabej, Tiranë.

Hjarvard, Stig. (2004). The Globalization of Language – How the Media Contribute to the Spread of English and the Emergence of the Medialects, in Nordicom Review, no. 1-2, pp. 75-97, Nordicom: Gothenburg University. Also available online at: http://www.nordicom.gu.se/common/publ_pdf/157_075-098.pdf

Ismajli, Rexhep. (2003), Standarde dhe identitete, Dukagjini, Pejë.

Kostallari, Androkli. (1984) Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë, në Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë (Materiale të Konferencës shkencore të mbajtur në Tiranë më 7-8 dhjetor 1984), Tiranë, 1988.

Paçarizi, Rrahman. (2006) Gjuha e mesenxherit, Filologji, 14, Prishtinë.

Munishi, Shkumbin. (2006), Probleme të shqipes standarde në Kosovë, ZeroPrint, Prishtinë, 2013.

Munishi, Shkumbin. (2008), Globalizimi, komunikimi gjuhësor dhe gjuha shqipe, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 27/1, Prishtinë, 2008, f. 321-341; shih edhe në Internet: http://www.linguasocio.blogspot.com/

Munishi, Shkumbin (2009), Barazia e gjuhëve në Kosovë dhe perspektiva evropiane, 1 Uluslararasi Balkanlarda Tarih ve Kültür Kongresi, Bildirler Kitabi, (Kongresi I Ndërkombëtar Ballkanik), 10-16 Mayis, 2009, Kosova, Priştine. (shih edhe në Internet: http://www.linguasocio.blogspot.com/)

Munishi, Shkumbin. (2010), Planifikimi i statusit të gjuhëve në Kosovë, Pozita e sotme e gjuhës shqipe në Mal të Zi në krahasim me atë në përgjithësi (sesion shkencor i organizuar më 19.12.2010 në Ulqin – Mali i Zi), Art Club, Ulqin, Mali i Zi, 2010. (shih edhe në Internet: http://www.linguasocio.blogspot.com/)

Silaški, Nadežda. (2009), Economic Terminlogy in Serbian and Croatian – A Comparative Analysis of Anglicisms, FACTA UNIVERSITATIS, Series: Linguistics and Literature Vol. 7, No 1, 2009, pp. 75 – 86, në Internet: http://facta.junis.ni.ac.rs/lal/lal2009/lal2009-06.pdf qasja e fundit më 17.10. 2013.

Albana DEDA (NDOJA), Tiranë

IDENTIFIKIMI STRUKTUROR I HYRJEVE TË REJA DHE LEHTËSITË KODIFIKUESE TË TIJ

KDU 811.18'373.45
811.18'271

Problematika e hyrjeve nga gjuhët e tjera është e njohur dhe njëkohësisht e lashtë. Studimet tona në rrafsh historik janë munduar të argumentojnë shtresëzimet e periudhave të ndryshme, nga kode të ndryshme.

Dihet se një ndër faktorët kryesorë të këtyre hyrjeve kanë qenë kontaktet direkte me këto gjuhë. Natyrisht ky proces lidhet me historikun e pushtimeve të gjata e të ndryshme të trojeve tona.

Nga ana tjetër kufijtë gjeografikë kanë kushtëzuar dhe kalime të ndërsjella në kodet përkatëse.

"Pushtuesi" i kohëve moderne nuk karakterizohet nga asnjëri nga faktorët e lartpërmendur (të paktën jo në masë aq të madhe). Ai shfaqet në forma specifikisht të ndryshme nga trajtat dhe burimet klasike.

Sipas nesh tre janë faktorët që kanë ndihmuar dhe kushtëzuar këto lloj dyndjesh në mënyrë të veçantë të anglicizmave.

1. Zhvillimi i jashtëzakonshëm i medias dhe infrastrukturës së saj.

2. Zhvillimi i jashtëzakonshëm i internetit dhe zhdukja pothuajse e çdo barriere hapësinore dhe kohore nga ana e këtij të fundit.

3. Fluksi i pakodifikuar i konteksteve situative, që lidhen me perspektiva specifike, si të zhvillimit shkencor, ashtu dhe të kontesteve situative specifike të fushave të caktuara profesionale (E kemi fjalën për stilin shkencor dhe tekstet përkatëse të fushave të ndryshme, si dhe perspektiva profesionale të tilla si kuzhina, parukeria dhe estetika etj.).

Mendojmë se janë arsyet e mësipërme që kanë lehtësuar kontaktet mes gjuhëve të ndryshme, të cilat nuk kanë qenë në kontakt direkt. Për këtë arsye dhe ndikimi e deri dhe ngulitja e tyre bëhet shumë më shpejt se më përpara.

Natyrisht që jo të gjitha gjuhët natyrale kanë të njëjtin ndikim në

korpusin tonë gjuhësor (shumë pak prej tyre madje).

Prestigji i një kodi, si një faktor sociolinguistik mjaft i rëndësishëm, bën të mundur që të seleksionohen dhe kodet më tërheqëse. Natyrisht prestigji gjuhësor lidhet pazgjidhshmërisht me prestigjin politik, ekonomik dhe kulturor. Pikërisht për këto arsye dhe anglicizmat janë më të favorizuara në këtë proces.

Janë bërë mjaft studime dhe për zhvillimet e sotme të këtyre hyrjeve, por me sa kemi parë përgjithësisht problemi është lidhur sidomos me hyrjet në rrafsh leksikor,përshkrime të ndryshimeve fonetike dhe morfologjike të tyre. (Sot vazhdon të jetë e zakonshme të dëgjosh për çdo lloj rasti [1]: Kujdes fjalët e huaja!).

Dihet se sidomos pas viteve 90, shqipja u gjend përpara një trysnie shumë të madhe, që kërkonte futjen e prerjeve të shumta gjuhësore, të cilat, sipas nesh, nuk prekën vetëm leksikun, por dhe rrafshet e tjera gjuhësore, e në këtë mënyrë dhe strukturën sintaksore.

Metodologji të reja shkencore, të ndryshme nga këndvështrimi tradicional, i cili ka qenë metoda kryesore e hulumtimit të korpusit të shqipes deri tani, na pohojnë faktin se është e pamundur që shumica e këtyre ndikimeve të jenë shtresëzuar vetëm në leksik, me fjalë të tjera ne mendojmë se ato kanë hyrë bashkë me perspektivën[2], në të cilën kanë marrë pjesë në kodin nga është huazuar fjala (Pra, në fund të fundit, kanë përcaktuar modele të reja të kokave ekzistuese ose janë modele specifike që nuk i kemi pasur me parë).

Drejtime gjuhësore të tilla si deskriptivizmi apo gjenerativizmi, strukturën e fjalisë e shohin të organizuar në varësi të marrëdhënieve që krijojnë sintagmat e hierarkive të ndryshme. Si kokë organizuese e këtyre sintagmave shihet koka foljore, e cila konceptohet si një sintagmë e madhe që përfshin gjithë fjalinë (bashkë me komplementet e adjunktet, informuesit[3]).

---

[1] Fakeqësisht dhe nga gjuhëtarët.

[2] Charles Fillmore, Case for Case, New Jork 1967.

[3] Adjunkt (adjunct), koncept mjaft i njohur në mjaft gramatika. Zakonisht referencat kryesore i ka pasur në lidhje me rrethanorët . Ai është parë si një element më periferik se komplementet, i cili nuk përcaktohet nga forca tërheqëse valentore e foljes. Shih: Thomas Herbst and Susan Schüller, Introduction to Syntactic Analysis, Tübingen, Germany, 2008, f. 22.

Komplementet e kokës foljore modelohen nga përzgjedhja semantike valentore e saj. Ato përfaqësojnë argumente, të cilat konfigurohen në modele karakteristike, nga pasuritë semantike të kokës foljore[4].

Komplementet realizohen si sintagma emërore, parafjalore, ndajfoljore etj. (këto, jo vetëm si komplemente të thjeshta, por dhe në formën e sintagmave fjali).

Sipas kësaj logjike, të paktën duhet të pranojmë se, kur këto të fundit (pra kokat foljore), janë identifikuar si hyrje nga kodet e tjera gjuhësore, ato duhet të kenë sjellë me vete dhe një pjesë komplementesh specifike, duke krijuar kështu modele të reja valence, pra perspektiva[5] të reja.

Ajo që ne duam të vëmë në dukje është fakti se këto të ashtuquajtura "fjalë të huaja" në pjesën më të mirë të rasteve hyjnë në strukturë bashkë me modelin me të cilin janë përdorur në gjuhën përkatëse.

Gjuha e kompjuterit përbën kontekstin tipik situativ, të hyrë komplet pas viteve 90. Pavarësisht se sot mund të thuhet se një pjesë e terminologjive janë zëvendësuar, harrohet fakti se secilit "term" i është shtuar një kuptim i ri dhe një strukturë e re, në të cilën del ky kuptim.

Në rastet e përdorimit të kokave foljore, vihet re se, edhe nëse ato janë përkthyer, përsëri janë dhënë në një perspektivë të re semantike, pasi bashkë me to kanë hyrë dhe komplementet e seleksionuara nga ato, duke disenjuar kështu një model të ri të kësaj koke. Po marrim disa shembuj.

Mjaft e përdorshme në këtë kontekst është struktura **"*navigoj në internet*"**, e në variantet shqip del dhe si **"*lundroj në internet*".**

Komponentet semantike të përzgjedhura nga kjo kokë foljore në këtë strukturë janë [+frymorë sintagma nominative SE (që i referohet kryefjalës tradicionale) dhe SP, sintagma parafjalore që del si [+vend real ose [+mjet]:

Unë lundroj në det me anije.

Në punimet tona, duke iu referuar funksionit dhe semantikës të tyre kemi propozuar shenjën "informues "si ekuivalent të tyre.

[4] E kemi fjalën për koncepte të tilla të Gramatikës së Varësisë si: komplement, argument, adjunkt, seleksionim semantik etj., të cilat i gjejmë në mjaft punime deskriptiviste të teorisë së valencave si: Valency, Descriptive, Theoritical Issues, Berlin, New Jork, 2005; A Valency Dictionary of English, Mouton de Gruyter 2004 etj.

[5] Perspektiva, sipas konceptit të Fillmor-it; Charles Fillmore, Case for Case, New Jork, 1967.

Nëse bëjmë një hulumtim të modeleve më të përdorshme ekzistuese në shqipe të foljes ***lundroj***, vëmë re se komplementi i dytë dhe i tretë (në det, liqen, oqean; me lundër, anije, vapor etj) zakonisht dalin si SP me komponente semantike [+vend objektivë i pari dhe [+objekt fizikë i dyti.

Në fjalinë e marrë në shqyrtim (***Unë lundroj në internet***.), mund të dallohet fare qartë se ka ndryshuar konteksti situativ dhe një pjesë e komplementeve përbërëse.

Komplementi i dytë (***në det***) shënjohet tashmë me një komplement tjetër në internet, që karakterizohet nga [+vend virtualë si tipar semantik. Nga ana tjetër, rasa e mjetit zhduket.

Në këtë moment mund të dallojmë dhe futjen e modifikimit semantik të foljes, të realizuar dhe në rrjetën valentore që ajo paraqet në këtë model tashmë të ri për të. (Procese të tilla janë më se të zakonshme në shumicën e literaturave të ekonomisë dhe sidomos legjislativit, po të kemi parasysh procesin e futjes së shumë ligjeve të huazuara nga Komuniteti Europian; avokat i popullit, gjykatë administrative etj.)

Shpjegimi i mësipërm ilustrohet nga modelet ekzistuese valentore, në të cilat ne do shohim se është modifikuar njëri nga modelet ekzistuese.

Modelet valentore më të zakonshme të foljes ***lundroj*** në shqipe janë si më poshtë[6]:

Lundroj folje

A "udhëtoj zakonisht nëpër ujë"

Aktive 2/4Pasive ½Pavetore 0

I [SE $_{(+frym)}$ë $_{A}$ M_{DT}

II [SE $_{(+frym)}$ë $_{A}$/ [SP $_{(+vend)}$ë D_{3T4}

III [SE $_{(+frym)}$ë $_{A}$/ [SP $_{(+vend)}$ë $_{1,}$ [SP $_{(+mjet)}$ë T_{1-4}

IV [SE $_{(-frym)}$ë $_{A}M_{1-2}$

V [SE $_{(-frym)}$ë $_{P}$M

VI [SE $_{(-frym, +vend)}$ë $_{P}$/ [SP$_{(+kohë)}$ë

VII [SE$_{(+frym)}$ë $_{A}$/ [SP$_{(+vend\ virtual)}$ë D

[6] Fjalori i gjuhës shqipe, 1980.fq 451.

I. Unë po lundroj.

II. Unë po lundroj në det (në liqen, oqean, lumë, hapësirë).

III. Unë po lundroj me anije (me varkë, jaht, lundër).

IV. Lundrojnë retë (shtëllungat e tymit).

V. A lundrohet ky lumë? A lundrohet në këtë lumë?

VI. Nuk lundrohet lumi (ky lumë, në këtë lumë) në dimër[7].

VII. Unë lundroj në internet.

E njëjta gjë mund të thuhet për strukturën valentore të ***faqe, kyç*** apo ***shkyç*** (nga facebook-u) etj.

Një fushë mjaft e prekshme e këtyre hyrjeve është dhe stili shkencor specifik. Duhet thënë se këto lloj dekodifikimesh në fushën e gjuhësisë nuk kanë qenë kaq të pakontrolluara, sa në fusha të tjera studimi. Në përgjithësi ato kanë pasur njëtrajtshmëri përdorimi të koncepteve nga autorë të ndryshëm. Megjithatë dhe këtu ka probleme, sidomos në reflektimet në tekstet parauniversitare.

Po marrim një shembull të thjeshtë nga gjuhësia. Le të shohim përdorimin e njësisë leksikore ***hap*** në deskriptivizëm, teorinë e valencave.

Deskriptivizmi (por dhe gjenerativizmi) e përdor këtë njësi leksikore, sidomos kur karakterizojnë procese të tilla si ai i valencës, si ky në vijim: ***Folja hap rreth vetes vendin e kryefjalës dhe kundrinës.***

Po të shohim Fjalorin e gjuhës shqipe (1980), vëmë re se na paraqiten disa pasuri semantike, pjesë të valencës semantike përkatëse.

Kuptimi i saj i parë lidhet me lëvizjen fizike, ose zhvendosjen e një objekti fizik (hap derën, dritaren, perdet etj)

Modeli tjetër i kësaj foljeje ka kuptimin e foljes *krijoj*. Në inventarin e modeleve të valencës të dhënë më poshtë, mund të dallohet lehtësisht ndryshimi i komponenteve semantike të modelit të ri nga ata paraardhës.

Në këtë strukturë shfaqen dy modele të njohura dhe një i ri, në të cilin [SEë $_{A}$ ndryshon komponentet semantike e bëhet [-frymë .

Komplementi i dytë merr këto karakteristika semantike [SE$_{(+\text{vend virtual})}$ë .

[7] Ka dhe përdorime idiomatike që këtu nuk po i përmendim.

Le të shohim një pjesë të inventarit[8] të modeleve të foljes ***hap*** në shqipe:

Hap folje

Aktive 1/5Pasive 1/3Pavetore 0

A hap- lëviz duke shtyrë

I [$SE_{(+frym)}$ë $_{A}$/[$SE_{(+objekt)}$ë D_{1-4}

II [$SE_{(+frym)}$ë $_{A}$/[$SE_{(+frym)}$ë DT

III [$SE_{(+ngjarje\ kult)}$ë M

[$SE_{(+ngjarje\ kult)}$ë / [$SP_{(+frym)}$ë D

IV [$SE_{(+frym)}$ë $_{P}$M

B hap-krijoj

I [$SE_{(+frym)}$ë /[$SE_{(+hapësirë)}$ë D_{1-3}

II [$SE_{(\pm person\ fizik\ juridik)}$ë /[$SE_{(+punë)}$ë D

[$SP_{(+frym)}$ë T

III [$SE_{(-frym;+gjuhësor)}$ë /[$SE_{(vend\ virtual)}$ë D

A

I Hap derën.

II Hapi ushtarët në formacion.

III A u hap ekspozita (shfaqja etj).

Ekspozita (tuneli, shkolla etj) në nëntor

IV Mos u hap shumë.

B

I Hap një vrimë (gropë etj).

II Hap vende të lira pune (për invalidët) .

III Folja hap rreth vetes vendin e kryefjalës dhe të kundrinës.

E njëjta gjë mund të thuhet për folje të tjera si ***seleksionoj, projektoj***, a për koka emërore si ***rasë, plotës, komplement, argument, projeksion*** etj.

Le të shohim dhe një kokë emërore se si ndryshon dhe brenda disiplinë, përkatësisht sipas teorive të ndryshme.

[8] Edhe ky komplement, inventar komplementesh, është strukturë e huazuar.

Koncepti tradicional këtë fjalë e karakterizon vetëm në aspektin formal-funksional (Kemi parasysh Gramatikën I, në të cilën ajo shihet si kategori morfosintaksore[9]. Ky këndvështrim nuk e përmend fare rasën semantike.

Atë e gjejmë në dy teori më të reja se ajo tradicionale, përkatësisht gjenerativizëm dhe deskriptivizëm.

Koncepti i rasës semantike ka një pozicion të ndryshëm në to, pavarësisht se në pamje të parë, duket se është i njëjti, jo vetëm në emërtim, por dhe në përkufizim.

Në deskriptivizëm rasa semantike seleksionohet nga forca përzgjedhëse semantike e valentore e kokës folje, por nga ana tjetër ajo shihet si pasuri e komplementit (bashkë me komponentet semantike).

Nga ana tjetër perceptimi i rolit semantik në gjenerativizëm është shumë më i ngushtë dhe më i kufizuar se trajtimi mjaft i detajuar nga autorë deskriptivistë. Mjafton të shohim numrin e roleve semantike që përcakton gjenerativizmi (rreth pesë[10]), ndërkohë që këndvështrimi tjetër paraqet një numër të madh listash mjaft të detajuara me një numër shumë më të madh rasash semantike[11].

Në fakt dhe në auditorin tonë shkencor vihet re shpesh një ngatërrim i këtyre koncepteve, që sipas nesh vjen nga mosnjohja e materialit teorik.

Shtjellimi i mësipërm i rasës semantike dhe formale pasqyronte semat kryesore të tyre. Këto pasuri semantike seleksionojnë komplemente komplet të ndryshme (Vëmë re rasë emërore, gjinore etj. dhe rasë kohore, vendore, të pacientit, të eksperimentuesit, e deri rasë të komplementit dhe të adjunktit në analizat më të imta semantike.).

Megjithatë duhet thënë se këto lloj dekodifikimesh në fushën e gjuhësisë nuk kanë qenë kaq të pakontrolluara, sa në fusha të tjera studimi. Në përgjithësi ato kanë pasur njëtrajtshmëri përdorimi të koncepteve nga autorë të ndryshëm brenda teorive përkatëse.

Në kontekstin e analizës së mësipërme, mendojmë se problemi krye-

[9] Gramatika I, Akademia e Shkencave, 2003, f. 105.
[10] L.Hegeman, Introduction on the governing and binding theory, New Jork, 1999
[11] K. Tarvainen, Semantic cases in framework of Dependency Theory, De Gruyter, 1985.

sor në lidhje me anglicizmat (por jo vetëm) ka lidhje fillimisht me identifikimin e tyre.

Ai duhet studiuar dhe identifikuar më thellë në strukturën ku gjallon, për të parë, nëse flitet për një fjalë të vetme, apo për një kontekst të tërë situativ, e nga ana tjetër nëse ky kontekst është i nevojshëm si në shumicën e konteksteve shkencore të reja, apo i panevojshëm si në shumicën e strukturave mediatike të panevojshme të tilla si *bëj me dije, ndaj me ju të njëjtin mendim, kam flutura në bark* etj. etj.

Pra në mungesë të një korpusi strukturor momentalisht (fjalori valencash, në të cilin të identifikohen strukturat më karakteristike të përdorimit, dhe kështu të dallohen modelet e reja), të paktën të jemi më të kujdesshëm në hulumtimin e perspektivës, në të cilin gjallon e ashtuquajtura "fjalë e re" e futur.

Duke pasur parasysh rolin e medias si krijues modelesh, fatkeqësisht në një pjesë rastesh jo të mira, sugjerojmë propozimin e instancave shtetërore përkatëse, vënien e një rregullatori gjuhësor kontrollues në mediat vizive dhe të shkruara, i cili të bëjë kontrollin, redaktimim dhe përshtatjen e teksteve, të cilat në një pjesë rastesh janë përkthim i drejtpërdrejtë dhe jo përshtatje.

Gjithashtu një këshilltar i tillë duhet të jetë pjesë e Këshillit Kombëtar të Radio-televizioneve, minimalisht në Këshillin e Etikës.

Krijimi i një kulture më të lartë gjuhe, që do të kufizonte dhe hyrjet e pakontrolluara, mund të realizohej dhe me emisione televizive, që tash për tash janë shumë të pakta, e që në televizionet e huaja janë të zakonshme.

Nga ana tjetër, shohim si të domosdoshëm rikonceptimin dhe botimet e fjalorëve terminologjikë, në të cilët të pasqyrohen hyrjet e reja, por të diskutuara fillimisht nga grupe pune, dhe jo nga një autor.

Natyrisht presionet e hyrjeve të ndryshme nga kode të ndryshme shfaqen si viroza kronike mbarëkohore për çdo gjuhë natyrale.

Besojmë se është detyra e specialistëve të fushave përkatëse, pra jo vetëm gjuhëtarëve, që të mos i lejojnë një pjesë prej tyre të kthehen në kancer të kodit tonë gjuhësor.

Bibliografi

Akcema P, 1984, Issues in Morphosintax, Amsterdam, J.Benjamins PC
Buxheli, L. Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe, Neraida. 2007
Bybee, J.J., Morphology,Johns Bejamins Publishing Company, Amsterdam/Filadephia, 1985.
CGEL, London New Jork, Longman, 1985.
Chomsky, N., Aspects of theory of syntax, The M.T.I press.
Cruise.D.A, Lexical Semantics, Cambridge University Press, 1997.
Fillmore. Ch., Case for case, New Jork, 1968.
Fillmore. Ch., Case for case reopened, New Jork, 1977.
Fillmore. Ch., Valency Issues in Frame Net në Valency, Theoritical, Deskriptive and Cognitive Issues, 2005.
Gramatika I, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2003
Lloshi. Xh., Stilistika dhe Pragmatika, Toena, 1999
Mathews. P.H.,Syntax, Cambridge University Press, 1996.
Mc Carthy A., Current Morfology, London, 1992
Valency, Descriptive, Theoritical Issues, Berlin New Jork, 2005.

Albana DEDA (NDOJA), Tirana

STRUCTURAL IDENTIFICATION OF NEW BORROWINGS AND CODIFICATION SCHEMES

Summary

A new entry from one linguistic code to another is a known process already in all languages. The normal way of passing from one code to another, has been direct contact between them.We think that our studies until now are focused generally in identifycation of the new entries especially in lexical, morphological and phonetic plane.At the other side, syntactic plane have been neglected in general in these studies. This process has an important impact especially in syntactic structure, that's why we have given some examples taken from different registers to show the projections of the new word and the accommodation in an existing pattern, or importing a new one, from the code where they have been.Identification of the structure where these words lives in our language, can prevent the unnecessary entries in syntactic plane.

Muhamet HAMITI, Prishtinë

VENERIME PËR ANGLICIZMAT NË SHQIP

KDU 811.18'373.45
811.18’27

Kjo parashtresë e shkurtër nuk është rezultat i një analize sistematike cilësore a sasiore (kualitative/kuantitative) për anglicizmat në shqip, duke qenë se me formim jam studiues letërsie dhe jo studiues i gjuhë/gjuhësisë. Përbën venerime të miat për fenomenin e anglicizmave në shqip, si përdorues i shqipes dhe i anglishtes në fusha kulturore e letrare, por edhe politike dhe diplomatike.

Anglishtja është gjuhë e epokës sonë të globalizimit, një *lingua franca*, më shumë si rezultat i fuqisë dhe i ndikimit të SHBA-ve sesa i Anglisë (Mbretërisë së Bashkuar), vendit amë të kësaj gjuhe.

Shqipja ka qenë në kontakt të papërfillshëm me anglishten deri në vitet 1990, kohë e ndërrimeve të mëdha në Kosovë e Shqipëri. Kontaktet gjuhësore janë rritur fuqishëm pas vitit 1999 në Kosovë, ndërsa vazhdojnë me ritme të njëjta edhe në vitet e paspavarësisë. Anglishtja është efektivisht gjuhë e tretë zyrtare në Kosovë, pas shqipes, dhe krahas me serbishten. Një pjesë e madhe e ligjeve që ka miratuar Kuvendi i Republikës së Kosovës, sidomos i atyre me ndjeshmëri më të madhe politike dhe që prekin pakicat, janë shkruar fillimisht dhe tingëllojnë si origjinale në anglishtNë Shqipëri anglishtja nuk është gjuhë e dytë zyrtare, por gjithësesi e gjithëpranishme në jetën shoqërore e politike, ndonëse gjuhët e kontaktit më të madh të drejtpërdrejtë (për arsye të fqinjësisë, por edhe ekonomike) janë greqishtja dhe italishtja.

Përmes fuqisë së hatashme të SHBA-ve – ekonomike, politike, ushtarake, kulturore e shkencore – por edhe të internetit që fillimisht është mbizotëruar krejt nga anglishtja, kjo gjuhë ka marrë pushtet të madh në shumë gjuhë, qofshin pak, qofshin shumë të përpunuara. Në OKB dhe në Bashkimin Evropian, si gjuhë e parë në përdorim zyrtar, anglishtja ka marrë status supranacional. Në shqip dhe në gjuhë të tjera, përmes sistemit shkollor në vendet ku anglishtja bëhet gjuhë e dytë ose gjuhë e huaj krye-

sore, anglishtja ka hyrë thellë, në palcë: madje vetë emërtimet për nivelet e shkollimit universitar sipas sistemit të Bolonjës, Baçelor dhe Master, janë prej anglishtes. Janë të fuqishme kalket që kanë përlarë gjuhën shqipe dhe të tjera (yll filmi, ta zëmë, nga *film star*). Politika, diplomacia, biznesi, reklamat, dhe sidomos filmi dhe mediat e reja përgjithësisht përshkohen dukshëm nga anglishtja.

Mbasi fjala është për anglicizmat, do përkujtuar së Manfred Görlach, autori/redaktori i tre librave me peshë të madhe për huazimet angleze në rrafsh evropian, duke përfshirë edhe *A Dictionary of European Anglicisms*, OUP, 2001/2005, ka përkufizuar kështu anglicizmin:

An anglicism is a word or idiom that is recognizably English in its form (spelling, pronunciation, morphology or at least one of the three) but is accepted as an item in the vocabulary of the receptor language". Manfred Görlach**.** *English Words Abroad*. 2003, fq.1.

[Anglicizmi është fjalë apo idiomë që njihet qartazi si angleze në formë (ortografi, shqiptim, morfologji, apo së paku në njërën prej këtyre trijave), por që pranohet si një njësi/zë në vokabularin e gjuhës pranuese.]

Ka ndërkaq edhe përkufizime me nxënësi më të madhe, që fusin te anglicizmat edhe fjalë e fraza që nuk janë shembëllyese të huazimeve angleze në rrafsh ortografik, fonologjik, morfosintaksor dhe semantik, por edhe pragmatik.

Si në gjuhët e tjera, anglicizmat hyjnë në shqipe nëpërmjet fushave të mbizotërimit global anglez (amerikan), ndërsa sipas lindjes së tyre mund të klasifikohen si: 1) të përkthyera (ta zëmë, miu apo miushi, në kompjuteristikë, nga *mouse*), 2) të përshtatura, dhe 3) të përziera (ta zëmë studim fizibiliteti, nga *feasibility study*). Ka edhe anglicizma grafikë. Ka anglicizma të rremë: *fotoreporter* dhe *autogol*, ta zëmë, që kanë hyrë te ne përmes italishtes.

Simbas realizimit, anglicizimat dalin a) të dukshëm, b) të fshehur dhe, c) si lëndë e parë/bruto. Të dukshëm: shou biznis (*show business*); biznis klasë (*business class*); imeill/email (*email)*; dizajner grafik (*graphic designer*); video kasetë (*video cassette*), fajll (*file*), procesor (*processor*). Shembuj anglicizmash të fshehtë: fjalëkalim (*password*), ruaj (*save*), apo madje edhe KTV (Televizioni Koha, në vend se me akronimin TVK del si

KTV, që i bie Koha Television). Shembuj anglicizmash si lëndë e parë/ bruto: bekap (*backup*), onllajn (*online*), folder (*folder*), *no comment*, *non-stop*; *bonus*; *laptop*, uebsajt (*website*); sajt (*site*) që nganjëherë shfaqet si sit. Anglicizmi si lëndë e parë Okej (OK) paraqitet madje në mbarim të një teksti të At Zef Pllumit për *Lahutën e Malcis* të Gjergj Fishtës -- me nëntekst ironik gjithësesi!

Cilat janë arsyet e vërshimit të madh të anglicizmave në shqip? Fillimisht, ashiqare nevoja për to. Pastaj, pafuqia e ledhit mbrojtës ndaj tyre. Por, arsye të mëdha janë edhe padija, dembelia dhe snobizmi i folësve dhe i shkruesve shqiptarë.

Si në gjuhët e tjera, edhe në shqip, huazimet dalin të hallit dhe të mallit; të domosdosë dhe të luksit, do të thoshim me terma më pak poetikë. Huazimet bëhen me katakrezë, apo pa katakrezë.(Metaforat katakretike përdoren për të plotësuar një zbraztirë në vokabular, kur nuk ekzistonjë terma të fjalëpërfjalshëm). Mirëpo ato kanë rol të fortë për ndërtimin e neologjizmave në shqip

Anglicizmat janë të dobishëm, kur merren me me masë dhe me dije/ njohje. Dijes sonë i duhet një Fjalor etimologjik i anglicizmave, të vërtetë e të rremë. Poashtu një studim i anglicizmave mbi bazë të gjuhëve ndërmjetësuese për anglicizmat në shqip: serbishtja, italishtja, frengjishtja, etj.

Nuk e besoj se Kosovës dhe Shqipërisë u duhen komisione ministrore të terminologjisë (si në Francë), apo madje ndonjë iniciativë si në Gjermani (e ministrit të Transportit në Qeverinë e Angela Merkelit), por e di që inkurajimi i përkthimeve të drejtpërdrejta në vend të huazimeve të drejtpërdejta është i pëlqyeshëm dhe i dobishëm për hapësirën kulturore shqiptare.

Anglishten nuk e ka mbytyr pushtimi norman. Shqipen nuk e kanë mbytyr pushtimet e hershme e të vonshme, edhe pse kanë zgjatur shumë, tepër shumë. As tash nuk do të mbytet. Kujdes duhet pasur gjithësesi nga huazimet e kamufluara. Ndërsa pyetja që do shtruar kur shqyrtohen anglicizmat veç e veç është: cila fjalë e mirë shqipe do t'i zëvendësonte efektivisht, apo, thënë ndryshe, cilën fjalë të mirë shqipe e kanë nxjerrë jashtë përdorimit? Nuk do të na bënte keq pak më shumë rigorozitet në këto shqyrtime, qoftë edhe nga puristë të pandehur të gjuhës, për t'i rezistuar një vale të akulturimit shqiptar.

LETËRSIA SHQIPE NË SHKRIMET ENCIKLOPEDIKE

Tryezë shkencore e organizuar nga Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 7 qershor 2013 në Prishtinë.

Këtu po botojmë të gjitha materialet e autorizuara për botim sipas renditjes në Tryezë.

Ali ALIU, Prishtinë

FUNKSIONI ENCIKLOPEDIK I LETËRSISË

KDU 821.18.09

Kur në seksionin tonë Gjuhë dhe Letërsi vendosëm ta shtrojmë në një diskutim tryeze praninë e letërsisë në projektet enciklopedike, në fillim sikur kishim parasysh vetëm letërsinë shqipe dhe përvojën tonë në këtë fushë. Për veten time, i nxitur pak edhe nga jehona që gjatë vitit të kaluar iu bë Monografisë Kosova, projekt i kësaj Akademie, e sidomos kapitullit Letërsia Shqipe në Kosovë, e para, dhe e dyta edhe fillimi i punës në projektin e ri të kësaj Akademie "Fjalori enciklopedik i Kosovës", qenë persiatjet kryesore. Natyrisht parasysh kishim edhe përvojën e dy botimeve të Fjalorit enciklopedit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Letërisa shqipe, ndërsa, e pranishme në përvojat enciklopedike të huaja, që, siç e dimë është thuajse incidentale, erdhi fare spontanisht dhe natyrshëm, duke e zgjeruar kështu shtratin tematik të ngasjes së parë, që ishte Letërsia shqipe në projektet enciklopedike shqiptare të gjertanishme dhe të projektuara për nesër.

Përballë temës së shtruar kështu, Letërsia shqipe në projektet enciklopedike, nxit ngasje edhe nga një perspektivë e tillë: ç'kërkon letërsia në dijen enciklopedike, përkatësisht ç'pretendime ka ajo në këtë fushë? Cili aspekt i saj mbetet i përjashtuar, cila perspektivë e dijes letrare mbetet e përjashtuar, e pa përfshirë brenda fushës e dijes që e quajmë shkencë mbi letërsinë? Ç'pjesë e objektivit të saj mbetet përjashta kur dihet se burim mësimi, formimi, përvetësimi i saj nuk mbështetet e as nuk vjen përmes projekteve enciklopedike?

Pyetjet e shtruara detyrimisht të kthejnë te funksioni kryesor i tekstit, i librit të emërtuar Fjalor enciklopedik, Enciklopedi e përgjithshme e që më i pari do të ishte infomim i shpejtë dhe i shkurtë në shërbim të përgjithshëm, ndihmesë e të gjithë atyre që e konsultojnë doracakun në fjalë, pavarësisht ngasjes dhe nevojës, objektivit që kanë, ngasjes që i shtrëngon ta shfletojnë atë doracak shpejt e shpejt.

Nuk kam njohuri në shkallë sa të flas për përvojat e letërsive të kulturave dhe gjuhëve të huaja në këtë fushë, por nga përvoja e pakët e jona bie në sy se ndjeshmëria e atyre që e krijojnë letërsinë, por edhe të atyre që besojnë që janë të tillë, është posaçërisht e madhe. Përfshirjen – mospërfshirjen në një doracak të këtillë leksikografik shumica e përjetojnë dramë të vërtetë. Ata mund të mos kenë lexues të shumtë, mund të mos u blihen librat që vazhdojnë, pa marrë parasysh, të botohen pa u sekëlldisur fort, por po nuk e gjetën emrin në një projekt enciklopedik dëshpërimi vjen përmasasht tunduese.

Pse ndodh keshtu? Ç'u ofron shkrimtarëve prania në kolonat e fjalorit enciklopedik, që s'ua ofron dot as jehona e lexuesit, as konsiderata e pranishme ose e munguar e vlerësuesit? Mos vallë një ndjenjë e pranisë së përhershme, meqë libri enciklopedi është dhe do të vazhdojë të mbetet, pavarësisht formës dhe rrugës së komunikimit (vetëm para disa muajve "Britanika", shpalli vendimin se në vazhdim do jetë libër elektronik), ndihmesë praktike në bibliotekën e secilit që është lexues.

Libri i tillë leksikografik, duke qenë ndihmesë për të gjithë, që nga kureshtari më i rëndomtë, deri tek krijuesi, intelektuali etj., pra tekst i përhershëm në tavolinën e punës, në raftet e bibliotekës, nga njëra anë, dhe të qenit i pranishëm me emër dhe mbiemër në faqet e tij qoftë edhe në rrethin e fundit të vlerës së shkallëzuar, duket se vetvetiu merr peshë që është tërheqëse, ose të paktën që duket e tillë. Libri i tillë i përhershëm, i kudopranishëm, burim i formimit dhe i informimit kulturor, është të paktën indikator lehtësus për përpiluesit e teksteve nga historia e letërsisë, për studiuesit e saj, për përpiluesit e programeve dhe teksteve shkollore, për autorët dhe përpiluesit e antologjive letrare.

Libri enciklopedik, dua të them, ka një ngjashmëri tundimi me librin e quajtur antologji letrare, përzgjedhje antologjike. Edhe pse libri i parë për autorësi ka një institucion leksikografik kryesisht, libri i dytë për autor ka një individ, ndjeshmëria megjithatë e letërsisë ndaj tyre, e krijuesve të saj është e madhe. Dhe objekivi që kanë ose pretendojnë gjithashtu është edhe s'është i ngjashëm: i pari, projekti enciklopedik shtrihet më përfshirës në një botë letrare, por që klasifikimin vlerësues e ka të njëjtë me librin e dytë, përkatësisht me hapësirën tekstorenë rasti e pare me rreshta, në të dytin me

vargje. Të përbashët, gjithashtu, kanë besimin, përkatësisht iluzionin e të pranishmëve midis të përhershmëve. Te krijuesit e vërtetë besimi në vete është i natyrshëm, i përhershëm pavarësisht pranisë në projektet e zëna në gojë, që manifestohet qoftë i pranishëm apo i munguar në të dy rastet.

Sabri HAMITI, Prishtinë

ENCIKLOPEDIA LETRARE

KDU 821.18(031)

Për një enciklopedi të letërsisë shqipe

Kultura shqiptare tashmë ka nevojë për hartimin e një enciklopedie të letërsisë shqipe, vepër që do ta trajtonte historinë e letërsisë shqipe dhe bashkëkohësinë e saj, me synimin për të dhënë në një sistem të përbashkët evidencat dhe vlerat e saj. Kjo vepër kolektive, e hartuar nga njohësit e letërsisë, domosdoshmërisht shkon përtej provave të bëra për hartimin e historisë së letërsisë shqipe të nivelit elementar, apo të nivelit akademik.

Enciklopedia e letërsisë shqipe do të hartohej me zëra të përfshirë në disa kategori themelore: biografi; interpretime; kryevepra; periudha e drejtime; gjini, lloje e forma; revista e gazeta; institucione; letërsi e përkthyer.

1. Biografi

Artikujt biografikë të shkrimtarëve shqiptarë do të kenë këtë strukturë: në fillim të dhënat themelore civile të shkrimtarëve, pastaj paraqitja e veprës letrare, analiza e veprave të rëndësishme, pastaj bibliografia e shkrimtarëve, e në fund literatura më e rëndësishme për shkrimtarët.

Artikujt për shkrimtarët, do të ndahen në disa kategori, në bazë të mënyrës së trajtimit dhe të gjatësisë.

I. Artikuj për shkrimtarët klasikë (nacionalë) të letërsisë shqipe, që me veprat e veta kanë shënuar epokat e veta letrare dhe kanë mbetur të shenjuar si vlera kulmore kulturore në historinë e letërsisë shqipe. Këtu hyjnë shkrimtarët si Marin Barleti, Gjon Buzuku, Pjetër Bogdani, Jeronim De Rada, Naim Frashëri, Ndre Mjedja, Gjergj Fishta, Ismail Kadare, etj.

II. Në këtë grupim hyjnë artikujt për shkrimtarë të njohur, për të cilët kritika e historiografika letrare tanimë ka dëshmuar që kanë krijuar vepra me vlera të pakundërshtueshme, si Jul Variboba, Zef Serembe, Gavril Dara, Sami Frashëri, Andon Zako Çajupi, Pashko Vasa, Zef Skiroi, Alek-

sandër Drenova, Fan S. Noli, Faik Konica, Ernest Koliqi, Mitrush Kuteli, Migjeni, Martin Camaj, Jakov Xoxa, Esad Mekuli, Anton Pashku, Ali Podrimja, etj.

III. Në këtë grupim hyjnë artikujt për shkrimtarët e periudhave të kaluara, të cilët historiografika letrare dhe kritika i çmon të rëndësishëm, si dhe shkrimtarët bashkëkohorë të vlerësuar nga kritika, të përkthyer në gjuhë të tjera, por që nuk e kanë përfunduar ende veprën e vet letrare.

IV. Në këtë kategori hyjnë shkrimtarët më pak të rëndësishëm nga e kaluara e letërsisë shqipe dhe shumica e shkrimtarëve shqiptarë bashkëkohorë.

2. Interpretime

Në këtë kategori shkrimesh hyjnë interpretimet e veprave të njohura të të gjitha gjinive e llojeve në letërsinë shqipe: poezi, romane, drama, novela, ese. Këto janë interpretime letrare me qëllim të shpalimit të strukturave të tyre të veçanta dhe të vlerave letrare, në raport me veprat e tjera të shkrimtarit dhe me veprat e tjera të llojit në kuadër të letërsisë shqipe.

3. Kryevepra

Kategori e veçantë e artikujve është ajo për kryeveprat letrare, të cilat përkufizohen si veprat kryesore të autorëve, dhe të epokave letrare, ato që shpërfaqin struktura e domethënie të reja, duke ruajtur karakteristikat e epokave; përfaqësojnë poetikat e autorëve, shfaqin shndërrimet e përhershmëritë letrare, duke ruajtur vlera letrare të përhershme, si, *Histori e Skënderbeut*, *Cuneus Prophetarum*, *Këngët e Milosaos*, *Lulet e verësë*, *Andrra e jetës*, *Mino*, *Lahuta e Malcís*, *Ylli i zemrës*, *Vargjet e lira*, *Kronikë në gur*, *Oh!* etj. Statusi i kryeveprës letrare trajtohet si i përfituar në kuadër të letërsisë shqipe, mirëpo vetvetiu sprovohet duke u krahasuar me kryeveprat e letërsive të tjera, në këtë rast së pari me vepra të letërsive evropiane.

4. Periudha e drejtime

Këto janë tekste sintetizuese që përfshijnë tërësinë e letërsisë shqipe dhe rrokin epoka stilistike, karakterizime poetike e ngjarje letrare, si huma-

nizmi, biblizmi, romantizmi, paramodernizmi, modernizmi, socrealizmi, etj. Pra, kërkohet trajtimi i periudhave dhe drejtimeve letrare simbas paraqitjes historike të literaturave botërore, duke i parë këto të shfaqura dhe në letërsinë shqipe. Mirëpo epokat letrare, madje dhe emërtimet e tyre, nuk janë të barasvlefshme në kohë e në emërtime me epokat dhe fenomenet në letërsinë shqipe. Kjo shtron domosdonë që në këtë nivel trajtimi të merren fenomene specifike të letërsisë shqipe, të cilat do të kenë dhe emërtime që prodhohen nga trajtimi i kësaj letërsie si: fetërsia filobiblike, fejtexhinjtë, Rilindja, fetërsia e françeskanëve, fetërsia e fiasporës, fetërsia e fisidencës, etj. Të gjitha këto emërtime, për fenomene karakteristike të letërsisë shqipe, është e domosdoshme që të diskutohen para se të marrin formulimin përfundimtar. Këta artikuj sintetizues do të përfshijnë referenca historike dhe karakterizime tipologjike, duke u argumentuar me autorët më të mëdhenj përfaqësues.

5. Gjini, lloje e forma

Artikuj për ndarjet klasike të gjinive: lirikë, epikë e dramatikë. Artikuj të veçantë: lirika, tregimi, romani, epi, poezia epike, kritika, eseja, drama, antidrama, autobiografia, biografia, kujtimet, ditari, soneti, vargnimi, prozca poetike, skica, etj. Kjo lidhet me format klasike dhe bashkëkohore të prodhuara në trashëgiminë e letërsive të ndryshme. Mirëpo edhe në këtë nivel, klasifikimit universal letrar duhet t'i shtohen dhe venerimet për forma letrare që janë nganjëherë karakteristikë e zhvillimit të letërsisë shqipe, si forma a struktura letrare, që në fazë kalimtare kalojnë nga një formë në një formë tjetër, po shenjojmë veprat: *Gjella e Shën Mërisë Virgjër*, *Divani*, *Baba Musa lakuriq*c. Edhe më tutje një nënkategori formale në trajtën e librit të prozave (tregime të lidhura): *Pasqyrat e Narçizit*, *Novelat e Qytetit të Veriut*, *Ahmet Koshutani*, *Vdekja më vjen prej syve të tillë*. Po ashtu, libri i poezisë si: *Ylli i zemrës, Vargjet e lira, Psalmet e murgut*. Edhe libri i dramës, si *Bregu i pikëllimit.*

6. Revista e gazeta

Një enciklopedi e letërsisë shqipe i ka të domosdoshëm artikujt për revistat kryesore dhe gazetat (të përkohshmet), të cilat kanë rëndësi të

dyfishtë sepse botojnë letërsi, vlerësojnë letërsinë në kohën e shfaqjes së saj dhe në këtë mënyrë shprehin sensibilitetin letrar të kohës e po ashtu krijojnë një vetëdije letrare. Në veçanti revistat që mbledhin rreth vetes grupime letrare artikulojnë dhe karakteristikat themelore të brezave letrarë dhe të kërkimeve të reja letrare. Donë trajtim revistat: *Albania, Hylli i Dritës*, *Diturija*, *Illyria*, *Bota e re*, *Literatura jonë*, *Nëntori*, *Jeta e re*, *Fjala, Pionieri, Drita,* etj. Trajtimi i revistave bëhet i lidhur dhe me pikëpamjet e shkrimtarëve – redaktorëve shumëvjeçarë të tyre.

Një kategori e veçantë artikujsh do të trajtojnë botimin dhe shqyrtimin e letërsisë edhe në gazetat ditore, sidomos ato që për vite të tëra kanë pasur rubrika të veçanta standarde për botimin dhe interpretimin e fenomeneve letrare.

7. Institucione

Kategori e veçantë e artikujve lidhen me institucionet të cilat e botojnë dhe e studiojnë në mënyrë sistematike letërsinë shqipe. Ndër të parët hyjnë shtëpitë botuese në kohë të ndryshme, të cilat pa mëdyshje që me zgjedhjen dhe me botimet kanë ndikim në vlerësimet dhe në mënyrën e receptimit të letërsisë, në mënyrë të veçantë botuesit e mëdhenj, që kanë bërë ose bëjnë qarkullimin më të madh të librave letrarë. Në institucionet e studimit të letërsisë përfshihen akademitë, botimet enciklopedike, botimet shkencore, institutet e letërsisë, katedrat e letërsisë në botën shqiptare dhe në botën e huaj. Këtu hyjnë dhe teatrot nacionale si shpërfaqje publike të vlerave letrare dhe të komunikimit të veçantë, sidomos të veprave dramatike. Asociacionet letrare, po ashtu, kanë pasur një rol të veçantë të vlerësimit të letërsisë nëpër kohë, duke provuar kriteret e vlerësimit në raport me kohën e shfaqjes së veprave dhe të autorëve.

8. Letërsia e përkthyer

Çështja e letërsisë së përkthyer do trajtim në dy rrafshe, në dy drejtime. Njëri drejtim është përkthimi i letërsisë botërore, veçanërisht i kryeveprave të autorëve të mëdhenj në gjuhën shqipe, i cili pos që merr karakter kulturor, njohës, merr karakter të fuqishëm ndikues në periudha të ndryshme të shkrimit të letërsisë shqipe. Shtresimi kohor i përkthimit në shqip të

veprave të Homerit, tragjedianëve grekë, Biblës, Virgjilit, Dantes, Shekspirit, të klasikëve, romantikëve, realistëve e të modernëve të letërsive evropiane, mund të lexohet si një ndikim frytdhënës edhe në shkrimin dhe në komunikim letrar të letërsisë shqipe. Drejtimi tjetër ka të bëjë me përkthimin e veprave të letërsisë shqipe në gjuhët e huaja. Ky fenomen letrar domosdo ka dy funksione kulturore dhe letrare: afirmon identitetin letrar shqiptar, duke e bërë të komunikueshëm me letërsitë e tjera, dhe sprovon vlerat e letërsisë sonë në komunikime universale letrare.

Dhurata SHEHRI, Tiranë

ZËRAT E LARTË DHE ZËRAT E MËDHENJ TË LETËRSISË SHQIPE

KDU 821.18.09

Enciklopeditë apo fjalorët enciklopedikë i shkruajnë ekspertët e fushës (nëse enciklopedia është sektoriale) ose të fushave (nëse enciklopedia është gjenerativiste) për t'u lexuar apo përdorur nga jospecialistët. Shumë prej nesh janë objekte apo subjekte të zërave të një apo më shumë enciklopedive, por shumë pak prej nesh janë lexues që presin të marrin informacione të reja "objektive" ose interpretime të reja apo të vjetra "subjektive" prej enciklopedive. Sot kushdo që e ndjen veten specialist të një fushe mund të bëhet pjesë e një grupi për të ndërtuar një enciklopedi apo fjalor enciklopedik: kemi mbërritur në erën e "demokratizimit" të dijes, por edhe të gjykimit për të. Gjithsesi, autoriteti i institucionit dhe i hartuesve të një enciklopedie (zakonisht të shpallur në krye të secilës) janë filtri i parë për seriozitetin e ndërmarrjes. Më herët *Fjalori enciklopedik shqiptar* i vitit 1985 dhe në bashkëkohësi *Fjalori enciklopedik shqiptar* i vitit 2008-2009 botuar nën siglën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë hartuar nga akademikët dhe profesorët e letërsisë, paragjykohet si botimi më i ri dhe më autoritar. Me këtë paramendim niset çdo lexues (jo specialist, edhe jo shqiptar, ndonëse shqipfolës) për të lexuar informacione dhe interpretime për letërsinë shqipe (në rastin konkret) që do ta ftonin të dinte më shumë e ta lexonte më shumë (vetë enciklopedinë), por sidomos letërsinë shqipe.

Më lart përmenda që enciklopedia shkruhet nga specialistët për jospecialistët, në këtë rast nga kritikët, për jokritikët, nga studiuesit e letërsisë për lexuesit e letërsisë. Duke e deformuar pakëz receptuesin, ose *intentio operis*, një studiues i letërsisë mund të gjejë në këto enciklopedi: vendin e letërsisë në botën shqiptare; hierarkinë e letërsisë shqipe; kritikën aktuale për letërsinë shqipe dhe në fund të fundit një shumësi mënyrash subjektive, sado autoritare, të leximit dhe interpretimit të letërsisë shqipe.

Vendi i letërsisë në botën shqiptare

Statistikat e fjalorëve enciklopedikë shqiptarë japin këto të dhëna:

Në *Fjalorin enciklopedik shqiptar të vitit 1985* gjithsej janë 5000 zëra. Nga këta, zërat e letërsisë janë vetëm 106, ndryshe vetëm 2.12 % e botës shqiptare.

Në *Fjalorin enciklopedik shqiptar të vitit 2008***,** gjithsej janë 7200 zëra ndër të cilët zërat e letërsisë janë vetëm 284, ndryshe 3.94% ose dyfishi i vendit që zë letërsia në botën shqiptare.

Hierarkia e letërsisë shqipe

Zërat e mëdhenj të letërsisë shqipe: Në FESH 1985 janë në rend alfabetik vetëm 4 zëra autorësh: Çajupi, De Rada, N. Frashëri, Migjeni, Noli dhe katër zëra "konceptualë**":** Historiografia letrare shqiptare, Letërsia e LANÇ, Letërsia shqiptare, PPSH dhe E. Hoxha për letërsinë dhe artet, Poezia.

Zëra të mesëm: Në FESH 1985 janë në rend alfabetik këta zëra autorësh: Asdreni, Buzuku, Bogdani, Gurakuqi, Kadare, Kristoforidhi, Thimi Mitko, Ndre Mjeda, Naum Veqilharxhi, Jani Vreto, Jakov Xoxa dhe Estetika, Kritika letrare, Letërsia dokumetare, Letërsia e arbëreshëve të Italisë, Letërsia për fëmijë, Letërsia satirike, Libri, Lidhja e shkrimtarëve dhe artistëve, Metrika, Përralla, Romantizmi shqiptar, "Shqipëria ç'ka qenë … " si zëra "konceptualë",

Në FESH 2008-9, *Zërat e mëdhenj të letërsisë shqipe* janë 14 në rend alfabetik: Agolli, Çajupi, De Rada, Fishta, N. Frashëri, Kadare, Koliqi, Konica, Kuteli, Petro Marko, Migjeni, Mjeda, Noli, Poradeci. Por Agolli, Cajupi, De Rada, Fishta, N. Frashëri, Kadare, Migjeni, Noli – janë 8 më të mëdhenjtë dhe të mëdhenj të kategorisë së dytë janë: Koliqi, Konica, Kuteli, Marko, Mjeda Poradeci. 14 zërat e tjerë të mëdhenj ndahen në:

Gjinitë e mëdha të letërsisë shqipe janë: dramaturgjia, eposi i kreshnikëve, kritika letrare, letërsia satirike, përkthimet, poezia, romani

Rryma më "e madhe" e letërsisë shqipe: realizmi.

Ndërsa zërat "historikë" të letërsisë shqiptare janë: Shqipëria (letër-

sia); letërsia shqipe, letërsia e arbëreshëve të Italisë, letërsia shqipe në Kosovë; historia e letërsisë shqiptare;

Gjatë krahasimit mes dy fjalorëve zbulojmë se te zërat e mëdhenj të letërsisë shqipe, përveç Çajupit, De Radës, N. Frashërit, Migjenit dhe Nolit shtohet edhe Agolli, Fishta dhe Kadare. Te gjinitë e mëdha të letërsisë shqipe përveç poezisë në Fjalorin e 1985, në 2008-2009 shtohet edhe dramaturgjia, dposi i kreshnikëve, kritika letrare, letërsia satirike, përkthimet dhe romani. Rryma më e madhe e letërsisë shqipe mbetet realizmi. Ndërsa zërat e mesëm të letërsisë shqipe në Fjalorin Enciklopedik të vitit 2008-9 janë: Injac Zamputi; Jakov Xoxa; Jani Vreto; Pashko Vasa; tregimi; Kasëm Trebeshina; Dhimitër Shuteriqi; Skënderbeu në letërsinë botërore; rryma letrare e bejtexhinjve; romantizmi shqiptar; Ibrahim Rugova; Rexhep Qosja; Arshi Pipa; Anton Pashku; Ali Podrimja; Esad Mekuli; Metrika; Sejfulla Malëshova; Skënder Luarasi; lirika popullore; libri; letërsia për fëmijë; kreshnikët (të vetmit heronj protagonistë që futen në enciklopedi); Shtjefen Gjeçovi; Luigj Gurakuqi; folklori; folkloristika; estetika; Martin Camaj; Asdreni; Fatos Arapi.

Dija dhe interpretimi i letërsisë

Asnjë vepër e letërsisë shqipe nuk është zë i madh në asnjërin prej fjalorëve enciklopedikë shqiptarë, vetëm një vepër e literaturës shqipe është zë i mesëm në fjalorin e 1985: "Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë", por edhe ky zë, i joshur prej pjesës së fundit të titullit të veprës, nuk është më i pranishëm në fjalorin e vitit 2009; rryma më e rëndësishme (e madhe) e letërsisë shqipe mbetet realizmi, të dhëna këto që lidhen statistikisht me përqindjet fare të vogla të letërsisë shqipe në botën shqiptare, por kryesisht me mënyrën e interpretimit të letërsisë me kritere kryesisht jashtë letrare.

Pasqyrë e mbizotërimit të kritereve jashtëletrare në të shkruarit mbi letërsinë janë pothuaj të gjithë zërat në Fjalorin enciklopedik të vitit 1995 dhe një pjesë e mirë e zërave të fjalorit të vitit 2008-9, po mjaftohemi me disa shembuj: Fishta është zë më i madh i letërsisë shqipe se Mjeda, sipas cilave kritere? Migjeni e Noli janë zëra më të mëdhenj të letërsisë shqipe se Poradeci, apo Koliqi, apo Kuteli - sipas cilave kritere? Agolli është zë më i

madh i letërsisë shqipe se Camaj apo Pashku - sipas cilave kritere? Kriteret herë kanë dukën historike e herë gjeografike, herë politike, herë sociale, por pothuaj gjithmonë ideologjike. Në fjalorët enciklopedikë shqiptarë, megjithëse janë fjalorë gjeneralistë, dija, informacioni dhe interpretimi i letërsisë shpesh ka peshën dhe vendin që i kanë dhënë letërsisë interpretuesit ideologjikë në botën shqiptare (a thua se nuk mjaftonte dy apo katër përqindëshi që zë ajo si sasi brenda fjalorëve) dhe një ligjërim që priret drejt jashtëletrares edhe kur shfaqet me terma kinse letrarë.

Duke u përpjekur t'i afrohemi "lexuesit model" të fjalorëve enciklopedikë shqiptarë mund të lexojmë:

Te zëri i MIGJENIT në Fjalorin e vitit 1985 – "Krijimtaria e tij la gjurmë të dukshme në letrarët e rinj të kohës. Me mohimin e shoqërisë çifligaro-borgjeze dhe aspiratën e fortë për një të ardhme më të mirë për masat e popullit, M. pati ndikim të ndjeshëm në rrethet e rinisë përparimtare; me veprat e tij ndihmoi në formimin shpirtëror të saj".[1]

Dhe tek zëri MIGJENI në vitin 2008 shkruhet: – "Krijimtaria e tij luajti një rol të madh reformues e risues në letërsinë shqiptare; ajo ishte pamja më e shënjuar e takimit të saj me zhvillimet moderne të letërsisë evropiane. Kjo është një nga arsyet që ajo është botuar në disa gjuhë"[2]

Ky pohim nuk është aq ekskuziv në FESH 2008 kur shkruhet tek zëri i KOLIQIT – "Koliqi, bashkërealizoi tok me L. Poradecin, M. Kutelin e Migjenin, në fillim të viteve '30 kthesën e letërsisë shqipe drejt modernes"[3].

Interpretimi ideologjik njeh kulme te zëri i KUTELIT në fjalorin e 1985 ku shkruhet: "Vendin kryesor në tregimet e M. K. e zënë përfaqësuesit e vegjëlisë që luftojnë për mbrojtjen e nderit dhe të vendit nga lakmitë e pushtuesve dhe të bejlerëve... M. K. krijoi një tip të veçantë të tregimit shqiptar, që i afrohet mënyrës së rrëfimit popullor, me mgjyresa romantike... me një farë poetizimi të tepruar të së kaluarës".[4]

Prania e të njëjtit lloj ligjërimi në Fjalorin e vitit 2008 në zërin KU-

[1] Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, FESH 1985, f. 703.
[2] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, FESH 2008, f. 1710.
[3] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, FESH 2008, f. 1211.
[4] Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, FESH 1985, f. 584.

TELI merr këto trajta: "Tema mbizotëruese e prozës së M. Kutelit është ajo sociale patriotike. ...Vendin kryesor në prozën e M. K. e zënë përfaqësuesit e vegjëlisë së fshatit e të qytetit që luftojnë për mbrojtjen e tokës dhe të nderit... Proza e M. K është realiste që të kujton realizmin magjik, me personazhe gjysmë reale, gjysmë fantastike, përshkruar nga një humor i vetvetijshëm dhe i mbrujtur sipas modelit të ligjërimit popullor me gjuhë të gjallë e të larmishme"[5].

Një dukuri krejt të veçantë përbën trajtimi i metodës së realizmit socialist, sidomos në Fjalorin e vitit 2008-9. Është më e saktë të flasim për mostrajtim në kësaj metode që ka dominuar letërsinë shqipe për gjysmë shekulli në Shqipëri, a thua nuk ka ekzistuar kurrë, a thua nuk kanë ekzistuar shkrimtarët që e kanë zbatuar, kritikët që e kanë lëvduar, lexuarit që e kanë lexuar ose jo. Në Fajalorin enciklopedik shqiptar botuar me tre vëllime në vitet 2008-2009 nuk ka asnjë përkufizim për realizmin socialist. Është zhdukur si zë më vete, po kemi këtë shpjegim se si erdhi në letërsinë shqipe "Fryma romantike (dhe këtu romantike nuk është kundërvënie por zgjatim i realizmit – qoftë dhe atij socialist) e disa prej poezive të P. Markos, S. Malëshovës, A. Varfit, dhe më pas të Shefqet Musarajt, K. Jakovës, F. Gjatës etj, krijoi fillesat e një letërsie shumë të angazhuar, të cilat, siç rrodhën ngjarjet në Shqipëri, çuan në lindjen e realizmit socialsit. "(Cilat ngjarje?)" ... "Ndonëse me një vonesë relative, letërsia erdhi e u bë faktor ndikues në jetën shpirtërore të shoqërisë" ... "Realizmi socialist, megjithëse i inkurajuar prej vetë zhvillimeve objektive dhe subjektive në fund të LANÇ; megjithëse herë-herë i vetëzgjedhur prej krijuesish me bindje në epërsinë e tij u zhvillua për katër dekada si drejtim letrar i përcaktuar prej autoritetit të shtetit. Rreptësia e kanoneve të realizmit socialist ... shkruhet më tej... "Shkrimtarët mesatarë, sidomos gjetën tek realizmi socialist një zgjidhje komode për të shprehur vetveten. Ishin pikërisht këta shkrimtarë që dëshmuan kufizimet dhe karakterin propagandistik të disa prej parimeve më të rëndësishme të realizmit socialist"[6]. Nuk gjejmë një përkufizim të termit reealizëm socialist as tek zëri "poezia" ku shkruhet: "Në këtë kohë (vitet '50) u zhvillua edhe teorikisht koncepti i realizmit socialist". Tek zëri i "romanit" shfaqet

[5] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, FESH 2008, f. 1429.
[6] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, FESH 2008, f. 1479-80.

koncepti i dogmës – po nuk kuptohet kujt i referohet[7]. Por gjejmë këtë koment për një lloj poezie që iu kundërvu paksa poezisë së realizmit socialist: "P. e këtij brezi (i viteve '60) pasqyroi realitetin e një shoqërie në lëvizje dhe në kërkim të progresit e të idealit, por ndikimet kufizuese të parimeve të rrepta të realizmit socialist u shprehën më qartë se në prozë".

Për të kuptuar ç'ishte ky realizmi socialist duhet t'i kthehemi FESH 1985: "Heroi i ri, pasqyrimi i masave popullore si forcë vendimtare e historisë, partishmëria komuniste, karakteri kombëtar dhe fryma popullore janë tiparet karakteristike të letërsisë dhe të arteve tona të RS."[8]

Atëherë do ta kemi më të qartë edhe zërin e Dritëro Agollit në FESH 1985, ku shkruhet:

DRITËRO AGOLLI – "Poet, prozator dhe publicist, që nga viti 1973 kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve, anëtar i Komitetit Qendror të PPSh dhe deputet e kuvendit popullor. "Në vjerrshat dhe poemat e D. A. gjejnë shprehje ndjenjat dhe mendimet e njeriut të ri, patriotizmi dhe besnikëria ndaj idealeve revolucionare... Vepra e tij poetike më e shquar është *Nënë Shqipëri* (1975) ku krijohet figura e Atdheut socialist."[9]

Por do ta kemi më të qartë edhe zërin DRITËRO AGOLLI në FESH 2008 ku shkruhet– "Shkrimtar, publicist, veprimtar shoqëror, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë... Ka qenë deputet në Kuvendin popullor dhe në Kuvendin e Shqipërisë për disa legjislatura (1974-2005). "Ai është prurësi i poezisë së unit të fortë"... por pak më tutje. "Poezia e DA nuk e ndan të përgjithëshmen nga vetanakja, bën sintezën e kolektives me individualen". "Krijimtaria poetike e D. A. në thelbin e vet është liriko-epike, ndryshe nga ajo tradicionale që mbahej kryesisht në lavdinë epike" – ku lihet i paqartë termi poezi tradicionale.

Ndërsa kur flitet për prozën: "Shkrimtari arrin një shkallë të lartë lirie me "romanin brenda romanit" me "arkën e djallit" ku gjendet vepra e ndaluar. Ajo quhet "Shakaja e ndaluar" titull që të kujton romanin e njohur disident të M. Kunderës "Shakaja"[10].

---

[7] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, FESH 2008, f. 2259.
[8] Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, FESH 1985, f. 909-10.
[9] Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, FESH 1985, f. 4.
[10] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, FESH 2008, f. 17.

U përshkrua më lart në mënyrë të përmbledhur se mes dy fjalorëve ka ndryshime, qoftë edhe sasiore, por ka edhe zëra ku informacioni, dija dhe interpretimi mbetet i njëjtë (duke filluar nga pasaktësia në emër), e kam fjalën për zërin e mesëm të letërsisë shqipe: Ndre Mjedjen:

"Në poemën e njohur "Andrra e jetës" ...autori zbuloi tragjedinë e malësorëve të varfër, që rronin në zgrip të jetës, mjerimin dhe padijen e madhe ku ata ishin kredhur". Shkruhet në FESH 1985, por shkruhet saktësisht njësoj edhe në FESH 2008.

Si *"bashkëlexues model"* të letërsisë shqipe, ju ftoj të kërkojmë tiparet e mësipërme në këto vargje nga "Andrra e jetës":

Cice, shka ka sot
Trinka qi po priton m'u çue?
Zgjoje me dalë me mue,
me lëshue bag'tin' e vet.

- Bij', mos e prek, se njomja
tash a tue folë me Zojën;
len zan' e mos çil gojën
se e lumja Zojë t'bërtet.

Qe prifti, nanë, qe dajat
mbas tij, me qiri n'dorë;
katundca me malcorë
sa shpia nuk i xe.

- Rri, bij' se sonte Trinka
po shkon me bujtë te Zoja;
merri këto lule e çoja
së lumës dhunti për të.

Një lexues tjetër, ai i letërsisë shqipe kur pyet: A ka qenë ndonjëherë letërsia bosht i jetës së shqiptarëve? A ka shërbyer ndonjëherë ajo si mjet për të arritur tek e vërteta hyjnore e qenies? - nuk do të gjejë shumë përgjigje dhe as do të ftohet të kërkojë përgjigje në fjalorët enciklopedikë shqiptarë.

Ardian MARASHI, Tiranë

PËRFAQËSIMI SHQIPTAR NË "ENCYCLOPÆDIA UNIVERSALIS" (2012)

KDU 001(092)(031) =18
929(4/9)(031) =18

Enciklopedia *Universalis* është padyshim një ndër referencat më autoritare në llojin e enciklopedive të përgjithshme. Ajo botohet në gjuhën frënge dhe i drejtohet kryesisht publikut francez, por hartohet në mënyrë të atillë që t'u përgjigjet kërkesave të një publiku të ftilluar universal dhe universalist. Tipari më i dallueshëm i kësaj enciklopedie është serioziteti me të cilin përzgjidhet ekipi i gjerë i autorëve hartues të zërave, si dhe kujdesi me të cilin punohet në aspektin redaksional dhe atë grafik. Nga koha kur doli vëllimi i parë i botimit të parë të saj, më 1968, *Universalis* është botuar periodikisht në format letër, gjithsej shtatë herë, me nga 20 vëllime në botimin e parë të plotë më 1975 dhe 30 vëllime në botimin e saj të fundit në format letër, më 2012. Ndërkaq, duke nisur nga viti 1995, kjo enciklopedi botohet çdo vit në format elektronik, e përditësuar me të rejat më të fundit, të karakterit shkencor po aq sa edhe të konceptimit grafik dhe elektronik.

Encyclopædia Universalis mëton të përmbajë të rejat botërore të shkencave e të dijeve, të cilat kanë marrë paraprakisht konfirmim të besueshëm në nivel akademik e shkencor. Për këtë arsye, *Universalis* shënohet jo vetëm si referencë kryesore në fushën e enciklopedisë, në rang botëror, por edhe si model i seriozitetit dhe i besueshmërisë. Misioni i saj është që t'u ofrojë lexuesve tërësinë e konfirmuar të dijeve dhe të informacionit, në ndërthurjen e tyre të natyrshme apo rastësore, duke bashkuar për këtë qëllim dijen *e integruar* për secilin zë të përfaqësuar në të: rrjeti tejet i përpunuar dhe i sofistikuar i referencave të tërthorta, që shërbejnë për ta ndriçuar artikullin dhe për të ndërlidhur në një rrjet kuptimplotë gjithçka që i shërben njohjes sa më të plotë për të, përbën pikën më të fortë të kësaj vepre monumentale.

Konkretisht, në edicionin e saj të fundit në letër, atë të vitit 2012, për

hartimin e *Encyclopædia Universalis* kanë punuar mbi 7.200 autorë, që janë ndër specialistët më në zë nga të gjitha fushat e dijes. Artikujt e tyre shoqërohen me mbi 25.000 dokumente ikonografike: fotografi, sekuenca filmike e video ilustruese; me mbi 9.000 skica, grafikë, tablo e vizatime; si dhe me një atlas interaktiv, ku përfshihen rreth 1.300 harta të tipave të ndryshëm. Në total, *Encyclopædia Universalis,* sipas të dhënave që ekipi i redaksisë jep për versionin e fundit të botuar në volum letër,[1] përmbledh 34.400 artikuj dhe 30.200 medie, në 30 vëllime. Në versionin elektronik, këtyre të dhënave u shtohet edhe një fjalor frëngjisht-frëngjisht i tipit të thelluar, me 120.000 hyrje.

Për vetë pozicionimin e kësaj vepre në bibliotekën e dijes botërore është me shumë interes të shihet se sa dhe si janë përfaqësuar në të shqiptarët, se ç'vend zë ky përfaqësim në tërësinë e artikujve të ngjashëm për vende e popuj të tjerë, si dhe çfarë realizimesh, po edhe çfarë mangësish, mund të vërehen lidhur me vlerat njohëse të informacionit për botën shqiptare që përçojnë artikujt e *Encyclopædia Universalis* tek lexuesi francez dhe ai botëror. Në shqyrtimin tonë do të ndalemi pikërisht në këtë problematikë, duke u fokusuar njëkohësisht në dy aspekte, në aspektin *informues* dhe në aspektin *vlerësues* të artikujve që bëjnë fjalë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga afër ose nga larg, për shqiptarët.

Fillimisht, le të shohim se ç'rezultate na sjell kërkimi tematik në edicionin e vitit 2012 të *Encyclopædia Universalis*.[2]

Zëri "Albanie", në kërkimin e thjeshtë tematik përfaqësohet me 46 hyrje në enciklopedi, prej të cilave 22 janë me lidhje të drejtpërdrejtë, të paraqitura vetëm për Shqipërinë, pra me kuptimësi ose përfaqësim maksimal. Këtu bëjnë pjesë edhe 8 medie, përkatësisht foto dhe harta, që ilustrojnë zërin kryesor "Albanie", kurse pjesa tjetër e zërave, 16 syresh, janë artikuj

[1] Në faqen zyrtare të internetit (www.universalis.fr), por edhe në shtyp, ekipi i redaksisë njofton se versioni i vitit 2012 është i fundit që do të botohet në vëllime letër. Botimi i parë i *Encyclopædia Universalis* nis në vitin 1968 dhe përfundon më 1975, në 20 vëllime. Deri më sot, përfshirë edhe versionin e fundit të vitit 2012, kjo enciklopedi është ribotuar shtatë herë, pa llogaritur versionin elektronik, i cili që nga viti 1995 e vijim botohet rregullisht çdo vit, i përditësuar me të rejat më të fundit.

[2] Meqenëse versioni elektronik ofron një hipertekst të përgjithësuar e të plotë për krejt enciklopedinë, kërkimet dhe shqyrtimet e pasqyruara në këtë artikull do të mbështeten në versionin elektronik të *Encyclopædia Universalis,* për t'u fokusuar në zërat-kyç: *Albanie / Albanais* dhe *Kosovo / Kosovar*.

sintetizues ose individualë, që lidhen nga afër a nga larg me Shqipërinë, prej të cilëve 3 nga afër dhe 13 nga larg ose nga shumë larg. Si artikuj individualë, me hyrje të veçantë dhe me lidhje të drejtpërdrejtë me Shqipërinë, gjejmë, në rend alfabetik, 14 zëra: Ali Pasha, Alia Ramiz, Arkeologjia shqiptare, Bektashizmi, Durrësi, Enver Hoxha, Epiri, Gegët, Kadare Ismail, Korça, Shehu Mehmet, Skënderbeu, Tirana, Zogu I. Mrekullisht, zëri "Mère Thérésa" figuron në ndërlidhje të drejtpërdrejtë hiperteksti me zërin "Albanie "dhe është shkruar nga Anne SEBBA, gazetare dhe biografe.[3] Së fundi, në një kërkim pa kritere në *indeksin* e enciklopedisë, emri "Albanie "përmendet gjithsej në 133 artikuj dhe medie.

Zëri kryesor, "Albanie", është një artikull sintezë prej 27 faqesh, për të cilin kanë punuar 4 autorë, respektivisht Anne-Marie Autissier dhe Edith Lhomel për pjesët *Hyrje* dhe *Historia e pasluftës,* Christian Gut për pjesën *Historia deri më 1945* dhe Odile Daniel për pjesët *Gjeografia* dhe *Letërsia.* Ndërkaq, zëri kryesor "Albanie" plotësohet, në formë përditësimi, me zëra të dedikuar shtesë, që janë: *Kronologji e viteve 1990-2008,* shkruar nga Redaksia; *Aktualiteti i vitit 2009,* shkruar nga Fabian Schmidt; dhe *Aktualiteti i vitit 2010,* nga po ky autor.

Kërkimi tematik për zërin-kyç "Albanais" i shton shumë pak zërit "Albanie", duke e drejtuar hipertekstin në pothuaj të njëjtit zëra si "Albanie", që shërben si zëri i referencës bazë. Përmendim këtu daljen e hyrjeve të reja me shumë kuptimësi dhe interes, që janë Marko Botzaris, Ibrahim Rugova, Angjelin Preljocaj, Shkupi, Shkolla e Venedikut, Arianët, Bill Klinton, Diaspora; por edhe: Mafia, të Drejtat e minoriteteve, Spastrimi etnik. Ndërkaq, nëse për zërin "Kadare", të ndërlidhur me "Albania", kemi një paraqitje të drejtpërdrejtë prej rreth 3 faqesh, të hartuar nga Jean-Paul Champseix, tek zëri "Albanais" gjejmë edhe si hyrje të veçantë analizën e romanit të Kadaresë "Muzgu i perëndive të stepës", nga Jacques Jouet.[4]

---

[3] Themi se zëri "Nënë Tereza" figuron *mrekullisht* në ndërlidhje të drejtpërdrejtë hiperteksti me zërin "Shqipëri", sepse shpesh, në enciklopeditë e ndryshme, ky zë ose figuron me Maqedoninë në lidhje të drejtpërdrejtë origjine, ose shkruhet nga autorë me origjinë sllave. Në enciklopedinë *Universalis* zëri "Nënë Tereza" ndërlidhet vetëm me zërin "Shqipëria" dhe s'ka lidhje të drejtpërdrejtë hiperteksti me zërin "Maqedonia".

[4] Nuk ka ndonjë arsye të dukshme që shpjegon pse romani "Muzgu i perëndive të stepës" veçohet për t'u trajtuar si zë më vete në këtë enciklopedi, përkundër romaneve të tjerë më të përmendur ose atyre më të fundit të autorit. Por duhet theksuar se kjo analizë figuron në dosjen e madhe të enci-

Fjala-kyç "Albanie", me artikullin sintezë prej 27 faqesh dhe me ndërlidhjet në hipertekst me 133 zëra të *Encyclopædia Universalis* themi se e përmbush relativisht bindshëm misionin enciklopedist për t'i dhënë lexuesit informacion bazë dhe njohje të përzgjedhura orientuese rreth Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Ndërkaq, fjala-kyç "Kosovo" (në krah të së cilës shënohen edhe grafitë 'Kossovo' dhe 'Kosovë') ka një paraqitje mjaft problematike, e cila lë për të dëshiruar qoftë për sa i takon aspektit të përfaqësimit, qoftë atij të hartimit e të redaktimit të zërit kryesor e të zërave përbërës.

Së pari, në kërkimin e orientuar tematik brenda enciklopedisë, sipas zinxhirit të propozuar nga vetë redaksia e kësaj enciklopedie, në ndërlidhjen: *Histori / Historia sipas zonave gjeografike dhe vendeve / Historia e Europës Qendrore dhe Lindore,* Kosova nuk figuron. Ndërkaq, përveç Shqipërisë e vendeve të tjera të rajonit në fjalë, në këtë lidhje rreshtohen Jugosllavia me gjashtë vende të dala nga copëtimi i saj (sipas shfaqjes në listë: Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Sllovenia).

Së dyti, tërheq vëmendjen fakti se, ndërsa zëri "Kosovo" ndërlidhet me zërin "Albanie" përmes indeksit tematik të drejtpërdrejtë, ky i fundit nuk propozon ndërlidhje të indeksuar me zërin "Kosovo", përpos ndërlidhjes që jep hiperteksti për tërësinë e zërave të enciklopedisë.

Së treti, çudia bëhet e madhe kur vëren se kërkimi për zërin-kyç "Kosolo" të nxjerr përpara një artikull me vetëm një faqe e gjysmë (kundrejt 27 faqeve, për shembull, që jepen për zërin-kyç "Albanie"). Nga ana tjetër, ilustrimet e paraqitura për zërin-kyç "Kosovo" nuk shënojnë asnjë simbol të Kosovës, as hartën, as flamurin dhe as stemën, sikurse ndodh me shtetet e me vendet e tjera.

Duket se redaksia e *Encyclopædia Universalis* e ka pasur më fort shqetësim që të tregohet "politikisht korrekt", sesa të plotësojë misionin e vet të rëndësishëm për të dhënë informacion dhe dije sintetike për zëra të mëdhenj, siç janë vendet dhe shtetet e ndryshëm të botës. Mirëpo duke privilegjuar qasjen politike kundrejt asaj shkencore, me zërin "Kosovo"

klopedisë, me titull "Biblioteka", ku janë përzgjedhur për analizë gjithsej 1000 vepra nga literatura e përbotshme e të gjitha kohëve.

redaksia e *Universalis* ka rënë në kundërshti dhe në pasaktësi bërtitëse, nëmos tendencioze.

Përmbajtja e zërit "Kosovo" befason qysh në hyrje, menjëherë në fjalinë e parë, ku njoftohet se Kosova, si territor, bën pjesë në Serbinë jugore (lexo : "territor i Europës jugore të Serbisë" [?!] – *territoire de l'Europe méridionale de la Serbie).* Në vijim, po në fjalinë e parë dhe në kontradiktë të plotë me veten, artikulli njofton se Kosova kufizohet me Serbinë, Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi.[5] Në fillim Kosova quhet "terri-

[5] Ja teksti i plotë në origjinalin frëngjisht i zërit "Kosovo":

Territoire de l'Europe méridionale de la Serbie, le Kosovo (Kosovo i Metohija ou Kosmet pour les Serbes, Kosovë en albanais) a des frontières communes avec la Serbie, l'Albanie, la Macédoine et le Monténégro. Sa population est de l'ordre de 2,2 millions d'habitants (2005), repartis sur 10 887 kilomètres carres et comprenant, pour s'en tenir a ses deux composantes principales, une très forte majorité d'Albanais et une minorité de Serbes. Sa capitale est Priština (env. 600 000 hab.). Possédant un relief montagneux, le Kosovo est constitue de deux bassins : le Kosovo proprement dit a l'est et la vaste plaine orientale de la Metohija. Les hivers sont rigoureux et neigeux, les étés torrides. Les richesses minières sont variées (plomb, zinc, nickel, lignite, bismuth, etc.).

L'exacerbation des antagonismes nationaux entre Serbes et Albanais a marque les années 1990 et 2000. Le Kosovo, en effet, représente un des centres historiques du peuple serbe, alors qu'il est peuplé majoritairement d'Albanais, qui voient en lui la terre de leurs ancêtres, les Illyriens. Pour les Serbes, le Kosmet représente le cœur de la Serbie médiévale, le foyer de l'orthodoxie, le lieu de la célèbre bataille de Kosovo Polje (le « champ des merles »,1389), qui marqua la victoire des Ottomans et entraîna la disparition de l'autonomie serbe. Les migrations serbes furent massives (XVIIe-XVIIIe s.). Avec la première guerre balkanique (1912-1913), le Kosovo est rattaché a la Serbie. Pendant la Seconde Guerre mondiale, il est annexé par la Grande Albanie, et une partie de la Metohija est occupée par la Bulgarie.

Au sein de l'ancienne Yougoslavie socialiste, le Kosovo a d'abord le statut de région autonome puis celui de province autonome. A partir de 1989 et sur l'initiative de Slobodan Milošević. (1941-2006), il perd les prérogatives que lui avait accordées la Constitution de 1974, retournant dans le giron serbe. Il fait donc partie intégrante de la république fédérale de Yougoslavie.

La situation des Albanais du Kosovo est catastrophique : en majorité, ils sont exclus du pouvoir, de la production, de la vie sociale normale. Le gouvernement serbe, appuyé par un important système policier, exerce une forte répression a l'encontre de la communauté albanaise (nombreuses arrestations et tortures).

Les idées irrédentistes et pannationales (Grande Serbie et Grande Albanie) sont présentes dans les deux camps. Les Albanais veulent l'indépendance du Kosovo, refusant l'autonomie simple, tout en promettant de garantir les droits culturels et nationaux des Serbes et des Monténégrins; mais, pour les Serbes, le Kosovo doit indiscutablement rester à la Serbie, et seule peut être négocié une certaine forme d'autonomie culturelle des Albanais. Des 1992, Belgrade a conçu un programme de colonisation de la province, pour installer 100 000 Serbes et Monténégrins au Kosovo afin d'en changer a moyen terme la structure nationale.

Parallèlement, les forces politiques s'organisent chez les Albanais, mais sont loin d'être épargnées par les scissions et les tensions internes, Le Parlement du Kosovo proclame dans la clandestinité, le 7 septembre 1990, la république du Kosovo, et des élections pluripartites législatives et présidentielle (non reconnues par le gouvernement yougoslave) ont lieu en mai 1992. Le président de cette nouvelle république (seulement reconnue par l'Albanie) est Ibrahim Rugova (1944-2006), président également de la Ligue démocratique du Kosovo (L.D.K.), principal parti politique. Les

tor" i Serbisë, kurse menjëherë në vijim njoftohet se territori i saj kufizohet me Serbinë (!). Se çfarë duhet të kuptojë nga kjo lexuesi, që Kosova është apo nuk është shtet a njësi politike e dallueshme, kjo nuk duket se i shqetëson fort autoren e zërit dhe ekipin e redaksisë. Përkundrazi, mënyra e të shprehurit brenda artikullit e vendos informacionin në një ekuivok të vazhdueshëm, aq sa as shqiptarët dhe as serbët nuk e kuptojnë dot se cila është situata e tyre "zyrtare" në raport me Kosovën. Në paragrafin e parë, shqiptarët quhen "shumicë" *(majorité),* mirëpo ky përcaktim e pengon lexuesin të konkludojë se Kosova është shqiptare. Në paragrafin e dytë, përdorimi i konektorit argumentues "në fakt" *(en effet)* fsheh një tendenciozitet në dobi të tezës serbe se Kosova qenka djepi historik i Serbisë *(Le Kosovo,* en effet, *représente un des centres historiques du peuple serbe)*; ndërkohë, fakti se Kosova ka qenë lashtësisht iliro-shqiptare, kreditohet nga autori vetëm si tezë shqiptare: "shqiptarët shohin në të tokën e stërgjyshërve të tyre, ilirëve" *(les Albanais voient en lui la terre de leurs ancêtres, les Illyriens)*. Po

autorités de Belgrade ne reconnaissent pas ces élections mais autorisent l'existence de la L.D.K. Les Albanais boycotteront les élections législatives de décembre 1992 et 1993 en Serbie.

Le choix de la résistance armée, préconisée dès 1992-1993 par l'Armée de libération du Kosovo (U.Ç.K.), prend peu à peu de l'ampleur. Discrète au début, l'U.Ç.K multiplie les attentats à partir de 1996 et décide de passer à l'offensive au début de 1998 afin de constituer des zones libérées. Les autorités serbes réagissent en fermant les frontières avec l'Albanie et la Macédoine pour éviter l'entrée d'armes au Kosovo. Les violents affrontements qui ont lieu en 1998 amènent les Occidentaux à proposer une solution négociée. En octobre 1998, un accord, obtenu sous la pression des États-Unis, entérine la mise en place d'un dispositif de surveillance du retrait des forces serbes sous le contrôle de l'Organisation pour la sécurité et la coopération en Europe (O.S.C.E.).

Officiellement accepté par Belgrade, cet accord suspend temporairement l'ultimatum lancé par l'O.T.A.N. Mais la mauvaise volonté manifestée par les Serbes à l'égard de l'O.S.C.E. et la poursuite des hostilités poussent le Groupe de contact sur l'ex-Yougoslavie à convoquer les Serbes et les Kosovars à des négociations avec obligation d'aboutir à un accord. Tenues à Rambouillet (février 1999) puis à Paris (mars 1999), celles-ci échouent, les Serbes rejetant finalement les dispositions d'un accord qui prévoit une autonomie substantielle pour le Kosovo et le déploiement d'une force multinationale dans la région. Le 24 mars 1999, l'O.T.A.N. décide de lancer des frappes aériennes contre des cibles serbes. Belgrade amplifie alors les opérations de nettoyage ethnique de la région; devant les violences perpétrées par les Serbes, les Albanais du Kosovo s'enfuient massivement, principalement vers l'Albanie et la Macédoine.

Au terme des affrontements, conclus par la résolution 1244 du Conseil de sécurité des Nations unies et les accords de paix de juin 1999, le Kosovo est placé sous administration de l'O.N.U. et les forces de l'O.T.A.N. sont chargées de se déployer. Relancées en 2005-2007 avec la mission confiée par l'ON.U. à l'ancien président finlandais Martti Ahtisaari, les négociations sur le statut du Kosovo entre Belgrade, soutenue par la Russie, et Priština, appuyée par la diplomatie européenne et par les États-Unis, resteront dans l'impasse. Le 17 février 2008, le Parlement kosovar proclame unilatéralement l'indépendance du Kosovo. La reconnaissance de celle-ci partage la communauté internationale, et l'Union européenne elle-même.

kështu, në fund të paragrafit të tretë, konektori "pra" *(donc),* shoqëruar me folje në kohën e tashme, kohë që në tipin e shkrimit enciklopedik shërben për të shprehur të vërteta të përhershme, duket sikur akrediton tezën se qenka e natyrshme që Kosova, si pjesë përbërëse e ish-RFJ, të jetë e integruar në Serbinë (*Il fait* donc *partie intégrante de la république fédérale de Yougoslavie)*. Në fund, duke shënuar se njohja e Kosovës ka krijuar ndarje në komunitetin ndërkombëtar e madje brenda vetë bashkësisë europiane, insistohet te kjo ndarje dhe te divergjencat politike, të cilat duket sikur e mbyllin çështjen, pa hapur perspektivë dhe pa sugjeruar zgjidhje.

Zëri "Kosovo" është hartuar nga autorja Catherine Lutard, e cila ka shkruar gjithashtu zërat "Serbi", "Jugosllavi" dhe "Vojvodinë". Siç konstatohet lehtësisht, në botimet e saj ajo shfaqet si specialiste e ish-Jugosllavisë, por aspak si njohëse e botës shqiptare. Serioziteti i një botimi monumental, siç është *Encyclopædia Universalis,* do të kërkonte, minimalisht, që për këtë zë problematik të punonin së paku dy bashkautorë, siç kanë punuar, fjala, vjen, 5 bashkautorë për zërin "Albanie".

Për fjalën-kyç "Kosovo" (përkatësisht "Kossovo" dhe "Kosovë") gjejmë gjithsej 35 hyrje të ndërlidhura, ndërkohë që kërkimi me fjalën-kyç "Kosovar" jep vetëm 4 hyrje, të cilat gjithsesi përfshihen në fjalën-kyç të referencës "Kosovo", pra nuk sjellin asnjë informacion të ri.

Nga 35 hyrje në enciklopedi për zërin "Kosovo", vetëm 11 janë me lidhje të drejtpërdrejtë, të paraqitura vetëm për Kosovën, pra me kuptimësi ose me përfaqësim maksimal. Në këto 11 hyrje, kemi 3 hyrje të veçanta kuptimplote, me artikuj, për zërat" Ibrahim Rugova", " LDK" dhe "UÇK", kurse 8 hyrjet e tjera janë të tipit medie (foto), që figurojnë të shpërndara si ilustrime për zëra të tjerë. Ndërkaq, 24 zëra lidhen nga afër ose nga larg e nga shumë larg me fjalën-kyç Kosova.

Nga sa u parashtrua, duket qartë se me vetëm rreth dy faqe tekst të dedikuar, zëri "Kosovo" nuk e arrin qëllimin për t'i dhënë lexuesit një sintezë njohurish të besueshme rreth kësaj njësie politike, gjeografike, historike e kulturore. Përkundrazi, në fund të konsultimit të këtij zëri lexuesi mbetet më i painformuar e madje më i çorientuar sesa nga leximi i një artikulli gazete të rëndomtë.

Si përfundim, mbas këtyre dëshmive që i shqyrtuam rast pas rasti,

kujtojmë se *Encyclopædia Universalis,* tani e lidhur ngushtë në drejtimin editorial dhe shkencor me një tjetër enciklopedi serioze, siç është *Enciklopedia Britanica,*[6] përbën tashmë një institucion. Si e tillë, për vetë karakterin universalizues që ia njeh vetes, kjo enciklopedi është e thirrur të luajë një rol të rëndësishëm në etapën moderne të globalizimit të dijeve dhe proceseve kulturore. Për t'ia arritur këtij pikësynimi, ekipi i redaksisë së *Encyclopædia Universalis* është e domosdoshme që ta rishikojë, për të mos thënë ta ndryshojë, metodën e vet të punës në përzgjedhjen e autorëve të disa zërave të rëndësishëm. Krahasuar me momentin historik kur u realizua botimi i parë i enciklopedisë, më 1975, pra në kulmin e luftës së ftohtë dhe të mbylljes hermetike të kufijve, sot, në kushtet e komunikimit global, është plotësisht e mundur që autorët të përzgjidhen në mënyrë më bindëse, më përfaqësuese dhe sigurisht më efektive. Autorët e zërave "Albanie" e bashkëpërkues, si dhe ata të zërave "Kosovo" e të bashkëlidhur, mund të përzgjidhen në të ardhmen nga radhët e specialistëve të Kosovës dhe të Shqipërisë, të cilët e njohin shumë më mirë objektin e kërkimit dhe janë plotësisht të përgjegjshëm në lidhje me seleksionimin e materialit dhe paraqitjen sintetike të tij. Enciklopedi nga më seriozet realizohen sot përmes koordinimit të punës nga faqet internet dhe të bashkëpunimit të redaktorëve apo autorëve në mediet elektronike.

Sigurisht, çdo ngrehinë e qëndrueshme është në vetvete pak a shumë konservatore, çka garanton besueshmërinë e publikut në atë çka ajo përfaqëson. Në rastin konkret, duke qenë se lexuesi pret nga *Encyclopædia Universalis,* prej njërit edicion në tjetrin, të njëjtin informacion falë të cilit botuesi ka fituar besimin e publikut, një informacion vazhdimisht të përditësuar, ekipi redaktorial i kësaj enciklopedie është në mënyrë të veçantë i ndjeshëm në këtë drejtim. Mirëpo, çka duket se ka funksionuar përgjithësisht mirë për zërin "Albanie", mund të themi se fatkeqësisht nuk ka funksionuar aq mirë për zërin "Kosovo". Sidoqoftë, *Encyclopædia Universalis* ribotohet tashmë e plotë dhe e përditësuar çdo vit, tërësisht në variant elektronik, çka jep shpresë se në edicionet e ardhshme mangësitë e botimit të vitit 2012 do të mund të përmirësohen ndjeshëm për zërin "Kosovo".

[6] Duke nisur nga korriku i vitit 2005, *Encyclopædia Britannica* ka marrë drejtimin editorial dhe shkencor të *Encyclopædia Universalis,* duke u bërë botuesi dhe pronari i saj ligjor.

Fatmir SULEJMANI (USHT), Tetovë

LETËRSIA SHQIPE NË ENCIKLOPEDINË MAQEDONASE

KDU 821.18(497.17):(031)

*

Enciklopeditë, që nga ideja fillestare e Aristotelit mbi to, që nga botimet e para të tyre në gjysmën e dytë të sh. XVIII[1], janë konceptuar si tekste të përpiluara për nevojat e edukimit të përgjithshëm, si libra që ofrojnë dije të gjithanshme bazike, të vërteta të sistemuara dhe të besueshme shkencore mbi personalitetet e shquara të fushave të ndryshme, mbi veprat dhe arritjet e njohura, ngjarjet dhe fenomenet e rëndësishme që lidhen me një vend të caktuar dhe jetën e gjithmbarshme të tij.

Megjithatë, enciklopeditë, jo përherë, janë në shërbim të dijes dhe të së mirës, veçmas në shtete etnishë në formim, popujsh të shtypur, të kompleksuar e të frustruar mohimesh, që shtrembërojnë të vërtetat historike dhe aktuale, duke i vënë ato në shërbim të politikës ditore dhe duke ua përshtatur ideologjive dhe politikave të papërgjegjshme.

Pikërisht kjo ndodh në Maqedoni, shtetin ku një të tretën e popullatës e përbëjnë shqiptarët, kundër qenësisë së të cilëve është ndërsyer një mekanizëm i tërë propagandistik, që, edhe përmes enciklopedive, synon djallëzimin e etnisë me të cilën bashkëjeton, etnisë së vetme që nuk merr pjesë me asgjë në mohimin shumëdimensional që ua bëjnë maqedonasve të tjerët. Përkundrazi: i pranon ashtu si duan ata, shpesh edhe në dëm të vetvetes.

*

Në shikim të parë, Enciklopedia maqedonase duket sikur nuk e ka lënë krejtësisht jashtë vëmendjes letërsinë shqipe. Ajo përfshin në total 27 zëra krijuesish shqiptarë, që nga Rexhep Voka e gjer tek brezi krijues i

[1] Enciklopedia e parë llogaritet ajo franceze, e përgatitur dhe botuar nga D. Didëro ndërmjet viteve 1751-1780. Më pas u botua dhe enciklopedia e njohur britanike, ajo italiane, amerikane, turke (kjo e fundit është vepër e rilindësit shqiptar Sami Frashërit).

viteve të '90[2]. Por e vërteta është se ajo vuan nga të meta serioze, kur është fjala për prezantimin e vlerave tona.

Në enciklopedi nuk janë përfaqësuar emra domethënës të letërsisë shqipe në Maqedoni, si: Haki Stërmilli (romansieri i hershëm nga këto troje…), Sadudin Gjura (poeti i talentuar që u eliminua në mënyrë tinzare dhe u la me muaj të tërë i pavarrosur në bjeshkët e Sharrit …), Mahmud Hysa e Agim Vinca (krijues e studiues të letërsisë…), Rahmi Tuda e Nuhi Vinca (studiues të folklorit shqiptar…), Halit Basha, Mustafa Laçi, Nexhat Pustina, Murtezan Arifi, Salajdin Salihi, Lulëzim Haziri (shkrimtarë e poetë të njohur…) dhe një numër i konsiderueshëm krijuesish të tjerë, që do të duhej të zënë vend në faqet e Enciklopedisë, duke pasur parasyshë kualitetet e zërave të përfshirë të etnive të tjera, si puna e krijuesve maqedonas, serbë e turq.

Ndryshe nga letërsitë tjera, letërsia shqipe që krijohet në Maqedoni është kundruar me dioptri shumë negative. Ajo është ndarë nga pjesa tjetër e letërsisë sonë dhe është vënë në kontekst të përgjithshëm të diabolizimit të shqiptarëve dhe të minimizimit të vlerave të krijuara prej tyre, me kujdesin që asgjë të mos dalë jashtë kornizës së paraparë për ta. Kështu, autorë eminentë si Murat Isaku e Abdylazis Islami janë barazvlerësuar për nga sasia dhe cilësia e të dhënave me krijues minorë të përkatësive të tjera etnike. Natyrisht, kjo nuk ndodh me kolegët maqedonas të brezit të tyre me arritje të parafërta, si Sllavko Janevski, Radovan Pavllovski e ndonjë tjetë.

Dëshminë e minimizimit të vlerave të letërsisë shqipe e kuptojmë edhe nga mënyra e trajtimit të arritjeve tona të shënuara në fushat e tjera të jetës. Bie fjala, në faqet e Enciklopedisë maqedonase, personalitete si Nëna Terezë, Ferid Murati e ndonjë tjetër… janë pa përkatësi etnike, kurse Leka i Madh, Jan Kukuzeli, figura të famshme historike e luftëtarë të dëgjuar arvanitas, në përkatësinë etnike të të cilëve mund të thirremi edhe ne, madje duke iu referuar librave të shumtë botërorë që i lidhin emrat e tyre me

[2] Zërat e letërsisë sonë të përfaqësuar në Enciklopedinë maqedonase janë: Rexhep Voka, Ali Aliu, Murat Isaku, Abdylazis Islami, Adem Gajtani, Hasan Kaleshi, Murteza Peza, Lutfi Rusi, Mehmedali Hoxha, Fejzi Bojku, Xhabir Ahmeti, Eqrem Basha, Nehas Sopaj, Resul Shabani, Asllan Selmani, Sejfedin Sulejmani, Mustafa Spahiu, Kalosh Celiku, Punëtorie Ziba - Muça, Vait Nasufi, Nexhmi Mehmeti, Kim Mehmeti, Shkëlzen Halimi, Shazim Mehmeti, Linditë Aliu, Linditë Ahmeti…

shqiptarët, janë dhënë me përkatësi etnike maqedonase; nuk ekziston asnjë zë për Qiriazët e famshëm, apo për Kumbarët, të shndërruar sot në Kirijazovskë e Kumbarovski…; asnjë e dhënë mbi trashëgiminë kulturore materiale të shqiptarëve; asnjë fjalë e vetme për shqiptarët ortodoksë të Rekës së Gostivarit, nga radhët e të cilëve kanë dalë akademikë, poetë, krijues, gazetarë, studiues të shquar …, që vetëm tani së fundmi kanë nisur ta pranojnë ndërdhëmbshëm të vërtetën e hidhur mbi asimilimin e tyre…; shtrembërohen të dhënat për kishat katolike e ortodokse dhe manastiret e teqetë bektashiane shqiptare, si Shën Naumi, Shën Nikolla[3], Jovan Bigorski[4], Harabati Baba[5]… dhe rolin e tyre në historinë shqiptare…; nuk thuhet asnjë fjalë për kullën e moçme shqiptare në oborin e parlamentit të Maqedonisë, ku thonë se ka banuar një kohë prijësi i luftëtarëve liridashës shqiptarë Isë Boletini; asnjë e dhënë për shtëpinë monumentale të Halim Beut apo të Xhafer Sulejmanit të Tetovës…; asnjë zë mbi kompleksin unikat të pashallarëve të Tetovës…; asnjë e dhënë për polifoninë shqiptare - brendin tonë të mbrojtur nga UNESKO-ja, që kultivohet me shekuj edhe në Prespë e Strugë; asgjë për muzikën karakteristike dyzëreshe kërçovare, ndërkohë që plasohet e dhëna për gjoja muzikë të tillë tek maqedonasit…; nuk përmenden fare disa prej mjeshtërve të këngës popullore shqiptare të viteve ’60, si Gonxhe Manaku (në dokumente zyrtare Manakovski); shtrembërohen të dhënat për personalitetet si kardiologu i famshëm Jusuf Rexhepi, apo mësuesi atdhetar Azem Morana; heshtet emri i ndritur i intelektualit dhe prefektit të parë të Tetovës - Shaip Kamberit, të vrarë në mënyrë barbare nga partizanët sllavë të 45-tës…; për ironi, nuk ka asnjë rresht të vetëm për

[3] Fjala është për një kishë katolike shqiptare në dalje të Tetovës për në fshatrat e Malësisë së Sharrit (rrugës për në Sellcë e Vicë…), të cilës, gjatë viteve të monizmit, iu ndryshua çatia, kurse para 10 vitesh, në oborrin e saj u ngrit një maket kishe ortodokse. Përndryshe, kambanën e kësaj kishe e ka sjellë nga Jemeni Haxhi Shaza nga Sellca për të nderuar vëllezërit e tij të krishterë, kurse, në vitin 1987, në hapësirat e saj, gazetari i RTVM Sefer Musliu zbuloi përkthimin e Biblës në shqip nga Konstandin Kristoforidhi. Por ç’e do, kur sot, më shumë se kurrë më parë dhe për shkak të injorancës shqiptare, janë krijuar kushte për ortodoksizimin e pjesëve shumë të vlevshme të kulturës materiale e shpirtërore të shqiptarëve të kësaj ane…

[4] Ka dyshime të bazuara se djegia e këtij manastiri që ndodhi para pak vitesh mund të ketë qenë e qëllimshme dhe është bërë për të zhdukur nga faqja e dheut të vërtetat mbi ndërtuesit dhe pronarët e vërtetë të manastirit dhe librat e shënimet e shumta që hidhnin dritë mbi to…

[5] Në Enciklopedinë maqedonase ka të dhëna për çdo gjë të vlefshme që i shkon në favoir kulturës maqedonase, po asgjë për vatrat e dikurshme të kulturës shqiptare - Teqetë bektashiane, si Harabai Baba në Tetovë, e cila, në kohën e lulëzimit të saj, ka pasur bibliotekë të pasur dhe krijues e poetë që kanë organizuar madje edhe gara poetike…

albanologun më të sipkatur të këtyre trevave - profesor Remzi Nesimin, ndërkohë që janë shkruar panegjirikë për tipa me CV shumë modeste profesionale; kur flitet për arsimimin e lartë shqip në Maqedoni ofrohet hapësira e duhur vetëm për personalitetin e Maks Van Der Shtulit (themeluesit të UEJL, Tetovë), po nuk përmendet fare profesor Fadil Sulejmani – themeluesi i Universitetit publik Shtetëror të Tetovës, që, pa dyshim, paraqet shpresën e rritës së shqiptarëve të mbetur në kufijtë e Maqedonisë etj. Relativizohet dhe tkurret maksimalisht edhe kryengritja e Dervish Carës (1873-1877), njëra ndër betejat më të përgjakshme antiosmane, me shtrirjen më të gjerë gjeografike dhe me afro 200.000 kryengritës shqiptarë. Shqiptarëve madje nuk u takojnë as faltoret e vjetra muslimane të ndërtuara me paratë dhe djersën e tyre, sepse edhe ato na qenkan të kohës otomane dhe për rrjedhojë më shumë të turqve sesa tonat… Me një fjalë, heshtet gjithçka shqiptare, sepse gjithçka e trashëguar dhe e ndodhur e bukur në të kaluarën duhet t'i takojë vetëm kombit të zgjedhur maqedonas. Heshtet gjithçka e vlefshme dhe e denjë për një enciklopedi serioze, sepse ashtu e do projekti antishqipatar i ASHAM (Akademia e Shnekcave dhe Arteve të Maqedonisë), që ka për qëllim bazë ishullzimin e letërsisë sonë dhe prezantimin e saj si letërsi të re dhe të patraditë, gjithsesi më të re dhe më pa themel se letërsia maqedonase; epërsinë racore e kulturore të maqedonasve ndaj shqiptarëve; mbjelljen e kompleksit të vlerës së ulët dhe të vetëdijes së shoqërisë ardhacake, me kulturë aksidentale e rastësore, me kontribute modeste dhe me prurje triviale…; imponimin e idesë së kulturës inferiore dhe pa të kaluar, të kulturës pa rrënjë dhe, për rrjedhojë, edhe pa të ardhme.

Enciklopedia, pra, është fundekrye në funksion të propagandës dhe krijimit të miteve të lavdisë për vetveten dhe miteve të djallëzimit të të tjerëve, fund-e-krye e sunduar nga tendencat zhvlerësuese të shqiptarëve, nga njëra anë dhe nga tendenca e ikonografizmit të maqedonasve nga ana tjetër. Thjesht është një përrallë mitologjike e një etnie në formim, një etnie diskutabile për të gjithë fqinjët e saj, përveç shqiptarëve, të cilët, në vend se të respektohen për këtë gjest, që kapërcen kufijtë e naivitetit, përçmohen në vazhdimësi, gjë që vjen si pasojë e kompleksit që zakonisht ka i përbuzuri që kërkon ta shfryejë hakërrimin mbi më të dobëtit se vetja.

*

Hilja e bërë ndaj letërsisë shqipe që kriojohet në Maqedoni, minimizimi kuantitativ dhe kualitativ i saj, vërehet edhe nga krahasimi i sipërfaqshëm me mënyrën e përfaqësimit të letërsisë turke, të prezantuar me 34 zëra, kundrejt 27 zërave të krijuesve shqiptarë.

Letërsia turke, ndryshe nga ajo shqiptare, është një dhe e tërë. Ajo e ka pjesën themel të saj, sepse aty janë dhe shumë autorë të vjetër, si udhëpërshkruesi i famshëm Evlija Çelebi (1611-1688), bashkë me poetë të tjerë të sh. XV - XVI, si: Isak Çelebi (1493–1537), Çakdede Jusuf (1546…?), Zaifi, Uskubi Atai, Husamedin Mulla (1552 …?), Hasan Qatib, Efendi Vejsi (1561-1628), Çelebi Ashik (1518-1572), Faik Bej (1825 – 1898), Tefim Selaniklli (1860-1910), Beatli Qemal Jahja (1884-1958)…

Shtrohet pyetja: A është e drejtë kjo kur të kihet parasyshë numri pakrahasimisht më i madh i popullatës shqiptare në raport me atë turke të këtij vendi? Përse ky favor ndaj letërsisë së pakicës turke në Maqedoni, që, dorën në zemër, ka arritur të japë vetëm disa emra krijuesish modestë letrarë? Përse ky favor dhe mbitheksim i traditës dhe arritjeve të letërsisë turke e serbe në raport me letërsinë shqipe? Si është e mundur që në kontekst të letërsisë turke të përmenden aq poetë të kohës osmane e të heshtet emri i Pjetër Bogdanit që në këto vise shërbeu si prift, madje bëri dhe një betejë antiosmane me mbi 8000 luftëtarë, duke rënë dhe viktimë e përpjekjeve çlirimtare? A nuk pati vend të paktën për 2-3 emra rilindësish shqiptarë, që, në kohëra kur disa letërsi fqinje ishin bërë pjesë e politikave të luftërave shfarrosëse dhe nxitësit e tyre, mbillnin farën e mirëkuptimit dhe dashurisë ndaj tjetrit?

*

Megjithatë, edhe përkundër të gjitha të metave, përkundër gjithë injorimeve të bëra ndaj letërsisë dhe kulturës shqiptare, duhet ta pranojmë sërish se Enciklopedia maqedonase, ka bërë më shumë dhe ka qenë shumëfish më e kujdesshshme ndaj vlerave të trashëgimisë shpirtërore e materiale të shqiptarëve të Maqedonisë në raport me tekstet enciklopedike të publikuara gjer më sot në shtetin amë.

Për paradoks, në *"Fjalorin enciklopedik"* të botuar në Tiranë në vitin 2002, nuk përmenden madje as emrat e dy krijuesve të njohur nga ish republika e vogël jugosllave - Murat Isakut e Abdylazis Islamit, lëre më ato

të shkrimtarëve dhe poetëve të mirënjohur të brezave të mëvonshëm, si: Xhabir Ahmeti, Murtezan Arifi, Kim Mehmeti, Linditë Ahmeti, Salajdin Salihi, Lulëzim Haziri, Shazim Mehmeti...

Fatkeqësisht, më shumë se për shkaqe objektive (pamundësi njohjeje, mungesë komunikimesh normale brendashqiptare të vlerave estetike, mungesë reale vlerash të krijuara nga shqiptarët e Maqedonisë…), fjala është për prirjen tonë separatiste brendashqiptare dhe për injorim të qëllimshëm dhe mendjemadhësi qendrash kulturore, që, në mungesë kaçiku për matje e garime serioze me vlerat e kryeqendrave ballkanike e evropiane, marrin veten mësyshë duke u shit karshillëk provincave dhe skajeve të robëruara të atdheut që i kanë paguar tagrin më të rëndë historisë sonë fatkeqe.

Deri më sot përjashtimin pozitiv e bën vetëm teksti me natyrë enciklopedike *"KOSOVA - vështrim monografik"*, i botuar më 2011 nga AShAK, e cila e ka trajtuar si pjesë të veten letërsinë e krijuar nga shqiptarët e Maqedonisë. Mbase për shkak të prishjes së traditës injoruese, u duk i kuptueshëm mllefi i atyre që e sulmuan ashpër përpiluesin e kapitullit të letërsisë të veprës në fjalë, prof. Ali Aliun, koncepti i të cilit për letërsinë shqipe, si një e vetme dhe e pandashme, është shembull i mirë që duhet ndjekur prej të gjithëve.

*

Në fund fare, mund të konstatojmë: enciklopeditë zakonisht nuk janë në funksion të propagandës dhe krijimit të miteve të lavdisë për vetveten dhe miteve të demonizimit të të tjerëve. Por Enciklopedia e parë e Maqedonisë së pavarur, për të cilën është folur e shkruar aq shumë që ditën e daljes së saj në qarkullim, nuk e trajton në mënyrë të drejtë letërsinë shqipe, veprat dhe autorët më të njohur, arritjet dhe sukseset më të mira të saj. Në dallim prej letërsive të tjera, ajo jona tkurret qëllimshëm, duke u kundruar krejtësisht e shkëputur nga ëma e saj e natyrshme. Ajo mohon unitetin e letërsisë shqipe, e gjymton atë përmes prezantimesh shkel e shko, i minimizon vlerat e dëshmuara, përmes hapësirash të pamjaftueshme të zërave të prezantuar dhe mënyrës së prezantimit të letërsisë shqipe të këtyre hapësirave si të ishte e huaj dhe sikur nuk ka të bëjë me letërsinë e një pjese shumë të madhe të popullatës së Maqedonisë së sotme.

S'do mend se prapavija e Enciklopedisë është imponimi i tezës për shqiptarët e egër dhe ardhacakë në këto territore. Ajo është në vijën e mashtrimeve të pseudohistorisë serbe, e cila, sado në kontekst negativ, shqiptarët i përmend, kurse maqedonasit nuk i bën "beli" fare. I kësaj vije është dhe stili i tejdukshëm mashtrues i përpiluesve të Enciklopedisë, që ditkan gjithçka për shqiptarët "ardhacakë" dhe të vendosur nëpër vendbanimet sllave, ndërkohë që nuk japin asnjë detaj për kolonët serbë të vendosur pikërisht nëpër vendbanimet shqiptare pas vitit 1912, as për popullatën e ashtuquajtur EGEJE të cilën e sollën nga të katër anët e botës për ta vendosur e sistemuar me të gjitha të mirat (me banesa, me shtëpi, me vende të favorshme pune…), në qytetet shqiptare të Maqedonisë Perëndimore, të njohura si vendbanime me dendësi më të madhe popullate në Ballkan e më gjerë.

Megjithatë, duke pasur parasyshë tendencat e hapura antishqiptare të klasës politike dhe asaj akademike e intelektuale të Maqedonisë së sotme, gjithë ajo që shkruhet e thuhet për shqiptarët është e pritshme. Së këndejmi, më e dhimbshme rezulton të jetë ajo që ndodh me tekstet enciklopedike shqiptare dhe injorimin që ato ia bëjnë në vazhdimësi kulturës së një pjese të madhe të kombit të mbetur pa të drejtë nën pushtetet e të tjerëve.

Floresha DADO, Tiranë

LETËRSIA NË BOTIMET ENCIKLOPEDIKE: ÇËSHTJE PËRZGJEDHJEJE APO METODOLOGJI E VLERËSIMIT HISTORIKO-ESTETIK?

KDU 821.18
03=18

Duke u mbështetur vetëm në tri vepra: "Fjalori enciklopedik shqiptar", ASh RPSSh, Tiranë 1985; "Historia e letërsisë botërore", Rilindja, Prishtinë 1985, Vëllimi 2; dhe "Fjalori Enciklopedik Shqiptar", Tiranë 2008 (botim i ripunuar), mendoj se problematika e pasqyrimit të letërsisë në botime enciklopedike, përqendrohet në dy boshte themelore: në *aspektet praktike***,** që kanë të bëjnë me vërejtjet mbi:

- përzgjedhjen e autorëve dhe dukurive letrare;
- me saktësinë e përcaktimit të llojit të zërit (të madh, të mesëm apo të vogël) për autorët e ripërfshirë, ose të futur rishtazi;
- me korrigjimin e raporteve jo të drejta midis autorëve;
- me krijimin e zërave të rinj apo heqjen e ndonjë zëri të panevojshëm;
- me shmangien e subjektivizmit në përzgjedhje dhe në vlerësim;
- me korrigjimin e faktit që jo rrallë hartuesit e zërave nuk janë specialisë të mirëfilltë mbi autorin apo dukurinë letrare;
- me plotësimin e zërave të konceptuar varfërisht, ose çeshtjeve të pastabilizuara në interpretimin shkencor (si letërsia. arbëreshe);
- mbi nevojën e ndryshimit apo plotësimit të hierarkisë së vlerave, si pasojë e zbulimit të dorëshkrimeve të veprave të reja, etj.

Probleme të kësaj natyre, por edhe të tjera, ka shumë. Në botimet e 1985-ës janë në përmasa alarmante. Por vizioni i sotëm i shkencës sonë letrare nuk mund të mbetet thjesht dhe vetëm në konstatimet e problematikës komplekse, për të cilat jemi të gjithë dakort. Prandaj them se boshti i dytë, themelori në temën e tryezës së sotme, ka të bëjë me *metodologjinë e konceptimit të pasqyrimit* të letërsisë në këto lloj botimesh. Duke

pasur parasysh këtë lloj botimi, *fjalor i përgjithshëm kombëtar,* ku dukuria letrare vendoset sipas vlerësimit historiko-estetik, çeshtja kapërcen thjesht kriterin e zgjedhjes dhe vlerësimit të saj dhe i përfshin pashmangshmërisht hartuesit në një varg diskutimesh të karakterit metodologjik.

Së pari, problem themelor është përcaktimi i *raportit informim / vlerësim estetik*. Në një fjalor enciklopedik cili aspekt duhet të jetë në plan të parë: njohja e fenomenit, autorit, si fakt historiko-letrare, apo identifikimi i tablosë së specifikave artistike? Ka zëra të mëdhenj ku mbizotëron analiza prej specialisti mbi tiparet stilore-poetike, në dallim nga disa zëra, përsëri të mëdhenj, që konceptohen më shumë si informacion për një dukuri letrare (let. për fëmijë).

Së dyti: prezantimi i letërsisë në botimet enciklopedike nxjerr problemin e *unifikimit të konceptimit strukturor* të zërave. Përgjithësisht, pjesa e parë (jeta, formimi dhe aktiviteti jashtletrar, etj.) është e strukturuar sipas të njëjtit parim; problemet lindin kur vjen momenti i prezantimit të krijimtarisë letrare. Diskontinuiteti në strukturën e brendshme të disa zërave na vë para çeshtjes: a duhet një strukturë e unifikuar, apo ajo mund të jetë edhe e variueshme, sipas specifikave të autorëve të ndryshëm?

Së treti: sipas cilit kriter duhet konceptuar një zë *i mesëm* apo i *vogël*? (sepse zëri i madh është më i lehtë.). Domethënë: cila duhet të jetë *dominanca përcaktuese*: prezantimi si krijues i mirëfilltë, apo si personalitet me kontribut në jetën politike-kulturore (pa mohuar vlerësimin e të dyjave)? Kjo lidhet edhe me çeshtjen se a do të mbizotërojë, në *llojin e zërit*, kriteri i sasisë së krijimtarisë, apo pesha e dukurisë letrare (edhe nëse kjo krijimtari është e pakët)? Në këtë aspekt, mendoj se kufiri midis zërit të mesëm dhe të vogël është më problematiku.

Së katërti: zërat përgjithësues të mëdhenj, që merren me fenomene të periudhave, drejtimeve letrare, a duhen karakterizua (sado pak) edhe në *plan krahasimtar* me letërsitë fqinje, ballkanike dhe më gjerë evropiane, kur dihet se pjesa më e madhe e krijuesve të traditës letrare zhvilluan aktivitetin e tyre krijues ose në vende të tjera, ose nën ndikimin e autorëve evropianë? Nga ana tjetër, për autorë që shënojnë hope cilësore në zhvillimin letrar, a mund të shtrihet ky parim krahasimtar, sado shkurt, edhe me autorë paraardhës dhe

bashkëkohorë shqiptarë, sigurisht pa tejkaluar caqet e një fjalori enciklopedik?

Së pesti: problematika metodologjike shfaqet edhe në *respektimin e specifikës* së një fenomeni përgjithësues, p.sh romantizmi shqiptar, apo tipologjia e gjinive letrare, në raport me dukuri që i përkasin një nënlloji letrar, apo patosi të krijimit (siç ka ndodhur me zërin 'letërsia satirike'). Një konfuzion i tillë shpreh mosrespektimin e kufijve të strukturës emocionale-tipologjike në kategorinë e gjinive, llojeve dhe nënllojeve letrare.

Së gjashti: botimi enciklopedik nxjerr edhe një çeshtje tjetër metodologjike: qartësinë e raportit midis qasjes ndaj fenomenit letrar si **historian i letërsisë, apo si kritik letrar.** Nëse themi të dyja, vështirësia vjen, megjithatë, në kombinimin praktik, kur dihet se këto dy qasje kanë specifikat e veta. Problemin e vërteton, p.sh., zëri mbi *kritikën letrare*, me varfëri dhe pasaktësi të palejueshme. Saktësia e kësaj marrëdhënieje do t'i jepte përgjigje çështjes, që përmenda më parë mbi kriterin e dominancës historiko-estetike, apo thjesht estetike? Nëse kritiku e interpreton veprën si *strukturë të realizuar*, si një konfiguracion të qëndrueshëm, ndërsa historiani e shikon strukturën poetike në *lëvizje konstante*, atëhere është e domosdoshme të kuptohet thelbi i këtij dallimi. Marrëdhënia midis sensit historik të kritikut dhe sensit kritik të historianit të letërsisë bëhet më të komplikuara në një botim enciklopedik. Mosvlerëimi i thelbit të dallimit midis kritikës letrare dhe historisë së letërsisë, ka sjellë shpesh kritere vetiake në hartimin e zërave dhe sidomos përzierje kriteresh në interpretimin e autorëve dhe veprave letrare.

Së shtati: Si mund të realizohet marrëdhënia e brendshme midis makrosistemit (letërsia shqiptare) dhe mikrosistemit (vepra, dukuria letrare)? Ndonëse zërat janë të shpërndarë, a është e domosdoshme të ndjehet filli i lidhjes midis tyre? Ky parim i brendshëm, që sigurisht kërkon mjeshtëri në realizimin e plotë, shkencërisht ndihmon njohjen e hierarkisë së vërtetë artistike.

Së teti: Problem shumë i rëndësishëm është vëmendja ndaj respektimit të kufijve të letërsisë, kur dihet se në tekste të ndryshëm janë konsideruar vepra letrare edhe të tilla që realisht qëndrojnë jashtë sistemit letrar. Në një fjalor enciklopedik, ku përfshihen monumente të kulturës së gjithë

shekujve (15, 16), është e nevojshme të diferencohet lloji i tyre dhe prezantimi *si letërsi* të respektojë tiparin thelbësor të saj, si art i fjalës.

* * *

Pasqyrimi i strukturës së plotë të letërsisë sonë, në një botim enciklopedik, mund të realizohet vetëm në një *Enciklopedi të letërsisë shqiptare*. Padyshim, është koha të mendohet për një projekt të tillë madhor, i cili, gjithashtu, na përball me kompleksitet problemesh, sa të karakterit metodologjik, aq edhe të aftësisë së realizimit praktik.

Megjithatë, kam bindjen e plotë se realizimi i një enciklopedie të letërsisë shqiptare nuk mund të jetë i suksesshëm pa një histori të re, të rikonceptuar, të letërsisë. Dhe nëse sot ne konstatojmë një varg problemesh në botimet enciklopedike, ato, në thelb, reflektojnë dobësitë e *Historisë së Letërsisë*, e cila ka nxjerrë probleme metodologjike të sistemimit të gjithë procesit historiko-letrar. Problemi nuk është thjesht korrigjimi në përfshirjen e autorëve, vendosja e raportit të drejtë midis letërsisë dhe realitetit historik, apo midis qasjes historiko-kontekstuale dhe qasjes sipas strukturave të brendshme poetike, etj., por janë disa çështje themelore, që shënojnë realizimin e një shkence të vërtetë. Metodologjia ndërton marrëdhënien midis letërsisë dhe interpretuesit të saj. P.sh. është i rëndësishëm të kuptohet parimi se marrëdhëniet midis një modeli poetik dhe gjithë sistemit të letërsisë janë një nga kushtet për vazhdimësinë e të dyjave. Apo se evolucioni letrar sigurisht realizohet brenda sistemit, por njëkohësisht edhe në marrëdhëniet e letërsisë me sisteme të tjera: social, historik, ideologjik, etj. Apo njohja e faktit se teoria e formacionit estetik na orienton për ta parë një fazë të zhvillimit letrar sa në aspektin historik, aq edhe përmes tipologjizimit të formacioneve estetike. Dy aspektet e studimit të letërsisë sonë: i *gjenezës* dhe i *specifikës* së sistemit letrar, përbëjnë boshtet e konceptimit të historisë së letërsisë. Në trajtimet e deritanishme ka mbizotëruar prerja historiko-diakronike, por në të vërtetë, dimensioni i vështrimit diakronik ka një përmasë më të gjerë se sa thjesht ndërtimi i një serie kronologjike veprash, të cilat kanë vlerën e paraqitjes historike të letërsisë sonë. Në kryqëzim me këtë rrafsh prerja sinkronike ndihmon që të zbulohen strukturat e reja letrare, që shpërthejnë letërsinë në një moment të caktuar. Por nga ana tjetër dihet se sinkronizmi i pastër është tashmë një iluzion; çdo sistem për-

mban të kaluarën dhe të ardhmen e tij, që janë aspekte strukturorë të pandashëm. Nëse çdo sistem është një evolucion, ky evolucion ka, në mënyrë të pashmangshme, edhe një karakter sistemik.

Këto janë *shumë, shumë pak*, nga zgjidhja e çeshtjeve që do të realizonte një *Histori letërsie* me konceptime të reja, çka do të ndikonte drejtpërdrejtë edhe në zgjidhjen e disa problemeve të botimeve enciklopedike. Vetëm mbi këtë bazë do të garantohej suksesi edhe i *Fjalorit Enciklopedik të Letërsisë Shqiptare*, kur dihet se një fjalor enciklopedik strukturohet në mënyrë sa të 'çuditshme', të 'ngatërruar', jashtë respektimit të rendit historik, etj. Renditja alfabetike, në një farë kuptimi, të fut në kurth, provokon zbehjen e vazhdimësisë logjike të dukurisë letrare, midis morisë së zërave nga fusha të ndryshme. Në daljen, me sukses, prej kësaj 'xhungle' mund të ndihmojë vetëm Historia e Letërsisë.

Kemi të bëjmë, pra, me dy projekte të mëdha, realizimi i të cilëve është i lidhur me njeri tjetrin: hartimi i një *Enciklopedie të Letërsisë Shqiptare* dhe rikonceptimi i vendosjes së letërsisë në *Fjalorin Enciklopedik Shqiptar*. E them këtë, sepse mendoj se në sheullin XXI shkenca jonë duhet të synojë jo më botime të zakonshme, që, sado më pak, mund të reflektojnë përsëri disa nga dobësitë e deritanishme, por të hartojë enciklopedi elitare, në kuptimin më shkencor të strukturës dhe nivelit të paraqitjes së sistemit tonë letrar.

Bashkim KUÇUKU, Tiranë

PAK E NJOHUR PËRTEJ VETES

KDU 821.18
03=133.1

Letërsia shqipe në tekste enciklopedikë francezë

Në botën e sotme të ndërkomunikimit të madh, njëkohësisht të pohimit dhe të përhapjes së kulturave pak, ose, aspak të njohura, mes të cilave, për një sërë arsyesh dhe rrethanash, fatkeqësisht ka mbetur e tillë edhe kultura dhe letërsia shqipe, njohja e tyre, në Europë dhe në botë, është pohim i identitetit shqiptar, i gjenisë së tij krijuese, i qytetërimit dhe i integritetit të lirisë së vet.

Duke ndjekur, herë pas here mbi njëzet vjet disa lloje tekstesh enciklopedikë francezë, vërehet një tërësi problemesh, mangësi e dobësi, kryesisht, pasojë e paaftësisë së institucioneve shkencore shqiptare, e, në radhë të parë, të Akademive dhe të Universiteteve, që nuk e kanë përcjellë letërsinë në mënyra të ndryshme përtej kufijve politikë dhe gjuhësorë.

Për disa dhjetëvjeçarë, deri nga fillimvitet 1980, kanë pasur vetëm Naim Frashërin dhe Gjergj Fishtën. Më pas, vjen një periudhë tjetër, që hiqet Gjergj Fishta, dhe, nuk përfshihet as Ismail Kadareja.

Të dhëna

1. "Encyclopaedia Universalis/ Enciklopedia Universalis", 1985-1988[1], në të cilën flitet më gjerësisht për çdo letërsi, kështu, edhe për letërsinë shqipe, ka këta shkrimtarë: Jeronim De Rada, Gavril Dara, Migjeni, Naim Frashëri, Lasgush Poradeci, Haki Stërmilli. Përmenden, gjithashtu, emrat e Ali Abdihoxhës, Dhimitër Shuteriqit, Fatmir Gjatës, si dhe i Mehmet Shehut, autor kujtimesh. Mirëpo nuk është përfshirë më Gjergj Fishta, kuptohet, me ndërhyrjen e censurës dhe, as Ismail Kadareja, megjithëse, deri më 1988, vepra e tij ishte përkthyer afërsisht në tridhjetë gjuhë dhe për të cilën në gjuhë të Europës dhe të Amerikës ishin botuar

[1] Encyclopaedia Universalis, 1985-1988.

qindra artikuj e studime. Pra, 6 autorë dhe 4 emra të tjerë, gjithsej 10.

2. Në "Histoire de la littérature européenne/ Histori e letërsisë europiane"[2], nën drejtimin e Annick Benoit-Dusausoy, Guy Fontaine, 1992, me mbi 1000 faqe, gjithashtu, edhe enciklopedi shumë e pasur e krejt letërsisë së kontinentit, që nga lashtësia deri sot, sendërtuar prej një ekipi të njëqind e pesëdhjetë universiteteve nga e gjithë Europa gjeografike, me përjashtim të Shqipërisë, letërsia shqipe nuk përmendet fare, as si emër. Edhe Ismail Kadareja është përfshirë si autor europian i njohur, në kapitullin "Figura bashkëkohore", bashkë me Sioranin, Umberto Ekon, Maks Frishin, Peter Handken, Shejmës Hinin, Danilo Kishin, Milan Kunderën, Hoze Saramagon, Klod Simonin.

3. Një hap më përpara, më afër njëmendësisë është "Le Petit Robert, Dictionnaire Universel des Noms Propres/ Roberi i Vogël, Fjalor Universal i Emrave të Përveçëm", 1994[3], në të cilin janë: Gjergj Fishta, Naim Frashëri, Ismail Kadare, Faik Konica, Migjeni, Fan Noli, me një fjalë, 6 autorë përfaqësues.

Teksti për ta po citohet i plotë, me gjithë pasaktësitë, sepse është i njëllojtë edhe tek "Le Petit Robert des Noms Propres/ Roberi i Vogël i Emrave të Përveçëm", 2003[4], me përjashtim, se, në këtë të fundit, është shtuar De Rada, madje, janë në të njëtat faqe në të dy botimet.

FISHTA (Gegë Tosca, i quajtur At Gjergj).

Poet dhe politikan shqiptar (Fishtë, Zadrimë, 1871-Shkodër, 1940). Me prejardhje nga mjedisi katolik i Veriut të Shqipërisë, ai mori pjesë në lëvizjen për çlirim kombëtar, që, sipas tij, kalonte nëpërmjet një konsensusi për gjuhën dhe alfabetin (Kongresi i Manastirit 1908). Në poemat e tij të përmbledhura me titullin "Lahuta e Malcís" (1937) rrëfehet historia e popullit shqiptar në luftën për pavarësinë e tij; ai themeloi gjithashtu revistën "Hylli i dritës"[5].

[2] Histoire de la littérature européenne, sous la direction d'Annick Benoit-Dusausoy, Guy Fontaine, Hachette Éducation, 1992.
[3] Le Petit Robert, Dictionnaire Universel des Noms Propres, 1994.
[4] Le Petit Robert des Noms Propres, 2003.
[5] Le Petit Robert "Dictionnaire Universel des Noms Propres", 1994, faqe 737.

FRASHËRI (Naim, i quajtur D. Keto). Shkrimtar shqiptar (Frashër, 1846 - Kizilltoprak, afër Stambollit, 1900). Rridhte prej një familjeje myslimane fisnike të Jugut të Shqipërisë, shumë e zjarrtë në luftën për çlirim (vëllezërit e tij Abdyl dhe Sami u shquan me veprimin e tyre politik), ai punoi për të lartësuar ndjenjën kombëtare në diasporën e shumtë shqiptare dhe filloi të shkruajë në shqip pas krijimit të Lidhjes së Prizrenit. Ai kompozoi një poemë të famshme epike për vendlindjen, "Epopeja e Qerbelasë" (1898), poezi të shumta lirike midis të cilave "Lulet e verës" dhe një epope historike "Histori e Skënderbeut" (1898)[6].

KADARE (Ismail). Shkrimtar shqiptar (Gjirokastër, 1936). Pas studimeve për letërsi, të kryera në Moskë, ai kaloi në gazetari prej së cilës hoqi dorë pas daljes së romanit "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" (1963); ai pati privilegjin e dykuptimshëm, të bëhet një autor i njohur në qendër të njërit prej regjimeve më të tmerrshme komuniste. Romanet e tij rrëfejnë historinë e vendit të vet ("Kronikë në gur", 1970; "Dosja H", 1989 si dhe marrëdhëniet serbo-shqiptare në Kosovë ("Viti i mbrapshtë", "Krushqit janë të ngrirë"). Ai përshkruan, gjithashtu, botën mbytëse të diktaturës nëpërmjet lojës së metaforës ("Pallati i ëndrrave", 1981;"Piramida"), por herë-herë edhe në referim të qartë me totalitarizmin e Enver Hoxhës ("Dimri i madh", 1973; "Koncerti", 1988). Ai shkroi edhe ese estetike ("Eskili, ky humbës i madh") apo politike ("Pranverë shqiptare", 1991), shkruar pasi mori strehim politik në Francë[7].

KONIKA (Faik). Shkrimtar shqiptar (Konika, në Epirin grek 1875 - Boston 1943 (2)). Ai bëri, përbri Fan Nolit, një karierë diplomatike dhe gazetarie; themeloi "Albanian", gazetë nacionaliste, botuar në Bruksel, pastaj "Diellin", organ i Shoqatës së shqiptarëve të Amerikës. Shkrimet e tij satirike, veçanërisht "Doktor Gjilpëra" (1924) e bënë atë popullor, por toni me të cilin fshikulloi anët e dobëta të bashkatdhetarëve ("Nën hijen e hurmave") 1924, u përdor për t'u ndaluar në vendin e vet pas Luftës së Dytë Botërore[8].

MIGJENI (i quajtur Millosh Gjergj Nikolla). Shkrimtar shqiptar

[6] Po aty, faqe 779.
[7] Po aty, 1102.
[8] Po aty, faqe 1139.

(Shkodër, 1911-Torre Teliçe [Peliçe] afër Torinos, 1938). Me tone të afshit fetar, ai i këndoi, në dialektin geg, shpirtit luftarak të popullit të tij ("Vargjet e lira", 1936); ai shkroi gjithashtu tregime të shkurtra ("Novela të qytetit të Veriut")[9].

NOLI (Fan). Shkrimtar, politikan dhe prelat shqiptar (Ibrik - Tepe, afër Adrianopolit, 1882 - Fort Loderdal, Florida, 1965). I mërguar në Nju-Jork më 1906, rivjen në Shqipëri dhe bëhet hieratik i Kishës Ortodokse të Shqipërisë, të cilën arriti ta kthejë në Kishë Autoqefale më 1922. Kryetar i një qeverie demokratike, ai u përmbys më 1924 prej Ahmet Zogut të cilin e fshikulloi tek "Kënga e Salep Sulltanit". Ai shkroi drama ("Izraelitë dhe Filistinë", 1902) dhe sidomos poezi me tema biblike[10].

4. Në "Dictionnaire des auteurs européens/Fjalor i autorëve europianë", 1995, është vetëm Ismail Kadareja me biografi, shënime për veprat dhe vepra referuese për të[11].

5. Në "Le Petit Robert des Noms Propres/Roberi i Vogël i Emrave të Përveçëm", 2003, janë: De Rada, Gjergj Fishta, Naim Frashëri, Ismail Kadare, Faik Konica, Migjeni, Fan Noli, 7 autorë. De Rada, i shtuar në këtë tekst, me formulimin më të saktë, ka mundësi të jetë marrrë nga ndonjë enciklopedi italiane, e përgatitur nga studiues arbëreshë[12].

6. "Encyclopédie de la littérature/ Enciklopedi e letërsisë", "Garzanti", 2003[13], meqenëse është enciklopedi e letërsisë botërore, pra, e shtrirë në krejt rruzullin, jo vetëm e autorëve, por edhe e dukurive letrare, ka tre autorë, gjithsesi, përfaqësues: Gjergj Fishta, Ismail Kadare, Migjeni.

Probleme

Përfaqësimi i pamjaftueshëm.

Në ta mungojnë disa emra përfaqësues të rëndësishëm të traditës: Ndre Mjeda, Ernest Koliqi, Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli, etj. Po

[9] Po aty, faqe 1386.
[10] Po aty, faqe 1496.
[11] Dictionnaire des auteurs européens, sous la direction de A. Benoit-Dusausoy, G. Fontaine, Hachette Éducation, 1995.
[12] Le Petit Robert des Noms Propres, 2003.
[13] Encyclopédie de la littérature, "Garzanti", 2003.

ashtu, nuk ka asnjë prej autorëve që kanë jetuar dhe shkruar në Kosovë, ndonëse, Ali Podrimja, p.sh., është përkthyer në 17 gjuhë të tjera, dhe në frëngjisht, me dy botime.

Përzgjedhja është e rastit, ose, subjektive, nga mungesa e teksteve të këtij lloji në gjuhë të huaja.

Sot e kësaj dite nuk është botuar ndonjë Fjalor enciklopedik letrar, as i Përgjithshëm, as ndonjë Histori e letërsisë shqipe në gjuhë të huaj, që mund t'ju ofrojë të dhënat, veç një teksti për letërsinë shqipe të realizmit socialist para 30-40 vjetësh.

Në vitet e lirisë së mendimit, krahasuar me vitet e mëparshme, të censurës, del, se autorët në kohën e afërt janë më të pakët. Para viteve 1990 ishin 6 autorë, zë më vete, dhe katër emra të tjerë tek zëri letërsia shqipe. Në vitet 1990 janë 6 autorë, dhe, në vitet 2000, 7 autorë, me gjithë hapjen e plotë të Shqipërisë, si dhe të Kosovës me botën.

Pasaktësi të dhënash, disa herë deri në të kundërtat e tyre.

Tek zëri Naim Frashëri, shkruhet: "Ai kompozoi një poemë të famshme epike për vendlindjen, "Epopeja e Qerbelasë" (1898). "Poema e tij për vendlindjen, sikurse dihet, është lirike, "Bagëti e bujqësi", dhe jo "Qerbelaja", që nuk ka lidhje fare me vendlindjen e poetit.

Tek zëri Migjeni, shkruhet: "Me nota/ tone të afshit (zell i madh) fetar, ai i këndoi, në dialektin geg, shpirtit luftarak të popullit të tij." ("Avec des accents (theks, ton, tingëllim) de ferveur religieuse, il chanta, en dialecte guègue, la combativité de son peuple. "Migjeni nuk i këndoi shpirtit luftarak të popullit të tij, përkundrazi, e paraqiti ironikisht me hiperbolë bjerrjen e tij deri në degjenerim. Gjithashtu, jo me tonet e afshit/theksit fetar, por me tone të rrepta kundërfetare.

Zgjidhja është përgatitja dhe botimi i Enciklopedisë Shqiptare, qoftë e përgjithshme, qoftë vetëm e letërsisë, fillimisht në anglisht, dhe, me kohë, edhe në gjuhë të tjera parësore të Europës. Edhe më e rëndësishme është lidhja e institucioneve shqiptare me gjegjëset e tyre në vendet e tjerë europianë, sidomos pjesëmarrja në projektet për botimin e enciklopedive, historive të letërsisë, si dhe të teksteve të tjerë të këtij lloji në të cilët nuk ka pse mos të jetë edhe letërsia shqipe, natyrisht, e detyruar/imponuar prej institucioneve shqiptare.

Përfundimi: Në Paris, Londër, Berlin, Romë e gjetkë, sikurse dihet, vërshojnë botime për kulturën, historinë, letërsinë e identiteteve më të ndryshëm, edhe në gjuhët kryesore të kontinentit. Mjafton të ndërmenden "Panairet e librit", ku, bie fjala, edhe Mali i Zi paraqitet me botime të këtij lloji në gjuhë të huaj, madje, me botime luksoze, ndërsa, Shqipëria nuk e ka patur deri tani vullnetin dhe aftësinë, për të mos thënë se ende nuk i bie ndërmend të paraqitet, veç personaliteteve të veçantë të paraqitur prej të huajve.

Ne, për të huajt, jemi aq dhe ashtu siç na njohin ata, dhe jo siç mund të jemi në të vërtetë, dhe as si do të dëshironim të na njihnin. Ata, për aq sa na njohin, dhe ashtu siç na njohin na paraqesin në botimet, në kulturën e tyre, dhe, po mbi bazën e saj, krijojnë marrëdhëniet me ne: të barazisë e të nderimit të merituar, të respektit të natyrshëm a të mirësjelljes keqardhëse, të nënvleftësimit a të superioritetit ndaj "varfanjakëve provincialë." Në sytë e të tjerëve njëmendësisht dukemi "varfanjakë shpirtërorë dhe provincialë", kur nuk jemi të tillë, së paku, në historinë dhe në gjeninë krijuese shpirtërore. Letërsia e varfëruar dhe e cunguar, para botës, është portreti, identiteti, intelekti, shpirti dhe kultura, qytetërimi ynë i varfëruar dhe i cunguar. Ajo, që e ka thyer e para "karikaturën" tonë në vështrimin europian, do të mund ta copëtonte atë për të na paraqitur dinjitozë në tryezën e madhe të letërsisë.

Kujtim M. SHALA, Prishtinë

LETËRSI E ENCIKLOPEDI

KDU 82:03

I LETËRSI E ENCIKLOPEDI: TEORIA E PËRFAQËSIMIT

Enciklopedia, për nga struktura e funksioni, shenjohet si diskurs universal, që mat tërësitë dhe lakon përfaqësimin, në trajtë epokash, fenomenesh, personazhesh etj., nën emërtimin *zë*. Ajo jep *zëra* të diferencuar e të lidhur së bashku në një *polifoni*, nën disa regjistra.

Diskurset për enciklopeditë nënvizojnë se në Romën e vjetër "encyclopedia" shenjonte një *qark të zënies* së dijeve që njiheshin si të domosdoshme për edukimin, ndërsa pas Rilindjes kapte gjithë çfarë mund të thuhej në mënyrë të lidhur për botën. Vërtet, kështu shenjohet natyra antropologjike e enciklopedisë, meqë antropologjia do të kapë përnjëherë kulmet e civilizmeve, si sjelljet e rëndomta në jetën humane.

Etimologjia e përdorimi i hershëm, ashtu dhe tradita e vjetër apo e re, e shenjojnë enciklopedinë si vepër të dijes bazë, që nis me evidenca, kalon nëpër sistematikë e arrin te sistemimet e mëdha, për të marrë e dhënë shenjat e Librit të librave.

Një libër për të gjitha e për të gjithë, i shkruar me saktësi informuese, që do të përfaqësojë e të kthejë te dijet si burim i parë (i tij).[1]

***

Diskursi i enciklopedisë, në radhë të parë, përqendrohet te *kategori* që përcaktohen si *themelore* dhe këtu hapet paradoksi i tërësores bazike (enciklopedikes) që shenjon *njësitë*. Por vetë enciklopedia e provon se *njësitë* janë kategori që *përfaqësojnë*, ndaj lakmojnë të universalizohen. Të përshkruara si njësi historike, ato përfaqësojnë epoka, klasë veprimtarësh e

[1] *Enciklopedia e përgjithshme e Oxfordit*, Instituti i Dialogut & Komunikimit, Tiranë, 2006; *Collins World Encyclopedia*, Collins, Glasgow, 2005; *World of Knowledge Encyclopedia*, Gallery Press, Leicester, 1985; *Encyclopedia of Social and Cultural Anthropology*, Routledge, London & New York, 2007; *International Encyclopedia Linguistics*, Oxford University Press, Oxford, 2003; *Fjalor enciklopedik*, Shtëpia Botuese Bacchus, Tiranë, 2002.

veprimtari. Kategoritë shtrihen përtej vetes, ndërsa enciklopedia, së paku, *zërat e parë* (të lartë) i jep si nyja të mendimit e të veprimit human.

Nën shenjat e tilla të përfaqësimit mund të hapet edhe raporti i letërsisë me enciklopedinë: e para *e përfaqësuar* (kategori, *zë*), e dyta si *përfaqësim* (diskurs i dytë). Por ky raport është shumë më i ndërliqshëm, meqë *e përfaqësuara* e *përfaqësimi* përherë dalin si diskurse të shtrira në dy shkallë: *fiksion* e *fiksim verbal* (evidencë). Vërtet, loja e tillë shtrihet edhe ndërmjet letërsisë e kritikës letrare, por ndërmjet tyre raporti është ekzistencial: s'ka kritikë letrare pa letërsi; ndërsa, ndërmjet enciklopedisë e letërsisë ka raport përfaqësimi, me shkallë tjetër determinimi ndërmjet diskurseve.

E hapur kështu dhe me këto shenja, teoria e përfaqësimit ngadalë çon te një epistemologji nistore, e cila lakmon e lakon fuqinë e përfaqësimit të diskursit. Meqë enciklopeditë janë diskurse evidentuese e përgjithësuese, grumbuj të lidhur informacionesh, bibliografi *zërash*, më parë se të hapemi në epistemologji, duhet të kthehemi te një *pragmatikë e kritikës*, për ta përshkruar funksionin e enciklopedisë në raport me letërsinë.

Diskursi i enciklopedive (letrare) lidhet në evidenca e piketa, me fuqi të vogël komentimi, por me një fushë të shënueshme sugjerimesh. Ky diskurs është me rrënjë në format për përdorim, që përherë duan të jenë përfaqësuese. I lakuar në doracakë, tek enciklopedia diskursi çlirohet nga vlerësimet e hapura dhe krijon pamje përfaqësuese, që lidhen edhe me kategori të tjera të dijes e të jetës, si rëndësia, funksioni etj. Por vetë zgjedhja është vlerësim dhe këtu hapet çështja se sa përfaqësojnë zgjedhjet.

Do t'i kthehemi kësaj pike.

II VEPRA LETRARE

(Intertekstualitet e enciklopedizëm)

Moderniteti e shenjoi veprën e hapur letrare, veprën si rrjet tekstesh (intertekst/ualitet), ndërsa teoria e kritika moderne i provuan e lexuan edhe veprat klasike si *ontos*-e intertekstuale. Koncepti i intertekstualitetit zgjerohet në thurjen e në leximin e Librit si një bibliotekë, shenjë kjo e enciklopedikes dhe e universales. Por një diferencim duhet, interteksti është *gjendje*, ndërsa enciklopedia një *zgjedhje tematike*, madje një *zhanër*.

S'ka tekst pa intertekst, tashmë një formulë, hap fuqishëm paradigmat e teorisë së intertekstualitetit, të nisur si kërkim i gjenezës së veprës letrare në vepra të tjera e në *diskursin letrar* (abstrakt), të lakuar si dialog diskursesh (dialogjizmi) e të rikthyer tek autori, që shtrihet e lexohet si diskurs autobiografik me status interteksti brenda vetë veprës së tij. Gjithë kjo e shenjon vetëdijen se *në një tekst* ndodhen *tekstet*, se vepra është *rrjet* dhe se pret të hapet për t'i zgjidhur nyjat e për t'i ndjekur fijet e rrjetit.

Enciklopedizmin letrar si *tendencë* e mendojmë edhe si një produkt të modernitetit, të lojës me format dhe të përballjes me ideologjitë e mëdha. Në ndryshim nga intertekstualiteti, që është një gjendje, enciklopedizmi është vetëdije e zgjedhje.

Por vetë enciklopedizmi letrar është intertekstual dhe këtu, nga diferencimi intertekstualitet/ enciklopedizëm, kalojmë te raporti ndërmjet tyre. Shenjat e dijeve enciklopedike në veprën letrare, informacionet për epokat, kontekstet, personat e shënuar, teoritë, filozofitë etj., bëhen diskurse që lidhen në rrjetin intertekstual enciklopedik të veprës.

Në raportin e tillë, zgjedhja/ enciklopedizmi i brendashkruhet gjendjes/ intertekstualitetit dhe vepra bëhet thurimë që lidh fragmente, copa, diskurse, rrëfime, dije, *jehona* të largëta apo *zëra* të afërt. Por enciklopedizmi i nënshtrohet fiksionit letrar, për t'u bërë vetë vetëm njëri prej diskurseve në rrjetin e fiksionit (intertekstual).

Vepra letrare e shenjës së enciklopedizmit hapet për dy farë lexuesish përnjëherë: në shtresën semantike, që shtron fushën e gjerë të kuptimeve, e në shtresën semiotike, që lidh diskurset e manifeston strategjitë tekstore. Paradoksalisht, shtresimi semiotik e hap atë enciklopedik, ashtu siç hapen dyert e mbyllura me kode. Strategjia e tekstit, kështu, na çon te *strategjia e kuptimit*, siç gjuha/sistemi shenjues çon te rrjeti i të shenjuarve/ kuptimet.

Kështu provohet se enciklopedizmi s'është një shtojcë e tekstit, por një esencë e shkallës që do duhej të shenjonte fenomen, i cili lidh shkrimtarët *enciklopedistë* përtej një vendi e kohe. Ndoshta, këta shkrimtarë do të tingëllonin si *zëra të lartë* edhe në enciklopeditë letrare.

Tashmë do duhej të kalonim tek estetika dhe te filozofia e letërsisë, apo te dëshmitë e leximit, të lidhura në tradita shkrimi për letërsinë, për ta

provuar se si letërsia jep *njohje* dhe se si enciklopedizmi, përmjet evidencash si *jehona*, çon te burimet si *esenca*.

III PËRZGJEDHJE E PËRFAQËSIM

Përzgjedhja është sjellje klasike në kërkimet dhe në diskurset për letërsinë, e shpallur qoftë ose jo. Por te rasti i enciklopedisë, ajo përbën një problem klasik, meqë enciklopedia do të përfaqësojë në shtrirje të gjera, sado që bazike, ndërsa letërsia kërkon të diferencohet nga jashtë e brenda vetes, ashtu që të veçojë vepra e autorë, që do të thotë *individualitete*.

Enciklopeditë kanë rrëshqitur përskaj përzgjedhjeve letrare, drejt përzgjedhjeve me parabazë sociale, që lidhen me *autoritete* letrare me ndikime në jetën sociale e politike të vendeve dhe të epokave, në jetën e përbashkët. Autoritetet shtrihen gjerë dhe i eklipsojnë individualitet. Ilustrativ është kërkimi i Poetit nacional si Hero kulture dhe refuzimi i poetit personal, pa ndikim në veprimin dhe në jetën nacionale. Enciklopedia shpejt e ndoshta lehtë(sisht) e *zgjedh* Poetin-hero, përballë poetit të mbytur në dhimbjet e veta. Se çfarë vlen më shumë, temat nacionale a dhimbjet personale, enciklopedia e kritika letrare japin përgjigje të ndryshme, për ta provuar se *zgjedhin* ndryshe. Enciklopeditë kështu shenjojnë zgjedhje dhe bëhen përfaqësime të gjasmuara letrare.

Por enciklopeditë nisen për të përfaqësuar nën shenjën e një neutraliteti, që përqendrohet te diskursi evidentues, dhe e provojnë utopinë e përfaqësime neutrale, pa zgjedhje e pa motivimet me burim interpretimet. Vetëdija e përzgjedhjes enciklopedinë letrare e mban brenda natyrës së diskurseve për letërsinë kur kalohet në dije për përzgjedhjen. Jo për ta mbyllur diskursin në përfaqësime, por për ta hapur pakufi në zgjedhje.

IV LETËRSI NË ENCIKLOPEDI

Letërsia në enciklopeditë e përgjithshme apo në fjalorët enciklopedikë është një *kategori* e lidhur në rrjetin e gjerë të *zërave bibliografikë*. Është e vështirë që letërsia të shenjojë vende e kohë të zgjedhura në enciklopeditë e përgjithshme, meqë ato shkojnë drejt një përfaqësimi të dijeve apo sociales, të fenomeneve e autoriteteve, që, më parë se me estetikat, lidhen me etikat e me politikat.

Po letërsia shqipe si të përfaqësohet, në/nga cilët *zëra*: si fenomene, autorë, vepra, si sektor i lidhur me institucionet, nga botuesit, bibliotekat, tek akademitë, të gjitha së bashku? Të ndiqet historia letrare e shenjuar dhe e shënuar nga poetika, fenomene e vepra, apo portretet e autorëve të jenë *zërat* e saj të parë përfaqësues?

Këto pyetje të zgjeruara e hapin së pari dilemën për raportin e letërsisë shqipe me diskursin e enciklopedisë, që është universal, më tej dilemat për metodën e përshkrimit dhe kjo, përfundimisht, çon te pyetja e madhe se si të lexohet letërsia shqipe.

Një çelës e japin kërkimet e Ibrahim Rugovës, dijetarit që e lexonte një epokë përmjet Bogdanit. Metoda e Rugovës e ka brenda përfaqësimin dhe, vetiu, Bogdanin e bën *zë të madh* në historinë letrare shqipe. Kjo metodë lejon më shumë se një *zë* për epokë, ashtu që të përfaqësojnë së bashku De Rada e Naimi, por rrezikohet në modernitet, kur autorët bëhen individualitete e përfaqësojnë sensibilitete që s'nënkuptohen. Në këtë pikë ndodhë kapërcimi nga përfaqësimi te diversiteti i *zërave*. Favori i kësaj metode, lidhur me enciklopedinë, është sistematika, disfavori, paradoksalisht, përqendrimi i saj i madh.

Edhe *zërat* e lidhur me autorë përbëjnë zgjidhje klasike në një enciklopedi, por kjo e hap dilemën e *zërave të mëdhenj*, *të mesëm* etj., për ta çuar përfaqësimin te vlerësimet.

Letërsia shqipe, e lidhur në portrete të mëdha, si *zëra të mëdhenj* biobliografikë, në një enciklopedi shqiptare e më tej, do të përfaqësohej nga autorë të rëndësishëm, përcaktim ky që ka brenda dhe shenjat e vlerësimit. Kështu, vetë letërsia e bën të pamundur kapërcimin e vlerësimeve qoftë dhe në faqet e një enciklopedie.

Portretet e tilla, nga vepra e veprimi i një autori, zgjerohen në përfaqësime poetikash apo epokash, ashtu që portretet e lidhura të shenjojnë një sistematikë letrare (të pashpallur).

Është në natyrën e fenomeneve që të përfaqësojnë edhe autorë e vepra, të lidhura në poetika e në epoka. Kështu, poetikat bëhen *zëra* të gjerë/përfshirës dhe i nënkuptojnë zërat e veçantë.

Një *enciklopedi e letërsisë shqipe* e rihap çështjen, meqë përcaktohet si *letrare* dhe përnjëherë i vë faqet e enciklopedisë përballë letërsisë. Një

vepër e tillë lidh evidencat për autorë, vepra e fenomene dhe jep shenjat e mëdha të *procesit letrar*, ashtu si dhe të një aksiologjie letrare të pashpallur. Nëse letërsia me natyrën e vet i vë në krizë parimet e një enciklopedie, enciklopedia letrare (sektoriale) përcaktohet nga kushtet që *i thotë* vetë letërsia. Enciklopedia letrare bëhet një vepër letrare, ashtu siç janë të kësaj natyre të gjitha *diskurset e dyta* me objekt letërsinë.

Ndoshta, në këtë pikë do duhej të ndaleshim për të pushuar, apo për të mos u nisur më, me vetëdijen se letërsia vetë prodhon paradokse të sojit që një esencë e zgjedhur të mbajë larg klasë të tëra, sikur për ta provuar se përballë saj shtrihen jo *përfaqësimet*, por *zgjedhjet*, që do të thotë *vlerësimet*.

Ymer ÇIRAKU, Tiranë

LETËRSIA SHQIPE SI **DIVERSITET** STILISTIK DHE KLASIFIKIMI (INTERPRETIMI) **KOHEZIV** I SAJ (RASTI I LETËRSISË ARBËRESHE)

KDU 821.18.09
821.18'282.4(450).09

Çdo letërsi e ka të pranishëm diversitetin stilistik, që vjen nga fakti i njohur se atë e realizojnë individualisht dhe për pasojë, origjinalisht, një radhë krijuesish. Letërsia shqipe e ka të potencuar veçmas këtë diskurs diversiteti stilistik, edhe për shkak ndikimesh prej rrethanash ekstraletrare. Kujtojmë se kanë funksionuar njëkohshëm letërsia në Shqipërinë politike, ajo në trojet etnike - jashtë kufijve të saj, në diasporën e hapur globale, apo ajo në ngulimet historike arbëreshe. Përkundër sfidave që vinin prej tronditjeve të homogjenitetit nacional, kjo situatë ka sjellë ndërkaq rastin, që në kontekste të ndryshme sociokulturore, kjo letërsi, të bjerë në kontakt, të përqafojë, të ndikohet e të formatohet në rryma, shkolla e lëvizje të caktuara letrare. Sigurisht, pa e bekuar rrjedhën e atyre konteksteve, shpesh kundërthënës, gjithsesi mbetet i vlerësuar produkti (rezultati) kompleks e mozaikal i kësaj letërsie, si profil i një krijimtarie polivalenciale, që përmes poleve të saj letrarë, ka arritur të realizojë disa prirje, në funksion këto: balancues, ndikues, konkurrues e deri atakues apo refuzues estetikisht mes këtyre poleve, apo qarqeve letrare.

Kjo situatë ka krijuar (le ta themi) luksin që në këtë letërsi të mos kenë qenë të munguara edhe referencat autoritare së brendshmi, sidomos në ato raste, kur janë ndjerë rreziqet bjerrëse, në hapësira të caktuara letrare. Pra, brenda letërsisë shqipe ka funksionuar parimi i kompensimit mes hapësirave të ndryshme, shenjë kjo e një sistemi letrar unitar.

Letërsia arbëreshe mbetet një dimension përherë prezent në rrjedhat 5 shekullore të letërsisë shqipe. Por shtrohet pyetja, si është interpretuar ajo në tekste, në manuale e në botime të tjera të natyrës

enciklopedike? Gjykojmë se nuk kanë munguar dhe inkoseguencat, madje serioze, sidomos në vlerësimin konceptual të rolit e të misionit të saj në raport me botën shqiptare.

Para së gjithash, tek kjo letërsi nuk është dalluar apo nuk është përcaktuar si duhet roli i saj unikal, si një letërsi që vinte e selitur nga krijues italo-shqiptarë, pra arbëreshë, që ishin gjuhësisht, estetikisht dhe me botëperceptim të dyfishtë, nga shkaku se njëkohshëm, me shtysën obsesive për të qënë të pashkëputur me atdheun e të parëve, ata ishin të mbrujtur dhe me civilizimin metropol të botës latine, ku jetonin e punonin. Kësisoj, letërsia e tyre u bë një urë lidhëse mes letërsisë shqipe dhe asaj italiane, ishte pra, një dritare e hapur nga ku letërsisë shqipe i përcilleshin modelet letrare që aplikoheshin në Oksident.

Lëndë ballkanike e derdhur në formë romane, do të vrente hollë rreth kësaj letërsie Çabej qysh në vitet `30. Kurse në studimin tjetër të tij *Romantizmi në Europën lindore e juglindore dhe në literaturën shqiptare*, ai shtyhet më tej, duke shtruar tezën se romantizmi arbëresh vjen si një model kontribues e pasurues jo vetëm për letërsinë shqipe, por dhe na raport me *romantizmin nacional* në letërsitë e popujve ballkanikë, të cilët nuk e patën rastin ta kishin prezente një rrjedhë letrare perëndimore, sikundër e kishte letërsia shqipe.

Këtë lloj shansi të bekuar të letërsisë shqipe, për të pasur përmes letërsisë arbëreshe një urë lidhëse e dritare të hapur komunikimi me letërsitë e mëdha të Perëndimit, e kanë vërejtur sipas rastit dhe studiues të tjerë disa dekada vitesh më parë si: Karl Gurakuqi, Justin Rrota, Namik Resuli, Rosolin Petrotta, Ernest Koliqi, por pas Luftës së Dytë Botërore, kjo tezë nuk u kujtua më, sigurisht për shkaqe ideologjike, pasi ishin të anatemuara theksimet e atyre vlerave që vinin nga qarqet kulturore të Oksidentit – i ashtuquajtur *kapitalist*.

Duhet sjellë gjithashtu në vëmendje se Kadareja në një shkrim të tij të vitit 1963 *Duke lexuar Milosaon*, i drejtohet me tendencë këtij areali letrar dhe brenda rrjetit të sinjaleve alegorike të shkrimit merr shkasin të dëshmojë për vlerat e njëmendta që duhet të përcjellë prej kësaj tradite letërsia e re shqipe, përkundër dogmatizmit asfiksues të socrealizmit. Me tendencë, ai e thekson rolin e De Radës, si novatori më i madh i letërsisë

shqipe dhe poemën e tij e kualifikon si *metaforë të dritares së hapur përkundrejt detit*, pra, një vepër e atillë, që transmeton filozofinë e marrëdhënieve e kontakteve të hapura mes kulturave, përkundër moralit të izolimit e mbylljes. Ndonëse i pakujtuar nga kritika, në theksimet e këtij shkrimi për sintetizmin, frymën e universalitetit, errësirën që vjen nga thellësia e gjërave, për stilin fragmentar që krijohet sipas parimit të ajsbergut - tek vepra e De Radës, vështruar nga horizonti i sotëm, mund të pohojmë se tek ai shkrim mund të gjejmë formatin e një manifesti letrar, i cili, me jo pak guxim për kohën, njoftonte alegorikisht *padinë* e pritshme për *divorcin* me letërsinë zyrtare dhe projektonte modelet natyrale që duhej të ndiqte letërsia bashkëkohëse, që në fakt, vetë Kadareja pati rastin ta dëshmojë e ta realizojë suksesshëm në veprat e tij.

Problem i hapur mbetet gjithashtu vështrimi tërësor i letërsisë arbëreshe, e cili vazhdon të prezantohet ende në disa botime si fragmentar, apo i cunguar. P.sh. shekujt 16-18, me autorë si L. Matrënga, J. Variboba, Gj. Guxeta, N, Filja, N. Brankati, e të tjerë, kufizohen të vlerësuar në veprat e tyre kryesisht brenda kuadratit didaskalik e religjioz, duke mos tentuar ende që në to të shihen dhe fryma apo gjurmë të renesansës, të sensizmit, racionalizmit e neoklasicizmit, që ato vepra përcjellin - për shkak kontakti të autorëve me ato lëvizje respektive europiane (siç janë vënë në dukje te vepra për Bogdanin e I. Rugovës). Ky duhej të ishte një dimension i pranishëm, përmes të cilit, letërsia shqipe kishte rastin të vështrohej e rënë në kontakt dhe e ndikuar nga lëvizjet iluministe europiane të kohës, çka do ta pasuronte atë në tipologji e do t`i afrohej prestigji i merituar, në këtë rast i munguar. Sepse letërsisë së një gjuhe, pasuritë e lëvizjet i vijnë prej shumë kahjesh, i vijnë nga individualietet, i vijnë nga qendrat apo periferitë letrare.

Për simetri, kjo duhej të vazhdonte edhe me rrjedhën letrare arbëreshe të shek. të 20, ku ka vend të evidencohen tipare të lëvizjeve letrare italiane që qarkullojnë kësaj kohe si: futurizmi, poezia e muzgut, verizmi, neorealizmi, hermetizmi, me të cilat autorët arbëreshë doemos kanë rënë në kontakt njohjeje dhe rezulton se në nivele të caktuara janë ndikuar prej tyre krijues të kësaj kohe si: Dushko Vetmo, Lluka Perrone, Vorea Ujko etj. Mirëpo, herë nga mosnjohja sa duhet e kësaj krijimtarie, por dhe nga fobia inerciste e së kaluarës (ndaj atyre drejtimeve letrare që etiketoheshin

dekadente), studimet dhe antologjitë i kanë kornizuar ata kryesisht brenda motiveve patriotike e sociale.

Konsiderimi i këtyre prirjeve, të cilat vijnë të ndikuara prej lëvizjeve të formatit europian, do sillte një përmasë të re në relievin e historisë së letërsisë shqipe të shek. të 20-të, por do ta çmontonte dhe përshtypjen e pasaktë mbi kronologjinë e letërsisë arbëreshe, sikur ajo i ka limitet e saj pothuaj brenda romantizmit.

Nisur nga zelli për ta parë sa më shqiptare letërsinë arbëreshe, sidomos atë romantike, shpesh u është mëshuar kryesisht elementeve të ngjashëm respektivisht me romatizmin nacional dhe nuk janë vlerësuar tiparet specifike që mbart ajo letërsi e ardhur nga bota latine, tek e fundit si një romantizëm i modelit perëndimor. Sigurisht, përkatësia shqiptare e karakteri integrant i asaj letërsie me atë shqipe mbeten të palëkundura, sepse ato janë të stampuara tek shprehja gjuhësore e saj. Por ndërkohë është mistifikuar apo anashkaluar përmasa e saj e pastër (puro) romantike me kultin e ndjenjës, me pozitën e individit në kontrast me shoqërinë, me përjetimet religjioze e mistike, me figurën shpesh në qendër të gruas, me ndjenjat e forta të pasioneve e endërrimeve…, që shansi e solli ta pasuronin me një regjistër tjetër (apo ndryshe) ligjërimor romantizmin e letërsisë shqipe. E kjo përmasë duhet vlerësuar në kontekstin e historisë së letërsisë shqipe, për ta prezantuar romantizmin e kësaj letërsie si polifonik nga pikëpamja estetike, që është padyshim vlerë, origjinalitet.

Vështruar kështu, nuk ka pse vijon ende kompleksi i *supernacionalitetit*, që ka sjellë spostimin e rendit të autorëve romantikë arbëreshë - pas autorëve të tjerë, që kronoligjikisht janë më të vonshëm. Kështu, mbulohet fakti real historik se romantizmi ynë rilindas, fillimet e veta i gjen brenda qarkut kulturor italo-shqiptar, e kjo nuk do të sillte asgjë kundërthënëse apo problematike.

Thënë përmbledhtazi, prej botës arbëreshe, letërsia shqipe ka pasur rastin fatlum të ekuilibrojë e të plotësojë vakuumet e saj kulturorë dhe estetikë, të krijuara për shkaqe rrethanash historike – ku gjendej hapësira shqiptare ballkanike, nën sundimin e perandorisë otomane, por që e vazhdoi këtë kontribut edhe më pas. Si një letërsi që ushqehet nga dy burime kulturore dhe me dy nivele lexuesish, pra, krijesë multikulturore dhe njëherazi

multifunksionale, ajo vlerësohet si një krijimtari *sui generis,* aspak eklektike, por origjinale. Ajo pati statusin që, krahas mbartjes së shumëçkaje prej origjinës, të merrte dhe misionin dhënës drejt saj, d.m.th. të kishte atributet e ndikimit për atje nga ku lindi e u shkëput në rrethana të njohura. Pra, letërsia arbëreshe ishte *bijë* e kësaj letërsie vendëse, por njëherazi dhe *limfë* ushqyese e ripërtëritëse (krijuese) për të.

Këto, e çështje të tjera, sjellin argumentin se letërsia arbëreshe mbetet sot një ftesë e hapur për (*ri)interpretim.*

Nehas SOPAJ, Shkup

"THE PRINCETON ENCYCLOPEDIA OF POETRY AND POETICS" PËR POEZINË SHQIPE

KDU 821.18-1.09
929(4/9)(031)

Tema që po paraqes këtu me titull "The Princeton Encyclopedia of Poetry and Poetics – Albanian poetry" (*Enciklopedia e Prinsëtonit e poezisë dhe e poetikës – Poezia shqipe*), në të vërtetë, me pak modifikime, ka qenë një preokupim imi i para tri dekadash dhe për të cilën kisha shkruar që atëherë në gazetën studenteske *Bota e re* e Prishtinës me titull *Lajthitje dhe shtrembërime* me një mbititull të vënë nga redaksia *Gjurmëve të (disa) enciklopedive* dhe për të cilën kisha sinjalizuar si më poshtë. Kjo temë që edhe sot mund t'ua zgjojë kërshërinë atyre që duan të dinë se si ka "rrugëtuar" një prezantim të poezisë shqipe në një nga universitetet më të njohura të botës, në fakt bën fjalë për një prezantim të shtrembëruar të poezisë shqipe, fillimisht në vitin 1972, përkatësisht të vitit 1974 (të ribotuar), për t'u përmirësuar vite më vonë dhe për t'u bërë e vërtetë shkencore, e pranueshme nga të gjithë, gjersa sot e futur në internet, e gjejmë si faktografi të cilës secili mund t'i referohet.

Në të vërtetë, në një botim të edicionit Enlarged, në Nju-Xhersi të SHBA-së, u botua dhe ribotua enciklopedia shumë voluminoze "The Princeton Encyclopedia of Poety and Poetics" për formulimin e së cilës botuesit angazhuan mbi 200 profesorë dhe punëtorë të tjerë shkencorë të universiteteve anekënd SHBA-së dhe jashtë. Enciklopedia lëndë shqyrtimi ka: 1. Historinë e poezive të kombeve nga mbarë bota; 2. Gjinitë, llojet, format e modelet e poezisë; 3. Poetikat dhe kritikat mbi poezinë dhe 4. Poezinë në raport me kreacionet e tjera njerëzore. Këtë punë kaq të madhe e të vështirë, botuesit arritën ta realizojnë brenda një decenie e më tepër, gjë që shihet nga datat e shënuara poshtë të çdo punimi veç e veç. Meqë nuk jemi në gjendje të japim një mendim të prerë mbi vlerat e vërteta të kësaj enciklopedie kaq grandioze, këtu po ndalem vetëm në ato pak faqe ku bëhet fjalë mbi poezinë shqipe. "Albanian poetry", poezia shqipe, që sipas alfabetit, i bie të jetë ndër punimet e para të këtij libri 992 faqesh me

format të madh e me rreshta të ngushtë, të shkruar në dy shtylla, është një tekst me pretendime informimi për lindjen dhe zhvillimin e poezisë shqipe, në etapa e rrethana të ndryshme kohore. Në hyrje të librit editorët Alex Preminger, Frank J. Warnke dhe O. B. Hardison, u bëjnë thirrje të gjithë njohësve, shkencëtarëve dhe përfaqësuesëve të letërsisë kombëtare se vërejtjet, ndryshimet dhe sugjerimet e tyre do t'i konsiderojnë dhe respektojnë dhe do t'i përfshijnë duke i sistemuar në ndonjë nga botimet e ardhshme të kësaj enciklopedie (ne në dorë e patëm botimin e saj të dytë, të vitit 1974, dhe sot nuk jemi në gjendje ta dimë sa herë është ribotuar deri sot deri sa është futur në internet, ndërkaq, botimi i saj i parë, u bë më 1972). E theksojmë: për shkrime të këtilla shkencore publike, të parët që do të duhej të reagonin duhet të jenë lidhjet e shkrimtarëve të shteteve tona, R. e Shqipërisë dhe R. e Kosovës, por edhe Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptarë të Maqedonisë, përmes formave që i parashohin ato në programet e tyre, por edhe institucionet e tjera të larta të shkencës e të kulturës. Këtë gjë s'duhet kuptuar si çështje të parëndësishme, kur poezia shqipe, por edhe mbarë letërsia dhe kultura shqiptare, janë zgjeruar dhe begatuar me vepra të reja duke bërë hapa të mbarë në afirmimin e identitetit të vet. Për dekada, me sa di unë, deri sot askush nuk ka shkruar asgjë për këtë enciklopedi, qoftë edhe me shtrembërimet dhe lajthitjet e bëra për letërsinë tonë.

Këtu më poshtë, unë po paraqes dy versionet: të parin, me lajthitje dhe të dytin pa to. Tek i pari, i nënshkruari C. A. M., që, sipas fletëfalënderimit të botuesit të vënë në fillim të librit, del se është Clarence A. Manning, ngjashëm si edhe shumë herë të tjera në të kaluarën kur studiuesit e huaj letërsinë shqipe e kanë prezantuar nga kute të ndryshme të këndvështrimit, që në hyrje të artikullit shpreh mosnjohje të lëndës që merr ta trajtojë, tek thotë: **"**shqiptarët, numerikisht një nga popujt më të vegjël të Evropës, poashtu janë edhe ndër më të ndarët..." në mënyrë që më tutje artikullshkruesit këto ndarje t'i duken ndarje gati përçarje, sipas të folmeve, në dialektet gegë e toskë, si dhe sipas religjionit "...në tri religjione – në romano-katolikë, ortodoksë dhe myslimanë". Artikullshkruesi nuk shkon më tutje ta thotë të vërtetën historike mbi popullin tonë, se religjioni kurrë shqiptarët s'i ka ndarë, por pushtuesit e ndryshëm dhe veglat e tyre kanë bërë të duken. Më tutje artikullshkruesi e nis prezantimin e letërsisë shqipe duke filluar me letërsinë popullore dhe pasi flet për këngët tona popullore

dhe strukturën e tyre në komponim, pasi përmend si ndër më të realizuarit ciklin e Mujit dhe të Halilit, kalon në këngët mbi Skënderbeun, për të cilat thotë: "Shumë të rralla janë këngët në Shqipëri të cilat flasin mbi heroin kombëtar, Gjergj Kastriotin ose Skënderbeun, i cili u rrit në pallatin e sulltanit, por vdiq për kauzën e krishterë në Lezhë /Alessio/**...** "Autori i këtij teksti si duket i mungojnë informatat e mjaftueshme, se vetëm në *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, I, II, III* ndodhet një cikël prej tetë këngësh të cilat janë gurra për motërzime të ndryshme, për krijime gojore në prozë, e me këtë frymë tek ndodhen edhe nëpër blene e publikime të tjera folklorike, si dhe për frymëzime shkrimtarësh që kanë reprodukuar qindra vepra të gjinive e të ndryshme e që për temë kanë heroin tonë kombëtar, e të cilat tashmë s'janë anonime.

Për fillimet e poezisë shqiptare thuhet: "Shembulli më i vjetër që dihet nga poezia shqipe, është shkruar në dialektin italo-shqiptar (!), (Tosk) nga Ati Llukë Matrënga (1958) nga kolonitë shqiptare të Siqelisë. Në përgjithësi, vargu shqip lindjen e vet të vërtetë e ka në shekullin 19, si rezultat i interesimit të madh për poezinë popullore, e cila identifikohet me romantizmin. Girolamo de Rada (Jeronim de Rada), një italian me prejardhje shqiptare (!) mblodhi vargje popullore, disa prej të cilave më vonë i shfrytëzoi për poezinë e tij. Një poet tjetër i rëndësishëm italo-shqiptar, ishte Zef Sqiroi (Schiro). Më vonë në kulturën shqiptare, vëllezërit Sami Bej dhe Naim Frashëri bënë një lëvizje të madhe për kulturën shqiptare. Naimi ngrihet në poet-apostull të nacionalizmit shqiptar (!). Nipi i tij, Mit'hat Frashëri (Lumo Skendo 1880-1949), edhe pse jo poet, në Sofje botoi një numër të madh punimesh të shqiptarëve të mërguar, midis të cilëve edhe ato të Aleksandër Drenovës (Asdrenit). Një poet tjetër i rëndësishëm, Ando Çako (Andon Zako – Çajupi!), shumicën e lirikave të tij i botoi në Egjipt".

Edhe lexuesi fare pak i informuar me historinë e letërsisë shqipe do të vërejë se këtu ka disa lajthitje të tipit: Llukë Matrënga (Lekë Matrënga, poeti i parë është vetëm shënues i tetë vargjeve të para), kurse Pjetër Budi merret si i tillë nga i tërë areali shkencor shqiptar (duke mos harruar *Kënga mbi këngët* e Gjon Buzukut, më para). Pastaj ka një kërcim të papritur tek poetët e Rilindjes duke mos përmendur fare bejtexhinjtë, të ashtuquajturën letërsi *alhamiado*. Nga ajo që lexojmë nga teksti, si p.sh. për De Radën, "një italian me prejardhje shqiptare" dhe për Naim Frashërin "poet-apostull

i nacionalizmit shqiptar" etj., edhe për një projekt kaq grandioz, them s'e meritojnë vëmendjen e lexuesit të rëndomtë qofshin ato edhe të kësaj enciklopedie të këtij Universiteti të këtilla të pavërteta.

Vëmendjen e artikullshkruesit e ka tërhequr më shumë poeti kombëtar shqiptar, At Gjergj Fishta, për të cilin s'mungon epiteti "poet kombëtar". Pastaj, në mesin e letrarëve që krijuan midis dy luftrave botërore, ai përmend në radhë të parë, Vinçenc Prennushin, Ndre Mjedën, Ernest Koliqin dhe Ethem Haxhiademin, të cilët përbënin, citojmë "fokusin e letërsisë së Rilindjes, e cila ishte në veriun katolik!". Në plan të dytë mbeten këtu F. Noli, për të cilin thotë: "Fan S. Noli, peshkop i kishës orthodokse shqiptare, është i njohur jo me poezinë e tij origjinale (!), por me përkthimet e shumë kryeveprave letrare, si me përkthimet e veprave të Shekspirit dhe 'Rubiareve' të Khajamit". Prej këtij kalibri shkrimtarësh, pa shkarje në vlerësim ka kaluar L. Poradeci, por edhe atë e cilëson ndryshe nga mendimi relevant kritik letrar shqiptar. Për të thuhet: "Poeti më i ri i kësaj kohe, i cili shkroi në toskërishte, Lasgush Poradeci nxiti interesim të madh. Me thekse vërtet të reja poetike, ai i kombinoi ndikimet e Getes, të Emineskut dhe simbolistëve frëngë". Pra, edhe vlerat e poezisë së tij, siç mund të shihet, gjejnë shpjegim si rezultat i ndikimeve të poetëve të mëdhenj të huaj, që si dhe në të gjitha rastet e përparme, s'përkon me të vërtetën, sepse, siç dihet, poezitë e L. Poradecit janë kaq të fuqishme më shumë sepse kanë ngjyra dhe muzikë të një lirizmi folklorik se sa produkt ndikimesh. Po të ishin vetëm produkt përkthimesh, atëbotë ç'bëjmë me faktin se ato janë kaq origjinale kaq sa ato është shumë vështirë të përkthehen në gjuhë të huaja (nëse edhe përkthehen, humbin kaq shumë nga vlerat fonologjike që kanë). Ali Asllani përmendet si poet që shkroi në frymën popullore dhe që u këndoi kohëve të shkuara.

Duke vazhduar më tej për realitetin shqiptar midis dy luftërave, artikullshkruesi arrin te Migjeni, për të cilin thotë: "në ndërkohë, u shfaq vetëm një zë i ndjeshëm poetik, Migjeni. Shkrimtarët e rinj, si Aleks Çaçi, Mark Ndoja dhe Veli Islami ndoqën temat dominuese sovjetike me një kolorit shqiptar dhe stil autoresk, por puna e tyre është shumë më inferiore nga ajo e gjeneratës më të vjetër, që ndoqi rrugët dhe modelet e veta".

Ky version i botimit të vitit 1974 nuk i përmend fare bejtexhinjtë,

letërsinë bashkëkohore shqiptare si dhe asnjë krijues jashtë shtetit shqiptar, Shqipërisë zyrtare, asnjë krijues të Kosovës etj.

Versioni i ri, ky i internetit, tek i cili nënshkrues është profesori i nderuar dhe eminent R. Elsie, qasjen për fillet dhe zhvillimin historik të mbarë poezisë shqipe e sheh pa kurrfarë përkufizimesh gjeografike, ideologjike, estetike etj. Ai tërë mbarëshkrimin e lëndës e bën me kompetencë të plotë shkencore, duke reduktuar, sektuar dhe prezantuar vlerat më të larta të të arriturave tona artistike, i prezanton shkrimtarët më kulmorë që kemi duke i parë ata jo skematikisht, por ndryshe nga pararendësi për të cilin folëm më lart. Nuk ka asnjë shabllonizim dhe shtrembërim shkencor, nuk ka as mosnjohje e shtrembërim, por brenda aq faqeve kaq sa i janë lejuar shkruesit ta paraqesë materien (që përafërsisht është e njëjtë si edhe versioni i parë me një dallim se të gjitha mangësitë e detektuara më parë janë kompensuar), të gjitha ato fakte dhe faktografi shkencore vihen në vendin e duhur të shoqëruara me tërë aparaturën e nevojshme dhe me një prezantim adekuat siç ndodh edhe me poezitë dhe poetikat e kombeve të tjera të botës.

Këtu më poshtë unë po paraqes shkurtimisht pikat kryesore të mangësive të detektuara dhe të riparuara nga autori R. Elsie dhe po ua lë lexuesve që vetë t'i shohin ato:

"POEZIA SHQIPE: Gjuha shqipe është gjuhë indoevropiane e cila flitet në Shqipëri, Kosovë dhe në viset e tjera jugperëndimore të Gadishullit Ballkanik. Shqipëria ka fituar pavarësinë në vitin 1912 pas pesë shekujve nga pjesa e Perandorisë Otomane. Fillet e shkrimeve në vargje në Shqipëri janë të lidhura fort me Kishën Katolike. Pjetër Budi (1566–1622), nga rrethina e Matit, ka mësuar për prift në Kolegjin Ilirian të Loretos në jug të Ankonës së Italisë dhe ai më vonë zgjidhet peshkop i Sapës dhe Sardës në rajonin e Zadrimës. Botimi i tij më i shquar, një katekizëm i titulluar Dottrina Christiana (Doktrina e krishterë), 1618, ka një shtojcë prej 53 faqeve me poezi religjioze shqipe me rreth 3000 vargje...

Invazioni otoman dhe okupimi i Shqipërisë, duke filluar nga fundi e shekullit XIV, ka shkaktuar një shuarje graduale të poezisë katolike të hershme. Kjo poezi u zëvendësua nga vargu alhamiado, i shkruar alfabet arab dhe me ndikim të fortë nga kultura islame. Poetët myslimanë fillimisht

shkruanin në gjuhën turke, në osmanishte, mirëpo nga mesi i shekullit XVIII ata gjithashtu eksperimentonin edhe me gjuhën shqipe. Ndër figurat kryesore letrare nga kjo periudhë ishte Nezim Frakulla, (1680–1760) nga rajoni i Fierit...

Duke i lënë anash poetët italo–shqipëtarë të Italisë së Jugut, siç janë Jul Variboba (1724-88), Nikollë Keta (1740-1803), Jeronim de Rada (1814-1903) dhe Zef Serembe (1844-1901), që të gjithë dhanë kontribut të madh në evoluimin e poezisë shqipe, në fillim dallojmë një ringjallje të poezisë në vetë Shqipërinë në fund të shekullit XIX, gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare. Ndër figurat kryesore të kësaj levizjeje për identitet kombëtar dhe autonomi politike ishin Pashko Vasa (1825-92) nga Shkodra, kënga e të cilit *O moj Shqypni e mjera Shqypni,* thërret për një zgjim kombëtar, ishte e shkruar në vitet dramatike të Lidhjes së Prizrenit, 1878-80, dhe Naim Frashëri (1846-1900), tanimë gjerësisht i njohur si poeti kombëtar i Shqipërisë, botoi gjatë gjithë kohës derisa jetonte në Konstantinopojë dhe ishte shumë i njohur mes shqipëtarëve të asaj kohe, duke i përfshirë vargjet pastorale sipas traditës së Virgjilit, të stërmbushura me imazhet e vendlindjes së tij malësore; epikë historike; dhe vargje religjioze bektashiane...

Ndër poetët kryesorë të dekadave të hershme ishin Anton Zako Çajupi (1866-1930), i cili ishte aktiv në Egjipt; Ndre Mjeda (1866-1937) nga Shkodra, përmbledhja Juvenilja (1917) e të cilit ishte e ndikuar nga shekulli XIX. Klasikët italianë përfshinin sonete dhe vargje të tjera në metrikë të rafinuar; dhe Asdreni (1872-1947) nga rajoni i Korçës juglindore, tri përmbledhjet në poezi të para të të cilit ishin pranuar mirë.

Figura më e madhe e poezisë shqipe para Luftës së Dytë Botërore ishte Gjergj Fishta (1871–1940), epika e tij në vargje për historinë shqiptare me pesëmbëdhjetë mijë vargje, Lahuta e Malcisë – 1937 e të cilit ndikoi që ai të çmohet si Homeri shqiptar. Kur komunistët erdhën në pushtet më 1944 puna e tij shpejt u ndalua dhe vetë përmendja e tij i tij paraqiste një tabu për plot 46 vite.

Dy poetë plotësisht ndryshe nga njëri–tjetri, mund të jenë të quajtur si avangardë e modernë në letërsinë shqipe. Nismëtari Migjeni (1911–1938) nga Shkodra ia ktheu fytyrën bukurive të maleve shqiptare dhe

traditave të shenjta të kombit të tij që me vargjet e tij t'ia dedikojë shoqërisë shqiptare të dëshpëruar dhe realitetit të padrejtë, kundër të cilit ai u ballafaqua me sfidë. Përmbledhja e tij jo aq voluminoze Vargjet e lira, 1944, e botuar pas vdekjes, paraqiste një revolucion letrar dhe një freski e cila nuk lidhte punë përgjithmonë me traditat e nacionalizmit romantik. Lasgush Poradeci (1899–1987), një poet panteistik nga Poradeci pranë Liqenit të Ohrit, e studioi disponimin gjithmonë të ndryshueshëm të liqenit që të ofrojë një poezi kristale të stilit jugor folkloristik të Shqipërisë...

Veprimet staliniste dhe mundimet nën diktaturën e Enver Hoxhës (1908–85) shkaktuan një tmerr në qarqet intelektuale dhe e ngulfatën shkrimin krijues në këtë shtet për gati njëzet vjet. Vetëm Martin Camaj (1925–1992), i cili gjendej në azil në Bavari, dhe poetët e paprekur nga tmerri që gjendeshin në Kosovë, ishin të lirë të krijojonin mbi traditat e vendosura më parë.

Deri në vitet e '60 një gjeneratë e re e poetëve në Shqipëri, prirë nga Fatos Arapi (1930), Dritëro Agolli (1931) dhe Ismail Kadare (1936), mundën t'i vendosnin veprat e tyre estetike në volumet e poezive detyrimisht me temë të rezistencës partizane. Nuk kishte mundësi lakimi të vargjeve shqipe gjatë periudhës komuniste (1944–1989); mirëpo hapjet e kujdesshme, sado të pakta, mundësuan të botohen disa vargje cilësore, të cilat menjëherë e kapën imagjinatën e publikut të uritur.

Ndalesat ideologjike u zhdukën kur regjimi stalinist pësoi kolaps në 1989–1990 dhe mbretëroi kaos në shtetin e vogël Ballkanik për një dekadë..."

Persida ASLLANI, Tiranë

(MOS)KOORDINIMI NË *FJALORIN ENCIKLOPEDIK SHQIPTAR* TË ASHSH DHE ZHDUKJA E MODERNIZMIT SHQIPTAR

KDU 82:03

Në vitin 2007, të gjitha akademitë e kontinentit evropian, me iniciativë të *Institut de France*, u mblodhën në një takim tejprotokollar me temën domethënëse: "Akademitë në Europën e shekullit XXI". Në fjalimin e hapjes[1], ky tubim, dhe të gjithë akademikët pjesëmarrës, u ftuan të pranonin një imazh-metaforë të rolit të akademive sot në botë: atë të këngës IV të *Ferrit* të *Komedisë hyjnore*, ku në hapësirën fantazmagorike të Limbit, Dante poet prezantohet nga Virgjili me Homerin, moment simbolik ky (ndër të tjera) i ruajtjes dhe përcjelljes së çmuar të dijeve, ideve dhe kreativitetit. Duke mos u takuar dot kurrë realisht me njeri-tjetrin, Dante trashëgon brenda veprës së vet Virgjilin, e ai vetë Homerin, pavarësisht se në sistemin e teologjisë së Mesjetës ata të dy do të cilësoheshin të papranueshëm për shkak të përkatësisë "pagane". Akademitë ftohen të jenë ky Limb mbrojtës e trashëgues, por njëkohësisht edhe strukturues i dijeve, ideve dhe kreativitetit në gjirin e ndryshimeve të fuqishme të mijëvjeçarit në të cilin jetojmë. Për rrjedhojë, në një nga referatet kryesore të takimit, atë me titull "Mémoire, recherche et création", akademikja Dominique Meyer e cilëson fjalën "kujtesë", pra artin e kombinimit mes akteve të të kujtuarit dhe të harruarit, si simbolizuesen më të mirë të shpirtit të brendshëm të akademive. "Ato kanë për mision të ruajnë dhe të zhvillojnë kujtesën e së shkuarës, por edhe të krijojnë sot atë çka do të jetë kujtesa e së ardhmes"[2].

Kjo detyrë dhe njëkohësisht premtim i "figurës" së akademikut na nxit të mbajmë parasysh faktin se ndërtimi i kujtesës sonë në trajtë të një korpusi trashëgues është një proces aktiv, në të cilin rolin më të madh e

[1] Fjala e hapjes nga Gabriel de Broglie (Chancelier de l'Institut de France), *Les Académies en Europe au XXI siècle*, Institut de France, 2007

[2] MEYER, Dominique, Mémoire, recherche et création, po aty, f. 58

luan pikërisht "harresa", apo më saktë, vendimi thellësisht aktiv e i angazhuar për të "harruar" pikërisht ato gjëra që do t'i lënë hapësirën e nevojshme asaj që do të "kujtohet". Konceptimi i temës së kësaj tryeze shkencore përmes konceptit të "shkrimit enciklopedik" merr kuptimin e tij të plotë nëse mbajmë parasysh polaritetin e brendshëm të aktit të shkrimit, pikërisht si "écriture" në kuptimin bartezian, domethënë përtej *erratumit* njerëzor dhe brendashkruar në një prej angazhimeve (njëkohësisht ndjesor, gjuhësor, ideor e shkencor) nga më seriozët të atij që shkruan.

Por filozofia bashkëkohore e historisë na paralajmëron ndërkaq se edhe vetë shkrimi i kujtesës, pra asaj që aktivisht nuk u harrua, gjallon përmes një tjetër polariteti: atij të së shkruarës dhe projektimit tonë mendor e koherent mbi të. Hartimi dhe shkrimi i një fjalori enciklopedik (sidomos nga një akademi) nuk përbën kurrsesi të shkuarën e trashëgueshme në të shkuarën e saj, por bashkëkohësinë e kësaj të shkuare dhe, për pasojë e njëkohësisht, të tashmen e një së ardhmeje. Përzgjedhja sistematike mes së kujtueshmes e të harrueshmes është në thelb një problematikë aktive sa shkencore aq edhe etike.

Duke marrë këtu në shqyrtim se çfarë është "harruar" e "kujtuar" (në fushën e letërsisë) në Enciklopedinë shqiptare[3] të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, nuk kam për qëllim aspak "të argëtohem" duke qortuar punën e të tjerëve, por të pasqyroj disa nga vendimet shkencore e për pasojë thellësisht etike që kanë vepruar në të tashmen e shkrimit dhe projektimit të kësaj të shkuare në *shkrimin enciklopedik* të letërsisë shqipe.

Le ta nisim këtë shqyrtim me një pasqyrë përmbledhëse të disa prej "harresave" të mëdha të kësaj enciklopedie në lidhje me letrat shqipe:

- harresa e zërit më vete "realizmi socialist";
- harresa e zërit dhe më gjerë konceptit operues "modernizëm" dhe "modernitet";
- harresa e zërit të "Esesë", "Prozës poetike" dhe "Skicës letrare" si elemente përbërëse të modernitetit letrar;
- harresa e "Letërsisë dokumentare (memuaristike)";

[3] Fjalori Enciklopedik shqiptar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2008-2009. Në citimet e mëtejshme FESH.

- harresa e diasporës letrare e kulturore;
- harresa e nocioneve të "mistifikimit letrar"; e "oralitetit", etj;
- harresa (për pasojë edhe) më konkrete në autorë e vepra plotësisht ose pjesërisht, duke filluar nga Konica, Fishta, Harapi, romani i shkruar në Kosovë, At Zef Pllumi, etj;
- Po e quaj gjithashtu "harresë" aktive moskoordinimin tepër të dukshëm mes zërave të ndryshëm, të cilët qarkullojnë informacione të ngjashme ose të përafërta, moskoordinimi i të cilave shpie pashmangshmërisht në një konfuzion të përsëritur veçanërisht në zërat panoramikë të historisë, drejtimeve letrare, zhanreve e llojeve dhe autorëve të letërsisë shqipe.

Disa nga çështjet që do të trajtohen këtu poshtë synojnë të argumentojnë përmes depistimit dhe jo shterimit disa nga problematikat shkencore dhe sidomos etike që shoqërojnë shqyrtimin shkencor por edhe leximin praktik të kësaj enciklopedie.

Harresa mistifikuese e realizmit socialist

Edhe pse **"realizmi socialist"** trajtohet dhe përmendet në zëra enciklopedikë si "Shqipëria" (letërsia e saj), në zërin Letërsia Shqipe (rimarrje e së parës), në zërin Poezia (përciptazi), në zërin Romani (kalimthi), ai nuk del si zë më vete, zë që do të kishte për qëllim sqarimin e një dukurie letrare e kulturore nga më të fortat dhe problematiket në letrat dhe kulturën shqiptare. Edhe aty ku shfaqet, realizmi socialist nuk sqarohet se çfarë ishte dhe as se prej nga i erdhi letërsisë shqipe, duke e lënë lexuesin e thjeshtë pa asnjë informacion mbi të, si në rastin e zërit "Shqipëria "(Letërsia e saj), ndërsa në zërin "Letërsia shqipe" lexojmë këtë interpretim përfundimtar: "fryma romantike e P. Markos, S. Malëshovës, A. Varfit dhe më pas e Shefqet Musarjt, K. Jakovës, F. Gjatës krijoi fillesat e një letërsie shumë të angazhuar, të cilat, siç rrodhën ngjarjet në Shqipëri, çuan në lindjen e realizmit socialist"![4]

Kjo harresë ndryn në vetvete një problem të thellë etik. Ajo rezulton një përpjekje për të fshehur, deformuar, mistifikuar një dukuri komplekse

[4] FESH, f. 1479

që kërkon jo vetëm analiza dhe detajime faktesh, jo vetëm historikun e zhvillimit të saj e sidomos të "importimit" dhe dështimit, por veçanërisht faktimin, analizimin dhe identifikimin e dhunës që ajo "importoi" në letrat dhe kulturën shqiptare, si me ndalimet programatike, kufizimet ideologjike dhe tematike, por kryesisht përmes censurës deri në asgjësim të veprës së autorit, si edhe shpesh të lirisë dhe jetës së tij njerëzore. Pikërisht këtu përmasa etike e "harresës" është më e mprehta. Për pasojë, shumë nga "harresat" e tjera do të derivojnë "natyrshëm" prej këndej:

- Le të mos habitemi teksa shohim se te zërat e "Novelës" apo "Tregimit" dukuria e Realizmit socialist as që përmendet fare, duke u zëvendësuar me përkufizimin periodizues "mbas luftës së dytë botërore"[5]. Novela dhe tregimi shqiptar "pastrohen" kësisoj nga gjurma historike, ideologjike, etike dhe metodike e dukurisë letrare që dominoi për rreth 45 vjet.

- Për më tepër, fshehja mbas mungesës së zërit të "Realizmit socialist" u ka lejuar autorëve të saj të fshijnë nga "kujtesa e definuar", pra kujtesa aktive dhe e cilësuar, pikërisht ato dukuri që morën trajtë dhe jetë pikërisht si pasojë ose kundërpërgjigje ideologjike, etike dhe artistike të tij. Nën këtë "gomim" të zërit dhe zhvillimit historik si të nocionit ashtu dhe të dukurisë së "Realizmit socialist" është fshirë edhe kundërvënia e tij e hapur dhe aktive në hapësirën e diasporës letrare dhe kulturore shqiptare, duke i mundësuar kësaj *Enciklopedie* harresën e saj metodike të radhës, mungesën e informacionit në zërin "Diaspora" mbi shkrimtarët e diasporës shqiptare letrare dhe kulturore. Ky grup autorësh përmendet vetëm në zërin "Letërsia shqipe" përmes komentit: "Si një degëzim më vete i L.Sh. u zhvillua krijimtaria e shkrimtarëve shqiptarë në mërgim. Krahas E. Koliqit, ky degëzim u përfaqësua nga A. Pipa e M. Camaj – (shih), të cilët zhvilluan një letërsi të mbështetur kryesisht në motive etnografike, duke përftuar stilistikisht vlera të prozës moderne"[6]- përkufizim i zbehtë dhe "etnografizues" i krijimtarisë së tyre, i ngjashëm me përkufizimin "folklorizante" përmes të cilit dikur, po nga kritikët e realizmit socialist, denigrohej vepra monumentale e Fishtës *Lahuta e Malcís*.

- Të njëjtën praktikë asgjësuese ka pësuar edhe krejt romani i

[5] FESH, f. 1856 dhe f. 2749
[6] FESH, f. 1480

shkruar në Kosovë! Lexuesi që kërkon një informacion bazik se cilët janë autorët dhe romanet më përfaqësuese në letërsinë shqipe në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, etj, nuk do ta gjejë dot në faqet e kësaj enciklopedie. Të njëkohshëm me realizmin socialist në Shqipëri, rrugëtimi i tyre ka rezultuar krejt i ndryshëm, me referenca letrare e kulturore, por edhe qëndrime, konceptime, qasje dhe shije letrare krejt të tjera[7]. Të shkruash për to në raport me dijen dhe shijen e lexuesit shqiptar do të duhej doemos të kalohej nga përvoja e "realizmit socialist" në Shqipëri. Harresa e njërit ka sjellë për pasojë edhe asgjësimin po aq aktiv të tjetrit.

- Ndërsa harresa tjetër e fortë e kësaj enciklopedie, heshtja e plotë mbi dukurinë letrare dhe historike të Letërsisë dokumentuese dhe memuaristike, e tejkalon çështjen e një metode dhe dukurie letrare dhe shtrihet në kufijtë e një lufte të shpallur ideologjike. Mungesa e zërit "Letërsia dokumentuese ose e kujtesës", prania e së cilës do të kishte lejuar të sqarohej vlera e rrallë e një vepre si *Andrra e Prêtashit* e Harapit, por sidomos figura dhe vepra monumentale e Át Zef Pllumit, denoncon sot një nga përpjekjet e fundit për të dënuar me heshtje dhe harresë të dënuarit dhe viktimat më të skajshme të diktaturës komuniste në Shqipëri, siç ishin personalitetet kulturore të klerik katolik shqiptar. Hartuesit e kësaj enciklopedie duket sikur nuk kanë pasur asnjë informacion se *Rrno për me tregue* e At Zef Pllumit ka nisur të botohet që në vitin 1995, dhe se në vitin 2006 autori i saj është nderuar edhe me çmimin e madh kombëtar të Pendës së artë. Duke gjykuar se vepra e tij përfaqëson jo vetëm një dukuri konkrete letrare në letërsinë shqipe, por edhe një shkrim të rrallë dokumentues me qëndrim të thellë etik, gjykoj se kjo harresë nuk mund të jetë aspak "e pafajshme".

Në këtë pikë të parashtrimit tonë fjala "harresë" priret ta zgjerojë shenjimin duke sugjeruar zëvendësimin e saj me një formulim të ri, edhe më aktiv, siç është ai i "zhdukjes".

Zhdukja e modernizmit dhe "makthi realist"

Heshjta më kuptimplotë e këtij fjalori enciklopedik është zëri i munguar **"modernizmi"**, i cili shkëlqen me mungesën e tij, kur kësaj enci-

[7] Për më tepër shih SHEHRI, Dhurata, *Statusi i kritikës*, Albas, Tiranë 2013

klopedie nuk i ka munguar paraqitja e zërave homologë si romantizmi, realizmi, e madje edhe tepër i diskutueshmi sentimentalizëm! Nëse harresa e realizmit socialist rezulton "modifikuese", fshirja e "modernizmit" rezulton shkencërisht dhe etikisht "asgjësuese". Në verbërinë e saj ajo nuk e ka parë të arsyeshme as të "lexojë" mbi "modernizmin e moderuar" për të cilin vetëshprehet Koliqi[8], apo përcaktimet e argumentuara fort të viteve '30 për Lazgush Poradecin si poet modern te Çabej[9] dhe Kutelit[10], te Pipa[11] për Migjenin, e as mendimin e sotëm të studiuesve shqiptarë që e argumentojnë edhe më profesionalisht këtë gjë, si p.sh. te Poradeci, Koliqi, Konica, Migjeni, Kuteli, Spasse, etj.

Por nga se vjen vallë kjo harresë kaq aktive?! Besoj se përgjigja gjendet po brenda këtyre zërave. Ajo është e përhapur fragmentarisht në zëra të ndryshëm dhe për arsye studimi mund të quhej **"makthi realist"**! Po e sjellim këtu me pak shembuj:

- Në zërin "Poezia" lexojmë: "Ndërsa realizmi dhe letërsia shoqërore kishin lindur e përparonin, në poemat e Gjergj Fishtës rishfaqet romantizmi dhe kulti i epopesë kombëtare"[12]. Në gjithë zërin "Poezia", kjo është hera e parë dhe e fundit që përmendet poeti kombëtar Gjergj Fishta. Pyes veten edhe nëse e njohin si duhet kronologinë e botimeve fishtjane, dhe nëse e kanë lexuar ndonjëhere *Nji lule vjeshtet* dhe *Kataklizma e rruzullimit*!

- Po në zërin "Poezia", për autorët e tij, një poet si Mjeda nuk shfaq asnjë element modernist në poetikën e vet: "në poezinë e Mjedës bashkohen shqetësime poetike realiste, përfytyrime romantike dhe teknika të pastra klasike"[13], - duke fshehur mbas një ideje "të realizmit" dhe "klasikes" sprovat më të bukura formaliste dhe moderniste (simboliste) që ka bërë ky poet, ndër më të çmuarit sot sipas vështrimit të kritikës letrare.

- Edhe kur nuk mund të heshtet mbi praninë e trajtave të modernizmit në poezinë shqipe, ky fakt sillet i mjegullt e i përgjithshëm, pa iu

[8] KOLIQI, Ernest, Introduzione alla lirica albanese në *Antologia della lirica albanese*, Milano 1963, f. 28

[9] ÇABEJ, Eqrem, artikulli i vitit 1929, Mbi poezinë e Lazgush Poradecit, ku vjen për herë të parë në ligjërimin kritik formulimi "letërsi moderne shqipe".

[10] KUTELI, Mitrush, Parathënia e vitit 1937 e vëllimit poetik të Poradecit *Ylli i zemrës*.

[11] PIPA, Arshi, *Për Migjenin*, Princi, Tiranë, 2006

[12] FESH, f. 2050

[13] Po aty.

referuar asnjë poeti në mënyrë konkrete duke e lënë informacionin të bjerë në nivelin e një hamendësimi lehtësisht të harrueshëm: "Pati prurje të simbolizmit dhe ndikimeve të tjera të poezisë evropiane"[14].

- Migjeni do të gëzojë përkufizimin "Me Migjenin poezia qytetare dhe realizmi morën trajtën e modelit"[15]. Vërtet! Për cilin model flitet këtu! Përmes Luftës ANÇ poezia shqipe përjetoi rrugëtime krejt të ndryshme, dhe në kohën kur Migjenit iu botuan poezitë ishte shumë vonë që ai të shndërrohej në model të një poeti si Poradeci, Mjeda apo Noli.

Por në këto përkufizime nuk është domethënëse mospërfillja ndaj Fishtës, Mjedës, Poradecit, por ekzaltimi, mallëngjimi dhe adhurimi pa kushte i një ideje mbi realizmin në letrat shqipe. Këtu qëndron problemi: ende të paçliruar nga hierarkia e deformuar e realizmit socialist, gjykohet se është pikërisht "realizmi" ai që qëndron më lart historikisht, estetikisht, moralisht, letrarisht, se dukuritë e tjera letrare. E vetmja bezdi në këtë hierarki do të vinte nga "modernizmi", e për pasojë ai asgjësohet krejt, duke përftuar një Koliq si realist kritik, një Mjedë herë si romantiko-klasik e herë si realisto-kritik, një Fan Nol politik, apo edhe më tej në zërat e prozës një Kutel antiçifligar, një Koliq psikologjizues, një Sterjo Spasse të paqartë, e kështu me radhë. Në këtë kaos, fjalitë e tipit anonim "pati prurje të simbolizmit dhe ndikime të tjera të poezisë evropiane" nuk sqarojnë dhe nuk adresojnë asgjë. Duke e cilësuar Realizmin si "drejtim letrar që mbizotëron në letërsinë shqiptare rreth viteve '20-'30 të shekullit XX", është harruar (sërish e sërish) se autorët mbizotërues të këtyre viteve janë pikërisht Konica, Koliqi, Poradeci, Kuteli e Mjeda, të cilët, si modernistë, me realizmin kanë lidhje krejt të tërthorta e të largëta.

Kjo dhunë konceptuale qëndron në zanafillë edhe të shumë **harresave të tjera**:

- eseja, proza poetike, skica letrare – si shprehje të qarta e dokumentuese të modernizmit janë krejt të papranishme në enciklopedi. Ato do të përbënin një nga argumentet e forta të zhvillimeve moderne të letrave shqipe pikërisht përmes eksperimentimit të trajtave subjektive të prozës së shkurtër. Në këto zëra lexuesi do të mund të njihej me disa nga rrugëtimet

[14] Po aty.
[15] Po aty.

më interesante të shkrimit të Konicës, Mit'hat Frashërit, Koliqit, Migjenit, Petro Markos, Musine Kokalarit etj, siç edhe do të vijonte zhvillimin e këtij zhanri edhe në periudhat e mëtejshme;

- deformime kronologjike: Migjeni cilësohet si "themeluesi i novelës moderne shqiptare" duke harruar jo vetëm Koliqin me dy vëllimet e tij *Hija e maleve* (1929) dhe *Tregtarë flamujsh* (1935), (i përmendet vetëm emri dhe asnjë vepër), por edhe faktin se proza e Migjenit u botua vetëm pas luftës II botërore; apo duke u shprehur për Kutelin se "përmbledhjet e tij (...) shënojnë një zhvillim të ri të novelës shqiptare, veçanërisht për gjuhën e tyre shumë të pasur dhe stilin e rrëfimit".[16] Po kaq i çuditshëm vjen edhe përkufizimi përdhunës se "rol të rëndësishëm në historinë e romanit shqiptar kanë luajtur romanet e Foqion Postolit"[17] teksa harrohet romani *Pse?!* i Spasses si romani i parë modern në historinë e romanit shqiptar;

- mungesa e krijimtarisë së Konicës, në zërat e Tregimit, Novelës, etj. mbetet e paqartë nëse autorët e shkrimit kanë pasur vështirësi në klasifikimin e prozës së Konicës dhe e kanë shmangur nga kategorizimi zhanror (ndonëse i diskutueshëm) apo nëse ata nuk e gjykojnë gjithsesi prozën e Konicës si një piketë ekskluzive në historinë e letërsisë shqipe;

- moskoordinim mes zërave të ndryshëm: te zëri Letërsia shqipe dhe Romantizimi shfaqen cilësime mbi prirjet post-romantike ose për kategorizime si simbolistë për Koliqin, Migjenin, Poradecin etj., të cilat do të duhej të përbënin argumentin e një pranie të modernizmit në letrat shqipe dhe jo të "fshiheshin" nën paqartësinë e dukurive dhe nocioneve romantike e post-romantike.

Duke e shqyrtuar Enciklopedinë nga këndvështrimi i strukturës, vihet re mungesa e një parimi të përbashkët (moskoordinim i brendshëm) në mënyrën se si do të zbërtheheshin në zëra enciklopedikë më vetë dukuritë përbërëse të trashëgimisë kulturore-letrare shqiptare. Zhvillimi në zëra të veçantë i dukurive përbërëse të letrave shqipe paraqitet konceptualisht i cunguar: mungon zhvillimi i nocionit, shpjegimi i termit dhe më pas historia e një gjinie, lloji apo nënlloji letrar siç do të duhej të ishin më vete (dhe

[16] FESH. f. 1856
[17] FESH. f. 2257

nuk janë) për shembull: Epika, Lirika, Soneti, Elegjia, Poema, Madrigali etj. (Rasti i vetëm i një informacioni të strukturuar e të plotë vjen në zërin "Dramaturgjia", shkruar nga Josif Papagjoni). Në të njëjtën kohë, ky zbërthim strukturor është krejt i saktë në rastin e Folklorit po në të njëjtën enciklopedi. Zërat janë më vete dhe i gjegjen logjikës së zbërthimit dhe historikut të një lloji e nënlloji letrar konkret: Folklori, Balada, Epika popullore, Eposi i Kreshnikëve, Legjenda, Lirika popullore, Mitologjia popullore, Përralla, etj. Nëse një përdoruesi të *Enciklopedisë* do t'i duhej të informohej mbi Epikën letrare shqipe, ai nuk do ta gjente dot këtë zë dhe për pasojë nuk do të mësonte mbi rrugëtimin e epikës shqipe (si epope letrare) në veprat e De Radës, Gavril Darës, Skiroit, Naimit dhe Fishtës. Duke kaluar nga një zë enciklopedik në tjetrin, si tek ata kushtuar autorëve ashtu edhe tek ata që sqarojnë dukuri dhe nocione, shfaqet një moskoordinim sistematik edhe mes zërave dhe cilësimeve për dukuri, autorë, periudha, vepra. Po sjellim në këtë artikull edhe shembullin e fundit (siç jemi të kufizuar nga hapësira e një kumtimi):

- Në zërin "Estetika", ku synohet një sqarim i termit dhe historia e mendimit estetik shqiptar, mungon i vetmi autor i viteve '30 që ka hartuar dhe botuar po në ato vite një mendim të strukturuar dhe origjinal estetik, Gjergj Fishta. Harrohet mendimi estetik i Fishtës, i ribotuar edhe në vitin 1999 në një libër më vete[18], pikërisht në këtë zë, tek i cili gjejmë edhe përpjekjen për të argumentuar ekzistencën e ndoca gjurmëve të mendimit apo problematikave estetike. Autori i zërit është kujdesur gjithsesi të rendisë, me shumë modesti, të gjitha veprat e tij personale botuar gjatë viteve 1970-2007. Në punë e sipër ai ka harruar ndoshta të lexojë zërin "Gjergj Fishta" të po kësaj enciklopedie, në të cilin jepet informacion konkret për mendimin estetik të Fishtës dhe botimin e tij.

Por ky është vetëm një shembull ndër dhjetëra të tjerë. Ngjan sikur artikujt e kësaj enciklopedie janë lexuar nga redaksia pa u konfrontuar e "harmonizuar" qoftë edhe pjesërisht me njëri-tjetrin. Disa nga problemet e këtij fjalori mund të ishin shmangur pikërisht kështu. Ka vetëm një rast kur ky moskoordinim rezulton i koordinuar: kjo është harresa aktive, është

[18] FISHTA, Gjergj, në *FISHTA* : *Estetikë dhe Kritikë*; antologji e përgatitur nga Persida Asllani, Tiranë, Hylli i Dritës dhe ShLK, 1999

zhdukja e papërligjshme e "modernizmit shqiptar".

Renditja e këtyre harresave dhe shumë të tjerave që për arsye kohe dhe vendi nuk mund të paraqiten këtu ndërton panoramën aspak të bukur dhe etike të një mendimi shkencor letrar dhe të një mendimi kritik letrar jo vetëm të paemancipuar, jo vetëm ende peng të një hierarkie artificiale të së shkuarës sonë totalitare (sidomos kulturalisht), jo vetëm pasiv ndaj prurjeve të reja e të fuqishme në studimet letrare të këtyre 20 viteve të fundit, por aktiv e të guximshëm në mistifikime të vazhdueshme, në heshtje të qëllimshme dhe në zhdukje të paargumentueshme dukurish, veprash, emrash dhe kontributesh. Shumë larg nga një mesatare e pranueshme e "subjektivitetit kritik dhe gabimit njerëzor", kjo panoramë shpie vetvetiu në pikëpyetje jo më vetëm të karakterit shkencor por kryesisht etik. Të gjithë jemi subjektivë përballë tekstit letrar, letërsisë dhe artit, liri me të cilën kemi lindur dhe me të cilën veprojmë e shkruajmë edhe kur bëhet fjalë për një fjalor enciklopedik, botim të një akademie shkencash. Por duke iu rikthyer metaforës së Limbit dantesk me të cilën e hapa këtë diskutim, nuk më mbetet gjë tjetër veçse të them se harresa e etikës dhe e ndershmërisë shkencore nuk e ka vendin aty!

Vjollcë BERISHA, Tetovë

10 VËSHTIRËSI TË PËRFSHIRJES SË LETËRSISË SHQIPE NË BOTIMET ENCIKLOPEDIKE

KDU 82:03

Nëse strehimi i dijes letrare nëpër enciklopedi, veç të tjerash, trajohet si një çështje e determinuar jo rrallë edhe nga rrethana jashtëletrare, mund të listohen një sërë vështirësish që dalin përpara hartuesve të enciklopedive, fjalorëve enciklopedikë dhe botimeve enciklopedike në përgjithësi. Ato sqarime të sakta që përmblidhën përpara duarve tona në zëra të ndryshëm, të vegjel, të mesëm a të mëdhenj, kalojnë në radhë të parë nëpër filtrin gjykues të hartuesit të tekstit, nëpër sistemimin dhe hamendësimin nëse aksh zëri duhet të qëndrojë, nëse informacioni është i mjaftueshëm për aq sa i duhet natyrës së tekstit që hartohet, nëse radhitja e të dhënave është e drejtë e një varg dilemash të tjera të rrafshit subjektiv, pa kaluar në vështirësitë që dalin nga rrethana të caktuara të jashtme, objektive. Këto që u përpoqëm t'i shprehim në mënyrë të përmbledhur janë emëruesi i përbashkët i problemeve që dalin gjatë përpilimit të akëcilit botim me natyrë enciklopedike, pavarësisht nga gjuha a kultura që e prodhon, për të kaluar pastaj në shkallë të së veçantës, ku vijnë në shprehje probleme të tjera që e karakterizojnë një kulturë, një komb apo edhe një fushë të dijes. Parë në vija të trasha po radhisim 10 vështirësi që dalin gjatë përpunimit dhe përfshirjes së zërave që kanë të bëjnë me letërsinë shqipe, disa prej të cilave vlejnë edhe për zërat e letërsisë në përgjithësi. Ky mëtim për të vënë në pah në mënyrë të përmbledhur vështirësitë nuk bëhet vetëm për shkak të ndonjë përligjjeje të lëshimeve, por që duke rrugëtuar nga vështirësitë te lëshimet, duke e vënë theksin në to, të mbërrihet deri te botime edhe më gjithpërfshirëse se këto që kemi hë për hë.

Një nga vështirësitë themelore gjatë hartimit të enciklopedive, përkatësisht të zërave që kanë të bëjnë me letërsinë shqipe është *vëllimi i madh i kësaj lënde*, autorët, periudhat, rrymat, që nuk përfshihen dot në tërësi, por vetëm ato që me disa kritere të gjithëpranueshme kanë zënë vend në sistemin e vlerave. Procesi i përzgjedhjes vështirësohet edhe më kur

bëhet fjalë për letërsinë bashkëkohore, për të cilën historia e letësisë, për shkakun e ditur të mungesës së distancës së mjaftueshme kohore për vlerësimin e drejtë të veprave, si dhe për shkak të fluksit të madh, gati-gati të pakontrollueshëm të botimeve në të gjitha trojet ku jetojnë shqiptarët, ende s'e ka mbyllur "hesapin" përkitazi me vlerësimin përfundimtar të saj.

1. *Periudha kohore që shenjon zëri (paradigmat).* Një problem tjetër që shfaqet përpara hartuesve të enciklopedive është edhe përzgjedhja e autorëve që nuk paraqesin ndonjë vlerë të veçantë krahasuar me majat e letërsisë, por që me veprën e tyre kontribojnë në zhvillimin e ndonjë rryme apo që shenjojnë prurje në ndonjë ngjarje a lëvizje edhe jashtëletrare, vështirësi kjo që përpiluesit e fjalorëve enciklopedikaë apo të botimeve enciklopedike në përgjithësi e zgjidhin me përcaktimin për vepra paradigmatike dhe dukuri novatore në letrat tona.

2. *Rrethanat historike kombëtare (copëtimi i Shqipërisë)*Fakti që shqiptarët jetojnë në disa shtete dhe krijojnë në hapësira të ndryshme gjeografike e vështirëson njohjen dhe përmbledhjen e të gjithë autorëve dhe veprave në një vend. Kjo njohje vështirësohet edhe më në mungesë të institucioneve përkatëse jashta Shqipërisë londineze dhe jashta Kosovës, të qendrave encikolpedike apo të instituteve të letërsisë, ku do të sistemoheshin të dhënat, do të vlerësoheshin, duke u krijuar kështu natyrshëm një sistem vlerash dhe do t'i jepej e gatshme cilitdo projekt serioz enciklopedik apo të ndonjë natyre tjetër. Së këndejmi mund të vlerësohet që përveç shtrirjes së gjerë gjeografike të shqiptarëve në shtete të ndryshme administrative (përfshirë edhe diasporën), njohjen dhe përfshirjen e letërsisë sonë në mënyrë më të plotë e vështirëson edhe të qenit e shqiptarëve që jetojnë përtej kufijve shtetërorë të Shqipërisë jashtë institucioneve shkencore, gjë që rezulton me mospasjen e një sistemi të plotë të dhënash dhe me vështirësinë e selektimit dhe përfaqësimit të drejtë në botime enciklopedike.

3. *Periudha e socrealizmit dhe rishikimi i kritereve vlerësuese të asaj kohe.* Një nga vështirësitë që u shfaqën gjatë përpilimit të teksteve enciklopedike pas rënies së komunizmit në Shqipëri ishte rishikimi i kritereve gjatë hartimit të tyre, gjatë ribotimeve e plotësimeve. Për arsye që dihen, shumë emra autorësh e vepra të përfaqësuara mirë në botimet e hershme, janë redaktuar ose hequr fare në botimet e mëvonshme postkomuniste. Për

shembull, botimi i vitit 2008 i Fjalorit enciklopedik shqiptar përfshin 7200 zëra për dallim nga botimi i 1985-s, i cili përfshin 5000 zëra. Në këtë rritje, sikurse e pohojnë edhe autorët, krahas shtesave të natyrshme, që vijnë si pasojë e kalimit të viteve, siç është, bie fjala, realiteti i ri i krijuar në Kosovë pas 1999-ës, janë bërë edhe shtesa të tjera të autorëve dikur të padëshiruar, janë redaktuar zëra, si dhe janë fshirë disa që me kriteret e sotme vlerësuese konsiderohen të parëndësishëm.

4. *Natyra e letërsisë.* Meqë letërsia, për dallim nga shumë fusha të tjera, është një lëmi pothuajse krejtësisht refuzuese ndaj përkufizimeve strikte, sidomos kur ka të bëjë me vepra letrare, stile autorësh, karakteristika periudhash etj., si një nga vështirësitë "sui generis" në hartimin e zërave që lidhen me letërsinë, duhet radhitur edhe vetë natyra e saj. Përpara përpiluesit të këtij zëri qëndron sfida e madhe e selektimit të informacionit mbi të, sfida e radhitjes së të dhënave, e parashtrimit dhe e sqarimeve të ndryshme që jorrallë kërcënohen nga subjektivizmi. Ndonëse ai "syri i madh "i enciklopedisë rëndomë përpiqet t'i rrokë gjërat e përgjithshme, karakteristikat kryesore që mund të krijojnë një ide solide për zërin në fjalë, por në rastin e letërsisë këto karakteristika janë të lakueshme dhe shpesh të pamjaftueshme për ta dhënë të plotë informacionin mbi një zë letrar. Bie fjala, a mjafton të thuhet vetëm roman biografik, apo roman historik tek flet për një vepër kapitale të letërsisë? Apo me cilat cilësime do të mund t'i afroheshe më shumë thelbit të një vepre? Ose dilema tjetër se cilës shtresë kuptimore t'i referohesh. Ç'të shkruash për autorin? Cilat fjalë mund ta japin më të plotë veçantinë e tij si krijues? Si të jepet mendimi i përgjithshëm, i ngritur disi në standard nga kritika, për të mos u mundur nga gjykimet subjektive mbi një autor a vepër? A mjafton të përmenden dy-tre vepra për ta prezantuar sadopak krijimtarinë e autorëve më produktivë? Cila nga veprat e autorëve të mëdhenj meriton të paraqitet si më e mira? Me ç'kritere arrihet ky përfundim? Kjo dilemë e fundit mund të ilustrohet edhe me faktin se në tekste të ndryshme enciklopedike mund të gjenden mendime të ndryshme për sa i përket veprës më të njohur apo më të arrirë të një autori. Siç është, bie fjala, rasti me Ismail Kadarenë, si vepër më e njohur e të cilit në pothuajse të gjitha enciklopeditë figuron "Gjenerali…", ndërsa në enciklopedinë universale kroate të ilustruar si vepra më e rëndësishme e Kadaresë qëndron "Kështjella".

5. *Dozat e subjektivizmit të hartuesve të tekstit***.** Nisur nga natyra e veçantë e letërsisë mund të konstatohet lehtë se një vështirësi reale që del përpara përiluesit të zërave mbi letërsinë në tekstet enciklopedikë është shmangia e subjektivizmit gjatë gjykimit mbi një autor a vepër, meqë në të shumtën e rasteve hartuesit i duhet të japë një vlerësim të vetin mbi ta.

6. *Steriotipet, përplasjet etnike dhe paragjykimet e "nikoqirëve të enciklopedive"*. Duke pasur parasysh natyrën pak a shumë subjektive të përpilimit të këtyre teksteve, ka vend për të diskutuar edhe mbi mundësinë e të rënit të hartuesve pre e stereotipeve apo edhe përplasjeve etnike. Kjo më tepër vihet re gjatë përpilimit të teksteve të përgjithshme enciklopedike, në të cilat përfshirja dhe cilësia e tekstit të zërit motivohet nga faktorë krejtësisht jashtletrarë. Bie fjala, është kryekëput jo profesional veprimi i redaktorëve dhe përkthyesve të Enciklopedisë Britanika në gjuhën maqedone, të botuar në vitin 2005, por si tekst i shkurtuar dhe i redaktuar (sqarim ky që jepet në parathënien e botimit të përkthyer), të cilët te zëri ku flet për shkrimtarin Ismail Kadare në 10 rreshta thonë se I. Kadare është romancier dhe poet, i biri i një zanatçiu, se ka punuar gazetar dhe se romanet e tij më të njohura janë *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* (1963), në të cilën flitet për Shqipërinë në LDB, si dhe *Kështjella* (1970), vepër tek e cila është marrë me hulumtim të nacionalizmit shqiptar, cilësim ky i cili jo vetëm që nuk gjendet askund në tekstin origjinal të enciklopedisë Britanika, por nuk gjendet në asnjë tekst tjetër që flet për këtë vepër. Gjithashtu, zëri mbyllet me sqarimin se Ismail Kadareja është shqiptari i vetëm me renome ndërkombëtare në shekullin XX, konstatim ky që gjithashtu nuk ekziston në tekstin origjinal.

7. *Mungesa e komunikimit të plotë ndërkuluror edhe në ditët e sotme*, i cili komunikim do ta zbuste sadopak mungesën e institucioneve kompetente për ruajtjen e vlerave dhe afirmimin e tyre sidomos jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë dhe do të mundësonte një lloj selektimi prej nga, më pastaj, do t'u servohej redaksive të përpilimit të enciklopedive letare apo edhe të fjalorëve enciklopedikë në përgjithësi.

8. *Mungesa e një historie të mirëfilltë letrare dhe e një fjalori serioz letrar* që do të ishin bërthamë për hartimin e enciklopedive të përgjithshme në të ardhmen.

9. *Zgjedhja e një kriteri që do të përcaktonte dominanten e informacionit për të gjitha zërat që kanë të bëjnë me letërsinë*, e cila është një çështje metodologjike e vështirë për t'u zbatuar te zërat mbi artet, por e domosdoshme gjatë hartimit të teksteve enciklopedike.

Nysret KRASNIQI, Prishtinë

LETËRSIA E KOSOVËS DHE ENCIKLOPEDIA

KDU 821.18(496.5):03

Pa hyrë në *etimologjinë* e nocionit, në *arkeologjinë* dhe *historinë kulturore* të burimësisë së kësaj *disipline* nga *fjalorët*, në *diskursivitetin* e saj, shumëllojshmërinë, mund të veçojmë mendimin e Didërosë për *enciklopedinë* që thotë se *ne nuk duhet të vdesim pa i bërë një shërbim racës njerëzore e cila do të pasojë*. Kjo thirrje me premisa pararomantike, por edhe filozofike kulturore, kur përkthehet në kulturën tonë gjen vend, kohë e hapësirë, madje shndërrohet në zë kumbues për ta sprovuar *vetëdijen* tonë për *ikonografinë* e këtij vendi. Jemi në fushën e *semiotikës* dhe nuk di *semë* më të fuqishme të kësaj hapësire sesa letërsinë, e cila do të përbashkohej në esencat e substancës ikonografike shqiptare.

Këtu po e rrah çështjen e krijimit të një objekti enciklopedik të përgjithshëm nacional, një trupi njohjeje, ku *sema letrare* tashmë e diseminuar do të integrohej në këtë *ikonë*. Mirëpo, para se të ndodhte kjo, sheshohet pikëpyetja sfiduese: A do të duhej të jetësohej *ikona poetike* e letërsisë së Kosovës, e cila do të përbënte një shtresë *strukturore të lëndës* së *Enciklopedisë së Kosovës* e me gjerë edhe të strukturës së *Enciklopedisë nacionale*. Ma merr mendja se po! Ideja e brezave për totalitetin gjenetik të kulturës dhe të letërsisë nacionale nuk do të vihej në krizë, nëse fokusi ynë do të përqëndrohej në fatumin historik të Kosovës, fenomenet kulturore të saj, zërat letrarë tashmë të etabluar etj., për ta krijuar kështu këtë ikonë poetike të saj. Përdorim nocionin *ikonë poetike* për dy arsye: e para, ka të bëjë me fatin apo fatkeqësinë historike dhe, e dyta, ka të bëjë me veçantinë letrare brenda llojit apo gjenezës.

Nëse me gjuhën shqipe nënkuptojmë identitet nacional, letërsia shqipe në Kosovë, në planin e përgjithshëm, është pjesë e pandashme e letërsisë nacionale. Njeriu i Kosovës *rrëfeu*, *këndoi* dhe *shkroi* shqip. Gjuha, në manovrimin e saj në këto tri rrafshe, u shndërrua jo vetëm në mjet autentik të komunikimit, por u bë bartëse e fuqishme e trashëgimisë etnike e nacio-

nale. Dëshmi të kësaj janë narracionet e autorësisë anonime të miteve, legjendave, baladave, pra faza *fantastike*, e cila ka qëndruar e fuqishme deri në ditët tona. Mirëpo, njeriu i Kosovës edhe *këndoi* shqip, duke e shndërruar zërin e tij në mjet për ruajtjen e trashëgimisë epike dhe, më vonë, për ruajtjen e *kujrisë* etnike. Kjo fazë *metonimike* popullore është e gjallë edhe sot nëpër cepat e ndryshëm krahinorë, ku kultura e oralitetit ruhet si reminishencë. Duke e ditur fenomenologjinë e komunikimit të këtyre dy formave të shprehjes artistike të shpirtit etnik-nacional, pra jetën e tyre në variante, pa asnjë dyshim, mund të themi se ka qenë gjuha shqipe që i ka transformuar ato nëpër kohë në tërë arealin gjuhësor të saj. Dëshmi e kësaj janë rrëfimet e njëjta, por në variante, të kulturës mitike, legjendare e baladike në tërë orbitën e saj. Dëshmi e kësaj janë këngët rapsodike, por në variante, në tërë hapësirën shqiptare. Mirëpo, njeriu i Kosovës, ndonëse vonë dhe ngjashëm me hapësirat e tjera shqiptare, përdori edhe *alfabetin*, pra *germat* dhe *rrokjet*, për ta jetësuar *tekstin* apo *teksturën* e tij shpirtërore.

Por duke e ditur se shkrimi është proces historik, i cili kushtëzohet nga qendrat dhe institucionet, atëherë domosdo janë rrethanat kulturo-historike, politike-ideologjike që e determinuan në masë të madhe shtrirjen e tij. Fati historik i Kosovës thotë se tashmë jemi shtet i dalë nga një krijesë federale artificiale që quhej Jugosllavi, e cila po harrohet edhe në *psikenë* e përgjithshme, por askush nuk mund ta mohojë se kjo ngrehinë ka diktuar krijimin e një konteksti tjetër politik, social e kulturor, i cili domosdo ka ndikuar edhe në krijimin e kësaj ikone poetike. Këtë e themi pa ngurrim, sepse fati historik nuk është dëshirë dhe nuk mund t'i shtrohet procesit reversibil. Ndërsa veçantia letrare është sforcuar pikërisht mbi këtë kauzalitet historik, të prerjes historike, të dhunës sistematike, të shpërnguljes, pastaj alfabetizmit, të krijimit të institucioneve arsimore e shkencore etj., duke e shndërruar shkrimin letrar në *figurë* të një realiteti apo *figurë të shpirtit shqiptar* në këto hapësira, po flasim gjithnjë për letërsinë e shkruar, duke e ndërtuar kështu gradualisht *ikonën poetike të Kosovës,* kështu që, nëse shpërfillen këto dy evidenca, atëherë ekziston rreziku që, në emër të një totaliteti të kulturës dhe të letërsisë nacionale, të ndodhë defaktorizimi nacional-shtetëror dhe kulturor-letrar, dhe, në instancën esktreme, fshirja e Prishtinës si qendër e fuqishme e ikonës politike e kulturore të Kosovës.

Të mos habitemi: me fjalën *poetikë* nënkuptojmë dy gjëra: diskursin

fenomenologjik e teorik të shkaqeve dhe pasojave, të cilat kanë diktuar në jetësimin e letërsisë së Kosovës dhe pastaj diskursin poetik për zërat e veçantë të kësaj letërsie, të cilët tashmë qëndrojnë në hierarkinë letrare pa e pasur nevojën e pranimit nëpërmjet diskursit hermeneutik. Sepse diskursi enciklopedik në fushë të ndërtimit të ikonës letrare të Kosovës duhet të jetë poetik, të themi i një gjuhe pa *frikën* dhe *lojën* e madhe hermeneutike, madje i sprovuar në nivelin *antologjik*, *anektodik* e *gjenetik* (Roland Barthes: 1980:24).

Tashmë kur kemi një shekull vetmi, nga e cila doli shteti ynë, duke mos mohuar asnjë shenjë të totalitetit nacional, e shtrojmë pikëpyetjen e ndjeshme e themi: Meqenëse kjo vetmi e ka ruajtur qenien dhe e ka krijuar shtetin, atëherë ky shtet i ri a duhet ta ruajë trashëgiminë e tij të veçantë si shenjë të identitetit të vet, apo ta shuajë atë mbi filozofinë e shkrirjes në totalitetin e trashëgimisë nacionale shqiptare, e cila ruan shenjat e veta në tërë hapësirën shqiptare? Ma merr mendja se është e para, e cila nuk e lëndon aspak të dytën. Nëse kultura nacionale është shuma e përbërë nga pjesët, si pasojë e fatumit historik, atëherë letërsia e Kosovës është një pjesë e veçantë, madje themelore, e ikonografisë së projektuar nacionale. Ikonografia nacionale forcohet e njihet më shumë nëse tumiret gnoseologjia e njeriut tonë. Pikëpyetja tjetër, e cila ka të bëjë pikërisht me këtë gnoseologji del me sa vijon: Nëse enciklopedia pretendon ta ruajë të kaluarën dhe të tashmen si dokument e monument për të ardhmen, atëherë a mund të themi se kemi njohje të mjaftueshme të vetmisë kulturore dhe letrare të Kosovës dhe korpus të mjaftueshëm të *autorëve të vdekur,* në kuptimin eliotean të termit, për ta strukturuar ikonën letrare të Kosovës? Ma merr mendja se, me gjithë ndërlikimet e karakterit historik e vullneteve pannacionale, konkluza do të dalë pozitive. Në vijimësi do të flasim në rrafshin aksiomatik të problematikës.

Identiteti i një kulture dhe letërsie nacionale nuk është perceptim, por evidencë, e cila, sidomos te ne, është ruajtur dhe ruhet nëpër *ndërmjetëzat* e teheve të mprehta ideologjike e politike, të hegjemonive të vjetra e të reja, për ta shenjuar kështu si shpëtim shpirtin shqiptar këtu. Nëpër këto ndërmjetëza është konsoliduar *gjuha* si shkrim e shkrimi si evidencë e një pune kolosale të kristalizimit dhe vetëdijes kulturore shqiptare në Kosovë. Kështu që fokusimi themelor duhet të jetë në *gjuhë*, e cila në artikulimet e saj

është filozofi autentike, me të cilën nuk kuptoj asgjë tjetër përveçse jetën kulturore, institucionale e letrare të saj në ambientin tonë të prerë nga ideologjitë dhe hegjemonitë e shumta. Nuk flasim këtu për mënyrën e shkrimit, por për filozofinë e gjuhës shqipe, e cila e ka ndërtuar aureolën e njeriut të Kosovës. Meqenëse gjuha e enciklopedisë është poetike, atëherë evidencat duhet të jenë joideologjike e jocensuruese, sepse *ikona* bart në mozaikun e saj edhe shenjat e ndryshme për ta reflektuar identitetin e vet.

Tashmë shtojmë edhe një çështje problemore, e cila rrok dimensionin e ndjeshëm të iluzionit prapavështrues. Ai që njeh udhën e Kosovës në vetminë e saj shekullore dhe kupton fatumin e saj historik, politik e ideologjik nuk do ta ketë asnjë problem pranimin dhe vlerësimin e fuqishëm të identitetit kulturor, institucional e letrar si një evidencë të ndërtuar nëpër ndërmjetëzat e rrezikshme, identitet ky i cili po na shpie drejt sovranitetit në kuptimin e shenjës sonë në botë. Ai i cili nuk e njeh, apo nuk do ta njohë, do të kredhet në hamendësime e perceptime, të cilat burimësinë e kanë në iluzionin prapavështrues duke gjetur mbështetje në mbrojtjen e rrejshme për totalitetin apo njësinë e vetme të kulturës dhe letërsisë nacionale, për pa e kuptuar kurrë se nacionalja është shuma e pjesëve të dallueshme brenda llojit. Hap i mirë madje i nevojshëm do të ishte kërkimi i evidencave letrare, qofshin ato të ngjyrosura apo të fundosura në ideologjitë e ndryshme, në pajtim me kornizat pushtetore apo në shmangie latente nga to, sepse janë pikërisht këto përplasje, kriza, orientime, mbyllje poetike e hapje poetike, të cilat e kanë ndërtuar identitetin tonë të *germës* kosovare. Madje ky korpus kulturor, i cili qysh në vitet '60 arriti në 150 autorë të formave e zhanreve të ndryshme të shkrimit, i cili u shumëfishua deri më sot, thërret për pjesëmarrje në ikonografinë enciklopedike të Kosovës. Sepse, enciklopedia në esencë del të jetë ikonë orientimi që në momentin kur një kulturë identitare, në vijimësinë e saj historike, dinamizohet dhe e bën luftën ndërmjet kujtesës dhe harresës. Nëse në dinamikën e furishme të mediumeve masive sulmohet në vazhdimësi kultura e përgjithshme e tekstit, e cila e ka zvetnuar durimin hulumtues kulturor dhe ka shkaktuar rrudhjen e kulturës në disa vepra e autorë, atëherë kemi të bëjmë me prirjen e harresës kulturore. Kur kësaj vale ia shtojmë edhe të dhënën se letërsia e Kosovës është zhvilluar e përballur me amplitudat e sistemeve politike, të cilat herë e kanë lejuar frymën e saj, herë e kanë ngulfatur deri

në djegie librash, atëherë dikush mund të mendojë se letërsia e Kosovës rrudhet në disa vepra. Por e vërteta kulturore del të jetë tërësisht tjetër dhe ketë na e thotë jo mendimi i egër e me bazë në fisnikërinë egoiste, por ai që bazohet në hulumtimet empirike me qëllime gnoseologjike të korpusit të letërsisë së Kosovës.

Përveç *lexuesve modelë* (Eko), kush njeh veprën filozofike, teologjike e letrare të Pjetër Bogdanit, pastaj etnologjike-letrare e kodifikuese të Gjeçovit? Kush njeh sot lirikën sociale të Esad Mekulit, tregimet e përkthimet e Zekeria Rexhës, pastaj totalitetin lirik të Enver Gjerqekut, Din Mehmetit, Besim Bokshit, Adem Gajtanit, Fahredin Gungës, Azem Shkrelit, Rrahman Dedajt, Ali Podrimjes, Beqir Musliut, etj, shumica prej të cilëve qysh në valën nistore të krijimtarisë së tyre botuan vepra të çmuara letrare, duke e lakuar brenda mundësive të tyre shqipen poetike në kuadër të letërsisë së Kosovës. Kush njeh sot shpërthimin estetik modern të viteve '70 me librat e Anton Pashkut, Eqrem Bashës, Sabri Hamitit, Teki Dërvishit, Zejnullah Rrahmanit, Rexhep Qosjes, Musa Ramadanit, Mehmet Krajës, Nexhat Halimit, Ramadan Musliut, Edi Shukriut e të tjerëve, të cilët sot janë shenja të ikonës së identitetit letrar të Kosovës për faktin se patën vetëdijen se letërsia nuk duhet të shkruhet si *rrjedhë historiciste*, por krijohet si botë e ndërliqshme për lexuesin estetik të kohës *zero*. Këta autorë, shikuar në planin fenomenologjik, konsoliduan një letërsi shqipe si *differentia specifica,* qoftë kur forcohet dimensioni personal i tekstit, qoftë kur me anë të risemantizimeve hyhet në arkeologji e histori nacionale, qoftë kur vihet edhe një lojë e madhe apo aventurë në shpërndërrimin e formave shkrimore. Në këtë udhë fuqizohet zhanri i prozës letrare, tregimi, romani e drama, ku kemi *literaritete* psikologjike, alegorike, avangarde, refleksive, arki-historike etj., në të gjitha format moderne të lojës me prizmat narrativë e strukturorë, ndërsa poezia arrin majat e shprehjes metaforike.

Kjo valë e shpërthimit kulturor përcillet edhe me mendimin letrar ku forcohen edhe autorët e kritikës si Rexhep Qosja, Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, Rexhep Ismajli, Mensur Raifi, Ali Aliu etj., të cilët krijimtarinë letrare e shqyrtojnë në përqasje me rrymat dhe metodat e ndryshme evroamerikane të aplikuara në tekstin letrar shqiptar. Duke ikur nga kritika dogmatike forcohen teoritë pozitiviste, filozofia e letërsisë, analiza strukturale e gjuhësore, kritika psikanalitike, etj., për ta afruar kështu studimin

letrar me fiksionin letrar. Prishtina bëhet qendër reflektuese e rrezatuese kulturore e arsimore. Kosova e bën jetën e vet bazuar mbi emrat e vet, markat e veta, duke krijuar kështu aureolen etnike. Kosova përjeton gjallërinë nacionale dhe jeton si republikë letrare pa nominimin zyrtar të saj. Nacionalja merr hapësirë duke e sfiduar komunizmën artificiale.

Por histeria antishqiptare, jugosllave e veçanërisht serbe, e cila ishte latente, u ringjall në vitet ,80 pikërisht në shenjë mosdurimi ndaj rritjes shqiptare. Kjo histeri sulmin nistor e bëri në kulturë, pra në gjuhë, në arte për të vazhduar në arsim, shkencë, institucione, duke kulmuar në vitin 1989 me shuarjen brutale të institucioneve të Kosovës. Dhe janë pikërisht autorët e Kosovës, të cilët u detyruan që nga *homo poeticus* të kapërcejnë në *homo politicus* për ta mbrojtur kulturën e traditën shqiptare. Pra, për ta mbrojtur atë që kishin rikujtuar dhe ndërtuar vetë. *Për të mbajtur jetën dhe artin jemi bërë zoon politikon*, tha në vitin 1990 Ibrahim Rugova, i cili edhe i priu për më shumë se dy decenie mbrojtjes së shpirtit shqiptar në udhën drejt mvehtësisë. Por kjo udhë, thënë me figurë, ishte kapërcim nëpër *nivelet e ferrit* te Dantes, pra të hegjemonisë së vrasjes e të vdekjes, e cila kulmoi me tendencën e shfarosjes e që u ndërpre në vitin 1999. Dhe janë pikërisht autorët e viteve '70 dhe '80 ata të cilët nga vdekja patën fuqi të shohin dritën e jetës, duke vazhduar ta ruajnë shpirtin njerëzor nëpërmjet vazhdimit të shprehjes artistike.

Sabri Hamiti vazhdoi *poiesisin* e veçantë të tij, por edhe studimin e autorëve të modernitetit shqiptar, të cilët i ringjalli në hapësirën shqiptare, Zejnullah Rrahmani botoi romanet për etninë, Ali Podrimja vazhdoi thirrjet poetike, Teki Dervishi kujtoi figurat historike e kulturore, Eqrem Basha mbrojti refleksivitetin e tij poetik, Mehmet Kraja ndërtoi figurën e netëve bizantine etj., për ta mbajtur gjallë kështu letërsinë në kohë vdekjeje!

Prandaj, meqenëse kemi dëshirë të merremi me *autorët* e jo me *shkrimtarët*, atëherë janë pikërisht këta autorë, të cilët dalin në vitet '70 dhe '80, disa prej të cilëve nuk janë gjallë, që e mbajnë gjallë frymën e letërsisë së Kosovës. Që sot mund t'i cilësojmë *klasikë të letërsisë* së Kosovës në kuptimin eliotian të termit.

Problemi themelor del të jetë me ndërmjetëzen kohore të fundit të viteve '80 dhe të dekadës së viteve '90, kur evidencat letrare përjetojnë

"mesjetën komunikuese". Autorët tanë, qoftë të traditës, qoftë ata që shfaqen me krijimtarinë e tyre filluese nuk e njohin mediumin, diseminimin, dhe letërsia priret të komunikojë si prani e mungesë, pra shndërrohet në *urbis* pa e ditur pranimin apo mospranimin e *orbit*, të përdorim një terminologji kishtare. Kështu që, nëse deri në këtë zonë kohore kemi një pamje, sado e brishtë qoftë ajo, vitet 90-të dalin kokëçarëse për bibliografin e mundshëm, madje sfiduese edhe për projektin e ikonografisë së letërsisë së Kosovës. Madje ne nuk kemi një pamje të besueshme edhe në planin bibliografik e biografik, e cila duhet të plotësohet si parakusht themelor për ta nisur poetikën e ikonografisë së letërsisë sonë. Kjo kërkon hulumtim empirik e shkencor për të përfshirë edhe të tashmen e shekullit të ri të letërsisë sonë. Pra, hulumtimi rrok tri periudha themelore: traditën letrare të Kosovës, qoftë ajo mitologjike, historike, etnografike e literare deri në vitet '80, pastaj hulumtimin si iluminim të viteve '90 për të prekur edhe letërsinë e shekullit të ri, ku në një zonë kohore do të arrihej të plotësohej ikonografia letrare e Kosovës nëpërmjet një filozofie të amalgamit të sinkronisë dhe diakronisë. Përveç kësaj, duhet të analizohen gazetat, revistat, institucionet kulturore, e duke e respektuar traditën tonë akademike, edhe vepra e redaksisë enciklopedike të Kosovës në kuadër të projektit enciklopedik të mëparshëm, në mos më shumë për t'i ruajtur shenjat e një kohe dhe për ta parë mundësinë e plotësimit, të ridimensionimit dhe të avancimit.

Pa asnjë dyshim jetësimi i kësaj enciklopedie, në bazë të standardeve të vendosura, do të ndryshonte *mënyrën e të menduarit* për letërsinë e Kosovës. Rivlerësimi i letërsisë së Kosovës do të ridimensiononte edhe *poetikën e letërsisë shqipe* në përgjithësi dhe do të ringjallte autorët e Kosovës në të tashmen dhe të ardhmen nacionale, ku koncentrimi i lexuesit dhe i studiuesit të ardhshëm do të zgjerohej dhe do të kapërcente *klishenë* e disa autorëve, të cilët tani për tani më shumë jetojnë në botën e mitit sesa në hieraktinë normale të rendit të vlerave të kulturës nacionale.

Kur tashmë jetojmë në një botë dinamike dhe me tendenca të ndryshme të hegjemonive gjuhësore, letrare e kulturore në përgjithësi, jetësimi i ikonografisë letrare të Kosovës në kuadër të *Enciklopedisë së Kosovës* shndërrohet në imanencë politike e ideologjike. Jo pse diskursi enciklopedik duhet të ngjyroset nga ideologemat, por i mbrujtur me diskursin poetik do të shndrrohej në një *monument autentik kulturor* të

njeriut, kohës dhe hapësirës shqiptare në Kosovë. Vetëm nëpërmjet rikujtesës së shenjave letrare do të ngjallej hermeneutika e shprehjes artistike në Kosovë, e cila më pastaj do të diseminohej edhe në mediumet virtuale, për ta sfiduar me kulturë tendencën e harresës dhe të hegjemonisë kulturore, e cila del të jetë latente, madje vepruese në Ballkan, ku nocioni *kosmopolitizëm* ende shqiptohet me humor!

Laura SMAQI, Tiranë

LETËRSIA SHQIPE MES DY LUFTËRAVE BOTËRORE NË FJALORIN ENCIKLOPEDIK SHQIPTAR TË VITIT 2008-2009

KDU 821.18(091)
03(=18)"2008/2009"

Brenda fjalorëve enciklopedikë shqiptarë, letërsia është një ndër fushat e shumta të përfshira. Konkretisht, në fjalorin e fundit enciklopedik që po marrim në shqyrtim, ajo është një nga njëzet e një fushat tematike përbërëse, fakt ky që natyrisht e kufizon shtrirjen e saj. Një enciklopedi e letërsisë do të ishte idealja për paraqitjen në parametra të duhur të letërsisë shqipe dhe kontributit në shkallë të ndryshme të autorëve. Ajo do të propozonte pamjen më të gjerë të mundshme të personaliteteve, veprave, rrymave që kanë qenë pjesë e letërsisë sonë që prej fillimeve të saj deri sot, por po t'i kthehemi hapësirës së FESh, problematikat që mund të vëmë në dukje lidhen me

- fjalësin ose listën e zërave, përfshirjen e autorëve në fjalor;
- me kategorizimin e zërave sipas rëndësisë e kontributit në zëra të mëdhej, të mesëm e të vegjël;
- me mosruajtjen e raporteve të duhura mes zërave;
- me mënyrën e hartimit të zërit përkatës, ku vlen të diskutohet marrëdhënia mes informacionit dhe interpretimit të krijimtarisë së autorëve të përfshirë.

Po përqendrohemi në paraqitjen në vija të përgjithshme të problematikave të mësipërme në zërat që lidhen me letërsinë shqipe mes dy luftërave botërore.

1. Lista e zërave:

Mungesat e tepritë: Ndoshta si pasojë e vendit të reduktuar që letërsisë i takon të ketë, prerjet tematike, prerjet sipas qarqeve, sipas rrymave, shkollave, prerjet figurative e metrike të letërsisë, përkthimet, përshtatjet, rikrijimet, nuk zënë aspak vend në fjalor, duke e cunguar mjaft infor-

macionin me karakter të përgjithshëm mbi letërsinë që i jepet lexuesit.

Brenda autorëve pjesëmarrës e përfaqësues të periudhës bie në sy përfshirja e autorëve minorë të atij që është quajtur "brezi i viteve '30 "e në këtë linjë më pas dhe brezi i luftës.

Prania e tyre në një kontekst të caktuar ideologjik e politik ka qene krejtësisht e kuptueshme e e motivuar dhe në funksion të dhënies së idesë së brezit letrar, por përfshirja e Veli Stafës, KAPËS përmendja si letrar i K.Tutulanit në fjalor enciklopedik nuk motivohen më sot.

2. Mosruajtja e raporteve të duhura mes zërave:

▪ Autorët e kësaj periudhe që trajtojnë tematikë shoqërore janë nxjerrë më në pah si në aspektin e përfshirjes së tyre në fjalor, ashtu edhe në përshkrimin e vlerësimin që u është dhënë. Në këtë kuadër është kufizuar Henelau, apo krijimtaritë letrare me nota jo realiste siç janë vëllimet poetike të viteve '30 të Shuteriqit, që thjesht përmenden, ndonëse kanë luajtur rol e janë bërë objekt debatesh e diskutimesh në shtypin e kohës.

▪ Mbajtja e një raporti të diskutueshëm për sa i takon rolit që kanë luajtur autorë si Nikaj e Postoli në lindjen e zhvillimin e gjinisë së romanit vlen për t'u vënë në dukje. Nikaj "*është ndër nismëtarët e romanit në letërsinë shqiptare....Rrëfimi i thjeshtë dhe herë-herë naiv, gjuha dialektore dhe e papërpunuar sa duhet, ndërtimi jo gjithnjë i goditur i veprave formojnë veçoritë e stilit të N.N*[1] *".*

Për Postolin shkruhet: *"Krijimtaria e F.P. luajti rol të rëndësishëm në formimin e romanit shqiptar. Në "Lulja e kujtimit", vepra e tij më në zë ku spikat prirja realiste, F.P. e paraqiti vegjëlinë si forcën kryesore të luftës për çlirimin kombëtar. Romani u bë një ndër veprat më të njohura në v.'20-30"*[2].

Ndoc Nikaj duket sikur është vënë për t'u kritikuar, ndërsa Postolit i theksohet roli që ka luajtur në zhvillimin e romanit. Gjuha dialektore e njërit konsiderohet e papërpunuar ndërsa e tjetrit është plotësisht e pranueshme.

[1] Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 2009, vëllmi III, f.1843.
[2] Po aty, f. 2076.

▪ Nëse do të përqasim krijimtaritë përkatëse, krijimtaria e autorëve që kanë vijuar veprimtarinë dhe në periudhën e mëvonshme (pas Luftës së dytë Botërore) Shuteriqi, Marko, Spasse, duhet thënë se çfarë përmendet shkarazi ose aspak për periudhën e tyre të viteve ’30 ka pasur më shume ndikim në procesin letrar të kohës se sa krijimtaria e autorëve të “brezit të viteve ‘30” që përmendëm më lart, e që dalin si zëra më vete. Kjo për vetë faktin se të parët botuan përmbledhje poezish apo tregimesh, jo thjesht dhe vetëm krijime në shtypin e kohës.

▪ Prania jo me të njëjtën shtrirje e gazetave e revistave letrare

Roli që kanë luajtur revista si “Hylli i dritës”, “Leka”, në fushën e letërsisë, si në botime të krijimtarisë letrare ashtu dhe në fushën e kritikës nuk del në pah.

▪ E njëjta gjë mund të thuhet për revistën “Illyria” ku përveç këshillit botues shkruhet vetëm se “*artikujt dhe materialet e tjera të botuara në këtë revistë përligjnin në plan filozofik vijën politike të mbretit Zog. Në të u botuan në vijimësi shumë shkrime analitike, politike, ekonomike e shoqërore, që rekomandonin ndryshime të vogla, të pjesshme dhe graduale të regjimit. Në faqet e gazetës u shfaqën ide nga më të ndryshmet***.**[3]”

▪ dhe në ekstrem shkohet te revista “Minerva”, ku i gjithë zëri ka këtë formulim: “*Revistë shkencore e letrare, me ilustrime. Dilte në Tiranë, zakonisht një herë në muaj. Numri i parë doli në gusht 1932. U botuan 38 numra. Ishte e rrymës konservatore*[4]”.

▪ Më e zgjeruara paraqitet revista “Bota e re”, në të cilën përveç pjesës së informacionit mbi linjat ideore të gazetës: “*Trajtoi me frymë demokratike problemet themelore shoqërore, politike e kulturore. Drejtpërdrejt ose tërthorazi shtroi çështjen e ndryshimit të rendit shoqëror. Revista stigmatizoi regjimin e mbretit Zog, zbuloi plagët e shoqërisë së asaj kohe, ngriti çështjen e çlirimit të gruas dhe të mbrojtjes së lirisë nga rreziku i agresionit fashist italian. Në faqet e saj u botuan krijime letrare. Me B. R ‘‘bashkëpunuan intelektualë të shquar të kohës, si Migjeni, Bulka, S. Shpu-*

[3] Fjalori enciklopedik shqiptar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, vëllmi II, f.981.
[4] Po aty, f.1722

za, O. Plumbi, M. Treska etj. Revista botoi edhe përkthime nga shkrimtarë të huaj si: Viktor Hygo, Maksim Gorki etj.[5]"

Informacione të këtij karakteri nuk jepen për revistat e përmendura më lart, tek te cilat si pjesëmarrja bashkëpunëtorëve ashtu edhe llojshmëria e përkthimeve është akoma më e gjerë.

3. Mënyra e hartimit të zërit:

Reduktimi i kontributit: Kolë Mirdita – Helenau paraqitet tepër shkurt e në mënyrë të thjeshtuar. "*Në faqet e revistës "Djalëria" botoi vjersha dhe tregime me motiv patriotik e shoqëror që shquhen për frymën e theksuar romantike-sentimentale, notat e trishtimit dhe sinqeritetin e ndjenjave*.[6]", ndërkohë që përveç frymës nuk jepet asnjë konsideratë për veçoritë e vlerat artistike të krijimtarisë së Helenaut,

Në një varg figurash që hyjnë në FESh dhe si personalitete historike edhe si letrare (Fishta, Konica e sidomos Noli) marrëdhëniet mes veprimtarisë letrare dhe asaj politike, shoqërore paraqiten në përmasa të ndryshme.

• Po ashtu dhe ngjyrimi emocional shfaqet i ndryshëm për autorë të ndryshëm. Te zëri i Nolit ka formulime të tipit "*Në mërgimin e gjatë... vazhdoi të ishte tribun i demokracisë shqiptare"*.[7] "*Noli është gjeniu i kulturës shqiptare të shek. XX"*.[8] Për figura të tjera (Konica) mjaft konsiderata jepen përmes citimit të personaliteteve, në mënyrë që gjykimi të jetë sa më i paanshem.

4. Marrëdhënia mes informacionit dhe interpretimit të krijimtarisë së autorëve të përfshirë

Është një tjetër çështje që le vend për diskutime. Në mjaft autorë – zëra të vegjël për vetë hapësirën që ka zëri i vogël, jepet vetëm informacioni për krijimtarinë e tyre, karakterizimi ose mungon fare, ose është aq i përgjithshëm sa nuk thotë asgjë. I njëjti problem shfaqet edhe në

[5] Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, vëllmi I, f.285.
[6] Shih, shën.3, f.903.
[7] Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2009, vëllmi III, f.1850.
[8] Po aty, f.1851.

zëra të tjerë që mund të jenë më të gjatë, por interpretimi e konsideratat mbi veprën diku jepen më shumë, diku më pak.

Megjithë përpjekjet që janë bërë përmes futjes si zëra të mëdhej të autorëve të patrajtuar për 50 vite (Fishta, Koliqi) e përmes përfshirjes së studiuesve të një brezi më të ri në hartimin e tyre, bashkimi i zërave ekzistues të Fjalorit të parë enciklopedik me zërat e rinj, apo trajtimet e bëra në periudha të ndryshme, sipas këndvështrimeve që dalin përtej letërsisë, krijojnë apo japin shkas për problematikat e përmendura.

Në mbyllje të kësaj paraqitjeje të shkurtër do të thoshim se përcaktimi dhe hartimi i zërave enciklopedikë të të gjitha fushave në përgjithësi dhe të letërsisë në veçanti ka si domosdoshmëri mbajtjen parasysh të çështjeve të mësipërme, veçanërisht mënyrën e hartimit të zërave dhe raportet e domosdoshme për t'u ruajtur mes tyre, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e një fjalori enciklopedik.

Kastriot GJIKA, Tiranë

A ËSHTË DIJA ENCIKLOPEDIKE DIJE BASHKËKOHORE

KDU 001:03

Po e them që në fillim, duke i kërkuar shumë ndjesë këtij paneli të nderuar akademikësh e profesorësh dhe sidomos organizatorëve të kësaj tryeze shkencore, të cilët edhe një herë gjej rast t'i falënderoj për ftesën, se unë bëj pjesë në atë kategori njerëzishqë nuk entusiazmohen fort nga idea e hartimit të një enciklopedie të përgjithshme.

Për ta verifikuar qëndrimin tim dhe për ta bërë atë sa mëtë pranueshëm (nëse është e mundur) edhe nga miq e kolegë, po e parashtroj këtë ide mbi bazën e disa tezave apo edhe të disa pyetjeve që bartin dilemat personale që kam përpara detyrave të kësaj natyre.

Le të më lejohet që në fillim të shtroj pyetjen: Ç'është enciklopedia sipas konceptit tim, të verifikuar edhe në formulime e përkufizime të referueshme:

1. *Etimologjikisht*¸ fjala enciklopedi vjen nga latinishtja "encyclopedia", që i korrespondon greqishtes, formuar nga tradita dorëshkrimore e autorëve latinë (Quintiliani, Plini etj) nga "engkiklios pedhia" që në greqishten helenistike do të thoshte "formim bazë", por edhe "kulturë e përgjithshme" e themeluar mbi disiplina që përbëjnë "një trup të vetëm" (Vitruvi)

2. Në thelbin e vet *semantik*¸ enciklopedia është "sistem i njohurive njerëzore (enciklopedi sistematike), nocion i cili buron nga përdorimi origjinar i termit (që si titull shfaqet për herë të parë në *Encyclopaedia septem tomis distincta* të 1630, zgjerim i një vepre të parë të tij, të titulluar *Cursus philosophici encyclopaedia, 1620*) nga struktura në trajtë peme që supozohej për dijen (F. Bacon), nga kërkimi i një çelësi leximi për të gjitha njohuritë sipas disa rrymave të mendimit mesjetar por edhe të Rilindjes. Ekspozimi organik i një sistemi të tillë është organizuar më tepër sipas një vazhdimësie trajtimesh për disiplina të veçanta.

3. Përmbledhje, shpesh e ilustruar, e të gjithë dijes (enciklopedi e përgjithshme) e shprehur në formë të qartë dhe jospecialistike (në rend

alfabetik, por ndonjëherë me renditje objektive e subjektive, metodologjike, dukeqëndruar sipas zërave të veçantë) përgjithësisht në shumë vëllime, shoqëruar ose i ndërtuar i tëri në CD-Rom, redaktuar e botuar për t'i shpërndarë kulturën shoqërisë dhe për të rikompozuar një kuadër tëunifikuar të dijes së specializimeve të veçanta (ky tip enciklopedie lindi në 700 me *"L'enciclopedie; ou Dictionnaire raisone des Sciences, des Arts e des Metiers", 1751* dhe me *Enciclopedia Britannica 1768* dhe vazhdoi më pas përmes veprash të promovuara nga kulturat e veçanta kombëtare, mes të cilave *Enciclopedia Italiana di Scienze, Lettere ed Arti, 1929*);

4. Projekt i rinjohjes dhe rindërtimit unitar, ndonjëherë specifikisht kritik i të tërë dijes, i një disipline apo grup displinash, i një qytetërimi apo një periudhe historike, apo i një vepre të një personaliteti të spikatur (Enciclopedia Dantesca, 1970)

Wikipedia jep këtë përkufizim për zërin ENCIKLOPEDI; **Enciklopedia** (*lat*: encyclopaedia gr. enkyklios - i gjithëpërfshirëshëm + paideia, arsimim i përgjithshëm) është vepër e madhe shkencore që përfshin njohuri për të gjitha fushat e jetës e të veprimtarisë, të sistemuara në mënyrë të përmbledhur në trajtën e një fjalori. Vepra e tillë që përfshin njohuri për një degë të veçantë të shkencës, të artit, të teknikës, etj.Një enciklopedi (shkruar edhe Encyclopaedia) është një përmbledhje gjithëpërfshirëse me shkrim që mban ose informacion nga të gjitha degët e diturisë ose nga një degë e veçantë e diturisë. Enciklopeditë janë të ndarë në artikuj, me një artikull mbi çdo subjekt të mbuluar. Artikujt mbi subjektet në një enciklopedi janë në disponim zakonisht alfabetik sipas emrit dhe mund të përfshihen në një vëllim ose në shumë vëllime, në varësi nga sasia e materialit.

Është interesant të themi në këtë mes se FESh 2008-09 as nuk e ka përkufizuar veten (veçse në parathënie), por ka si zë vetëm "FESh 1985"

Nisur nga premisa të këtilla, ideja e hartimit të një "Enciklopedie të Kosovës" na duket pak si jashtë kohe, pikërisht nga përkufizimi për dijen enciklopedike si **dije universale**. Kjo do të binte ndesh me prirjen e sotme, moderne, të specializimit të dijes dhe të ngushtimit të fushave, degëve e nëndegëve. Kjo shpjegon faktin se pse në historinë e njerëzimit dija enciklopedike, posaçërisht hartimi e botimi i fjalorëve enciklopedikë, duket të jetë i kapërcyer dhe i tejkaluar apo më mirë, siç do ta themi më poshtë,

është tjetërsuar 1- në formë, 2- në përmbajtje, 3- në destinacion. Mjafton të shohim shembullin e Enciklopedisë Britanike: *Encikopedia Britanike u botua për herë të parë duke nisur nga 1768 -1771, në Edinburg, në Skoci. Britanika qe një nga të parat enciklopedi të përgjithshme gjeneraliste në gjuhën angleze që vijon ende sot të botohet. Duke nisur nga fundi i 700 deri në fillim të nëntëqindës, zërat e Britanikës u cituan shpesh nga shumë burime si autoritet kryesor për një argument të caktuar. Gjatë kësaj kohe Britanika fitoi një reputacion dhe pati një pozicion unik në kulturën e gjuhës angleze. Roli i enciklopedisë ndryshoi në një mënyrë thelbësore në nisje të shek XX dhe kjo u reflektua edhe në botimet e Britanikës, duke nisur nga botimi i 11. Enciklopeditë u bënë vepra më gjeneraliste dhe iu drejtuan një publiku gjithmonë e më të gjerë, me zëra më të shkurtër dhe lehtësisht të lexueshëm. Nuk shërbejnë më si një referencë autoritare mbi një argument: në epokën moderne, një gamë e gjerë e revistave akademike, e teksteve librore, e botimeve të specializuara dhe e burimeve dixhitale i kanë zënë vendin enciklopedisë.*

Në këtë kuadër, duke u nisur edhe nga shembujt jo aq të suksesshëm të dy botimeve të FESh (1985 dhe 2008-09), nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë,ne mendojmë se nuk do të ishte një punë fort e goditur hartimi i një FEK a një Enciklopedie të Kosovës. Personalisht, siç do të kem rast ta theksoj pak më poshtë, mendoj se do të ishte më i udhës hartimi e botimi i një "Enciklopedie të letërsisë shqipe", pra një dije enciklopedike sektoriale, edhe kjo e ridimensionuar dhe e sjellë në frymën e zhvillimit të sotëm të diturive e të shkencave.

Dija enciklopedike, e sendërtuar në botime të karakterit enciklopedik, është gjithashtu dije **autoritare**. Në kuptimin që po të ndjekësh vijën historike të zhvillimit e të botimit të tyre, ajo përkon me fazën e centralizimit të shtetit, të krijimit të shteteve nacionalë dhe në këtë mënyrë, "lëvizja enciklopediste "(siç do ta quanim) është një lëvizje paralele me shtetformimin dhe procesin e konsolidimit të shtetit. Disa shembuj i përmendëm, por po të nisemi edhe nga vetë shembulli i "enciklopedizmit shqiptar"(1985-a pastaj 2008-2009-adhe tani kjo përpjekje në Kosovë), kur shteti i pavarur i Kosovës sapo ka mbushur 5 vjeç dhe ka nevojë imperative ta dëshmojë veten, qoftë edhe përmes kësi formash e iniciativash. Mirëpo kjo bart edhe njëfarë rreziku eminent, për shkak se specifika e kombit

tonë shënohet edhe prej faktit se popullata e tij jeton e ndarë në në së paku në 5 shtete, një nga të cilat, Shqipëria, një shtet unikombëtar e tjetri, Kosova, i trajtuar formalisht si multietnik, por ku shqiptarët*de facto*përbëjnë shumicë absolute. Në këtë rrafsh arsyetimi shtrohet pyetja: Enciklopedia e Kosovës do të jetë Enciklopedi e shqiptarëve të Kosovësapo do të jetë enciklopedi e botës kosovare që i përfshin të gjitha prurujet etnike e kulturo-gjuhësore? Shembullin negativ e kemi shumë pranë, në shtetin shumëkombëtar të Maqedonisë fqinje, ku Akademia e Shkencave e atij shteti hodhi në qarkullim, por pastaj u detyrua ta pezullojë një Enciklopedi të Maqedonisë, nëtë cilën ndaj shqiptarëve mbahej një qëndrim racist, joshkencor, johistorik e i pavërtetë, madje i përçudnuar, provokativ e fyes.*

Kjo prirje për ta konceptuar Enciklopedinë si autoritare e produkt të markuar nga njëautoritet i rëndësishëm shkencor, siç janë akademitë e shkencave dhe të arteve në Tiranë e në Prishtinë, duket edhe nga faktise këto të fundit mbajnë apo duan të mbajnë autorësinë e enciklopedive përkatëse. Le të më lejohet të bëj një pyetje nga pozita disi "naive": A duhet patjetër angazhimi i Akademisë/ve për këtë mision? A mos do të ishte më mirë të realizohej e gjithë kjo sipërmarrje nga ndonjë institut i posaçëm apo çfarëdolloj institucioni tjetër i ngritur eksluzivisht për hartimin, pasurimin, botimin, ribotimin, promovimin, qarkullimin e njohurive enciklopedike në këtë trajtë a në çfarëdolloj trajte apo edhe mediumiqë do të bihej dakord?

Se duhet pranuar gjithashtu se dija enciklopedike është edhe dije **historike**. Jo vetëm në kuptimin që ka pasurnjë cikël historik, që duket se tani është mbyllur a është drejt mbylljes, por edhe nëkuptimin e "vjetërimit "të saj dhe të nevojës për ta ribërë në mënyrë të përsëritur, të përditësuar e të rivlerësuar. Shembulli më elokuent mbetet përsëri FESh-i, i cili edhe pse u ribë në 2008-09, sot ngjan i vjetëruar dhe ka shumë zëra qëqysh sot, pas vetëm 4-5 vitesh, kanë nevojë për t'u ribërë. Po nga kush? Këshilli a organizmi që e hartoi, më nuk ekziston përveçse në trajtë rudimentare. Personat përgjegjës janë liruar nga detyrimi institucional për ta kryer këtë punë. Për pjesën e mbështetjes financiare nuk po futem të flas, se ajo edhe kur FESh u hartua, nuk ishte dhe aq motivuese.

Andaj unë mendoj se puna për hartimin e Enciklopedisë së përgjithshme të Kosovës është një punë me mjaft përgjegjësi jo vetëm shken-

core por edhe politike e si e tillë nuk e pranon as ngutjen dhe as mungesën e drejtpeshimit, qoftë edhe për shkak të entusiazmit e të frymës pozitive. Ndërkaq, mendoj se i udhës do të kishte qenë hartimi i punëve enciklopedike sektoriale e në këtë kuadër, siç e thashë edhe më lart, një Enciklopedi e Letërsisë Shqiptare do të kënaqte mjaft më mirë interesat e pritshmëritë e publikut shqiptar e të huaj që kërkon ta njohë e ta vlerësojë letërsinë tonë edhe përmes kësaj rruge.[1]

[1] "Shqiptarët në Maqedoni kanë ardhur nga Shqipëria veriore. Ata, kanë kolonizuar viset në Maqedoni në shekullin XVI, duke i dëbuar maqedonasit nga shtëpitë e tyre". "Vërshimin e tyre drejt Maqedonisë e ka mundësuar Ali Pashë Tepelena. Shteti i parë shqiptar është formuar nga Gjermania fashiste, e cila kufijtë e këtij shteti i zgjeroi në rajonet e Maqedonisë perëndimore. Shqiptarët, veç të tjerash, njihen edhe si njerëz malorë...".

Këto janë vetëm disa pjesë të shkëputura për shqiptarët nga Enciklopedia e re maqedonase, e botuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Maqedonisë, e që ka shkaktuar reagime të ashpra në mesin e qarqeve të ndryshme shqiptare në Maqedoni. Akademikët maqedonas, në promovimin e kësaj enciklopedie, nuk kanë dhënë detaje, përveç faktit se ajo përfshin edhe të kaluarën e bashkësive etnike në Maqedoni, që nga historia e hershme e deri në ditët e sotme dhe se për këtë kanë qenë të angazhuar edhe historianë shqiptarë.

Salajdin SALIHI, Tetovë

LETËRSIA SHQIPE NË MAQEDONI NË TEKSTET ENCIKLOPEDIKE

KDU 821.18(497.17):030

Enciklopeditë, fjalorët tematikë, monografitë, krestomacitë, si depozitim kujtese, dijeje, përvoje, janë libra të nevojshëm dhe të domosdoshëm për çdo sistem kulturor. Për përgatitjen e tyre, krahas resurseve intelektuale, nevojiten edhe resurse financiare. Duhet strategji e qartë kulturore, për sa kohë është fjala për projekte të kushtueshme. Botimi i enciklopedive, në çdo sistem kulturor, shënohet si ngjarje e veçantë. Enciklopeditë janë çmuar ose janë përçmuar. Janë adhuruar ose kritikuar. Janë shumëfishuar ose ndaluar. Adhuroheshin nga Borhesi, i cili, sipas Umberto Ekos, falë depozitimeve enciklopedike arriti që të krijonte muzikën e ideve, por përçmohen nga Hoze Saramago, sepse, sipas tij, përmbajnë dije sipërfaqësore. Enciklopeditë, thotë Saramago, përmbledhin jetën e Xhordano Brunos me disa rreshta, por nuk thonë *"se sa i dhimbshëm qe martirizimi"*[1].

Enciklopeditë, si libra që përmbledhin informacione themelore mbi dijet njerëzore, krahasohen me bibliotekën e pafundme, që nuk është tjetër veçse univers i llojit të vet - ashtu sikurse ishte projektuar në mendjen e Borhesit - me numër të pafundmë galerish, me kate të poshtme dhe të sipërme pa mbarim, me rafte të panumërta. Dhe ky univers ngjan me atë të uebit, ku një nyje (dalje), të çon te nyja tjetër dhe kështu deri në pafundësi. Të rrugëtosh nëpër këtë univers do të thotë të bësh udhëtim imagjinar nëpër kujtesën e përvojën njerëzore; do të thotë të bredhësh nëpër një labirint, ku koha është ciklike dhe jolineare, ashtu sikurse te mitet...

Ka pasur enciklopedi që kanë influencuar në një epokë të caktuar, sikurse ishte *Enciklopedia franceze*[2], e vlerësuar edhe si pasqyra e ilumi-

[1] Zhoze Saramago, *Udhëtimi i përkryer* (përktheu: Ajsela Koka), Dritan, Tiranë, 2002

[2] *Enciklopedia ose fjalori universal i shkencave, arteve dhe zanateve,* 1751-1780, në origjinal: *Encyclopédie ou Dictionnaire raisonné des sciences, des arts et des métiers, par une société de gens de lettres, 1751.* Në fillim i botua në dhjetë vëllime dhe dy vëllime me gravura, kurse më pas

nizmit, e cila synonte jo vetëm sjelljen e informacioneve dhe përvojave nga të gjitha sferat, por edhe çlirimin e individëve nga paragjykimet, padrejtësitë apo nga pushteti *despotik.*

***

Ka pasur raste kur enciklopeditë janë keqpërdorur për qëllime të ndryshme politike e propagandistike. Pasi kemi një shembull më të freskët me ***Enciklopedinë maqedonase,*** preferojmë të fokusohemi pak më gjatë. Ekipi redaktues i *Enciklopedisë maqedonase* ishte në shërbim të politikës ditore. *Enciklopedia* u shoqërua me pasaktësi të shumta. Redaktorët nuk janë naivë, por janë djallëzor. Nëpërmjet *Enciklopedisë* synuan të shkruanin një histori të re. Sikundër thuhet, "*shkrimi i historisë, sipas kësaj mënyre, paraqet një formë të luftës politike për pushtet idesh dhe sundim të një grupi ose të individëve ndaj resurseve shpirtërore*[3]. E ngjyrosur me ngjyrat e partisë në pushtet, ajo kushtoi 400 mijë euro, përfshirë edhe mjetet shtesë për promovimin e saj nëpër botë. Pas reagimit të shqiptarëve, u morr vendimi për një botim të ri, të korrigjuar, por botimi i ri, me gjasë, ose do të presë shumë kohë ose nuk do të ndodhë kurrë. Në ndërkohë, qarkullon si "samizdat" botimi aktual. Në internet mund të shkarkohet në formë kinse "pirate".

Politika maqedonase, e cila gjithnjë e më shumë i thellon ndarjet etnike në vend, që e nxit dominimin kulturor, gjuhësor, kombëtar nuk e merr aspak në konsideratë faktin se Maqedonia është shtet shumëkulturor. Nëse do të merrej parasysh ky fakt, atëherë do të duhej të ndiqej modeli i *Enciklopedisë kanadeze*, e botuar në dy gjuhë (anglisht dhe frëngjisht), e cila u quajt si edhe si "*përmendore e fuqisë integruese të kulturës"*.

Botimi i *Enciklopedisë maqedonase*, zgjoi reagime të shumta te shqiptarët. Si kundërvënie u botua krestomacia *Maqedonia shqiptare,* që mediat maqedonase e quajtën "*enciklopedi kundër një enciklopedie*".

Maqedonia shqiptare ishte përmbledhje studimesh shqiptare dhe të huaja, që synonte t'i kundërvihej historiografisë maqedonase. Projekti i quajtur *Maqedonia Shqiptare* ishte ideuar si një kollanë botimesh në disa vë-

numri i vëllimeve u shtua në 17 dhe 11 vëllime me gravura. Në krye ishin Didëroi dhe D'Alaberti, të ndihmuar nga Volteri (1694-1778) dhe Zhan Zhak Rusoi (1712-1778).

[3] Miomir Tomić, *Enciklopedije, počeci rada na sveznanju*, www.planeta.org.rs

llime, përfshirë edhe një enciklopedi specifike, por mbeti i papërfunduar për mungesë mjetesh financiare.

Enciklopedia maqedonase duket se është në sinkron me *Enciklopedinë serbe*, e ideuar nga Akademia e Arteve dhe Shkencave Serbe, për botimin e së cilës është miratuar ligj i veçantë nga Kuvendi i Serbisë[4]. Titulli, pra "*Enciklopedia e përgjithshme e popullit serb dhe vendeve të tij në të kaluarën dhe të tashmen",* dëshmon se qëllimi i kësaj enciklopedie është në rend të parë politik, që theksohet nga akademikët serbë. *Enciklopedia serbe,* sipas akademikëve serbë, është kundërvënie ndaj *Enciklopedisë jugosllave.* Sipas tyre *Enciklopedia jugosllave* ishte përpiluar në masë të madhe nga shkencëtarët kroatë dhe si e tillë dija enciklopedike nuk ishte grupuar sipas kritereve kombëtare.

***

Në botën kulturore shqiptare, në krahasim me atë që ndodh me sistemet tjera kulturore, në veçanti ato rajonale, mbetet i rëndësishëm fakti se institucionet prestigjioze shqiptare të shkencës dhe arteve kanë filluar të reflektojnë në këtë drejtim. Por gjërat ecin vështirshëm për sa kohë kemi politika të paqarta kulturore. Tekstet enciklopedike, qofshin të përgjithshme ose specifike, shoqërohen me mangësi. Ne mund të marrim si shembull disa tekste të këtilla që të shohim se si janë prezantuar autorët shqiptarë që kanë krijuar ose krijojnë në Maqedoni.

Në *Fjalorin enciklopedik shqiptar*[5], janë përfshirë disa emra shkrimtarësh nga Maqedonia, që gjithsesi e kanë vendin aty, por mungojnë emra reprezentativë për letërsinë kombëtare. Fjalori ka gabime të shumta, të patolerueshme.

Në *Fjalorin enciklopedik letrar*[6]*,* të autorëve dr. Gjergj Zheji, dr. Natasha Xhafka, përmenden më shumë autorë shqiptarë nga Maqedonia (Ali Aliu, Josif Bageri, Eqrem Basha, Jashar Erebara, Adem Gajtani, Dervish Hima, Murat Isaku, Agim Vinca), por mungojnë shumë të tjerë, në mesin e të cilëve edhe shkrimtari Luan Starova, i njohur ndërkombëtarisht.

---

[4] Gazeta Zyrtare e RS, 110/2005
[5] *Fjalori enciklopedik shqiptar*, Bacchus, Tiranë, 2002
[6] Gjergj Zheji, Natasha Xhafka, *Fjalor enciklopedik letrar,* Libri Shkollor, Tiranë, 2001.

Vlen të përmendet *Kosova, vështrim monografik*[7], botim i ASHAK. Libri i konceptuar si monografi gjithëpërfshirëse, në pjesën e letërsisë, përmend shumicën e autorëve që kanë jetuar ose jetojnë në Maqedoni (Nehas Sopaj, Resul Shabani, Salajdin Salihi, Fatmir Sulejmani, Lulzim Haziri, Linditë Ahmeti, Lindita Aliu, Eqrem Basha, Kim Mehmeti, Murat Isaku, Halil Zendeli, Rexhep Zllatku, Fejzi Bojku, Nuhi Vinca, Abdylazis Islami, Agim Vinca etj). Pikërisht, për shkak të përmendjes së emrave të shkrimtarëve shqiptarë nga Maqedonia, u hapën debate në Kosovë. Përderisa autori e koncepton letërsinë shqipe unike, kritikuesit bëjnë të kundërtën. Bashkë me kufijtë e rinj të shtetit kosovar, duan të krijojnë edhe kufij për letërsinë shqipe.

Enciklopedia e artit shqiptar, e konceptuar si projekt i *Qendrës së Studimeve të Artit* (me bordin e përbërë nga: Zana Shuteriqi, Ferid Hudhri, Moikom Zeqo, Jakup Mato, Kristaq Dhamo nga Shqipëria; Nebi Islami, Shyqyri Nimani dhe Engjëll Berisha nga Kosova, si dhe Luljeta Isaku nga Maqedonia), e prezantuar si e para enciklopedi e këtij lloji në botën kulturore shqiptare, nuk u botua. Ndërkohë lindën dy tekste enciklopedike, nga disa autorë të angazhuar në këtë projekt. Gjegjësisht: libri i profesor Josif Papagjonit, me titull, *Enciklopedi: Teatri dhe kinematografia shqiptare* dhe vepra e Luljeta Isakut dhe Nebi Islamit, *Leksikon i arteve dramatike*[8]. Në librin e profesor Josif Papagjonit janë anashkaluar emra të njohur të teatrit dhe kinematografisë shqiptare nga Maqedonia, por kemi prezantim të kënaqshëm në veprën e Luljeta Isakut dhe Nebi Islamit, *Leksikon i arteve dramatike*. Aty janë përfshirë pothuajse të gjithë emrat më të rëndësishëm nga sfera e arteve dramatike që janë nga Maqedonia.

Në tekstet e këtilla enciklopedike pothuajse anashkalohen krijuesit e brezit më të ri, edhe pse, disa prej tyre, përmenden në enciklopedi prestigjioze botërore (sikundër është *Enciklopedia e poezisë* e Universitetit të Prinçestonit). Kjo ndodh sa për shkak të mosnjohjes së kësaj letërsie nga ana e përpiluesve të teksteve enciklopedike, po aq nga një mospranim i kësaj letërsie, ndonëse, për sa u përket prurjeve artistike, qëndron më lartë se sa letërsia e disa emrave tashmë të paanashkalueshëm për çdo tekst të kë-

[7] *Kosova, vështrim monografik*, ASHAK, Prishtinë, 2011
[8] Luljeta Isakut dhe Nebi Islamit, *Leksikon i arteve dramatike*, Instituti Albanologjik, 2012.

tillë, të cilët lënë për të dëshiruar në aspektin artistik.

Që të kemi tekste enciklopedike cilësore duhet të përfshihen studiues të dëshmuar prej të gjithë viseve shqiptare. Para së gjithash, duhet bërë strategji paraprake, me qëllim që tekstet e këtilla të jenë në mision të afirimit të vlerave shqiptare, por pa ekzagjerime, pa megalomani, pa mitizime.

Botimi i një enciklopedie të mirrëfilltë shqiptare, me kritere dhe metodologji adekuate shkencore, është jo vetëm projekt i rëndësishëm shkencor, por edhe shoqëror e kombëtar. Që të realizohet ky projekt, në rend të parë, duhet buxhet i veçantë. Aq më shumë kur sërishmi kemi një agresivitet antishqiptar nga disa akademi (maqedonae dhe serbe), kundër shqiptarëve në përgjithësi.

RECENSIONE, SHËNIME
REVIEWS, NOTES

Shefkije ISLAMAJ*: GJERGJ FISHTA (GJUHA DHE STILI) I, II*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2012, ff.

Shefkije Islamaj ka botuar në Prishtinë monografinë *Gjergj Fishta / Gjuha dhe stili*, në të cilën ajo ka trajtuar aspekte të gjuhës dhe të stilit në veprën e Fishtës, duke u ndalur edhe te *Lahuta e Malcís*.

"Gjuha e Fishtës shpreh të gjitha shtresëzimet, plotësinë e gjerësinë, si dhe lëvizjet brenda gjuhës shqipe: ajo bart dhe përfaqëson të ashtuquajturën histori të brendshme të shqipes - me veçoritë e saj strukturore-gjenetike dhe tipologjike, dhe atë që paraqet historinë e saj të jashtme – me kontekstin e saj etnokulturor. Këtej del shumështresëzimi, pasuria dhe plotësia e gjuhës dhe e shprehjes së Fishtës. Fishta ka arritur të nxjerrë në dritë edhe mundësitë estetike të shqipes në përgjithësi e të gegërishtes veriore në veçanti"[1], shkruan Islamaj, e cila, gjithashtu, pohon se "vlerat gjuhësore ekspresive-dialektore, nëndialektore e krahinore të krahut verior të shqipes, askund tjetër nuk marrin jetë e frymë si në Lahutën e Malcís"[2].

Kjo studiuese e veprës së Fishtës thekson se "gjuha e Fishtës është gjuha popullore, gjuha që na del edhe në krijimet popullore, rrjedhimisht edhe në epikën popullore, gjuha ku ai ka marrë më së shumti në mënyrë krijuese dhe ka ka treguar gjithë mundësitë e poetikës e të estetikës së tij"[3].

Monografia e studiueses Shefkije Islamaj, pa dyshim, është njëra ndër përpjekjet më voluminoze për ta analizuar veprën e At Gjergj Fishtës, në tërësinë e saj, nga aspekti i gjuhës dhe stilit. Vlerësimet që i janë bërë kësaj monografie, sidomos në Shqipëri, kanë qenë të shumta, ndërsa në Kosovë më të pakta. Ndër të tjerë, për këtë vepër të Islamajt kanë shkruar: Jani Thomai (në Gjurmime albanologjike, nr. 41-42, IA, Prishtinë, 2012), Xhevat Lloshi (në Gjuha shqipe, 2, IA, Prishtinë, 2013), Vilma Proko-Jazexhiu (gazeta Republika, Tiranë, 8.12. 2012), Gjovalin Shkurtaj, (*Shefkije Islamaj: Gjergj Fishta, Gjuha dhe stili*, IA, Prishtinë, 2102, tekst i lexuar në përurimin e kësaj monografie në Tiranë, dorëzuar për botim në rev. Gjurmime albanologjike 2013) etj.

Sipas Jani Thomait, "në themel të monografisë autorja vë aspektin gjuhësor të veprës së Gj. Fishtës, por ajo zgjerohet e pasurohet me analiza për përmbajtjen, për lidhjet me kohën, për historinë e traditën popullore, për poetikën, për jehonën që pati dhe për vlerat e sotme"[4]. Gjovalin Shkurtaj, ka shpehur bindjen se "monografia *Gjergj Fishta, gjuha dhe stili*, është një ndihmesë e vlefshme dhe e mirëseardhur për një fushë ende të re, por me vlera e mundësi për prurje e studime të rëndësishme rreth ligjërimit të autorëve shqiptarë të sotëm e të traditës, sipas një boshti ku peshorja stilistike e hijeshia gjuhësore, bashkë me leksematikën dhe 'ojnat' fonetike e morfosintaksore, zbulojnë vlerat e vërteta të

[1] Shefkije Islamaj, *Gjergj Fishta/Gjuha dhe stili 1*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2012, f. 59.
[2] Islamaj, po aty.
[3] Islamaj, po aty.
[4] Jani Thomai, *Shefkije Islamaj: Gjergj Fishta (Gjuha dhe stili)* I, II, IA, Prishtinë, 2012, 1100 p., Gjurmime albanologjike, nr. 41-42, IA, Prishtinë, 2012.

çdo shkrimtari"[5].

Monografia e Islamajt përbëhet prej dy librash. Libri i parë nis me *Hyrjen*: *Gjergj Fishta dhe vepra e tij,* dhe vazhdon me dy kapitujt: *Fonetika stilistike* (f.123-276), dhe *Morfologjia stilistike* (f. 277-514). Libri i dytë ka dy kapituj: *Sintaksa stilistike* (f. 123-276) dhe *Leksikostilistika* (f. 227-507).

Islamaj veprën e Fishtës e ka studiuar nëpërmjet analizës formale përshkruese të veprimeve stilistike. Siç dëshmon vetë, ajo është përpjekur që veprën letrare të Fishtës ta shohë "përmes lëndës gjuhësore, por duke mos lënë anash poetikën e saj të mbështetur në ndjenjat dhe në intuitën"[6]. Pra, "në metodologjinë e studimit niset me përshkrimin"[7]. Në kapitullin **Fonetika stilistike**, Islamaj trajton modifikimet dhe mjetet shprehëse në rrafshin e fonetikës dhe të fonologjisë: "tingujt, kundërvënia e tyre, vlera e tyre shenjuese semantike dhe dukuritë e ndryshme gjuhësore të kuptuara si cilësi e si sasi përmbajtjesore"[8]. Por para se ta shtellojë këtë çështje, ajo prek drejtshkrimin e Fishtës, duke vlerësuar se "edhe pse pas Komisisë së Shkodrës, vërehet një qëndrueshmëri më e madhe në drejtshkrimin e Fishtës, sidomos në rrafshin fonetik: ruajtja e grupeve të bashkëtingëlloreve **nd**, **mb**, **ng**, etj., ruajtja e togjeve **ue**, **ie**, **ye**, etj., përdorimi i theksit dhe i shenjave diakritike për gjatësinë e hundorësisë, etj., mund të thuhet se ai nuk u kujdes shumë për drejtshkrimin e tij, në të vërtetë drejtshkrimi në veprën e tij letrare shpreh mjaft lëkundje dhe joparimësi"[9]. Dhe, këto "joparimësi drejtshkrimore" në veprat e Fishtës ajo i gjen të lidhura jo vetëm me aspektin kohor, largësinë kohore të botimit të tyre, por "edhe me prerjen horizontale domethënë është lëkundje drejtshkrimore edhe brenda botimeve të së njëjtës kohë, madje brenda edhe të së njëjtës vepër"[10].

Ndonëse përpiqet "t'i arsyetojë" këto *joparimësi* e *lëkundje* drejtshkrimore të Fishtës, duke argumentuar se "në veprën letrare udhëheq gramatika poetike e ligjet metrike, prandaj vepra e tij poetike në këtë rrafsh nuk bën përjashtim", ajo insiston sidomos në ato që i quan "joparimësi drejtshkrimore të paarsyetuara dhe të pamotivuara nga ana e gramatikës poetike e nga ana e ligjeve të metrikës", për të konkluduar qartas se "në veprën letrare të Fishtës joparimësitë a lëkundjet drejtshkrimore dalin në të gjitha rrafshet gjuhësore, po sidomos në rrafshin fonetik e morfologjik"[11].

Po ashtu, në këtë kapitull, Islamaj trajton **modifikimet strukturore fonologjike,** duke dalluar pesë tipa modifikimesh: *zgjeruese*, *rrëgjuese*, *zëvendësuese*, *parkaluese* dhe *tejvendosëse*. Duhet të theksohet se modifikimet strukturore të Fishtës Islamaj i sheh jo vetëm si rezultat të proceseve tingullore, po edhe si rrjedhojë të proceseve morfologjike. Emërtimi *modifikime fonologjike*, sipas saj, duket të motivohet nga fakti se "ndryshimi rrok formën fonologjike të fjalës së caktuar".

Në kuadër të modifikimeve zgjeruese në veprën e Fishtës, ajo ka renditur: *protezën fonologjike*, *epentezën fonologjike* dhe *paragogën fonologjike;* në kuadër të modifikimeve rrëgjuese: *aferezën fonologjike*, *sinkopën fonologjike* dhe *apokopën fonologjike*, ndërsa në kuadër të modifikimeve përkaluese: *asimilimin* dhe *disimilimin fonologjik*.

---

[5] Gj. Shkurtaj, *Shefkije Islamaj: Gjergj Fishta, Gjuha dhe stili*, IA, Prishtinë, 2102, Gjurmime albanologjike, 2013.
[6] Sh. Islamaj, *vep e cit. II.*, f. 11.
[7] J. Thomai, *rev. e cit*.
[8] Sh. Islamaj, *vep. e cit*. I., f. 125.
[9] Sh. Islamaj, *vep e cit* I, f. 105.
[10] Po aty.
[11] Sh. Islamaj, *vep e cit* I, f. 106.

Në kapitullin **Morfologjia stilistike** Islamaj në plan të parë kujtojmë se qet dy dukuri, të cilat, në pikëshikimin e saj, janë më kryesoret për analizimin dhe vlerësimin e morfologjisë stilistike të Fishtës, *tejvendosjen semantike gramatikore* dhe *inversionin semantik*.

Me anë të tejvendosjes semantike, kategoritë gramatikore (emri, mbiemri, folja...) kthehen në kategori figurative, në figura leksikore (metafora, personifikime, metonimi, hiperbola...).

"Dukuria kur një kur një kategori gramatikore merr kuptimin e kategorisë tjetër në gjuhën e Fishtës, del mjaft e shpeshtë dhe, në të shumtën e herës, kthehet në përftesë stilistike. Një veprim i tillë i Fishtës lidhet me synimin për shprehësi stilistike dhe me përpjekjen për të shquar anën kuptimore të kategorive të ndryshme gjuhësore"[12], shkruan Shefkije Islamaj.

E, në këtë kontekst, ajo vëren se "në gjuhën e Fishtës figurat stilistike më tipike në rrafshin morfologjik na paraqiten te kategoria e vetës, e kohës e mënyrës e më rrallë te kategoria e numrit, e gjinisë dhe e rasës[13]", ndërsa trajtimin e këtyre kategorive (gramatikore) e bën sipas sistemit të gramatikave tona, duke nisur nga emri, mbiemri, përemri, folja etj. Për të gjitha këto kategori, ajo sjell shembuj të shumtë, mirëpo duket se vend qendror zë folja, kohët (narrative) dhe mënyrat e saj.

"Përsëritja e foljes në *Lahutën e Malcís* bën që ajo të përjetohet edhe si formë muzikore qarkore. Ndoshta nuk e teprojmë nëse e themi se ajo është vepër shumë evokuese edhe me anën e saj "muzikor". Dhe, në këtë rrafsh, pothuajse, asgjë nuk është e vetvetishme"[14], mendon studiuesja Islamaj. Pra, ajo, anën muzikore, muzikalitetin e *Lahutës së Malcís* e sheh pikërisht në përdorimin e veçantë të kohës dhe të shenjave gjuhësore të saj – formave foljore.

"Vlerë metaforike merr vetë koha, që mund të cilësohet edhe si figurë, ndërsa folja dhe format e saj foljore si kohësi ose si kohëshënuese. Sidomos *paskajorja*, *habitorja* dhe *e tashmja historike* mund të futen në këto vlerësime, edhe pse, siç dihet koha që rrjedh, në përgjithësi, është *e kryera*. Ajo ndërkëmbehet me të kryerën e thjeshtë. Edhe në rastet kur këto forma këmbehen me të tashmen historike, gramatika e foljes narrative mbetet e realizuar në skemën që është modifikuar ndjeshëm për qëllime stilistike, në raport me traditën e përdorimit të saj në të folmen e dialektit të Fishtës. Ndërkëmbimi i sekuencave narrative dhe i atyre përshkruese sjell pamjen e rrjedhës kohore të ngjarjeve, njërën pas tjetrës, dhe ky ndërkëmbim ndikon në dinamizmin, aq sa ndikon edhe grumbullimi i formave foljore – veçori tipike kjo e narracionit të Fishtës"[15], pohon Sh. Islamaj.

Sintaksa stilistike është kapitulli i parë i pjesës së dytë të monografisë *Gjergj Fishta / Gjuha dhe stili* të autores Shefkije Islamaj. Edhe në këtë kapitull, autorja merret me një gamë mjaft të gjerë problemesh, me qëllim që të provojë "çka e bën artistike veprën e Fishtës nga ana e përbërësve sintaksorë"[16]. Pasi shtjellon veçoritë e përgjithshme të sintaksës stilistike të veprës së Fishtës (*periudhat lidhëzore dhe palidhëzore*, *mjetet sintaksore në ndërtimet kundërvënëse*), autorja rreket të analizojë dukurinë sintaksore e stilistike të përsëritjes dhe llojet e saj, pastaj anasjellën, paralelizmin (paralelizmin si nënlloj i për-

[12] Sh. Islamaj, *vep e cit* I, f. 281.
[13] Po aty.
[14] Sh. Islamaj, *vep e cit* I, f. 384.
[15] Sh. Islamaj, vep. e cit. I, f. 385.
[16] Sh. Islamaj, *vep. e cit. II*, f. 11.

sëritjes), grumbullimin e njësive gjuhësore në pozicion të njëjtë sintaksor (të cilat kanë funksion të njëjtë stilistik), parafrazën, paradoksin, shkallëzimin etj.

Gjithashtu, Islamaj analizon veprimet stilistike mbi bazën e sinonimisë, frazeologjisë dhe krahasimit, si dhe strukturën dhe funksionin e tyre në veprën e Fishtës. Mbase, nga shumësia e çështjeve që shtjellon, krijohet përshtypja se disa dukuri me peshë, në kuadër të stilistikës së sintaksës, mund t'i shihte më hollësisht, veçmas përdorimin apo funksionin stilistik të kryegjymtyrëve, po edhe të gjymtyrëve të dyta, të cilave, ndonëse i përmend, sikur nuk u kushton hapësirën e pritshme (sidomos nëse merret parasysh vëllimi i punimit të saj).

Në këtë kapitull, Sh. Islamaj, po ashtu, prek edhe narracionin në *Lahutën e Malcís*. Sipas saj, Gjergj Fishta, posaçërisht me gjuhën, është vazhdues tipik i romantizmit, ndërsa narracioni i *Lahutës së Malcís* mbështetet në ligjërimin popullor. Kjo studiuese mendon se Fishta eci "vazhdës" së rrahur nga shkrimtarët tanë të parë, traditës së krijuar nga ta dhe shprehjes që mori kjo traditë e shkrimit shqip sidomos në kohën e Rilindjes. Porse, Islamaj, po ashtu, pohon se "Fishta e gjeti rrugën e rrahur, por nuk u mjaftua me kaq: ai ndihmoi që gjuha populllore, jo vetëm të ecë qëndrueshëm nëpër kohën e saj, po të bëhet gjuhë, vërtet, artistike, me tiparet e një gjuhe të zhvilluar e të gatshme për t'u bërë gjuhë për vepra të mëdha, që do të krijohen pas tij e në historinë e saj të pashkëputur"[17].

Meqenëse e sheh si të ndërtuar mbi gjuhën popullore dhe shumë të ndikuar nga epika popullore, Shefkije Islamaj vlerëson se "është e kuptueshme që narracioni i *Lahutës* të ketë veçoritë e stilit dhe të karakterit të së parës dhe të së dytës: karakterin e përzier të ligjërimit dhe stilin rrëfimtar. Mbizotërimi i narracionit epik ka përcaktuar edhe veçori të tjera në këtë rrafsh: ai identifikon veten jo vetëm me rrëfimtarin popullor, po edhe këngëtarin popullor; ligjërimi i shkrimtarit dhe i personazhit është, pothuajse, i njëjtë, dialogu nuk zhvillohet vetëm midis dy personazheve, narratorit e lexuesit a dëgjuesit të supozuar ose në raste të tjera, vetë narratori identifikohet me personazhin"[18].

Leksikostilistika është kapitulli i dytë i pjesës së dytë të monografisë *Gjergj Fishta / Gjuha dhe stili* të Shefkije Islamajt. Në këtë kapitull, ajo trajton shprehësinë leksikore, dialektizmat, leksikun e veçantë dhe funksionin poetik të tij. Gjithashtu, krahas përzgjedhjes së leksikut, leksikut të moçëm dhe atij fetar, Islamaj interpreton edhe shprehësinë leksikore të krijuar nga kategoritë leksikore, si: polisemia, sinonimia, antonimia, paronimia, homonimia etj., si dhe shprehësinë leksikore të krijuar si rezultat i shtresave të ndryshme leksikore (arkaizmat, historicizmat, neologjizmat, pastaj emërtimet që janë karakteristikë e fushave të veçanta, si etnografia, shtazëria, bimësia etj).

Në këtë kapitull, sipas nesh, është më interes edhe qasja e Islamajt ndaj fjalëformimit dhe shprehësisë stilistike, po edhe ndaj frazeologjisë, strukturës dhe njësive frazeologjike. Megjithatë, vëmendjen sikur e tërheq më shumë pjesa *Konkordancat leksikore në Lahutën e Malcís*, në të cilën ajo sjell tabelat e dendurisë së përdorimit të fjalëve në këtë vepër, sipas paradigmës së kategorive gramatikore morfologjike (emri, mbiemri, folja, përemri, ndajfolja, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat dhe pasthirrmat). Po ashtu, Islamaj jep edhe listën e emrave të përveçëm me dendurinë më të lartë të paraqitjes në *Lahutë*, si dhe listën e fjalëve që ajo i vlerëson si fjalë-çelës.

Xhavit Beqiri

[17] Sh. Islamaj, *vep. e cit. II*, f. 211.
[18] Po aty.

PARARENDËSI. PËRZGJEDHJE PUNIMESH. Nga akademik Idriz Ajeti. Nën përkujdesjen e R. Ismajlit. Botimet Koha, Prishtinë, 2011, ISBN 978-9951-417-58-7, ff. 398.

Botimi që kemi përpara është një përzgjedhje studimesh të rëndësishme të akademik Idriz Ajetit, e bërë me synimin që të përfaqësojë në mënyrë sa më të plotë veprimtarinë e tij. Në fakt, botimi është më tepër i karakterit jubilar. E ka përgatitur grupi Koha dhe e botoi në ditën kur akademik Idriz Ajetit Koha ia ndau Çmimin për vepër jetësore më 22 dhjetor 2011. Me këtë nderim për Akademik Idriz Ajetin, Grupi Koha deshi të nderonte njërin nga themeluesit dhe prijatarin e studimeve albanologjike në Kosovë.

Libri është ndërtuar në disa tërësi. Në fushën e studimeve dialektologjike dhe të dialektologjisë historike dhe të historisë së gjuhës janë përfshirë në këtë botim studimet për të folmen e Gajkovës në fillim të sh. XIX, për Divanin e Shejh Maliqit, për të folmet e Preshevës e të Bujanovcit; nga fusha e preokupimeve të tij për shqipen letrare dhe zhvillimet e saj janë përfshirë vështrimet për historinë e shqipes letrare; në vijim janë vështrimet për origjinën ilire të gjuhës shqipe, për autoktoninë e shqiptarëve, për shqiptarët dhe gjuhën e tyre, disa vështrime për studimet etimologjike, teksti për Enciklopedinë Jugosllave, një vështrim për fjalët shqipe në gjuhët sllave të jugut dhe një tjetër për të kundërtën, dy studime me karakter ballkanistik, një studim për onomastikën mesjetare, një vështrim për S. Frashërin dhe reagimi Patologjia e një fushate.

Edhe pse me karakter jubilar, botimi paraqet një pasqyrë të qartë të interesimeve të gjera gjuhësore të akademik Idriz Ajetit.

Idriz Ajeti tashmë hyn në radhën e figurave të shquara shkencore, kulturore e publike shqiptare të shekullit XX dhe të fillimit të sh. XXI. Veprimtaria e tij shkencore i ka kaluar suazat lokale, ka arritur të bëhet pjesë e thesarit bazë albanistik, shpesh prijëse në rrjedhat hulumtuese jo vetëm në Kosovë. Duke qenë albanologjia një nga shtyllat e ballkanologjisë, kjo vepër i përket thesarit ballkanistik në përgjithësi.

Studimet e tij Idriz Ajeti i ka përqendruar në këto fusha të shqipes dhe të ballkanistikës:

- dialektologji historike dhe aktuale, e lidhur me të histori e gjuhës së shkruar,
- histori e gjuhës (fonetikë historike, morfologji, çështje të prejardhjes së shqipes) në përgjithësi,
- leksikologji historike dhe etimonlogji,
- kontakte të shqipes me gjuhët e Ballkanit, sidomos me sllavet, dhe
- çështje të normimit të shqipes dhe të kulturës së gjuhës.

Veprat e rëndësishme të Idriz Ajetit janë:

Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX, Prishtinë, 1960, 72.

Istorijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra, Sarajevo, 1961, 164.

Historia e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1969, ribotim 1983, 130.

Kërkime gjuhësore, Rilindja, Prishtinë, 1977, 418.

Studije iz istorije albanskog jezika, ANUK, Prishtinë, 1982, 211.

Studime gjuhësore në fushë të shqipes I, Rilindja, Prishtinë, 1982, 195.

Studime gjuhësore në fushë të shqipes II, Rilindja, Prishtinë, 1985, 300.

Studime gjuhësore në fushë të shqipes III, Rilindja, Prishtinë, 1985, 371.

Studime gjuhësore në fushë të shqipes IV, Rilindja, Prishtinë, 1989, 167.

Shqiptarët dhe gjuha e tyre, AShAK, Prishtinë, 1994, 243.

Zhvillimi historik i së folmes gege të Arbëneshëve të Zarës, Prishtinë, 1997, 180.

Për të vërtetën shkencore, ASHAK, Prishtinë, 2005.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës e ka botuar kompletin e veprave të I. Ajetit në 5 vëllime me studime në fushat e historisë së gjuhës, të dialektologjisë aktuale e historike, të filologjisë, të historisë së gjuhës së shkruar, të etimologjisë, të ballkanistikës, të kontakteve të shqipes me gjuhët përreth, të normimit të shqipes letrare, të kulturës së gjuhës, etj.

Botimi që kemi përpara shtrihet në 398 f dhe përveç studimeve në fjalë përmban edhe fotografi.

R. Ismajli

Vesel NUHIU: *NDIKIMI I ANGLISHTES NË GJUHËN SHQIPE*, ASHAK, Prishtinë, 2013, Botime të veçanta, Libri 48, ff. 334, ISBN 978 9951 615 11 2.

Libri "Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe" i autorit Vesel Nuhiu është një përmbledhje e punës shumëvjeçare të autorit sa i përket hulumtimit të ndikimeve të anglishtes në shqipen, në rrafshe të ndryshme gjuhësore dhe në hapësira të ndryshme gjuhësore (ndikimi i anglishtes në shqipen e Ballkanit kundruall ndikimit të anglishtes në shqipen e shqiptarëve të SHBA-së) brenda një periudhe prej katër dekadash (1970-2010), kryesisht të përqëndruar në vitet '70-të dhe '80-të të shekullit të kaluar.

Libri "Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe", i autorit Vesel Nuhiu, është një finalizim i përpjekjeve të tij për t'i shpjeguar rrethanat shoqërore në përgjithësi dhe ato gjuhësore në veçanti të zgjedhjeve të caktuara fonologjike, leksikore dhe gramatikore, të cilat i ka trasuar folësi shqiptar i anglishtes në Ballkan gjatë përdorimit dhe përshtatjes së këtyre huazimeve, kryesisht kulturore dhe të emigrantëve shqiptarë në SHBA, gjatë përpjekjes së tyre për integrim sa më të shpejtë dhe të pavërejtshëm në shoqërinë amerikane, duke u mbështetur detyrimisht në gjuhën e folur e duke i marrë parasysh rrethanat specifike të këtij inkuadrimi në veçanti për këtë komunitet.

Meqë autori i studimit është një nga pionierët e mësimdhënies universitare të anglishtes në Kosovë dhe një nga kuadrot e parë shqiptarë të specializuar në fushë në ndikimeve dhe të huazimeve gjuhësore në universitetin shtetëror të Zagrebit, nën mbikëqyrjen e akademik Rudolf Filipoviqit, profesorit të mirënjohur në këtë fushë të studimeve (gjatë viteve '70 dhe '80 të shekullit XX), lexuesi i këtij botimi do të mund të zgjedhë midis një studimi puro gjuhësor të analizës fonologjike, morfologjike, leksikore dhe sintaksore të huazimeve të anglishtes në shqipen, si dhe një studimi sociolinguistik të interferencës gjuhësore si pasojë e ndikimit të anglishtes në shqipen e shqiptarëve të Amerikës (Amerika këtu i referohet SHBA-së) para rreth tri dekadash. Për më tepër, autori i përmbledh edhe disa trajtesa të tjera të botuara më herët në revista të ndryshme kulturore-gjuhësore e që kryesisht kanë të bëjnë me ortografinë e huazimeve të anglishtes në shqipen, me përshtatjen gramatikore dhe me përdorimin e termave të anglishtes në shqipen. Brenda kësaj përmbledhjeje, do ta theksoja një punim me rëndësi që rezulton me një listë të përpunuar, por jo edhe te përfunduar të huazimeve të reja të anglishtes ne shqipen e që ende mbesin fjalë të papërfshira në fjalësin zyrtar të shqipes, por që përdoren dendurisht në pothuajse të gjitha situatat formale dhe joformale gjuhësore.[1]

Libri është i organizuar në 17 kapituj të veçantë që në të vërtetë i paraqesin punimet e autorit të botuara nëpër revista të ndryshme shkencore dhe disa sosh më pas janë ndarë në nënkapituj që në vete i ngërthejnë strukturimin dhe klasifikimin e huazimeve të anglishtes në shqipen sipas segmentit gjuhësor të shtjelluar.

Ndonëse hulumtimi mbështetet kryesisht në rezultate të një analize gjuhësore që nuk e pasqyron gjendjen e sotme të ndikimeve të huazimeve intensive të anglishtes dhe nuk e trajton procesin e huazimit gjuhësor në rrethana të sotme, metodologjia e hulumtimit e mbështetur në modele bashkëkohore të kohës (teoritë e bilinguizmit dhe të sociolinguistikës sipas Haugen-it, Weinreich-it, Filipović-it) dhe shtjellimi konciz me shembuj konkretë i këtyre dukurive gjuhësore mbesin model origjinal i krahasimit dhe pikënisje e sigurt për

[1] Fjala është për punimin me titullin "Shqipja dhe huazimet angleze sot", të botuar paraprakisht në revistën Thesis Kosova, nr.I, ff.111-129, 2008, Universiteti AAB, Prishtinë.

studime të tjera që do të mund të ndërmerreshin në këtë fushë, natyrisht, në rrethana pothuajse krejtësisht jokongruente me ato të periudhës kur është realizuar studimi.

Autori e mbështet studimin e tij të parë, të pasqyrimit të gjendjes së ndikimit të anglishtes në gjuhën shqipe në Ballkan, në korpusin e përbërë prej 900 trajta fjalësh dhe nja 400 emrash të përveçëm, kryesisht të nxjerrë nga të përditshmet dhe revistat e botuara në Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri. Ndërkaq, për të mbledhur materialin gjuhësor të folësve në SHBA, ai ka përzgjedhur 36 informatorë, prej tyre 17 të brezit të parë të emigrantëve dhe 19 të brezit të dytë të lindur në SHBA. Për më tepër, ai i ka analizuar edhe mbi 700 numra të gazetave në gjuhën shqipe, të botuara në SHBA, nga aspekti sinkronik dhe diakronik, duke i krahasuar ato në periudha të ndryshme të botimit. Zatën, studime të ngjashme të folësve bilingë nga aspekti sociolinguistik dhe në fushë të huazimeve janë shumë të rralla në shqipen dhe pak të studiuara edhe sot. Studimet e sotme të ndikimit të anglishtes në shqipen mbështeten kryesisht në një kontekst krejt tjetër të një globalizimi të përgjithshëm gjuhësor, shkencor dhe kulturor shumë agresiv. Në një situatë të tillë edhe rezultatet e studimeve për huazimet e anglishtes në shqipen dallojnë nga ato të Vesel Nuhiut, por jo edhe bërthama e këtyre studimeve. Baza teorike klasike e përdoruar nga autori gjatë përshkrimit teorik të kësaj dukurie gjuhësore dhe klasifikimet e huazimeve në shqipen si gjuhë marrëse mbesin ende aktuale në shumë studime të këtij lloji sot e kësaj dite. Në tridhjetë vjetët e fundit të shekullit XX, për shkak të rrethanave shoqërore dhe kulturore, në të cilat gjendej shqipja dhe shqipfolësit, nuk mund të paramendoheshin disa prurje gjuhësore të anglishtes që janë bërë pas vitit 2000: kryesisht prurje leksikore, por edhe të tilla që shpeshherë i ngacmojnë sistemin fonologjik dhe gramatikor të shqipes. Autori aludon në krijimin e një mekanizmi institucional për mbrojtjen e gjuhës shqipe nga huazimet e panevojshme dhe e mbështet tezën se duhet patur kujdes që gjatë vlerësimit nëse duhet të përvetësohen ose jo fjalët e huaja. Sipas tij, mund të jemi liberalë ndaj huazimeve vetëm nëse nuk gjejmë një emër përkatës në shqipen dhe me këtë rast të kihet kujdes nëse huazimi e emëron një nocion të ri apo një nocion të ngjashëm në kontekste të ndryshme (Nuhiu, 2013: 131).

Përfundimet e ngjashme autori i përcakton si nevojë të menjëhershme dhe të domosdoshme me qëllim të kontrollimit të huazimeve të panevojshme dhe, gjithnjë sipas tij, të refuzimit të tyre nga shqipja. Autori jep përshtypje mjaft subjektive rreth çështjes së të huazuarit sot (mbështetur në përvojat e shumta si mësimdhënës dhe përkthyes nga anglishtja në shqipen dhe anasjelltas) dhe konsideron se përvojat e studimeve të huazimeve të anglishtes në gjuhët tjera në SHBA e gjetiu duhet të merren parassysh gjatë shqyrtimit të tyre shkencor.

Krejt në fund, mund të përfundojmë se në mungesë të studimeve të këtij lloji në shqipen dhe për shqipen si dhe për shkak të shumëdimensionalitetit gjuhësor që përmban, libri "Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe" i autorit Vesel Nuhiu paraqet një përmbledhje të rëndësishme punimesh nga fusha e huazimeve gjuhësore dhe e përshtatje së tyre në gjuhën shqipe, është një referencë e domosdoshme për studiuesit e ardhshëm dhe një model i mirë i punës shkencore në rrafsh të kontakteve ndërgjuhësore.

Linditë Sejdiu-Rugova

Alfred UÇI: *ESTETIKA MIGJENIANE. STUDIM MONOGRAFIK GJITHËPËRFSHIRËS I VEPRËS SË MIGJENIT*. Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, ff. 610.

"Estetika migjeniane" (2013) e Alfred Uçit është vepra më gjithëpërfshirëse studimore për krijimtarinë letrare të Migjenit. Është prurje thuaja shteruese e mendimit dhe vlerësimit kritik të kësaj vepre, i cili zë fill menjëherë pas vdekjes së poetit. Autori me këtë rast sjell dhe regjistron të parin tekst të tillë për Migjenin, atë të Veli Stafës (1914-1939), që në fakt është një klithje e poetit për vdekjen e poetit, që edhe vetë është i shtruar për shërim po nga e njëjta sëmundje si ajo e Migjenit, në një sanatorium të kohës në Slloveni (Golik). Stafa e nënshkruan tekstin me pseudonimi "Platonikus", botuar në gazetën "Shtypi" në shtator të vitit 1938, pra një muaj pas vdekjes së Migjenit. Në këtë shkrim Veli Stafa do të bëjë fjalë për dy tekste të Migjenit, për poezinë "Kanga skandaloze" dhe prozën "Bukuria që vret". Vlerësim më komplet, tekst që artikulon dy tipare më të veçanta të letërsisë së Migjenit, atë si "Uragani i ndërprerë" dhe "Lule e re me një aromë të panjohur në kopshtin tonë letrar" është shkrimi i Kristaq Tutulanit (1922-1943). Në një shkrim përkujtimor dy vjet pas vdekjes së poetit Kristaq Tutulani i pari vë në pah dy karakteristika, të cilat do të shtjellohen dhe thellohen në studime të mëvonshme nga autorë të shumët. Le të kujtojmë, gjithnjë në këtë vijë, esenë e Ismail Kadaresë, të sjellë gjithashtu në këtë studim monografik, i cili ndër të tjera thotë "ngrehu Migjen të shkosh te letërsia shqipe. Për shkak të rrethanave e ke ëndërruar këtë letërsi disi nga larg. Tani që u afrohet portave të saj të rënda, që dëgjon kërcëllimën e zinxhirëve të tyre, turbull e ndjen se ka diçka që është vjetruar në këtë letërsi. E ndjen se ajo ka nevojë për riparim, për risi. Ai i hyri rrugës së letërsisë, por arti që do të bëjë ai është ndryshe nga të tjerët. Ndryshe për çdo gjë dhe në çdo gjë". Një tjetër shkrimtar i ri, poet gjithashtu, Gjikë Kuqali (1921-1944), gjithnjë në dy vjetorin përkujtimor do të botojë shkrimin me titullin "Pranvera mua më gjeti me Migjenin". "Shkrimet e kaluara dorë më dorë (fjala është për librin "Vargjet e lira", që u ndalua dhe sekuestrua nga policia në 1936 ende pa dalë nga shtypi), gjer tek unë janë hapur mbi tryezë… Migjeni përmendore që kurrë nuk do humbasë" e përfundon shkrimin e vet në mars të vitit 1940 Gjikë Kuqali. Pikërisht për këta të tre, klithës dhe vlerësues të parë të krijimtarisë së Migjenit, Skënder Luarasi do të shkruajë: "Këta janë vetëm disa pak zëra që nuk do t'i dëgjojmë më kurrë, pse edhe ata vetë shkuan udhës që shkoi Migjeni, po që dëshmojnë ushtimën e madhe që zgjoi kënga e Migjenit në zemrat e rinisë shqiptare të kohës, të etur për dije e liri!"

Libri "Estetika migjeniane" i Alfred Uçit, shkruar dhe konceptuar brenda projektit "Fryma moderne në letërsinë shqipe", nënkupton një punë dhe përkushtim titanik të autorit, të investuar gjatë disa viteve. Edhe ashtu libri voluminoz, përfshin në vete dy vëllime: vëllimin e parë të përgatitur më herët me rastin e njëqind vjetorit të lindjes të Migjenit (2011) dhe vëllimin e dytë me rastin e shtatëdhjetë e pesë vjetorit të vdekjes (2013). Në këtë vepër janë përfshirë dhe komentuar mbi dyzet autorë dhe studime, tekste monografike mbi veprën letrare të Migjenit si dhe dhjeta autorë dhe vepra, kryesisht teorike nga fusha e filozofisë dhe estetikës dhe që vijnë për të hedhur dritë në këtë debat të gjerë dhe të hapur mbi poezinë dhe prozën e Migjenit, për të sjellë rrjedhat universale të kohës, brenda së cilës lindi fenomeni Migjen. Alfred Uçi, duke i sjellë bashkë në një tryezë debati të gjitha këto prurje të shfaqura brenda harkut kohor nëntëdhjetë vjeçar, gjykime dhe vlerësime që edhe kryqëzohen, edhe përputhen, edhe përplasen e përjashtohen pa fund, i artikulon brenda vizionit të vet kritik dhe estetik të qartë dhe kompetent, por tryezën e madhe të debatit e lë

të hapur, me të drejtë dhe i bindur se do të vazhdojë. Do të vazhdojë edhe për arsyen, thotë Alfred Uçi, se Migjeni e ka përballuar gjenialisht sfidën me kohën dhe i tillë ka zënë vend të përhershëm në panteonin letrar të shqipes. Prandaj, vepra e tij hyn në rrethin e klasikëve universal, që pareshtur do ta nxisë komunikimin me ndjesitë e brezave dhe epokave në vazhdim, gjithnjë, në këtë rrjedhë epokash do të rrezatojë reflekse vlerash artistike, shpirtërore dhe estetike në kohë.

Ali Aliu

Ali ALIU: *DON KISHOTI TE SHQIPTARËT*, ASHAK, Prishtinë, 2005, ff. 226.

Don Kishoti te shqiptarët i Ali Aliut, një libër i botuar së pari në maqedonisht (Shkup, 2003), pastaj në shqip (Prishtinë, 2005), është kërkimi më sistematik i raporteve të shqiptarëve (në letërsi) me Don Kishotin (personazhin) e me (anti)donkishotizmin (fenomenin). I nisur me pesë autorë, i zgjeruar në njëmbëdhjetë (2005), libri i Aliut për Don Kishotin mbetet i hapur, ndërsa kërkimi zgjerohet shkallë-shkallë, si një lexim që ndjek fenomenin e donkishotizmit të lakuar në aventurë shkrimtarësh, të familjes së *Don Kishotëve të lumtur*. Në shtrirjen e këtij kërkimi, (anti)donkishotizmi kërkohet si synim ideal, i përkthyer në aventurë letrare, në të cilën letërsia bëhet "shtizë" në dorë të autorit, fushë e kërkimit dhe e përmbylljes së idealit.

Aliu niset nga De Rada, për të ardhur tek autorët bashkëkohës, në një kërkim që anticipon historinë e re letrare shqipe (shek. XIX e XX), të pashpallur në terma të fortë e të thurur *ndryshe*, të lidhur si kërkim variantesh të manifestimit të (anti)donkishotizmit në letërsi. Nga kjo vërejmë se donkishotizmi nuk është kërkuar si temë, por si *mënyrë e sjelljes*, që në letërsi bëhet edhe *mënyrë e shkrimit*. E gjithë letërsia e madhe, universale, është kërkim e (s)provim idealesh, qoftë edhe si punë Sizifi, përtej një kohe, vendi e rrethane, si aventurë nga e cila nuk hiqet dorë, edhe kur të tjerët s'e kanë asnjë shpresë. Kjo e bën letërsinë punë Don Kishoti, një donkishotizëm që buron nga ëndrra dhe që vetë ëndërron të dalë në jetën e gjallë.

Donkishotizmi tek autorët që lexon Aliu merr disa fytyra, po përherë ngelet i lidhur me ëndrrën dhe ëndërrimtarët e pandreqshëm, me shkrimtarët.

Kështu, de Rada, si Don Kishot, përherë plot besim, kërkon rrënjët e identitetit, trungun, po edhe degët e tij, duke kërkuar e shkruar gjuhën e arbëreshëve, gjithnjë duke shkruar edhe italisht, për të komunikuar më gjerësisht, por edhe për të veçuar arbërishten si gjuhë të trungut e të jetës së gjallë arbëreshe.

Naimi, i lidhur me veprimin nacional për pavarësi, pas shkollimit e shkrimeve në gjuhë të tjera, *zbuloi* gjuhën shqipe si trezor të qenies e të jetës nacionale dhe shkroi veprën që lexohet sot për idetë, sa për gjuhën e hapur.

Noli e solli Don Kishotin te shqiptarët, herë duke i bërë donkishotë të gjithë, e herë duke u parë vetë në pasqyrën e Don Kishotit, *sojliut* të rënë.

Konica iu bashkua veprimit e kulturës nacionale, për ta rizbuluar e për ta transformuar në kulturë kritike. Ai përherë ruajti idealizmin donkishotesk, idealizmin e veprimit që buron nga ëndrra, qoftë kur teorizoi për gjuhët, qoftë kur shkroi shqipen e pastër, apo kur ra në truallin e ashpër të jetës politike shqiptare. Konica, një dijetar poliglot, një stilist i rrallë i shqipes, ashtu si dhe i frëngjishtes, ia pa sherrin veprimit, por kultura e jeta shqiptare fituan shumë nga veprimi i tij.

Poradeci i bashkohet këtij qarku me antidonkishotizmin e tij, për të provuar se antidonkishtizmi në kohë donkishoteske, nën diktaturë, është një soj donkishotizmi. Porti rri larg ideologjisë së pushtetit e skemës së jetës së projektuar nga ai, për të jetuar në ideologjinë e së bukurës dhe në iluzionin e jetës që ëndërron vetë.

Në leximin e Aliut, Fatos Arapi është një Don Kishot i zhgënjyer, që sheh se si zhbëhen iluzionet për ideologjitë e për jetën shqiptare. Ndërsa, Kadare - Don Kishoti shqiptar që kalon nëpër Ferr, plot iluzione e besim se Ferri kapërcehet.

Azem Shkreli klith si Don Kishot në aventurën e rëndë shpirtërore për ta fisnikëruar jetën shqiptare. Shkreli vritet aq sa vritet personi kur përballet me kolektiven.

Podrimja ironik, qoftë dhe ë shkallën më të lartë të ironisë, ecën në fillin e donkishotizmit shqiptar, në të cilin poezia e shoqëron e do ta përfaqësojë dhimbjen kolektive kosovare.

Don Kishotëve shqiptarë, ëndrrave e iluzioneve të mëdha shqiptare, Luan Starova u bashkohet me letërsinë në maqedonishte, shqipe e frëngjishte, për të provuar skemën shqiptare të lojës së rëndë me gjuhën, pra me identitetin.

Ndërsa, Xhevahir Spahiu hyn e rri në poezi si në një Ferr-parajsë, në të cilën e mira dhe keqja, drita dhe errësira rrinë bashkë, përballen e ndahen përherë.

Eseja kryesore e librit të Ali Aliut është *Don Kishoti te shqiptarët*, kushtuar Fan S. Nolit. Ky është teksti amzë i librit, një amzë prej nga buron kërkimi e një paradigmë që do të hetohet e të provohet fenomeni i donkishotizmit në kapërcimet e pandërprera nga vepra te veprimi i autorëve. Aliu e interpreton veprën dhe veprimin politik të Nolit, përherë të lidhur e të kushtëzuar nga donkishotizmi si fenomen që përcakton sjellje e veprime në kulturë e në jetë. Nga teksti dhe siç nënvizohet nga vetë autori në fund të tij, provohet se ai është shkruar gjatë, se autori i është rikthyer dhe secilën herë ka hapur rreth të ri kërkimi, ka lëshuar dritë të re në veprën dhe veprimin e Nolit.

Insistimi themelor i Aliu lidhet me interpretimin që i bën Noli *Don Kishotit* të Servantesit, në *introduktën* e tij të njohur. Aliu i kërkon shenjat e mëdha të interpretimit të Nolit dhe e shoqëron me vlerësim e miratime Vërtet, Aliu zgjedh Nolin, por vetë kapërcen paradigmën ideologjike që ka vënë leximi i Nolit dhe (anti)donkishotizmin e kërkon në paradigmën e veprimeve të zgjedhura e fisnike, të përcaktuara nga idealizmi e misioni, të cilit i besohet dhe i cili çmohet si ekzistenca.

Don Kishoti te shqiptarët është kërkimi më sistematik i Ali Aliut për një fenomen letrar e kulturor dhe merr në vete kërkimet jetësore të këtij studiuesi për autorë e vepra, për autorët e tij të zgjedhur. Në leximin e tillë, hapen shenjat e leximeve të përhershme të Aliut në shoqërimin e gjatë me këta autorë dhe jeton diskursi i hapur i tij, përherë i një shenje eseistike. Ndërsa, e tëra lidhet me kërkimin e varianteve të manifestimit të atij që Aliu e quan (anti)donkishotizëm, për të provuar se si takohen e si ndryshojnë autorët. Të gjithë së bashku, e provojnë (anti)donkishotizmin te shqiptarët, të përthyer në letërsi, në fushën më të gjerë të të fiksioneve e të iluzioneve që mban e jep paradigmën idealiste të Don Kishotit.

Don Kishoti mund të jetojë vetëm në letërsi, në këtë zonë që lejon të përmbushen misionet, edhe kur burojnë nga iluzionet, është mësimi që del dhe nga kërkimi i Aliut.

Kujtim M. Shala

Shkumbin MUNISHI: *PROBLEME TË SHQIPES STANDARDE NË KOSOVË*, ZeroPrint, 2013, ff. 226.

Libri "Probleme të shqipes standarde në Kosovë" i Shkumbin Munishit është një përpjekje për t'i përshkruar përdorimin e shqipes standarde në Kosovë dhe trendet e zhvillimit të saj, duke ofruar kështu një raport sociolinguistik të një shtrirjeje të gjerë të gjendjes së standardit të shqipes atje. Si i tillë, ky punim ofron një kontribut të dobishëm për hulumtimin e zbatimit dhe të funksionimit në praktikë të këtij standardi.

Duke e caktuar periudhën 2003-2006 si periudhë të vëzhgimit, autori i ka kundruar domenet, situatat dhe vendndodhjet e përdorimit të shqipes standarde, si edhe, për aq sa ka qenë e mundur, qëndrimet, siç i ka quajtur ai, "e bashkësisë folëse kosovare ndaj shqipes standarde".

Studimi është ndarë në gjithsej 6 krerë, përfshirë përfundimet e përgjithshme.

Dy krerët e parë e ofrojnë sfondin e problemit: i pari ofron një historik të përmbledhur të gjuhës standarde shqipe, me theks të veçantë pranimin dhe zbatimin e shqipes standarde në Kosovë, ndërsa i dyti ofron një përshkrim të statusit të sotëm të shqipes në Kosovë.

Krerët 3 – 5 e përfshijnë pjesën e hulumtimit. Kreu i tretë titullohet "Shqipja standarde në Kosovë", kreu i katërt e trajton drejtshkrimin e shqipes në Kosovë, ndërsa kreu i pestë e trajton gjuhën e folur.

Secili nga kapituj ofron metodologji më vete, për shkak të specifikave të hulumtimit sociolinguistik.

Shkumbin Munishi, i cili e ka botuar më 2013 edhe librin "Pikëpamjet e Androkli Kostallarit për gjuhën standarde shqipe", është mësimdhënës në Fakultetin e Filologjisë, ku, mes tjerash, e ligjëron lëndën e sociolinguistikës. Në krijimtarinë e tij, sociolinguistika ka qenë fusha dukshëm më produktive, ndërsa brenda sociolinguistikës, në shkrimet e tij çështjet e standardizimit kanë dominuar.

Munishi ka trajtuar në shkrimet e tij të deritashme, mes tjerash, probleme të gjuhës standarde dhe të variacionit sociolinguistik, pastaj të ndikimit të globalizimit në gjuhën standarde shqipe, i ka diskutuar gjuhën standarde dhe konvergjencën e gjuhës së folur, ka raportuar për konfliktet dhe kontaktet gjuhësore si dhe për politikën e planifikimit gjuhësor të shqipes në kontekstin e sotëm. Ndryshe nga disa autorë që e kanë diskutuar çështjen e standardit kryesisht me nuanca ideologjie, Munishi studimet e tij i mbështet në lexime kritike të një literature të gjerë e të shumëllojshme botërore dhe në të dhëna empirike, të nxjerra nga hulumtimet e bëra, mbështetur në metoda të ndryshme, të përshtatura për secilën fushë veç e veç.

Në "Studime 19/2012" të AShAK-ut kemi raportuar për shkallën e subjektivitetit në kumtesat e paraqitura në simpoziume shkencore që trajtojnë probleme të shqipes standarde, ndërsa hulumtimi pati treguar se një pjesë e madhe e këtyre kumtesave i nxjerrin përfundimet mbështetur në hamendje e supozime dhe jo në metodë shkencore.

Libri "Probleme të shqipes standarde në Kosovë" i Shkumbin Munishit nuk është i tillë. Ai përbën një përpjekje objektive, mbështetur në të dhëna të nxjerra nga hulumtimi konkret.

Kjo e bën Munishin njërin ndër autorët më seriozë të studimeve sociolinguistike në gjuhën shqipe dhe një kontribues i një vargu jo aq të gjatë të studimeve serioze në këtë fushë.

Studimet e para serioze sociolinguistike që e kanë rrahur temën e shqipes standarde shfaqen në fillimin e viteve nëntëdhjetë me kontributet e Rexhep Ismajlit, të cilat janë përmbledhur në tri vëllime: "Gjuhë dhe etni", "Në gjuhë dhe për gjuhë" dhe "Standarde dhe identitete". Një tjetër autor që ka kontribuar në fushë të përafërt është Rrahman Paçarizi, i cili problemin e standardit e ka rrahur edhe nga këndi psikolinguistik.

Munishi në punimin e tij ka përdorur bibliografi të rëndësishme, mbi leximin kritik të së cilës e vendos bazën e tij teorike, ndërsa hulumtimin e ka mbështetur duke përdorur matje të opinionit për ta nxjerrë relacionin e koncepteve me shoqërinë, e jo për të nxjerrë doemos raportin shkak-pasojë – qëllim i hulumtimit ka qenë nxjerrja e informacioneve preliminare për situatën gjuhësore në Kosovë, në mënyrë që mbështetur mbi këto rezultate pastaj të përqendrohet në studimin për gjuhën standarde shqipe në Kosovë. Për hetimin e reagimeve subjektive lidhur me raportet gjuhë standarde/ dialekt ai është mbështetur në një anketë kryesisht të tipit të mbyllur me 100 respodentë.

Shkallën e zbatimit të drejtshkrimit në Kosovë e ka bërë me një vëzhgim rasti nëpër kategori të ndryshme të tekstit, por duke e lënë anash letërsinë artistike, duke e pasur parasysh fleksibilitetin e normës në këtë kategori.

Përdorimin e gjuhës së folur e ka trajtuar mbështetur në vëzhgimin e përdorimit të shqipes në dy emisione televizive, të cilat janë transkribuar dhe analizuar më tutje. Mbështetur në hulumtimet e tij dhe në konceptin se gjuha standarde nuk është varieteti i vetëm gjuhësor, Munishi konstaton tre faktorë që e kanë vështirësuar pranimin e shqipes standarde në Kosovë: mungesa e një komunikimi më intensiv me folës të shqipes nga Shqipëria; imponimi i pamjaftueshëm i normës në institucione dhe dallimet sistemore të varietetit standard kundruall varietetit autokton.

Si përfundime të përgjithshme të të gjithë hulumtimit të tij, Munishi oforn të dhënat që tregojnë se shqipja standarde në Kosovë përdoret në situata, domene dhe vendndodhje të caktuara që janë karakteristike për gjuhët standarde, ndonëse krahas saj në situata formale përdoret edhe një gegërishte e kultivuar letrare. Për gjuhën e shkruar, Munishi e nxjerr përfundimin se është konsoliduar relativisht mirë, ndërsa problem kryesor është drejtshkrimi i ë-së. Ndërkaq, sa i përket gjuhës standarde të folur, Munishi vlerëson se është ende në konsolidim e sipër. Sipas tij, shpesh shqipja standarde në Kosovë del si një kod i përzier me tipare dialektore të gegërishtes.

Libri "Probleme të shqipes standarde në Kosovë" i Shkumbin Munishit, si një hulumtim i gjerë dhe shumështresor, del si një pikë mbështetëse për studime të ardhshme të studimeve që do ta kenë shqipen standarde për objekt të tyrin të studimeve. Si i tillë, është një vepër e rëndësishme për gjuhësinë shqiptare në përgjithësi dhe sociolinguistikën shqiptare në veçanti.

Bardh Rugova

Dhurata SHEHRI: *STATUSI I KRITIKËS,* Botoi, Albas, Tiranë, 2013.

Libri më i ri studiueses Dhurata Shehri *Statusi i Kritikës* sjell në kulturën shqiptare një mënyrë më ndryshe të vështrimit të kritikës dhe rolit të saj, pasi që, siç dihet, teorizimi për kritikën mbetet gjithnjë objekt "i lartë" i studiuesve. Shehri kohëve të fundit, është shquar po ashtu edhe për risi në kërkime të fenomeneve të ndryshme letrare, ashtu edhe për autor të veçantë. Edhe kësaj here shohim që Shehri nuk ka dalë jashtë konturave të saj, duke e ndarë librin në dy pjesë: e para metakritike, pra kritikë e kritikës, dhe pjesa e dytë që merret me leximе personale të autorë të veçantë, si ilustrues të problemeve më të gjera.

Në pjesën e parë Shehri do të ndalet te problemi i zhvillimit dhe vlerësimit të statusit të kritikës. Nga ky aspekt shqyrtimin do ta nisë nga statusi i kritikës që zotëron në Shqipëri, madje do të ndalet edhe te kanoni letrar sot, duke analizuar shkolla dhe avangarda letrare; pastaj ndalet te kritika letrare dhe terminologjia, duke e ilustruar me rryma të ndryshme dhe tekste, dhe në fund jep disa rileximе të letërisisë shqipe, në të cilat shquan rileximin si lexim filologjik dhe rileximin si lexim ideologjik.

Duke pasur parasysh problemin e statusit te kritikës si të shumë të rëndësihëm, Shehri në radhë të parë do të bëjë një klasifikim të kritikës letrare të shekullit XX në: kritikë formalisto-strukturaliste; kritikë marksiste dhe kritikë psikanalitike. Brenda këtyre prirjeve metodologjike kërkon dallime në diakroni e sinkroni dhe gjithashtu heton se këto metoda të kritikës artikulohen sipas marrëdhënies së këtyre elementeve të komunikimit letrar: autorit, tekstit, kontekstit dhe lexuesit. Problemin e "skemës së komunikimit", nga e cila niset, Shehri e merr nga Jakobsoni, i cili, sipas këndvështrimit të saj, nga të gjitha elementet përbërëse jashtë vëmendjes kishte mbetur lexuesi dhe leximi si interpretim, për t'u lidhur me kritikën, interpretimin, komentin dhe kanonin. Kështu studjuesja duke u shquar në kërkmet teorike shqipe, lexon edhe këndvështrimet e Haidegerit, Gadamerit, Jausit dhe Izerit, Ekos, Foucosë, Derridës etj. Në këtë rrugë përfundimisht sheh mundësi të ndryshme të interpretimit dhe leximit, duke parë qëndrime të ndryshme në rol të tekstit, autorit dhe lexuesit. Pas këtyre paraqitjeve Shehri vjen te konstatimi se pikëpamjet janë të ndryshme, shpesh edhe të kundërta sa i përket satusit të kritikës, pra tekstit apo lexuesit.

Kur merret me analizën e kritikës shqipe, Shehri do të ndalet më shumë te "Historia e kritikës moderne", e Rene Uelekut, i cili kritikës i njihte disa funksione, duke hetuar kështu krizën e kritikës, që për këtë studiuese në Shqipëri shpeshherë është artikuluar si mungesë e kritikës. Koncepti i saj për kritikën si vlerësim e gjykim njeh statusin ndërmjetës midis veprës e lexuesit e po ashtu edhe statusin *post festum*, që mbështetet në besimin që ka lexuesi te kritika, te ndërmjetësimi. Me një fjalë, për Shehrin nëse kritika shqipe nuk e bën sa dhe si duhet ndërmjetësimin mes letërisë dhe lexuesit, shkaktar është mosbesimi. Mbi këto diskutime ëë në pah edhe ndryshimin e termit letërisë, i cili përfaqëson ide funksionale dhe jo ontologjike.

Për këtë problem e sidomos kur sheh një status të dyfishtë të kritikës në Shqipëri (vektorin e të kuptuarit dhe vektorin e veprimit), Shehri ndjek mendimin e Ibrahim Rugovës për krikën e kritikës. Libri në fjalë jep një pamje më të gjerë të aksiomës "mungesa e kritikës", duke hetuar se kjo ndodh për shkak të humbjes së subjektivitetit të kritikës. Kështu pra libri hap dhe diskuton cështjet ose pasojat që kishte lënë realizmi socialist në letërsi dhe kritikë, duke humbur shijen personale për letërisnë dhe konceptin ontologjik të letërisë, duke e zëvendësuar me atë funksional të letërsisë. Prandaj, Shehri mendon se në radhë të parë duhet të trajtohet letrarësia, për të arritur më pastaj te funksioni vlerësues e krijues i shijes së kritikës. Në radhë të parë pra për studiesen tonë duhet të hetohet letërsia,

pra çka është letërisa? Saktësisht Shehri mendon se shkrimtarët duhej dhe ishin të parët që tentuan kritikën subjektiviste.

Natyrisht, Shehri duke u nisur nga insistimi për teorinë e kritikës, ajo do ta hetojë atë edhe pas viteve '90, duke hetuar receptimin e saj si rezistencë ndaj formave të reja ligjërimore që bashkëshoqëronin ndryshimin e statusit, funksionit dhe ligjërimit të letërisë. Si duket këtë përceptim Shehri e sheh vetëm si ndryshim, sepse ajo mendon se përsëri kritika e ka të paqartë statusin e saj ligjërimor. Më tej, mbi këtë pikë të diskutimit ajo vëren edhe mungesën e kritikës shqipe si mungesë e terminologjisë, pas rënies së pushtetit të ideologjisë.

Për ta provuar përfundimisht shtrirjen dhe statusin e kritikës shqipe, Shehri jep edhe një rrugë tjetër që ka rrokur kritika shqipe, atë shkencore. Shehri lakon kryesisht statusin e kritikut, prandaj këtu e gjen autoritetin e kritikut "specialist", i cili shkon drejt karakterit institucional të kritikës.

Duke vështruar praktikën kritike Shehri nxjerr konstatime se kritika letrare shqiptare iu afrua metodave strukturaliste dhe tekstuale edhe pse me vonesë dhe në këto diskutime thekson se terminologjia e re synon autoritetin përmes "kompleksimit" të lexuesve. Vend të rëndësishëm në këto shqyrtime të këtij mendimi zë përkufizimi se statusi i kritikës sot lidhet me anomalitë në komunikimin e vet metaligjërimit kritik. E një nga problemet që shtrohet këtu është se rivendosja e statusit autoritar të kritikës, u tenstua edhe përmes rikanonizimit të shkrimeve kritike të letërisë shqipe të anatemuara bashkë me autorët. Kështu, duke e ilustruar këtë pikëpamje, ajo thotë se letërisa nuk komunikon njësoj me lexues të ndryshëm në periudha historike të ndryshme dhe se shija letrare është krejt e ndryshme.

Përfundimisht, sa i përket statusit të kritikës sipas Shehrit procedimi i analizës tekstore nuk arrin të bëhet tendencë në kritikën bashkëkohore për shkak të mungesës së statusit të besimit tek ndërmjetësimi i kritikës. Kështu ajo vlerëson se objektiviteti mund të jetë parakusht i kthimit të besimit. Po ashtu kritiku sipas kësaj studiueseje është një ekspert që njeh dhe transmeton kompleksitetin e teksteve dhe në këtë plan ngreh tekstin si pikë kryesore, si material pune, të cilit duhet t'i referohemi.

Shehri, e formuar në dijen e teorive moderne letrare, pret një kritikë të hapur, madje krejt të hapur, por mendon se në Shqiëri kritika duhet të vetëpropozojë krizën ose të autoanulohet. Një veprim të tillë e sheh në gjithë kritikën botërore. Me një fjalë, kërkimii Shehrit për statusin e kritikës kap edhe "zonën" e sotme kohore, duke konstatuar se kritika sot në Shqipëri zotërohet ende pavetëdijshëm prej antinomisë dominante ideologjike.

Dhurata Shehri, duke zhvilluar mendimin për statusin e kritikës nëpërmjet analizës detajuese dhe unike, në pjesën e dytë të librit promovon lexime personale. Pra, në këtë pjesë kemi disa vështrime të vecanta për autorë të preferuar të autores. Teksti i parë ndërtohet nën titullin *Figurat e modernitetit*. Në kërkimin e tillë lexohet Poradeci dhe Migjeni që, së bashku me Koliqin, konsiderohen si autorë të letërisë moderne shqipe. Poradeci në këtë vështrim zgjedh unin e vet, qenien thelbësore përmes metaforës paradigmatike. Shehri e sheh poliseminë si rrugëtim dhe rrugëdalje drejt përcaktimit të referentit, sepse për Shehrin referenti në modernitet do të thotë ta shpikësh atë, kur e di se vetë moderniteti humb me vetëdije refernetin. Ndërsa, te Migjeni objektin e sheh të shfaqur vetëm si mundësi, në të shkuarën, por sidomos në të ardhmen fluide.

Më pas në tekstin e dytë që titullohet *Teksti i Migjenit dhe konteksti iKoliqit* lexohen përsëri Migjeni e Koliqi, por tash për të veneruar se si konteksti zëvendëson tekstin në historinë e letërsisë shqipe. Këtyre dy autorëve u vështrohen veprat duke u vënë në pah se

si fati i teksteve të tyre u shenjua nga kontekstet e dhunshme. Në këtë kontekst jeta e teksteve të Migjenit përkon me ekzekutimin e teksteve të Koliqit dhe Shehri mendon se bashkëkohësia është prishur. Më tej ajo mendon se mbizotërimi i kontekstit mbi tekstin deformoi edhe ata autorë që nuk dolën jashtë qarkullimit letrar. Prandaj, ideja se historiani i letërisë duhet të kthehet në çdo moment e të jetë ai vetë lexues, para se të kuptojë e ta vendosë në një rend një vepër, del si mesazh itekstit, pasi që në vështrimet e Shehrit vend të veçantë zë përcaktimi i shkollave letrare dhe kanonizimi i letërisë. Prandaj, qëndrimi i saj është vetëdijësim për vendim si lexues-vlera dhe tekstin në kontekst. Kështu, duke iu referuar edhe pikëpamjes së Jakobsonit për ideologjinë e lexuesit të sotëm, problemin e Migjenit e Koliqit e ilustron kështu: "S'na mbetet veçse të pohojmë se 'Qyteti i Veriut' në tekstet e Migjenit mund të shihet më mirë nga Xhami i dritores së Koliqit".

Koliqi lexohet edhe në tekstin e tretë të pjesës së dytë, port tash Shehri hap një problem të ri duke kërkuar *Ernest Koliqin, si shkrimtar i ekzilit.*

Ndërsa, në tekstin e katërt Shehri ka objekt romanin "Pse?!", duke propozuar në nivel diskutimi teorik librin si eros i estetizuar. Gjon Zaveri në vështrimin e Shehirit del i bukur dhe i vetmuar. Ai sipas saj ka vetëm një qëllim, të jetojë si i bukur dhe të vdesë si i tillë, të vetëpohohet e të vetërealizohet si subjekt erotik. Kështu mendon se erosi i tij është erosi që estetizohet, duke u bërë diskurs fantazie. Përfundimisht, Gjon Zaveri del heroi i parë narcist i letërisë shqipe.

Diskursi poetik si diskurs politik është teksti i radhës i librit të Shehirit. Në këtë tekst dëshmohet diskursi poetik si diskur politik, i ilustruar me veprën e Nolit. Duke u shqyrtuar problemi i natyrës së tillë, Fan Noli del si actor e autor i diskursit politik. Për Shehrin ai tenton të fiksojë duke krijuar, të ndërtojë histori duke folur për bashkëkohësinë, të ndërtojë njëherësh edhe përfaqësimin dhe të përfaqësuarin. Duke pasur referncë kryesorë për këtë model Ugo Vollin, studuesja jonë mendon se të vepruarit politik është të vepruarit gjuhësor dhe kjo krijon një afri mes fushës së të bërës - hapsira politike - dhe fushës diskursive. Se si dskursi poetik del si diskurs politik Shehri e dëshmon duke e ilustruar me disa poezitë e tij më të mira të këtij lloji dhe duke evidentuar elmentet që krijojnë këtë fenomen. Më së shumti shquhet alegoria, të cilën mendohet se Noli e përdor sit të vetmin ligjërim politik të mundshëm brenda ligjërimit të tij poetic. Përfundimish, Shehri mendon se alegoria e tij është politike, jo për shkak të referentit politik, por për shkak të përformativetit që kërkon të përçojë te lexuesi (dëgjuesi).

Vështrime të veçanta të Shehrit kemi edhe në tekstet e tjera në vijim që ajo vetë i ka definuar si leximе personale, si: *Liria e vetmisë ose njeriu me vete e pa të tjerë* ku kemi objekt poezinë e Martin Camajt; *Hapësira e lirisë* me objekt veprën e Ismail Kadaresë; *Lulet e vona të lirikës së Bilal Xhaferit* këtu merret poezia e Xhaferit; pastaj kemi tekstin *Kolektivizmi i subjektit lirik në poezinë shqiptare të realizmit socialist*, në të cilën vërehet që në titull kërkimi i autores, dhe në fund kemi *Një antimodel në kërkim të modelit* dhe *Për kufirin, ose "Odë mesit"* me objekt autorin Eqrem Basha.

Albanë Mehmetaj

Ibrahim RUGOVA: *TEORIA LETRARE - TEKSTE TË ZGJEDHURA*, Fondacioni "Ibrahim Rugova", Prishtinë, 2013, f. 268.

Teoria letrare është *dija e zgjedhur* e Ibrahim Rugovës, ndërsa secili lexim që do të përshkruajë a të përfaqësojë Rugovën, duhet së pari ta përfaqësojë dijen e tij të zgjedhur.

Teoria letrare e Rugovës, nga paradigmat te abstragimet totale, shtrihen në veprën e tij diskursive si rrjet konstantash të mendimit e të profilit të tij prej dijetari, ndërsa, në lexime klasifikuese, lidhet në fusha tematike: estetikë/ teori e veprës letrare; teori e kritikës letrare; teori e poezisë shqipe. Diskurset e fushës së parë janë eseistike, ndërsa ato të dy pjesëve të tjera më të lidhura, më të përqendruara e më përgjithësuese.

Teoria letrare e Rugovës lidh bashkë temat e mëdha të diskursit teorik të tij, që kapin cepat e shekullit të kërkimit dhe bëhen paradigma të kritikës letrare të tij. Së bashku, këto fusha tematike e provojnë *teorinë letrare* të Rugovës, nga referencat te shenja e dija autoriale e propozuar.

Rugova, kritiku modern i shqipes, lidhet e lidh nyjat e teorisë letrare e estetike moderne, po kërkon rrënjët e mendimit, se duhet kërkim më parë, epistema të lidhura më pas.

Ibrahim Rugova teorinë letrare e kryqëzon me estetikat dhe e shpie drejt një estetike letrare. Ligjërimi ecën nga *natyra* e letërsisë (poetika) te *funksioni* i saj (estetika). Tekstet e pjesës së parë të *Teorisë letrare*, të titulluar *Estetika letrare*, e provojnë diskursin e tillë të Rugovës, teorinë estetike letrare, të frymës së shekullit XX.

Teoria e kritikës e Rugovës buron nga paradigmat e teorisë letrare moderne, që, në nyja të forta, është teori e metodave të kërkimit (metodologji). Në tekstet e kësaj fushe, diskursi i Rugovës provon shkallë të re konceptualizimi, shoqëruar nga problematizimet e njohura të tij, po edhe përfundimet për metodën si *procedurë* që s'mund të jetë *doktrinë*, meqë ashtu rrëshqitet në *dogmë*. Metodat maten me rezultatet, përballë dogmës që rezultat bëhet vetë. Rugova e çlironte *kërkimin letrar*, se më parë çlironte *mendimin*.

Fusha tematike e *poieisis*-it, në kuptimin klasik, lidhet me studimin teorik/ tipologjik të titulluar *Teori e poezisë shqipe*, i cili e provon Rugovën teoricien, studiues të poezisë e kritik letrar, në lakoren që nis me diskursin teorik, vijon me kërkimin tipologjik, provohet me shembuj/ ilustrime dhe mbyllet me vlerësime. Këtu si kudo, Rugova e provon fort se teoria buron nga letërsia dhe i kthehet asaj, pa u bërë qëllim i vetes. Vërtet, kjo është një paradigmë e madhe e teorisë letrare/estetike moderne, e propozuar dhe e provuar nga Rugova në shtrirjen e veprës së tij.

Teoria letrare e Rugovës, e lidhur në një vend, si tekste të lidhura (*Teoria letrare*) apo si rrjet dijeje, kap diskurset teorike të Rugovës dhe e provon sistematikën e teorizimeve të tij.

Teoria letrare e Rugovës është një nyjë e teorisë letrare shqipe, madje një paradigmë moderne e saj. *Trashëgimi* e *diskurs i gjallë*, e tillë hapet e lexohet teoria letrare e Ibrahim Rugovës.

Këto skajime janë shenjat e *Teorisë letrare* të Rugovës, të një vepre përfaqësuese të mendimit letrar rugovian. Libri është strukturuar në pjesët tematike/ tipologjike: *I. Estetika letrare*, *II. Kritika letrare* dhe *III. Teoria e poezisë*, për të përfaqësuar paradigma, abstragime e vlerësime. Një libër që e *përqendron* dijen rugoviane në prerjet e saj të mëdha.

Kujtim M. Shala

RUGOVA I LETËRISË, Fondacioni "Ibrahim Rugova", Prishtinë, 2012.

"Rugova i letërsisë" është libër me studime të zgjedhura për Ibrahim Rugovën dhe është ndërtuar në atë mënyrë që të vihet në pah se si është studiuar deri më tani vepra e madhe e Rugovës, e cila sipas hartuesve pret e hapur për leximet e tjera që do t'i shtohen "korpusit rugovian". Vepra e Rugovës i pret e hapur leximet dhe shkrimet, sepse vetë është "vepër e hapur". Rugova si studiues i formuar në frymën e teorive letrare moderne s'ka si të mendojë dhe të shkruajë ndryshe, pos të jetë i hapur me veprën dhe me lexuesit potencialë, duke lënë mundësi të ndryshme interpretimi e shqyrtimi.

Studimet që janë përfshirë në librin "Rugova i letërsisë" e dëshmojnë se me veprën e Rugovës studimi letrar është çliruar e hapur edhe për faktin se kahja teroike e studiuesit tonë buron nga *genus proximum*, që shpjegohet si dalje e letërsisë nga roli i gjinisë më të lartë. Që në tekstet e para, Rugova e nis shqyrtimin e letërsisë si *differentia specifica.* Po ashtu, në gjithë veprën e tij Rugova e ka kërkuar elementin estetik dhe artistik të letërsisë, duke bërë që të shkëlqejë letërsia. Kështu pra, Rugova e propozon letërsinë si gjini të veçantë; e kërkon letërsinë si vlerë dhe funksionin e saj si qenësi; do ta lexojë letërsinë si një model të botës dhe shoqërisë dhe mbi të gjitha poezinë e konsideron si model paralel të botës, të jetës dhe të vetë ekzistencës.

Siç u tha edhe më lart, "Rugova i letërsisë" është një përzgjedhje tekstesh për veprën e Ibrahim Rugovës dhe është hartuar nga: Kujtim M. Shala, Dhurata Shehri, Munish Hyseni dhe autorja e këtij teksti. Në esencë libri synon ta japë portretin e dijatrit Ibrahim Rugova në trajtën "Rugova i lexuar". Tekstet janë zgjedhur nga autorë të brezave të ndryshëm, nga bashkëkohësit, te pasuesit e studiuesit më te rinj të veprës së Rugovës, të shkruara për gjallje e pas shkuarjes së tij. Këta së bashku e japin shekullin e leximit të veprës së Rugovës.

Autorët me këtë përzgjedhje tekstesh në radhë kanë synuar të parë ta provojnë natyrën e diskursit të Ibrahim Rugovës, si dhe rrjetin e mendimit që ka krijuar ky diskurs nga fillimi. Po ashtu, shohin se tekstet e dëshmojnë jetën e veprës së Rugovës në diskursin e autorëve rugovianë, autorëve që e lexojnë dhe duan Rugovën. Kështu, vepra e tij kalon në tekstet e të tjerëve, si frymë dhe mendim, si ide dhe si diskurs.

Libri "Rugova i letërsisë" është strukturuar në pesë tërësi tipologjike: "Memento", "Dijetari Rugova", "Vepra", "Testamenti" dhe "Bibliografia".

"Memento" jep shenjat e mëdha të portretit të Ibrahim Rugovës dhe përbëhet nga teksti studiuesit të njohur, prof. Sabri Hamiti. Askush më mirë se Hamiti nuk mund ta shkruante këtë pjesë, kur dihet se dy autorët përpos që kanë qenë të një qarku, të pikëpamjeve dhe dijeve të afërta, si letrare, ashtu edhe politike, kanë qenë edhe miq, prandaj vështrimi nga kjo perspektivë e shton rëndësinë e tekstit dhe të gjithë librit.

Pjesa e dytë e librit, pra "Dijetari Rugova" ka përbërëse tekstet si: "Ibrahim Rugova: kritik Letrar" (Sabri Hamitit); "Rugova: kultura e ideologjia (Vehbi Miftari); "Rugova, Qarku i Prishtinës dhe rugovizmi (Kujtim M. Shala). Ndërsa, pjesa e tretë, që ka në qendër veprën e Rugovës, përbëhet nga tekste të autorëve të ndryshëm si: Sabri Hamiti, Mensur Raifi, Teki Dërvishi, Beqir Musliu, Ali Aliu, Anton Berisha, Shaban Sinani, Xhemail Mustafa, Ramadan Musliu, Vehbi Miftari dhe Albanë Mehmetaj..

Pjesa e katërt e librit gjithashtu përbëhet nga tekste të autorëve të rëndësishëm e të cilët kanë në fokus: *Testamentin*. Këtu përfshihen: Gjergj Zheji, Rexhep Ismajli,, Muhamedin Kullashi, Mark Marku, Ahron Tufa, Xhavit Beqiri, Kujtim M. Shala dhe Nysret

Krasniqi. Ndër tekstet kryesore që mund ta theksojmë këtu e që dallohet që në titull,është *Rugova - ndër figurat e rëndësihme të studimeve letrare në albanistikë,* nga akademik Rexhep Ismajli, në të cilin shpaloset figura e Rugovës në dijen letrare, duke u hulumtuar vepra e tij që nga fillimet. Duke vlerësuar se Rugova i la kulturës shqiptare vlera intelektuale, shkencore dhe të dijes, Ismjali konkludon se Rugova la një vepër "të rëndësishme, madhore, dimensionet e së cilës mbase nuk i vërejmë për shkak të afërisë së pandërmjetme, që bashkë me plejadën e qëndrestarëve të kësaj kohe, e kanë krijuar me lëvizjen për çlirimin kombëtar dhe njëherësh për ndërtimin e vlerave demokratike e për emancipim të përgjithëshem të shoqërisë shqiptare".

Tërësia e pestë dhe e fundit e libri e jep Bibliografinë e shkrimeve për Rugovën dhe dëshmon se tekstet e përfshira në këtë libër janë disa nga leximet e Rugovës dhe fton, si edhe ky libër në tërësi, që leximi të shtrihet më tej te tekstet që janë shkruar për të.

Për ta përfunduar këtë shkrim prezantues për "Rugovën e letërisë", themi se të gjitha stumet që janë përfshirë në këtë libër, në thelb i bashkohen përkushtimit të Zef Pëllumit: "Kujtimi i tij kjoftë i përhershëm!" Për këtë arsye hatuesit e konsiderojnë "Rugovën e letërsisë" si një homazh për Rugovën.

Albanë Mehmetaj

Nysret KRASNIQI: *SABRI HAMITI*, botoi AIKD, Prishtinë, 2011, 565.

"Sabri Hamiti" është libri më i ri i kritikut Nysret Krasniqi, në të cilin, përmjet një leximi sistematik të veprës së letrare, ndërtohet portreti i Sabri Hamitit shkrimtar e mendimtar. Libri i Krasniqit ka natyrë monografike. Është strukturuar në katër tërësi të mëdha kërkimore, që u referohen zhanreve të veprës së Hamitit dhe vetë bëhen "blloqe tematike".

Librin e dominon interpretimi i poezisë, që zbulon synimin për një lexim të ri të Hamitit poet, kur ai mbretëron në mendimin letrar shqiptar. Më tej Krasniqi shtrihet në leximin e romanit *Njëqind vjet vetmi*, të dramave dhe mbyllet me pjesën metakritike për veprën diskursive të këtij mendimtari, të hapur e të klasifikuar sipas formave e metodave, gjithnjë të konceptuara si epistema.

Kërkimi i Krasniqit është insistues, në radhë të parë kur interpreton veprën poetike të Hamitit, shtrihet në honet semantike e hermeneutike, për të arritur te fenomenologjia e saj. Pastaj, lidhet për nyjat themelore të mendimit teoriko-letrar të Hamitit dhe bën evidencat e rezultateve të kërkimeve konkrete të tij.

Ky libër e provon Krasniqin si një kërkues letrar që tashmë ka autorët e tij të zgjedhur, që ka shenjat e veta prej studiuesi, e provon edhe një herë diskursin e hapur, që komunikon me lehtësi dhe rezultatet e tij.

Krasniqi është autor i Shkollës së Prishtinës dhe një nëxënës i shpallur i Hamitit, shenja këto që zbulojnë edhe një sensibilitet të *kërkuesit* e të *kërkimit*, të shtrirë si raport ndërmjet kërkuesit e veprës, që shpesh e determinon diskursin e studiuesit. Të gjitha këto hapen duke e hapur diskursin e Krasniqit.

Për të kaluar nga karakterizimet tona te diskursi i Krasniqit, po rimarrim të rezymuara pikat e mëdha të kërkimit të tij, të përthyera në rezultate kërkimore, që bëjnë nyjat e Portretit të shkrimtarit e të dijetarit Sabri Hamiti. Një Portret i thurur ngadalë, me durim, dashuri e identifikime pafund. Një Portret që zbulon përnjëherë *portretuesin* e *të portreturarin*, si dy faqe të një letre apo të shkruara në një letër.

1. Sabri Hamitin Krasniqi e skajon si poet që e shkruan jetën e tij poetike në sistem, që burimësinë e vet e ka në veçantinë e ndjesimeve autoriale, të cilat hyjnë në *ricorso*-n e vazhdueshme të "persones autoriale", duke kaluar nëpër gjendjen "paraformale", "motivuese" dhe "formale", për ta jetësuar formën e veçantisë së veprave poetike, që i bën ato të dallueshme në letërsinë shqipe dhe më gjerë.

2. Në jetën me letërsinë, Sabri Hamiti e krijon një "botë", një "Libër poetik", i cili e mban fuqishëm e përherë shenjën autoriale. Libri poetik i Hamitit, duke marrë e jetësuar brenda tij trajta personale, nacionale e universale të shprehjeve poetike, në format më të ndërliqshme të saj, problematizon rishtas pikëpyetjen historike se a merret poezia me të veçantën apo me të përgjithshmen. Po dihet se interpretuesi Krasniqi përfundon se poezia e Hamitit në botën e saj i mban gjallë të dy fenomenet, se i mban të dy raportet.

3. Më tej, poezia e Sabri Hamitit shtron pikëpyetjen e raportit të letërsisë apo të poetit me proceset nacionale e politike. Mirëpo, me sy nga *historia* e poetëve, theksohet se nuk ka poet që nuk e ka pasur në shpirtin e tij ndjenjën e vrojtimit të problemeve nacionale e politike. Vrojtimi i këtyre problemeve dhe transcendimi i tyre në poezi, është shenjë e fuqishme e vet qenësisë së artit e kurrsesi ideologjizim i tij, nënvizon Krasniqi në këtë nyjë.

4. Në aventurën e shkrimit të të gjitha formave të mëdha letrare, Hamiti e shkroi romanin e diskursit të lidhur me individualitetin, që e forcon edhe "individualizimin e letërsisë" në Kosovë, përveç në poezi, edhe në këtë formë letrare, në një kohë kur shkrimi

romansor trajtonte temat e mëdha të figurës së reales apo të ideologijve të mëdha.

5. Dramatikën Hamiti e njeh si formë më të afërt me figurimin e realitetit njerëzor, për të shenjuar një trashëgimi aristotelike të dijes letrare. Por përballë dramatikës, që tradicionalisht skajohet si shprehja artistike më neutrale në raport me krijuesin e saj, kjo nuk ngjet edhe me shkrimin dramatik të Hamitit, intenca e të cilit është që vepra ta hetojë fatin e njeriut idealist, po të mbërthyer në prerjet ideologjike, të cilat e lidhin atë për një rrjet.

6. Diskursi i Krasniqit shkon nga rithënia e diskursit dhe e dijeve të Hamitit, për të nënvizuar se ai, që në fillim, e di se në letërsi dominon *varianti* e jo synimi për një ekzaktësi falso e shterpe që në dijet humane e zbeh mendimin, fushë në të cilën interpretimi është loja më e këndshme për afrimin te *hapësira e letërsisë*.

Sabri Hamiti e ndjen se kur interpretohet, teksti jeton në sistemin e vlerave, ndërsa kur ideologjizohet vritet, bashkë me autorin e tij.

Hamiti e heton se kritiku letrar duhet ta nisë punën kur atij i flet teksti letrar me poetikën e vet e jo kur i bën trysni koha apo ideologjia e caktuar, prandaj i ngjalli shumë vepra e autorë në letërsinë e në kulturën shqiptare.

E di se pas analizës letrare dalin edhe nominimet (nuk duhet të ndodhë e kundërta) dhe ato vetëm si relativitete, prandaj, pas një pune dekadash, hartoi poetikën historike të letërsisë shqipe vetëm si një kornizë të brishtë ndihmëse.

7.Sabri Hamiti ndërtoi sistem të fortë të interpretimeve letrare, prej të cilit buron poetika pa ideologjinë, prandaj dhe e jetësoi atë për të parën herë në shkrimin shqip mbi letërsinë, "poetikën historike letrare shqipe".

Sabri Hamiti, përfundimisht, nga hetimet kritike e teorike, ecën drejt fenomenologjisë së letërsisë shqipe, për të dhënë mendime edhe për letërsinë si fenomen universal, do të theksojë fort Krasniqi.

8. E gjithë kjo, në përfundimet e Krasniqit, lidhet me emrin e Sabri Hamitit si një model i veçantë e valid për studimin e literaturës.

Në këto rezymime rikujtohet vepra e Hamitit, kujtesa me shkrim me Krasniqin, e provuar si dije e diskurs, që do të thotë si ide e stil. Krasniqi i ka edhe idetë, edhe stilin e tij.

Libri i lexuar është sintagmë për Librin e Krasniqit dhe na kthen te leximi i tij, i lidhur me pasionin për veprën që ka përpara e me dijen letrare që vetë e lidh me këtë vepër. Në këto raporte, Hamiti e Krasniqi hapin, shtrijnë e s'e mbyllin dialogun, as kur mbyllet faqja e fundit e *Sabri Hamitit*.

Në këtë shkalllë identifikimi, diskursi i Krasniqit i ngjan diskursit të Hamitit, sa interpretimin ta bëjë rrëfim e veprën e vet ta shkruajë "bashkë" me Hamitin. Këto janë shenja të një dijetari modern, që dijen letrare e mendon si *diskurs të dashuruar* me veprën e që vetë bëhet *diskurs i këndshëm*. Të tillë i njohim autorët e Qarkut letrar prishtinas, zbulues nga fillimi të shenjave të identitetit nacional e të provuar në modernitetin universal.

Ricorso-ja që ndërton Krasniqi me interpretimin e tij, do kthimin te vepra e Hamitit, rikthimin te *Sabri Hamiti*, për ta mbyllur harkun e për ta provuar interpretimin. Kështu shenjohen dy shkallë determinuese ekzistenciale, ndërmjet veprës e diskursit për të dhe ndërmjet interpeetimit e veprës.

Krasniqi mëson si nxënës ditunor, shkruan në shkallë të lartë identifikimi me diskurset e Hamitit dhe e mbyll librin me një formulë adhurimi, e cila e shenjon adhurimin në secilën faqet të libit: "Lavdi atij që nuk vdes…" Kështu sugjerohet leximi i Sabri Hamitit të Krasniqit nga kjo formulë apo në shenjë të saj, për të na kthyer sërish te *ricorso*-ja e famshme, për të na përfshirë ngadalë brenda saj.

Kujtim M. Shala

Sabri HAMITI, *Zef Pllumi*, Albas, Tiranë, 2013, f. 72.

Zef Pllumi është vepra që lidh në një Libër esetë e Sabri Hamitit për veprën, personën e kulturën e Zef Pllumit, nën shenjën e librit eseistik, i cili është pandani modern i librit monografik.

Këto *skajime* të para e shenjojnë raportin e Hamitit me Pllumin, diskursin e hapur të esesë dhe zhanrin që i ikën përmbylljeve e finaliteteve, për ta lënë të hapur librin. Një libër si ky pret faqet e reja, ashtu siç pret faqe të reja vepra e Pllumit, e pabotuar në tërësi dhe përherë e hapur për t'u lexuar.

Zef Pllumi është autor, madje person i zgjedhur i Hamitit, zgjedhje të cilat së bashku e bëjnë një figurë kulturore e morale, një *fenomen kulturor*, që do të thotë përfaqësues, prandaj mësues. Një figurë si Pllumi rri e hapur për leximе, qoftë kur shkruan e dëshmon, kur hapet në imagjinime, qoftë kur hesht. Në të gjitha pikat ai është mësues yni, kur ne duam dhe mund t'i ngjajmë. *Zef Pllumi* i provon këto, ashtu si dhe ngjashmërinë e *kërkuesit* me të *kërkuarin*.

Ngjashmëritë i përsërit e i shumëfishon vetë libri *Zef Pllumi*, me diskurisn substancial, kur Pllumi është rezymues e substancial; me idetë e rithëna, kur kërkohen e parafrazohen në dialogjikën që thur kërkuesi me të kërkuarin, kur jetët e tye të ndryshme takohen në ide e pëlqim të ndërsjelle, që ruhet e thuhet në shenjat e fisnikisë shqiptare e të respektit të vendit. Por, siç e do dialogjika, Hamiti ndahet kur interpretimin e lakon në hone të tjera, të lidhura me dijet e me jetën e vet, madje me sensibilitetin e vet. Kështu ruhet dialogu, meqë monologu përherë e përjashton njërin. Kështu provohet ikja nga diskursi monografik te libri eseistik, që s'jeton nga zbulimet, por nga leximet e hapura të kuptimeve.

Hamiti ka ndjekur dhe lexuar veprën e Pllumit në radhën e shkrimit e të botimit, metodë apo sistematikë që çon te përgjithësimet e trajtës: *Át Zef Pllumi: fenomeni kulturor*, që do të thotë Át Zef Pllumi: një kurorë. Vepra e Hamitit, si bijë e veprës dhe e veprimit të Pllumit, e njeh dhe e propozon Zef Pllumin si figurë morale shqiptare, të shtrirë e të shkrirë në *shkrimtarinë* e tij, sepse ajo kap jetën e Pllumit si dokument apo psikenë si fiksion, që së bashku bëhen *shkrim*, pra kulturë.

Sistematika e kërkimit, nis si sistematikë strukturimi, lidh esetë e *Zef Pllumit* nga *Át Zef Pllumi: Rrno vetëm për me tregue*, tek *Át Zef Pllumi: Ibrahim Rugova*, ndërsa ndërmjet këtyre skajeve merr: *Át Zef Pllumi: Françeskanët e mëdhaj*, *Át Zef Pllumi: Frati i pashallarëve*, *Át Zef Pllumi: Saga e fëmijnisë*, *Át Zef Pllumi: fenomeni kulturor*, *Át Zef Pllumi: Autobiografia*, dhe *Intervistë me Sabri Hamitit*. *Át Zef Pllumi* i përsëritur në krye të çdo teksti, e shenjon autorin e identifikueshëm me veprën dhe autorin e njohur si autoritet, ndërsa leximi nis nga një dorëshkrim i vonë, lexon veprën, arrinë aubiografinë e mbyllet me një dorëshkrim të vonë, që e provon të përqendruar diskursin substancial të Pllumit, kur e bën portretin e Ibrahim Rugovës. Vepra e lexuar ndërmjet dorëshkrimeve, që bëhen parafjalë e fjalë e mbylljes, kapet si *monument* kulturor, ndërsa dorëshkrimet si dokumente autentike e provë për monumentin e Pllumit.

Zef Pllumi, i tillë, kalon nga portret për Pllumin, në model moraliteti, i cili i teston kulturalisht dhe në jetën e gjallë, që do të thotë në biografitë konkrete, shqiptarët e Pllumit e shtrohet si provë për shqiptarët nesër. Kështu, vetë shkrimi për Pllumin bëhet sprovë e provë për sot dhe lë të hapur sprovën e nesërme.

Në skajin tjetër, *Zef Pllumi* e provon edhe një herë diskursin e hapur të Hamitit, të lakuar honeve të tekstit, kur do të kërkojë lidhjet e dokumentit me jetën e gjallë apo të

fiksionit me psikografinë. Ndërsa, kërkimi i tij lidhet me dijet letrare, që mbajnë mbrenda metodat dhe i sprovojnë me epistema. Leximi i Pllumit i shtohet këtij diskursi dhe shenjohen në një *ricorso*, në të cilën përfshihemi edhe ne, për të marrë mësimin e për t'u testuar. Për çfarë?

Përgjigjet e mëdha mësohen në *veprën* e Pllumit, si dëshmi e rrëfim, madje si utopi, ndërsa vepra mëson nga jeta e tij, e ruajtur në skaj të ekzistencës, kur Pllumi kaloi përmes territ e Ferrit, po me dritën e së vërtetës në shpirt. Hamiti e thotë fort, Zef Pllumi, me pamjen, shikimin, ecjen, me fjalën e thënë e të shkruar, është *figura*, mësimi, fenomeni kulturor dhe vepra përfaqësim.

Mësimi i Át Zef Pllumit apo i shkrimtarit Zef Pllumi s'mbaroi kur françeskani i madh mbylli jetën, s'mbaron as kur mbyllen kapakët e librave të tij. Po, se jeta e tij e gjallë është një provë moraliteti e vepra e tij një s'provë idealiteti. Në këto nyja lidhet *Zef Pllumi* i Hamiti, si zbulim e si mësim.

Kujtim M. Shala

ODA BUCHHOLZ (1940-2014)

In memoriam



Më 2 janar 2014 në Berlin u shua albanologia e shquar Dr. Oda Buchholz.

Oda Buchholz u lind në Berlin më 21 janar të vitit të turbullt 1940 në një familje socialdemokratësh. Fëmijërinë dhe rininë i ka kaluar në rrethana dhe periudha të vështira, ndërsa pastaj ka pasur një jetë më të qetë dhe të përshtatshme për punët e saj hulumtuese. Pasi kishte mbaruar shkollimin e mesëm, më 1959 ishte dërguar të studionte në Shqipëri në Fakultetin Histori-Filologji, në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe, ku kishte mundur të qëndronte për dy vjet të plota dhe të mbaronte provimet që ishin parashikuar me sukses shumë të mirë. Për shkak të ndryshimit të raporteve midis Shqipërisë dhe vendeve të Paktit ajo pas dy vjetësh ishte detyruar të kthehej në Berlin, ku i vijoi studimet për albanologji në Universitetin Humboldt të Berlinit, Fakultetin e Filozofisë, për t'u diplomuar më 1964 me fah kryesor Albanologjinë dhe fah të dytë Gjuhën dhe letërsinë bull-

gare.[1] Oda Buchholz është ndër të parët albanologë në Europë me formim që në krye të herës në albanologji.

Në këtë kohë Oda pati mundësinë të niste punën studimore në Akademinë e Shkencave nën drejtimin e gjuhëtarit A. V. Isaçenko të njohur për studimet strukturale. Në ato rrethana ajo njëkohësisht i thellonte njohuritë për gjuhën shqipe.

Më 1969 Oda Buchholz mbrojti me sukses disertacionin e saj të doktoratës në gjuhësi me një temë me interes dhe pak të studiuar të strukturës së shqipes – *Zur Verdoppelung der Objekte im Albanischen* (Mbi përsëritjen e kundrinës në shqipen) dhe me këtë ajo u kualifikua për të punuar në *Zentralinstitut für Sprachwissenschaft* të Akademisë së Shkencave, ku bashkë me Wilfried Fiedler-in do të vijonin më tej studimet e tyre të thelluara për shqipen dhe në një kuadër më të gjerë ballkanistik.

Gjatë gjithë kohës së studimeve në Berlin, Oda Buchholz u zhvillua si gjuhëtare në kontakte të drejtpërdrejta me gramatologjinë gjermane, por njëherësh edhe me gjuhësinë strukturale tashmë klasike në mjedise të tjera dhe me zhbillimet shumë të rëndësishme në fushën e gjuhësisë gjenerative rreth qerthullit tashmë ndërkombëtarisht të njohur të Manfred Bierwiesch, ajo vetë në studimin e saj në hullinë e *Aspects of the Theory of Syntax* të N. Chomskyt. Në ato rrethana, me njohje të shkëlqyera të gjuhës shqipe, po edhe të bullgarishtes, gjuhë ku përsëritja e kundrinës manifestohet në përmasa dhe rrethana afërsisht si të shqipes, ajo ndërmori përshkrimin dhe shpjegimin e rregullave në varësi komplekse nga faktorë të ndryshëm sintaksorë të përsëritjes së kundrinës. Në tërë veprën e saj ajo hulumtoi vetëm gjuhën moderne letrare. Rezultatet e shumta në këtë punë i japin librit të saj statusin e veprës së parë serioze dhe të thelluar në këto punë, primatin e studimit gjithnjë jo të tejkaluar dhe të veprës së parë gjenerative-transformacionale për shqipen. Në 230 faqet e librit të botuar më 1977, version i shkurtuar i doktoreshkrimit me të njëjtin titull, studiuesit vazhdojnë të gjejnë

[1] Shënime me vlerë për veprimtarinë e Oda Buchholz-it mund të gjenden te Erwin Levin & Gerd-Dieter Nehring: Forschungen zur albanischen Sprache, Kultur und Geschichte. Neubeginn und Traditionen, në Osteuropa in Tradition und Wandel. Leipziger Jahrbücher 8 (2). Osteuropakunde an der Leipziger Universität und in der DDR. Leipzig 2006, ff. 579-614. Po ashtu: Erwin Levin & Gerd-Dieter Nehring: Kontributi albanologjik i filologëve dhe historianëve gjermanolindorë, në Hylli i Dritës 258, 2008, 3, Shkod]r, ff. 99-137.

mbështetjen gjithnjë të dobishme për hulumtime të mëtejme në këtë fushë.

Në vijim Oda Buchholz ndërmori studime të shumta për sintaksën e shqipes, ku shquajnë hulumtimet e saj në fushën e modeleve të fjalisë në gjuhët ballkanike dhe në shqipen, por edhe të konfrontuara me gjuhë si gjermanishtja, pastaj hulumtimet për çështje të ndryshme të nyjës dhe të shquarsisë në gjuhën shqipe, për çështje të rasave dhe të funksioneve të tyre në grupin emëror, për çështje të ndryshme të foljeve, duke filluar nga reksioni e deri te fjalitë ekzistenciale me 'kam', për të arritur te vetë "kallëzuesori", etj. Me një fjalë, objekt i interesimit të saj ishte bërë e tërë struktura gramatikore e shqipes së sotme, me kohë vështrimin e kishte shtrirë edhe më tej në funksionimin e gjuhës letrare, në proceset e formimit të saj dhe posaçërisht në hulumtimin e leksikut shoqëror të saj.

Fazën nga vitit 1968 e tutje në veprimtarinë shkencore të Oda Buchholzit e karakterizon frymë e lartë e bashkëpunimit me grupin e ballkanologëve të Berlinit, në radhë të parë me dr. Wilfried Fiedler-in. Bashkë me Fiedler-in ajo ka ndërmarrë disa projekte me rëndësi, siç janë: hartimi i gramatikës së madhe të shqipes së sotme, hartimi i fjalorit shqip-gjermanisht, studimi i raporteve të shqipes me gjuhët e Ballkanit dhe përkthimi i veprave të ndryshme nga shqipja gjermanisht, përgjithësisht paraqitja e kulturës shqiptare për botën e ndarë gjermane në atë kohë. Nuk ka qenë e rastit që pikërisht kjo fazë e bashkëpunimit dhe e hulumtimeve të thelluara për gjuhën shqipe dhe për gjuhët e Ballkanit u përputh me ardhjen e tyre në Prishtinë dhe pjesëmarrjen shumë të rregullt në punimet e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, ku ishin shumë aktivë dhe gjetën tërë mbështetjen e nevojshme, madje kishin krijuar miqësi në qytet. Çdo vit ata vinin jo vetëm me kumtesa e studime të reja për çështje të strukturës së shqipes, po edhe me vëllimin e rritur të gramatikës së tyre që po ecte me ritme të shpejta. Natyrisht, Oda Buchholz dhe Wilfried Fiedler kanë luajtur një rol me rëndësi në shkëmbimet e ideve me albanologëve vendës, të Shqipërisë dhe të vendeve të tjera që vinin në Seminar dhe në këtë mënyrë edhe kanë dhënë ndihmesë me rëndësi për avancimin e këtyre studimeve. Në vitet 1985-86 ata tashmë kishin sjellë tri vëllimet e mëdha me lidhje të posaçme të dorëshkrimit të Gramatikës, për të cilin, në recensionin që ma kishte kërkuar Akademia pata nderin të shquaja vlerat e larta të veprës dhe të rekomandoja ngrohtësisht botimin.

Në *Albanische Grammatik* të O. Buchholz e W. Fiedler, Berlin, 1987, sistemi gramatikor i shqipes së sotme vështrohet në tërë gjerësinë e tij: në fonologji, në strukturën morfologjike dhe në fushën sintaksore. Pjesën për morfologjinë në këtë gramatikë, pra edhe atë për foljet, e karakterizon tendenca për të qenë shterruese sa u përket formave. Bie në sy qëndrimi risimtar në raport me gramatologjinë për shqipen në shumë aspekte të morfologjisë, sidomos në sistemin e foljeve. Tërë vështrimin e morfologjisë së shqipes në plotninë e tij e cilësojnë konsideratat për format dhe varietetet e tyre në gjallninë e shqipes së sotme dhe në kompleksitetin që presupozon vështrimi i integruar formal dhe semantik, përfshirë aspektet pragmatike brenda. Kjo bie në sy në trajtimet e veçanta të sistemit të mënyrëve të foljes dhe të admirativit, pastaj të posibilitativit dhe të komplekseve më tej të ndërtimit të pyetjeve e të përdorimeve infinitivale.

Në fushën e sintaksës kjo Gramatikë është gjithsesi shumë e rëndësishme dhe prijatare. Duke u mbështetur në kriteret e standardet e larta të kësaj gramatologjisë gjermane, autorët kanë ditur të integrojnë në veprën e tyre për shqipen aspektet formale e semantiko-pragmatike në fushat e morfologjisë, ndërtimin dhe përbërjen e njësisë minimale strukturore të fjalisë apo kompleksitetin hierarkik të zhvilluar të saj më tej, llojet e fjalisë, tipologjinë më të suksesshme që kemi njohur deri sot, shqyrtimin e intencave të folësit në këtë kuadër makrosintaksor, po edhe rezultatet e vështrimeve teorikisht të ndryshme të studimeve linguistike nga gramatologjia tradicionale e sh. 20 (Helbig-Buscha,) nëpër vështrimet funksionale e strukturale e deri tek vështrimet e hershme gjenerative.

Kjo gramatikë konsiderohet ndër veprat bazë të gramatologjisë shqiptare në përgjithësi. Kjo Gramatikë kishte qenë dhe vepër habilitimi në kuadër të sistemit të atëhershëm të gradave shkencore në RDGJ e autorëve Buchholz dhe Fiedler.

Sintaksologe e spikatur, dr. Oda Buchholz, bashkë me prof. dr. W. Fiedler-in ka bërë dhe vepra shumë të dobishme për komunikimin e ndërsjellë midis kulturave shqiptare e gjermane: bashkë me sintaksologen tjetër dr. Gerda Uhlisch, ata bënë *Fjalorin shqip-gjermanisht*, me pasqyrimin kryesisht të shqipes pas normimit të vitit 1972, me shumë shprehje idiomatike e begatime të tjera të natyrës stilistike, të shoqëruar me një grama-

tikë relativisht të plotë. Fjalori pati 4 botime në Gjermaninë Demokratike dhe vijoi nga viti 2000 në serinë Langenscheidt të fjalorëve me status ndërkombëtarisht të verifikuar si leksikografi standarde, ku pjesa Shqip-gjermanisht arrin në 739 f. Në këtë botimin e fundit pjesën e dytë, Fjalorin gjermanisht-shqip në 831 f. e kanë hartuar W. Fiedler dhe A. Klosi.

OdaBuchholz njihet po ashtu si përkthyese e letërsisë shqipe në gjuhën gjermane sidomos me *Tregimet shqiptare* më 1976, *Der bekümerte Zweig* (*Antologji e poezisë shqipe të Kosovës)* 1979, *Ziech dich zurük in den Vers Homers* (Kthehu në vargun e Homerit) 1988, me *Gjeneralin e ushtrisë së vdekur* qysh më 1977, të ribotuar më 1988 në Berlin e Kiel, të rishikuar në München 1990, me *Novelat* e I. Kadaresë të Kadaresë Berlin 1988 e Kiel 1989, tregimet e Shuteriqit e të Agollit, nga i cili kishin përkthyer dhe romanin Zylo, etj. Kohët e fundit kishte përkthyer bashkë me D. Nehring ditarin e Bardhyl Hoti/ Frank Nordhausen: *Entkommen* (I shpëtuar), Berlin 2000 dhe librin me poezi të Bekim Morinës *Diçka më të mirë se vdekja*, Hanover 2006. Oda Buchholz kishte bërë një punë shumë të dobishme me paraqitjen e zërave për letërsinë shqiptare në *Encyklopédia literarnych diel* në Bratisllavë më 1989 dhe më pastaj në BI-Lexikon *Literaturen Ost- und Südosteuropas*, Leipzig, 1990, etj.

Me punën e saj sistematike e të heshtur, me angazhimet e ngulmëta, me bashkëpunimet jo të pakta, kjo studiuese me cilësi shumë të larta i ka lehtësuar kontaktet në bashkëpunimet kulturore midis dy popujve tanë edhe në situatat e vështira të Gjermanive të ndara dhe të Shqiptarive të ndara.

Me këmbënguljen tonë ia dolëm të botonim dy nga veprat madhore të Fiedlerit në Prishtinë. Deri sot nuk ia kemi dalë ta përkthejmë veprën e përbashkët jashtëzakonisht të rëndësishme të O. Buchholz e W. Fiedler *Albanische Grammatik*, ndërmarrje që do të ishte me shumë vlerë për studimet albanistike. Të shpresojmë që në të ardhmen të kemi mundësinë ta përkthejmë dhe studimin e O. Buchholz *Zur Verdoppelund der Objekte im Albanischen* dhe bashkë me studime të tjera të saj të shpërndara në botimet albanologjike e ballkanologjike dhe në revistat Seminari, Gjurmime albanologjike, Përparimi, etj., në Prishtinë, të bëjmë një botim në të

cilin do të shfaqej hapur e tërë begatia e mendimit dhe thellimi studiues i gjuhëtares Oda Buchholz.

Pas rënies së sistemit komunist, Oda Buchholz, si të gjithë studiuesit e fushave humanitare në ish-Gjermaninë Lindore, u detyrua të bënte rikualifikimin, venia legendi, me një temë të mbrojtur për gjuhësinë ballkanike më 1992. Në vijim ajo ka qenë e shtrënguar të mbijetonte duke shërbyer si përkthyese zyrtare edhe nëpër gjyqet e Berlinit.

Me shuarjen e saj familja humbi më të dashurën, albanologjia gjermane njërin nga zërat e saj më të veçantë, ndërsa komuniteti i studimeve shqiptare një sintaksologe të kalibrit të madh dhe një mike të shquar të botës shqiptare.

Rexhep Ismajli

Dr. sc. phil. Oda BUCHHOLZ

LISTË E BOTIMEVE
LISTE DER VERÖFFENTLICHUNGEN[2]

O. Buchholz: Zur Frage der Verdoppelung der Objekte im Albanischen. In: **Actes du Premier Congres International des Etudes Balkaniques et Sud-Est Europeennes. VI.** Sofia 1968, 711-724.

W. Bahner, O. Buchholz, W. Fiedler, R. Lötzsch: Die Entwicklung der Literatursprachen der Völker Südosteuropas im Zusammenhang mit den sozialen Umgestaltungen während des 19. und 20. Jahrhunderts. a) Papier zum III. Internationalen Balkanologenkongreß. Bukarest 1974, 1-23. b) In: **Linguistische Studien/ZISW/A. Heft 33.** Berlin 1976, 1-20.

O. Buchholz: Zur Entwicklung der albanischen Literatursprache seit dem 19. Jahrhundert. In: Linguistische Studien ZISW/A. Heft 33. Berlin 1976, 21-45.

O. Buchholz, Fiedler: Herausgabe und literarische Übersetzung **„8 albanische Erzähler".** Berlin 1976, 5-328.

O. Buchholz, W. Fiedler: literarische Übersetzung „Der General der toten Armee" (I. Kadare). a) Berlin 1977, 5-258. b) Berlin 1988, 5-301. c) Kiel 1988, 5-307.

O. Buchholz, W. Fiedler: Zur Stellung der Objektzeichen in der albanischen Literatursprache der Gegenwart und bei Gjon Buzuku. In: **Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft. Sonderheft 41.** Innsbruck 1977, 433-458.

O. Buchholz: Zu Verben, die durch ein Objekt und ein Objektsprädikativ ergänzt werden. In: **Linguistique Balkanique XX** (1977). Sofia 1977, 147-159.

O. Euchholz: Zur Verdoppelung der Objekte im Albanischen. Linguistische **Studien/ZISW/A. Heft 34**. Berlin 1977, 1-228.

O. Buchholz, A. Beyrer, W. Fiedler, K. Kostov: Zur Rektion Verben in den Balkansprachen. In: Linguistische **Studien/ZISW/A. Heft 43**. Berlin 1977. 1-115.

O. Buchholz, W. Fiedler, G. Uhlisch: **Wörterbuch Albanisch - Deutsch (mit Kurzgrammatik)**. Verlag Enzyklopädie a) Leipzig 1977, 1-739. b) Leipzig 1981, 1-739 (2. (unveränderte) Auflage). **c) Leipzig 1987, 1-739 (3.** (unveränderte) Auflage). d) Leipzig 1990, 1-739 (4. (unveränderte) Auflage).

O. Buchholz: Mbi gershetimin e aspekteve morfologjike e sintaksore te rasat në gjuhën shqipe ('Zur Verflechtung morphologischer und syntaktischer aspekte bei den Kasus im Albanischen'). In: **Gjurmime Albanologjike VII-**1977. Prishtinë 1978, 145-158.

O. Buchholz: Struktura predloženija i sintaksičeskie funkcii sobiratel 'nych imjon suščestvitel'nych v albanskom jazyke ('Satzstruktur und syntaktische Funktionen der Kollektiva im Albanischen'). In: Problemy sintaksisa jazykov balkanskogo areala. Leningrad 1979, 44-61. W. Bahner - unter Mitarbeit von O. Buchholz, W. Fiedler, J., Irmseher und H. Walter: Entwicklungsrichtungen in der Herausbildung des modernen gesellschaftlichen Wortschatzes in Südosteuropa. In: **Linguistische Studien/ ZISW/A. Heft 58**. Berlin 1979, 1-34.

O. Buchholz, W. Fiedler: Zur Herausbildung des modernen gesellschaftlichen

[2] Falënderojmë dr. Gerd-Dieter Nehring që pati mirësin] të na vinte në dispozicion këtë bibliografi të hartuar nga vetë Oda Buchholz.

Wortschatzes im Albanischen. In: **Linguistische Studien/ZISW/A. Heft 53.** Berlin 1979, 102-176

O. Buchholz, W. Fiedler: literarische Übersetzung **"Der bekümmerte Zweig"** (Anthologie - Gedichte). Prishtine 1979, 4-99.

O. Buchholz, W. Fiedler: Rreth formimit të leksikut shoqëror në gjuhën shqipe ('Zur Entwicklung des gesellschaftlichen Wortschatzes im Albanischen'). In: **Përparimi** - revistë shkencore. Teil I: Nr. 3, Prishtinë 1980, 311-340. Teil II: Nr. 4, Prishtinë 1980, 477-512.

O. Buchholz, W.- Fiedler: Rreth zhvillimit të disa termave politiko-shoqërore në gjuhën shqipe para vitit 1912('Zur Entwicklung einiger gesellschaftspolitischer Termini im Albanischen vor 1912'). In: **Gjurmime Albanologjike X**-1980. Prishtinë 1980, 55-73.

O. Buchholz, Fiedler: Rezension zu "Studime Gjuhesore" (E. Çabej), Prishtinë, I-VI. In: **ZPSK Band 34, Heft 5**. Berlin 1981, 626-628 O. Buchholz, W. Fiedler: EQREM ÇABEJ - Nachruf, In: **ZPSK Band 34, Heft 5**. Berlin 1981, 591-593.

O. Buchholz, W. Fiedler: Rezension zu "Fjalor i gjuhës së sotme snqipe", 'Tiranë 1980. In: **ZPSK Band 34, Heft 6**. Berlin 1981, 756-758.

O. Buchholz: On the Postpositive Article in Albanian - Its Role in the Expression of Determinacy. In: **Folia Slavica Vol. 4, Numbers 2-3 (Festschrift Eric P. Hamp).** Columbus/Ohio 1981, 227-234.

O. Buchholz: Mbi kategorinë gramatikore të shquarsisë/pa-shquarsisë dhe mbi kategorine semantikofunksionale të determinativitetit/indeterminativitetit ('Zur grammatischen Kategorie der Bestimmtheit/Unbestimmtheit und zur funktional-semantischen Kategorie der Determiniert- heit/Indeterminiertheit'). In: **Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare VII.** Prishtinë 1982, 85-93.

O. Buchholz: Rreth fjalive ekzistenciale me foljen "habere" në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera të Ballkanit ('Zu Existenzsätzen mit dem Verb "habere" im Albanischen und in anderen Balkansprachen'). In: **Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën... VII**. Prishtinë 1982, 161-171.

O. Buchholz, W. Fiedler: Probleme des Vergleichs von Satzmodellen des Albanischen und Deutschen. In: **ZPSK Band 35, Heft 4.** Berlin 1982, 383-391.

O. Buchholz, Fiedler: Rezension zu "Tò Ellēno-Albanikòn Lexikòn toũ Márkou Mpòtsarē" (Titos P. Jochalas), Athen 1980. In: **Balkan-Studies 23, Nr. 1.** Thessaloniki 1982, 285-288. 0. Buchholz: Modele fjalish të shqipes dhe të gjermanishtes ('Satzmodelle des Albanischen und Deutschen'). In: **Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën ... VIII**. Prishtinë 1983, 91-100.

O. Buchholz: Aspekte të zhvillimit të leksikut në gjuhën shqipe ('Aspekte der Entwicklung des Wortschatzes im Albanischen'). In: **Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën ... VIII**. Prishtine 1983, 71-82.

O. Buchholz: Aspekte të zhvillimit të leksikut shoqëror në gjuhën letrare shqipe ('Aspekte der Entwicklung des gesellschaftlichen Wortschatzes in der albanischen Literatursprache'). In: **"Gjuha shqipe" Nr. 3**, Prishtinë 1983, 5-9. b) In: Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën ... IX. Prishtinë 1984, 95-99.

O. Buchholz: Kallëzuesori në gjuhën shqipe - në krahasim me gjermanishten ('Das Prädikativ im Albanischen - im Vergleich zum Deutschen'). In: **Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën ... IX**. Prishtinë 1984, 53-60.

O. Buchholz: Auswahl und literarische Übersetzung "Die Schwalben" (Dh. Shuteriqi) "Der wieting" (Dh. Shuteriqi). In: **"Der Tanz der Fledermäuse"**. Berlin 1985, 311-324. Berlin 1987, 311-324.
O. Buchholz: "Rezension zu "Die Schöne der Erde". Albanische Märchen und Sagen, Leipzig 1985. In: "**Neues Deutschland" vom 12./13. Juli** 1986 (Kulturbeilage), S. 14
O. Buchholz: Rreth gjinores dhe rrjedhores pa parafjalë në grupe emërore me funksionin e përcaktorit në gjuhën shqipe ('Zum reinen Genitiv und Ablativ in Substantivgruppen mit attributiver Funktion in der albanischen Gegenwartssprache'). In: **Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën ... XII**. Prishtinë 1987, 59-72.
O. Buchholz, Fiedler: Die Monatsnamen im Albanischen - Emrat e muajve në gjuhën shqipe. In: **Studime filologjike dhe pedagogjike për nder të Prof. Dr. Aleksandër Xhuvanit.** Tiranë 1986, 577-616.
O. Buchholz: Zu komparativischen und superlativischen Konstruktionen in den Balkansprachen. In: **Linguistische Studien/ZISW/A. Heft 157**. Berlin 1987, 1-44.O. Buchholz, W. Fiedler: **Albanische Grammatik**. Leipzig 1987, 5-582.
O. Buchholz: literarische Uoersetzung "**Porträt eines großen Mannes**" (D. Agolli). In: "Ad libitum" Nr. 7, Berlin 1987, 258-269.
O. Buchholz: Rreth tautologjisë në shprehjen e determinativitetit ('Zur Tautologie beim Ausdruck der Determiniertheit'). In: **Gjurmime** Albanolog**jike 16-**1986. Prishtinë. 151-168.
O. Buchholz: Rreth bashkimeve të fjalëve me folje funksionale në gjuhën e sotme shqipe ('Zu Funktionsverbfügungen in der albanischen Gegenwartssprache'). In: **"Gjuha shqipe" Nr. 2**. Prishtinë 1987, 40-48.
O. Buchholz: Për rolin e Eqrem Çabejt në fushën e ballkanistikës ('Zur Rolle Eqrem Çabejs auf dem Gebiet der Balkan Iinguistik'). a) In: **Gjurmime Albanologjike 17-**1987. Prishtinë 1988, 33-39. b) In: **Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën ... XIII**. Prishtinë 1988, 169-173.
O. Buchholz: Përdorimi i nyjave të gjunëve ballkanike në shkallëzimin e mbiemrave ('Die Verwendung der Artikel in den Balkansprachen bei der Steigerung der Adjektive') In: **Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën ... XIII**. Prishtinë 49-55.
O. Buchholz: literarische Übersetzung moderner albanischer Dichtung aus Kosovo. In: **"Zieh dich zurück in den Vers Homers".** Prishtinë 1988, 3-123.
O. Buchholz, W. Fiedler: literarische Ubersetzung **"Die Schleierkarawane"** (I. Kadare). a) Berlin 1988, 5-182. b) Kiel 1989, 5-219.
O. Buchholz: Zu äquativischen Konstruktionen in den Balkansprachen. In: **Linguistische Studien/ZISW/A. Heft 192**. Berlin 1939, 1-45.
O. Buchholz: Zum Ausdruck von Elativität in den Balkansprachen. In: **Linguistische Studien/ZISW//A. Heft 192**. Berlin 46-69.
O. Buchholz: Zu Konstruktionen mit unpersönlich gebrauchtem "haben" in den Balkansprachen. In: **ZPSK Band 42, Heft 3.** Berlin 1989, 331-340.
O. Buchholz: literarische Übersetzung "Lebe wohl, mein Hauptmann!" (D. Agolli). In**:"Der letzte Hügel".** Berlin 1989, 206-237.
O. Buchholz: Lexikonartikel zu literarischen werken
a) D. Agolli "Kommissar Memo" (S. 278)
b) J. De Rada "Lieder des Milosao" (S. 480)
c) N. Frashëri "Die Geschichte Skanderbegs" (S. 589)
d) I. Kadare "Der General der toten Armee" (S. 188)

e) P. Marko "Hasta la vista" (S. 150)
f) E. Mekuli "Die Ufer" (S. 77)
g) Migjeni "Freie Verse" (S. 728)
h) Dh. Shuteriqi "Die Befreier" (S. 443)
i) S. Spasse "Sie waren nicht allein" (S. 399)
j) J. Xoxa "Der tote Fluß" (S. 376)
In: **Bncyklopédia literárnych diel**. Bratislava 1989.

O. Buchholz: Konstruksione të arbërishtes me mbiemra në komparativ dhe në Superlativ - Construtti della lingua arbëreshe con aggettivi al comparativo e al superlativo ('Konstruktionen des Italoalbanischen mit Adjektiven im Komparativ und Superlativ'). In: **Le minoranze etniche e linguistiche -** Atti **del 2°** Congresso **Internazionale. I**. Palermo 1989, 277–298.

O. Buchholz, W. Fiedler: Lexikonartikel zur albanischen Literatur:
a) albanische Diaspora (S. 21-22)
b) albanische Literatur in Jugoslawien (S. 22–24)
c) Bejtexhinjtë (S. 57–58)
d) Drita (S. 79–30)
e) italoalbanische Literatur (£. 133-135)
f) Jeta e Re (S. 138)
g) Literatur des albanischen katholischen Nordens (S. 170)
h) Nëntori (S. 243)
i)Rilindja Kombëtare Shqiptare (S. 280–282)
j) Schule von Voskopoja (S. 302–303)
k) Skanderbeg-Tradition (S. 311)
- Beteiligung an Kollektivartikeln (S. 176 ff., 204 ff., 236 270 ff., 284 ff., 319 ff.)
In: **BI-Lexikon "Literaturen Ost- und Südosteuropas".** Leipzig 1990.

O. Buchholz, W. Fiedler: literarische Übersetzung (Nachauflage) **"Der General der toten Armee"**, Roman von Ismail Kadare München 1990* im Druck befindlich

O. Buchholz, W. Fiedler: Überblick über die albanische Literatur von den Anfängen bis zur Gegenwart. - In: **Geschichte der Weltliteratur**. Bratislava. Ms. 25 S.

O. Buchholz, W. Fiedler: literarische Übersetzung **"Glanz und Fall des Genossen Zylo"**, Roman von Dritëro Agolli. Ms. 335 S., erscheint in Kiel.

O. Buchholz: Zum Ausdruck eines möglichst hohen Grades und eines stetig ansteigenden Grades in den Balkansprachen. - erscheint in **"Zeitschrift für Balkanologie"**. Ms. 30 S.

KRONIKA 2013
(Aktivitete shkencore, ekspozita, vizita, përvjetorë, ligjërata, përurime…)

TAKIM SOLEMN ME ANËTARËT E RINJ TË RREGULLT DHE KORRESPONDENTË TË ASHAK-UT

Në mjediset e Akademisë më 10 janar 2013 u mbajt takimi solemn me anëtarët e rinj të zgjedhur në zgjedhjet e fundit, të rregullt (akademikët) dhe korrespondentë të Akademisë. Në takim morën pjesë edhe shumica e anëtarëve të rregullt (akademikëve). Takimin e hapi kryetari i Akademisë akademik Hivzi Islami.

KONCERT SOLEMN NË 5-VJETORIN E PAVARËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, përkatësisht Seksioni i saj i Arteve, kushtuar 5-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, organizuan më 15 shkurt 2013, në mjediset e ASHAK-ut koncert solemn, në të cilin morën pjesë akademikë, pedagogë e studentë të artit, personalitete të shquara të muzikës nga Shqipëria si Avni Mula dhe Zhani Ciko si dhe përfaqësues të mediave. Koncertin e shpalli të hapur Kryetari i Akademisë akademik Hivzi Islami. Në vazhdim: Luan Durmishi, tenor, Arta Jashari, soprano, Besa Llugiqi, soprano, Lule Ballata, pikolo flaut, Ardiana Bytyqi, mexosoprano, Astrit Mustafa, (bas) klarinetë, Ergin Brahimi, bariton, Lirika Pula, piano, Pranvera Hoxha, piano, Riad Ymeri, tenor, me dirigjent akademik Zeqirja Ballatën, realizuan programin e paraparë.

LIGJËRATË INAUGURUESE E AKADEMIK KOLEC TOPALLIT ANËTAR I JASHTËM I ASHAK-ut

Me ftesë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Kolec Topalli, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,më 28 shkurt 2013 ka mbajtur ligjëratën inauguruese me temë: *Disa rezultate në studimin e zhvillimit historik të gjuhës shqipe.*

Në praninë e anëtarëve të Akademisë, profesorëve universitarë, mediumeve dhe të interesuarve të tjerë , fjalën e rastit e mbajti kryetari i Akademisë, akademik Hivzi Islami.

AKADEMIK NEXHAT DACI NË KONFERENCËN E AKADEMIVE TË DANUBIT (4 th Danube Conference)

Më 9-10 prill 2013 akademik Nexhat Daci ka përfaqësuar ASHAK-un në Konferencën e organizuar nga Akademia Rumune me titull *Science and European Danube Strategy* . Profesor Daci në Konferencën e lartëpërmendur ka marrë pjesë me punimin *Impacts of Thermo Power Plants Pollution on Human Biochemical Blood Parameters-Kosova Case.*

LIGJËRATË INAUGURUESE E AKADEMIK ALAJDIN ABAZIT ANËTAR I JASHTËM I ASHAK-ut

Me ftesë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Alajdin Abazi, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë dhe anëtar i jashtëm

i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,më 24 prill 2013 ka mbajtur ligjëratën inauguruese me temë: *Konceptet e rrjetave energjetike inteligjente dhe kualiteti i fuqisë.*

Në praninë e anëtarëve të Akademisë, profesorëve universitarë, mediumeve dhe të interesuarve të tjerë , fjalën e rastit e mbajti kryetari i Akademisë, akademik Hivzi Islami.

LIGJËRATË INAUGURUESE E ANËTARIT KORRESPONDENT ARSIM BAJRAMI

Në mjediset e Akademisë, më 15 maj 2013 anëtari korrespondent Arsim Bajrami mbajti ligjëratën inauguruese me temën : Argumentimi kushtetues juridik i pavarësisë së Kosovës dhe vendimi i GJND-së. Fjalën e hapjes më këtë rast e mbajti sekretari i Seksionit të Shkencave Shoqërore akademik Mark Krasniqi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit tha se ligjërata inauguruese po mbahet me rastin e zgjedhjes së Prof. Bajramit anëtar korrespondent i ASHAK.

PËRUROHET VEPRA E AKADEMIK ESAT STAVILECIT "TË SHKRUARIT DHE TË MENDUARIT JURIDIK"

Në praninë e anëtarëve të Akademisë, profesorëve universitarë , të interesuarve të tjerë, mediumeve më 20 maj 2013 në mjediset e Akademisë u përurua libri i akademik Esat Stavilecit "Të shkruarit dhe të menduarit juridik". Fjalën e hapjes me këtë rast e mbajti sekretari i Seksionit të Shkencave Shoqërore akademik Mark Krasniqi. Më pas fjalë e mori recensenti i librit akademik Pajazit Nushi, pastaj dr. Blerim Reka.

AKADEMIK REXHEP FERRI NDEROHET ME ÇMIMIN "PERSONALITET I SHQUAR (në fushën e artit)"

Akademik Rexhep Ferri, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, është nderuar nga Këshilli i Qarkut Kukës, me titullin "Personalitet i shquar (në fushën e artit)", me motivacionin: "Për afirmimin e vlerave të Qarkut Kukës, nëpërmjet veprimtarisë së tij artistike dhe akademike në fushën e pikturës dhe krijimtarisë letrare". Fletdëshmia i është dorëzuar në një ceremoni rasti dhe pritje madheshtore nga Kryetari i Qarkut Kukës zoti Ibsen Elezi, më 8 maj 2013 .

LIGJËRATË INAUGURUESE E ANËTARIT KORRESPONDENT RUZHDI PLLANA

Në mjediset e Akademisë, më 4 qershor 2013 anëtari korrespondent Ruzhdi Pllana mbajti ligjëratën inauguruese me temën: „Karakteristikat morfo-hidrologjike të karstit të Kosovës''. Fjalën e hapjes më këtë rast e mbajti sekretari i Seksionit të Shkencave të Natyrës akademik Fejzullah Krasniqi.

MBAHET TRYEZA SHKENCORE ME TEMË: *Letërsia shqipe në shkrimet enciklopedike*

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës organizoi tryezën shkencore me temë: "Letërsia shqipe në shkrimet enciklopedike". Tryeza u mbajt më 7 qershor 2013, në mjediset e Akademisë. Në Tryezë morën pjesë: anëtarë të ASHAK-ut, profesorë universitarë, punonjës të Institutit albanologjik , përfaqësues të mediave dhe të interesuar të tjerë. Tryezën e hapi me një fjalë rasti akademik Mehmet Kraja, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Në vazhdim kontributet e tyre i paraqitën: Ali Aliu, Sabri Hamiti, Dhurata Shehri, Ardian Marashi, Fatmir Sylejmani, Floresha Dado, Bashkim Kuçuku, Kujtim M. Shala, Ymer Çiraku, Shaban Sinani, Nehas

Sopaj, Persida Asllani, Stefan Çapaliku, Vjollcë Berisha, Nysret Krasniqi, Laura Smaqi, Kastriot Gjika, Salajdin Saliu.

NËNSHKRUHET PROTOKOLLI I RI I BASHKËPUNIMIT MIDIS AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË DHE **AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS**

Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës në zbatim të Marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor dhe artistik të vitit 2000, nënshkruan në Tiranë (në mjediset e ASHSH-së) më 13 qershor 2013, Protokollin e bashkëpunimit për vjetët 2013-2015. Protokolli u nënshkrua nga Akademik Salvator Bushati, sekretar shkencor i ASHSH-së dhe Akademik Isuf Krasniqi, sekretar i përgjithshëm i ASHAK-ut. Në ceremoninë e nënshkrimit morën pjesë: akademik Gudar Beqiraj, kryetar, akademik Muzafer Korkuti, zëvendëskryetar, akademik Salvator Bushati, sekretar shkencor, akademik Jorgo Bulo, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike, akademik Dhimitër Haxhimihali kryetar i Seksionit te Shkencave Natyrore e Teknike dhe akad.asoc. Efigjeni Kongjika, sekretare e Seksionit te Shkencave Natyrore e Teknike, akademik Pajazit Nushi, nënkryetar, akademik Isuf Krasniqi, sekretar i përgjithshëm, znj. Lendita Pula, sekretare e Akademisë .

PËRUROHET VEPRA E DR. ARSIM EJUPIT "LUGINA E PRESHEVËS- STUDIM KOMPLEKS GJEOHAPËSINOR ''

Në mjediset e ASHAK më 19 qershor 2013 u përurua vepra e Dr. Arsim Ejupit me titull: *''Lugina e Preshevës- studim komlpeks gjeohapësinor''*. Fjalën e hapjes më këtë rast e mbajti anëtari korrespondent Jusuf Bajraktari. Pastaj për vlerat e librit folën: Akademik Pajazit Nushi dhe akademik Hivzi Islami. Në fund autori i veprës dr.Arsim Ejupi falenderoi Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës që ia dha mundësinë e botimit veprës së tij.

KRYETARI I ASHAK-UT VIZITON AKADEMINË BULLGARE TË SHKENCAVE

Në vazhdën e vizitave të ndërsjella, të mbështetura në Marrëveshjen për bashkëpunim shkencor dhe artistik midis Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Bullgarisë, nga data 20-21 qershor në Sofie qëndruan Kryetari i ASHAK-ut, akademik Hivzi Islami, akademik Rexhep Ismajli dhe akademik Eqrem Basha. Vizita u realizua me ftesë të Akademisë së Shkencave të Bullgarisë për diskutimin e bashkëpunimit të mëtejmë shkencor dhe artistik në vitin që vjen, si dhe për realizimin e pikave të mbetura nga programi i mëhershëm.

MBAHET TRYEZA SHKENCORE ME TEMË: *Depërtimi dhe përshtatja e huazimeve angleze në gjuhën shqipe'*.

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës organizoi tryezën shkencore me temë: "Depërtimi dhe përshtatja e huazimeve angleze në gjuhën shqipe". Tryeza u mbajt më 27 qershor 2013, në mjediset e Akademisë. Në Tryezë morën pjesë: anëtarë të ASHAK-ut, profesorë universitarë, punonjës të Institutit albanologjik, përfaqësues të medieve dhe të interesuar të tjerë. Tryezën e hapi akademik Mehmet Kraja, ndërsa kontributet e tyre i paraqitën: Rexhep Ismajli, Vesel Nuhiu, Jani Thomai, Bardh Rugova, Shykrane Gërmizaj, Jashar Kabashi, Arta Toçi, Valter

Memisha, Linditë Sejdiu-Rugova, Agron Duro, Drita Kadriu, Nebi Caka, Irena Pata Kapo, Muhamet Hamiti, Shkumbin Munishi, Albana Ndoja, Dieter Nehring.

PËRUROHET VEPRA E PLOTË E ALI PODRIMJES

Më 5 korrik 2013, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u bë paraqitja e botimit *të veprës së plotë të poetit dhe akademikut Ali Podrimja.* Me këtë rast folën akademik Mehmet Kraja, Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, akademik Hivzi Islami, Kryetar i ASHAK-ut, akademik Ali Aliut dhe akademik Rexhep Ismajli. Të pranishëm ishin znj. Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës, z. Ramë Buja, Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Memli Krasniqi, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, familja e poetit Podrimja, anëtarët e Akademisë dhe shumë të ftuar të tjerë.

KRYETARI I FEDERATËS SË AKADEMIVE EVROPIANE VIZITON ASHAK-un

Kryetari i Federatës së Akademive Evropiane (All European Academies - ALLEA), prof. dr. Günter Stock ka qëndruar për vizitë zyrtare në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 29-30 gusht. ALLEA është federatë e 55 akademive të shkencave dhe të arteve nga pothuaj të gjitha vendet e Evropës, 40 prej tyre anëtare të Këshillit të Evropës. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës është anëtare e ALLEA-s që nga viti 2004. Më 29 dhe 30 gusht, Kryetari i ALLEA-s është pritur nga Kryetari i ASHAK, akademik Hivzi Islami, me bashkëpunëtorë dhe ka zhvilluar vizita e takime njohëse me anëtarë të tjerë të ASHAK-ut. Z. Islami e ka njoftuar z. Stock me punën dhe veprimtarinë e Akademisë dhe me projekte të veçanta shkencore e hulumtuese që realizohen nga anëtarët dhe bashkëpunëtorët e Akademisë. Akademik Hivzi Islami, Kryetar i ASHAK-ut e njoftoi Kryetarin e ALLEA-s për rrugën e zhvillimit të akademisë dhe për synimet e saj në të ardhmen, për përpjekjet për ta ruajtur autonominë, etj. Dr. Shtok tha se sfidat e sotme nuk dallojnë shumë nga sfidat e djeshme, siç është globalizmi, energjia, ambienti, etj. Akademitë sot duhet të bashkohen për të përballuar këto sfida, theksoi ai. Kryetari i ALLEA-s përkujtoi se në disa vende të Evropës ka pasur përpjekje nga pushteti për të ndikuar në procesin e zgjedhjes së anëtarëve të akademive apo të udhëheqjeve të tyre, apo në imponimin e rregullave të paracaktuara nga pushteti. Ai e ilustroi këtë me rastin e Turqisë, ku po hartohet një ligj i ri për akademinë, i cili, siç tha Dr. Shtok, mund të cenojë pavarësinë e akademisë. "Ne i kemi shkruar presidentit Gyl dhe kemi shprehur shqetësimin tonë. Deri më tash nuk kemi marrë ndonjë përgjigjje nga presidenti për shqetësimin tonë, por letra jonë ka hasur në reagime të fuqishme pozitive të institucioneve të shkencës e dijes dhe të shoqërisë civile", tha ai. "Tani e kemi edhe rastin e Akademisë së Rusisë, njërës ndër akademitë më të vjetra të Evropës. Edhe atje presidenti Putin po harton një ligj për akademinë, me të cilin ajo mund të vihet nën kontrollin e politikës dhe të pushtetit. Ne do të shkojmë në Moskë dhe do të përpiqemi të bindim autoritetet ruse se pa autonomi të akademisë nuk ka dije", thekoi Shtok. Kryetari i ALLEA-s, Gynter Shtok, ka folur edhe për një numër aspektesh të rëndësishme për promovimin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe dijes së kosovarëve. Ai ka falenderuar në veçanti Akademik Rexhep Ismajlin për punën e tij në zgjerimin e bashkëpunimit me akademitë evropian dhe kontributin e tij për realizimin e vizitës së tij në Prishtinë.

TRAJNIMI PËR FJALORIN ENCIKLOPEDIK

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, përkatësisht Redaksia Qendrore e FEK-ut ka organizuar Takim pune për Fjalorin Enciklopedik të Kosovës në Durrës nga 19 - 22 shtator 2013. Në takim kanë marrë pjesë: Bordi i Fjalorit Enciklopedik të Kosovës, Redaksia Qendrore e Fjalorit dhe redaktorët e fushave përkatëse të FEK-ut, me përjashtim të ndonjë zëvendësimi të tyre nga një anëtar i redaksisë përkatëse.

Takimi është realizuar sipas programit të paraparë.

ASHAK PREZANTON BOTIMET E VETA NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR ''FRANKFURTI 2013''

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës është prezantuar më botimet e veta në Panairin Ndërkombëtar "Frankfurti 2013" që është mbajtur nga data 9-13 tetor. Me 11 tetor 2013, gazeta Zëri në portalin e saj (shih artikullin: http://www.zeri.info/artikulli/17312/kosova-megjithate-dinjitoze-ne-panairin-e-librit-ne-frankfurt) raporton se paraqitja e botuesve kosovar ka qenë dinjitoze. "Botuesit si ASHAK, Instituti Albanologjik, Instituti i Historisë, Koha, Buzuku, Dukagjini etj. e arsyetojnë pjesëmarrjen dhe të arriturat në fushën e librit në Kosovë, e cila mund të quhet megjithatë e suksesshme dhe dinjitoze!"

PËRUROHET EDHE NË TIRANË VEPRA E PLOTË E ALI PODRIMJES

Pas përurimit në Prishtinë *vepra e plotë e Ali Podrimjes* u përurura edhe në Tiranë. Përuruimi u organizua nga Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe u mbajt më 10 tetor 2013, ora 18:00 në mjediset e hotelit Tirana International. Solemnitetin e hapi dhe e moderoi shkrimtari Zija Çela, ndërsa për akademik Podrimjen dhe veprën e tij folën ministrja e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Mirela Kumbaro, Bashkim Kuçuku, Visar Zhiti, Ali Aliu dhe Rexhep Ismajli. Në përurim nga Akademia jonë morën pjesë edhe akademik Mehmet Kraja, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisië dhe znj. Lendita Pula, sekretare e Akademisë, si shumë të ftuar të tjerë në mesin e të cilëve akademikë, shkrimtarë të njohur, profesorë universitarë, adhurues të shumtë të poezisë së akademik Podrimjes, si dhe përfaqësues të mediave.

ANËTARJA KORRESONDENTE E ASHAK EDI SHUKRIU MERR PJESË NË TAKIMIN E I TË KOMITETEVE NACIONALE TË EVROPËS JUGLINDORE TË ICOMOS.

Më 10-13 tetor 2013 anëtare korrspondente Edi Shukriu ka qëndruar në Vjenë për të marrë pjesë në Takimin I të Komiteteve Nacionale të Evropës Juglindore të ICOMOS, organizatës për trashëgimi kulturore. Tema e takimit ka qenë Bashkëpunimi rajonal-trashëgimi e përbashkët dhe thesar në rajonin e Evropës. Takimi është bazuar në programet e Unionit Evropian për trashëgimi kulturore (Programi kulturor 2014-2020) dhe ICOMOS-Grupit të Europës (qershor 2011) me të cilat mundësohet bashkëpunimi shkencor i anëtarëve të ICOMOS në rajon. Në takim është pranuar edhe bashkëpunimi me shkencëtarët e Kosovës dhe është rekomanduar themelimi i Komitetit nacional të Kosovës, si në vendet e tjera në rajon dhe në botë.

MSC. ARDIAN GOLA PËRFAQËSON ASHAK-un NË PODGORICË

Më 16-18 tetor 2013, msc. Ardian Golan në emër të ASHAK-ut ka marrë pjesë në Konferencën ndërkombëtare me titull: Young Scientists and Science in the Region. Z. Gola në Konferencë, është paraqitur me temën Research practices in Kosova-Challenges in Humanities and Social Sciences.

PËRUROHET MONOGRAFIA TAHIR EMRA

Në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 23 tetor 2013 u përurua Monografia Tahir Emra, me autor Kujtim Buza, artist i merituar. Për botimin folën: sekretari i Seksionit të Arteve akademik Zeqirja Ballatadhe Kujtim Buza, artist i merituar.

DELEGACIONI I AKADEMISË SË SHKENCAVE TË BULLGARISË VIZITON ASHAK-un

Më 24 tetor 2013 Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës e vizitoi delegacioni i Akademisë së Shkencave të Bullgarisë përkatësisht kryetari i saj akademik Stefan Vodenicharov, D. sc. dhe sekretarja e përgjithshme shkencore prof. Evdokia Pasheva D. sc. Delegacionin në orët e pasditës e priti Kryetari i ASHAK-ut, akademik Hivzi Islami me bashkëpunëtorë. Më 25 tetor 2013, për nder të mysafirëve u mbajt mbledhje solemne e Kyesisë së Akademisë , me çrast anëtarët e saj njoftuan më për së afërmi me punën dhe veprimtarinë e Akademisë së Shkencave të Bullgarisë. Po këtë ditë në Amfiteatrin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Kryetari Vodenicharov mbajti një ligjëratë. Të pranishëm me këtë rast ishin edhe ambasadori i Bullgarisë z. Bobi Bobev dhe të ftuar të tjerë.

MBAHET KONFERENCA SHKENCORE *Energjetika dhe mjedisi për zhvillim të qëndrueshëm*

Seksioni i Shkencave të Natyrës i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës organizoi Konferencën shkencore me titull: "Energjetika dhe mjedisi për zhvillim të qëndrueshëm". Konferenca u mbajt më 30 tetor 2013 në mjediset e ASHAK. Në të morën pjesë: anëtarë të ASHAK-ut, ministri i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë z.Ramë Buja, rektori i Universitetit të Prishtinës z. Ibrahim Gashi, z. Ramush Haradinaj, profesorë universitarë, përfaqësues të mediave dhe të interesuar të tjerë. Konferencën e hapi akademik Fejzullah Krasniqi, e përshëndeti dr. Ramë Buja, Ministër i Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, i cili përshëndeti edhe në emër të Kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi.

ASHAK PREZANTON BOTIMET E VETA NË PANAIRIN E 16 TË LIBRIT TIRANA 2013.

Nga data 13 deri 17 nëntor, në Tiranë është mbajtur Panairi i 16-të i librit Tirana 2013. Në mesin e rreth 90 shtëpive botuese, institucioneve shkencore dhe arsimore nga Shqiptaria, Kosova dhe Maqedonia, përfshirë ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikë dhe Francës si dhe Përfaqësia e BE-së në Shqipëri, me botimet e veta është paraqitur edhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

MBAHEN NË PRISHTINË MBLEDHJET E KRYESISË DHE TË KËSHILLIT NDËRAKADEMIK PËR GJUHËN SHQIPE

Më 6 dhjetor 2013 në Prishtinë, në mjediset e Qendrës Leksikografike-Enciklopedike të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u mbajt mbledhja e radhës e Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe. Mbledhja u mbajt nën drejtimin e akademik Rexhep Ismajlit dhe akademik Jani Thomait (bashkëkryetarë) me pjesëmarrjen e: akademik Besim Bokshit, akademik Ethem Likajt, akademik Gjovalin Shkurtajt, akademik Kolec Topallit, prof. dr. Tomor Osmanit, prof. dr. Seit Mansakut, prof dr. Imri Badallajt, prof. dr. Enver Hysës, prof. dr. Bardh Rugovës, prof. dr. Shefkije Islamajt, prof. dr. Abdullah Zymberit dhe Isa Bajçincës. Në pamundësi për të marrë pjesë vetë diskutimet lidhur me materialet e dër-guara paraprakisht i kishin dërguar me shkrim prof. dr. Franko Altimari dhe prof. dr. Mehmet Çeliku. Mbledhja u mbajt sipas rendit të ditës të parashtruar më herët. Pikë qendrore e rendit të ditës ishte diskutimi i materialeve të përgatitura nga komisionet për çështje të morfologjisë në Tiranë dhe në Prishtinë. Komisionet kishin përmbledhur në dy materiale të ndara me detaje dhe lëndë ilustrimi pikat në rregullat ekzistuese të drejtshkrimit për të cilat ka pasur diskutime në opinion ose ato për të cilat anëtarët e Komisioneve e kanë gjykuar të nevojshme të diskutohet. Materialet e paraqitura me shkrim u diskutuan për çdo pikë veç e veç dhe me frymë të theksuar mirë-kuptimi. Pasi u dëgjuan të gjitha diskutimet Këshilli arriti këto përfundime:

1. Pas diskutimeve për format e shumësit të disa emrave të gjinisë mashkullore që mbarojnë me -i të theksuar të sanksionuar si shumësa me -nj, u arrit përfundimi të propozohet që këta shumësa të përfundojnë me -j. Këtu përfshihen rrjedhojat që në temë kanë një shumës të tillë;

2. U miratua propozimi që te foljet që pësojnë ndryshimin -t/-s të mbetet normative vetëm forma me -s;

3. U miratua propozimi që forma e rasës kallëzore të shquar tek emrat që mbarojnë me -ua: krua, kroi të rrafshohet sipas tipit të përgjithshëm të ndërtimit të këtyre formave të emrave mashkullorë, pra krua-kroi-kroin, ashtu si dhe trajta e kallëzores së shquar të emrave mashkullorë që dalin me -a ose -e të theksuar (again, babain, jubileun, atdheun);

4. U konsideruan si gabime prirjet në përdorim të formave të zhdrejta të përemrave pronorë të gjinisë femërore ime, jonë, jote dhe juaj si vajzës time, vajzës tonë, vajzës tënde, vajzës tuaj dhe kërkohet respektimi i normës ekzistuese, pra vajzës sime, vajzës sate, vajzës sonë, vajzës suaj;

5. Përdorimi i trajtave të lidhores pa formantin të (p.sh. do laj) konsiderohet shkelje e normës; formë e vetme e drejtë konsiderohet forma me të: do të laj;

6. Tek urdhërorja joveprore e foljeve të tipit kruaj, ruaj duhet të mbetet normative forma me -j (ruaju, kruaju), dhe jo me -h (kruhu, ruhu);

7. Rastet e tjera të sistemit emëror dhe foljor, të cilat mund të dalin me zgjidhje të veçanta, mbetet të studiohen dhe të diskutohen në mbledhjen e radhës të Këshillit, bashkë me çështjen e përdorimit të shkronjës së madhe;

8. U arrit përfundimi që të mos mbështetet prirja për respektimin e ambigjinisë tek emrat shumës më -ra (fshatra të elektrizuara, ujëra të ftohta) dhe të konsiderohet si normative vetëm forma e gjinisë mashkullore (fshatra të elektrizuar, ujëra të ftohtë).

9. U vendos që në mbledhjen e radhës të Këshillit të merren në shqyrtim çështjet e mbetura nga kjo mbledhje dhe nga mbledhja e kaluar, e që lidhen me drejtshkrimin dhe me morfologjinë, si dhe ato që do të propozojnë grupet e punës për çështje sintaksore.

ANËTARI KORRESPONDENT SALIH GASHI MERR PJESË NË TAKIMIN VJETOR TË GRUPI PUNUES PËR SHKENCË DHE EDUKIM TË ALLEA-s

Më 19-21 nëntor anëtari korrespondent i ASHAK ka qëndruar në Dublin, me ç'rast ka marrë pjesë në takimin vjetor të grupi punues për shkencë dhe edukim të ALLEA-s. Profesor Gashi ka prezantuar në takim të arriturat dhe projektet që janë zhvilluar dhe janë në zhvillim e sipër në institucionet e Kosovës.

TRYEZA SHKENCORE "Punësimi në kontekstin zhvillimor dhe integrues të Kosovës".

Seksioni i Shkencave Shoqërore i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës organizoi tryezën shkencore me temë: "Punësimi në kontekstin zhvillimor dhe integrues të Kosovës ". Tryeza u mbajt më 27 dhjetor 2013, në mjediset e Akademisë. Në Tryezë morën pjesë: anëtarë të ASHAK-ut, profesorë universitarë, përfaqësues të institucioneve të ndryshme, përfaqësues të mediave dhe të interesuar të tjerë. Tryezën e hapi akademik Mark Krasniqi. Në vazhdim kontributet e tyre i paraqitën: Isa Mustafa, Muhamet Mustafa, Lumir Abdixhiku, Premton Hyseni, Venera Demukaj, Dr. Avdullah Hoti, Dr. Besnik A. Krasniqi, Hafiz Leka, Ymer Havolli.

Lendita Juniku – Pula

PËRMBAJTJA - CONTENT

SHËNIM I REDAKSISË – EDITORIAL NOTE 5

PËRVJETORË – ANNIVERSARIES 9

Rexhep Ismajli: Në traditën e madhe të albanologjisë gjermane 11

Profesor Dr. Wilfried Fiedler, München-Berlin-Jena: Botimet shkencore - Wissenschaftliche Publikationen. *Gjendja - Stand: 18.12.2013* 20

ARTIKUJ – PAPERS 33

Victor A. Friedman, Chicago: Shumësi turk *-lv₂r (-lar/-ler)* në gjuhën shqipe dhe në kontekstin ballkanik 35

Giuseppina Turano, Università di Venezia: Nga teoria e parimeve dhe e parametrave tek teoria e minimalizmit: Fraza kauzative 47

Teuta Abrashi, Prishtinë: A ka fjali njëgjymtyrësh (pa kryefjalë) në gjuhën shqipe? Refleksion rreth sintaksës së Mehmet Çelikut 59

Sahadete Limani - Beqa, Prishtinë: Metodologjia e analizës kritike të diskursit për kërkimet në fushën e transformimeve shoqërore-politike. Një vështrim kritik 85

Blertë Ismajli, Prishtinë: Format foljore në shqipen: Mënyrë, folje modale, kohë? ..... .97

Ina Arapi, Vjenë: Mësimi i gjuhës shqipe në Universitetin e Vjenës (fundi i shek. XIX - 2010) 107

Mehmet Halimi, Prishtinë: Mbi disa togje bashkëtingëlloresh në të folmen e Karadakut 145

Anton Berishaj, Prishtinë: Semio–etika e letërsisë së ekzistencës negative 161

Kujtim M. Shala, Prishtinë: Tekstet pa kontekste 181

Shaban Sinani, Tiranë: "Malli i shtampësë" si mit iluminist 193

DEPËRTIMI DHE PËRSHTATJA E HUAZIMEVE ANGLEZE NË GJUHËN SHQIPE 211

Rexhep Ismajli, Prishtinë: Pse të shtrohet tani dhe këtu një tematikë e këtillë?..... 213

Vesel Nuhiu, Prishtinë: Depërtimi dhe përdorimi i elementeve gjuhësore të huaja në gjuhën shqipe 221

Jani Thomai, Tiranë: Anglicizmat në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe 227

Shykrane Gërmizaj, Prishtinë: Sfidat dhe rezultatet e kontakteve të shqipes me anglishten 237

Jashar Kabashi, Prishtinë: Depërtimi i pakontrolluar i anglicizmave – sfidë për gjuhën shqipe 249

Arta Toçi, Tetovë: Anglicizmat në mediat elektronike në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni 261

Valter Memisha, Tiranë: Depërtimi i emërtimeve të shkurtuara në shqipe prej anglishtes 271

Linditë Sejdiu - Rugova, Prishtinë: Përshtatja e trajtave foljore të gjuhës angleze në gjuhën shqipe 281

Agron Duro, Tiranë: Për një fjalor të huazimeve angleze në shqipe 289

Nebi Caka, Prishtinë: Anglicizmat në terminologjinë teknike 297

Irena Pata Kapo, Tiranë: Anglicizmat në shtypin shqiptar pas 1990, vërshimi dhe sjellja e tyre në kontekstin shqiptar dhe në kushtet e globalizmit 307

Shkumbin Munishi, Prishtinë: Ndikimi i anglishtes në terminologjinë e legjislacionit ekonomik 321

Albana Deda (Ndoja), Tiranë: Identifikimi strukturor i hyrjeve të reja dhe lehtsitë kodifikuese të tij 335

Muhamet Hamiti, Prishtinë: Venerime për anglicizmat në shqip 345

LETËRSIA SHQIPE NË SHKRIMET ENCIKLOPEDIKE 349

Ali Aliu, Prishtinë: Funksioni enciklopedik i letërisisë 351

Sabri Hamiti, Prishtinë: Enciklopedia letrare 355

Dhurata Shehri, Tiranë: Zërat e lartë dhe zërat e mëdhenj të letërsisë shqipe 361

Ardian Marashi, Tiranë: Përfaqësimi shqiptar në "Encyclopædia universalis" (2012) 369

Fatmir Sulejmani (USHT), Tetovë: Letërsia shqipe në enciklopedinë maqedonase 377

Floresha Dado, Tiranë: Letërsia në botimet enciklopedike: Çeshtje përzgjedhjeje apo metodologji e vlerësimit historiko-estetik..... 385

Bashkim Kuçuku, Tiranë: Pak e njohur përtej vetes 391

Kujtim M. Shala, Prishtinë: Letërsi e enciklopedi..... 397

Ymer Çiraku, Tiranë: Letërsia shqipe si diversitet stilistik dhe klasifikimi (interpretimi) koheziv i saj (rasti i letërsisë arbëreshe) 403

Nehas Sopaj, Shkup: "The Princeton Encyclopedya of Poetry and Poetics" për poezinë shqipe..... 409

Persida Asllani, Tiranë: (Mos)koordinimi në *Fjalorin enciklopedik shqiptar* të ASHSH dhe zhdukja e modernizmit shqiptar 417

Vjollcë Berisha, Tetovë: 10 vështirësi të përfshirjes së letërsisë shqipe në botimet enciklopedike 427

Nysret Krasniqi, Prishtinë: Letërsia e Kosovës dhe enciklopedia..... 433

Laura Smaqi, Tiranë: Letërsia shqipe mes dy Luftërave Botërore në Fjalorin enciklopedik shqiptar të vitit 2008-2009..... 441

Kastriot Gjika, Tiranë: A është dija enciklopedike dije bashkëkohore... .447

Salajdin Salihi, Tetovë: Letërsia shqipe në Maqedoni në tekstet enciklopedike..... 453

RECENSIONE, SHËNIME – REVIEWS, NOTES 459

Xhavit Beqiri: Shefkije Islamaj*: Gjergj Fishta (gjuha dhe stili) I, II*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2012, ff. 453

R. Ismajli: Pararendësi. Përzgjedhje punimesh nga akademik Idriz Ajeti. Botimet Koha, Prishtinë, 2011, ISBN 978-9951-417-58-7, ff. 398..... 463

Linditë Sejdiu-Rugova: Vesel Nuhiu: *Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe***,** ASHAK, Prishtinë, 2013, Botime të veçanta, Libri 48, ff. 334, ISBN 978 9951 615 11 2..... 465

Ali Aliu: Alfred Uçi: *Estetika migjeniane. Studim monografik gjithëpërfshirës i veprës së Migjenit*. Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2013, ff. 610 467

Kujtim M. Shala: Ali Aliu: *Don Kishoti te shqiptarët*, ASHAK, Prishtinë, 2005, ff. 226 469

Bardh Rugova: Shkumbin Munishi: *Probleme të shqipes standarde në Kosovë*, ZeroPrint, Prishtinë, 2013, ff. 226 471

Albanë Mehmetaj: Dhurata Shehri: *Statusi i kritikës,* Botoi, Albas, Tiranë, 2013 473

Kujtim M. Shala: Ibrahim Rugova: *Teoria letrare - tekste të zgjedhura*, Fondacioni "Ibrahim Rugova", Prishtinë, 2013, f. 268 477

Albanë Mehmetaj: *Rugova i letërisë*, Fondacioni "Ibrahim Rugova", Prishtinë, 2012 479

Kujtim M. Shala: Nysret Krasniqi: *Sabri Hamiti*, botoi AIKD, Prishtinë, 2011, 565. 481

Kujtim M. Shala: Sabri Hamiti, *Zef Pllumi*, Albas, Tiranë, 2013, f. 72 .. 483

R. Ismajli: Oda Buchholz (1940-2014). In memoriam 485

Dr. sc. phil. Oda Buchholz: Listë e botimeve - Liste der Veröffentlichungen 491

Lendita Juniku - Pula: Kronika 2013 495

Përmbajtja 503

STUDIME

20

2013

Botues
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:
Mr. Shefqet Riza

Lektor për anglisht:
Hilmi Zogjani

Rezymetë anglisht i përktheu:
Hilmi Zogjani

Redaktor teknik:
ASHAK

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia:
31.68 tabakë shtypi

Tirazhi:
200 copë

Formati:
16x24 cm

U shtyp në shtypshkronjën:
Focus Print
Shkup